FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 199

Tiranë – E premte, 17 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017	Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".....	9551

VENDIM
Nr. 651, datë 10.11.2017

PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 102/2014, "KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" [1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 18, 19, 24, 26, 29, 35, 39 deri 42, 47, 51, 58, 62, 64, 71, 83, 94, 98, 100, 108, 115, 118, 119, pika 7, 123, 129, 133, 141, 145, 148, 149 deri 152, 153, pikat 1, 2 e 3, 154, 160 deri 169, 174 deri 177, 181, 184, 188, 190, 193, 196, 200, 202, 206, 209, 212, 226, 238, 240, 245, 248, 286, 287 dhe 288, të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU 1
Fusha e legjislacionit doganor, misioni i doganave dhe përkufizimet

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e më poshtëm kanë këto kuptime:

1. "**Masa të politikës bujqësore**", dispozitat që lidhen me aktivitete të importit e të eksportit për produktet e përmendura në pikat 1, 2 e 3, të aneksit 71-02, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

2. "**Carnet ATA**"**,** një dokument doganor ndërkombëtar për lejim të përkohshëm, i lëshuar në përputhje me Konventën ATA ose Konventën e Stambollit;

3. "**Konventa ATA**", konventa doganore për Carnet ATA, për lejimin e përkohshëm të mallrave, e nënshkruar në Bruksel, më 6 dhjetor 1961;

4. "**Konventa e Stambollit**", konventa për lejimin e përkohshëm, e nënshkruar në Stamboll, më 26 qershor 1990;

5. "**Konventa TIR**", Konventa Doganore mbi Transportin Ndërkombëtar të Mallrave nën mbulimin e Carnet TIR, bërë në Gjenevë, më 14 nëntor 1975.

6. "**Operacion TIR**", lëvizja e mallrave brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Konventën TIR;

7. "**MRN**" **(Numri kryesor i lëvizjes)**, numri i regjistrimit, i caktuar nga autoritetet doganore kompetente në deklaratat dhe njoftimet e referuara në pikat 9 e 14, të nenit 6, të Kodit, në operacionet e TIR ose për të provuar statusin doganor të mallrave shqiptare;

8. "**Dokument i vetëm transporti**", në kushtet e statusit doganor, një dokument transporti i lëshuar në Republikën e Shqipërisë, që mbulon transportimin e mallrave nga pika e nisjes, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, deri në pikën e destinacionit në këtë territor, nën përgjegjësinë e transportuesit që lëshon dokumentin;

9. "**Konventa për transitin e përbashkët**", konventa për një procedurë transiti të përbashkët;

10. "**Vend transiti i përbashkët**", çdo vend që është palë kontraktuese e konventës për procedurën e transitit të përbashkët;

11. "**Vend tjetër**", një vend ose territor jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

12. "**Carnet CPD**", një dokument doganor ndërkombëtar, që përdoret për lejimin e përkohshëm të mjeteve të transportit, i lëshuar në përputhje me Konventën e Stambollit;

13. "**Kodi**", ligji nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

14. "**Aeroport i Republikës së Shqipërisë**", çdo aeroport i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

15. "**Aeroport ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë**", çdo aeroport i Republikës së Shqipërisë, i autorizuar nga autoriteti kompetent për trafik ajror me vendet jashtë territorit doganor

[1] *Ky vendim përafron pjesërisht:*

- Rregulloren e Komisionit nr. 2015/2446, të 28 korrikut 2015, për sa u përket rregullave të detajuara në lidhje me dispozita të caktuara të Kodit Doganor të Bashkimit Evropian nr. 952/2013, Celex nr. 32015R2446; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 343, datë 29.12.2015. (OJ L 343, 29.12.2015, p. 1–557)

- Rregulloren Zbatuese nr. 2015/2447 të Komisionit, e datës 24 nëntor 2015, që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e disa dispozitave të Rregullores (BE) Nr. 952/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që ka miratuar Kodin Doganor të Bashkimit Evropian nr. 952/2013. Celex nr. 32015R2447. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 343, datë 29.12.2015. (OJ L 343, 29.12.2015, p. 558–893)

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit nr. 341/2015, që plotëson rregulloren 952/2013 lidhur me rregullat tranzitore për dispozita të caktuara të Kodit Doganor të Bashkimit, ku sistemet elektronike përkatëse nuk janë ende operacionale dhe për amendimin e Rregullores 2446/2015. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, (OJ L 69, 15.3.2016, p. 1–313)

të Republikës së Shqipërisë;

16. "**Fluturim brenda Republikës së Shqipërisë**", fluturimi pa asnjë ndalesë i një avioni ndërmjet dy aeroporteve të Republikës së Shqipërisë, i cili nuk niset apo përfundon në një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë;

17. "**Avionë biznesi apo turistikë**", avionë privatë, të destinuar për udhëtime, itinerari i të cilëve përcaktohet nga përdoruesi;

18. "**Port i Republikës së Shqipërisë**", çdo port detar, që ndodhet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

19. "**Zyrë doganore e nisjes**", zyra doganore ku pranohen deklaratat doganore që i vendosin mallrat nën regjimin e transitit;

20. "**Zyrë doganore e destinacionit**", zyra doganore ku mallrat e vendosura nën regjimin e transitit paraqiten për të mbyllur regjimin;

21. "**Zyrë doganore e hyrjes**", zyra doganore, e cila është kompetente për mbikëqyrjen doganore në vendin ku mjetet e transportit, që transportojnë mallin, arrijnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga një territor jashtë këtij territori;

22. "**Zyrë doganore e eksportit**", zyra doganore ku depozitohet deklarata e eksportit ose deklarata e rieksportit për mallrat që dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

23. "**Zyrë doganore e vendosjes nën regjim**", zyra doganore e treguar në autorizim për një regjim të posaçëm, siç referohet në pikën 1, të nenit 192, të Kodit, e autorizuar për lëshimin e mallrave për një regjim të posaçëm;

24. "**Zyrë doganore e paraqitjes**", zyra doganore kompetente për vendin ku janë paraqitur mallrat;

25. "**Zyra doganore e transitit**" nënkupton:

a) zyrën doganore kompetente të daljes nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, kur mallrat dalin nga ky territor në vazhdim të një operacioni transiti nëpërmjet kufirit me një territor jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshëm nga një vendi i transitit të përbashkët;

b) zyrën doganore kompetente të hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, kur mallrat kalojnë nga një territor jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në vazhdim të një operacioni transiti.

26. "**Numri RIOE**" **(numri RIOE (NUIS/NIPT**), një numër unik i regjistrimit dhe identifikimit të operatorëve ekonomikë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i caktuar nga autoriteti kompetent për një operator ekonomik ose për një person tjetër, në mënyrë që ta regjistrojë atë edhe për qëllime doganore;

27. "**Eksportues**" nënkupton:

a) personin e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i cili në kohën kur pranohet deklarata mban kontratën me marrësit në vendin tjetër dhe ka të drejtë për të përcaktuar se mallrat duhet të dërgohen në një destinacion jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) personin (individin) që mban mallrat që do të eksportohen, kur këto mallra ndodhen në bagazhin personal të tij;

c) në raste të tjera, personin e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i cili ka të drejtë për të përcaktuar se mallrat duhet të dërgohen në një destinacion jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

28. "**Parime të përgjithshme kontabiliteti**", parimet, të cilat janë të njohura sipas legjislacionit në fuqi;

29. "**Person (individ)**", personat fizikë natyrorë, të ndryshëm nga personat e tatueshëm që veprojnë si të tillë, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës në fuqi;

30. "**Udhëtar**", çdo person (individ), i cili:

a) hyn përkohësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ku, normalisht, nuk është rezident;

b) rikthehet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ku ai është normalisht rezident, pasi ka qenë përkohësisht jashtë këtij territori;

c) largohet përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku ai është normalisht rezident;

ç) largohet nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pas një qëndrimi të përkohshëm, pa qenë normalisht rezident atje.

31. "**Bagazh**", të gjitha mallrat që transportohen nga çfarëdo lloj mjeti, të lidhura me udhëtimin e ndonjë personi (individi);

32. "**Bagazhi i dorës/kabinës**", në rastin e udhëtimit në rrugë ajrore, bagazhi që personi (individi) merr me vete brenda dhe jashtë kabinës së avionit;

33. "**Bagazhi i regjistruar/hambarit**", në rastin e udhëtimit në rrugë ajrore, bagazhi që është kontrolluar në aeroportin e nisjes dhe nuk është në

dispozicion të personit (individit) gjatë fluturimit dhe as gjatë çdo ndalese;

34. "**Mallra të natyrës jotregtare**" nënkuptojnë:

a) mallrat që ndodhen në dërgesat e dërguara nga një person (individ) te një tjetër, ku dërgesa të tilla:

i. janë të një natyre rastësore;

ii. përmbajnë mallra ekskluzivisht për përdorim personal të marrësit ose të familjes së tij, të cilat, për nga natyra ose sasia nuk paraqesin interes tregtar;

iii. i janë dërguar marrësit nga dërguesi pa asnjë lloj pagese.

b) mallrat e përfshira në bagazhet personale të udhëtarëve, kur:

i. janë të një natyre rastësore;

ii. përbëhen, ekskluzivisht, nga mallra për përdorim personal të udhëtarëve apo familjeve të tyre ose nga mallra të destinuara si dhurata, natyra dhe sasia e të cilave nuk duhet të jetë e tillë që të mund të tregojë se ato janë duke u importuar apo eksportuar për qëllime tregtare.

35. "**Mallra në dërgesë postare**", mallrat, përveç artikujve të korrespondencës, të përfshira në një pako ose paketë postare, të përcjellë nën përgjegjësinë ose nëpërmjet një operatori postar, në përputhje me dispozitat e Konventës së Bashkimit Universal Postar, miratuar më 10 korrik 1984, nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

36. "**Operator postar**", një operator i vendosur në Republikën e Shqipërisë, që ofron shërbime ndërkombëtare të rregulluara nga Konventa Universale Postare;

37. "**Artikuj korrespondence**"**,** letrat, kartolinat, letrat me shkrim për të verbrit, si dhe materiale të shtypura/printuara, që nuk i nënshtrohen detyrimit të importit ose eksportit;

38. "**Afati për mbyllje**", periudha në të cilën mallrat e vendosura nën një regjim të posaçëm, përveç transitit, ose produktet e përpunuara duhet të vendosen nën një regjim doganor pasues, të shkatërrohen, të nxirren jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë apo të caktohen për përdorim të veçantë përfundimtar (*end-use*). Në rastin e përpunimit pasiv, afati për mbyllje nënkupton periudhën brenda së cilës mallrat e eksportuara përkohësisht mund të riimportohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në formën e produkteve të përpunuara dhe të çlirohen për qarkullim të lirë, me qëllim që të përfitojnë nga përjashtimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimet e importit;

39. "**Përpunim pasiv IM/EX**", importi paraprak i produkteve të përpunuara e të përftuara nga mallrat ekuivalente nën përpunimin pasiv përpara eksportit të mallrave që ato zëvendësojnë, referuar shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 201, të Kodit;

40. "**Përpunim pasiv EX/IM**", eksporti i mallrave shqiptare nën përpunimin pasiv, para importit të produkteve të përpunuara;

41."**Përpunim aktiv EX/IM**", eksporti paraprak i produkteve të përpunuara e të përftuara nga mallrat ekuivalente nën përpunimin aktiv para importit të mallrave që ato zëvendësojnë, referuar shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 201, të Kodit;

42. "**Përpunim aktiv IM/EX**", importi i mallrave joshqiptare nën përpunimin aktiv para eksportit të produkteve të përpunuara;

43. "**Produkte kryesore të përpunuara**", produkte të përpunuara, për të cilat është dhënë autorizim për përpunim aktiv;

44. "**Aktivitete marketingu**", në kontekstin e vlerësimit doganor, të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me reklamat, marketingun dhe promovimin e shitjes së mallrave në fjalë, dhe të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me garancitë e dhëna në lidhje me to;

45. "**Produkte dytësore të përpunuara**", produkte të përpunuara, të cilat përbëjnë një nënprodukt që duhet të rezultojë domosdoshmërisht nga operacioni i përpunimit, ndryshe nga produktet kryesore të përpunuara;

46. "**Magazinë doganore publike e tipit I**", një magazinë doganore publike, ku përgjegjësitë e referuara në pikën 1, të nenit 215, të Kodit, i përkasin mbajtësit të autorizimit dhe mbajtësit të regjimit;

47. "**Magazinë doganore publike e tipit II**", një magazinë doganore publike, ku përgjegjësitë e referuara në pikën 2, të nenit 215, të Kodit, i përkasin mbajtësit të regjimit;

48. "**Magazinë doganore publike e tipit III**", një magazinë doganore në të cilën veprojnë autoritetet doganore;

49. "**Zyrë doganore e mbikëqyrjes**" nënkupton:

a) në rastin e magazinimit të përkohshëm, siç referohet në titullin IV, të Kodit, ose në rastin e

regjimeve të posaçme, të ndryshme nga ai i transitit, siç referohet në titullin VII, të Kodit, zyrën doganore që përcaktohet në autorizim për të mbikëqyrur magazinimin e përkohshëm të mallrave ose regjimin e posaçëm në fjalë;

b) në rastin e deklaratës doganore të thjeshtuar, siç referohet në nenin 152, të Kodit, të zhdoganimit të centralizuar, siç referohet në nenin 163, të Kodit, ose të hyrjes në regjistrimet e deklaruesit, siç referohet në nenin 165, të Kodit, zyrën doganore që përcaktohet në autorizim për të mbikëqyrur vendosjen e mallrave nën regjimin doganor në fjalë.

50. "**Transbord**", ngarkimi ose shkarkimi i produkteve dhe mallrave nga bordi i një mjeti transporti në një mjet tjetër transporti;

51. "**Instalime fikse transporti**", mjete teknike që përdoren për transport të vazhdueshëm të mallrave të tilla si, energjia elektrike, gazi dhe nafta;

52. "**Mbeturina dhe mbetje**", nënkupton:

a) mallrat ose produktet, të cilat janë klasifikuar si mbeturina dhe mbetje/skrap, në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave;

b) në rastet e përpunimit aktiv ose të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*), mallrat ose produktet që dalin nga një operacion përpunimi, të cilat nuk kanë ose kanë një vlerë të ulët ekonomike dhe nuk mund të përdoren pa përpunim të mëtejshëm.

53. "**Paletë**", një pajisje në shtratin e së cilës mund të grumbullohet një sasi mallrash për të formuar një njësi ngarkese për qëllime transporti, trajtimi ose grumbullimi me ndihmën e pajisjeve mekanike. Kjo pajisje është e përbërë nga dy shtretër të ndarë, që lidhen me traversa, ose nga një shtrat i vetëm, që mbështetet mbi këmbët. Lartësia e saj e përgjithshme është reduktuar në minimum, në përputhje me trajtimin me vinça pirun ose kamiona për paleta. Ajo mund të ketë ose jo një superstrukturë;

54. "**Anije-fabrikë shqiptare**", një anije e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që mban flamurin shqiptar dhe që nuk kap produkte peshkimi, por që përpunon produkte të tilla në bord;

55. "**Anije/barka peshkimi shqiptare**", një anije/barkë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që mban flamurin shqiptar, që kap produkte peshkimi detar dhe që, sipas rastit, i përpunon ato në bord;

56. "**Shërbim i rregullt transporti detar**", një shërbim që transporton mallra në anije/barka që lundrojnë vetëm ndërmjet porteve të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk shkojnë, vijnë apo ndalojnë në ndonjë pikë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë apo në ndonjë pikë të një zone të lirë të një porti të Republikës së Shqipërisë;

57. "**Mallra identike**", në kontekstin e vlerësimit doganor, janë mallrat e prodhuara në të njëjtin vend, të cilat janë të njëjta në të gjitha pikëpamjet, duke përfshirë karakteristikat fizike, cilësinë dhe reputacionin. Ndryshime të vogla në pamje nuk përbëjnë shkak për t'u konsideruar joidentike, mallra, të cilat në gjithçka tjetër përputhen me përkufizimin e të konsideruarit si identike;

58. "**Mallra të ngjashme**", në kontekstin e vlerësimit doganor, janë mallrat e prodhuara në të njëjtin vend, të cilat, edhe pse nuk janë njësoj në çdo pikëpamje, kanë karakteristika dhe materiale përbërëse të ngjashme, që u mundësojnë atyre të kryejnë të njëjtat funksione dhe të jenë të shkëmbyeshme nga ana tregtare; cilësia e mallrave, reputacioni i tyre dhe ekzistenca e një marke tregtare janë ndër faktorët që merren parasysh në përcaktimin nëse mallrat janë të ngjashme;

59. "**Aplikues**", një person, i cili aplikon pranë autoriteteve doganore për një vendim;

60. "**Mbajtës i vendimit**", një person ndaj të cilit aplikohen efektet ligjore të një vendimi;

61. "**Aftësi paguese**", një gjendje e mirë financiare, e cila është e mjaftueshme për të plotësuar detyrimet e aplikuesit për sa i përket karakteristikave të llojit të aktivitetit të operatorit të interesuar;

62. "**OEA**", një operator ekonomik i autorizuar sipas përcaktimeve të nenit 40, të Kodit;

63. "**OEAD**", një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësime doganore, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 40, të Kodit;

64. "**OEAS**", një operator ekonomik i autorizuar për sigurinë dhe mbrojtjen, sipas përcaktimeve të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 40, të Kodit;

65. "**Autorizim OEAD**", certifikata që lëshohet në formatin e një Certifikate OEA për Thjeshtësime Doganore;

66. "**Autorizim OEAS**", certifikata që lëshohet në formatin e një Certifikate OEA për sigurinë dhe mbrojtjen.

KREU 2
Të drejtat dhe detyrimet e personave në lidhje me legjislacionin doganor

Seksioni 1
Dispozitat mbi informacionin

Nënseksioni 1
Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për shkëmbimin dhe ruajtjen e të dhënave

Neni 2
Kërkesat e përbashkëta të të dhënave
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

1. Shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit të nevojshëm për aplikimet dhe vendimet do t'i nënshtrohet kërkesave të përbashkëta të të dhënave të përcaktuara në aneksin A, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit të kërkuar për deklaratat, njoftimet dhe prova e statusit doganor u nënshtrohen kërkesave të përbashkëta të të dhënave të përcaktuara në aneksin B, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të informacionit tarifor të detyrueshëm (IDT) dhe të sistemit të mbikëqyrjes 2, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, kolona 1, e aneksit A, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij nuk do të zbatohet, por do të zbatohen të dhënat e përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar OEA, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, kolona 2, e aneksit A, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij nuk do të zbatohet, por do të zbatohen të dhënat e përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Duke anashkaluar pikën 2, të këtij neni, deri në implementimin e sistemeve përkatëse IT të informatizuara, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, të dhënat e përgjithshme, të përcaktuara në aneksin B, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij nuk do të zbatohen.

6. Për sistemet IT të referuara në pikën 2, deri në implementimin e sistemeve përkatëse IT të informatizuara, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit të kërkuar për deklaratat, njoftimet dhe prova e statusit doganor do të jenë sipas të dhënave të përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

7. Kur të dhënat e kërkuara për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit për deklaratat, njoftimet dhe provat e statusit doganor nuk janë të përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, autoriteti doganor duhet të sigurojë që kërkesat për të dhënat përkatëse të jenë të tilla, që të lejojnë aplikimin e dispozitave që rregullojnë këto deklarata, njoftime dhe prova të statusit doganor.

8. Deri në implementimin e sistemeve të informatizuara, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të vendosin kërkesa alternative të të dhënave me ato të përcaktuara në aneksin A, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, të cilat do të zbatohen në lidhje me aplikimet dhe autorizimet:

a) që lidhen me thjeshtimin për përcaktimin e shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave;

b) që lidhen me garancinë globale;

c) për shtyrjen e pagesës;

ç) për përdorimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm, siç referohen në nenin 138, të Kodit;

d) për shërbime të rregullta të transportit detar;

dh) për lëshuesin e autorizuar;

e) për statusin e peshuesit të autorizuar të bananeve;

ë) për vetëvlerësimin;

f) për statusin e pritësit të autorizuar për operacionet TIR;

g) për statusin e dërguesit të autorizuar për transitin;

gj) për statusin e pritësit të autorizuar për transitin;

h) për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë;

i) për përdorimin e një deklarate transiti me të dhëna të reduktuara;

j) për përdorimin e një dokumenti transporti elektronik si deklaratë doganore;

k) për zhdoganimet në ambientet e operatorit ekonomik.

9. Kur autoriteti doganor vendos, në përputhje me pikën 8, që do të zbatohen kërkesat alternative të të dhënave, siguron që këto kërkesa alternative të të dhënave të lejojnë autoritetin doganor të verifikojë që kushtet për dhënien e autorizimit në fjalë janë plotësuar dhe se ato përfshijnë, të paktën, një nga kërkesat e mëposhtme:

- Identifikimin e aplikuesit/mbajtësit të autorizimit (Kërkesa për të dhënat 3/2, "Aplikuesi/mbajtësi i autorizimit ose identifikimi i vendimit", ose, kur mungon një numër i vlefshëm RIOE i aplikantit, kërkesa për të dhënat 3/1, "Aplikuesi/mbajtësi i autorizimit ose i vendimit");

- Llojin e aplikimit ose autorizimit (Kërkesa për të dhënat 1/1, "Llojet e kodeve të aplikimit/vendimit");

- Përdorimin e autorizimit në një ose më shumë zyra doganore (Kërkesa për të dhënat ¼, "Vlefshmëria gjeografike/territoriale"), kur është e aplikueshme.

10. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të vendimeve sipas Kodit Doganor, autoritetet doganore do të zbatojnë kërkesat e të dhënave për aplikimet dhe autorizimet e anekseve përkatëse, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në vend të kërkesave të të dhënave sipas aneksit A, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për procedurat për aplikimet dhe autorizimet për:

a) përdorimin e deklaratës së thjeshtuar;

b) zhdoganimin e centralizuar;

c) hyrje në të dhënat në regjistrimet e deklaruesit;

ç) përdorimin e përpunimit aktiv;

d) përdorimin e përpunimit pasiv;

dh) përdorimin e veçantë përfundimtar (*end-use*);

e) përdorimin e lejimit të përkohshëm;

ë) funksionimin e ambienteve për magazinim doganor.

11. Duke anashkaluar pikën 10, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të eksportit ose të importit, kur një aplikim për autorizim bazohet në një deklaratë doganore, në përputhje me pikën 1, të nenit 531, deklarata doganore duhet të përmbajë, gjithashtu, të dhënat e mëposhtme:

a) Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për të gjitha regjimet:

- Natyrën e përpunimit apo të përdorimit të mallrave;

- Përshkrimet teknike të mallrave dhe/ose produkteve të përpunuara dhe mjetet e identifikimit të tyre;

- Periudhën e vlerësuar për mbylljen;

- Zyrën e propozuar për mbylljen (jo për përdorimin përfundimtar *end - use*);

- Vendin e përpunimit apo përdorimit.

b) Kërkesat specifike të të dhënave për përpunimin aktiv:

- Kodet e kushteve ekonomike, të përmendura në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

- Normën e vlerësuar të rendimentit ose metodën sipas së cilës kjo normë është përcaktuar; dhe nëse llogaritja e shumës së detyrimit të importit duhet të bëhet në përputhje me pikën 3, të nenit 81, të Kodit (trego "po" ose "jo").

Nënseksioni 2
Formatet dhe kodet e kërkesave të përbashkëta për të dhënat, shkëmbimi dhe ruajtja e të dhënave

Neni 3
Formatet dhe kodet për kërkesat e përbashkëta për të dhënat

(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

1. Formatet dhe kodet për kërkesat e përbashkëta për të dhënat, të përmendura në pikën 2, të nenit 17, të Kodit, dhe në nenin 2, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit të kërkuar për aplikimet dhe vendimet, janë të përcaktuara në aneksin A, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Formatet dhe kodet për kërkesat e përbashkëta për të dhënat e përmendura në pikën 2, të nenit 17, të Kodit, dhe në nenin 2, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit të kërkuar për deklaratat, njoftimet dhe provat e statusit doganor, janë të përcaktuara në aneksin B, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar IDT dhe të sistemit 2, të mbikëqyrjes, nuk do të zbatohen kodet dhe formatet e aneksit A, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, por kodet dhe formatet e përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, formulari i aplikimit për Informacionin Detyrues të Origjinës (IDO) është formulari i përcaktuar në aneksin 11, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të OEA, nuk do të zbatohen kodet dhe formatet e aneksit A, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, por kodet dhe formatet e përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Duke anashkaluar pikën 2, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar përkatës dhe për aq sa këto sisteme nuk janë ende funksionale, formatet dhe kodet e përcaktuara në aneksin B, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, do të jenë opsionale.

7. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar përkatës dhe për aq sa këto sisteme nuk janë ende funksionale, formatet dhe kodet e nevojshme për deklaratat, njoftimet dhe prova e statusit doganor do t'i nënshtrohen kërkesave për të dhënat e përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

8. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të eksportit/importit, sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të sigurojë që kodet dhe formatet për njoftimin e paraqitjes të lejojnë paraqitjen e mallrave, në përputhje me nenin 130, të Kodit.

9. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të vendimeve doganore, formatet dhe kodet për aplikimet e mëposhtme dhe autorizimet e aneksit A, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, janë opsionale për aplikimet dhe autorizimet:

a) që lidhen me thjeshtimin për përcaktimin e shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave;

b) që lidhen me garancinë globale;

c) për shtyrjen e pagesës;

ç) për përdorimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm, siç referohen në nenin 138, të Kodit;

d) për shërbime të rregullta të transportit detar;

dh) për lëshuesin e autorizuar;

e) për përdorimin e deklaratës së thjeshtuar;

ë) për zhdoganimin e centralizuar;

f) për hyrje në të dhënat në regjistrimet e deklaruesit;

g) për vetëvlerësimin;

gj) për statusin e peshuesit të autorizuar të bananeve;

h) për përdorimin e përpunimit aktiv;

i) për përdorimin e përpunimit pasiv;

j) për përdorimin e veçantë përfundimtar (*end-use);*

k) për përdorimin e lejimit të përkohshëm;

l) për funksionimin e ambienteve për magazinim doganor;

ll) për statusin e pritësit të autorizuar për operacionet TIR;

m) për statusin e dërguesit të autorizuar për transitin;

n) për statusin e pritësit të autorizuar për transitin;

nj) për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë;

o) për përdorimin e një deklarate transiti me të dhëna të reduktuara;

p) për përdorimin e një dokumenti transporti elektronik si deklaratë doganore.

Kur administrata doganore heq dorë nga kode dhe formate të caktuara gjatë periudhës transitore, duhet të sigurojë zbatimin e procedurave efektive që i mundësojnë asaj verifikimin e plotësimit të kushteve për dhënien e autorizimit.

Neni 4

Siguria e sistemeve elektronike

(Neni 17, i Kodit)

1. Ndërkohë që zhvillon, mirëmban dhe vë në funksionim sistemet elektronike, të përmendura në nenin 286, të Kodit, administrata doganore duhet të vendosë dhe të mbajë rregulla sigurie të përshtatshme për funksionimin e rregullt, të besueshëm dhe të sigurt të sistemeve të ndryshme. Ajo, gjithashtu, duhet të sigurojë që janë marrë masat për të kontrolluar burimin e të dhënave dhe

mbrojtjen e të dhënave kundër rrezikut të aksesit të paautorizuar, humbjes, ndryshimit ose shkatërrimit.

2. Çdo hyrje, modifikim dhe fshirje e të dhënave do të regjistrohet së bashku me informacionin për arsyen dhe kohën e saktë të këtij përpunimi si dhe identifikimin e personit që e ka kryer atë.

3. Administrata doganore informon organin kompetent dhe, kur është e përshtatshme, operatorin ekonomik të interesuar për të gjitha shkeljet aktuale ose të dyshuara të sigurisë së sistemeve elektronike.

4. Nënshkrimi dhe/ose vulosja në rrugë elektronike bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Certifikimi sigurohet nga autoriteti kompetent.

Neni 5
Ruajtja e të dhënave

Të gjitha të dhënat e përpunuara në sistemin përkatës elektronik do të ruhen për të paktën 3 vjet, nga fundi i vitit në të cilin këto të dhëna janë përpunuar, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Neni 6
Disponueshmëria e sistemeve elektronike

1. Administrata doganore dhe organi kompetent do të lidhin marrëveshje operacionale, që përcaktojnë kërkesat praktike për disponueshmërinë dhe performancën e sistemeve elektronike, si dhe për vazhdimësinë e aktivitetit.

2. Marrëveshjet operacionale, të përmendura në pikën 1, duhet, në veçanti, të përcaktojnë kohën e duhur të përgjigjes për shkëmbimin dhe përpunimin e informacionit në sistemet përkatëse elektronike.

3. Sistemet elektronike duhet të garantojnë funksionimin në mënyrë të përhershme. Megjithatë, ky detyrim nuk zbatohet:

a) në raste të veçanta, që lidhen me përdorimin e sistemeve elektronike të përcaktuara në marrëveshjet e përmendura në pikën 1, ose në legjislacionin kombëtar, në mungesë të këtyre marrëveshjeve;

b) në rastet e forcës madhore.

Nënseksioni 3
Regjistrimi i personave pranë autoriteteve doganore

Neni 7
Organi kompetent doganor
(Neni 19, i Kodit)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për regjistrimin e personave dhe publikimin e këtij informacioni në faqen zyrtare të saj.

Neni 8
Sistemi elektronik në lidhje me numrin RIOE (NUIS/NIPT)
(Neni 17, i Kodit)

1. Për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit lidhur me RIOE (NUIS/NIPT), do të përdoret një sistem elektronik i ngritur për këtë qëllim, sipas nenit 17, të Kodit (sistemi RIOE (NUIS/NIPT).

Informacioni bëhet i mundur nëpërmjet këtij sistemi nga autoritetet doganore kompetente, sa herë që jepen numra të rinj RIOE (NUIS/NIPT) ose ka ndryshime në të dhënat ekzistuese lidhur me regjistrimet.

2. Për çdo person jepet vetëm një numër RIOE (NUIS/NIPT).

3. Formati dhe kodet e të dhënave, të ruajtura në sistemin RIOE (NUIS/NIPT), janë të përcaktuara në aneksin 12-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të ri të informatizuar qendror RIOE (NUIS/NIPT), nuk zbatohen formatet dhe kodet e përcaktuara në aneksin 12-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Deri në implementimin e sistemit të ri të informatizuar qendror RIOE (NUIS/NIPT), kodet e kërkesave të përbashkëta për të dhënat për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe personave të tjerë përcaktohen në aneksin 1, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. DPD, kur mbledh të dhënat e pikës 4, të aneksit 12-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, siguron përdorimin e formateve dhe kodeve të përcaktuara në aneksin 12-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 9
Përmbajtja e të dhënave
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

1. Në kohën e regjistrimit të një personi, autoritetet doganore duhet të mbledhin e të ruajnë të dhënat e parashikuara në aneksin 12-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në lidhje me atë person. Këto të dhëna përbëjnë të dhënat për regjistrimin e numrit RIOE.

2. Duke anashkaluar pikën 1, deri në implementimin e sistemit të informatizuar RIOE, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, nuk do të zbatohen kërkesat e zakonshme të të dhënave të përcaktuara në aneksin 12-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar RIOE, autoriteti doganor mbledh dhe ruan të dhënat që do të përbëjnë të dhënat RIOE, siç është përcaktuar në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, si më poshtë vijon:

a) të dhënat e listuara në pikat 1 deri 4, të aneksit përkatës të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

b) bazuar në sistemin e autoritetit kompetent, të dhënat e listuara në pikat 5 deri 12, të aneksit përkatës të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Autoriteti doganor kompetent hedh të dhënat e mbledhura sipas pikës 3, të këtij neni, në një mënyrë të rregullt në sistemin RIOE.

4. Duke anashkaluar pikat 2 e 3, të këtij neni, mbledhja e dhënave të listuara në titullin I, kreu 3, pika 4, e aneksit 12-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, nuk do të jetë detyruese. Në rastet kur autoriteti doganor kompetent mbledh këto të dhëna, ato duhet të hidhen në sistemin RIOE sa më shpejt që të jetë e mundur, pas implementimit të këtij sistemi.

Neni 10
Paraqitja e të dhënave për regjistrimin e numrit RIOE
(Pika 4, e nenit 19, të Kodit)

1. Autoritetet doganore mund t'i lejojnë personat të paraqesin të dhënat e nevojshme për regjistrimin e numrit RIOE me mjete të tjera, përveç teknikave elektronike për përpunimin e të dhënave.

2. Personat e regjistruar tashmë në sistemin doganor duhet të përditësojnë të dhënat e tyre sipas aneksit 12-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Përditësimi i të dhënave duhet të bëhet në momentin e parë që personi kryen procedura doganore.

Neni 11
Operatorët ekonomikë, që nuk janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Pika 2, e nenit 19 dhe pika 2, e nenit 27 të Kodit)

1. Një operator ekonomik, që nuk është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duhet të regjistrohet:

a) para depozitimit të deklaratës doganore në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të deklaratës doganore:

i. të bërë në përputhje me nenet 529 deri në 533;

ii. për vendosjen e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm ose të një deklarate të rieksportit, për të mbyllur këtë regjim;

iii. të bërë në bazë të një marrëveshjeje ose konventës për procedurën e transitit të përbashkët, nga një operator ekonomik i vendosur në një vend transiti të përbashkët.

b) para depozitimit të një deklarate përmbledhëse të daljes apo hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) para depozitimit të një deklarate magazinimi të përkohshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

ç) kur vepron si një transportues për qëllime transporti përmes detit, rrugëve të brendshme ujore ose ajrore;

d) kur vepron si një transportues, i cili është i lidhur me sistemin doganor, dhe dëshiron të marrë ndonjë prej njoftimeve të parashikuara në legjislacionin doganor në lidhje me depozitimin ose ndryshimin e deklaratave përmbledhëse të hyrjes.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i nënndarjes "ii", të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, operatorët ekonomikë, që nuk janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, do të regjistrohen pranë autoriteteve doganore para

paraqitjes së deklaratës doganore për vendosjen e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm ose të një deklarate të rieksportit për mbylljen e atij regjimi, ku regjistrimi është i nevojshëm për përdorimin e sistemit të menaxhimit të përbashkët të garancisë.

3. Pavarësisht nga përcaktimi i nënndarjes "ii", të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, operatorët ekonomikë, të vendosur në një vend transiti të përbashkët, do të regjistrohen pranë autoriteteve doganore para paraqitjes së deklaratës doganore, në bazë të një marrëveshjeje apo konventës për procedurën e transitit të përbashkët, kur kjo deklaratë është depozituar në vend të deklaratës përmbledhëse të hyrjes ose është përdorur si një deklaratë paranisjeje.

4. Me përjashtim të shkronjës "ç", të pikës 1, një operator ekonomik, që vepron si transportues për qëllime transporti përmes detit, rrugëve të brendshme ujore apo ajrore, nuk do të regjistrohet pranë autoriteteve doganore kur i është caktuar një numër identifikimi unik, në kuadër të një programi partneriteti të tregtarëve nga vendet e tjera, i cili njihet nga Republika e Shqipërisë.

5. Në rastet kur regjistrimi është i nevojshëm, në përputhje me këtë nen, ai do të bëhet pranë autoriteteve doganore kompetente për vendin ku operatori ekonomik paraqet një deklaratë apo kërkon marrjen e një vendimi, ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Neni 12
Persona të ndryshëm nga operatorët ekonomikë
(Pika 3, e nenit 19, të Kodit)

1. Personat, të ndryshëm nga operatorët ekonomikë, duhet të regjistrohen pranë autoriteteve doganore kur plotësohet njëri nga kushtet e mëposhtme:

a) Një regjistrim i tillë kërkohet nga legjislacioni në fuqi;

b) Personi angazhohet në operacione, për të cilat duhet të sigurohet një numër RIOE, në përputhje me anekset A dhe B, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Duke anashkaluar pikën 1, kur një person, i ndryshëm nga një operator ekonomik, depoziton një deklaratë doganore të rastësishme dhe autoritetet doganore e konsiderojnë këtë si të justifikuar, atëherë regjistrimi mund të mos kërkohet.

Neni 13
Pavlefshmëria e numrit RIOE apo çregjistrimi
(Pika 4, e nenit 19, të Kodit)

1. Autoritetet doganore e bëjnë të pavlefshëm një numër RIOE në një nga rastet e mëposhtme:

a) Me kërkesë të personit të regjistruar;

b) Kur autoriteti doganor vihet në dijeni se personi i regjistruar ka pushuar aktivitetet që kërkojnë regjistrimin.

2. Autoritetet doganore regjistrojnë datën e pavlefshmërisë së numrit RIOE dhe ia komunikojnë këtë personit të regjistruar.

Seksioni 2
Vendime që lidhen me zbatimin e legjislacionit doganor

Nënseksioni 1
E drejta për t'u dëgjuar

Neni 14
Procedurat e përgjithshme për të drejtën për t'u dëgjuar
(Pika 6, e nenit 27, të Kodit)

1. Komunikimi, i përmendur në paragrafin e parë, të pikës 6, të nenit 27, të Kodit, duhet të:

a) përfshijë një referencë të dokumenteve dhe informacioneve, në të cilën autoritetet doganore kanë si qëllim të bazojnë vendimin e tyre;

b) tregojë periudhën brenda së cilës personi i interesuar duhet të shprehë pikëpamjet e tij, nga data në të cilën ai merr atë komunikim apo konsiderohet se e ka marrë atë;

c) përfshijë një referencë, për të drejtën e personit të interesuar, për të pasur akses në dokumentet dhe informacionet e përmendura në shkronjën "a", në përputhje me dispozitat që zbatohen.

2. Kur personi i interesuar paraqet pikëpamjet e tij brenda afatit të përmendur në shkronjën "b", të pikës 1, autoritetet doganore mund të vazhdojnë me marrjen e vendimit, përveç rastit kur personi i interesuar, në të njëjtën kohë, paraqet synimin për të shprehur më tej këndvështrimin e tij brenda kohëzgjatjes së përcaktuar.

Neni 15
Procedurat specifike për të drejtën për t'u dëgjuar
(Pika 6, e nenit 27, të Kodit)

1. Autoritetet doganore mund ta bëjnë komunikimin e përmendur në paragrafin e parë të pikës 6, të nenit 27, të Kodit, si pjesë e procesit të verifikimit apo kontrollit, kur ato do të marrin një vendim bazuar në një nga rastet e mëposhtme:

a) Rezultatet e një verifikimi pas paraqitjes së mallrave;

b) Rezultatet e verifikimit të deklarimit doganor, siç përmendet në nenin 172, të Kodit;

c) Rezultatet e kontrollit pas çlirimit, siç përmendet në nenin 49, të Kodit, kur mallrat janë ende nën mbikëqyrje doganore;

ç) Rezultatet e verifikimit të provës së statusit doganor të mallrave shqiptare ose, sipas rastit, rezultatet e verifikimit të aplikimit për regjistrimin e një vërtetimi të tillë apo për miratimin e një vërtetimi të tillë;

d) Lëshimit të provës së origjinës nga autoritetet doganore;

dh) Rezultatet e kontrollit të mallrave, për të cilat nuk është depozituar deklaratë përmbledhëse, deklaratë magazinimi të përkohshëm, deklaratë rieksporti apo deklaratë doganore.

2. Kur komunikimi bëhet sipas pikës 1, personi në fjalë mund të:

a) shprehë, menjëherë, pikëpamjet e tij, me të njëjtat mjete që përdoren për komunikimin, sipas nenit 17;

b) bëjë kërkesë për komunikim, sipas nenit 16, me përjashtim të rasteve të përmendura në shkronjën "dh", të pikës 1.

Personi në fjalë do të informohet nga autoritetet doganore për këto dy mundësi.

3. Kur autoritetet doganore marrin një vendim refuzimi ndaj personit të interesuar, ata do ta regjistrojnë, pavarësisht nëse ai ka shprehur ose jo pikëpamjet e tij, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2.

Neni 16
Periudha e së drejtës për t'u dëgjuar
(Pika 6, e nenit 27, të Kodit)

1. Periudha që aplikuesi të shprehë pikëpamjen e tij, para se të merret një vendim, i cili do të ndikojë negativisht ndaj tij, është 30 (tridhjetë) ditë.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1, kur vendimi ka të bëjë me rezultatet e kontrollit të mallrave, për të cilat nuk janë depozituar deklarata përmbledhëse, deklarata e magazinimi të përkohshëm, deklarata e rieksportit apo deklarata doganore, atëherë autoritetet doganore mund të kërkojnë nga personi në fjalë që të shprehë pikëpamjen e tij brenda 24 (njëzet e katër) orëve.

Neni 17
Mjetet për komunikimin e arsyeve
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Në rastet kur komunikimi i përmendur në paragrafin e parë të pikës 6, të nenit 27, të Kodit, është bërë si pjesë e procesit të verifikimit apo kontrollit, komunikimi mund të bëhet duke përdorur mjete të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

Në rastet kur aplikimi është paraqitur apo vendimi është njoftuar duke përdorur mjete të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave, komunikimi mund të bëhet duke përdorur të njëjtat mjete.

Neni 18
Përjashtime nga e drejta për t'u dëgjuar
(paragrafi i dytë, i pikës 6, të nenit 27, të Kodit)

Rastet e veçanta, kur aplikuesit nuk i është dhënë mundësia për të shprehur pikëpamjen e tij, do të jenë, si më poshtë vijon:

a) Kur aplikimi për një vendim nuk plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 19;

b) Kur autoritetet doganore njoftojnë personin që ka depozituar deklaratën përmbledhëse të hyrjes se mallrat nuk duhet të ngarkohen, në raste të trafikut detar dhe ajror të kontejnerëve;

c) Kur vendimi ka të bëjë me një njoftim të vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ndaj aplikuesit, referuar pikës 3, të nenit 109, të Kodit;

ç) Kur një numër RIOE duhet bërë i pavlefshëm.

Nënseksioni 2
Rregulla të përgjithshme për vendimet në bazë të aplikimit

Neni 19
Kushtet për pranimin e një aplikimi
(Pika 2, e nenit 27, të Kodit)

1. Aplikimi për një vendim, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, do të pranohet nëse plotësohen këto kushte:

a) Kur kërkohet nga regjimi me të cilin lidhet aplikimi, aplikuesi është i regjistruar në përputhje me nenin 19, të Kodit;

b) Kur kërkohet nga regjimi me të cilin lidhet aplikimi, aplikuesi është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) Aplikimi është paraqitur pranë autoritetit doganor të përcaktuar për të marrë aplikime, referuar në paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 27, të Kodit;

ç) Aplikimi nuk ka të bëjë me një vendim që ka të njëjtin qëllim si vendimi i mëparshëm, drejtuar të njëjtit aplikues, i cili, gjatë periudhës njëvjeçare para aplikimit është anuluar apo revokuar me arsyetimin se aplikuesi nuk arriti të përmbushë detyrimet, sipas këtij vendimi.

2. Duke anashkaluar shkronjën "ç", të pikës 1, periudha e përmendur atje do të jetë 3 vjet, kur vendimi i mëparshëm është anuluar në përputhje me pikën 1, të nenit 31, të Kodit, apo aplikimi është një aplikim për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar, të bërë në përputhje me nenin 40, të Kodit.

Neni 20
Autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit
(Pika 1, e nenit 27, të Kodit)

Në rastet kur nuk është e mundur të përcaktohet autoriteti doganor kompetent, në përputhje me paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 27, të Kodit, autoriteti doganor kompetent do të jetë ai i vendit ku mbahen ose aksesohen të dhënat dhe dokumentacioni i aplikuesit (llogaritë kryesore për qëllime doganore), të cilat i mundësojnë autoritetit doganor të marrë një vendim.

Neni 21
Zgjatja e afatit për marrjen e vendimit
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

1. Në rastet kur, pas pranimit të aplikimit, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit e konsideron të nevojshëm kërkimin e informacionit shtesë nga aplikuesi, me qëllim që të marrë një vendim, ai do t'i caktojë aplikuesit një afat kohor që nuk duhet t'i kalojë 30 (tridhjetë) ditë, për të siguruar këtë informacion. Afati për marrjen e vendimit, i përcaktuar në pikën 3, të nenit 27, të Kodit, zgjatet me atë periudhë kohe. Aplikuesi informohet për zgjatjen e afatit kohor për marrjen e vendimit.

2. Në rastet kur zbatohet pika 1, e nenit 16, afati për marrjen e vendimit, i përcaktuar në pikën 3, të nenit 27, të Kodit, zgjatet me një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh. Aplikuesi informohet për zgjatjen e afatit.

3. Në rastet kur autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit ka zgjatur periudhën për konsultime me një autoritet tjetër, afati për marrjen e vendimit zgjatet për të njëjtën periudhë kohore sa dhe zgjatja e periudhës së konsultimit. Aplikuesi informohet për zgjatjen e afatit kohor për marrjen e vendimit.

4. Në rastet kur ka arsye serioze për të dyshuar një shkelje të legjislacionit doganor dhe autoritetet doganore kryejnë hetime bazuar në këto arsye, afati për të marrë vendimin zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar hetimet. Kjo zgjatje nuk duhet t'i kalojë nëntë muaj. Aplikuesi informohet për zgjatjen, përveç rasteve kur rrezikohen hetimet.

Neni 22
Data e hyrjes në fuqi
(Pikat 4 dhe 6, të nenit 27, të Kodit)

Vendimi hyn në fuqi në një datë të ndryshme nga data në të cilën aplikuesi e merr apo konsiderohet se e ka marrë atë, në rastet e mëposhtme:

a) Kur vendimi ndikon pozitivisht mbi aplikuesin dhe aplikuesi ka kërkuar një datë tjetër të hyrjes në fuqi, vendimi hyn në fuqi nga data e kërkuar nga aplikuesi, me kusht që ajo të jetë pas datës në të cilën aplikuesi merr ose konsiderohet ta ketë marrë vendimin;

b) Kur vendimi i mëparshëm është lëshuar për një afat kohe të kufizuar dhe qëllimi i vetëm i vendimit të ri është zgjatja e vlefshmërisë së tij, vendimi hyn në fuqi nga data pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së vendimit të mëparshëm;

c) Kur hyrja në fuqi e vendimit kushtëzohet me përmbushjen e formaliteteve të caktuara nga ana e aplikuesit, vendimi hyn në fuqi nga data në të cilën aplikuesi merr ose konsiderohet të ketë marrë njoftim nga autoritetet doganore kompetente, të cilat deklarojnë se formalitetet janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme.

Neni 23
Rivlerësimi i vendimit
(Shkronja "a", e pikës 4, të nenit 28, të Kodit)

1. Autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit do ta rivlerësojë vendimin në rastet e mëposhtme:

a) Kur ka ndryshime në legjislacionin përkatës, që ndikojnë në vendim;

b) Kur është e nevojshme, si rezultat i monitorimit të kryer;

c) Kur është e nevojshme, për shkak të informacionit të dhënë nga mbajtësi i vendimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 28, të Kodit, ose nga autoritetet e tjera.

2. Autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit ia komunikon rezultatin e rivlerësimit mbajtësit të vendimit.

Neni 24
Pezullimi i vendimit
(Shkronja "b", e pikës 4, të nenit 28, të Kodit)

1. Autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit e pezullon vendimin, por nuk e anulon, revokon ose ndryshon atë në përputhje me nenet 28, pika 3, 31 ose 32, të Kodit, kur:

a) autoriteti doganor gjykon se mund të ketë arsye të mjaftueshme për anulimin, revokimin ose ndryshimin e vendimit, por ende nuk disponon elementet e nevojshme për të vendosur për anulimin, revokimin ose ndryshimin;

b) autoriteti doganor gjykon se nuk janë përmbushur kushtet sipas vendimit ose që mbajtësi i vendimit nuk respekton detyrimet sipas këtij vendimi dhe mbajtësit të vendimit mund t'i jepet kohë për të marrë masa për përmbushjen e kushteve ose respektimin e detyrimeve;

c) mbajtësi i vendimit e kërkon pezullimin për shkak se, përkohësisht, nuk është në gjendje të përmbushë kushtet e përcaktuara sipas vendimit ose për të respektuar detyrimet e vendimit.

2. Në rastet e referuara në shkronjat "b" e "c", të pikës 1, mbajtësi i vendimit duhet të njoftojë autoritetin doganor kompetent për marrjen e vendimit, për masat që do të marrë për të siguruar përmbushjen e kushteve ose respektimin e detyrimeve si dhe periudhën e kohës që i nevojitet për të marrë këto masa.

Neni 25
Periudha e pezullimit të vendimit
(Shkronja "b", e pikës 4, të nenit 28, të Kodit)

1. Në rastet e referuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 24, periudha e pezullimit, e përcaktuar nga autoritetet doganore kompetente, duhet t'i korrespondojë periudhës së kohës që i nevojitet autoritetit doganor për të vendosur nëse plotësohen kushtet për anulim, revokim ose ndryshim. Kjo periudhë nuk mund t'i kalojë 30 (tridhjetë) ditë.

Megjithatë, kur autoriteti doganor konsideron se mbajtësi i vendimit nuk mund t'i përmbushë kriteret e përcaktuara në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit, vendimi do të pezullohet derisa të vërtetohet nëse është kryer ndonjë shkelje serioze apo e përsëritur nga personat e mëposhtëm:

a) mbajtësi i vendimit;

b) personi përgjegjës i kompanisë mbajtëse të vendimit në fjalë ose që ushtron kontroll mbi menaxhimin e saj;

c) personi përgjegjës për çështjet doganore në kompaninë, e cila është mbajtëse e vendimit në fjalë.

2. Në rastet e referuara në shkronjat "b" e "c", të pikës 1, të nenit 24, periudha e pezullimit, e përcaktuar nga autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit, duhet t'i korrespondojë periudhës kohore të njoftuar nga mbajtësi i vendimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 24. Periudha e pezullimit, në rastet kur është e nevojshme, mund të zgjatet më tej me kërkesë të mbajtësit të vendimit.

Periudha e pezullimit mund të zgjatet përtej periudhës së kohës që u nevojitet autoriteteve doganore kompetente për të verifikuar nëse këto masa sigurojnë përmbushjen e kushteve apo respektimin e detyrimeve. Kjo periudhë kohore

nuk duhet t'i kalojë 30 (tridhjetë) ditë.

3. Në rastet kur, pas pezullimit të vendimit, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit synon ta anulojë, ta revokojë ose ta ndryshojë atë, në përputhje me nenet 28, pika 3, 31 ose 32, të Kodit, periudha e pezullimit, e përcaktuar në përputhje me pikat 1 e 2, të këtij neni, zgjatet, kur është e nevojshme, deri sa të hyjë në fuqi vendimi për anulimin, revokimin ose ndryshimin.

Neni 26
Përfundimi i pezullimit
(Shkronja "b", e pikës 4, të nenit 28, të Kodit)

1. Pezullimi i vendimit duhet të përfundojë me mbarimin e periudhës së pezullimit, përveç rasteve kur, para mbarimit të kësaj periudhe, ndodh një nga situatat e mëposhtme:

a) Pezullimi është hequr bazuar në faktin se në rastet e referuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 24, nuk ka asnjë arsye për anulimin, revokimin ose ndryshimin e vendimit, në përputhje me nenet 28, pika 3, 31 ose 32, të Kodit. Në këtë rast pezullimi do të përfundojë në datën e revokimit;

b) Pezullimi është hequr bazuar në faktin se në rastet e referuara në shkronjat "b" e "c", të pikës 1, të nenit 24, mbajtësi i vendimit ka marrë masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kushteve të përcaktuara për marrjen e vendimit apo për të respektuar detyrimet e vendosura në këtë vendim, të pranueshme nga autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit. Në këtë rast pezullimi do të përfundojë në datën e revokimit;

c) Vendimi i pezulluar anulohet, revokohet ose ndryshohet. Në këtë rast pezullimi do të përfundojë në datën e anulimit, revokimit apo ndryshimit.

2. Autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit informon mbajtësin e vendimit për përfundimin e pezullimit.

Neni 27
Sistemet elektronike në lidhje me vendimet
(Neni 17 i Kodit)

1. Për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit që ka të bëjë me aplikimet dhe vendimet, të cilat merren nga autoritetet doganore dhe, në çdo rast të mëvonshëm, që mund të ndikojë në aplikimin ose vendimin e marrë, do të përdoret një sistem elektronik i ngritur për këto qëllime, në bazë të pikës 1, të nenit 17, të Kodit.

Informacioni bëhet i mundur nëpërmjet këtij sistemi nga ana e autoritetit doganor kompetent, pa vonesë dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data në të cilën ky autoritet ka marrë dijeni për informacionin.

2. Pika 1, e këtij neni, do të zbatohet nga data e implementimit të sistemit të informatizuar të vendimeve doganore, sipas planit të punës, të miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për vendimet doganore, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave, në lidhje me aplikimet, vendimet dhe për çdo veprim/ngjarje pasuese, e cila mund të ndikojë në aplikimin ose vendimin fillestar.

Neni 28
Autoritetet doganore kompetente për të marrë aplikimet
(Paragrafi i tretë, i pikës 1, të nenit 27, të Kodit)

Kur nuk është e specifikuar, DPD-ja përcakton autoritetin doganor kompetent për të marrë aplikimet, në zbatim të paragrafit të tretë të pikës 1, të nenit 27, të Kodit.

Neni 29
Pranimi i aplikimit
(Pika 2, e nenit 27, të Kodit)

1. Kur autoriteti doganor kompetent pranon një aplikim, sipas pikës 1, të nenit 19, data e pranimit të aplikimit do të jetë data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar, në përputhje me pikën 2, të nenit 27, të Kodit, është marrë nga autoritetet doganore.

2. Kur autoriteti doganor kompetent përcakton se aplikimi nuk përmban gjithë informacionin e kërkuar, ai i kërkon aplikuesit të sigurojë informacionin e duhur brenda një afati kohor të arsyeshëm, i cili nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë.

3. Kur aplikuesi nuk i jep informacionin e kërkuar autoritetit doganor brenda periudhës të caktuar nga ata për këtë qëllim, aplikimi nuk do të pranohet dhe për këtë njoftohet aplikuesi.

4. Në mungesë të një komunikimi me aplikuesin, lidhur me pranimin ose jo të aplikimit të tij, aplikimi do të konsiderohet i pranuar. Data e

pranimit do të jetë data e paraqitjes së aplikimit ose, në rastet kur jepet informacion shtesë nga aplikuesi, si pasojë e kërkesës së autoritetit doganor kompetent, siç përmendet në pikën 2, data e pranimit është data në të cilën është dhënë informacioni i fundit, i kërkuar.

Neni 30
Ruajtja e informacionit në lidhje me vendimet
(Pika 5, e nenit 28, të Kodit)

Autoriteti doganor kompetent për marrjen e një vendimi do të ruajë të gjitha të dhënat dhe informacionin mbështetës, në të cilin u bazua për vendimin e marrë, për të paktën 3 vjet, nga data e përfundimit të vlefshmërisë së tij.

Neni 31
Konsultimi mes autoriteteve doganore
(Neni 27 i Kodit)

1. Kur një autoritet doganor kompetent për marrjen e një vendimi ka nevojë të konsultohet me një autoritet tjetër doganor në lidhje me plotësimin e kushteve dhe kritereve të nevojshme për marrjen e një vendimi të favorshëm, konsultimi duhet të kryhet brenda afatit të caktuar për vendimin në fjalë. Autoriteti doganor kompetent për marrjen e një vendimi do të caktojë një afat kohor për konsultim, që fillon nga data kur ky autoritet i komunikon autoritetit tjetër konsultues kushtet dhe kriteret që duhet të shqyrtohen nga ky i fundit.

Kur, pas shqyrtimit të përmendur në paragrafin e mësipërm, autoriteti doganor konsultues konstaton se aplikuesi nuk përmbush një ose më shumë nga kushtet dhe kriteret për marrjen e një vendimi të favorshëm, rezultatet e dokumentuara dhe të justifikuara do t'i dërgohen autoritetit doganor kompetent për marrjen e vendimit.

2. Afati kohor, i caktuar për konsultim, në përputhje me pikën 1, mund të zgjatet nga autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit në ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) Kur, për shkak të natyrës së shqyrtimit që do të kryhet, autoriteti doganor konsultues kërkon më shumë kohë;

b) Kur aplikuesi kryen rregullimet për të siguruar plotësimin e kushteve e të kritereve të përmendura në pikën 1 dhe ia komunikon ato autoritetit doganor kompetent për marrjen e vendimit, i cili do të informojë, sipas rastit, autoritetin doganor konsultues.

3. Kur autoriteti doganor konsultues nuk përgjigjet brenda afatit të përcaktuar për konsultim, sipas pikave 1 e 2, kushtet dhe kriteret për të cilat u krye konsultimi mund të konsiderohen të përmbushura.

4. Procedurat e konsultimit, të përcaktuara në pikat 1 e 2, mund të aplikohen edhe për qëllim rivlerësimi dhe monitorimi të një vendimi.

5. Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për vendimet doganore, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore duhet të sigurojnë disponueshmërinë e mjeteve të shkëmbimit e të ruajtjes së informacionit në mënyrë që të sigurojnë konsultimet në përputhje me nenin 31.

Neni 32
Revokimi i një vendimi të favorshëm
(Nenet 32 dhe 37 të Kodit)

1. Një vendim i pezulluar sipas pikës 1, të nenit 24, revokohet nga autoriteti doganor kompetent për marrjen vendimit në rastet e përmendura në shkronjat "b" e "c", të pikës 1, të nenit 24, kur mbajtësi i vendimit nuk merr brenda afatit masat e nevojshme për të përmbushur kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në këtë vendim.

2. Në zbatim të shkronjës "a", të pikës 7, të nenit 37, të Kodit, një vendim informacioni detyrues tarifor (IDT) revokohet nga autoriteti doganor kompetent nëse nuk është më në përputhje me interpretimin e ndonjërës prej nomenklaturave të përcaktuar në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 56, dhe që rrjedh nga secili nga rastet kur:

a) shënimet shpjeguese, të përmendura në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, me efekt nga data e hyrjes në fuqi;

b) vendimet e klasifikimit, mendimet e klasifikimit ose ndryshimet e shënimeve shpjeguese të Nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodifikimit të Mallrave, miratuar nga Organizata e krijuar nga Konventa që themeloi Këshillin e Bashkëpunimit Doganor, bërë në Bruksel, më 15 dhjetor 1950.

Nënseksioni 3
Vendimet për informacionin detyrues

Neni 33
Aplikimi për një vendim për informacionin detyrues
(Pika 1, e nenit 27 dhe shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Aplikimi për një vendim, në lidhje me informacionin detyrues, dhe të gjitha dokumentet shoqëruese ose mbështetëse i paraqiten Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).

2. Duke paraqitur një aplikim për një vendim në lidhje me informacionin detyrues, aplikuesi konsiderohet se ka rënë dakord që të dhënat e vendimit, përfshirë çdo fotografi, imazh apo broshurë, mund të publikohen në faqen zyrtare të DPD-së, me përjashtim të informacionit konfidencial. Për çdo publikim të të dhënave duhet të respektohet e drejta e mbrojtjes të të dhënave personale.

3. Një aplikim për një vendim informacioni detyrues tarifor (IDT) duhet të lidhet vetëm me mallra, të cilat kanë karakteristika të ngjashme, dhe nëse dallimet ndërmjet tyre janë të parëndësishme për qëllimet e klasifikimit të tyre tarifor.

4. Një aplikim për një vendim informacioni detyrues të origjinës (IDO) duhet të lidhet vetëm me një lloj malli dhe një grup rrethanash, për përcaktimin e origjinës.

5. Për qëllime të sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 36, të Kodit, në lidhje me një aplikim për një vendim IDT, DPD, siç përcaktohet në pikën 1, të këtij neni, do të konsultohet me sistemin elektronik të përmendur në nenin 38, dhe mund të mbajë një regjistrim të këtyre konsultimeve.

6. Në rastet kur nuk ka një sistem informatik funksional për paraqitjen e aplikimeve për një vendim, në lidhje me informacion detyrues të origjinës (IDO), DPD-ja mund të lejojë që këto aplikime të paraqiten duke përdorur mjete të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 34
Afatet kohore
(Pika 3, e nenit 27 dhe shkronja "b" e pikës 4 të nenit 28 të Kodit)

1. Kur DPD-ja njofton zyrat doganore se marrja e vendimeve IDT dhe IDO është pezulluar, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 28 të Kodit, afati për marrjen e vendimit të përmendur në paragrafin e parë të pikës 3, të nenit 27, të Kodit, zgjatet më tej, derisa DPD-ja të njoftojë zyrat doganore se është përcaktuar saktë dhe në mënyrë uniforme klasifikimi tarifor dhe origjina.

Zgjatja e periudhës së përmendur në paragrafin e parë nuk duhet t'i kalojë 10 (dhjetë) muaj, por, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të zbatohet një zgjatje shtesë jo më shumë se 5 muaj.

2. Periudha kohore e përmendur në paragrafin e dytë të pikës 3, të nenit 27, të Kodit, mund t'i kalojë 30 (tridhjetë) ditë në rastet kur nuk është e mundur që brenda kësaj periudhe të përfundojë analiza që autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit e konsideron si të nevojshme për marrjen e vendimit.

Neni 35
Njoftimi i vendimeve IDO
(Pika 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Kur paraqitet një aplikim për një vendim IDO, duke përdorur mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave, autoritetet doganore mund të njoftojnë aplikuesin për vendimin IDO duke përdorur mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

2. Kur DPD-ja njofton aplikuesin për vendimin IDO, duke përdorur mjete, të ndryshme nga teknikat elektronike të përpunimit të të dhënave, duhet ta bëjë këtë duke përdorur formularin e përcaktuar në aneksin 12-02, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Kur DPD-ja njofton aplikuesin për vendimin IDO, duke përdorur teknika elektronike të përpunimit të të dhënave, ky vendim do të jetë sipas formatit të përcaktuar në aneksin 12-02, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 36
Shkëmbimi i të dhënave për vendimet IDO
(Pika 5, e nenit 28, të Kodit)

DPD-ja duhet t'i transmetojë, periodikisht, degëve doganore, detajet përkatëse të vendimeve IDO.

Neni 37
Monitorimi i vendimeve IDT
(Pika 5, e nenit 28, të Kodit)

Kur formalitetet doganore janë duke u kryer nga mbajtësi ose në emër të tij, për një vendim IDT në lidhje me mallrat e mbuluara nga vendimi IDT, kjo duhet të pasqyrohet në deklaratën doganore, duke deklaruar numrin referencë të vendimit IDT.

Neni 38
Sistemi elektronik për IDT
(Pika 1, e nenit 17 dhe pika 5, e nenit 28, të Kodit.)

1. Për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit që i përket aplikimeve dhe vendimeve lidhur me IDT ose ndonjë ngjarje të mëpasshme, e cila mund të ndikojë në aplikimin fillestar ose vendimin, duhet të ngrihet një sistem elektronik, në mbështetje të pikës 1, të nenit 17, të Kodit.

2. Kur përpunohet një aplikim për një vendim IDT, autoritetet doganore duhet të tregojnë statusin e aplikimit në sistemin e përmendur në pikën 1.

3. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar, të referuar në planin e punës, të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, do të përdoret baza e të dhënave të sistemit qendror të DPD-së.

4. Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për IDT, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera, të ndryshme nga teknika elektronike, të përpunimit të të dhënave në lidhje me aplikimet e vendimet dhe për çdo veprim/ngjarje pasues, që mund të ndikojë në aplikimin ose vendimin.

Aplikimet për një vendim IDT do të bëhen duke përdorur formatin e formularit sipas aneksit 2, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe vendimet IDT do të merren duke përdorur formatin e formularit e sipas aneksit 3, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, autoritetet doganore do të kryejnë monitorimin e përdorimit të vendimit IDT kur bëjnë kryerjen e kontrolleve doganore ose kontrollet pas zhdoganimit, sipas neneve 47 dhe 49, të Kodit.

Neni 39
Përputhshmëria me vendimet ekzistuese IDT
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

DPD-ja, për marrjen e një vendimi, duhet të konsultohet me sistemin elektronik, të përcaktuar në nenin 38, dhe mund të mbajë një regjistrim të konsultimeve të tilla, me qëllim që të sigurojë se vendimi IDT, të cilin ka për qëllim të lëshojë, është në përputhje me vendimet e IDT, që tashmë janë lëshuar.

Neni 40
Zgjatja e përdorimit të vendimeve për informacionin detyrues
(Pika 9, e nenit 37, të Kodit)

1. Kur DPD-ja vendos të zgjasë periudhën e përdorimit, sipas paragrafit të tretë të pikës 9, të nenit 37, të Kodit, duhet të përcaktojë datën në të cilën përfundon zgjatja e përdorimit të vendimit në fjalë.

2. Kur DPD-ja vendos të zgjasë periudhën e përdorimit të një vendimi IDT, sipas paragrafit të tretë të pikës 9, të nenit 37, të Kodit, duhet të specifikojë, përveç datave të përmendura në pikën 1, sasitë e mallrave që mund të zhdoganohen gjatë periudhës së zgjatur të përdorimit.

Përdorimi i një vendimi, për të cilin është dhënë një zgjatje periudhe përdorimi, përfundon sapo këto sasi të jenë plotësuar.

Neni 41
Kufizimi i zbatimit të rregullave për rivlerësim dhe pezullim
(Pika 4, e nenit 28, të Kodit)

Nenet 23 deri në 26, në lidhje me rivlerësimin dhe pezullimin e vendimeve, nuk zbatohen për vendimet që lidhen me informacionin detyrues.

Seksioni 3
Operatori ekonomik i autorizuar

Nënseksioni 1
Përfitimet që rezultojnë nga statusi i operatorit ekonomik të autorizuar

Neni 42
Lehtësirat në lidhje me deklaratat e paranisjes
(Shkronja "b", e pikës 2, të nenit 40, të Kodit)

1. Kur një Operator Ekonomik i Autorizuar për Sigurinë dhe Mbrojtjen (OEAS), siç referohet në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 40, të Kodit, dorëzon në emër të tij një deklaratë paranisjeje, në formën e një deklarate doganore ose të rieksportit, nuk kërkohen detaje të tjera nga ato të deklaruara në këto deklarata.

2. Kur një OEAS dorëzon në emër të një personi tjetër, i cili është, gjithashtu, një OEAS, një deklaratë paranisjeje, në formën e një deklarate doganore ose të rieksportit, nuk kërkohen detaje të tjera nga ato të deklaruara në këto deklarata.

Neni 43
Trajtim më i favorshëm për sa i përket vlerësimit dhe kontrollit të riskut
(Pika 5, e nenit 40, të Kodit)

1. Operatori ekonomik i autorizuar (OEA) i nënshtrohet më pak kontrolleve fizike dhe dokumentare, krahasuar me operatorët e tjerë ekonomikë.

2. Kur një OEAS ka paraqitur një deklaratë përmbledhëse të hyrjes ose, në rastet e përmendura në nenin 122, të Kodit, një deklaratë doganore apo një deklaratë për magazinim të përkohshëm ose kur një OEAS ka depozituar një njoftim dhe ka ofruar akses ndaj detajeve që lidhen me deklaratën përmbledhëse të hyrjes në sistemin e tij informatik, siç referohet në pikën 8, të nenit 119, të Kodit, zyra doganore e hyrjes, e referuar në paragrafin e parë, të pikës 3, të nenit 119, të Kodit, duhet të njoftojë OEAS në rastet kur ngarkesa është përzgjedhur për kontroll fizik. Njoftimi duhet të bëhet para mbërritjes së mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Ky njoftim duhet t'i vihet në dispozicion edhe transportuesit, nëse është i ndryshëm nga OEAS, e referuar në paragrafin e parë të pikës 3, të nenit 259, me kusht që transportuesi të jetë një OEAS dhe të jetë i lidhur me sistemet informatike në lidhje me deklaratat e referuara në këtë paragraf.

Njoftimi nuk jepet kur rrezikohen kontrollet që duhet të kryhen ose rezultatet që rrjedhin prej tyre.

3. Kur një OEA depoziton një deklaratë për magazinim të përkohshëm ose një deklaratë doganore në përputhje me nenin 156, të Kodit, zyra doganore kompetente për pranimin e deklaratës për magazinim të përkohshëm apo deklaratës doganore në përputhje me nenin 156, të Kodit, duhet të njoftojë OEA kur ngarkesa përzgjidhet për kontroll doganor. Njoftimi duhet të bëhet përpara paraqitjes së mallrave në doganë.

Njoftimi nuk jepet kur rrezikohen kontrollet që duhet të kryhen ose rezultatet që rrjedhin prej tyre.

4. Kur dërgesat e deklaruara nga një OEA janë përzgjedhur për kontroll fizik apo dokumentar, këto kontrolle duhet të kryhen me prioritet.

Me kërkesë të një OEA-je, kontrollet mund të kryhen në një vend tjetër, të ndryshëm nga vendi ku mallrat duhet të paraqiten në doganë.

5. Njoftimet e referuara në pikat 2 dhe 3 nuk përfshijnë kontrollet doganore të vendosura në bazë të deklaratës për magazinim të përkohshëm ose të deklaratës doganore pas paraqitjes së mallit.

Neni 44
Përjashtimi nga trajtimi më i favorshëm
(Pika 5, e nenit 40, të Kodit)

Trajtimi më i favorshëm, i referuar në nenin 43, nuk zbatohet për kontrollet doganore që lidhen me nivele të larta të riskut apo me detyrimet e kontrollit të përcaktuara në një legjislacion tjetër në Republikën e Shqipërisë.

Megjithatë, autoritetet doganore kryejnë përpunimin, formalitetet dhe kontrollet e nevojshme për dërgesat e deklaruara nga një OEAS si çështje prioritare.

Nënseksioni 2
Aplikimi për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar

Neni 45
Aplikimi dhe kushtet për pranimin e aplikimit për statusin OEA
(Pikat 1, dhe 2, të nenit 27, të Kodit)

1. Aplikimi për një autorizim OEA duhet të bëhet me shkrim ose në formë elektronike, në përputhje me specimenin e përcaktuar në aneksin

12, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij

2. Aplikimi për marrjen e një autorizimi OEA paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

3. Përveç kushteve për pranimin e një aplikimi, të parashikuara në pikën 1, të nenit 19, me qëllim që aplikuesi të aplikojë për statusin OEA, së bashku me aplikimin duhet të paraqesë pyetësorin e vetëvlerësimit, sipas aneksit 13, "Pyetësori i vetëvlerësimit", të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, të plotësuar në mënyrën e duhur.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një aplikim të vetëm për statusin OEA, që mbulon të gjitha ambientet ekzistuese të biznesit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

5. Aplikuesi duhet të caktojë një pikë qendrore informacioni ose të emërojë një person kontakti brenda administratës së tij për t'i bërë lehtësisht të disponueshëm autoritetit doganor të gjithë informacionin e nevojshëm që provon përputhshmërinë me kërkesat për lëshimin e autorizimit OEA.

6. Aplikuesi, për aq sa është e mundur, i paraqet me mjete elektronike të dhënat e nevojshme për autoritetet doganore.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëshon autorizimin OEA në përputhje me modelin e përcaktuar në aneksin 14, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 46
Afati kohor për marrjen e vendimeve
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

1. Afati kohor për marrjen e vendimit të referuar në paragrafin e parë të pikës 3, të nenit 27, të Kodit, mund të zgjatet për një periudhë deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

2. Kur ka proces hetimi penal, që ngre dyshime nëse aplikuesi plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjën "b", të nenit 41, të Kodit, atëherë afati për të marrë vendimin zgjatet deri sa të përfundojnë ky proces.

Neni 47
Data e hyrjes në fuqi të autorizimit OEA
(Pika 4, e nenit 27, të Kodit)

Duke anashkaluar pikën 4, të nenit 27, të Kodit, autorizimi që siguron statusin OEA (autorizimi i OEA) hyn në fuqi në ditën e pestë pas marrjes së vendimit.

Neni 48
Efektet ligjore të pezullimit
(Shkronja "b", e pikës 4, të nenit 28, të Kodit)

1. Kur autorizimi OEA është pezulluar për shkak të mosrespektimit të ndonjë prej kritereve të përmendura në nenin 41, të Kodit, çdo vendim i marrë në lidhje me atë OEA, i cili është bazuar në autorizimin e OEA në përgjithësi ose në ndonjë nga kriteret specifike, të cilat çuan në pezullimin e këtij autorizimi, do ta pezullohet nga autoriteti doganor që e ka marrë këtë vendim.

2. Pezullimi i një vendimi, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor të marrë në lidhje me një OEA, nuk duhet të çojë në pezullimin automatik të autorizimit të OEA.

3. Kur një vendim në lidhje me një person, që është, njëkohësisht, OEAS dhe Operator Ekonomik i Autorizuar për Thjeshtësimet Doganore, siç përmendet në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 40, të Kodit (OEAD), është pezulluar në përputhje me pikën 1, të nenit 24, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në shkronjën "d", të nenit 41, të Kodit, autorizimi i tij si OEAD pezullohet, ndërsa autorizimi si OEAS mbetet i vlefshëm.

Kur një vendim në lidhje me një person, që është, njëkohësisht, OEAS dhe OEAD është pezulluar, në përputhje me pikën 1, të nenit 24, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në shkronjën "dh", të nenit 41, të Kodit, autorizimi i tij si OEAS pezullohet, ndërsa autorizimi si OEAD mbetet i vlefshëm.

Nënseksioni 3
Kriteret për dhënien e statusit OEA

Neni 49
Konformiteti
(Shkronja "a", e nenit 41, të Kodit)

1. Kur aplikuesi është një person (individ), kriteri i përcaktuar në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit, do të konsiderohet i përmbushur nëse gjatë tre viteve të fundit aplikuesi dhe, kur është rasti, punonjësi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikuesit, nuk ka kryer shkelje serioze ose shkelje të përsëritura të legjislacionit doganor e tatimor dhe nuk ka kryer vepra penale, që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike.

Kur aplikuesi nuk është një person (individ), kriteri i parashikuar në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit, do të konsiderohet i përmbushur kur gjatë tre viteve të fundit nuk ka kryer shkelje serioze apo shkelje të përsëritura të legjislacionit doganor e tatimor apo nuk ka kryer vepra penale, që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike asnjë nga personat në vijim:

a) aplikuesi;

b) personi i ngarkuar nga aplikuesi ose që ushtron kontroll mbi menaxhimin e tij;

c) personi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore.

2. Megjithatë, kriteri referuar në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit, mund të konsiderohet i përmbushur kur DPD-ja e konsideron shkelje me rëndësi të papërfillshme, në raport me numrin apo madhësinë e operacioneve doganore, dhe autoritetet doganore nuk krijojnë dyshime në lidhje me mirëbesimin e aplikuesit.

3. Kur personi i referuar në shkronjën "b", të pikën 1, është i vendosur ose ka vendqëndrimin e tij në një vend tjetër, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, DPD-ja do të vlerësojë përmbushjen e kriterit të përmendur në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit, mbi bazën e të dhënave dhe informatave që disponon.

4. Kur aplikuesi është i themeluar për më pak se 3 vjet, DPD-ja do të vlerësojë përmbushjen e kriterit të përmendur në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit, mbi bazën e të dhënave dhe informacioneve që disponon.

Neni 50
Sistem efikas i menaxhimit të të dhënave tregtare dhe të transportit
(Shkronja "c", e nenit 41, të Kodit)

1. Kriteri i përcaktuar në shkronjën "c", të nenit 41, të Kodit, do të konsiderohet i përmbushur nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Aplikuesi mban një sistem kontabiliteti në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuara të kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë, që lehtëson kontrollin doganor të bazuar në auditim, dhe mban një raport historik të të dhënave, që sigurojnë një gjurmë të auditimit nga momenti që të dhënat hyjnë në regjistra;

b) Të dhënat e mbajtura nga aplikuesi, për qëllime doganore, janë të integruara në sistemin e kontabilitetit të aplikuesit ose lejojnë që të bëhen kontrolle të kryqëzuara të informacionit me sistemin e kontabilitetit;

c) Aplikuesi lejon aksesin fizik të autoritetit doganor në sistemet e tij kontabël dhe, kur është e zbatueshme, në regjistrimet e tij tregtare e të transportit;

ç) Aplikuesi lejon aksesin elektronik të autoritetit doganor në sistemet e tij kontabël dhe, kur është e zbatueshme, në regjistrimet e tij tregtare e të transportit, nëse të dhënat ose regjistrimet janë mbajtur në mënyrë elektronike;

d) Aplikuesi ka një sistem logjistik që identifikon mallrat si mallra shqiptare ose joshqiptare dhe tregon, kur është e mundur, vendndodhjen e tyre;

dh) Aplikuesi ka një organizim administrativ që korrespondon me llojin dhe madhësinë e biznesit, i cili është i përshtatshëm për menaxhimin e qarkullimit të mallrave dhe ka kontrolle të brendshme, të afta për parandalimin, zbulimin e korrigjimin e gabimeve dhe parandalimin e zbulimin e transaksioneve të parregullta ose të paligjshme;

e) Kur është e zbatueshme, aplikuesi ka procedura efikase për trajtimin e licencave dhe të autorizimeve të dhëna, sipas masave të politikave tregtare ose në lidhje me tregtinë e produkteve bujqësore;

ë) Aplikuesi ka procedura efikase për arkivimin e të dhënave dhe informacionit dhe për mbrojtjen kundër humbjes së informacionit;

f) Aplikuesi siguron që punonjësit përkatës të jenë udhëzuar të informojnë autoritetet doganore nëse zbulohen vështirësi të përmbushjes së kritereve dhe përcakton procedurat për informimin e autoriteteve doganore për vështirësi të tilla;

g) Aplikuesi ka miratuar masat e duhura të sigurisë për të mbrojtur sistemin kompjuterik të tij nga ndërhyrja e paautorizuar dhe për të siguruar dokumentacionin e aplikuesit;

gj) Kur është e zbatueshme, aplikuesi ka procedura efikase për trajtimin e licencave të importit dhe eksportit lidhur me ndalimet e kufizimet, duke përfshirë masa për të dalluar mallrat që u nënshtrohen ndalimeve ose kufizimeve nga mallra të tjera dhe masa për të siguruar pajtueshmërinë me këto ndalime e kufizime.

2. Kur aplikuesi aplikon vetëm për një autorizim si një operator ekonomik i autorizuar për

sigurinë dhe mbrojtjen, siç referohet në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 40, të Kodit (OEAS), kërkesa e përcaktuar në shkronjën "d", të pikës 1, nuk do të zbatohet.

Neni 51
Aftësia paguese financiare
(Shkronja "ç", e nenit 41, të Kodit)

1. Kriteri i përcaktuar në shkronjën "ç", të nenit 41, të Kodit, do të konsiderohet i përmbushur, kur:

a) aplikuesi nuk është subjekt i procedurave të falimentimit;

b) gjatë tri viteve të fundit, para dorëzimit të aplikimit, aplikuesi i ka përmbushur detyrimet e tij financiare për pagesat e detyrimeve doganore dhe të gjitha detyrimet e tjera, taksat apo pagesat, të cilat janë mbledhur ose që kanë lidhje me importin apo eksportin e mallrave;

c) aplikuesi, në bazë të regjistrimeve dhe informacioneve në dispozicion për tre vitet e fundit, para dorëzimit të aplikimit, ka qëndrueshmëri të mjaftueshme financiare për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet e tij, duke pasur parasysh llojin dhe vëllimin e aktivitetit të biznesit, duke përfshirë që nuk ka asete negative neto, përveç rasteve kur ato mund të mbulohen.

2. Në qoftë se aplikuesi është i themeluar për më pak se 3 vjet, aftësia paguese e tij financiare, siç përmendet në shkronjën "ç", të nenit 41, të Kodit, do të verifikohet në bazë të të dhënave dhe informacioneve që janë në dispozicion.

Neni 52
Standardet praktike të kompetencave ose kualifikimet profesionale
(Shkronja "d", e nenit nenit 41, të Kodit)

1. Kriteri i përcaktuar në shkronjën "d", të nenit 41, të Kodit, konsiderohet i përmbushur në qoftë se plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

a) Aplikuesi ose personi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikuesit plotëson një nga standardet praktike të kompetencës në vijim:

i. Ka një eksperiencë praktike të provuar me një minimum prej 3 vitesh në çështjet doganore;

ii. Ka standardet e cilësisë në lidhje me çështjet doganore të miratuara nga një organ i standardizimit shqiptar apo evropian.

b) Aplikuesi ose personi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikuesit ka përfunduar me sukses trajnimin që mbulon legjislacionin doganor në fuqi, në masën e përfshirjes së tij në aktivitetet që kanë të bëjnë me doganat, të mbajtura nga një nga organet në vijim:

i. DPD-ja;

ii. një institucion shkollor i njohur për qëllime të sigurimit të kualifikimit të tillë nga DPD-ja ose një institucion publik përgjegjës për trajnim profesional;

iii. një shoqatë profesionale apo tregtare e njohur nga DPD-ja ose e akreditуar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim dhënien e një kualifikimi të tillë.

2. Kur personi i ngarkuar për çështjet doganore të aplikuesit është një person i kontraktuar, kriteri i përcaktuar në shkronjën "ç", të nenit 41, të Kodit, do të konsiderohet i përmbushur nëse personi i kontraktuar është një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësime doganore, siç referohet në shkronjën "a", të pikës 2, të neni 40, të Kodit (OEAD).

Neni 53
Standardet e sigurisë dhe të mbrojtjes
(Shkronja "dh", e nenit 41, të Kodit)

1. Kriteri i përcaktuar në shkronjën "dh", të nenit 41, të Kodit, konsiderohet i përmbushur nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Ndërtesat që do të përdoren në lidhje me operacionet e mbuluara nga autorizimi OEAS sigurojnë mbrojtje nga ndërhyrjet e paligjshme dhe janë ndërtuar nga materiale, të cilat i rezistojnë hyrjes së paligjshme;

b) Të jenë vendosur masat e duhura për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në zyra, zonat e transportit, bankinat e ngarkimit, zonat e ngarkesave dhe vende të tjera përkatëse;

c) Të jenë marrë masat për lëvizjen e mallrave, të cilat përfshijnë mbrojtje kundër hyrjes ose shkëmbimit të paautorizuar, keqpërdorimit të mallrave dhe kundër ndërhyrjes në njësitë e ngarkesave;

ç) Aplikuesi të ketë marrë masa që lejojnë identifikimin e qartë të partnerëve të tij të biznesit dhe të sigurojë, nëpërmjet implementimit të marrëveshjeve përkatëse kontraktuale apo masave të përshtatshme të tjera, në përputhje me modelin e biznesit të aplikuesit, se ata partnerë të biznesit

garantojnë sigurinë e pjesës së tyre në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit;

d) Aplikuesi kryen, për aq sa e lejon legjislacioni kombëtar, kontrolle të sigurisë për të punësuarit e ardhshëm, që do të punojnë në pozicione sensitive të sigurisë dhe, sipas rrethanave, kontrolle periodike të punonjësve aktualë, në pozita të tilla;

dh) Aplikuesi ka miratuar procedura të përshtatshme të sigurisë për çdo ofrues të jashtëm të shërbimeve të kontraktuara;

e) Aplikuesi siguron që stafi i tij të ketë përgjegjësinë e duhur për çështjet e sigurisë dhe të marrë pjesë rregullisht në programet për të rritur ndërgjegjësimin për këto çështje të sigurisë;

ë) Aplikuesi ka caktuar një person kontakti kompetent për çështjet lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen.

2. Kur aplikanti është mbajtës i një certifikate të sigurisë e të mbrojtjes, të lëshuar në bazë të një konvente ndërkombëtare ose të një standardi ndërkombëtar të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim, apo nga një standard evropian i një organi evropian standardizimi, këto certifikata merren parasysh kur kontrollohet pajtueshmëria me kriteret e përcaktuara në shkronjën "d", të nenit 41, të Kodit.

Kriteret do të konsiderohen të përmbushura në masën që është vërtetuar se kriteret për lëshimin e certifikatës janë identike ose ekuivalente me ato të përcaktuara në shkronjën "d", të nenit 41, të Kodit.

Kriteret do të konsiderohen të përmbushura kur aplikuesi është mbajtës i një certifikate të sigurisë e të mbrojtjes, të lëshuar nga një vend tjetër me të cilin Republika e Shqipërisë ka lidhur një marrëveshje që parashikon njohjen e asaj certifikate.

Neni 54
Shqyrtimi i kritereve
(Neni 27, i Kodit)

1. Për qëllime të shqyrtimit të kritereve të përcaktuara në shkronjat "b" e "d", të nenit 41, të Kodit, DPD-ja duhet të sigurojë që verifikimet janë kryer në vend, në të gjitha ambientet që janë të lidhura me aktivitetet doganore të aplikuesit.

2. DPD-ja, për të marrë një vendim, mund të marrë në konsideratë rezultatet e vlerësimeve apo të auditimeve të kryera, në masën që i përket shqyrtimit të kritereve të përmendura në nenin 41, të Kodit.

3. Për qëllimet e shqyrtimit nëse kriteret e përcaktuara në shkronjat "b", "c" e "d", të nenit 41, të Kodit, janë plotësuar, autoritetet doganore mund të marrin në konsideratë konkluzionet e ekspertëve të ofruara nga aplikuesi, kur eksperti që i ka hartuar konkluzionet nuk është i lidhur me aplikuesin, në kuptim të nenit 96.

4. Autoritetet doganore, kur shqyrtojnë përmbushjen e kritereve të përcaktuara në nenin 41, të Kodit, duhet të marrin në konsideratë karakteristikat specifike të operatorëve ekonomikë, në veçanti të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

5. Shqyrtimi i kritereve të përcaktuara në nenin 41, të Kodit, si dhe rezultatet e tij, duhet të dokumentohen nga DPD-ja.

Neni 55
Sistemi elektronik lidhur me statusin OEA
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

1. Në mbështetje të pikës 1, të nenit 17, të Kodit, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit që ka të bëjë me aplikimet për një autorizim si operator ekonomik i autorizuar (OEA) dhe autorizimet e dhëna OEA për çdo ngjarje të mëvonshme apo akt që mund të ndikojë më pas në vendimin e parë, duke përfshirë anulimin, pezullimin, revokimin ose ndryshimin apo rezultatet e çdo monitorimi ose rivlerësimi, do të përdoret një sistem elektronik i ndërtuar për ato qëllime.

2. Kur është e zbatueshme, në mënyrë të veçantë kur statusi OEA është bazë për miratimin e autorizimeve apo lehtësirave sipas legjislacionit në fuqi, autoritetet doganore kompetente mund t'i japin autoritetit përkatës kombëtar përgjegjës për sigurinë e aviacionit civil informacionin e mëposhtëm:

a) autorizimet OEAS, duke përfshirë emrin e mbajtësit të autorizimit dhe, kur është e zbatueshme, ndryshimin e tyre ose revokimin apo pezullimin e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar dhe arsyet për to;

b) çdo rivlerësim të autorizimeve OEAS dhe rezultatet e tyre.

Autoritetet kombëtare përgjegjëse për sigurinë e aviacionit civil do ta përdorin informacionin në fjalë vetëm për qëllime sigurie dhe do të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e këtij informacioni.

3. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar, të referuar në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, do të përdoret baza e të dhënave të sistemit qendror të DPD-së.

4. Deri në datën e përmirësimit të sistemit të informatizuar për OEA, sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera, të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave, në lidhje me aplikimet dhe vendimet dhe, për çdo veprim/ngjarje pasues, i cili mund të ndikojë në aplikimin ose vendimin.

5. Në rastet e përmendura në pikën 4, për aplikimet për statusin e OEA dhe autorizimet për dhënien e statusit të OEA do të përdoren formularët e përcaktuar në anekset përkatëse të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Një aplikues nuk është e nevojshme të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë kur një marrëveshje ndërkombëtare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një vendi tjetër, në të cilin është vendosur operatori ekonomik, parashikon njohjen reciproke të certifikatave OEA dhe përcakton masat administrative për kryerjen e kontrolleve të duhura në emër të autoritetit doganor të Republikës së Shqipërisë, në qoftë se kërkohet.

Neni 56
Procedura e konsultimit dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve
(Neni 27 i Kodit)

1. Nëse vlerësohet e nevojshme, autoritetet doganore mund të konsultohen me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, sa i takon verifikimit të plotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 41, të Kodit. Konsultimet kryhen në qoftë se shqyrtimi i një ose më shumë kritereve të përcaktuara në nenet 49 deri 54 nuk mund të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për shkak të mungesës së informacionit apo për pamundësinë e kontrollit të tij. Në këto raste, konsultimet do të bëhen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, duke filluar nga data e komunikimit të informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mënyrë që të lejojnë lëshimin e "Certifikatës OEA" ose refuzimin e aplikimit, brenda afateve të përcaktuara.

2. Kur, pas shqyrtimit të përcaktuar në nenin 54, institucioni i konsultuar vendos që aplikuesi nuk përmbush një ose më shumë kritere, rezultatet e konsultimeve, të dokumentuara në mënyrë të rregullt, do të dërgohen te Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila refuzon aplikimin.

Neni 57
Refuzimi i aplikimit
(Neni 27 i Kodit)

Refuzimi i aplikimit për OEA nuk cenon vendimet e favorshme të marra në lidhje me aplikuesin, në përputhje me legjislacionin doganor ekzistues, përveç rasteve kur dhënia e këtyre vendimeve të favorshme është e bazuar në përmbushjen e ndonjë prej kritereve OEA, që provohen se nuk janë përmbushur gjatë shqyrtimit të aplikimit OEA.

Neni 58
Kombinimi i të dyja llojeve të autorizimeve
(Pika 3, e nenit 40, të Kodit)

Kur një aplikues ka të drejtë t'i jepet edhe autorizimi OEAD dhe OEAS, DPD-ja mund të lëshojë një autorizim të kombinuar.

Neni 59
Revokimi i një autorizimi
(Neni 32 i Kodit)

1. Revokimi i një autorizimi OEA nuk cenon asnjë vendim të favorshëm, i cili është marrë në lidhje me të njëjtin person, përveç nëse statusi OEA ishte një kusht për këtë vendim të favorshëm ose nëse vendimi ishte bazuar në një kriter të listuar në nenin 41, të Kodit, i cili nuk është më i përmbushur.

2. Revokimi ose ndryshimi i një vendimi të favorshëm, i cili është marrë në lidhje me mbajtësit e autorizimit, nuk cenon automatikisht autorizimin OEA të atij personi.

3. Kur i njëjti person është një OEAD dhe një OEAS dhe kur neni 32 ose 15, i Kodit, është i zbatueshëm për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në shkronjën "ç", të nenit 41, të Kodit, autorizimi OEAD revokohet dhe autorizimi OEAS mbetet i vlefshëm.

Kur i njëjti person është një OEAS dhe një OEAD dhe kur neni 32, i Kodit, ose neni 32, është i zbatueshëm për shkak të mospërmbushjes së

kushteve të përcaktuara në shkronjën "d", të nenit 41, të Kodit, autorizimi OEAS revokohet dhe autorizimi OEAD mbetet i vlefshëm.

Neni 60
Monitorimi
(Pika 5, e nenit 28, të Kodit)

1. Autoritetet doganore duhet të informojnë DPD-në, pa vonesë, për çdo faktor që lind pas dhënies së statusit të OEA, i cili mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

2. Kur një autoritet doganor revokon një vendim të favorshëm, i cili është marrë në bazë të statusit të OEA, ai njofton DPD-në.

KREU 3
KONTROLLET DOGANORE

SEKSIONI 1
MENAXHIMI I RISKUT

Neni 61
Informacion i përgjithshëm mbi menaxhimin e riskut dhe vlerësimin e riskut
(Neni 47 i Kodit)

1. Për qëllime të nenit 47, të Kodit, autoritetet doganore kryejnë menaxhim risku për të bërë dallimin ndërmjet niveleve të riskut, që lidhen me mallrat objekt i kontrollit ose mbikëqyrjes doganore dhe për të përcaktuar nëse mallrat do të jenë objekt i kontrolleve të veçanta doganore.

2. Përcaktimi i niveleve të riskut bazohet në vlerësimin e gjasave që të ndodhë një ngjarje me risk dhe ndikimin që ajo do të ketë. Bazat e përzgjedhjes së ngarkesave ose deklarimeve, të cilat do jenë objekt i kontrolleve doganore, përfshijnë një element rastësor.

Neni 62
Institucionet publike që shkëmbejnë informacion dhe forma e bashkëpunimit
(Neni 48 i Kodit)

1. Për të mundësuar zbatimin korrekt të legjislacionit doganor si dhe për qëllim të menaxhimit të riskut, Administrata Doganore shkëmben informacion me institucionet publike të mëposhtme:

a) Autoritetet veterinare;
b) Autoritetet fito-sanitare;
c) Autoritetet sanitare;
ç) Autoritetet statistikore;
d) Autoritetet e tatim-taksave;
dh) Autoritetet përgjegjëse për luftën kundër mashtrimit;
e) Autoritetet përgjegjëse për ekonominë, politikën tregtare, duke përfshirë autoritetet bujqësore, kur duhet;
ë) Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar dhe transportin;
f) Autoritetet e pushtetit vendor;
g) Autoritetet policore dhe të krimit ekonomik;
h) Autoriteti i parandalimit të pastrimit të parave.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e pikës 1, në rast se konsiderohet e nevojshme për qëllim të menaxhimit të riskut, autoritetet doganore shkëmbejnë informacion edhe me institucione të tjera publike ose private, shqiptare apo të huaja, rast pas rasti, lidhur me të dhënat që ato zotërojnë.

Neni 63
Modalitetet e shkëmbimit të informacionit
(Neni 48, i Kodit)

1. Për qëllim të menaxhimit të riskut, institucionet e përmendura në nenin 62, si dhe organizma të tjerë publikë apo privatë, mund të shkëmbejnë periodikisht ose rast pas rasti të dhënat që ato zotërojnë në lidhje me hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, magazinimin, trafikun postar, qarkullimin e mallrave, rezultatet e kontrolleve të kryera etj.

2. Kategoritë e informacionit që do të shkëmbehet, frekuenca e këtij shkëmbimi dhe modalitetet përkatëse përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit, të lidhura për këtë qëllim.

Neni 64
Kushtet për shkëmbimin e të dhënave
(Neni 48, i Kodit)

Autoritetet doganore shkëmbejnë informacion me autoritetet e përcaktuara në nenin 62 vetëm nëse ky proces është i nevojshëm për plotësimin e detyrimeve të tyre ligjore, në lidhje me lëvizjen e mallrave që i nënshtrohen një procedure doganore.

Neni 65
Masat për zbatimin uniform të kontrolleve doganore
(Neni 47, i Kodit)

Për qëllime të pikës 3, të nenit 47, të Kodit, me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave,

përcaktohen masat që sigurojnë zbatimin uniform të kontrolleve doganore, përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi riskun dhe rezultatet e analizave të riskut, kriteret dhe standardet e përbashkëta të riskut, masat e kontrollit dhe fushat prioritare të kontrollit.

Neni 66
Sistemi elektronik në lidhje me menaxhimin e riskut dhe kontrollet doganore
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

1. Për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit që ka të bëjë me komunikimin ndërmjet autoriteteve doganore të çdo informacioni të lidhur me riskun, do të përdoret një sistem elektronik i ndërtuar për këto qëllime (sistemi i menaxhimit të riskut doganor).

2. Sistemi i përmendur në pikën 1, do të përdoret, gjithashtu, për komunikimin ndërmjet autoriteteve doganore në zbatim të standardeve dhe kritereve të përbashkëta të riskut, zonave të kontrollit me prioritet të përbashkëta, menaxhimin e krizave doganore, shkëmbimin e informacionit lidhur me riskun dhe rezultatet e analizave të riskut, siç përmendet në pikën 5, të nenit 47, të Kodit, si dhe rezultatet e kontrolleve doganore.

Seksioni 2
Bagazhi i transportuar nga ajri dhe deti

Nënseksioni 1
Bagazhi i dorës dhe bagazhi i regjistruar të cilat transportohen nga ajri

Neni 67
Fluturimet transit
(Neni 50, i Kodit)

1. Kontrollet doganore dhe formalitetet e zbatueshme në bagazhet e dorës dhe në bagazhet e regjistruara të personave që fluturojnë nga një aeroport jo i Republikës së Shqipërisë në një avion, i cili, pas një ndalese në një aeroport të Republikës së Shqipërisë vazhdon në një tjetër aeroport të Republikës së Shqipërisë, do të kryhen në aeroportin e fundit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Bagazhet e dorës dhe bagazhi i regjistruar u nënshtrohen rregullave të zbatueshme për bagazhin e personave që vijnë nga një vend tjetër, përveç rastit kur personi që mban një bagazh të tillë provon statusin e mallrave të përfshira në të si mallra shqiptare.

2. Kontrollet doganore dhe formalitetet e zbatueshme në bagazhet e dorës dhe bagazhet e regjistruara të personave që fluturojnë nga një aeroport i Republikës së Shqipërisë në një avion, i cili ndalon në një aeroport tjetër të Republikës së Shqipërisë para se të vazhdojë për në një aeroport jo të Republikës së Shqipërisë, do të kryhet në aeroportin e parë ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Bagazhi i dorës, për të qartësuar statusin doganor të mallrave shqiptare, mund të jetë objekt kontrolli në aeroportin e fundit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë ku avioni ndalon.

Neni 68
Fluturimet transit në avionin e biznesit dhe atë turistik
(Neni 50, i Kodit)

Kontrollet doganore dhe formalitetet e zbatueshme për bagazhin e personave në bordin e avionit të biznesit ose atë turistik, kryhen në aeroportet e mëposhtme:

a) Për fluturimet që vijnë nga një aeroport jo i Republikës së Shqipërisë dhe ku avioni, pas një ndalese në një aeroport të Republikës së Shqipërisë vazhdon në një aeroport tjetër të Republikës së Shqipërisë, kryhen në aeroportin e parë ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë;

b) Për fluturimet që vijnë nga një aeroport i Republikës së Shqipërisë dhe ku avioni, pas një ndalese në një aeroport të Republikës së Shqipërisë, vazhdon për në një aeroport tjetër jo të Republikës së Shqipërisë, në aeroportin e fundit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Neni 69
Fluturime me transbord në hyrje
(Neni 50, i Kodit)

1. Kur bagazhi mbërrin në një aeroport të Republikës së Shqipërisë në bordin e një avioni që vjen nga një aeroport jo i Republikës së Shqipërisë dhe është transferuar/transborduar në atë aeroport të Republikës së Shqipërisë në një avion tjetër, i cili fluturon brenda Republikës së Shqipërisë, do të zbatohen pikat 2 dhe 3.

2. Kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhet e regjistruara duhet të kryhen në aeroportin e fundit ndërkombëtar të

Republikës së Shqipërisë, në mbërritjen e fluturimit brenda Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhet e regjistruara, që vijnë nga një aeroport jo i Republikës së Shqipërisë dhe transferohen/transbordohen në një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, në një avion që shkon për në një tjetër aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, mund të kryhen në aeroportin ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, ku bëhet transferimi i bagazhit të regjistruar.

Kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhet e regjistruara, në raste përjashtimore dhe si shtesë e kontrolleve e formaliteteve të përcaktuara në pikën 1, mund të kryhen në aeroportin e parë ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, kur është e nevojshme, në vijim të kontrollit të bagazhit të dorës.

3. Kontrollet doganore dhe formalitetet e zbatueshme për bagazhin e dorës duhet të kryhen në aeroportin e parë ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Kontrollet doganore shtesë dhe formalitet e zbatueshme për bagazhin e dorës mund të kryhen në aeroportin e mbërritjes së një fluturimi brenda Republikës së Shqipërisë, vetëm në raste përjashtimore, kur konsiderohet e nevojshme në vijim të kontrolleve të bagazhit të regjistruar.

Neni 70
Fluturimet me transbord në dalje
(Neni 50, i Kodit)

1. Kur bagazhi ngarkohet në një aeroport të Republikës së Shqipërisë, në një avion të një fluturimi brenda Republikës së Shqipërisë, dhe më pas transferohet/transbordohet në një tjetër aeroport të Republikës së Shqipërisë, në një avion, destinacioni i të cilit është një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë, do të zbatohen pikat 2 dhe 3.

2. Kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhet e regjistruara duhet të kryhen në aeroportin e parë ndërkombëtar të nisjes nga Republika e Shqipërisë. Megjithatë, kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhet e regjistruara, pasi janë ngarkuar në një avion në një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë dhe transbordohen në një aeroport tjetër ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, në një avion me destinacion një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë, mund të kryhen në aeroportin ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, ku kryhet transbordimi i bagazhit të dorës.

Kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhet e regjistruara, në raste përjashtimore dhe përveç kontrolleve e formaliteteve të përcaktuara në pikën 1, mund të kryhen në aeroportin e fundit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, kur konsiderohet e nevojshme, në vijim të kontrolleve të bagazhit të dorës.

3. Kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhin e dorës duhet të kryhen në aeroportin e fundit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Kontrollet doganore shtesë dhe formalitetet që zbatohen për bagazhin e dorës mund të kryhen në aeroportin e nisjes së një fluturimi, brenda Republikës së Shqipërisë, vetëm në raste përjashtimore, kur konsiderohet e nevojshme, në vijim të kontrolleve të bagazhit të regjistruar.

Neni 71
Transbordimi në një avion turistik apo biznesi
(Neni 50, i Kodit)

1. Kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhet që mbërrijnë në një aeroport të Republikës së Shqipërisë në bordin e një fluturimi të planifikuar ose çarteri, nga një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë, dhe transbordohen në atë aeroport të Republikës së Shqipërisë, në një avion turistik apo biznesi, në një fluturim brenda Republikës së Shqipërisë, do të kryhen në aeroportin e mbërritjes së fluturimit të planifikuar apo çarterit.

2. Kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen për bagazhin e ngarkuar në një aeroport të Republikës së Shqipërisë, në një avion turistik apo biznesi, në një fluturim brenda Republikës së Shqipërisë për transbordim në një aeroport tjetër të Republikës së Shqipërisë, në një fluturim të planifikuar apo çarter, destinacioni i të cilit është një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet të kryhen në aeroportin e nisjes së fluturimit të planifikuar apo çarterit.

Neni 72
Transferimet ndërmjet aeroporteve në territorin e Republikës së Shqipërisë
(Neni 50, i Kodit)

Autoritetet doganore mund të kryejnë kontrolle në aeroportin ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, ku bëhet transferimi i bagazhit të regjistruar, si në vijim:

a) Bagazhet që vijnë nga një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë dhe transferohen në një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, në një avion që fluturon për në një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë;

b) Bagazhet, pasi janë ngarkuar në një avion në një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, për fluturim në një aeroport tjetër ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në një avion me destinacion një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 73
Masat për parandalimin e transferimit të paligjshëm
(Neni 50, i Kodit)

Autoritetet doganore duhet të sigurojnë që:

a) në mbërritje në një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, ku duhet të kryhen kontrollet doganore, të bëhet monitorimi i çdo transferimi të mallrave që gjenden në bagazhin e dorës, përpara se të jenë kryer kontrolle në atë bagazh;

b) në nisje nga një aeroport ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë, ku duhet të kryhen kontrollet doganore, të bëhet monitorimi i çdo transferimi të mallrave që gjenden në bagazhin e dorës, pasi të jenë kryer kontrolle në atë bagazh;

c) në mbërritjen në një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, ku duhet të kryhen kontrollet doganore, marrjen e masave të duhura për të parandaluar çdo transferim të mallrave që gjenden në bagazhin e regjistruar, përpara se të jenë kryer kontrolle në atë bagazh;

ç) në nisje nga një aeroport ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë, ku duhet të kryhen kontrollet doganore, janë marrë masat e duhura për të parandaluar çdo transferim të mallrave të përfshira në bagazhin e regjistruar, pasi të jenë kryer kontrolle në atë bagazh.

Neni 74
Etiketa e bagazhit
(Neni 50, i Kodit)

Bagazhet e regjistruara në një aeroport të Republikës së Shqipërisë do të identifikohen me një etiketë të ngjitur në bagazh. Modeli dhe karakteristikat teknike të etiketës përcaktohen në aneksin 12-03, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 75
Lista e aeroporteve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë
(Neni 50, i Kodit)

DPD-ja publikon listën e aeroporteve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe përditëson çdo ndryshim në atë listë.

Nënseksioni 2
Bagazhi i transportuar nga deti

Neni 76
Anijet për shëtitje/argëtim
(Neni 50, i Kodit)

Kontrollet doganore dhe formalitetet e zbatueshme për bagazhin e personave në bordin e anijes për shëtitje/argëtim do të kryhen në të gjitha portet e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga origjina apo destinacioni i anijes.

Neni 77
Kalimet e transferimit
(Neni 50, i Kodit)

Kontrollet doganore dhe formalitetet e zbatueshme për bagazhin e personave që përdorin një shërbim detar, që sigurohet nga e njëjta anije, e cila kryen udhëtime të njëpasnjëshme nga një vend jashtë Republikës së Shqipërisë dhe që ndalon ose përfundon në një port jo të Republikës së Shqipërisë, do të kryhen në çdo port të Republikës së Shqipërisë, në të cilin bagazhi është ngarkuar ose shkarkuar.

KREU 4
Përfaqësimi në doganë

Seksioni 1
Përfaqësimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë

Neni 78
E drejta e përfaqësimit
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

1. Në zbatim të pikës 1, të nenit 24, të Kodit, të gjitha përfaqësimet e tërthorta duhet të bëhen vetëm nga agjentë doganorë të licencuar.

2. Agjentë doganorë konsiderohen personat (individët) të licencuar nga DPD-ja për të kryer formalitetet doganore.

Personi (individi), në këto raste, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë shtetësi shqiptare;

b) Të ketë diplomë universitare;

c) Të gjykohet i besueshëm nga administrata doganore;

ç) Të kalojë provimin e parashikuar në nenin 82;

d) Të ketë eksperiencë pune si punonjës pranë një agjencie doganore jo më pak se 1 vit;

dh) Nuk duhet të jetë i punësuar në administratë publike apo shtetërore.

Dokumentacioni që duhet të depozitohet për licencim do të përcaktohet me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

3. Agjentët doganorë të licencuar organizohen në agjenci doganore si persona juridikë, aktiviteti kryesor i të cilëve ka të bëjë me kryerjen e të gjitha formaliteteve doganore, për çdo lloj regjimi doganor në emër të tij, por për llogari të një personi tjetër.

4. Agjencia doganore, në këto raste, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) Të gjykohet e besueshme nga administrata doganore;

b) Të paraqesë një kopje të vendimit për regjistrimin e tij si person juridik;

c) Të depozitojë një garanci në shumën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, në përputhje me nenet 84 deri 93, të Kodit.

Dokumentacioni për përmbushjen e kushteve që duhet të depozitohet për licencim përcaktohet me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

5. Personat që kanë kryer shkelje të qëllimshme ose të përsëritura të legjislacionit doganor, të akcizës ose atij tatimor, si edhe që janë përfshirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm ose që janë dënuar për vepra penale, nuk kanë të drejtë të marrin licencë për të vepruar si agjentë doganorë. Po kështu, nuk kanë të drejtë të rimarrin licencë ata persona, të cilëve u është revokuar nga autoritetet doganore licenca e lëshuar për agjencitë doganore para datës 1 qershor 2017.

6. Të gjitha dokumentet e nënshkruara nga një agjent doganor duhet të vulosen me vulën e tij personale. Kjo vulë duhet të ketë emrin e agjentit, emrin e agjencisë dhe numrin identifikues të tij. Nënshkrimi dhe/ose vulosja mund të bëhet edhe në rrugë elektronike, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Përfaqësuesit e drejtpërdrejtë, për t'u licencuar nga DPD-ja duhet të plotësojnë këto kushte:

a) Të kenë shtetësi shqiptare;

b) Të kenë diplomë universitare;

c) Të gjykohen të besueshëm nga administrata doganore;

ç) Të zotërojnë një marrëveshje kontraktuale;

d) Të zotërojnë një prokurë përfaqësimi;

dh) Nuk duhet të jenë të punësuar në administratën publike apo shtetërore.

8. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave përcakton me udhëzim procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për licencimin e përfaqësimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

Neni 79
Regjistri i përfaqësuesve doganorë
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

DPD-ja regjistron agjentët doganorë të licencuar dhe personelin e tyre ndihmës, si dhe përfaqësuesit e drejtpërdrejtë, në një regjistër të veçantë. Forma dhe përmbajtja e këtij regjistri përcaktohen nga DPD-ja.

Neni 80
Prova e përfaqësimit
(Neni 25 i Kodit)

1. Autoritetet doganore, për çdo operacion doganor, mund t'i kërkojnë çdo personi, i cili deklaron që po vepron si një përfaqësues doganor, prova që atij i është lëshuar akti ligjor i përfaqësimit (autorizim/prokurë) nga i përfaqësuari, për kryerjen e formaliteteve doganore.

2. Ky autorizim duhet të përmbajë, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

a) Emrin e autorizuesit;

b) Shtrirjen/tagrat e përfaqësimit;

c) Numrin e NUIS/NIPT, në rast se autorizuesi është person juridik ose fizik;

ç) Firmën e autorizuesit.

Neni 81
Njoftimi për ndryshimin e informacionit të dhënë autoriteteve doganore
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

1. Të gjithë përfaqësuesit doganorë janë të detyruar të njoftojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, DPD-në për të gjitha ndryshimet e adresave të tyre, të statusit ligjor dhe të atij informacioni që u është dhënë autoriteteve doganore kur kanë paraqitur kërkesën e tyre për t'u bërë përfaqësues doganorë.

2. Agjentët doganorë mund të transferohen nga një agjenci doganore në një tjetër vetëm me miratim të DPD-së.

Neni 82
Kërkesa për pajisjen me licencë në rastin e përfaqësimit të tërthortë
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

1. Kërkesa për të marrë licencën e agjentit doganor paraqitet pranë DPD-së. Kërkesa duhet bërë me shkrim dhe shoqërohet me dokumentet e kërkuara në përputhje me pikën 2, të nenit 78. Dokumentet duhet të paraqiten pranë DPD-së.

2. Provimet për marrjen e licencës së agjentit doganor organizohen nga DPD-ja. Provimi konsiston në një kontroll, me shkrim, mbi njohuritë e përgjithshme teorike si dhe zbatimin praktik të legjislacionit doganor.

3. Komisioni që drejton provimin kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe ka në përbërje të tij drejtorin e procedurave, ose përgjegjësin e një prej sektorëve në këtë drejtori, dhe dy kryetarë degësh doganore.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave lëshon licencë pa afat për të vepruar si agjent doganor vetëm për kandidatët që kalojnë provimin dhe përmbushin të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara. Kjo licencë lëshohet kur plotësohen të gjitha kushtet. Çdo agjenti doganor i jepet një numër identifikimi individual.

Neni 83
Personeli ndihmës
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

1. Agjencitë doganore mund të punësojnë personel ndihmës. Personeli ndihmës autorizohet nga DPD-ja dhe duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë shtetësi shqiptare;

b) Të jetë mbi moshën 21 vjeç;

c) Të gjykohet i besueshëm nga administrata doganore.

2. Personeli ndihmës nuk lejohet të nënshkruajë asnjë deklaratë doganore. Deklaratat nënshkruhen vetëm nga një agjent doganor i licencuar.

3. Agjentët doganorë, pa rënë ndesh me përgjegjësinë ligjore të vetë personelit, mbajnë përgjegjësi të plotë për veprimet e ndërmarra nga personeli i tyre ndihmës gjatë kryerjes së formaliteteve doganore.

Neni 84
Karta e identifikimit
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

Agjentët doganorë dhe personeli i tyre ndihmës pajisen me kartë identifikimi, të cilën duhet t'a mbajnë në çdo rast ku dhe kur ata ushtrojnë aktivitetin e tyre si përfaqësues. Forma dhe përmbajtja e kartës së identifikimit parashikohet me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Neni 85
Regjistrimi i operacioneve
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

1. Agjentët doganorë duhet të mbajnë një regjistër ku regjistrohen të gjitha operacionet e kryera prej tyre. Forma dhe përmbajtja e këtij regjistri përcaktohen nga DPD-ja.

2. Në përputhje me kufirin kohor të përcaktuar në nenin 52, të Kodit, agjentët doganorë duhet të ruajnë autorizimet e përfaqësimit, regjistrat dhe dokumentet që dëshmojnë se kanë paguar të gjitha detyrimet.

Neni 86
Pagesa e detyrimeve
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

Agjentëve doganorë u kërkohet të paguajnë çdo borxh doganor që lind, në përputhje me nenet 72, pika 3, dhe 76, pika 3, të Kodit.

Neni 87
Pezullimi, shfuqizimi dhe ankimi
(Nenet 24, 25 dhe 28, të Kodit)

1. Agjentët doganorë, që punojnë për një person juridik, janë përgjegjës për çdo informacion të dhënë në një deklaratë doganore apo kur kryejnë ndonjë shkelje, siç parashikohet në titullin IX, të Kodit.

2. Pa rënë ndesh me të gjitha formalitetet e parashikuara nga Kodi, për vjeljen e borxhit doganor drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me një vendim të arsyetuar, mund të pezullojë licencën e agjentit doganor, në rastet e mëposhtme:

a) Për mospagim të detyrimeve doganore;

b) Për mosplotësim të ndonjë detyrimi tjetër ndaj autoriteteve doganore;

c) Kur dyshohet se ka kryer një shkelje të legjislacionit doganor në fuqi.

Pezullimi zgjat për aq kohë sa të përmbushen detyrimet e mësipërme.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me një vendim të arsyetuar, shfuqizon licencën dhe, më pas, çregjistron nga regjistri agjentët doganore, të cilët:

a) nuk arrijnë të përmbushin ndonjë nga kushtet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "c", të pikës 2, të nenit 78, ose shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 78;

b) kryejnë, në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur, një nga shkeljet e parashikuara në titullin IX, të Kodit;

c) janë dënuar për shkelje të tjera fiskale ose penale.

4. Vendimi për shfuqizimin ose pezullimin e licencës duhet t'i njoftohet personit të interesuar brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e marrjes së vendimit. Agjenti doganor, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni, mund të ankohet kundër vendimit të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave te ministri përgjegjës për financat. Në këto raste, ankimi duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, mbi bazën e të cilit mbështeten argumentet e ankimit. Nëse ankimi nuk bëhet brenda afatit dhe/ose nuk shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm, ankimi konsiderohet se nuk është bërë.

5. Ministri përgjegjës për financat merr një vendim dhe ia njofton personit të interesuar brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të ankimit, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm mbi bazën e të cilit mbështeten argumentet e ankimit. Kundër vendimit të ministrit përgjegjës për financat, personi i interesuar mund të ankohet në Gjykatën Administrative.

6. Paraqitja e ankimit nuk ndërpret efektet ligjore të shfuqizimit ose të pezullimit.

Neni 88
Vlefshmëria e licencave
(Nenet 24 dhe 25, të Kodit)

1. Licencat e lëshuara agjencive doganore para datës 1 qershor 2017 janë të vlefshme për sa kohë nuk janë pezulluar apo shfuqizuar, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

2. Licencat e lëshuara për agjentët doganorë persona fizikë, para datës 1 qershor 2017, do të vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me qëllim përmbushjen e të gjitha detyrimeve.

TITULLI II
FAKTORËT, MBI BAZËN E TË CILËVE ZBATOHEN DETYRIMET E IMPORTIT OSE EKSPORTIT DHE MASA TË TJERA NË KUADËR TË TREGTISË SË MALLRAVE

KREU 1
Trajtimi tarifor favorizues për arsye të llojit të mallrave dhe për arsye të përdorimit të tyre të veçantë

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 89
(Pika 2, e nenit 56 të Kodit)

Në përputhje me shkronjën "e", të pikës 2, të nenit 56, të Kodit, ky kre përcakton dispozitat lidhur me trajtimin tarifor favorizues.

Seksioni 2
Trajtimi tarifor favorizues për arsye të natyrës së mallrave

Nënseksioni 1
Mallrat që u nënshtrohen disa kushteve

Neni 90
Kushti i denatyrimit dhe kushti për disa tipe farash
(Shkronja "e", e pikës 2, e nenit 56, të Kodit)

1. Klasifikimi në nënkrerët tariforë, të përcaktuara në NKM, i nënshtrohet kushtit të denatyrimit, në mënyrë që mallrat të jenë të papërshtatshëm për konsum njerëzor, duke përdorur një nga denatyruesit dhe sasitë e përcaktuara në NKM.

Denatyrimi duhet të kryhet në mënyrë të tillë, që të sigurojë se produkti që do të denatyrohet dhe lënda denatyruese janë përzier në mënyrë të njëtrajtshme dhe nuk mund të ndahen përsëri në një mënyrë ekonomikisht të vlefshme.

2. Për disa tipe farash, klasifikimi në nënkrerët tariforë, i përcaktuar në NKM-ja, i nënshtrohet kushtit që personi i interesuar u provon autoriteteve doganore kompetente të Republikës së Shqipërisë se farat do të përdoren realisht për mbjellje.

Nënseksioni 2
Lejimi i mallrave me trajtim tarifor favorizues, për arsye të përdorimit të tyre të veçantë

Neni 91
Kushtet
(Shkronja "e", e pikës 2, e nenit 56, të Kodit)

1. Vendosja e mallrave në qarkullim të lirë, me trajtim tarifor favorizues për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, është objekt i lëshimit të një autorizimi, me shkrim, për personin që importon mallrat ose që i ka importuar ato për qarkullim të lirë. Autorizimi në fjalë lëshohet nga autoritetet doganore me aplikimin e personit të interesuar. Në këto raste zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e nenit 84 e në vijim të Kodit.

Aplikimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin dhe adresën e kërkuesit;

b) Një përshkrim përmbledhës të impianteve që do të përdoren për kryerjen e trajtimeve të propozuara;

c) Llojin e trajtimit të propozuar;

ç) Llojin dhe sasinë e mallrave që do të përdoren;

d) Kur është rasti, llojin, sasinë dhe përshkrimin tarifor të mallrave të përftuara. Personi i interesuar u mundëson autoriteteve doganore të identifikojnë mallrat në ambientin ose ambientet e tij gjatë gjithë procesit të trajtimit të tyre.

2. Të gjitha mallrat duhet të përdoren për qëllimin e veçantë, të përcaktuar brenda një viti nga data në të cilën nga autoritetet doganore është pranuar deklarata për qarkullim të lirë.

Afati kohor, i përcaktuar, mund të zgjatet nga autoritetet doganore në qoftë se mallrave nuk u është caktuar përdorimi i veçantë, i përcaktuar, si rrjedhojë e rrethanave të paparashikuara ose forcave madhore apo kërkesave të domosdoshme që lindin gjatë trajtimit të mallrave.

Mallrat konsiderohen se janë përdorur në mënyrën e veçantë kur të gjitha mallrat janë përdorur në këtë mënyrë, brenda kufirit kohor të vendosur.

Mbetjet dhe hedhurinat, që dalin nga trajtimi i mallrave, dhe firot, si pasojë e humbjeve natyrore, konsiderohen si mallra, të cilëve u është caktuar një përdorim i veçantë.

Autoritetet doganore mund të kufizojnë periudhën e vlefshmërisë së autorizimit, të përmendur në pikën 1.

Kur autorizimi shfuqizohet, mbajtësi i autorizimit paguan, menjëherë, detyrimet e importit, të përcaktuara në përputhje me nenin 75, të Kodit, për ato mallra, të cilave nuk u është përcaktuar ende një përdorim i veçantë.

3. Mbajtësi i autorizimit është i detyruar:

a) t'i përdorë mallrat për qëllimin e caktuar;

b) të mbajë dhe të ruajë regjistrime, për t'u mundësuar autoriteteve doganore kryerjen e çdo kontrolli që ata e konsiderojnë të nevojshëm, për të siguruar se mallrat janë vendosur në përdorimin e veçantë të përcaktuar.

4. Autoritetet doganore nuk miratojnë përdorimin e mallrave në një mënyrë të ndryshme nga ajo që është parashikuar për trajtimin tarifor, të përmendur në pikën 2, për aq kohë sa mbajtësi i autorizimit t'u argumentojë në mënyrë bindëse

autoriteteve doganore se ka qenë e pamundur, për arsye që lidhen me situatën e tij ose të vetë mallrave, që t'i vendosë ato në përdorimin e veçantë të përcaktuar.

5. Miratimi i përmendur në këtë kapitull e kushtëzon mbajtësin e autorizimit të paguajë shumën e detyrimeve të importit që përcaktohet në nenin 75, të Kodit.

6. Autoritetet doganore nuk do të lejojnë eksportimin e mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose shkatërrimin e mallrave nën mbikëqyrjen doganore, për aq kohë sa mbajtësi i autorizimit nuk u ka argumentuar, në mënyrë bindëse se ka qenë e pamundur, për arsye që lidhen me situatën e tij ose të vetë mallrave, që t'i vendosë ato në përdorimin e veçantë, të përcaktuar. Kur miratohet eksportimi i mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, mallrat konsiderohen si mallra joshqiptare, nga momenti i pranimit të deklaratës së eksportit.

KREU 2
Tarifa doganore dhe klasifikimi tarifor i mallrave

Seksioni 1
Menaxhimi i kuotave tarifore

Neni 92
Rregullat e përgjithshme për menaxhimin e kuotave tarifore
(Pika 4, e nenit 56, të Kodit)

1. Kuotat tarifore të hapura në përputhje me legjislacionin në fuqi, që i referohen metodës së administrimit në këtë nen dhe në nenet 93 deri 95, do të menaxhohen në përputhje me rendin kronologjik të datave të pranimit të deklaratave doganore për çlirim në qarkullim të lirë.

2. Për qëllime të këtij seksioni, deklarata për çlirim në qarkullim të lirë, e pranuar nga autoritetet doganore në 1, 2 ose 3 janar, do të konsiderohet se është pranuar më 3 janar, të të njëjtit vit. Megjithatë, kur një nga ato ditë është e shtunë apo e diel, një pranim i tillë do të konsiderohet sikur ka ndodhur më 4 janar të atij viti.

3. Për qëllime të këtij seksioni, ditët e punës nënkuptojnë ditët që nuk janë ditë pushimi për institucionet publike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 93
Përgjegjësitë për menaxhimin e kuotave tarifore
(Pika 4, e nenit 56, të Kodit)

1. Autoritetet doganore do të shqyrtojnë nëse një kërkesë për të përfituar nga një kuotë tarifore, e bërë nga deklaruesi në një deklaratë doganore për çlirim në qarkullim të lirë, është e vlefshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi lidhur me hapjen e kuotës tarifore.

2. Kur deklarata doganore për çlirim në qarkullim të lirë, që përmban një kërkesë të vlefshme nga deklaruesi për të përfituar nga kuota tarifore, pranohet dhe të gjitha dokumentet mbështetëse të kërkuara për dhënien e kuotës tarifore u janë dhënë autoriteteve doganore, autoritetet doganore kompetente do të tërheqin, nëpërmjet sistemit elektronik, nga kontingjenti tarifor sasinë përkatëse që i përkon nevojave të tij.

Neni 94
Anulimi i kërkesave dhe kthimi i sasive të pashfrytëzuara, të ndara sipas kuotave tarifore
(Pika 4, e nenit 56, të Kodit)

1. Autoritetet doganore do të kthejnë menjëherë, në sistemin elektronik, të përmendur në nenin 95, çdo sasi që është tërhequr në mënyrë të gabuar. Megjithatë, detyrimi për t'u kthyer nuk zbatohet kur një shpërndarje e gabuar, që përfaqëson një borxh doganor prej më pak se vlera ekuivalente në lekë të 10 eurove, zbulohet pas muajit të parë, që vjen pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së kuotës tarifore në fjalë.

2. Kur autoritetet doganore bëjnë të pavlefshme deklaratën doganore, në lidhje me mallrat që janë objekt i një kërkese për të përfituar nga kuota tarifore, autoritetet doganore duhet të anulojnë të gjithë kërkesën për të përfituar nga kuota tarifore. Autoritetet doganore kompetente, menjëherë, do të kthejnë sasinë e caktuar në sistemin elektronik, të përmendur në nenin 95.

Neni 95
Sistemi elektronik në lidhje me menaxhimin e kuotave tarifore
(Pika 1, e nenit 17, dhe pika 4, e nenit 56, të Kodit)

Për menaxhimin e kuotave tarifore do të përdoret një sistem elektronik i ngritur për këtë qëllim, sipas pikës 1, të nenit 17, të Kodit.

Seksioni 2
Mbikëqyrja e çlirimit për qarkullim të lirë apo të eksportit të mallrave

Neni 96
Rregullat e përgjithshme për mbikëqyrjen e çlirimit për qarkullim të lirë apo të eksportit të mallrave
(Pika 5, e nenit 56, të Kodit)

1. Kur DPD-ja përcakton që mallra të caktuara do të jenë subjekt i mbikëqyrjes nga çlirimi për qarkullim të lirë ose eksport, ajo duhet të informojë autoritetet doganore për kodet e NK-së të këtyre mallrave dhe të dhënat e nevojshme për qëllime të mbikëqyrjes, në kohën e duhur, para se kërkesa e mbikëqyrjes të bëhet e zbatueshme.

Lista e të dhënave, të cilat mund të kërkohen nga DPD-ja për qëllime të mbikëqyrjes, është përcaktuar në aneksin 21-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Kur mallrat janë bërë objekt i mbikëqyrjes nga çlirimi për qarkullim të lirë ose në eksport, autoritetet doganore do t'i sigurojnë DPD-së të dhënat mbi deklaratat doganore për procedurën përkatëse, të paktën një herë në javë.

3. Kur mallrat janë vendosur nën një regjim doganor në bazë të deklaratës së thjeshtuar, siç përmendet në nenin 152, të Kodit, ose nëpërmjet hyrjes në regjistrimet e deklaruesit, siç përmendet në nenin 165, të Kodit, dhe të dhënat e kërkuara nga DPD-ja nuk ishin në dispozicion në kohën kur mallrat janë çliruar, në përputhje pikën 1, të nenit 175, të Kodit, autoritetet doganore do t'i sigurojnë DPD-së këtë informacion pa vonesë, pas marrjes së deklaratës plotësuese, të parashikuar në nenin 153, të Kodit.

4. Kur detyrimi për të paraqitur një deklaratë plotësuese nuk është përmbushur në përputhje me pikën 3, të nenit 153, të Kodit, apo deklarata plotësuese është depozituar ose është vënë në dispozicion në përputhje me nenin 326, mbajtësi i autorizimit u dërgon autoriteteve doganore, të paktën një herë në muaj, të dhënat e kërkuara nga DPD-ja ose autoritetet doganore duhet t'i mbledhin këto të dhëna nga sistemi i deklaruesit.

Autoritetet doganore duhet të regjistrojnë të dhënat në sistemin elektronik të përmendur në nenin 97.

5. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar, të përmendur në pikën 1, të nenit 97, dhe të sistemeve të përmendura në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, lista e të dhënave që mund të kërkohet nga DPD-ja për qëllime të mbikëqyrjes është përcaktuar në aneksin 21-02, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 97
Sistemi elektronik në lidhje me mbikëqyrjen e çlirimit për qarkullim të lirë apo eksportin e mallrave
(Nenet 17, pika 1, dhe 56, pika 5, të Kodit)

Për mbikëqyrjen e çlirimit për qarkullim të lirë apo eksportin e mallrave do të përdoret një sistem elektronik i ngritur sipas pikës 1, të nenit 17, të Kodit, për transmetimin dhe ruajtjen e informacionit të mëposhtëm:

a) Të dhënat e mbikëqyrjes së çlirimit për qarkullim apo eksportit të mallrave;

b) Informacioni, i cili mund të rifreskojë të dhënat e mbikëqyrjes të paraqitura dhe të ruajtura në sistemin elektronik në çlirimin për qarkullim të lirë apo eksportin e mallrave.

KREU 3
Origjina e mallrave

Seksioni 1
Origjina jopreferenciale

Neni 98
Mallrat tërësisht të përftuara në një vend
(Pika 1, e nenit 60, të Kodit)

Mallrat në vijim konsiderohen si tërësisht të përftuara në një vend:

a) Produkte minerale të nxjerra brenda atij vendi;

b) Produktet bimore të korrura atje;

c) Kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;

ç) Produktet e prejardhura nga kafshët e gjalla të rritura atje;

d) Produktet e gjahut ose të peshkimit të zëna atje;

dh) Produktet e peshkimit si dhe produktet e tjera, të marra nga anijet/barkat e regjistruara në vendin ose territorin në fjalë dhe që mbajnë flamurin e atij vendi apo territori jashtë ujërave territoriale të secilit vend;

e) Mallrat e përftuara ose të prodhuara në bordin e anijeve-fabrikë nga produktet e përmendura në shkronjën "dh", me origjinë nga ai vend apo territor, me kusht që këto anije-fabrikë të jenë të regjistruara në këtë vend ose territor dhe të mbajnë flamurin e tij;

ë) Produktet e marra nga shtrati i detit apo nëntoka poshtë shtratit të detit jashtë ujërave territoriale, me kusht që vendi ose territori të ketë të drejtat ekskluzive për shfrytëzimin e shtratit të detit ose të nëntokës;

f) Mbeturinat dhe mbetjet që dalin nga procesi i prodhimit dhe artikujt e përdorur, në qoftë se ato janë mbledhur atje dhe shërbejnë vetëm për rikuperimin e lëndëve të para;

g) Mallrat e prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuara në shkronjat "a" deri në "f".

Neni 99
Mallrat, prodhimi i të cilave përfshin më shumë se një vend
(Pika 2, e nenit 60, të Kodit)

Mallrat e renditura në aneksin 22-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, konsiderohen se i janë nënshtruar punimit apo përpunimit të fundit thelbësor, duke rezultuar në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit në vendin në të cilin rregullat e përcaktuara në atë aneks janë plotësuar apo që identifikohen nga ato rregulla.

Neni 100
Operacionet e punimit ose përpunimit, të cilat nuk justifikohen ekonomikisht
(Pika 2, e nenit 60, të Kodit)

Çdo operacion punimi ose përpunimi, që kryhet në ndonjë vend, konsiderohet si i pajustifikuar ekonomikisht nëse, në bazë të fakteve të disponueshme, rezulton se qëllimi i këtij operacioni ishte për të shmangur zbatimin e masave të referuara në nenin 59, të Kodit.

Për mallrat e aneksit 22-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, zbatohen rregullat e tjera të kapitullit për ato mallra.

Për mallrat që nuk mbulohen nga aneksi 22-01, i shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, kur punimi ose përpunimi i fundit nuk konsiderohet si i justifikuar ekonomikisht, këto mallra konsiderohen se i janë nënshtruar punimit ose përpunimit të tyre të fundit thelbësor e të justifikuar ekonomikisht, duke rezultuar në prodhimin e një produkti të ri ose duke përfaqësuar një fazë të rëndësishme të prodhimit në vendin apo territorin ku e ka origjinën pjesa më e madhe e materialeve, siç përcaktohet në bazë të vlerës së materialeve.

Neni 101
Operacionet minimale
(Pika 2, e nenit 60, të Kodit)

Operacionet në vijim nuk konsiderohen si punime ose përpunime thelbësore, të justifikuara ekonomikisht për qëllime të dhënies së origjinës:

a) Operacionet për të siguruar ruajtjen e produkteve në gjendje të mirë gjatë transportit dhe magazinimit (ajrosja/ventilimi, përhapja, tharja, largimi i pjesëve të dëmtuara dhe operacione të ngjashme) ose operacionet që lehtësojnë dërgesat ose transportin;

b) Operacionet e thjeshta, që kanë të bëjnë me heqjen e pluhurit, kontrollin apo ekzaminimin, klasifikimin, përputhjen, larjen, prerjen;

c) Ndryshimet e paketimit, ndarja dhe grumbullimi i dërgesave, vendosja e thjeshtë në shishe, kanoçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, vendosja në kartonë apo dërrasa dhe të gjitha operacionet e tjera të thjeshta të paketimit;

ç) Vendosja e mallrave në komplete/sete apo grupe ose vënia në shitje;

d) Vendosja e shenjave/markave, etiketave apo shenjave të tjera të ngjashme e të dallueshme mbi produktet ose mbi paketimin e tyre;

dh) Bashkimi i thjeshtë i pjesëve të produkteve që përbëjnë një produkt të plotë;

e) Ndarja ose ndryshimi i përdorimit;

ë) Një kombinim i dy ose më shumë operacioneve të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "e".

Neni 102
Aksesorët, pjesët e këmbimit ose veglat
(Neni 60, i Kodit)

1. Aksesorët, pjesët e këmbimit ose veglat, të cilat janë dorëzuar me ndonjë nga mallrat e listuara në seksionet XVI, XVII dhe XVIII, të Nomenklaturës së Kombinuar, dhe që përbëjnë një pjesë të pajisjeve standarde, konsiderohen se kanë të njëjtën origjinë si ato mallra.

2. Pjesët kryesore të këmbimit për përdorim me një nga mallrat e listuara në seksionet XVI,

XVII dhe XVIII, të Nomenklaturës së Kombinuar, të çliruara më parë në qarkullim të lirë në Republikën e Shqipërisë, konsiderohen se kanë të njëjtën origjinë si këto mallra, nëse përfshirja e pjesëve thelbësore të këmbimit në fazën e prodhimit nuk do të kishte ndryshuar origjinën e tyre.

3. Për qëllime të këtij neni, pjesët kryesore të këmbimit nënkuptojnë pjesët, të cilat përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Janë komponentë, pa të cilët funksionimi i duhur i një pjese të pajisjes, makinës, aparatit ose mjetit që është vënë në qarkullim të lirë apo që është eksportuar më parë nuk mund të sigurohet;

b) Janë karakteristikë e këtyre mallrave;

c) Janë të destinuara për mirëmbajtjen e tyre normale dhe për të zëvendësuar pjesët e të njëjtit lloj, të cilat janë dëmtuar apo janë nxjerrë jashtë përdorimit.

Neni 103
Elementet neutrale dhe paketimi
(Neni 60, i Kodit)

1. Me qëllim që të përcaktohet nëse mallrat e kanë origjinën nga një vend apo territor, nuk do të merret parasysh origjina e elementeve të mëposhtme:

a) Energjia elektrike dhe karburanti;

b) Toka dhe pajisjet;

c) Makineritë dhe veglat;

ç) Materialet, të cilat as nuk hynë dhe as nuk janë të destinuara për t'u futur në përbërjen finale të produkteve.

2. Kur, në bazë të rregullit të përgjithshëm 5 për interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, materialet e paketimit dhe kontejnerët e paketimit konsiderohen si pjesë e produktit për qëllime klasifikimi, ato nuk do të merren parasysh për qëllime të përcaktimit të origjinës, përveç rasteve kur rregulli në aneksin 22-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për mallrat në fjalë, bazohet në përqindjen e vlerës së shtuar.

Nënseksioni 2
Prova e origjinës jopreferenciale

Neni 104
Certifikata e origjinës për produktet që u nënshtrohen marrëveshjeve/rregullimeve të veçanta jopreferenciale në import
(Pikat 1 dhe 2, të nenit 61, të Kodit)

1. Për produktet që e kanë origjinën e tyre në një vend të tretë, për të cilët janë përcaktuar marrëveshje/rregullime të veçanta jopreferenciale në import, kur këto marrëveshje i referohen këtij neni, duhet të lëshohet certifikatë origjine, duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin 22-14, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në të.

2. Certifikatat e origjinës do të lëshohen nga autoritetet kompetente të vendit të tretë, ku produktet me të cilat marrëveshjet e veçanta jopreferenciale të importit zbatojnë origjinën, ose nga një agjenci e besueshme, e autorizuar nga këto autoritete për këtë qëllim (autoritetet lëshuese), me kusht që origjina e produkteve të jetë përcaktuar në përputhje me nenin 60, të Kodit.

Autoritetet lëshuese duhet të mbajnë një kopje të secilës certifikatë të origjinës së lëshuar.

3. Certifikatat e origjinës do të lëshohen para se produktet, me të cilat ato kanë lidhje, të jenë deklaruar për eksport në vendin e tretë.

4. Duke anashkaluar pikën 3, certifikatat e origjinës mund, përjashtimisht, të lëshohen pas eksportit të produkteve me të cilat ato lidhen, kur moslëshimi i tyre në kohën e eksportit ishte rezultat i një gabimi, një lëshim i pavullnetshëm ose rrethana të veçanta.

Autoritetet lëshuese nuk mund të lëshojnë në mënyrë retrospektive (*a-posteriori*) një certifikatë të origjinës, të parashikuar në pikën 1, përveç rastit kur ato janë të bindura se të dhënat në aplikimin e eksportuesit korrespondojnë me ato në dosjen përkatëse të eksportit.

Neni 105
Bashkëpunimi administrativ në lidhje me marrëveshjet/rregullimet e veçanta jopreferenciale në import
(Neni 61, i Kodit)

1. Kur marrëveshjet/rregullimet e veçanta jopreferenciale në import, për produkte të caktuara, kërkojnë përdorimin e certifikatës së origjinës, të përcaktuar në nenin 104, përdorimi i marrëveshjeve / rregullimeve të tilla do t'i nënshtrohet kushtit që të jetë vendosur një procedurë bashkëpunimi administrativ, përveç rastit nëse specifikohet ndryshe në marrëveshjet në fjalë. Me qëllim krijimin e kësaj procedure bashkëpunimi administrativ, vendi i tretë do t'i dërgojë Republikës së Shqipërisë:

a) emrat dhe adresat e autoriteteve lëshuese, bashkë me specimenet e vulave të përdorura nga këto autoritete;

b) emrat dhe adresat e autoriteteve qeveritare kompetente, të ngarkuara për të marrë kërkesat për verifikimin e mëvonshëm të certifikatave të origjinës.

2. Kur vendi i tretë nuk arrin të dërgojë informacionin e specifikuar më sipër, autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë do të refuzojnë përdorimin e veçantë të marrëveshjeve/ rregullimeve jopreferenciale të importit.

Neni 106
Verifikimi i certifikatave të origjinës për produktet që u nënshtrohen marrëveshjeve/rregullimeve të veçanta jopreferenciale në import
(Neni 61, i Kodit)

1. Verifikimi i certifikatave të origjinës, të përmendura në nenin 104, kryhet pas pranimit të deklaratës doganore (verifikim *a-posteriori*).

2. Kur autoritetet doganore kanë dyshime të arsyeshme për origjinalitetin e certifikatës së origjinës ose saktësinë e informacionit që ajo përmban dhe kur ato kryejnë verifikime të mëvonshme, të rastit, ato do të kërkojnë nga autoritetet e përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 105, të verifikojnë nëse certifikata e origjinës është autentike apo origjina e deklaruar është përcaktuar në mënyrë korrekte dhe në përputhje me nenin 60, të Kodit, ose të dyja.

Për këto qëllime, autoritetet doganore do t'i kthejnë certifikatën e origjinës ose një kopje autoritetit të përmendur në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 105. Nëse një faturë ka shoqëruar deklaratën, fatura origjinale ose një kopje e saj do t'i bashkëngjitet certifikatës së origjinës së kthyer.

Autoritetet doganore do të japin, sipas rastit, arsyet për verifikimin dhe do të japin çdo informacion në zotërim të tyre për të argumentuar se detajet e të dhënave në certifikatën e origjinës janë të pasakta ose se certifikata e origjinës nuk është autentike.

2. Autoriteti i përmendur në shkronjën "b", të pikës 1, nenit 105, do t'u komunikojë rezultatet e verifikimeve autoriteteve doganore sa më shpejt të jetë e mundur.

Kur nuk ka përgjigje brenda 6 muajve, pas dërgimit të kërkesës në përputhje me pikën 2, autoritetet doganore refuzojnë përdorimin e veçantë të marrëveshjes jopreferenciale të importit për produktet në fjalë.

Neni 107
Certifikata e origjinës për produktet shqiptare në eksport dhe bashkëpunimi administrativ
(Neni 61, i Kodit)

1. Certifikatat e origjinës jopreferenciale, për produktet që e kanë origjinën e tyre në Republikës së Shqipërisë, lëshohen nga dhomat e tregtisë dhe të industrisë në Shqipëri, mbi bazën e një kërkese me shkrim nga personi i interesuar, me kusht që origjina e produkteve të jetë përcaktuar në përputhje me nenin 60, të Kodit. Certifikata e origjinës jopreferenciale lëshohet duke përdorur formularin e paraqitur në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në aneksin 22-09, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Kur e justifikojnë rrethanat, veçanërisht kur i interesuari ka aktivitet të rregullt eksporti, dhoma e tregtisë mund të vendosë të mos kërkojë paraqitjen e një kërkese për çdo operacion eksporti, me kusht që të respektohen dispozitat në fuqi për sa i përket origjinës.

Kur e justifikojnë nevojat tregtare, mund të lëshohet një ose disa kopje shtesë të certifikatës së origjinës.

2. Në kuadrin e bashkëpunimit administrativ me vende të tjera, dhoma e tregtisë do t'u përgjigjet

kërkesave të autoriteteve kompetente doganore të vendit ku janë importuar mallrat për kontrolle *a-posteriori*, qoftë edhe nëpërmjet autoriteteve doganore shqiptare.

Rezultatet e kontrollit *a-posteriori* duhet t'u komunikohen autoriteteve kërkuese sa më shpejt që të jetë e mundur. Koha maksimale për përgjigje nuk duhet të kalojë 6 (gjashtë) muaj.

Seksioni 2
Origjina preferenciale

Neni 108
Përkufizime

Për qëllime të këtij seksioni do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme, të cilat nënkuptojnë:

1. "Prodhim", çdo lloj punimi apo përpunimi, përfshirë edhe montimin;

2. "Material", çdo lloj përbërësi, lëndë e parë, përbërësi apo pjesë etj, të përdorur në prodhimin e produktit;

3. "Produkt", produkti që është prodhuar, edhe nëse ai është për t'u përdorur më vonë, në një proces tjetër prodhimi;

4. "Mallra", si materialet ashtu edhe produktet;

5. "Materiale të zëvendësueshme", materiale të të njëjtit lloj dhe cilësie tregtare, me karakteristika të njëjta teknike e fizike, dhe të cilat nuk mund të dallohen nga njëri-tjetri pasi ata janë të përfshirë në produktin e përfunduar;

6. "Vlerë doganore", vlera e përcaktuar në përputhje me marrëveshjen e vitit 1994, për zbatimin e nenit VII, të marrëveshjes së përgjithshme mbi tarifat dhe tregtinë (Marrëveshja e OBT mbi vlerësimin doganor);

7. "Vlerë e materialeve", vlera doganore në kohën e importimit të materialeve joorigjinuese të përdorura ose, nëse kjo nuk njihet dhe nuk mund të përcaktohet, çmimi i parë i përcaktuar dhe i paguar për materialet në vendin e prodhimit. Ky përkufizim zbatohet *mutatis mutandis*, kur duhet të përcaktohet vlera e materialeve origjinuese të përdorura;

8. "Çmimi i fabrikës/*ex-works*", çmimi i paguar për produktin e prodhuar (*ex-works*) te prodhuesi, në të cilin kryhet punimi apo përpunimi i fundit, me kusht që çmimi të përfshijë vlerën e të gjitha materialeve të përdorura dhe të të gjitha shpenzimeve të tjera në lidhje me prodhimin e tij, minus taksat e brendshme, të cilat janë ose mund të jenë të rimbursueshme kur produkti i përftuar eksportohet;

Kur çmimi aktual i paguar nuk pasqyron të gjitha shpenzimet që lidhen me prodhimin e produktit, të cilat aktualisht kryhen në vendin e prodhimit, çmimi i fabrikës/*ex-works* nënkupton shumën e të gjitha këtyre shpenzimeve minus taksat e brendshme, të cilat janë ose mund të jenë të rimbursueshme kur produkti i përftuar eksportohet;

Kur punimi apo përpunimi i fundit është nënkontraktuar për një prodhues, termi 'prodhues', referuar në pikën 1, mund t'i referohet ndërmarrjes që ka punësuar nënkontraktorin;

9. "Përmbajtja maksimale e materialeve joorigjinuese", përmbajtja maksimale e materialeve joorigjinuese, të cilat lejohen në mënyrë që prodhimi të konsiderohet si një punim apo përpunim i mjaftueshëm për t'i dhënë produktit statusin origjinues. Kjo mund të shprehet si përqindje e çmimit të fabrikës/*ex-works* për produktin ose si përqindje e peshës neto të këtyre materialeve të përdorura, që bëjnë pjesë në një grup të caktuar kapitujsh, kapitulli, kreu ose nënkreu;

10. "Pesha neto", pesha e vetë mallrave pa materialet e paketimit dhe kontejnerët/mbajtësit e paketimit të çdo lloji.

11. "Kapituj", "krerë" dhe "nënkrerë", kapitujt, krerët dhe nënkrerët (kodet katër- apo gjashtëshifrore) të Sistemit të Harmonizuar;

12. "I klasifikuar", i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali nën një kre ose nënkre të veçantë të Sistemit të Harmonizuar;

13. "Dërgesë", produktet të cilat ose:

a) dërgohen njëkohësisht nga një eksportues te një marrës;

b) mbulohen nga një dokument i vetëm transporti, që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marrës ose, në mungesë të një dokumenti të tillë, nga një faturë e vetme.

14. "Eksportues", një person që bën eksportimin e mallrave drejt Republikës së Shqipërisë ose drejt një vendi përfitues, i cili është në gjendje të provojë origjinën e mallrave, nëse ai është apo jo prodhuesi dhe nëse ai vetë kryen apo jo formalitetet e eksportit.

Nënseksioni 1
Lëshimi ose bërja e provës së origjinës

Neni 109
Deklaratat e furnitorit dhe përdorimi i tyre
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Kur furnitori pajis eksportuesin apo tregtarin me informacionin e nevojshëm për të përcaktuar statusin e origjinës së mallrave, për qëllime të dispozitave që rregullojnë tregtinë preferenciale, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve (për statusin preferencial të origjinës), furnitori do ta bëjë këtë me anë të një deklarate të furnitorit.

Për çdo ngarkesë të mallrave lëshohet një deklaratë e veçantë furnitori, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 110.

2. Furnitori do ta përfshijë deklaratën në faturën tregtare, në lidhje me këtë ngarkesë, ose në një fletëngarkesë apo në ndonjë dokument tjetër tregtar, i cili përshkruan mallrat përkatëse në detaje të mjaftueshme për të mundësuar identifikimin e tyre.

3. Furnitori mund të ofrojë deklaratën në çdo kohë, edhe pasi mallrat janë dorëzuar.

Neni 110
Deklarata afatgjatë e furnitorit
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Kur një furnitor furnizon rregullisht një eksportues apo tregtar me dërgesa mallrash dhe statusi i origjinës së mallrave të të gjitha këtyre dërgesave pritet të jetë i njëjtë, furnitori mund të japë një deklaratë të vetme, që mbulon dërgesat e mëvonshme të këtyre mallrave (deklarata afatgjatë e furnitorit). Deklarata afatgjatë e një furnitori mund të bëhet për një periudhë vlefshmërie deri në 2 vjet, nga data në të cilën është bërë.

2. Një deklaratë afatgjatë e furnitorit mund të bëhet me efekt prapaveprues për mallra të dorëzuara para marrjes së deklaratës. Një deklaratë e tillë afatgjatë e një furnitori mund të bëhet për një periudhë vlefshmërie deri në 1 vit, përpara datës në të cilën deklarata është bërë. Periudha e vlefshmërisë përfundon në datën në të cilën deklarata afatgjatë e furnitorit ishte bërë.

3. Furnitori duhet të njoftojë eksportuesin apo tregtarin në fjalë menjëherë, kur deklarata afatgjatë e furnitorit nuk është e vlefshme në lidhje me disa ose të gjitha ngarkesat e mallrave të furnizuara dhe që do të furnizohen.

Neni 111
Bërja e deklaratës së furnitorit
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Për produktet që kanë fituar statusin e origjinës preferenciale, deklaratat e furnitorit bëhen siç përcaktohet në aneksin 22-15, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij. Megjithatë, deklaratat afatgjata të furnitorit për këto produkte do të bëhen siç përcaktohet në aneksin 22-16, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Për produktet, të cilat i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Republikën e Shqipërisë pa e fituar statusin preferencial të origjinës, deklaratat e furnitorit bëhen siç përcaktohet në aneksin 22-17, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij. Megjithatë, për deklaratat afatgjata të furnitorit, deklarata e furnitorit bëhet siç është përcaktuar në aneksin 22-18, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Deklarata e furnitorit shoqërohet me një nënshkrim të shkruar me dorë të furnitorit. Megjithatë, kur të dyja, deklarata e furnitorit dhe fatura janë hartuar me mjete elektronike, këto mund të bëhen autentike në mënyrë elektronike ose furnitori mund t'i japë eksportuesit apo tregtarit një deklaratë me shkrim për pranimin e përgjegjësisë së plotë për çdo deklaratë furnitori, që e identifikon atë sikur të jetë e nënshkruar nga ana e tij me dorë.

Neni 112
Bashkëpunimi administrativ
(Pika 1, e nenit 64, të Kodit)

Autoritetet doganore duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën në kontrollin e saktësisë së informacionit të dhënë në deklaratat e furnitorit.

Neni 113
Verifikimi i deklaratave të furnitorit
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

Verifikimi i deklaratave të furnitorit kryhet në përputhje me rregullat e origjinës preferenciale dhe bashkëpunimin administrative, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi.

Neni 114
Autorizimi i eksportuesit të miratuar
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Kur Republika e Shqipërisë ka një marrëveshje preferenciale me një vend tjetër, e cila parashikon se prova e origjinës bëhet në formën e një deklarate-faturë ose deklarate-origjine, të bërë nga një eksportues i miratuar, eksportuesit e vendosur në territorin doganor të Republikën e Shqipërisë mund të aplikojnë për autorizim të eksportuesit të miratuar për qëllime të bërjes ose të zëvendësimit të deklaratës së origjinës.

2. Shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 19, nenet 24, 25 dhe 26, në lidhje me kushtet për aplikimet për pranimin dhe pezullimin e vendimeve, dhe nenet 27 dhe 32, në lidhje me përdorimin e mjeteve elektronike për shkëmbimin e ruajtjen e informacionit dhe revokimin e vendimeve të favorshme që kanë të bëjnë me aplikimet dhe vendimet, nuk zbatohen për vendimet që lidhen me autorizimet e eksportuesit të miratuar.

3. Autorizimet e eksportuesit të miratuar i jepen vetëm personave që plotësojnë kushtet e përcaktuara në dispozitat e origjinës ose të marrëveshjeve ndërkombëtare që ka nënshkruar Republika e Shqipërisë.

4. Autoritetet doganore i japin eksportuesit të miratuar një numër autorizimi doganor, i cili paraqitet në provat e origjinës preferenciale.

5. DPD-ja u përcjell vendeve në fjalë adresat e autoriteteve kompetente doganore përgjegjëse për kontrollin e vërtetimit të origjinës preferenciale të bërë nga eksportuesit e miratuar.

6. Kur marrëveshja preferenciale e zbatueshme nuk specifikon formën që do të ketë deklarata-faturë apo deklarata e origjinës, deklaratat hartohen në përputhje me rregullat e origjinës të vendit dhënës të preferencës.

Neni 115
Mjetet për të aplikuar dhe lëshuar autorizime të eksportuesit të miratuar
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Aplikimi për statusin e eksportuesit të miratuar, me qëllim lëshimin e provës së origjinës preferenciale, mund të paraqitet me mjete të tjera nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave. Gjithashtu, autorizimi i eksportuesit të miratuar mund të lëshohet me mjete të tjera të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

Nënseksioni 2
Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave (SPP)

Neni 116
Kërkesa të përgjithshme

Rregullat e origjinës janë elemente thelbësore të të gjitha skemave SPP. Në mënyrë që të kualifikohen për trajtim tarifor preferencial në bazë të skemës SPP, produktet e eksportuara nga Republika Shqipërisë duhet të përmbushin rregullat e origjinës preferenciale përkatëse të vendeve dhënëse të preferencave.

Neni 117
Sigurimi i bashkëpunimit administrativ
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në varësi të rregullave të origjinës, duhet të informojë direkt apo nëpërmjet sekretariatit të UNCTAD (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim/United Nation Conference on Trade and Development) autoritetet kompetente të vendeve ose grupeve të vendeve që i japin Republikës së Shqipërisë preferenca të njëanshme, listën e emrave dhe adresat e zyrave doganore, të cilat janë të autorizuara të lëshojnë certifikatat e origjinës preferenciale "*Form A*", specimenet e vulave që përdoren nga këto zyra si dhe emrin dhe adresën e zyrës përgjegjëse për kontrollin e këtyre certifikatave, në kuadër të sistemit të përgjithshëm të preferencave (SPP).

2. Për qëllim të kontrollit '*a-posteriori*' të certifikatës së origjinës preferenciale, zyra doganore që lëshon dokumentin përkatës duhet të ruajë për të paktën 3 vjet, nga data e lëshimit të certifikatës, kopje të certifikatave dhe kopje të dokumenteve të eksportimit.

3. Në rast se kërkohet të bëhet kontroll '*a-posteriori*' për vërtetësinë dhe rregullsinë e provave të origjinës preferenciale, si certifikata e origjinës "*Form A*" apo deklarata-faturë, të lëshuara nga zyrat doganore shqiptare në kuadër të SPP-së, autoritetet doganore kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme, në mënyrë që t'i përgjigjen në kohë kërkesës për kontroll të ardhur nga autoritetet e huaja.

Neni 118
Procedurat në lidhje me eksportet në kuadër të SPP

Autoritetet doganore duhet të sigurojnë përputhshmërinë me:

a) rregullat për origjinën e produkteve që eksportohen;

b) rregullat për plotësimin dhe lëshimin e certifikatave të origjinës "*Form A*";

c) dispozitat për përdorimin e deklaratave-faturë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në SPP.

Neni 119
Procedura për lëshimin e një certifikate të origjinës, "Forma A"
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Certifikata e origjinës "*Form A*" lëshohet me kërkesë me shkrim nga eksportuesi ose përfaqësuesi i tij, së bashku me çdo dokument tjetër mbështetës për të provuar që produktet, të cilat do të eksportohen, kualifikohen për lëshimin e certifikatës së origjinës "*Form A*". Certifikata e origjinës "*Form A*" lëshohet duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin 22-08, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Degët doganore do të venë në dispozicion të eksportuesit certifikatën e origjinës "*Form A*" në momentin e eksportit apo kur të jetë siguruar kryerja e tij. Megjithatë, degët doganore, sipas SPP-së të vendeve dhënëse të preferencave, mund të lëshojnë një certifikatë të origjinës "*Form A*" pas eksportimit të produkteve, të cilave u referohet, nëse:

a) nuk ishte lëshuar në kohën e eksportimit, për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme apo rrethanave të veçanta;

b) është demonstruar për të bindur autoritetet doganore që një certifikatë e origjinës "*Form A*" është lëshuar, por nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike;

c) destinacioni final i produkteve në fjalë është përcaktuar gjatë transportit ose magazinimit së tyre dhe pas ndarjes së mundshme të dërgesës.

3. Degët doganore mund të lëshojnë një certifikatë *a-posteriori* vetëm pasi të jetë verifikuar se informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikimin për një certifikatë të origjinës "*Form A*", të lëshuar në mënyrë retrospektive, është në përputhje me atë të dosjeve korresponduese të eksportit dhe një certifikatë e origjinës "*Form A*" nuk është lëshuar kur produktet në fjalë janë eksportuar, përveçse kur certifikata e origjinës "*Form A*" nuk është pranuar për arsye teknike. Shënimi "*Issued retrospectively*" apo "*Délivré a-posteriori*" do të vendoset në kutinë 4, të certifikatës së origjinës "*Form A*", lëshuar në retrospektivë (*a-posteriori).*

4. Në rast të vjedhjes, humbjes apo shkatërrimit të një certifikate të origjinës "*Form A*", eksportuesi mund të aplikojë për një dublikatë te dega doganore kompetente që e ka lëshuar atë, në bazë të dokumenteve të eksportit që ai zotëron. Shënimi "*Dublicate*" ose "*Duplicata*", data e lëshimit dhe numri serial i certifikatës origjinale do të vendoset në kutinë 4, të dublikatës së certifikatës së origjinës "*Form A*". Dublikata hyn në fuqi nga data e origjinalit.

5. Për qëllime të verifikimit, nëse produkti për të cilin kërkohet një certifikatë e origjinës "*Form A*" përputhet me rregullat përkatëse të origjinës, autoritetet kompetente doganore kanë të drejtë të kërkojnë dokumente shtesë ose të kryejnë çdo kontroll, të cilin ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

Neni 120
Kushtet për lëshimin e një deklarate-faturë
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Deklarata-faturë mund të bëhet nga çdo eksportues në Republikën e Shqipërisë, për produktet origjinuese, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në SPP të vendeve dhënëse të preferencave.

2. Eksportuesi që bën një deklaratë-faturë duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë.

3. Një deklaratë-faturë duhet të lëshohet nga eksportuesi në anglisht, frëngjisht ose në gjuhën e vendit dhënës të preferencës, duke shtypur, vulosur ose printuar mbi faturë, fletëngarkesë ose ndonjë dokument tjetër tregtar deklaratën e origjinës, teksti i së cilës tregohet në rregullat e origjinës të vendit dhënës së preferencave. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë, me shkronja kapitale. Një deklaratë-faturë duhet të ketë firmën origjinale të shkruar me dorë nga eksportuesi.

Nënseksioni 3
Masa preferenciale tarifore të miratuara në mënyrë të njëanshme nga BE-ja për vende dhe territore të caktuara

Neni 121
Kërkesat e përgjithshme
(Pika 3, e nenit 63, të Kodit)

1. Për qëllime të dispozitave në lidhje me masat preferenciale tarifore të miratuara në mënyrë të njëanshme nga BE-ja për vende të caktuara, grupet e vendeve ose territoreve, konsiderohen si produkte me origjinë nga Republika e Shqipërisë produktet e mëposhtme:

a) produktet tërësisht të përftuara në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 122;

b) produkte të përftuara në Republikën e Shqipërisë, në prodhimin e të cilave përdoren produkte të tjera nga ato të referuara në shkronjën "a", me kusht që ato produkte t'i jenë nënshtruar punimeve apo përpunimeve të mjaftueshme në kuptim të nenit 123.

2. Për qëllimet e këtij nënseksioni, produktet me origjinë në BE, në kuptim të pikës 3, të këtij neni, të cilat janë subjekt në Republikën e Shqipërisë, ku punimet apo përpunimet shkojnë përtej atyre që përshkruhen në nenin 124, konsiderohen si origjinuese në Republikën e Shqipërisë.

3. Pika 1 zbatohet *mutatis mutandis* në përcaktimin e origjinës së produkteve të përftuara në BE.

Neni 122
Produktet tërësisht të përftuara

1. Konsiderohen si tërësisht të përftuara në Republikën e Shqipërisë ose në BE:

a) produktet minerale të nxjerra nga toka ose nga shtrati i detit;

b) produktet bimore të korrura atje;

c) kafshët e gjalla, të lindura dhe të rritura atje;

ç) produktet nga kafshët e gjalla të rritura atje;

d) produktet nga kafshët e therura, që janë lindur e rritur atje;

dh) produktet e përftuara nga gjuetia apo peshkimi i kryer atje;

e) produktet e peshkimit dhe produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale nga anijet/barkat e tij;

ë) produktet e prodhuara në bordin e anijeve-fabrikë ekskluzivisht nga produktet e referuara në shkronjën "e";

f) artikujt e përdorur, me kusht që të jenë mbledhur atje dhe që shërbejnë vetëm për rikuperimin e lëndëve të para;

g) mbeturinat dhe mbetjet që rezultojnë nga operacionet e prodhimit të kryera atje;

gj) produkte të nxjerra nga shtrati i detit ose nën shtratin e detit, i cili ndodhet jashtë ujërave territoriale, por vetëm kur Republika e Shqipërisë ose BE-ja ka të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit;

h) mallra të prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuara në shkronjat "a" deri në "gj".

2. Termat "anijet/barkat e tyre" dhe "anijet e tyre fabrikë" në shkronjat "e" dhe "ë", të pikës 1, aplikohen vetëm për anijet/barkat dhe anijet-fabrikë që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Janë të regjistruara ose të matrikuluara në Republikën e Shqipërisë ose në BE;

b) Mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë ose të BE-së;

c) Zotërohen, me të paktën 50%, nga shtetasit e Republikës së Shqipërisë ose të BE-së apo nga një kompani me seli kryesore në Republikën e Shqipërisë ose në BE, nga të cilat administratori apo administratorët, kryetari i bordit të drejtorëve ose të bordit mbikëqyrës dhe shumica e anëtarëve të bordeve të tilla janë nënshtetas të Republikës së Shqipërisë ose të BE-së dhe, për më tepër, në rastin e kompanive, të paktën gjysma e kapitalit i përket Republikës së Shqipërisë ose BE-së apo institucioneve publike ose shtetasve të Republikës së Shqipërisë apo të BE-së;

ç) Kapiteni dhe oficerët e barkave dhe anijeve-fabrikë janë shtetas të Republikës së Shqipërisë ose të BE-së;

d) Të paktën 75% e ekuipazhit janë të Republikës së Shqipërisë ose të BE-së.

3. Termat "Republika e Shqipërisë" dhe "BE" mbulojnë, gjithashtu, edhe ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë ose të BE-së.

4. Anijet/barkat, që operojnë në det të hapur, përfshirë edhe anijet-fabrikë, në të cilat produktet/peshqit që kapen punohen apo përpunohen, konsiderohen si pjesë e Republikës së Shqipërisë ose e BE-së, të cilave u përkasin, me kusht që ato të plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 2.

Neni 123
Produkte të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm

Për qëllime të nenit 121, produktet, të cilat nuk janë tërësisht të përftuara në Republikën e Shqipërisë ose në BE, konsiderohen të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në aneksin 22-11, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Këto kushte tregojnë punimin ose përpunimin që duhet të kryhet mbi materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e të gjitha produkteve të trajtuara nga ky nënseksion dhe zbatohen vetëm në lidhje me materiale të tilla.

Nëse një produkt, i cili ka fituar statusin origjinues duke plotësuar kushtet e vendosura në listë, është përdorur në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e zbatuara ndaj një produkti në të cilin ai bën pjesë nuk zbatohen tek ai dhe nuk do të merren parasysh materialet joorigjinuese, të cilat mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

Neni 124
Punimi ose përpunimi i pamjaftueshëm

1. Pa rënë ndesh me pikën 2, konsiderohen si punime ose përpunime të pamjaftueshme për t'i dhënë statusin origjinues produktit, nëse plotësohen ose jo kërkesat e nenit 123, operacionet e mëposhtme:

a) Kryerja e operacioneve për të siguruar që produkti mbahet në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;

b) Ndarjet dhe bashkimet e paketimeve;

c) Larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksidit, vajit, njollave apo mbetjeve të tjera;

ç) Hekurosja ose presimi i tekstileve dhe artikujve të tekstilit;

d) Operacionet e thjeshta të lyerjeve apo lustrimit;

dh) Tharja, bluarja e pjesshme apo totale, shkëlqimi dhe lëmimi i drithërave dhe orizit;

e) Operacionet për të ngjyrosur ose për t'i dhënë shije sheqerit ose për të formuar kubikët e sheqerit; bluarja e pjesshme ose totale e sheqerit;

ë) Heqja e lëkurës, bërthamës dhe farave të frutave, arrave e perimeve;

f) Mprehja, bluarjet ose prerjet e thjeshta;

g) Shoshitja, sitja, seleksionimi, klasifikimi, kategorizimi, kombinimi (duke përfshirë vendosjen e pjesëve të artikujve);

gj) Vendosjet e thjeshta në shishe, kanoçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, fiksimi i tyre në kartonë ose dërrasa si dhe të gjitha operacionet e tjera të paketimit të thjeshtë;

h) Fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove dhe shenjave të tjera të dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;

i) Përzierjet e thjeshta të produkteve, qoftë të llojeve të ndryshme ose jo; përzierjet e sheqerit me çdo lloj materiali;

j) Shtimi i thjeshtë i ujit ose hollimi, tharja/ dehidratimi ose denaturimi i produkteve;

k) Bashkimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të bërë një artikull të plotë ose ndarja e produktit në pjesë;

l) Therja e kafshëve;

ll) Kombinimi i dy ose më shume prej veprimeve të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "l".

2. Për të përcaktuar nëse punimi ose përpunimi i një produkti të caktuar duhet të konsiderohet i pamjaftueshëm sipas pikës 1, mbahen parasysh në tërësi të gjitha operacionet që kryhen në Republikën e Shqipërisë ose në BE në atë produkt.

Neni 125
Njësia e kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për zbatimin e dispozitave të këtij nënseksioni duhet të jetë produkti specifik, i cili konsiderohet si njësi bazë gjatë përcaktimit të klasifikimit sipas Sistemit të Harmonizuar.

Në këtë kuptim, vijon se:

a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose bashkim artikujsh është i klasifikuar sipas Sistemit të Harmonizuar nën një kre të vetëm, atëherë e tëra përbën njësinë e kualifikimit;

b) kur një dërgesë përfaqëson një numër produktesh identike të klasifikuara nën të njëjtin kre të Sistemit të Harmonizuar, çdo produkt duhet të merret individualisht, në rastin e zbatimit të dispozitave të këtij nënseksioni.

2. Kur, në bazë të rregullit të përgjithshëm interpretues 5 të Sistemit të Harmonizuar, paketimi përfshihet bashkë me produktin për qëllime klasifikimi, ai do të përfshihet për qëllime të përcaktimit të origjinës.

Neni 126
Toleranca e përgjithshme

1. Duke anashkaluar nenin 123, materialet joorigjinuese mund të përdoren në prodhimin e një produkti të caktuar, me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos e kalojë 10% e çmimit të fabrikës/*ex-works* të produktit.

Nëse në listë, për vlerën maksimale të materialeve joorigjinuese janë dhënë një ose disa përqindje, zbatimi i paragrafit të parë nuk duhet të sjellë tejkalimin e kësaj përqindjeje.

2. Pika 1 nuk zbatohet për produktet e parashikuara nga kapitulli 50 deri në 63 të Sistemit të Harmonizuar.

Neni 127
Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe veglat

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe veglat e lidhura me një pjesë të pajisjes, makinës, aparatit ose mjetit, të cilat janë pjesë e pajisjes normale dhe përfshihen në çmimin e saj ose nuk janë faturuar veçmas, konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinës, aparatit apo mjetit në fjalë.

Neni 128
Setet

Setet, sipas përcaktimit në rregullin e përgjithshëm interpretues 3 të Sistemit të Harmonizuar, konsiderohen si origjinuese kur të gjitha produktet përbërëse të jenë origjinuese. Megjithatë, kur një set përbëhet nga produkte origjinuese dhe produkte joorigjinuese, atëherë seti, si i tërë, konsiderohet si origjinues, me kusht që vlera e produkteve joorigjinuese të mos e kalojë 15% të çmimit të fabrikës/*ex-works*.

Neni 129
Elementet neutrale

Me qëllim që të përcaktohet nëse një produkt është një produkt origjinues, nuk do të jetë e nevojshme të përcaktohet origjina e artikujve që mund të jenë përdorur gjatë prodhimit të tij, të tillë si:

a) energjia elektrike dhe karburanti;
b) toka dhe pajisjet;
c) makineritë dhe veglat;
ç) mallrat, të cilat nuk hyjnë dhe të cilat nuk synohen të hyjnë në përbërjen përfundimtare të produktit.

Neni 130
Provat e origjinës
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

Produktet me origjinë në Republikën e Shqipërisë do të përfitojnë nga preferencat e njëanshme tarifore të dhëna nga BE-ja me paraqitjen e:

a) një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1, lëshuar duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin 22-10, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

b) në rastet e specifikuara në pikën 1, të nenit 136, një deklaratë, teksti i së cilës jepet në aneksin 22-13, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhënë nga eksportuesi në një faturë, fletëngarkesë apo një dokument tjetër tregtar, i cili përshkruan produktet në detaje të mjaftueshme për të mundësuar identifikimin e tyre (në vijim referuar si 'deklaratë faturë').

Kutia 7 e certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 ose të deklaratave faturë duhet të përmbajë shënimin "*Autonomus trade measures*" apo "*Measures commerciales autonomies*" (Masat autonome tregtare).

Neni 131
Procedura për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Produktet origjinuese, në kuptimin e nënseksionit 3, të seksionit 2, të kreut 3, të titullit II, do të jenë të pranueshme gjatë importimit në BE për të përfituar nga preferencat tarifore të referuara në nenin 121, me kusht që ato të jenë transportuar direkt në BE, brenda kuptimit të nenit 145, me paraqitjen e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1, të lëshuar nga autoritetet doganore në Republikën e Shqipërisë, me kusht që DPD-ja:

a) t'i ketë komunikuar Komisionit Evropian informacionin e kërkuar nga neni 141;

b) të ndihmojë BE duke lejuar autoritetet doganore të shteteve anëtare të BE-së për të verifikuar vërtetësinë e dokumentit ose saktësinë e informacionit në lidhje me origjinën e produkteve në fjalë.

2. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR. 1 mund të lëshohet vetëm kur ajo mund të shërbejë si një provë dokumentare, e kërkuar për qëllimet e preferencave tarifore të referuara në nenin 121.

3. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR. 1 do të lëshohet vetëm me aplikimin me shkrim nga eksportuesi ose përfaqësuesi i tij. Aplikimi duhet të paraqitet duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin 22-10, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe do të plotësohet në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe të neneve 130, 132 - 135, 138 dhe 140.

Aplikimet për certifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1 do të mbahen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet, nga fundi i vitit në të cilin është lëshuar certifikata e qarkullimit.

4. Eksportuesi ose përfaqësuesi i tij duhet të paraqesë me aplikimin e tij të gjitha dokumentet e duhura mbështetëse, që provojnë se produktet për t'u eksportuar kualifikohen për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1.

Me kërkesën e autoriteteve kompetente, eksportuesi duhet të paraqesë të gjitha dokumentet shtesë që mund t'i kërkohen, me qëllim të vërtetimit të saktësisë së statusit të origjinës së produkteve të kualifikueshme për trajtim preferencial, dhe do të pranojë kontrollin e llogarive/kontabilitetit të tyre dhe çdo kontroll tjetër të kushteve të prodhimit dhe të rrethanave në të cilat produktet janë përftuar.

5. Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 do të lëshohet nga degët doganore, nëse produktet që do të eksportohen mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Republikën e Shqipërisë, në kuptimin e nënseksionit 3, të seksionit 2, të kreut 3, të titullit II.

6. Që në momentin që certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 përbën provë dokumentare për zbatimin e marrëveshjeve preferenciale, të përcaktuara në nenin 121, do të jetë përgjegjësi e autoriteteve doganore të Republikës së Shqipërisë të marrin të gjithë hapat e nevojshëm për të verifikuar origjinën e produkteve dhe për të kontrolluar treguesit e tjerë në certifikatë.

7. Me qëllim që të verifikohet nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në pikën 5, autoritetet doganore kompetente kanë të drejtë të kërkojnë dokumente shtesë ose të kryejnë çdo kontroll, të cilin ata e konsiderojnë të nevojshëm.

8. Do të jetë përgjegjësi e autoriteteve kompetente doganore të Republikës së Shqipërisë, si vend përfitues, ose e autoriteteve doganore të shtetit anëtar të BE-së eksportues, të sigurojnë që formularët e referuar në pikën 1, janë plotësuar si duhet.

9. Data e lëshimit të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 do të tregohet në atë pjesë të certifikatës rezervuar për autoritetet doganore.

10. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore kompetente të Republikës së Shqipërisë ose nga autoritetet doganore të shtetit anëtar të BE-së eksportues kur produktet, me të cilat ai ka lidhje, eksportohen. Kjo do të bëhet e vlefshme për eksportuesin sapo të kryhet eksporti ose kur është e sigurt që eksporti do të kryhet.

Neni 132
Importimi me këste
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

Kur, me kërkesën e importuesit dhe me kushtet e parashtruara nga autoritetet doganore të vendit importues, produktet e çmontuara ose të pamontuara, në kuptimin e rregullit të përgjithshëm interpretues 2, shkronja "a", të Sistemit të Harmonizuar dhe që janë në seksionin XVI ose XVII, ose titujt 7308 ose 9406 të Sistemit të Harmonizuar, importohen me këste (pjesë-pjesë), për të tilla raste, për këto produkte vërtetimi i origjinës duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore gjatë importimit të kështit (pjesës) të parë.

Neni 133
Paraqitja e provës së origjinës
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

Prova e origjinës duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore të shteteve anëtare të importit, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 150, të Kodit. Autoritetet e mësipërme mund të kërkojnë një përkthim të provës së origjinës dhe, gjithashtu, mund të kërkojnë që deklaratës së importit t'i bashkëlidhet një deklarim nga importuesi, që vërteton se produktet plotësojnë kushtet e kërkuara për zbatimin e këtij nënseksioni.

Neni 134
Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1, lëshuar *a-posteriori*
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Duke anashkaluar pikën 10, të nenit 131, një certifikatë qarkullimi mallrash EUR. 1 mund të

lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilave iu referohet, nëse plotësohet njëri nga dy kushtet e mëposhtme:

a) Ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit, për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta;

b) Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, e cila është lëshuar në vendin eksportues, u është paraqitur autoriteteve doganore kompetente importuese, por nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike.

2. Autoritetet doganore kompetente mund të lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR. 1 *a-posteriori* vetëm pasi të jetë verifikuar se informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjeve korresponduese të eksportit dhe që një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, për përmbushjen e dispozitave të këtij nënseksioni, nuk është lëshuar kur produktet në fjalë janë eksportuar.

3. Certifikatat e qarkullimit të mallrave EUR. 1, lëshuar *a-posteriori*, duhet të mbyllen me frazën në anglisht, "*ISSUED RETROSPECTIVELY*" ose në gjuhën përkatëse të shtetit anëtar.

Shënimi, i referuar në pikën 3, do të vendoset në kutinë "Shënime", të certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

Neni 135
Lëshimi i një certifikate të qarkullimit të mallrave EUR. 1 dublikatë
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Në rast të vjedhjes, humbjes ose shkatërrimit të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1, eksportuesi mund të aplikojë për një dublikatë tek autoritetet doganore kompetente, të cilat e kanë lëshuar atë, në bazë të dokumenteve të eksportit në zotërim të tij.

2. Dublikata e lëshuar në këtë mënyrë duhet të mbyllet me fjalën në anglisht "*DUPLICATE*", ose në gjuhën përkatëse të shtetit anëtar.

3. Shënimi, i referuar në pikën 2, do të vendoset në kutinë "Shënime" të certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

4. Dublikata duhet të tregojë datën e lëshimit të certifikatës origjinale të qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe do të jetë në fuqi që nga ajo datë.

Neni 136
Kushtet për lëshimin e një deklarate-faturë
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Deklarata-faturë mund të bëhet nga:

a) një eksportues i miratuar në BE, në kuptim të nenit 131;

b) çdo eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk e kalon shumën ekuivalente në lekë të 6 000 eurove, dhe me kusht që asistenca e dhënë në pikën 1, të nenit 131, të zbatohet në këtë procedurë.

2. Një deklaratë-faturë mund të bëhet nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen me origjinë në BE ose në Republikën e Shqipërisë dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të nënseksioneve 3 e 4, të seksionit 2, të kreut 3, të titullit II.

3. Eksportuesi, që bën një deklaratë-faturë, duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë si dhe përmbushjen e kërkesave të tjera të nënseksionit 3 të seksionit 2, të kreut 3, të titullit II.

4. Një deklaratë-faturë duhet të lëshohet nga eksportuesi duke shtypur, stampuar ose printuar mbi faturën, fletëngarkesën ose ndonjë dokument tjetër tregtar deklaratën, teksti i së cilës tregohet në aneksin 22-13, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të përcaktuara në atë aneks dhe në përputhje me dispozitat në fuqi. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë, me shkronja kapitale.

5. Një deklaratë-faturë duhet të ketë firmën origjinale të eksportuesit të shkruar me dorë. Megjithatë, një eksportuesi të miratuar, në kuptimin e nenit 137, nuk do t'i kërkohet të nënshkruajë deklarata të tilla, me kusht që ai t'u japë autoriteteve doganore një deklaratë me shkrim se ai pranon përgjegjësinë e plotë për çdo deklaratë, e cila e identifikon atë si të ishte e nënshkruar me nënshkrimin e tij me dorë.

6. Në rastet e përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, përdorimi i një deklarate- faturë është objekt i kushteve të mëposhtme:

a) Një deklaratë-faturë duhet të bëhet për secilën dërgesë;

b) Nëse mallrat e përfshira në dërgesë tashmë janë verifikuar në vendin eksportues, sipas përkufizimit të "produkteve origjinuese", eksportuesi mund ta referojë këtë verifikim në deklaratën faturë.

Dispozitat e kësaj pike nuk përjashtojnë eksportuesit nga përmbushja e ndonjë formaliteti tjetër të kërkuar sipas rregullave doganore ose postare.

Neni 137
Eksportuesi i miratuar
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

Autoritetet doganore të BE-së mund të autorizojnë çdo eksportues të vendosur në territorin doganor të BE-së, në vijim referuar si "eksportues i miratuar", që bën dërgesa të shpeshta të produkteve me origjinë në BE, brenda kuptimit të pikës 2, të nenit 59, të Rregullores së Deleguar (BE) 2015/2446, dhe që ofron, për të bindur autoritetet doganore, të gjitha garancitë e nevojshme për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të titullit II, kreu 1, seksioni 2, nënseksioni 4 dhe 5 të Rregullores së Deleguar (BE) 2015/2446, të lëshojë deklaratë-faturë, pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Autoritetet doganore të BE-së do t'i caktojnë eksportuesit të miratuar një numër autorizimi doganor, i cili do të shfaqet në deklaratën faturë.

Neni 138
Vlefshmëria e provës së origjinës
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Prova e origjinës do të jetë e vlefshme për 4 muaj, nga data e lëshimit në vendin eksportues, dhe duhet të dorëzohet brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore të vendit importues.

2. Prova e origjinës, e cila është paraqitur pranë autoriteteve doganore të vendit importues pas datës së fundit për paraqitje, specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen me qëllim aplikimin e preferencave tarifore të referuara në nenin 121, kur nuk është arritur depozitimi i këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare, shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme.

3. Në rastet e tjera të depozitimeve të vonuara, autoritetet doganore të vendit importues mund ta pranojnë provën e origjinës nëse produktet janë paraqitur përpara përfundimit të afatit të përcaktuar.

4. Me kërkesë të importuesit dhe duke pasur parasysh kushtet e parashtruara nga autoritetet doganore të shtetit anëtar importues të BE-së, një provë e origjinës mund të paraqitet pranë autoriteteve doganore me importimin e dërgesës së parë, kur mallrat përmbushin kushtet që vijojnë:

a) Janë importuar në kuadrin e flukseve të shpeshta e të vazhdueshme tregtare të një vlere të rëndësishme tregtare;

b) Janë objekt i së njëjtës kontratë të shitjes, palë të kësaj kontrate të vendosura në vendin eksportues ose në BE;

c) Klasifikohen në të njëjtin Kod (tetë shifror) të Nomenklaturës së Kombinuar;

ç) Vijnë ekskluzivisht nga i njëjti eksportues, janë të destinuara për të njëjtin importues dhe janë bërë objekt i formaliteteve të hyrjes në të njëjtën zyrë doganore në BE.

Kjo procedurë do të jetë e zbatueshme për sasitë dhe për një periudhë të përcaktuar nga autoritetet doganore kompetente. Kjo periudhë, në asnjë rrethanë, nuk mund të kalojë 3 (tre) muaj.

5. Procedura e përcaktuar në pikën e mësipërme zbatohet edhe kur vetëm një provë e origjinës paraqitet pranë autoriteteve doganore për importet me këste (pjesë-pjesë), në përputhje me nenin 132. Megjithatë, në këtë rast, autoritetet kompetente doganore mund të japin një periudhë të aplikimit që zgjat më tepër se 3 (tre)muaj.

Neni 139
Përjashtimet nga prova e origjinës
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Produktet e dërguara si paketa të vogla, nga personi privat te personat privatë, ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve, do të pranohen si produkte me origjinë që përfitojnë nga preferencat tarifore të referuara në nenin 121, pa kërkuar paraqitjen e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 ose një deklaratë-faturë, me kusht që këto produkte të mos jenë importuar për qëllime tregtie dhe të jenë deklaruar se plotësojnë kushtet e kërkuara për zbatimin e nënseksionit 3 të seksionit 2, të kreut 3, të titullit II, dhe atje ku nuk ka dyshim te vërtetësia e një deklarimi të tillë.

2. Importet, të cilat janë të rastit dhe përbëhen vetëm nga produkte për përdorim personal të pranuesit ose udhëtarëve apo familjeve të tyre nuk do të konsiderohen si importe për qëllime tregtie

nëse është e qartë nga natyra dhe sasia e produkteve që nuk ka asnjë qëllim tregtar.

Gjithashtu, vlera totale e produkteve nuk duhet të kalojë vlerën ekuivalente në lekë të 500 eurove, në rastin e pakove të vogla, ose vlerën ekuivalente në lekë të 1 200 eurove, në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve.

Neni 140
Mospërputhjet dhe gabimet formale
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

Konstatimi i mospërputhjeve të vogla midis të dhënave të bëra në provën e origjinës dhe atyre të bëra në dokumentet e paraqitura në zyrën doganore për qëllime të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve, nuk përbën fakt për ta bërë provën e origjinës të pavlefshme nëse përcaktohet që dokumenti i korrespondon produkteve të paraqitura.

Gabimet formale të dukshme në provën e origjinës, të tilla si gabime gjatë shtypjes, nuk bëhen shkas që ky dokument të refuzohet, nëse këto gabime nuk krijojnë dyshime lidhur me korrektësinë e të dhënave të bëra në atë dokument.

Neni 141
Bashkëpunimi administrativ
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. DPD-ja do të informojë Komisionin Evropian për emrat dhe adresat e autoriteteve doganore, të cilat janë të autorizuara të lëshojnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1, së bashku me një kopje të specimeneve të vulave të përdorura nga këto autoritete, emrat dhe adresat e autoriteteve doganore kompetente përgjegjëse për verifikimin e certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratave faturë. Vulat do të jenë të vlefshme nga data e marrjes së mostrave nga Komisioni Evropian. Komisioni Evropian do ta përcjellë këtë informacion tek autoritetet doganore të shteteve anëtare të BE.

2. Komisioni Evropian do t'i dërgojë DPD-së specimenet e vulave, të cilat përdoren nga autoritetet doganore të shteteve anëtare të BE-së për lëshimin e certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1.

Neni 142
Verifikimi i provave të origjinës
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Verifikimet e certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe të deklaratave faturë do të kryhen në mënyrë të rastësishme ose sa herë që autoritetet doganore në shtetin anëtar importues të BE apo autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë kanë dyshime të arsyeshme për origjinalitetin e të tilla dokumenteve, për statusin e origjinës së produkteve brenda kuptimit të nënseksionit 3, të seksionit 2, të kreut 3, të titullit II dhe dispozitave të tjera përkatëse.

2. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të pikës 1, autoritetet doganore kompetente importuese në shtetin anëtar të BE-së ose në Republikën e Shqipërisë do të kthejnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe faturën, në qoftë se ajo është dorëzuar, deklaratën-faturë ose një kopje të këtyre dokumenteve autoriteteve doganore kompetente eksportuese të Republikës së Shqipërisë apo shteteve anëtare të BE-së, duke i dhënë, sipas rastit, arsyet për hetimin. Çdo dokument dhe informacion i marrë, i cili tregon se informacioni i dhënë në provën e origjinës është jokorrekt, duhet të bashkëngjitet në mbështetje të kërkesës për verifikim.

Nëse autoritetet doganore në shtetin importues anëtar vendosin të pezullojnë përkohësisht dhënien e preferencave tarifore të referuara në nenin 121, ndërkohë që presin rezultatet e verifikimit, importuesit duhet t'i ofrohet mundësia për të çliruar produktet, përveç rasteve të marrjes së ndonjë mase parandaluese që gjykohet e nevojshme.

3. Kur një kërkesë për verifikimin e mëvonshëm është bërë në përputhje me pikën 1, një verifikim i tillë duhet të kryhet dhe rezultatet e tij do t'u komunikohen autoriteteve doganore të shteteve anëtare importuese ose Republikës së Shqipërisë, brenda një maksimumi prej 6 (gjashtë) muajsh. Rezultatet e verifikimit duhet të tregojnë qartë nëse prova e origjinës në fjalë i përket produkteve të eksportuara, pra është origjinale, dhe nëse këto produkte mund të konsiderohen si origjinuese në Republikës së Shqipërisë ose BE.

4. Në rast të dyshimeve të arsyeshme, nëse nuk ka përgjigje brenda 6 (gjashtë) muajve të specifikuara në pikën 3, ose në qoftë se përgjigjja

nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar origjinalitetin e dokumentit në fjalë ose origjinën e vërtetë të produkteve, një komunikim i dytë do të dërgohet tek organet kompetente. Në qoftë se, pas komunikimit të dytë, rezultatet e verifikimit nuk i komunikohen autoriteteve kërkuese brenda 4 (katër) muajve, ose në qoftë se këto rezultate nuk tregojnë origjinalitetin e dokumentit në fjalë apo origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, duhet të refuzojnë dhënien e preferencave tarifore.

5. Në rastet kur procedura e verifikimit ose çdo informacion tjetër i disponueshëm duket se tregon se dispozitat e nënseksionit 3, të seksionit 2, të kreut 3, të titullit II, po shkelen, autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë, me iniciativën e vet ose me kërkesë të BE-së, do të kryejnë hetimet e duhura ose do të marrin masa që hetime të tilla të kryhen me urgjencën e duhur për të identifikuar dhe për të parandaluar shkelje të tilla.

6. Për qëllime të verifikimit të mëvonshëm të certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1, kopjet e certifikatave si dhe çdo dokument eksporti që ka të bëjë me to, do të mbahen nga autoritetet kompetente doganore të eksportit të shtetit anëtar ose Republikës së Shqipërisë për të paktën 3 vjet, nga fundi i vitit në të cilin janë lëshuar certifikatat e qarkullimit.

Neni 143
Dispozita të tjera të zbatueshme nga BE-ja në mënyrë të njëanshme për Ceuta dhe Melilla
(Pika 1, e nenit 63, të Kodit)

1. Ky nënseksion do të zbatohet *mutatis mutandis,* për të përcaktuar nëse produktet mund të konsiderohen si origjinuese në Republikën e Shqipërisë, kur importohen në Ceuta dhe Melilla, ose si origjinuese në Ceuta dhe Melilla.

2. Ceuta dhe Melilla do të konsiderohen si një territor i vetëm.

3. Dispozitat e këtij nënseksioni, në lidhje me lëshimin, përdorimin dhe verifikimin e mëvonshëm të certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1, do të zbatohen *mutatis mutandis* për produktet me origjinë në Ceuta dhe Melilla.

4. Autoritetet spanjolle doganore do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij nënseksioni në Ceuta dhe Melilla.

Nënseksioni 4
Masa preferenciale tarifore të miratuara në mënyrë të njëanshme nga RSH për vende apo territore të caktuara

Neni 144
Parimi i territorialitetit
(Pika 3, e nenit 63, të Kodit)

Kushtet e përcaktuara në këtë nënseksion për përfitimin e statusit origjinues duhet të vazhdojnë të plotësohen në çdo kohë (pa ndërprerje) në vendin apo territorin përfitues ose në Republikën e Shqipërisë.

Nëse produktet origjinuese, të cilat janë eksportuar nga vendi ose territori përfitues apo nga Republika e Shqipërisë në një vend tjetër kthehen, konsiderohen si joorigjinuese me përjashtim të rasteve kur i paraqiten autoriteteve doganore kompetente prova se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Produktet e kthyera janë të njëjta me ato që janë eksportuar;

b) Ato nuk i janë nënshtruar ndonjë procesi tjetër, përveç atyre që nevojiten për t'i ruajtur në kushte të mira, gjatë kohës së qëndrimit në këtë vend ose gjatë eksportimit.

Neni 145
Transporti i drejtpërdrejtë
(Pika 3, e nenit 63, të Kodit)

1. Konsiderohen si të transportuara direkt nga vendi apo territori përfitues drejt Republikës së Shqipërisë apo nga Republika e Shqipërisë drejt vendit apo territorit përfitues:

a) produktet e transportuara pa kaluar përmes territorit të ndonjë vendi tjetër;

b) produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme e transportuar nëpër territorin e vendeve të tjera nga vendi apo territori përfitues ose nga Republika e Shqipërisë dhe, nëse është e nevojshme, përmes transbordit apo magazinimit të përkohshëm në këto vende, me kusht që produkti të mbahet nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore në vendin e transitit ose të magazinimit dhe ato nuk i nënshtrohen operacioneve të tjera, përveç shkarkimit, ringarkimit ose ndonjë operacioni tjetër me synimin për t'i ruajtur ato në kushte të mira;

c) produktet që transportohen me tubacione, pa ndërprerje, nëpër një territor të ndryshëm nga ai

i vendit ose territorit përfitues eksportues ose i Republikës së Shqipërisë.

2. Prova që vërteton se janë plotësuar tërësisht kushtet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, duhet t'i jepet autoriteteve doganore kompetente përmes paraqitjes së ndonjë prej dokumenteve të mëposhtme:

a) Një dokumenti të vetëm transporti, që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vendit transit;

b) Një certifikate të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit transit duke:

i. dhënë një përshkrim të saktë të produkteve;

ii. paraqitur datat e shkarkimit e të ngarkimit të produkteve dhe nëse është e zbatueshme, emrat e anijeve ose llojet e tjera të transportit të përdorura;

iii. paraqitur një vërtetim të kushteve nën të cilat ka qëndruar produkti në vendin e transitit;

c) Ose, në rast se nuk mundësohen këto, ndonjë dokument tjetër thelbësor.

Neni 146
Ekspozitat
(Pika 3, e nenit 63, të Kodit)

1. Produktet origjinuese të dërguara nga një vend ose territor përfitues për ekspozim në një vend tjetër dhe të shitura pas ekspozitës, për t'u importuar në Republikën e Shqipërisë përfitojnë në import nga tarifat preferenciale të referuara në nenin 121, me kusht që ato të plotësojnë kërkesat e këtij nënseksioni, që i jep atyre të drejtën për t'u konsideruar me origjinë nga ai vend ose territor përfitues dhe me kusht që të provojë pranë autoriteteve kompetente doganore të Republikës së Shqipërisë se:

a) një eksportues i ka dërguar produktet nga vendi ose territori përfitues direkt në vendin ku bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

b) produktet janë shitur ose dhënë nga ky eksportues një personi në Republikën e Shqipërisë;

c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas saj në Republikën e Shqipërisë, në gjendjen në të cilën ishin dërguar për ekspozim;

ç) produktet e dërguara për ekspozim nuk janë përdorur për ndonjë qëllim tjetër, përveç atij të ekspozimit.

2. Një certifikatë lëvizëse qarkullimi mallrash EUR. 1 dorëzohet sipas procedurave normale tek autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të treguara qartë në të. Kur është e nevojshme, mund të kërkohet një provë dokumentuese shtesë për natyrën e produkteve dhe kushtet në të cilat ato janë të ekspozuara.

3. Pika 1 zbatohet për çdo ekspozitë tregtare, industriale, bujqësore apo artizanale, panair apo shfaqje publike të ngjashme që nuk është organizuar për qëllime private në dyqane apo në ambientet e bizneseve me synimin e shitjes së produkteve të huaja dhe gjatë ekspozimit produktet mbeten nën kontrollin doganor.

Neni 147
Kërkesa të përgjithshme
(Pika 3, e nenit 63, të Kodit)

Produktet me origjinë nga vende, grupe vendesh apo territore do të përfitojnë nga masat tarifore preferenciale të miratuara në mënyrë të njëanshme nga Republika e Shqipërisë, duke zbatuar *mutatis mutandis* rregullat e përcaktuara në nenet 130 - 142.

KREU 4
Vlera e mallrave për qëllime doganore

Neni 148
Dispozita të përgjithshme
(Shkronja "ç", e pikës 3, e nenit 66, të Kodit)

1. Për qëllime të këtij kreu, dy persona do të konsiderohen të jenë të lidhur në qoftë se përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Njëri prej tyre është anëtar ose drejtues i biznesit të tjetrit dhe anasjelltas;

b) Janë ligjërisht të njohur si ortakë në biznes;

c) Janë punëdhënës dhe punëmarrës;

ç) Një person i tretë zotëron, kontrollon apo mban, drejtpërdrejt ose tërthorazi, 5% ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote ose të aksioneve të dy prej tyre;

d) Njëri prej tyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kontrollon tjetrin;

dh) Të dy, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kontrollohen nga një person i tretë;

e) Së bashku, ata kontrollojnë një person të tretë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

ë) Ata janë anëtarë të së njëjtës familje. Personat quhen se janë anëtarë të së njëjtës familje vetëm nëse ata kanë ndonjërën prej marrëdhënieve të mëposhtme me njëri-tjetrin:

i. burrë dhe grua;

ii. të paralindur dhe të paslindur, në vijë të drejtë, në shkallë të parë (prindër dhe fëmijë);

iii. vëlla e motër (pavarësisht nëse janë me gjak të plotë ose jo);

iv. të paralindur dhe të paslindur, në vijë të drejtë, në shkallë të dytë (gjysh/gjyshe dhe nip/mbesë);

v. dajë/xhaxha ose teze/hallë dhe nip/mbesë;

vi. vjehrri/vjehrra dhe dhëndër/nuse;

vii. kunetër dhe kunata.

2. Persona që janë të lidhur në biznes me njëri-tjetrin, për shkak se njëri prej tyre është i vetmi agjent, shpërndarës, ose koncesionar i tjetrit, sido që të jetë emërtimi, quhen të lidhur vetëm në qoftë se hyjnë në njërën prej marrëdhënieve të pikës 1.

3. Për qëllime të shkronjave "d", "dh", "e", të pikës 1, një person konsiderohet se kontrollon një tjetër kur i pari është ligjërisht ose faktikisht në një pozicion për të ushtruar drejtimin mbi të dytin.

Neni 149
Vlera e transaksionit
(Pika 1, e nenit 66, të Kodit)

1. Vlera e transaksionit të mallrave të shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë përcaktohet në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të shitjes që ndodh menjëherë para se mallrat të jenë sjellë në atë territor doganor.

2. Kur mallrat janë shitur për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, jo para se ato të silleshin në atë territor doganor, por ndërkohë që ishin në magazinim të përkohshëm ose ndërkohë që ishin vendosur nën një regjim të posaçëm të ndryshëm nga transiti i brendshëm, përdorimi i veçantë përfundimtar (*end-use*) ose përpunimit pasiv, vlera e transaksionit do të përcaktohet në bazë të kësaj shitjeje.

Neni 150
Çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar
(Pikat 1 dhe 2, të nenit 66, të Kodit)

1. Çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar, në kuptim të pikave 1 dhe 2, të nenit 66, të Kodit, do të përfshijë të gjitha pagesat e bëra ose që do të bëhen si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi, për ndonjë nga këta persona:

a) shitësin;

b) një palë të tretë në dobi të shitësit;

c) një palë të tretë të lidhur me shitësin;

ç) një palë të tretë, ku pagesa për atë palë është bërë në mënyrë që të plotësojë detyrimin e shitësit.

Pagesat mund të bëhen direkt ose indirekt, edhe me anë të letrave të kredisë ose të titujve të negociueshëm.

2. Veprimtaritë, duke përfshirë veprimtaritë e marketingut, të ndërmarra nga blerësi ose një ndërmarrje e lidhur me blerësin për llogarinë e tij, të ndryshme nga ato për të cilat një rregullim është parashikuar në nenin 67, të Kodit, nuk do të konsiderohen si një pagesë indirekte për shitësin.

Neni 151
Zbritjet
(Pikat 1 dhe 2, të nenit 66, të Kodit)

1. Për qëllimet e përcaktimit të vlerës doganore, në kuptim të pikës 1, të nenit 66, të Kodit, zbritjet do të merren në konsideratë në qoftë se, në momentin e pranimit të deklaratës doganore, kontrata e shitjes përcakton zbatimin dhe vlerën e tyre.

2. Zbritjet për pagesën e hershme do të merren në konsideratë në lidhje me mallrat për të cilat çmimi nuk ka qenë, në fakt, i paguar në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

3. Zbritjet, që rrjedhin nga ndryshimet në kontratë, në një kohë më të vonshme nga pranimi i deklaratës doganore, nuk do të merren parasysh.

Neni 152
Dërgesa të pjesshme
(Pika 1, e nenit 66, të Kodit)

1. Kur mallrat e deklaruara për një procedurë doganore janë pjesë e një sasie më të madhe të mallrave të njëjta, të blera në një transaksion, çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar, për qëllimet e pikës 1, të nenit 66, të Kodit, duhet të llogaritet proporcionalisht, në bazë të çmimit për sasinë totale të blerë.

2. Pjesëtimi i çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar do të zbatohet edhe në rastin e humbjes së një pjese të dërgesës apo kur mallrat janë dëmtuar përpara se mallrat të jenë çliruar për qarkullim të lirë.

Neni 153
Rregullimet e çmimeve për mallrat me defekte
(Pika 1, e nenit 66, të Kodit)

Një rregullim i çmimit të paguar ose të pagueshëm për mallrat, i bërë nga shitësi, në dobi të blerësit, mund të merret në konsideratë për përcaktimin e vlerës doganore, në përputhje me pikën 1, të nenit 66, të Kodit, nëse janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Mallrat janë me defekt në momentin e pranimit të deklaratës doganore për çlirim për qarkullim të lirë;

b) Shitësi ka bërë rregullimin për të kompensuar për defektin në mënyrë që të përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

i) një detyrim kontraktual, i lidhur para pranimit të deklaratës doganore;

ii) një detyrim ligjor i zbatueshëm mbi mallrat.

c) Rregullimi bëhet brenda një periudhe prej 1 viti, pas datës së pranimit të deklaratës doganore.

Neni 154
Vlerësimi i kushteve dhe kërkesave
(Shkronja "b", e pikës 3, e nenit 66, të Kodit)

Kur shitja ose çmimi i mallrave të importuara i nënshtrohet një kushti ose kërkese, vlera e të cilave duhet të përcaktohet në lidhje me mallrat që po vlerësohen, vlera të tilla do të konsiderohen si pjesë e çmimit realisht të paguar ose të pagueshëm, përveçse kur këto kushte apo kërkesa kanë të bëjnë me:

a) një aktivitet, për të cilin zbatohet pika 2, e nenit 150;

b) një element të vlerës doganore, në bazë të nenit 67, të Kodit.

Neni 155
Transaksionet ndërmjet personave të lidhur
(Shkronja "ç", e pikës 3, e nenit 66, të Kodit)

1. Kur blerësi dhe shitësi janë të lidhur, me qëllim që të përcaktohet nëse një marrëdhënie e tillë nuk ka ndikuar në çmim, rrethanat e shitjes do të shqyrtohen sipas nevojës dhe deklaruesit do t'i jepet një mundësi për sigurimin e mëtejshëm të detajuar të informacionit që mund të jetë i nevojshëm për ato rrethana.

2. Megjithatë, mallrat do të vlerësohen në përputhje me pikën 1, të nenit 66, të Kodit, ku deklaruesi provon se vlera e deklaruar e transaksionit i përafrohet shumë njërës prej vlerave të mëposhtme, të marra si kritere, të përcaktuara afërsisht të njëjtën kohë:

a) Vlerës së transaksionit në shitje, mes blerësve dhe shitësve, të cilët nuk janë të lidhur në ndonjë rast të veçantë, të mallrave identike ose të ngjashme për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, të përcaktuar në përputhje me shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit;

c) Vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, të përcaktuar në përputhje me shkronjën "ç", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit.

3. Gjatë përcaktimit të vlerës së mallrave identike ose të ngjashme, të përmendura në pikën 2, do të merren parasysh elementet e mëposhtme:

a) Ndryshimet e shfaqura në nivele tregtare;

b) Sasitë;

c) Elementët e listuar në pikën 1, të nenit 67, të Kodit;

ç) Shpenzimet e bëra nga shitësi në shitjet në të cilat ai dhe blerësi nuk janë të lidhur, nëse këto shpenzime nuk janë të shkaktuara nga shitësi, në rastet e shitjeve mes personave të lidhur.

4. Vlerat e marra si kritere të renditura në pikën 2, duhet të përdoren me kërkesë të deklaruesit. Ato nuk do të zëvendësojnë vlerën e deklaruar të transaksionit.

Neni 156
Mallrat dhe shërbimet që përdoren për prodhimin e mallrave të importuara
(Shkronja "b", e pikës 1, e nenit 67, të Kodit)

1. Kur një blerës furnizon shitësin me ndonjë nga mallrat ose shërbimet e renditura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, vlera e këtyre mallrave dhe shërbimeve do të konsiderohet të jetë e barabartë me çmimin e tyre të blerjes. Çmimi i blerjes duhet të përfshijë të gjitha pagesat, të cilat blerësi i mallrave ose i shërbimeve të renditura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 67, është i detyruar t'i bëjë, për të marrë mallrat ose shërbimet.

Kur këto mallra ose shërbime janë prodhuar nga blerësi ose një person i lidhur me të, vlera e tyre do të jetë kostoja e prodhimit të tyre.

2. Kur vlera e mallrave dhe shërbimeve të renditura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, nuk mund të përcaktohet në përputhje

me pikën 1, do të përcaktohet në bazë të të dhënave të tjera objektive e të përllogaritshme.

3. Kur mallrat e renditura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, janë përdorur nga blerësi para se ato të ishin furnizuar, vlera e tyre do të korrigjohet për të marrë parasysh çdo ulje çmimi.

4. Vlera e shërbimeve të përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, përfshin shpenzimet e aktiviteteve të zhvillimit që nuk ishin të suksesshme, për aq sa ato lidhen me projektet apo porositë e mallrave të importuara.

5. Për qëllimet e nënndarjes (iv), të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, shpenzimet e kërkimeve dhe projektimeve nuk do të përfshihen në vlerën doganore.

6. Vlera e mallrave dhe shërbimeve të furnizuara, siç është përcaktuar në përputhje me pikat 1 deri 5, do të ndahet në mënyrë proporcionale mbi mallrat e importuara.

Neni 157
Pagesa mbi përdorimin e të drejtës së pronësisë intelektuale (*royalties*) dhe licencat
(Shkronja "c", e pikës 1, të nenit 71, të Kodit)

1. *Royalties* dhe licencat që janë të lidhura me mallin e importuar, në mënyrë të veçantë të drejtat e transferuara sipas marrëveshjes së licencës apo të *royalties*, janë të trupëzuara në mallra. Metoda e llogaritjes së shumës së *royalties* ose të licencës nuk është vendimtare.

2. Kur metoda e llogaritjes së shumës së pagesës të *royalties* ose licencave bazohet në çmimin e mallrave të importuara, në mungesë të provave të kundërta, supozohet se pagesat e këtyre *royalties* ose të licencave lidhen me mallrat objekt vlerësimi.

3. Nëse pagesa për *royalties* ose për licenca lidhet pjesërisht me mallrat që do të vlerësohen dhe pjesërisht me përbërës të tjerë ose pjesë të shtuara mallrave pas importimit të tyre, ose të aktiviteteve apo shërbimeve të pas importimit, duhet të bëhet një rregullim i përshtatshëm.

4. *Royalties* dhe licenca konsiderohen për t'u paguar si kusht i shitjes për mallrat e importuara, kur përmbushet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

a) Shitësi ose një person i lidhur me shitësin i kërkon blerësit për të bërë këtë pagesë;

b) Pagesa nga blerësi është bërë për të përmbushur detyrimin e shitësit, në përputhje me detyrimet kontraktuale;

c) Mallrat nuk mund të shiten ose të blihen nga blerësi pa pagesën e *royalties* ose të licencave për një licencëdhënës.

5. Vendi në të cilin është vendosur pranuesi i pagesës së *royalties* ose licencës është i parëndësishëm.

6. Çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar, për filmat kinematografikë të importuar në Republikën e Shqipërisë me të drejtën e riprodhimit dhe të shpërndarjes, nuk do t'i shtohet pagesa mbi përdorimin e të drejtës së pronësisë intelektuale (*royalties*) dhe pagesa mbi përdorimin e licencës (*license fee*).

Neni 158
Vendi i hyrjes së mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 67, të Kodit)

1. Për qëllime të shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, vendi ku mallrat kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë do të jetë, si vijon:

a) Për mallrat e transportuara në rrugë detare, porti ku mallrat mbërrijnë për herë të parë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Për mallrat e transportuara në rrugë detare dhe më pas, pa transbordim, nëpërmjet ujërave të brendshëm, porti i parë ku mund të kryhet shkarkimi;

c) Për mallrat e transportuara në rrugë hekurudhore, rrugë të brendshme ujore, ose rrugë automobilistike, vendi ku ndodhet zyra doganore e hyrjes;

ç) Për mallrat e transportuara me mënyrat e tjera të transportit, vendi ku kalohet kufiri i territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Për qëllimet e shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, kur mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe pastaj transportuar për në një destinacion, në një pjesë tjetër të këtij territori, nëpërmjet territoreve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, vendi ku mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë do të jetë vendi ku mallrat janë sjellë për herë të parë në atë territor doganor, me kusht që mallrat të transportohen direkt përmes këtyre territoreve nga një rrugë e zakonshme në vendin e destinacionit.

3. Pika 2 zbatohet edhe kur mallrat janë shkarkuar, transportuar ose përkohësisht të palëvizshme në territoret jashtë territorit doganor të

Republikës së Shqipërisë, për arsye që kanë të bëjnë vetëm me transportin e tyre.

4. Kur kushtet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, pikave 2 dhe 3, nuk plotësohen, vendi ku mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë do të jetë, si më poshtë:

a) Për mallrat e transportuara në rrugë detare, porti i shkarkimit;

b) Për mallrat e transportuara me mjete të tjera të transportit, vendi i specifikuar në shkronjat "c", "ç" ose "d", të pikës 1, është ai i vendosur në këtë pjesë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, drejt së cilit janë dërguar mallrat.

Neni 159
Shpenzimet e transportit
(Shkronja "b", e pikës 1, të nenit 67, të Kodit)

1. Kur mallrat transportohen me të njëjtat mjete të transportit në një pikë përtej vendit ku ato janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, shpenzimet e transportit do të vlerësohen në raport me distancën nga vendi ku mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 158, vetëm nëse paraqiten prova para autoriteteve doganore për shpenzimet që do të ishin bërë në bazë të një tarife standarde, për transportin e mallrave deri në vendin ku mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Shpenzimet e transportit ajror, duke përfshirë kostot e shpërndarjes ajrore ekspres, do të përfshihen në vlerën doganore të mallrave.

Kur transporti është falas ose i siguruar nga blerësi, shpenzimet e transportit që do të përfshihen në vlerën doganore të mallrave, do të llogariten në përputhje me një tarifë standarde që zbatohet zakonisht për të njëjtat mënyra transporti.

Neni 160
Detyrimet mbi dërgesat postare
(Pika 1, e nenit 66, të Kodit)

Detyrimet postare, në lidhje me mallrat e dërguara me postë në vendin e destinacionit, do të përfshihen në vlerën doganore të këtyre mallrave, me përjashtim të çdo takse postare shtesë që vendoset në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë

Neni 161
Mospranimi i vlerave të deklaruara të transaksionit
(Pika 1, e nenit 66, të Kodit)

1. Kur autoritetet doganore, mbështetur në analizën e riskut, kanë dyshime të arsyeshme se vlera e deklaruar e transaksionit nuk përfaqëson shumën totale të paguar ose të pagueshme, siç referohet në pikën 1, të nenit 66, të Kodit, mund të kërkojnë nga deklaruesi të japë informacione shtesë dhe deklaruesi është i detyruar që të japë informacion dhe dokumente shtesë lidhur me:

a) vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;

b) informacion ose dokumente shtesë, të nevojshme, për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave.

2. Në qoftë se përsëri mbeten dyshime, autoritetet doganore mund të vendosin që vlera e mallit nuk mund të përcaktohet në përputhje me pikën 1, të nenit 66, të Kodit. Autoritetet doganore, mbështetur në nenin 7.3, të Marrëveshjes për Zbatimin e nenit 7, të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT-1994), informojnë deklaruesin për aktin e vlerësimit.

Akti i vlerësimit duhet të sqarojë dyshimet e arsyeshme, rivlerësimin dhe metodën e vlerësimit të përdorur për llogaritjen e vlerës doganore të mallit të importuar.

Brenda 10 ditëve nga informimi, deklaruesi mundet të ankohet me shkrim ndaj aktit të vlerësimit pranë degës doganore vendim marrëse.

Vendimi i arsyetuar i komunikohet me shkrim deklaruesit brenda 5 ditëve, depozitimi i ankimit.

3. Kundër vendimit, personit të interesuarit i lind e drejta e ankimimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në këtë rast, nenet 281 dhe 282, të Kodit, aplikohen *mutatis mutandis*.

4. Në zbatim të pikës 3, të nenit 70, të Kodit Doganor, përgatitja e të dhënave të disponueshme në Republikën e Shqipërisë dhe përditësimi i tyre, për përcaktimin e vlerës doganore, në rastet kur nuk ka qenë e mundur të përcaktohet në përputhje me pikën 3, të nenit 70, bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe miratohen nga komisioni *ad-hoc* i të dhënave të disponueshme në Republikën e Shqipërisë, i cili është në varësi të ministrit përgjegjës për financat. Detyrat dhe përbërja e komisionit caktohen me urdhër të

ministrit përgjegjës për financat. Të dhënat e disponueshme për vlerën doganore pasqyrohen në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

5. Ministri përgjegjës për financat mund të nxjerrë edhe akte të tjera nënligjore për vlerësimin doganor të mallrave.

Neni 162
Vlera doganore e mallrave identike ose të ngjashme
(Shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit)

1. Gjatë përcaktimit të vlerës doganore të mallrave të importuara në përputhje me shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit, do të përdoret vlera e transaksionit e mallrave identike ose të ngjashme të shitura në të njëjtin nivel tregtar dhe në sasi në thelb të njëjta me mallrat që po vlerësohen.

Kur nuk gjenden shitje të tilla, vlera doganore përcaktohet duke pasur parasysh vlerën e transaksionit të mallrave identike ose të ngjashme të shitura në një nivel të ndryshëm tregtar ose në sasi të ndryshme. Kjo vlerë e transaksionit duhet të përshtatet për të marrë parasysh ndryshimet që i përkasin nivelit tregtar dhe/ose sasisë.

2. Duhet të bëhet një rregullim, duke marrë parasysh ndryshimet thelbësore të këtyre shpenzimeve, ndërmjet mallrave të importuara dhe mallrave identike ose të ngjashme në fjalë, për shkak të dallimeve në largësi dhe mënyrat e transportit.

3. Kur është gjetur më shumë se një vlerë e transaksionit të mallrave identike ose të ngjashme, më e ulëta e këtyre vlerave do të përdoret për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave të importuara.

4. "Mallrat identike" dhe "mallrat e ngjashme", sipas rastit, nuk përfshijnë mallrat që kanë ose pasqyrojnë punën inxhinierike, zhvillimin, veprat e artit, punën e dizajnit, planet apo skicat për të cilat asnjë rregullim nuk është bërë në bazë të nënndarjes (iv), të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, sepse një punë e tillë është kryer në Republikën e Shqipërisë.

5. Vlera e transaksionit të mallrave të prodhuara nga një person tjetër duhet të merret parasysh vetëm kur vlera e transaksionit nuk mund të gjendet për mallra identike ose të ngjashme, të prodhuara nga i njëjti person që ka prodhuar mallrat objekt vlerësimi.

Neni 163
Metoda deduktive
(Shkronja "c", e pikës 2, të nenit 70, të Kodit)

1. Çmimi për njësi, i përdorur për përcaktimin e vlerës doganore në bazë të shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit, do të jetë çmimi me të cilin mallrat e importuara ose mallrat identike apo të ngjashme të importuara janë shitur në Republikën e Shqipërisë, në gjendjen siç janë importuar, përafërsisht me kohën e importimit të mallrave që vlerësohen.

2. Në mungesë të një çmimi për njësi, siç përmendet në pikën 1, çmimi i njësisë së përdorur do të jetë çmimi me të cilin mallrat e importuara ose mallrat identike të importuara apo të ngjashme janë shitur në gjendjen siç janë importuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në kohë më të hershme pas importimit të mallrave që do të vlerësohen dhe në çdo rast brenda 90 ditëve të atij importimi.

3. Në mungesë të një çmimi për njësi, siç referohet në të dy pikat 1 dhe 2, me kërkesë të deklaruesit, çmimi për njësi me të cilin mallrat e importuara janë shitur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, pas punimit të mëtejshëm ose përpunimit, do të përdoret kompensimi për shkak të vlerës së shtuar nga punime apo përpunime të tilla.

4. Për qëllime të përcaktimit të vlerës doganore në bazë të shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit, nuk do të merren parasysh:

a) shitja e mallrave në një nivel tregtar të ndryshëm nga ai i pari, pas importimit;

b) shitjet ndaj personave të lidhur;

c) shitjet ndaj personave, të cilët, direkt ose indirekt, furnizojnë pa pagesë apo me kosto të reduktuar mallrat ose shërbimet e renditura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, për përdorim në lidhje me prodhimin dhe shitjen për eksport të mallrave të importuara;

ç) shitjet në sasi të cilat nuk janë të mjaftueshme për të lejuar përcaktimin e çmimit për njësi.

5. Gjatë përcaktimit të vlerës doganore, do të zbriten nga njësia e çmimit të përcaktuar në përputhje me pikat 1 deri 4, elementët e mëposhtëm:

a) Secili nga komisionet, që zakonisht paguhet ose bihet dakord për t'u paguar apo shtesat që bëhen zakonisht për qëllime fitimi dhe shpenzime të përgjithshme (duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të marketingut të mallrave në fjalë) në lidhje me shitjen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave të importuara të së njëjtës kategori ose lloj, të cilat janë mallrat që bien brenda një grupi ose një sërë mallrash të prodhuara nga një sektor i caktuar industrial;

b) Shpenzimet e zakonshme të transportit dhe siguracionit dhe shpenzimet shoqëruese të shkaktuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) Detyrimet e importit dhe detyrimet e tjera të pagueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, për shkak të importit ose shitjes së mallrave.

Vlera doganore e mallrave që prishen shpejt, të importuara në ngarkesë, mund të përcaktohet direkt në përputhje me nenet 66 dhe 70, të Kodit.

Neni 164
Metoda e vlerës së përllogaritur
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 70, të Kodit)

1. Në zbatim të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit, autoritetet doganore nuk mund të kërkojnë ose të detyrojnë një person jo të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të paraqesë dokumente kontabile apo dokumente të tjera justifikuese, ose të lejojë akses në dokumente të tilla, për shqyrtim për qëllime të përcaktimit të vlerës doganore.

2. Kostoja ose vlera e materialeve dhe e përpunimit e përmendur në nenin nënndarjen (i), të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit, do të përfshijë koston e elementëve të përcaktuar në nënndarjet (ii) dhe (iii) të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit. Ajo do të përfshijë koston në proporcionalitet të çdo produkti apo shërbimi të specifikuar në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit, të cilat janë furnizuar direkt ose indirekt, nga blerësi, për përdorim në lidhje me prodhimin e mallrave që vlerësohen. Vlera e elementëve të përcaktuar në nënndarjen (iv), të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit të cilat janë ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë, përfshihet vetëm në masën që këto elemente i janë ngarkuar prodhuesit.

3. Kostoja e prodhimit përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për krijimin, zhvillimin ose përmirësimin e konsiderueshëm ekonomik të mallrave. Ajo, gjithashtu, përfshin kostot e specifikuara në nenin nënndarjet (ii) dhe (iii), të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 67, të Kodit.

4. Shpenzimet e përgjithshme, të përmendura në nënndarjen (ii), të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit, mbulojnë kostot e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të prodhimit dhe shitjes së mallrave për eksport, të cilat nuk janë të përfshira nënndarjen (i), të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit.

Neni 165
Metoda e të dhënave të disponueshme
(Pika 3, e nenit 70, të Kodit)

1. Gjatë përcaktimit të vlerës doganore në bazë të pikës 3, të nenit 70, të Kodit, mund të përdoret një arsyetim fleksibël në aplikimin e metodave të parashikuara në nenet 66 dhe 70, pika 2, të Kodit. Vlera e përcaktuar në këtë mënyrë, për aq sa është e mundur, do të bazohet në vlerat doganore të përcaktuara më parë.

2. Kur vlerat doganore nuk mund të përcaktohen sipas pikës 1, do të përdoren metoda të tjera, të përshtatshme. Në këtë rast, vlera doganore nuk do të përcaktohet në bazën e ndonjërit prej elementeve të mëposhtme:

a) Çmimi i shitjes brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, të mallrave të prodhuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Një sistem ku më e larta midis dy vlerave alternative është përdorur për vlerësimin doganor;

c) Çmimi i mallrave në tregun e brendshëm të vendit eksportues;

ç) Kostoja e prodhimit, e ndryshme nga vlerat e përllogaritura që janë përcaktuar për mallra identike ose të ngjashme, në bazë të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 70, të Kodit;

d) Çmimet për eksport në një vend tjetër;

dh) Vlerat minimale doganore;

e) Vlerat arbitrare ose fiktive.

Neni 166
Thjeshtësime
(Neni 69 i Kodit)

1. Autorizimi, i referuar në nenin 69, të Kodit, mund të jepet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Zbatimi i procedurës së referuar në nenin 152, të Kodit, në ato rrethana përfaqëson shpenzime administrative joproporcionale;

b) Vlera doganore e përcaktuar nuk do të ndryshojë shumë nga ajo e përcaktuar në mungesë të një autorizimi.

2. Dhënia e autorizimit kushtëzohet nga përmbushja e kushteve të mëposhtme:

a) Aplikuesi përmbush kriterin e parashikuar në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit;

b) Aplikuesi mban një sistem të kontabilitetit, i cili është në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuara të kontabilitetit, të aplikuara në Republikën e Shqipërisë dhe që mundësojnë kontrollin doganor të bazuar në auditim. Sistemi i kontabilitetit mban një protokoll regjistrimi të të dhënave, që ofron gjurmë të auditimit që nga momenti kur të dhënat hyjnë në dosje;

c) Aplikuesi ka një organizim administrativ që i korrespondon llojit dhe madhësisë së biznesit dhe i cili është i përshtatshëm për menaxhimin e qarkullimit të mallrave, si dhe ka kontrolle të brendshme të afta për zbulimin e transaksioneve të paligjshme ose të parregullta.

Neni 167
Dokumentet shoqëruese në lidhje me vlerën doganore
(Pika 1, e nenit 150, të Kodit)

Fatura, e cila ka të bëjë me vlerën e deklaruar të transaksionit, është e nevojshme si një dokument shoqërues.

Neni 168
Konvertimi i monedhës për qëllime të vlerësimit doganor
(Shkronja "a", e pikës 1, të nenit 54, të Kodit)

Në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 54, të Kodit, për qëllime të vlerësimit doganor do të përdoret kursi i këmbimit i publikuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 169
Sistemi elektronik në lidhje me vlerën e mallrave

Deklarata e të dhënave në lidhje me vlerën doganore:

1. Deri në datat e përmirësimit të sistemit të informatizuar për importin, sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, deklarata doganore për çlirim për qarkullim të lirë do të përfshijë të dhëna në lidhje me vlerën doganore.

2. Autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera, të ndryshme nga teknikat elektronike të përpunimit të të dhënave për t'u përdorur në lidhje me dispozitat mbi të dhënat e përmendura në pikën 1.

3. Kur të dhënat e përmendura në paragrafin 1 janë siguruar duke përdorur mjete të tjera, të ndryshme nga teknikat elektronike të përpunimit, do të përdoret formulari i aneksit 4, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Autoritetet doganore mund të heqin detyrimin për të paraqitur të dhënat e veçanta të referuara në pikën 1, të këtij neni, kur vlera doganore e mallrave në fjalë nuk mund të përcaktohet bazuar në nenin 66 të Kodit.

5. Përveç rasteve kur është e domosdoshme për përcaktimin e saktë të vlerës doganore, autoritetet doganore mund të heqin detyrimin për të siguruar të dhënat e përmendura në pikën 1, për ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) kur vlera doganore e mallrave të importuara në një ngarkesë nuk i kalon 10 000 euro, me kusht që kjo dërgesë të mos jetë e ndarë apo pjesë e dërgesave të shumëfishta nga i njëjti dërgues për të njëjtin marrës;

b) kur transaksioni bazë për çlirimin për qarkullim të lirë të mallrave ka natyrë jo tregtare;

c) kur paraqitja e të dhënave në fjalë nuk është e nevojshme për zbatimin e Tarifës Doganore;

ç) kur detyrimet doganore të parashikuara në Tarifën Doganore nuk janë të tarifueshme.

6. Në rastin e qarkullimit të vazhdueshëm të mallrave nga i njëjti shitës për të njëjtin blerës, sipas kushteve të njëjta tregtare, autoritetet doganore mund të heqin dorë nga kërkesa e vazhdueshme për të siguruar të dhënat e përmendura në pikën 1.

TITULLI III
BORXHI DOGANOR DHE GARANCITË

KREU 1
Lindja e borxhit doganor

Seksioni 1
Dispozita të përbashkëta për lindjen e borxhit doganor në import dhe eksport

Nënseksioni 1
Rregullat për llogaritjen e shumës së detyrimit të importit ose eksportit

Neni 170
Llogaritja e shumës së detyrimit të importit për produktet e përpunuara që rezultojnë nga përpunimi aktiv

(Pika 3, e nenit 81, të Kodit)

1. Për të përcaktuar shumën e detyrimit të importit që duhet paguar për produktet e përpunuara në përputhje me pikën 3, të nenit 81, të Kodit, sasia e mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv konsiderohet të jetë e pranishme në produktet e përpunuara për të cilat lind një borxh doganor, në përputhje me pikat 2 deri në 6.

2. Metoda e matjes sasiore, e përcaktuar në pikat 3 dhe 4, zbatohet në rastet e mëposhtme:

a) Kur vetëm një lloj i produkteve të përpunuara rrjedh nga operacionet e përpunimit;

b) Kur lloje të ndryshme të produkteve të përpunuara rrjedhin nga operacionet e përpunimit dhe të gjithë përbërësit ose komponentët e mallrave të vendosura nën regjim gjenden në secilin prej këtyre produkteve të përpunuara.

3. Në rastin e përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, sasia e mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv, që konsiderohet të jetë e pranishme në produktet e përpunuara për të cilat lind një borxh doganor, përcaktohet duke zbatuar ndaj sasisë totale të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv një përqindje që i korrespondon raportit mes sasisë së produkteve të përpunuara për të cilat lind një borxh doganor dhe sasisë totale të produkteve të përpunuara nga operacionet e përpunimit aktiv.

4. Në rastin e përmendur në shkronjën "b", të pikës 2, sasia e mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv, që konsiderohet të jetë e pranishme në produktet e përpunuara për të cilat lind një borxh doganor, përcaktohet duke zbatuar ndaj sasisë totale të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv një përqindje të llogaritur duke shumëzuar faktorët e mëposhtëm:

a) përqindjen që zënë produktet e përpunuara për të cilat lind një borxh doganor në sasinë totale të produkteve të përpunuara të të njëjtit lloj që del nga operacionet e përpunimit;

b) përqindjen që zë sasia totale e produkteve të përpunuara të të njëjtit lloj, pavarësisht nga fakti nëse lind një borxh doganor në sasinë totale të të gjitha produkteve të përpunuara që dalin nga operacionet e përpunimit.

5. Sasitë e mallrave të vendosura nën regjim, të cilat janë shkatërruar dhe kanë humbur gjatë operacionit të përpunimit, në veçanti nga avullimi, tharja, kalimi në gjendje të gaztë apo rrjedhja, nuk do të merren parasysh në zbatimin e metodës së matjes sasiore.

6. Në raste të tjera, përveç atyre të përmendura në pikën 2, metoda e matjes së vlerës zbatohet në përputhje me paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt.

Sasia e mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv, që konsiderohet të jetë e pranishme në produktet e përpunuara për të cilat lind një borxh doganor, përcaktohet duke zbatuar për të gjithë sasinë e mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv një përqindje të llogaritur duke shumëzuar faktorët e mëposhtëm:

a) Përqindjen që zënë produktet e përpunuara, për të cilat lind një borxh doganor, në vlerën totale të produkteve të përpunuara të të njëjtit lloj që del nga operacioni i përpunimit;

b) Përqindjen që zë vlera totale e produkteve të përpunuara të të njëjtit lloj, pavarësisht nëse lind ndonjë borxh doganor, në vlerën totale të të gjitha produkteve të përpunuara që dalin nga operacioni i përpunimit.

Për qëllime të zbatimit të metodës së matjes së vlerës, vlera e produkteve të përpunuara përcaktohet në bazë të çmimeve aktuale të fabrikës (*ex-works*) në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose, nëse nuk mund të përcaktohen çmime të tilla të fabrikës (*ex-works*), përcaktohet bazuar në çmimet aktuale të shitjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për produkte të njëjta ose të ngjashme. Çmimet e përcaktuara mes palëve që rezultojnë të jenë të lidhura ose të kenë një marrëveshje kompensuese me njëri-tjetrin nuk mund të përdoren për përcaktimin e vlerës së

produkteve të përpunuara, përveç rasteve kur provohet se çmimet nuk ndikohen nga marrëdhëniet.

Kur vlera e produkteve të përpunuara nuk mund të përcaktohet në përputhje me paragrafin e tretë, atëherë ajo përcaktohet me ndonjë metodë tjetër të arsyeshme.

Neni 171
Zbatimi i dispozitave të regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) ndaj produkteve të përpunuara që rezultojnë nga përpunimi aktiv
(Pika 3, e nenit 81, të Kodit)

1. Për qëllimet e zbatimit të pikës 3, të nenit 81, të Kodit, kur duhet të përcaktohet shuma e detyrimit të importit që i korrespondon borxhit doganor për produktet e përpunuara që dalin nga regjimi i përpunimit aktiv, përfitohet përjashtim nga detyrimi ose një reduktim i nivelit të detyrimit, nëse produktet e përpunuara vendosen nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*), në përputhje me nenin 227 të Kodit.

2. Pika 1 zbatohet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Mund të jetë lëshuar një autorizim për t'i vendosur mallrat nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*), dhe

b) Përmbushen kushtet për përjashtim nga detyrimi ose reduktim të nivelit të detyrimit për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) të këtyre mallrave në momentin e pranimit të deklaratës doganore për vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv.

Neni 172
Zbatimi i trajtimit tarifor preferencial për mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv
(Pika 3, e nenit 81, të Kodit)

Në zbatim të pikës 3, të nenit 81, të Kodit, kur në kohën e pranimit të deklaratës doganore për vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv, mallrat e importuara i plotësojnë kushtet për t'u klasifikuar për trajtim tarifor preferencial brenda kuotave apo tavaneve tarifore, këto mallra do të përfitojnë çdo trajtim tarifor preferencial të parashikuar në lidhje me mallrat identike në momentin e pranimit të deklaratës për çlirim në qarkullim të lirë.

Neni 173
Detyrimi i veçantë i importit për produktet e përpunuara që rezultojnë nga përpunimi pasiv apo produktet zëvendësuese
(Pika 5, e nenit 81, të Kodit)

Kur duhet të zbatohet një detyrim i veçantë importi, në lidhje me produktet e përpunuara që rezultojnë nga regjimi i përpunimit pasiv apo produktet zëvendësuese, atëherë shuma e detyrimit të importit llogaritet në bazë të vlerës doganore të produkteve të përpunuara në kohën e pranimit të deklaratës doganore për çlirim në qarkullim të lirë, minus vlerën statistikore të mallrave përkatëse të eksportuara përkohësisht, në kohën kur ato janë vendosur nën regjimin e përpunimit pasiv, shumëzuar me shumën e detyrimit të importit që zbatohet për produktet e përpunuara ose produktet zëvendësuese, pjesëtuar me vlerën doganore të produkteve të përpunuara ose produktet zëvendësuese.

Neni 174
Përjashtim nga llogaritja e shumës së detyrimit të importit për produktet e përpunuara që rezultojnë nga përpunimi aktiv
(Pika 3 dhe 4, të nenit 81, Kodit)

Pika 3, e nenit 81, Kodit, zbatohet në mungesë të një kërkese nga deklaruesi, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Produktet e përpunuara, që rezultojnë nga regjimi i përpunimit aktiv, janë importuar direkt ose indirekt nga mbajtësi përkatës i autorizimit, brenda një periudhe njëvjeçare nga rieksportimi i tyre;

b) Në momentin e pranimit të deklaratës doganore për vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv, mallrat kanë qenë paraprakisht objekt i një mase të ndërmarrë për politikat tregtare apo bujqësore, një detyrimi antidumping, një detyrimi kompensues, një mase mbrojtëse ose rënduese, nëse do të çliroheshin për qarkullim të lirë në atë moment;

c) Nuk është kërkuar asnjë shqyrtim i kushteve ekonomike në përputhje me nenin 535.

Nënseksioni 2
Afati kohor për përcaktimin e vendit ku lind borxhi doganor

Neni 175
Afati për përcaktimin e vendit ku lind borxhi doganor sipas transitit
(Pika 2, e nenit 82, të Kodit)

Për mallrat e vendosura nën regjimin e transitit, afati i referuar në pikën 2, të nenit 82, të të Kodit, do të jetë:

a) një muaj nga data e fundit në të cilën mallrat duhet të ishin paraqitur në zyrën doganore të destinacionit, përveç rastit kur, para skadimit të këtij afati kohor, është dërguar një kërkesë për të transferuar vjeljen e borxhit doganor tek autoriteti përgjegjës i vendit ku, sipas provave të marra nga autoritetet doganore të nisjes, ngjarjet nga të cilat ka lindur borxhi doganor kanë ndodhur. Në këtë rast afati zgjatet me një maksimum prej një muaji;

b) një muaj nga skadimi i afatit për përgjigje nga ana e mbajtësit të regjimit për një kërkesë për të dhënë informacionin e nevojshëm për mbylljen e regjimit, kur autoriteti doganor i nisjes nuk është njoftuar për mbërritjen e mallrave dhe mbajtësi i regjimit ka dhënë ose jo informacione të mjaftueshme.

Neni 176
Afati kohor për përcaktimin e vendit ku lind borxhi doganor sipas transitit në përputhje me Konventën TIR
(Pika 2, e nenit 82, të Kodit)

Për mallrat e vendosura nën regjimin e transitit në përputhje me Konventën Doganore mbi transportin ndërkombëtar të mallrave, që janë objekt i Carnet TIR, përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm (Konventa TIR), afati i përmendur në pikën 2, të nenit 82, të Kodit, do të jetë shtatë muaj nga data e fundit në të cilën mallrat duhet të ishin paraqitur në zyrën doganore të destinacionit ose të daljes.

Neni 177
Afati për përcaktimin e vendit ku lind borxhi doganor sipas transitit, në përputhje me Konventën ATA ose Konventën e Stambollit
(Pika 2, e nenit 82, të Kodit)

Për mallrat e vendosura nën regjimin e transitit në përputhje me Konventën ATA për Lejimin e Përkohshëm të Mallrave, të nënshkruar në Bruksel, më 6 dhjetor 1961, duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm të saj (Konventa ATA), ose me Konventën për Lejimin e Përkohshëm (Konventa e Stambollit), duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm, afati kohor i përmendur në pikën 2, të nenit 82, të Kodit, do të jetë shtatë muaj nga data në të cilën mallrat duhet të ishin paraqitur në zyrën doganore të destinacionit.

Neni 178
Afati kohor për përcaktimin e vendit ku lind borxhi doganor në raste të tjera përveç transitit
(Pika 2, e nenit 82, të Kodit)

Për mallrat e vendosura nën një regjim të posaçëm përveç transitit ose për mallrat, të cilat janë në magazinim të përkohshëm, afati i përmendur në pikën 2, të nenit 82, të Kodit, do të jetë një muaj nga përfundimi i ndonjërës prej periudhave të mëposhtme:

a) Periudha e përcaktuar për mbylljen e regjimit të posaçëm;

b) Periudha e përcaktuar për përfundimin e mbikëqyrjes doganore të mallrave për përdorim të veçantë përfundimtar (*end-use*);

c) Periudha e përcaktuar për përfundimin e magazinimit të përkohshëm;

ç) Periudha e përcaktuar për përfundimin e lëvizjes së mallrave të vendosura nën regjimin e magazinimit, mes vendeve të ndryshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, kur nuk është mbyllur regjimi.

KREU 2
Garancia për një borxh doganor të mundshëm ose ekzistues

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 179
Sistemet elektronike në lidhje me garancitë (Neni 17 i Kodit)

1. Për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit që ka të bëjë me garancitë do të ngrihet një sistem elektronik. Ky sistem zbatohet sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

2. Deri në datën e implementimit të sistemit të përmendur në pikën 1, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera, të

ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave, në lidhje me aplikimet dhe vendimet që do të përdoren për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit për garancitë.

3. Shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit për garancitë, siç përmendet në pikën 2, dhe kur garancitë janë paraqitur për ndonjë qëllim tjetër përveç transitit, do të zbatohet si vijon:

a) ruajtja e informacionit duhet të bëhet nga autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me sistemin ekzistues kombëtar;

b) për shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve doganore do të përdoret posta elektronike.

4. Për shkëmbimin e informacionit të përmendur në pikën 3 do të caktohen pika kontakti si përgjegjës.

Neni 180
Garancia individuale për një borxh doganor të mundshëm
(Paragrafi 2, i pikës 1, të nenit 85, të Kodit)

1. Kur është e detyrueshme që të sigurohet një garanci që mbulon një operacion të vetëm (garancia individuale), për një borxh doganor të mundshëm, ajo duhet të mbulojë shumën e detyrimit të importit ose të eksportit që i korrespondon borxhit doganor që mund të lindë, të llogaritur në bazë të normave më të larta të taksimit të zbatueshëm për mallra të të njëjtit lloj.

2. Kur pagesat e tjera në lidhje me importin dhe eksportin e mallrave mbulohen nga garancia individuale, llogaritja e tyre do të bazohet në normat më të larta të aplikueshme për mallra të të njëjtit lloj në Republikën e Shqipërisë, kur mallrat në fjalë janë vendosur nën një regjim doganor ose magazinim të përkohshëm.

Neni 181
Garancia fakultative
(Neni 86 i Kodit)

Kur autoritetet doganore vendosin të kërkojnë një garanci, e cila është fakultative, zbatohen nenet 182 deri 193.

Neni 182
Garancia në formën e një depozite në të holla (*cash*)
(Shkronja "a", e pikës 1, të nenit 87, të Kodit)

Kur një garanci është e nevojshme për një regjim të posaçëm ose magazinim të përkohshëm dhe është siguruar si një garanci individuale në formën e një depozite në të holla, kjo garanci i jepet autoritetit doganor të Republikës së Shqipërisë, ku mallrat janë vendosur nën regjim ose magazinim të përkohshëm.

Kur një regjim i posaçëm, i ndryshëm nga regjimi i përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) është mbyllur, ose mbikëqyrja e mallrave nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) ose magazinimit të përkohshëm është mbyllur në mënyrë korrekte, garancia do të rimbursohet nga autoriteti doganor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 183
Garancia në formën e një dorëzanie nga dorëzanësi
(Nenet 87, pika 1, shkronja "b"; dhe 89, të Kodit)

1. Garancia e dhënë në formën e një dorëzanie duhet të miratohet nga zyra doganore ku është dhënë garancia (zyra doganore e garancisë), e cila do t'i njoftojë miratimin e saj, personit që i kërkohet të sigurojë garancinë.

2. Zyra doganore e garancisë mund të revokojë miratimin e dorëzanisë nga dorëzanësi në çdo kohë. Zyra doganore e garancisë duhet t'i njoftojë revokimin dorëzanësit dhe personit të cilit i kërkohet të sigurojë garancinë.

3. Dorëzanësi mund të anulojë/tërheqë dorëzaninë e tij në çdo kohë. Ai duhet të njoftojë zyrën doganore të garancisë për anulimin/ tërheqjen.

4. Anulimi i dorëzanisë nuk do të ndikojë mbi mallrat të cilat në momentin kur anulimi hyn në fuqi kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të vendosura nën një regjim doganor ose magazinim të përkohshëm, në bazë të dorëzanisë së anuluar.

5. Një garanci individuale e siguruar në formën e një dorëzanie duhet të jepet duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin 32-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Një garanci globale e siguruar në formën e një dorëzanie duhet të jepet duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin 32-03, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

7. Pa rënë ndesh me pikat 5 dhe 6, të këtij neni dhe nenit 196, autoritetet doganore mund që në përputhje me legjislacionin në fuqi të lejojnë që dorëzania e siguruar nga një dorëzanës të ketë një

formë të ndryshme nga ato të përcaktuara në anekset 32-01, 32-02 dhe 32-03, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, me kusht që të ketë të njëjtin efekt ligjor.

Neni 184
Garancia në formën e një dorëzanie nga dorëzanësi në rastet e një marrëveshje ndërkombëtare
(Nenet 6, pika 3, shkronja "a"; 27, pika 4; dhe 89, të Kodit Doganor)

1. Në rastet kur është nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare për transitin dhe garancia e dhënë në formën e një dorëzanie nga dorëzanësi mund të përdoret në më shumë se një shtet, garantuesi duhet të tregojë një adresë për shërbime ose të caktojë një përfaqësues në shtetin, pjesë e marrëveshjes ku mund të përdoret kjo garanci.

2. Revokimi i miratimit të dorëzanësit ose i dorëzanisë së dorëzanësit hyn në fuqi në ditën e 16-të pas datës në të cilën është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga dorëzanësi vendimi për revokimin.

3. Anulimi i dorëzanësit do të hyjë në fuqi në ditën e 16, pas datës në të cilën dorëzanësi i ka komunikuar anulimin zyrës doganore ku është depozituar garancia.

4. Kur një garanci që mbulon një operacion të vetëm (garanci individuale) është dhënë në formën e kuponit (*voucher*), ajo mund të paraqitet duke përdorur mjete të ndryshme nga teknikat elektronike të përpunimit të të dhënave.

Neni 185
Format e garancisë të ndryshme nga depozita në të holla (cash) ose të një dorëzanie të dhënë nga një dorëzanës
(Shkronja "c", e pikës 1, të nenit 87, të Kodit)

1. Format e garancisë, të ndryshme nga depozita në të holla ose dorëzania e dhënë nga një dorëzanës, do të jenë:

a) Krijimi i një garancie hipotekore, një pagese për tokën, një kontratë shlyerjeje apo të drejte tjetër që konsiderohet e barabartë me të drejtën mbi pronën e paluajtshme;

b) Dhënia e kredive, vendosja e një pengu, me ose pa dorëzimin e posedimit të mallrave, titujve ose kredive mbi një llogari kursimi bankare apo një hyrje në regjistrin e borxhit kombëtar;

c) Marrja e përgjegjësisë së përbashkët kontraktore për shumën e plotë të borxhit nga një palë e tretë, e miratuar për këtë qëllim nga autoritetet doganore ose depozitimi i një kambiali, pagesa e të cilit garantohet nga kjo palë e tretë;

ç) Një depozitë në të holla ose mjetet e pagesës të barasvlershme me to, të ndryshme nga leku;

d) Pjesëmarrja, me pagesën e një kontributi, në një skemë garancie të përgjithshme, të administruar nga autoritetet doganore.

2. Format e garancisë, të referuara në pikën 1, nuk pranohen për vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit.

3. Autoritetet doganore kompetente pranojnë format e garancisë të përmendura në pikën 1, për aq sa këto forma garancie zbatohen sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 186
Garancia individuale e siguruar në formën e një dorëzanie
(Nenet 84 dhe 87, shkronja "b", pika 1, të Kodit)

1. Kur një garanci individuale është dhënë në formën e një dorëzanie nga një dorëzanës, dokumenti i dorëzanisë do të mbahet nga zyra doganore e garancisë për periudhën e vlefshmërisë së saj.

2. Kur një garanci individuale është dhënë në formën e një dorëzanie nga një dorëzanës, mbajtësi i regjimit nuk duhet të ndryshojë kodin e aksesit që lidhet me numrin e referencës së garancisë.

Neni 187
Asistenca e ndërsjellë ndërmjet autoriteteve doganore
(Shkronja "c", e pikës 1, të nenit 87, të Kodit)

Kur lind një borxh doganor në një zyrë doganore të ndryshme nga zyra doganore që ka pranuar një garanci në një nga format e përmendura në pikën 1, të nenit 185, dhe që mund të përdoret në më shumë se një zyrë doganore, zyra doganore që ka pranuar garancinë, pas skadimit të afatit për pagesë, me një kërkesë të bërë nga zyra doganore ku ka lindur borxhi, do t'i transferojë kësaj të fundit shumën e detyrimit të importit ose të eksportit të papaguara, brenda kufijve të garancisë së pranuar.

Transferimi do të bëhet brenda 1 muaji, nga data e pranimit të kërkesës.

Neni 188
Numri i referencës së garancisë dhe kodi i aksesit
(Pika 2, e nenit 84, të Kodit)

1. Kur përdoret një garanci individuale në më shumë se një zyrë doganore, zyra doganore e garancisë do t'i komunikojë personit që ka siguruar garancinë, ose në rastin e një garancie në formën e kuponit (*voucher*) garantuesit, të dhënat e mëposhtme:

a) Një numër reference garancie;

b) Një kod aksesi, që lidhet me numrin e referencës së garancisë.

2. Kur përdoret një garanci globale në më shumë se një zyrë doganore, zyra doganore e garancisë do t'i komunikojë personit që ka siguruar garancinë, të dhënat e mëposhtme:

a) Një numër reference të garancisë për secilën pjesë të shumës referencë që do të monitorohet në përputhje me nenin 192;

b) Një kod aksesi që lidhet me numrin e referencës së garancisë.

Me kërkesë të personit që ka siguruar garancinë, zyra doganore e garancisë do të caktojë një ose më shumë kode aksesi shtesë mbi këtë garanci për t'u përdorur nga ai person ose përfaqësuesit e tij.

3. Autoriteti doganor do të verifikojë ekzistencën dhe vlefshmërinë e garancisë, çdo herë që një person i komunikon një numër reference garancie.

Neni 189
Rastet kur nuk kërkohet garanci
(Shkronja "b", e pikës 8, të nenit 84 dhe pikat 3, 4, të nenit 192 të Kodit)

1. Vendosja e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm nuk i nënshtrohet depozitimi/dhënies së një garancie në këto raste:

a) Kur deklarata doganore mund të bëhet me gojë ose me ndonjë akt tjetër të përmendur në nenin 311;

b) Në rastet e materialeve të përdorura në trafikun ndërkombëtar, nëpërmjet kompanive ajrore, detare ose hekurudhore apo ofruesve të shërbimeve postare, me kusht që këto materiale të jenë shënjuar në mënyrë që të identifikohen;

c) Në rastin e ambalazheve/paketimeve të importuara bosh, me kusht që këto të jenë shënjuar në mënyrë që nuk mund të fshihet ose hiqet;

ç) Kur mbajtësi i mëparshëm i autorizimit për lejimin e përkohshëm ka deklaruar mallrat për regjimin e lejimit të përkohshëm, në përputhje me nenin 305 ose nenin 309, dhe këto mallra janë vendosur, më pas, në regjimin e lejimit të përkohshëm për të njëjtin qëllim.

2. Kur sigurohet mbikëqyrja dhe funksionimi i duhur i regjimeve të përdorimit të veçantë dhe të përpunimit, autoritetet doganore mund të mos kërkojnë depozitimin e një garancie.

Seksioni 2
Garancia globale dhe përjashtimi nga depozitimi i garancisë

Neni 190
Shuma referencë
(Neni 85 i Kodit)

1. Pa rënë ndesh me nenin 193, shuma e garancisë globale do të jetë e njëjtë me shumën referencë, të përcaktuar nga zyra doganore e garancisë, në përputhje me nenin 85, të Kodit.

2. Kur një garanci globale duhet të sigurojë shumën e detyrimit të importit ose të eksportit dhe pagesave të tjera, shuma e të cilave mund të përcaktohet me saktësi në kohën kur kërkohet garancia, pjesa e shumës referencë që mbulon këtë detyrim dhe pagesat e tjera, duhet t'i korrespondojë shumës së detyrimit të importit, eksportit dhe pagesave të tjera për t'u paguar.

3. Kur një garanci globale duhet të sigurojë shumën e detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesave të tjera, shuma e të cilave nuk mund të përcaktohet me saktësi në kohën kur kërkohet garancia, ose që ndryshon me kalimin e kohës, pjesa e shumës referencë që mbulon këtë detyrim dhe pagesat e tjera përcaktohen, si vijon:

a) Për pjesën që mbulon shumën e detyrimit të importit ose të eksportit dhe pagesat e tjera që kanë lindur, shuma referencë duhet t'i korrespondojë shumës së detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesave të tjera të pagueshme;

b) Për pjesën që mbulon shumën e detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesat e tjera që mund të lindin, shuma referencë duhet t'i korrespondojë shumës së detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesave të tjera, të cilat mund të bëhen të pagueshme në lidhje me çdo deklaratë doganore

ose deklaratë të magazinimit të përkohshëm, për të cilat është siguruar garancia, në periudhën midis vendosjes së mallrave nën regjimin doganor përkatës ose magazinimit të përkohshëm dhe momentit kur ky regjim mbyllet ose mbikëqyrja e mallrave nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) ose nën magazinim të përkohshëm ka përfunduar.

Për qëllimet e shkronjës "b", duhet të merren në konsideratë nivelet më të larta të taksimit të detyrimit të importit ose të eksportit, të zbatueshme për mallra të të njëjtit lloj dhe nga nivelet më të larta të pagesave të tjera në lidhje me importin apo eksportin e mallrave të të njëjtit lloj në Republikën e Shqipërisë.

Kur informacioni i nevojshëm për të përcaktuar pjesën që i takon shumës reference, nuk është në dispozicion të zyrës doganore të garancisë, kjo shumë do të fiksohet në vlerën ekuivalente në lekë të 7 000 eurove për çdo deklaratë.

4. Zyra doganore e garancisë përcakton shumën referencë në bashkëpunim me personin të cilit i është kërkuar të sigurojë garancinë. Kur përcaktohet pjesa e shumës referencë, në përputhje me pikën 3, zyra doganore e garancisë do ta vendosë atë shumë në bazë të informacionit për mallrat e vendosura nën regjimet doganore përkatëse ose magazinim të përkohshëm në 12 muajt e mëparshëm dhe sipas një vlerësimi të volumit të operacioneve të synuara siç tregohet, ndër të tjera, përmes dokumentacionit tregtar dhe llogarive të personit, të cilit i është kërkuar të depozitojë garancinë.

5. Zyra doganore e garancisë rishikon shumën referencë me iniciativën e saj ose me kërkesë të personit, të cilit i është kërkuar të sigurojë garancinë dhe e përshtat atë në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe të nenit 85, të Kodit.

Neni 191
Monitorimi i shumës referencë nga personi që i kërkohet të depozitojë garanci
(Neni 84 i Kodit)

Personi, të cilit i kërkohet të depozitojë një garanci, duhet të sigurojë që shuma e detyrimit të importit ose eksportit dhe e pagesave të tjera në lidhje me importin ose eksportin e mallrave, kur ato duhet të mbulohen nga garancia, shumë e cila është e pagueshme ose mund të bëhet e pagueshme, nuk duhet të tejkalojë shumën referencë.

Ky person informon zyrën doganore të garancisë kur shuma referencë nuk është në një nivel të mjaftueshëm për të mbuluar operacionet e tij.

Neni 192
Monitorimi i shumës referencë nga autoritetet doganore
(Pika 6, e nenit 84, të Kodit)

1. Monitorimi i pjesës së shumës referencë që mbulon shumën e detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesave të tjera në lidhje me importin ose eksportin e mallrave, shumë e cila do të bëhet e pagueshme në lidhje me mallrat e çliruara për qarkullim të lirë duhet të sigurohet për çdo deklaratë doganore në kohën e vendosjes së mallrave nën regjim. Kur deklaratat doganore për çlirim për qarkullim të lirë janë depozituar në përputhje me një autorizim të referuar në nenin 152, pika 2, ose nenin 165, të Kodit, monitorimi i pjesës përkatëse të shumës referencë duhet të sigurohet në bazë të deklaratave shtesë ose kur është e zbatueshme në bazë të të dhënave në regjistrimet e deklaruesit.

2. Monitorimi i pjesës së shumës referencë që mbulon shumën e detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesave të tjera në lidhje me importin ose eksportin e mallrave, shumë e cila mund të bëhet e pagueshme për mallrat e vendosura nën regjimin e transitit, duhet të sigurohet me anë të sistemit elektronik të referuar në pikën 1, të nenit 569, për çdo deklaratë doganore në kohën e vendosjes së mallrave nën regjim. Monitorimi nuk zbatohet për mallrat e vendosura nën regjimin e transitit duke përdorur thjeshtimin e referuar në shkronjën "d", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, kur deklarata doganore nuk është përpunuar nga sistemi elektronik siç referohet në pikën 1, të nenit 569.

3. Monitorimi i pjesës së shumës referencë që mbulon shumën e detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesave të tjera në lidhje me importin ose eksportin e mallrave, kur ato duhen mbuluar me garanci, shumë e cila do të lind ose mund të lind në raste të tjera nga ato të përmendura në pikat 1, dhe 2, duhet të sigurohet

përmes një auditimi të përshtatshëm dhe të vazhdueshëm.

Neni 193
Niveli i garancisë globale
(Pikat 2 dhe 3, të nenit 90, të Kodit)

1. Për qëllim të pikës 2, të nenit 90, të Kodit, shuma e garancisë globale reduktohet në:

a) 50% të pjesës të shumës referencë të përcaktuar në përputhje me pikën 3, të nenit 190, kur janë përmbushur kushtet e pikës 1, të nenit 194;

b) 30% të pjesës së shumës referencë të përcaktuar në përputhje me pikën 3, të nenit 190, kur janë përmbushur kushtet e pikës 2, të nenit 194; ose

c) 0% të pjesës së shumës referencë të përcaktuar në përputhje me pikën 3, të nenit 190, kur janë përmbushur kushtet e pikës 3, të nenit 194.

2. Për qëllimet e pikës 3, të nenit 90, të Kodit, shuma e garancisë globale do të reduktohet në 30% të pjesës së shumës referencë të përcaktuar në përputhje me pikën 2, të nenit 190.

Neni 194
Reduktimi i shumës të garancisë globale dhe përjashtimi nga depozitimi i garancisë
(Pika 2, e nenit 90, të Kodit)

1. Autorizimi për të përdorur një garanci globale me një shumë të reduktuar në 50% të shumës referencë jepet kur aplikuesi dëshmon se plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Ka një sistem kontabiliteti në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuara të kontabilitetit të zbatuara në Republikën e Shqipërisë ku mban llogaritë e tij, që lejon kontrollin doganor bazuar në audit dhe mban një protokoll të të dhënave që ofrojnë gjurmë të auditimit nga momenti që të dhënat hyjnë në dosje;

b) Ka një organizim administrativ që i korrespondon llojit dhe madhësisë së biznesit dhe që është i përshtatshëm për menaxhimin e fluksit të mallrave dhe ka një sistem kontrolli të brendshëm të aftë për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve dhe parandalimin e zbulimin e transaksioneve të paligjshme ose të parregullta;

c) Nuk është në procedurë falimentimi;

ç) Gjatë tri viteve të fundit, përpara paraqitjes së aplikimit, aplikuesi ka përmbushur detyrimet e tij financiare për pagesën e detyrimit doganor dhe të gjitha detyrimet e tjera, taksat apo detyrimet, lidhur me importin ose eksportin e mallrave;

d) Bazuar në të dhënat dhe informacionet në dispozicion për tri vitet e fundit para dorëzimit të aplikimit, vërteton që ka një gjendje financiare të mirë, të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet e tij duke pasur parasysh llojin dhe volumin e aktivitetit ekonomik të biznesit, veçanërisht që nuk ka asete negative neto, përveç rasteve kur këto mund të mbulohen;

dh) Mund të vërtetojë që ka burime financiare të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e tij, për sa i përket shumës referencë që nuk mbulohet nga garancia.

2. Autorizimi për të përdorur një garanci globale me një shumë të reduktuar në 30% të shumës referencë jepet kur aplikuesi dëshmon se plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Ka një sistem kontabiliteti në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuara të kontabilitetit të zbatuara në Republikën e Shqipërisë ku mban llogaritë e tij që lejon kontrollin doganor bazuar në audit dhe mban një protokoll të të dhënave që ofrojnë gjurmë të auditimit nga momenti që të dhënat hyjnë në dosje;

b) Ka një organizim administrativ që i korrespondon llojit dhe madhësisë së biznesit dhe që është i përshtatshëm për menaxhimin e fluksit të mallrave, dhe ka një sistem kontrolli të brendshëm, të aftë për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve dhe parandalimin e zbulimin e transaksioneve të paligjshme ose të parregullta;

c) Siguron që punonjësit përkatës të jenë udhëzuar të informojnë autoritetet doganore sa herë që hasin vështirësi pajtueshmërie dhe ka procedura të caktuara për informimin e autoriteteve doganore për vështirësi të tilla;

ç) Nuk është në procedurë falimentimi;

d) Gjatë tri viteve të fundit përpara paraqitjes së aplikimit, aplikuesi ka përmbushur detyrimet e tij financiare për pagesën e detyrimit doganor dhe të gjitha detyrimet e tjera, taksat apo detyrimet, lidhur me importin ose eksportin e mallrave;

dh) Bazuar në të dhënat dhe informacionet në dispozicion për tri vitet e fundit para dorëzimit të aplikimit, vërteton që ka një gjendje financiare të mirë, të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet e tij duke pasur parasysh llojin dhe volumin e aktivitetit ekonomik të biznesit,

veçanërisht që nuk ka asete negative neto, përveç rasteve kur këto mund të mbulohen;

e) Mund të vërtetojë që ka burime financiare të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e tij, për sa i përket shumës referencë që nuk mbulohet nga garancia.

3. Përjashtimi nga depozitimi i garancisë jepet kur aplikuesi plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Ka një sistem kontabiliteti në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuara të kontabilitetit të zbatuara në Republikën e Shqipërisë ku mban llogaritë e tij, që lejon kontrollin doganor bazuar në audit dhe mban një protokoll të të dhënave që ofrojnë gjurmë të auditimit nga momenti që të dhënat hyjnë në dosje;

b) I lejon autoritetit doganor të ketë akses fizik në sistemet e tij kontabël dhe, kur mund të jetë e zbatueshme, në regjistrimet e tij tregtare e të transportit;

c) Ka një sistem logjistik që identifikon mallrat si mallra shqiptare ose joshqiptare dhe tregon, kur është e përshtatshme, vendndodhjen e tyre;

ç) Ka një organizim administrativ që i korrespondon llojit dhe madhësisë së biznesit dhe që është i përshtatshëm për menaxhimin e fluksit të mallrave, dhe ka një sistem kontrolli të brendshëm, të aftë për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve dhe parandalimin e zbulimin e të transaksioneve të paligjshme ose të parregullta;

d) Kur është e zbatueshme, ka procedura të pranueshme për trajtimin e licencave dhe autorizimeve të lëshuara në përputhje me masat e politikës tregtare ose në lidhje me tregtinë e produkteve bujqësore;

dh) Ka procedura të pranueshme për arkivimin e të dhënave dhe informacioneve të tij dhe për mbrojtjen kundër humbjes së tyre;

e) Siguron që punonjësit përkatës të jenë udhëzuar të informojnë autoritetet doganore sa herë që hasin vështirësi pajtueshmërie dhe ka procedura të caktuara për informimin e autoriteteve doganore për vështirësi të tilla;

ë) Ka masa sigurie të përshtatshme për të mbrojtur sistemin e tij kompjuterik nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe për të siguruar dokumentacionin e aplikuesit;

f) Nuk është në procedurë falimentimi;

g) Gjatë tri viteve të fundit përpara paraqitjes së aplikimit, aplikuesi ka përmbushur detyrimet e tij financiare për pagesën e detyrimit doganor dhe të gjitha detyrimet e tjera, taksat apo detyrimit, lidhur me importin ose eksportin e mallrave;

gj) Bazuar në të dhënat dhe informacionet në dispozicion për tri vitet e fundit para dorëzimit të aplikimit, vërteton që ka një gjendje financiare të mirë, të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet e tij duke pasur parasysh llojin dhe volumin e aktivitetit ekonomik të biznesit, veçanërisht që nuk ka asete negative neto, përveç rasteve kur këto mund të mbulohen;

h) Mund të vërtetojë që ka burime financiare të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e tij, për sa i përket shumës referencë që nuk mbulohet nga garancia.

4. Kur aplikuesi është themeluar për më pak se 3 vjet, kushti i përcaktuar në pikat 1, shkronja "ç", 2, shkronja "d", dhe 3, shkronja "g", verifikohet në bazë të të dhënave dhe informacioneve në dispozicion.

Seksioni 3
Dispozitat për regjimin e transitit sipas Konventës së Stambollit/Konventës ATA dhe Konventës TIR

Neni 195
Llogaritja për qëllimet e transitit të përbashkët
(Pika 2, e nenit 84, të Kodit)

Për qëllime të llogaritjes së përmendur në nenin 180, dhe në paragrafin e dytë të shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 190, mallrat shqiptare të transportuara në përputhje me Konventën e Transitit të Përbashkët do të trajtohen si mallra joshqiptare.

Neni 196
Garancia individuale në formën e kuponit (*voucher*)
(Shkronja "b", e pikës 1, e nenit 87, të Kodit)

1. Në kuadër të regjimit të transitit, një garanci individuale në formën e një dorëzanie nga një dorëzanës mund të sigurohet, gjithashtu, nga një garantues përmes lëshimit të një garancie në formën e kuponit personave që duan të jenë mbajtës të regjimit.

Provë e kësaj dorëzanie do të jetë përdorimi i formularit të paraqitur në aneksin 32-02, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe kuponët do të jenë sipas formularit të

përcaktuar në aneksin 32-06, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Çdo kupon mbulon shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) eurosh, ose ekuivalentin në lekë të kësaj shume, për të cilën garantuesi është përgjegjës.

Periudha e vlefshmërisë së një kuponi është 1 vit, nga data e lëshimit.

2. Garantuesi duhet t'i sigurojë zyrës doganore të garancisë çdo detaj të kërkuar në lidhje me kuponët e garancisë individuale që ai ka lëshuar.

3. Për çdo kupon, garantuesi i komunikon personit që do të jetë mbajtës i regjimit të dhënat e mëposhtme:

a) Një numër reference garancie;

b) Një kod aksesi të lidhur me numrin e referencës së garancisë.

Personi që do të jetë mbajtës i regjimit nuk duhet ta ndryshojë kodin e aksesit.

4. Personi që do të jetë mbajtës i regjimit duhet të paraqesë në zyrën doganore të nisjes një numër kuponash që i korrespondojnë shumëfishit të 10 000 (dhjetë mijë) eurove, ose shumës ekuivalente në lekë, të kërkuar për mbulimin e shumës totale referuar nenit 180.

Neni 197
Revokimi dhe anulimi e një dorëzanie të siguruar në rastin e garancisë individuale në formën e kuponit
(Nenet 87, shkronja "b", pika 1 dhe 89, të Kodit)

Autoriteti doganor përgjegjës për zyrën doganore të garancisë do të shënojë në sistemin elektronik të referuar në pikën 1, të nenit 569, informacionet e çdo revokimi ose anulimi të dorëzanisë, në rastin e një garancie individuale në formën e kuponit dhe datën kur revokimi ose anulimi hyn në fuqi.

Neni 198
Garancia globale
(Nenet 84, pika 5 dhe 90, të Kodit)

1. Në kuadër të regjimit të transitit, garancia globale mund të jepet vetëm në formën e një dorëzanie nga një dorëzanës.

2. Prova e kësaj dorëzanie do të mbahet nga zyra doganore e garancisë për periudhën e vlefshmërisë së saj. Si zyrë garancie në këtë formë të garancisë do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Mbajtësi i regjimit nuk duhet ta ndryshojë kodin e aksesit, të lidhur me numrin e referencës së garancisë.

Neni 199
Përgjegjësia e shoqatave të garancive për operacionet TIR
(Shkronja "b", e pikës 3, të nenit 203, të Kodit)

Për qëllimet e pikës 4, të nenit 8, të Konventës TIR, përfshirë çdo ndryshim të saj të mëvonshëm, kur një operacion TIR kryhet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, shoqata garantuese e vendosur në këtë territor mund të bëhet përgjegjëse për pagesën e shumës së garantuar, në lidhje me mallrat e përfshira në operacionin TIR deri në një limit për Carnet TIR, prej 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) eurosh ose shumën ekuivalente të saj në lekë.

Neni 200
Çlirimi i garantuesit nga detyrimet nën regjimin e transitit
(Nenet 17, pikat 2 e 3, shkronja "a" dhe 93, të Kodit)

1. Kur regjimi i transitit nuk është mbyllur, zyra doganore e nisjes duhet që, brenda nëntë muajve, nga afati kohor i caktuar për paraqitjen e mallrave në zyrën doganore të destinacionit, të njoftojë garantuesin se regjimi nuk është mbyllur.

2. Kur regjimi i transitit nuk është mbyllur, autoritetet doganore, të përcaktuara në përputhje me nenin 82 të Kodit, brenda 3 vjetëve, nga data e pranimit të deklaratës së transitit, duhet të njoftojnë garantuesin të paguajë borxhin për të cilin është përgjegjës në lidhje me operacionin përkatës të transitit.

3. Garantuesi çlirohet nga detyrimet e tij në qoftë se cilido prej njoftimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 nuk është kryer para përfundimit të afatit kohor.

4. Kur cilido prej njoftimeve është kryer, garantuesi informohet për mbylljen e regjimit ose mbledhjen e borxhit.

5. Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për njoftimin sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen në aneksin 32-04, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për njoftimin sipas pikës 2 përcaktohen në aneksin 32-05, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Në përputhje me shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 17, të Kodit, njoftimi sipas pikave 1 dhe 2 mund të dërgohet me mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 201
Kërkesa për pagesë drejtuar një shoqate garantuese për mallrat e mbuluara nga Carnet ATA dhe njoftimi i mosmbylljes së Carnet CPD për një shoqatë garantuese sipas regjimit të Konventës ATA ose Konventës së Stambollit
(Nenet 17, pika 2, 17, pika 3, shkronja "a", dhe 93, të Kodit)

1. Në rast të mospërmbushjes së një prej detyrimeve sipas Carnet ATA ose Carnet CPD, autoritetet doganore rregullojnë dokumentet lidhur me lejimin e përkohshëm (kërkesën për pagesë drejtuar shoqatës garantuese ose njoftimin e mosmbylljes) në përputhje me nenet 9, 10 dhe 11 të aneksit A, të Konventës së Stambollit apo, kur është e zbatueshme, në përputhje me nenet 7, 8 dhe 9 të Konventës ATA.

2. Shuma e detyrimit të importit dhe taksat që rrjedhin nga kërkesa për pagesë drejtuar një shoqate garantuese duhet të llogaritet sipas formularit model të detyrimeve.

3. Kërkesat e përbashkëta për të dhënat për kërkesën për pagesë drejtuar një shoqate garantuese, të përmendur në pikën 1, përcaktohen në aneksin 33-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Kërkesat e përbashkëta për të dhënat për njoftimin e mosmbylljes të Carnet CPD, të përmendura në pikën 1, përcaktohen në aneksin 33-02, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Në përputhje me shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 17, të Kodit, kërkesa për pagesën drejtuar një shoqate garantuese dhe njoftimi i mosmbylljes së Carnet CPD mund mund t'u dërgohen shoqatave përkatëse garantuese me mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

KREU 3
Vjelja, pagesa, rimbursimi dhe falja e shumës së detyrimit të importit ose eksportit

Seksioni 1
Përcaktimi i shumës së detyrimit të importit ose eksportit, njoftimi i borxhit doganor dhe kontabilizimi

Nënseksioni 1
Njoftimi i borxhit doganor, pezullimi i afatit për pagesë dhe kërkesa për pagesë drejtuar shoqatës garantuese

Neni 202
Mjetet e njoftimit të borxhit doganor
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Njoftimi i borxhit doganor në përputhje me nenin 96, të Kodit, mund të bëhet në mënyra të tjera përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 203
Ndihma e ndërsjellë mes autoriteteve doganore
(Nenet 95, pika 1 dhe 96, pika 1, të Kodit)

1. Kur lind një borxh doganor, zyra doganore kompetente për vjeljen e shumës së detyrimit të importit ose të eksportit, që i korrespondon borxhit doganor, duhet të informojë zyrat e tjera doganore dhe DPD-në për:

a) faktin që një borxh doganor ka lindur;

b) veprimin e ndërmarrë ndaj debitorit për të vjelë shumat në fjalë.

2. Autoritetet doganore, në bashkëpunim, do të ndihmojnë njëra-tjetrën në vjeljen e shumës së detyrimit të importit ose të eksportit që i korrespondon borxhit doganor.

Neni 204
Përjashtimi nga njoftimi i borxhit doganor
(Shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 96, të Kodit)

1. Autoritetet doganore mund të mos njoftojnë një borxh doganor që lind përmes mospërmbushjes sipas neneve 74 ose 77 të Kodit, kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit në fjalë është më pak se 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë.

2. Kur borxhi doganor është njoftuar fillimisht për një shumë detyrimi importi ose eksporti, që ishte më e vogël se shuma e detyrimit të importit

ose eksportit për t'u paguar, autoritetet doganore mund të mos bëjnë njoftimin e borxhit doganor për diferencën mes këtyre shumave, me kusht që ajo të jetë më pak se 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë.

3. Kufizimi 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë, i referuar në pikat 1 dhe 2, vihet në zbatim për çdo veprim vjeljeje/rikuperimi.

Neni 205
Pezullimi i afatit kohor për pagesë në rast kërkese për falje
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 101, të Kodit)

1. Autoritetet doganore pezullojnë afatin për pagesën e shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor deri sa të marrin një vendim për aplikimin për falje, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Kur është paraqitur një aplikim për falje në përputhje me nenet 111, 112 ose 113, të Kodit, nëse kushtet e parashikuara në nenin përkatës plotësohen;

b) Kur është paraqitur një aplikim për falje në përputhje me nenin 110 të Kodit, nëse kushtet e parashikuara në nenin 110 dhe nenin 46, pika 2, të Kodit, plotësohen.

2. Kur mallrat që i nënshtrohen aplikimit për falje nuk janë më nën mbikëqyrjen doganore në kohën e aplikimit, duhet të depozitohet një garanci.

3. Duke anashkaluar pikën 2, autoritetet doganore nuk kërkojnë garanci, nëse vërtetohet se sigurimi i garancisë mund t'i shkaktojë debitorit vështirësi serioze ekonomike ose sociale.

Neni 206
Pezullimi i afatit për pagesë në rastin e mallrave që konfiskohen, shkatërrohen ose braktisen në favor të shtetit
(Shkronja "b", e pikës 3, të nenit 101, të Kodit)

Autoritetet doganore pezullojnë afatin e pagesës së shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor kur mallrat janë ende nën mbikëqyrjen doganore dhe duhet të konfiskohen, të shkatërrohen ose të braktisen në favor të shtetit dhe autoritetet doganore gjykojnë nëse kushtet për konfiskim, shkatërrim ose braktisje janë plotësuar, deri sa të merret vendimi përfundimtar për konfiskimin, shkatërrimin ose braktisjen e tyre.

Neni 207
Pezullimi i afatit për pagesë në rastin e borxhit doganor të lindur përmes mospërmbushjes
(Shkronja "c", e pikës 3, të nenit 101, të Kodit)

1. Autoritetet doganore pezullojnë afatin e pagesës së shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor të personit të përmendur në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 74, të Kodit, kur borxhi doganor ka lindur përmes mospërmbushjes, siç referohet në nenin 74 të Kodit, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Është identifikuar të paktën një debitor tjetër, në përputhje me shkronjat "b" dhe "c", të pikës 3, të nenit 74, të Kodit;

b) Shuma e detyrimit të importit ose eksportit në fjalë i është komunikuar debitorit të përmendur në shkronjën "a", në përputhje me nenin 96 të Kodit;

c) Personi i përmendur në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 74, të Kodit, nuk konsiderohet si një debitor në përputhje me shkronjat "b" dhe "c", të pikës 3, të nenit 74, të Kodit, dhe këtij personi nuk i adresohet asnjë mashtrim ose neglizhencë.

2. Pezullimi kushtëzohet me depozitimin e një garancie nga personi përfitues i pezullimit për shumën e detyrimit të importit ose të eksportit në fjalë, përveç në ndonjë prej rasteve të mëposhtme:

a) Kur ekziston, tashmë, një garanci që mbulon të gjithë shumën e detyrimit të importit ose eksportit dhe garantuesi nuk është çliruar nga detyrimet e tij;

b) Është vendosur, në bazë të një vlerësimi të dokumentuar, se kërkesa e një garancie mund t'i shkaktojë debitorit vështirësi serioze ekonomike ose sociale.

3. Kohëzgjatja e pezullimit është e kufizuar në një vit. Megjithatë, kjo periudhë mund të zgjatet nga autoritetet doganore për arsye të justifikuara.

Neni 208
Zyra doganore e koordinimit në lidhje me Carnet ATA ose Carnet CPD
(Shkronja "c", e pikës 3, të nenit 203, të Kodit)

DPD është përgjegjëse për koordinimin e veprimeve në lidhje me borxhin doganor që ka lindur nga mospërmbushja e detyrimeve ose kushteve që lidhen me Carnet ATA ose Carnet CPD, në bazë të nenit 74, të Kodit.

Neni 209
Mbulimi i detyrimeve të tjera nën regjimin e transitit dhe transitit në përputhje me Konventën TIR
(Shkronjat "a", dhe "b", të pikës 3, të nenit 203, të Kodit)

1. Kur zyra doganore, që konstaton borxhin doganor dhe detyrimin për të paguar detyrimet e tjera në lidhje me importin apo eksportin e mallrave të vendosura nën regjimin e transitit ose nën regjimin e transitit në përputhje me Konventën TIR, merr prova në lidhje me vendin se ku kanë ndodhur ngjarjet që kanë sjellë për pasojë lindjen e borxhit doganor dhe detyrimin për të paguar detyrimet e tjera, pezullon procedurën e vjeljes dhe dërgon, menjëherë, të gjitha dokumentet e nevojshme, duke përfshirë një kopje autentike të provave, zyrës doganore përgjegjëse në atë vend. Zyra dërguese, në të njëjtën kohë kërkon konfirmimin e zyrës marrëse për vjeljen e detyrimeve.

2. Zyra doganore marrëse, pas konfirmimit të marrjes së komunikimit, informon nëse ajo është kompetente për vjeljen e detyrimeve të tjera. Nëse nuk është marrë asnjë përgjigje brenda 10 ditësh, zyra doganore dërguese, menjëherë, do të rifillojë procedurën e vjeljes që iniciuan.

Neni 210
Njoftimi i vjeljes së detyrimeve dhe pagesave të tjera nën regjimin e transitit dhe transitit në përputhje me Konventën TIR
(Shkronjat "a", dhe "b", të pikës 3, të nenit 226, të Kodit)

Kur lind një borxh doganor në lidhje me mallrat e vendosura nën regjimin e transitit ose nën regjimin e transitit, në përputhje me Konventën TIR, autoriteti doganor kompetent për vjeljen e borxhit informon zyrën doganore të nisjes për vjeljen e detyrimeve dhe pagesave të tjera.

Neni 211
Kërkesa për pagesë nga shoqata garantuese sipas procedurës të Konventës ATA dhe Konventës së Stambollit
(Neni 93 i Kodit)

1. Kur autoritetet doganore konstatojnë se borxhi doganor ka lindur për mallrat e mbuluara nga një Carnet ATA, ato, pa vonesë, duhet të bëjnë një kërkesë ndaj shoqatës garantuese. DPD-ja bën kërkesën e përmendur në nenin 201, duke njoftuar zyrën doganore të vendosjes nën regjimin e lejimit të përkohshëm, mbi kërkesën për pagesën dërguar shoqërisë garantuese.

2. Formulari i detyrimeve, siç përmendet në nenin 201, mund të dërgohet pas kërkesës për pagesë që i dërgohet shoqatës garantuese, por jo më vonë se 3 muaj nga kërkesa dhe, në çdo rast, jo më vonë se 6 muaj nga data në të cilën autoritetet doganore fillojnë procedurën e vjeljes. Formulari i detyrimeve është përcaktuar në aneksin 33-04, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Seksioni 2
Rimbursimi dhe falja

Nënseksioni 1
Dispozita të përgjithshme dhe procedura

Neni 212
Aplikimi për rimbursim ose falje
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, pika 1, e nenit 27, dhe neni 97, të Kodit)

1. Aplikimi për rimbursim ose falje dorëzohet nga personi që ka paguar ose është i detyruar të paguajë shumën e detyrimit të importit ose të eksportit, ose nga çdo person të cilit i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e tij.

2. Duke anashkaluar paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 27, të Kodit, aplikimi për rimbursim ose falje të detyrimeve të importit ose eksportit të përmendura në nenin 109 të Kodit, dorëzohet në zyrën doganore kompetente që ka njoftuar borxhin doganor.

3. Aplikimi i përmendur në pikën 2, mund të bëhet me mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 213
Paraqitja e mallrave si kusht për rimbursim ose falje
(Pika 1, e nenit 109, të Kodit)

Rimbursimi ose falja do t'i nënshtrohen paraqitjes së mallrave. Kur mallrat nuk mund të paraqiten pranë autoriteteve doganore, atëherë, zyra doganore kompetente për marrjen e vendimit jep rimbursimin ose faljen vetëm kur ka prova që tregojnë se mallrat në fjalë janë ato për të cilat është kërkuar rimbursimi ose falja.

Neni 214
Kufizimi në transferimin e mallrave
(Pika 1, e nenit 109, të Kodit)

Pa rënë ndesh me pikën 4, të nenit 226, dhe derisa të jetë marrë vendimi lidhur me një aplikim për rimbursim ose falje, mallrat për të cilat është kërkuar rimbursimi ose falja nuk do të transferohen në një vend të ndryshëm nga ai i specifikuar në aplikim, përveçse kur aplikanti njofton paraprakisht zyrën doganore kompetente për marrjen e vendimit për rimbursim ose falje.

Neni 215
Informacioni shtesë që kërkohet kur mallrat janë vendosur në një zyrë tjetër doganore
(Pika 2, dhe shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Kërkesat e përbashkëta për të dhënat për informacion shtesë, kur mallrat janë vendosur në një zyrë tjetër doganore, përcaktohen në aneksin 33-06, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Kërkesa për informacion shtesë, e përmendur në paragrafin e parë, mund të bëhet me mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 216
Mjetet e njoftimit të vendimit për rimbursim ose falje
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Vendimi për rimbursim ose falje të detyrimit të importit ose eksportit mund t'i njoftohet personit të interesuar me mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 217
Kërkesat e përbashkëta për të dhënat lidhur me formalitetet kur mallrat janë vendosur në një zyrë tjetër doganore
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

Kërkesat e përbashkëta për të dhënat për përgjigje ndaj kërkesës për informacion në lidhje me përfundimin e formaliteteve, kur kërkesa për shlyerje ose rimbursim lidhet me mallra të cilat janë të vendosura në një zyrë tjetër doganore përveç asaj ku është njoftuar borxhi doganor, përcaktohen në aneksin 33-07, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 218
Mënyra për dërgimin e informacionit në përfundim të formaliteteve kur mallrat janë të vendosura në një zyrë tjetër doganore
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Përgjigjja e përmendur në nenin 217 mund të dërgohet me mënyra të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 219
Ndihma reciproke mes autoriteteve doganore
(Nenet 27 dhe 109, pika 1, të Kodit)

1. Kur, për qëllime të rimbursimit ose faljes duhet të merret informacion shtesë nga një zyrë doganore e ndryshme nga ajo në të cilin borxhi doganor është konstatuar, ose kur mallrat duhet të shqyrtohen nga ai autoritet për të siguruar se kushtet për rimbursim ose falje janë përmbushur, zyra doganore kompetente për marrjen e vendimit do të kërkojë ndihmën e zyrave doganore ku mallrat janë të vendosura, duke specifikuar natyrën e informacionit që do të marrë apo kontrollet që do të kryhen.

2. Zyra doganore ku mallrat janë vendosur duhet të përmbushë kërkesën e përmendur në pikën 1, brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së kërkesës. Kur zyra doganore në të cilën janë vendosur mallrat nuk është në gjendje të marrë informacionin, ose të kryejë kontrollet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar, ajo duhet ta kthejë kërkesën pa veprim, brenda të njëjtit afat.

Nënseksioni 2
Vendimet që merren nga DPD

Neni 220
Transferimi i dosjes në DPD për vendimin
(Pika 3, e nenit 109, të Kodit)

1. Zyra doganore duhet të njoftojë personin e interesuar për transferimin e dosjes në DPD para se kjo të ndodhë dhe për t'i dhënë personit të interesuar një afat 30-ditor për të nënshkruar një deklaratë që vërteton se ai e ka lexuar dosjen dhe nuk ka asgjë për të shtuar ose të listojë/të bashkëlidhë të gjitha informacionet shtesë që ai konsideron se duhet të përfshihen. Kur personi i interesuar nuk e jep këtë deklaratë brenda afatit 30-ditor, konsiderohet se ai e ka lexuar dosjen dhe se nuk ka asgjë për të shtuar.

2. Kur një zyrë doganore transferon në DPD një dosje për vendim, në rastet e referuara në pikën 3, të nenit 109, të Kodit, në dosje duhet të përfshihen:

a) një përmbledhje e rastit;

b) informacion i detajuar, që përcakton se janë plotësuar kushtet e referuara në nenin 112 ose nenin 113, të Kodit;

c) deklarata e përmendur në pikën 1 ose një deklaratë nga zyra doganore, që vërteton se personi i interesuar konsiderohet se ka lexuar dosjen dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

3. DPD i konfirmon zyrës doganore kompetente marrjen e dosjes sapo ta marrë atë në dorëzim.

4. Me kërkesë të zyrave doganore, DPD-ja vë në dispozicion të tyre një kopje të përmbledhjes së rastit, të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur DPD ka marrë dosjen.

5. Në rastet kur informacioni i transmetuar nga zyra doganore nuk mjafton që DPD-ja të marrë një vendim, atëherë DPD-ja mund të kërkojë informacione shtesë nga zyra doganore.

6. DPD-ja i kthen dosjen zyrës doganore dhe çështja konsiderohet sikur nuk i është dorëzuar asnjëherë DPD-së në rastet e mëposhtme:

a) Dosja nuk është e plotë, pasi nuk përmban asgjë që justifikon shqyrtimin e saj nga DPD-ja;

b) Dosja nuk duhej dorëzuar në DPD;

c) Zyra doganore i ka dorëzuar DPD-së informacion të ri, që ndryshon ndjeshëm faktet ose vlerësimin ligjor të rastit, ndërkohë që DPD-ja është ende duke shqyrtuar dosjen.

Neni 221
E drejta e personit të interesuar për t'u dëgjuar
(Pika 3, e nenit 109, të Kodit)

1. Kur DPD-ja duhet të marrë një vendim të pafavorshëm, në rastet e referuara në pikën 3, të nenit 109, të Kodit, ajo duhet t'i komunikojë me shkrim personit të interesuar arsyet, duke iu referuar të gjitha dokumenteve dhe informacioneve në të cilat është bazuar. DPD duhet të informojë personin e interesuar lidhur me të drejtën e tij për të pasur akses në dosje.

2. DPD-ja informon zyrën doganore kompetente për arsyet e marrjes së vendimit të pafavorshëm dhe komunikimin me personin e interesuar, siç përmendet në pikën 1.

3. Personit të interesuar i jepet mundësia t'ia shprehë pretendimet e tij me shkrim DPD-së në një afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga data në të cilën ai ka marrë komunikimin e përmendur në pikën 1.

Neni 222
Afatet kohore
(Pika 3, e nenit 109, të Kodit)

1. DPD-ja vendos nëse justifikohet apo jo rimbursimi a falja brenda 9 (nëntë) muajve, nga data në të cilën ajo ka marrë dosjen e përmendur në pikën 1, të nenit 220.

2. Kur DPD-ja e shikon të nevojshme të kërkojë informacion shtesë nga zyra doganore, siç përcaktohet në pikën 5, të nenit 220, afati i përmendur në pikën 1 zgjatet me të njëjtën periudhë kohore sa është periudha mes datës në të cilën DPD-ja ka dërguar kërkesën për informacion shtesë dhe datës në të cilën ajo e ka marrë këtë informacion. DPD-ja duhet të njoftojë personin e interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Kur DPD-ja zhvillon hetime në mënyrë që të marrë një vendim, periudha e përmendur në pikën 1, zgjatet deri në kohën e nevojshme për të përfunduar hetimet, e cila nuk duhet t'i kalojë nëntë muaj. DPD-ja duhet të njoftojë zyrën doganore dhe personin e interesuar për datën në të cilën kanë filluar dhe përfunduar hetimet.

4. Nëse DPD-së i duhet të marrë një vendim të pafavorshëm, siç përmendet në pikën 1, të nenit 221, periudha e përmendur në pikën 1 zgjatet edhe për 30 (tridhjetë) ditë.

Neni 223
Zgjatja e afatit për marrjen e vendimit për rimbursim ose falje
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

Kur zbatohet pika 3, e nenit 109, të Kodit, afati për marrjen e vendimit për rimbursim ose falje pezullohet deri në kohën kur zyra doganore kompetente të marrë njoftimin e vendimit të DPD-së ose njoftimin për kthimin e dosjes nga ana e DPD-ja për shkaqet e parashikuara në pikën 6, të nenit 220.

Neni 224
Njoftimi i vendimit
(Pika 3, e nenit 109, të Kodit)

1. DPD duhet të njoftojë zyrën doganore kompetente për vendimin e saj, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, në çdo rast, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të periudhës së përcaktuar në pikën 1, të nenit 222.

2. Zyra doganore kompetente merr vendim në bazë të vendimit të DPD-së, të njoftuar në përputhje me pikën 1.

Zyra doganore kompetente informon DPD duke i dërguar edhe një kopje të vendimit në fjalë.

3. Kur vendimi, në rastet e parashikuara me pikën 3, të nenit 109, të Kodit, është i favorshëm për personin e interesuar, atëherë DPD-ja mund të përcaktojë kushtet në të cilat zyra doganore do të kryejë rimbursimin apo faljen prej detyrimeve në raste të ngjashme faktike dhe ligjore.

Neni 225
Pasojat e mosmarrjes së vendimit ose njoftimit
(Pika 3, të nenit 109, të Kodit)

Nëse DPD nuk merr një vendim brenda afatit të parashikuar në nenin 222 ose nuk i komunikon vendimin zyrës doganore kompetente brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 224, zyra doganore kompetente merr një vendim të favorshëm për personin e interesuar.

Neni 226
Plotësimi i formaliteteve doganore
(Pika 1, e nenit 109, të Kodit)

1. Kur rimbursimi ose falja është objekt i plotësimit të formaliteteve doganore, mbajtësi i vendimit për rimbursimin ose faljen informon zyrën doganore të mbikëqyrjes që i ka plotësuar këto formalitete. Kur vendimi specifikon se mallrat mund të eksportohen ose të vendosen nën një regjim të posaçëm dhe debitori ka në dispozicion këtë mundësi, zyra e mbikëqyrjes doganore do të jetë zyra doganore ku mallrat janë vendosur nën këtë regjim.

2. Zyra doganore e mbikëqyrjes njofton autoritetin doganor kompetent vendimmarrës për plotësimin e formaliteteve doganore për të cilat rimbursimi ose falja është objekt, sipas përgjigjes të përmendur në nenin 217, duke përdorur formularin e përcaktuar në aneksin 33-07, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Kur zyra doganore kompetente për marrjen e vendimit ka vendosur që rimbursimi ose falja është e justifikuar, shuma e detyrimeve do të rimbursohet ose falet vetëm pasi autoriteti doganor ka marrë informacionin e përmendur në pikën 2.

4. Zyra doganore kompetente, për marrjen e vendimit mund të autorizojë kryerjen e formaliteteve doganore për të cilat rimbursimi ose falja mund të jenë objekt, para se ai të marrë një vendim. Një autorizim i tillë nuk duhet të paragjykojë atë vendim. Në këto raste, pikat 1 deri në 3 do të zbatohen *mutatis mutandis*.

5. Për qëllime të këtij neni, zyra doganore e mbikëqyrjes është zyra doganore e cila siguron, kur është e përshtatshme, që formalitetet ose kërkesat që kanë objekt rimbursimin ose faljen e shumës së detyrimit të importit dhe eksportit, të jenë plotësuar.

Neni 227
Formalitetet në lidhje me vendimin për rimbursim ose falet
(Pika 2, e nenit 109, të Kodit)

1. Kur merret një vendim për rimbursim ose falje të detyrimeve të importit ose eksportit, objekt i plotësimit paraprak të formaliteteve të caktuara doganore, zyrat doganore do të caktojnë një afat kohor për përfundimin e këtyre formaliteteve

doganore, i cili nuk do të kalojë 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e njoftimit të atij vendimi.

2. Mosrespektimi i afatit të përmendur në pikën 1 sjell humbjen e së drejtës për rimbursim ose falje, përveç rastit kur personi i interesuar provon se ai ishte penguar nga përmbushja e këtij afati për shkak të rrethanave të paparashikuara ose forcës madhore.

Neni 228
Pjesët ose komponentët e një artikulli të vetëm
(Pika 1, e nenit 109, të Kodit)

Kur rimbursimi apo falja është e lidhur me shkatërrimin, braktisjen në favor të shtetit ose vendosjen nën një regjim të posaçëm apo regjim eksporti të mallrave, por formalitetet përkatëse janë plotësuar vetëm për një ose më shumë pjesë apo komponentë të këtyre mallrave, shuma që duhet rimbursuar apo falur, do të jetë sa diferenca mes shumës së detyrimit të importit ose të eksportit të mallrave dhe shumës së detyrimit të importit ose të eksportit që do të kishte qenë e zbatueshme për pjesën e mbetur të mallrave në qoftë se ato do të ishin të vendosur në një gjendje të pandryshuar nën një regjim doganor që sjell lindjen e një borxhi doganor, në datën në të cilën mallrat janë vendosur në atë mënyrë.

Neni 229
Mbetjet dhe hedhurinat
(Pika 1, e nenit 109, të Kodit)

Kur shkatërrimi i mallrave, të autorizuara nga zyra doganore kompetente për marrjen e vendimit, krijon mbeturina apo hedhurina/skrap, këto do të konsiderohen si mallra joshqiptare, sapo të jetë marrë një vendim për dhënien e rimbursimit ose faljen.

Neni 230
Eksporti ose shkatërrimi pa mbikëqyrje doganore
(Pika 1, e nenit 109, të Kodit)

1. Në rastet e mbuluara nga paragrafi i dytë, i pikës 1, të nenit 109, nenet 111 ose 113, të Kodit, kur eksporti ose shkatërrimi ndodh pa mbikëqyrje doganore, rimbursimi apo falja në bazë të nenit 113, të Kodit, do të jetë i kushtëzuar nga sa më poshtë:

a) Aplikanti dorëzon në zyrën doganore kompetente për marrjen e vendimit provat e nevojshme për të përcaktuar nëse mallrat për të cilat kërkohet rimbursimi apo falja përmbushin një nga kushtet e mëposhtme:

i. Mallrat janë eksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

ii. Mallrat janë shkatërruar nën mbikëqyrjen e autoriteteve ose personave të autorizuar nga autoritetet për të vërtetuar një shkatërrim të tillë;

b) Aplikanti kthen në zyrën doganore kompetente për marrjen e vendimit çdo dokument që vërteton ose që përmban informacion që konfirmon statusin doganor të mallrave shqiptare për mallrat në fjalë, mbi bazën e të cilave mallrat në fjalë mund të jenë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose paraqet çfarëdo prove që autoriteti në fjalë e konsideron të nevojshme për të verifikuar se dokumenti nuk mund të përdoret më pas në lidhje me mallrat e sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Provat që mallrat për të cilat kërkohet rimbursimi ose falja janë eksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, përbëhen nga dokumentet e mëposhtme:

a) Vërtetimi i daljes, i përmendur në nenin 705;

b) Origjinali ose kopja e vërtetuar e deklaratës doganore për regjimin që përfshin lindjen e borxhit doganor;

c) Kur është e nevojshme, dokumentet tregtare ose administrative që përmbajnë një përshkrim të plotë të mallrave të cilat janë paraqitur me deklaratën doganore për regjimin në fjalë, ose me deklaratën doganore për eksport nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose me deklaratën doganore të bërë për mallrat në vendin tjetër të destinacionit.

3. Provat që vërtetojnë se mallrat për të cilat kërkohet rimbursimi ose falja janë shkatërruar nën mbikëqyrjen e autoriteteve ose të personave të autorizuar për të vërtetuar zyrtarisht një shkatërrim të tillë, përbëhen nga dokumentet të mëposhtme:

a) Një raport apo deklaratë të shkatërrimit, të hartuar nga autoritetet nën mbikëqyrjen e të cilave u shkatërruan mallrat ose një kopje të vërtetuar të saj;

b) Një certifikatë të hartuar nga personi i autorizuar për të vërtetuar shkatërrimin, shoqëruar nga dokumenti që provon autoritetin e tij.

Këto dokumente duhet të përmbajnë një përshkrim të plotë të mallrave të shkatërruara për të vendosur, me anë të krahasimit me të dhënat e deklaratës doganore për regjimin doganor që sjell lindjen e borxhit doganor dhe dokumentet mbështetëse, që mallrat e shkatërruara janë ato të cilat ishin vendosur nën regjimin në fjalë.

4. Kur prova e referuar në pikat 2 dhe 3 është e pamjaftueshme për autoritetin doganor për marrjen e vendimit, ose kur prova e caktuar nuk është në dispozicion, një provë e tillë mund të plotësohet ose zëvendësohet nga çdo dokument tjetër zyrtar që konsiderohet i nevojshëm nga autoriteti në fjalë.

Neni 231
Informacioni që duhet t'i dërgohet DPD
(Nenet 114 dhe 115, të Kodit)

1. Zyra doganore kompetente, përveç rasteve të përmendura në pikën 3, të nenit 109, të Kodit, do t'i dërgojë DPD-së një listë të rasteve të rimbursimit apo faljes.

2. Informimi duhet të bëhet gjatë tremujorëve të parë dhe të tretë të çdo viti, për të gjitha rastet në të cilat është vendosur për rimbursimin ose faljen e detyrimeve, gjatë gjysmës së parë të vitit.

3. Kur një zyrë doganore nuk ka marrë asnjë vendim për rastet e përmendura në pikën 1, gjatë gjysmës së vitit në fjalë, ajo do t'i dërgojë DPD-së një njoftim për këtë.

4. Për secilin prej rasteve të përmendura në këtë nen do të ofrohet informacioni i mëposhtëm:

a) Numri i deklaratës doganore apo dokumentit që njofton borxhin;

b) Data e deklaratës doganore ose e dokumentit që njofton borxhin;

c) Lloji i vendimit;

ç) Baza ligjore për vendimin;

d) Shuma e parave;

dh) Të dhëna të tjera të rastit (që përfshijnë një shpjegim të shkurtër se pse zyra doganore i konsideron kushtet për rimbursim ose falje sipas bazës përkatëse ligjore, të plotësuara).

KREU 4
Shuarja e borxhit doganor

Neni 232
Parregullsi të cilat nuk ndikojnë në funksionimin e duhur të një regjimi doganor
(Nënndarja "i", e shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 116, të Kodit)

Situatat e mëposhtme konsiderohen si parregullsi pa ndikim të rëndësishëm në funksionimin e duhur të regjimit doganor kur:

a) tejkalimi i afatit kohor me një periudhë jo më shumë se afati që do të ishte dhënë, nëse do të ishte vënë në zbatim zgjatja;

b) borxhi doganor ka lindur për mallrat e vendosura nën një regjim të posaçëm ose në magazinim të përkohshëm në përputhje me nenin 215, pika 1, shkronja "a" ose "c", të Kodit, dhe këto mallra janë hedhur më pas në qarkullim të lirë;

c) mbikëqyrja doganore është rivendosur për mallrat të cilat nuk janë formalisht pjesë e një regjimi transiti, por të cilat më parë ishin në një magazinim të përkohshëm ose janë vendosur në një regjim të posaçëm së bashku me mallrat e vendosura formalisht në atë regjim transiti;

ç) në rastin e mallrave të vendosura në një regjim të posaçëm përveç atij të transitit dhe zonave të lira ose në rastin e mallrave në magazinim të përkohshëm, kur është kryer një gabim në lidhje me informacionin në deklaratën doganore për mbylljen e regjimit ose në përfundim të magazinimit të përkohshëm me kusht që gabimi të mos ketë ndikim në mbylljen e procedurës ose në përfundimin e magazinimit të përkohshëm;

d) borxhi doganor ka lindur në bazë të nenit 215, pika 1, shkronja "a" ose "b", të Kodit, me kusht që personi i interesuar të informojë autoritetet doganore kompetente në lidhje me mospërmbushjen para se borxhi doganor të jetë njoftuar apo autoritetet doganore të kenë informuar personin se duan të kryejnë një kontroll.

TITULLI IV
MALLRAT QË HYJNË NË TERRITORIN DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU 1
Deklarata përmbledhëse e hyrjes

Seksioni 1
Depozitimi, afatet e depozitimit dhe regjistrimi i deklaratës përmbledhës të hyrjes

Nënseksioni 1
Depozitimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes

Neni 233
Sistemi elektronik në lidhje me deklaratat përmbledhëse të hyrjes
(Neni 17 i Kodit)

Një sistem elektronik i informacionit dhe komunikimit, ngritur në bazë të pikës 1, të nenit 17, të Kodit, do të përdoret për paraqitjen, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit, në lidhje me deklaratat përmbledhëse të hyrjes, si dhe për shkëmbimet e mëvonshme të informacionit, të parashikuara në këtë kre.

Duke anashkaluar paragrafin e parë të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të referuar në planin e punës, të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, deklarata përmbledhëse e hyrjes bëhet me anë të depozitimit të manifestit të ngarkesës së mjetit lundrues, mjetit ajror, mjetit hekurudhor, deklaratës së transitit, dokumentit të transportit rrugor (CMR) ose në çdo formë tjetër që pranohet nga zyra doganore përkatëse.

Neni 234
Depozitimi i një deklarate përmbledhëse të hyrjes
(Pikat 5 dhe 6, të nenit 119, të Kodit)

1. Të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes mund të sigurohen me depozitimin e një grupimi të dhënash.

2. Për qëllime të paraqitjes së deklaratës përmbledhëse të hyrjes përmes depozitimit të një grupimi të dhënash, zyra doganore e hyrjes do të jetë zyra doganore e njohur nga personi i interesuar në momentin e depozitimit të të dhënave, në mënyrë të veçantë bazuar në vendin në të cilin mallrat janë paraqitur.

3. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit të përmendur në Planin e punës, të miratuar nga ministri i përgjegjës për financat, pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk do të zbatohen.

Neni 235
Rastet kur detyrimi për të depozituar një deklaratë përmbledhëse të hyrjes nuk zbatohet
(Shkronja "b", e pikës 2, të nenit 119, të Kodit)

1. Depozitimi i një deklarate përmbledhëse të hyrjes nuk bëhet në lidhje me mallrat e mëposhtme:

a) Energjinë elektrike;

b) Mallrat që hyjnë nëpërmjet tubacioneve;

c) Artikujt e korrespondencës;

ç) Sendet shtëpiake, sipas përcaktimit të shkronjës "c", të nenit 399, me kusht që ato të mos jenë transportuar në bazë të një kontrate transporti;

d) Mallrat, për të cilat lejohet deklarimi doganor me gojë, në përputhje me nenet 304 dhe 305, pika 1, me kusht që ato të mos jenë transportuar sipas një kontrate transporti;

dh) Mallrat e referuara në nenin 308, shkronjat "b' deri "d" ose nenin 309, pika 1, të cilat konsiderohen se janë deklaruar në përputhje me nenin 311 me kusht që ato të mos jenë transportuar sipas një kontrate transporti;

e) Mallrat e ndodhura në bagazhin personal të udhëtarëve;

ë) Mallrat e lëvizura sipas formularit 302, të parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut në lidhje me statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951;

f) Armët dhe pajisjet ushtarake të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga autoritetet përgjegjëse të mbrojtjes ushtarake, nën transportin ushtarak ose transportin për përdorim vetëm të autoriteteve ushtarake;

g) Mallrat e mëposhtme, të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë drejtpërdrejt nga instalimet në det të hapur, që operohen nga një person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë:

i. Mallrat, të cilat janë trupëzuar në këto instalime në det të hapur për qëllime të ndërtimit, riparimit, mirëmbajtjes apo këmbimit të tyre;

ii. Mallrat, të cilat janë përdorur për t'iu përshtatur ose për të pajisur instalimet në det të hapur;

iii. pjesët për t'u përdorur apo konsumuar në instalimet në det të hapur;

iv. mbetjet jo të rrezikshme që dalin nga këto instalime në det të hapur;

gj) Mallra që gëzojnë të drejtën e lehtësirave në përputhje me Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të 18 prillit 1961, Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, të datës 24 prill 1963, si dhe konventa të tjera konsullore ose Konventën e Nju Jorkut, të 16 dhjetorit 1969, për misione të posaçme;

h) Mallrat e mëposhtme, në bordin e anijeve dhe avionëve:

i. mallrat, të cilat janë furnizuar për t'u përfshirë si pjesë ose pajisje në këto anije dhe avionë;

ii. mallrat për funksionimin e motorëve, makinave dhe pajisjeve të tjera të këtyre anijeve ose avionëve;

iii. ushqimet dhe sende të tjera për t'u konsumuar apo shitur në bord;

i) Produktet e peshkimit dhe produkte të tjera të marra nga deti jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nga anijet/barkat e peshkimit të Republikës së Shqipërisë;

j) Anijet/barkat dhe mallrat që ngarkohen në to, që hyjnë në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë me qëllim të vetëm marrjen në bord të furnizimeve pa u lidhur me ndonjë nga pajisjet e portit;

k) Mallrat e mbuluara nga Carnet ATA ose Carnet CPD me kusht që ato të mos jenë transportuar sipas një kontrate transporti.

2. Deri më 31 dhjetor 2023, depozitimi i një deklarate përmbledhëse të hyrjes nuk do të zbatohet në lidhje me mallrat në dërgesat postare, pesha e të cilave nuk i kalon 250 gramë.

Kur mallrat në dërgesat postare, pesha e të cilave i kalon 250 gramë, janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë pa një deklaratë përmbledhëse të hyrjes, nuk do të zbatohen sanksione /dënime. Analiza e riskut duhet të kryhet pas paraqitjes së mallrave dhe, kur është e mundur, në bazë të deklaratës së magazinimit të përkohshëm ose të deklaratës doganore që mbulon këto mallra.

Deri më 31 dhjetor 2023, ministria përgjegjëse për financat dhe DPD-ja do të shqyrtojnë situatën lidhur me mallrat në dërgesat postare sipas këtij paragrafi, me qëllim marrjen e masave të nevojshme, duke marrë parasysh përdorimin e mjeteve elektronike nga operatorët postarë që mbulojnë lëvizjen e mallrave.

3. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet dhe hiqet dorë nga paraqitja e një deklarate hyrëse, në lidhje me mallrat në dërgesat postare.

4. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, hiqet dorë nga paraqitja e një deklarate përmbledhëse hyrëse në lidhje me mallrat në një ngarkesë, vlera e të cilave nuk i kalon 22 euro, me kusht që autoritetet doganore pranojnë, me pëlqimin e operatorit ekonomik, të kryejnë një analizë risku duke përdorur të dhëna nga sistemi i operatorit ekonomik ose informacione të marra nga ky sistem.

Nënseksioni 2
Afatet e depozitimit të deklaratës përmbledhëse të hyrjes

Neni 236
Afatet kohore për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes në rastin e transportit detar

(Pikat 3 dhe 7, të nenit 119, të Kodit)

Kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë detare, deklarata përmbledhëse e hyrjes duhet të paraqitet brenda afateve kohore të mëposhtme:

a) Për mallra në kontejnerë, përveç rasteve kur zbatohet shkronja "c", jo më vonë se 24 orë përpara se mallrat të jenë ngarkuar në anijen që do t'i sjellë ato në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Për ngarkesat e plota ose të ndashme, përveç rasteve kur zbatohet shkronja "c", jo më vonë se katër orë para mbërritjes së anijes në portin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) Jo më vonë se dy orë para mbërritjes së anijes në portin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në rastin e mallrave që vijnë nga ndonjë prej këtyre vendeve:

i. Groenlanda;
ii. Ishujt Faroe;
iii. Islanda;
iv. portet në Detin Baltik, Detin e Veriut, Detin e Zi dhe Detin Mesdhe;
v. të gjitha portet e Marokut.

Neni 237
Afatet kohore për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes në rast të transportit ajror
(Pikat 3 dhe 7, të nenit 119, të Kodit)

1. Kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë ajrore, deklarata përmbledhëse e hyrjes duhet të depozitohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Të dhënat minimale të deklaratës përmbledhëse të hyrjes duhet të depozitohen të paktën para se mallrat të ngarkohen në avionin që i sjell në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Kur janë dhënë vetëm të dhënat minimale të deklaratës përmbledhëse të hyrjes brenda afatit të përmendur në paragrafin e dytë, të pikës 1, të dhënat e tjera sigurohen brenda afateve të mëposhtme kohore:

a) Për fluturimet me një kohëzgjatje prej më pak se 4 orësh, të paktën deri në kohën e nisjes faktike të avionit;

b) Për fluturimet e tjera, të paktën 4 orë para mbërritjes së avionit në aeroportin e parë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Duke anashkaluar pikat 1 dhe 2, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, deklarata përmbledhëse e hyrjes duhet të depozitohet brenda afateve kohore të mëposhtme:

a) Për fluturimet me një kohëzgjatje prej më pak se 4 orësh, që nga koha e nisjes së avionit;

b) Për fluturimet me një kohëzgjatje prej 4 orësh ose më shumë, dhe jo me vonë se 4 orë, përpara arritjes së avionit në aeroportin e parë të Republikës së Shqipërisë.

Neni 238
Afatet kohore për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes në rastin e transportit hekurudhor
(Pikat 3 dhe 7, të nenit 119, të Kodit)

Kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë hekurudhore, deklarata përmbledhëse e hyrjes duhet të depozitohet brenda afateve kohore të mëposhtme:

a) Kur udhëtimi me tren nga stacioni i fundit i trenit i vendosur në një vend jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në zyrën doganore të hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë zgjat më pak se 2 orë, të paktën 1 orë para mbërritjes së mallit në zyrën doganore të hyrjes;

b) Në të gjitha rastet e tjera, të paktën 2 orë para mbërritjes së mallit në zyrën doganore të hyrjes.

Neni 239
Afatet kohore për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes në rastin e transportit rrugor
(Pikat 3 dhe 7, të nenit 119, të Kodit)

Kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet transportit rrugor, deklarata përmbledhëse e hyrjes duhet të depozitohet jo më vonë se 1orë para mbërritjes së mallit në zyrën doganore të hyrjes.

Neni 240
Afatet kohore për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes në rastin e transportit në rrugë ujore të brendshme
(Pikat 3 dhe 7, të nenit 119, të Kodit)

Kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë ujore të brendshme, deklarata përmbledhëse e hyrjes duhet të paraqitet jo më vonë se 2 orë para mbërritjes së mallit në zyrën doganore të hyrjes.

Neni 241
Afatet kohore për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes në rastin e transportit të kombinuar
(Pikat 3 dhe 7, të nenit 119, të Kodit)

Kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me një mjet transporti që, në vetvete, është transportuar me një mjet aktiv transporti, afati kohor për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes do të jetë sa afati i zbatueshëm për mjetin aktiv të transportit.

Neni 242
Afatet kohore për depozitimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes në rastin e forcave madhore
(Pikat 3 dhe 7, të nenit 119, të Kodit)

Afatet kohore të referuara në nenet 236 deri 240 nuk zbatohen në rastet e forcave madhore.

Nënseksioni 3
Raste të veçanta për deklaratën përmbledhëse të hyrjes

Neni 243
Sigurimi i të dhënave të deklaratës përmbledhëse të hyrjes nga ana e personave të tjerë në raste të veçanta të transportit në rrugë detare apo përmes rrugëve ujore të brendshme
(Pika 6, e nenit 119, të Kodit)

1. Në rastin e transportit në rrugë detare apo përmes rrugëve ujore të brendshme, kur për të njëjtat mallra të mbuluara nga një ose më shumë fatura ngarkimi (*Bill of Lading B/L),* për të cilat janë lidhur një ose më shumë kontrata të tjera transporti nga një ose më shumë persona të tjerë përveç transportuesit, dhe kur personi që lëshon faturën e ngarkimit nuk i ofron të dhënat e kërkuara për deklaratën përmbledhëse të hyrjes partnerit të tij kontraktual, për të cilin lëshon një faturë ngarkimi, ose partnerit të tij kontraktual, me të cilin ka lidhur një marrëveshje për bashkëngarkimin e mallrave, atëherë personi, i cili nuk i ofron të dhënat e kërkuara, duhet t'i sigurojë këto të dhëna për zyrën doganore të hyrjes në përputhje me pikën 6, të nenit 119, të Kodit.

Kur marrësi i treguar në faturën e ngarkimit nuk disponon faturën kryesore të ngarkimit dhe nuk ofron të dhënat e kërkuara për deklaratën përmbledhëse të hyrjes, personi që lëshon faturën e ngarkimit duhet t'i sigurojë këto të dhëna për zyrën doganore të hyrjes.

2. Çdo person që paraqet të dhënat e përmendura në pikën 5, të nenit 119, të Kodit, do të jetë përgjegjës për këto të dhëna në përputhje me shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 23, të Kodit.

3. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk do të zbatohen.

Neni 244
Sigurimi i të dhënave të deklaratës përmbledhëse të hyrjes nga ana e personave të tjerë në raste të veçanta të transportit në rrugë ajrore
(Pika 6, e nenit 119, të Kodit)

1. Në rastin e transportit në rrugë ajrore, kur për të njëjtat mallra të mbuluara nga një ose më shumë fatura ngarkimi (*Air Way Bill/AWB*), për të cilat janë lidhur një ose më shumë kontrata të tjera të transportit nga një apo më shumë persona të tjerë, përveç transportuesit, dhe kur personi që lëshon faturën e ngarkimit AWB nuk i ofron të dhënat e kërkuara për deklaratën përmbledhëse të hyrjes partnerit të tij kontraktual për të cilin lëshon një faturë ngarkimi AWB ose partnerit të tij kontraktual me të cilin ka lidhur një marrëveshje për bashkëngarkimin e mallrave, atëherë personi, i cili nuk i ofron të dhënat e kërkuara, duhet t'i sigurojë këto të dhëna për zyrën doganore të hyrjes në përputhje me pikën 6, të nenit 119, të Kodit.

2. Në rastin e transportit në rrugë ajrore, kur mallrat janë zhvendosur sipas rregullave të akteve të Bashkimit Postar Universal dhe operatori postar nuk i ofron transportuesit të dhënat e kërkuara për deklaratën përmbledhëse të hyrjes, operatori postar duhet t'i sigurojë këto të dhëna për zyrën doganore të hyrjes në përputhje me pikën 6, të nenit 119, të Kodit.

3. Çdo person që paraqet të dhënat e përmendura në pikën 5, të nenit 119, të Kodit, do të jetë përgjegjës për këto të dhëna në përputhje me përcaktimet e shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 23, të Kodit.

4. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit sipas Planit të

punës së ministrit përgjegjës për financat, pikat 1 dhe 3, të këtij neni, nuk do të zbatohen.

Neni 245
Detyrimet për të informuar në lidhje me të dhënat e deklaratës përmbledhëse hyrëse nga persona të ndryshëm nga transportuesi
(Pika 6, e nenit 119, të Kodit)

1. Në rastet e përmendura në pikën 1, të nenit 243, transportuesi dhe çdo person që lëshon një faturë ngarkese, në grupimin e të dhënave të pjesshme të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, siguron identitetin e çdo personi që ka lidhur një kontratë transporti me ta, ka lëshuar një faturë ngarkese në lidhje me të njëjtat mallra dhe nuk ka vënë në dispozicion të tyre të dhënat e kërkuara për deklaratën përmbledhëse të hyrjes.

Kur marrësi i treguar në faturën e ngarkesës (*bill of lading*) nuk ka faturat bazë të ngarkesës dhe nuk vë në dispozicion të dhënat e nevojshme të personit që lëshon faturën e ngarkesës, ky i fundit duhet të sigurojë identitetin e marrësit.

2. Në rastet e përmendura në pikën 1, të nenit 243, personi që lëshon faturën e ngarkesës, informon për lëshimin e kësaj fature të ngarkesës, personin i cili përmbylli një kontratë transporti me të dhe lëshon faturën e ngarkesës së tij.

Në rastin e një marrëveshjeje të përbashkët ngarkimi të mallrave, personi që lëshon faturën e ngarkesës informon për lëshimin e kësaj fature të ngarkesës personin me të cilin ai hyri në atë marrëveshje.

3. Në rastet e përmendura në pikën 1, të nenit 244, transportuesi dhe çdo person që lëshon një dokument transporti ajror (*air waybill*), do të sigurojë në pjesën e grupimit të të dhënave të pjesshme të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, identitetin e çdo personi i cili ka nënshkruar një kontratë transporti me ta, ka lëshuar një dokument transporti ajror në lidhje me të njëjtat mallra dhe nuk i plotëson të dhënat e kërkuara për deklaratën përmbledhëse të hyrjes në dispozicion të tyre.

4. Në rastet e përmendura në pikën 1, të nenit 244, personi që lëshon një dokument transporti ajror do të informojë për lëshimin e këtij dokumenti personin me të cilin ka lidhur një kontratë transporti dhe i lëshon këtij të fundit dokumentin e transportit ajror.

Në rastin e një marrëveshjeje të përbashkët ngarkese të mallrave, personi që lëshon dokumentin e transportit ajror do të informojë për lëshimin e këtij dokumenti personin me të cilin ka lidhur këtë marrëveshje.

5. Në rastet e përmendura në pikën 2, të nenit 244, transportuesi, në pjesën e grupimit të të dhënave të pjesshme të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, do të sigurojë identitetin e operatorit postar i cili nuk vë të dhënat e nevojshme për deklaratën përmbledhëse të hyrjes në dispozicion të tij.

6. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit të përmendur në planin e punës, të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, pikat 1 deri 5, të këtij neni, nuk do të zbatohen.

Nënseksioni 4
Regjistrimi dhe ndryshimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes

Neni 246
Regjistrimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes
(Pika 1, e nenit 119, të Kodit)

1. Autoritetet doganore regjistrojnë deklaratën përmbledhëse hyrëse pas depozitimit së saj dhe njoftojnë, menjëherë, personin që ka e depozituar atë për regjistrim dhe i komunikojnë MRN e deklaratës përmbledhëse të hyrjes dhe datën e regjistrimit.

2. Nëse të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë siguruar duke paraqitur më shumë se një grupim të dhënash, autoritetet doganore regjistrojnë secilën prej këtyre të dhënave të deklaratës përmbledhëse të hyrjes pas depozitimit të saj dhe duhet të njoftojnë, menjëherë, personin që ka bërë depozitimin e të dhënave për regjistrim duke i komunikuar një MRN për çdo depozitim dhe datën e regjistrimit.

3. Autoritetet doganore njoftojnë menjëherë transportuesin për regjistrimin, me kusht që transportuesi të ketë kërkuar që të njoftohet dhe të ketë akses në sistemin elektronik të përmendur në nenin 233, në ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) Kur deklarata përmbledhëse e hyrjes është paraqitur nga personi i përmendur në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 119, të Kodit;

b) Kur të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë dhënë në përputhje me pikën 6, të nenit 119, të Kodit.

4. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit, të përmendur në planin e punës, të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, pika 2 dhe shkronja "b" e pikës 3, nuk do të zbatohen.

Neni 247
Ndryshimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes
(Pika 1, e nenit 121, të Kodit)

1. Kur të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë depozituar nga persona të ndryshëm, çdo person mund të lejohet të ndryshojë vetëm të dhënat, të cilat ai person ka depozituar.

2. Autoritetet doganore njoftojnë menjëherë personin që ka paraqitur ndryshime në të dhënat e deklaratës përmbledhëse hyrëse për vendimin e tyre për të regjistruar ose për të refuzuar ndryshimet.

3. Kur ndryshimet në të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë paraqitur nga një person i ndryshëm nga transportuesi, autoritetet doganore do të njoftojnë transportuesin, me kusht që transportuesi të ketë kërkuar që të njoftohet dhe të ketë akses në sistemin elektronik të përmendur në nenin 233.

4. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit të përmendur në planin e punës, të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, pika 1, e këtij neni, nuk do të zbatohet.

Nënseksioni 5
Analiza e riskut për deklarimin përmbledhës të hyrjes

Neni 248
Analiza e riskut
(Nenet 119, pika 3 dhe 120, të Kodit)

1. Analiza e riskut duhet të kryhet para ardhjes së mallrave në zyrën doganore të hyrjes, me kusht që deklarata përmbledhëse e hyrjes të jetë depozituar brenda afateve kohore të përcaktuara në nenet 236 deri 240, përveç nëse identifikohet një risk, ose nevojitet të kryhet një analizë risku shtesë.

Në rastin e ngarkesave me kontejnerë të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga deti, siç përmendet në shkronjën "a", të nenit 236, autoritetet doganore përfundojnë analizën e riskut brenda 24 orëve nga depozitimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes, ose në rastet e përmendura në pikën 6, të nenit 119, të Kodit, nga të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes, të paraqitura nga transportuesi.

Përveç paragrafit të parë, në rastin e mallrave të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë ajrore, analiza e riskut do të kryhet pas marrjes së dhënave minimale të deklaratës përmbledhëse të hyrjes , të referuar në paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 237.

2. Analiza e riskut duhet të plotësohet, kur është e nevojshme, përmes shkëmbimit të informacionit lidhur me riskun dhe rezultatet e analizave të riskut, siç përmendet në pikën 5, të nenit 47, të Kodit.

3. Kur përfundimi i analizës së riskut kërkon informacion të mëtejshëm mbi veçoritë e deklaratës përmbledhëse të hyrjes, analiza duhet të përfundojë vetëm pasi informacioni është dhënë.

Për këto qëllime, autoritetet doganore kërkojnë këtë informacion nga personi që paraqet deklaratën përmbledhëse të hyrjes, ose, kur është e zbatueshme, nga personi që ka depozituar detajet e deklaratës përmbledhëse të hyrjes. Nëse ai person është i ndryshëm nga transportuesi, autoritetet doganore informojnë transportuesin, me kusht që transportuesi ta ketë kërkuar që të njoftohet dhe të ketë akses në sistemin elektronik të përmendur në nenin 234.

4. Nëse autoritetet doganore, në rastin e mallrave që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë ajrore, kanë baza të arsyeshme për të dyshuar se dërgesa mund të përbëjë një kërcënim serioz për sigurinë e aviacionit, njoftojnë personin që paraqet deklaratën përmbledhëse të hyrjes ose, kur është e zbatueshme, personin që ka paraqitur të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes dhe, kur ky person është i ndryshëm nga transportuesi, informon transportuesin, me kusht që transportuesi të ketë akses në sistemin elektronik të përmendur në nenin 234, se dërgesa duhet të kontrollohet si ngarkesë dhe postë me risk të lartë, para se të ngarkohen në bordin e një avioni në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Pas njoftimit, ai person duhet të informojë autoritetet doganore nëse dërgesa është kontrolluar ose tashmë u kontrollua në përputhje me kërkesat e lartpërmendura dhe të sigurojë të gjithë informacionin e duhur lidhur me këtë kontroll.

Analiza e riskut duhet të kryhet vetëm pasi informacioni është dhënë.

5. Kur në rastin e ngarkesave me kontejnerë të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë detare, siç përmendet në shkronjën "a", të nenit 236, ose në rastin e mallrave të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë ajrore, analiza e riskut ofron baza të arsyeshme për autoritetet doganore duke konsideruar se hyrja e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë përbën një kërcënim serioz për sigurinë dhe mbrojtjen, që kërkon një ndërhyrje të menjëhershme, autoritetet doganore njoftojnë personin që depoziton deklaratën përmbledhëse të hyrjes, ose, kur është e zbatueshme, personin që ka paraqitur të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes dhe, kur ky person është i ndryshëm nga transportuesi, informon transportuesin, me kusht që transportuesi të ketë akses në sistemin elektronik të përmendur në nenin 234, se mallrat nuk duhet të ngarkohen. Një njoftim i tillë bëhet dhe informacioni përkatës jepet menjëherë pas identifikimit të riskut dhe, në rastin e mallrave të sjella me kontejnerë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë detare, siç përmendet në shkronjën "a", të nenit 236, brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 1.

6. Kur një dërgesë është identifikuar se paraqet një kërcënim të një natyre të tillë që kërkon veprim të menjëhershëm pas mbërritjes, zyra doganore e hyrjes do ta bëjë atë veprim me mbërritjen e mallrave.

7. Kur risku i identifikuar nuk përbën një kërcënim të tillë serioz për sigurinë dhe mbrojtjen që do të kërkonte masa të menjëhershme, zyra doganore e hyrjes ia kalon rezultatet e analizës së riskut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, informacionin në lidhje me vendin më të përshtatshëm ku duhet të kryhet kontrolli si dhe të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes, të gjitha zyrave doganore që preken nga lëvizja e mallrave.

8. Për mallrat për të cilat detyrimi për të paraqitur një deklaratë përmbledhëse të hyrjes është hequr, në përputhje me shkronjat "c" deri "gj", dhe "i", të pikës 1, dhe paragrafi i parë i pikës 2, të nenit 235, janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, analiza e riskut duhet të kryhet me paraqitjen e mallrave, nëse janë të disponueshëm, bazuar në deklaratën e magazinimit të përkohshëm ose në deklaratën doganore të mallrave në fjalë.

9. Mallrat e paraqitura në doganë mund të vendosen nën një regjim doganor ose të rieksportohen sapo analiza e riskut të jetë përfunduar dhe rezultatet e analizës së riskut dhe, sipas rastit, masat e marra lejojnë një vendosje të tillë.

10. Analiza e riskut, gjithashtu, duhet të kryhet në qoftë se të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë ndryshuar në përputhje me nenin 121, të Kodit. Në këtë rast, analiza e riskut duhet të kryhet, menjëherë, pas marrjes së të dhënave, përveç nëse identifikohet një risk, ose nevojitet të kryhet një analizë risku shtesë.

Neni 249
Analiza e Riskut
(Neni 120 i Kodit)

1. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të kontrollit të importit të përmendur në planin e punës, të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, pikat 1 deri 8, neni 247, nuk do të zbatohet.

2. Analiza e riskut duhet të kryhet para ardhjes së mallrave në zyrën doganore të hyrjes, me kusht që deklarata përmbledhëse e hyrjes të jetë depozituar brenda afateve kohore të përcaktuara në nenet 236 deri 240, përveçse kur është identifikuar një risk.

3. Në rast të ngarkesave me kontejnerë të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë detare, siç përmendet në shkronjën "a", të nenit 236, autoritetet doganore duhet të përfundojnë analizën e riskut brenda 24 orëve nga depozitimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes. Kur analiza ofron baza të arsyeshme për autoritetet doganore që të marrin në konsideratë, se hyrja e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë përbën një kërcënim serioz për sigurinë dhe mbrojtjen dhe një veprim i menjëhershëm është i nevojshëm, autoritetet doganore njoftojnë personin që ka depozituar deklaratën përmbledhëse të hyrjes, dhe, nëse ai person është i ndryshëm nga transportuesi, informon transportuesin me kusht që transportuesi të ketë akses në sistemin elektronik të përmendur në nenin 233, se mallrat nuk do të ngarkohen. Ky njoftim duhet të bëhet dhe informacioni duhet të jepet menjëherë pas zbulimit

të riskut përkatës dhe brenda 24 orëve nga depozitimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes.

4. Kur një anije ose avion duhet të ndalojë në më shumë se një port ose aeroport në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që të lëvizë mes tyre, pa ndaluar në asnjë port ose aeroport jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, do të veprohet si në vijim:

a) Për të gjitha mallrat e transportuara si më lart me anije ose avion, një deklaratë përmbledhëse hyrëse depozitohet në portin ose në aeroportin e parë të Republikës së Shqipërisë. Autoritetet doganore të portit ose aeroportit të hyrjes, duhet të kryejnë analizën e riskut për qëllime të sigurisë dhe të mbrojtjes për të gjitha mallrat e anijes ose avionit në fjalë. Analizat shtesë të riskut mund të kryhen për këto mallra në portin apo aeroportin në të cilin ato janë shkarkuar;

b) Në rastin e dërgesave të identifikuara se paraqesin një kërcënim serioz, ku kërkohet një ndërhyrje e menjëhershme, zyra doganore e portit ose aeroportit të hyrjes në Republikës së Shqipërisë do të marrë masa ndaluese, dhe në çdo rast, do t'i kalojë rezultatet e analizës së riskut në portet ose aeroportet e mëpasshme;

c) Në portet ose aeroportet e mëpasshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, për mallrat e paraqitura në doganë në atë port ose aeroport do të zbatohet neni 135, i Kodit.

5. Kur mallrat, për të cilat detyrimi për të paraqitur deklaratën përmbledhëse të hyrjes është hequr në përputhje shkronjat "c" deri "gj", dhe "i" të pikës 1, dhe pika 2, të nenit 235, janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, analiza e riskut bëhet me paraqitjen e mallrave, nëse janë të disponueshëm, bazuar në deklaratën e magazinimit të përkohshëm ose në deklaratën doganore të mallrave në fjalë.

KREU 2
Mbërritja e mallrave

Seksioni 1
Hyrja e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë

Nënseksioni 1
Vendi ku paraqiten mallrat

Neni 250
Miratimi i një vendi për paraqitjen e mallrave në doganë dhe magazinimin e përkohshëm

(Nenet 130, pika 1, dhe 137, pika 1, të Kodit)

1. Përveç zyrës doganore kompetente, mund të miratohet një vend tjetër për paraqitjen e mallrave, në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Kur janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 138, të Kodit, si dhe në nenin 258;

b) Mallrat e deklaruara për një regjim doganor një ditë pas paraqitjes së tyre, përveç rasteve kur autoritetet doganore kërkojnë që mallrat të kontrollohen në përputhje me pikën 2, të nenit 131, të Kodit.

Ky miratim nuk kërkohet kur ambienti është i autorizuar për përdorimin e magazinimit të përkohshëm.

2. Përveç ambientit të magazinimit të përkohshëm, mund të miratohet një vend tjetër për magazinim të përkohshëm të mallrave, në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Kur janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikat 2 e 3, të nenit 138, të Kodit, dhe në nenin 258;

b) Mallrat e deklaruara për regjim doganor, një ditë pas paraqitjes së tyre, përveç rasteve kur autoritetet doganore kërkojnë që mallrat të kontrollohen në përputhje me pikën 2, të nenit 131, të Kodit.

3. Deri në funksionimin e sistemit të informatizuar për hyrjen në regjistrimet e deklaruesit do të zbatohen nenet përkatëse për zhdoganimin në ambientet e operatorit ekonomik.

Neni 251
Devijimi i një anije detare ose një mjeti ajror, njoftimi i mbërritjes
(Neni 124 i Kodit)

1. Kur një anije detare ose një avion që hyn në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ndërron drejtimin dhe pritet të mbërrijë për herë të parë në një zyrë doganore të vendosur në Republikës së Shqipërisë, që nuk është treguar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes si një vend kalimi, operatori i atij mjeti transportues informon për këtë devijim zyrën doganore që tregohet në deklaratën përmbledhëse të hyrjes, si zyrën doganore të hyrjes.

Paragrafi i parë nuk do të zbatohet kur mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nën regjimin e transitit, në përputhje me nenin 132, të Kodit.

2. Zyra doganore e treguar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes, si zyra doganore e hyrjes, menjëherë pasi është informuar në përputhje me pikën 1, njofton zyrën doganore e cila në bazë të këtij informacioni është zyra doganore e hyrjes pas devijimit. Ajo do t'i dërgojë veçoritë përkatëse të deklaratës përmbledhëse të hyrjes dhe të rezultateve të analizës së riskut zyrës doganore të treguar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes.

3. Deri në datat e implementimit të sistemit të informatizuar për 'njoftimin e mbërritjes', autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera, të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave për depozitimin e një njoftimi të mbërritjes së një anije detare ose të një mjeti ajror, në përputhje me nenin 124, të Kodit.

4. Kur informacioni për mbërritjen e një anijeje detare ose të një mjeti ajror është i disponueshëm nga autoritetet doganore, në formën e një deklarate përmbledhëse të hyrjes, sipas nenit 122, të Kodit (deklaratë doganore, manifest, deklaratë magazinimi të përkohshëm), ato mund të mos kërkojnë njoftimin e mbërritjes.

Nënseksioni 2
Paraqitja, shkarkimi dhe verifikimi i mallrave

Neni 252
Paraqitja e mallrave në doganë
(Neni 130 i Kodit)

1. Autoritetet doganore mund të pranojnë përdorimin e sistemeve të portit ose të aeroportit, ose metoda të tjera të informacionit në dispozicion, për paraqitjen e mallrave në doganë.

2. Deri në datat e implementimit të sistemit të informatizuar për "njoftimin e paraqitjes", autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera, të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave për njoftimin e paraqitjes së mallrave në doganë, në përputhje me nenin 130, të Kodit.

3. Personi që paraqet mallrat i referohet deklaratës përmbledhëse të hyrjes ose, në rastet e parashikuara në nenin 122, të Kodit, deklaratës doganore ose deklaratës për magazinim të përkohshëm që është depozituar për këto mallra përveçse kur nuk kërkohet depozitimi i një deklarate përmbledhëse të hyrjes.

Seksioni 2
Magazinimi i përkohshëm i mallrave

Nënseksioni 1
Procedurat për magazinimin e përkohshëm

Neni 253
Procedura e konsultimit mes autoriteteve doganore para dhënies së autorizimit të ambienteve për magazinim të përkohshëm
(Neni 27 i Kodit)

1. Procedura e referuar në nenit 31 do të ndiqet në përputhje me pikat 2 dhe 3, të këtij neni, para se të merret një vendim për të autorizuar funksionimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm, përveçse kur DPD-ja gjykon se nuk janë përmbushur kushtet për dhënien e një autorizimi të tillë.

2. Autoritetet doganore kompetente për marrjen e vendimit, i komunikojnë kërkesën dhe projektautorizimin autoriteteve doganore të konsultuara, brenda 30 ditëve, pas ditës në të cilën është pranuar aplikimi.

3. Nëse autoritetet doganore të konsultuara nuk komunikojnë ndonjë kundërshtim brenda afatit, aprovimi i tyre do të konsiderohet si i dhënë.

Neni 254
Deklarata e magazinimit të përkohshëm

1. Kur deklarata doganore është depozituar para mbërritjes së pritshme të mallrave në doganë, në përputhje me nenin 156, të Kodit, autoritetet doganore mund ta marrin në konsideratë këtë deklaratë, si një deklaratë magazinimi të përkohshëm.

2. Deri në datat e implementimit të sistemit të informatizuar për "deklaratën e magazinimit të përkohshëm", autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera të ndryshme nga teknika elektronike të përpunimit të të dhënave për paraqitjen e një deklarate të magazinimit të përkohshëm në përputhje me nenin 135 të Kodit.

Neni 255
Regjistrimet
(Pika 4, e nenit 138, të Kodit)

1. Regjistrimet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 138, të Kodit, duhet të përmbajnë informacionin dhe të dhënat e mëposhtme:

a) Referencën e deklaratës përkatëse të magazinimit të përkohshëm për mallrat e magazinuara dhe referencën përkatëse për mbylljen e magazinimit të përkohshëm;

b) Datën dhe të dhënat identifikuese të dokumenteve doganore në lidhje me mallrat e magazinuara dhe të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me magazinimin e përkohshëm të mallrave;

c) Treguesit, numrat identifikues, numrin dhe llojin e paketimeve, sasinë dhe përshkrimin e zakonshëm tregtar apo teknik të mallrave dhe, sipas rastit, shenjat e identifikimit të kontejnerit, të nevojshme për identifikimin e mallrave;

ç) Vendndodhjen e mallrave dhe veçoritë e çdo lëvizjeje të mallrave;

d) Statusin doganor të mallrave;

dh) Të dhënat mbi format e trajtimit të përmendura në pikën 2, të nenit 137, të Kodit;

e) Në lidhje me lëvizjen e mallrave në magazinim të përkohshëm ndërmjet ambienteve të ndryshme të magazinimit të përkohshëm, të dhënat në lidhje me mbërritjen e mallrave në ambientet e magazinimit të përkohshëm të destinacionit.

Kur regjistrimet nuk janë pjesë e kontabilitetit /llogarive kryesore për qëllime doganore, duhet t'i referohen kontabilitetit/llogarive kryesore për qëllime doganore.

2. Autoritetet doganore mund të heqin dorë nga kërkesa për një pjesë të informacionit të përmendur në pikën 1, kur kjo nuk ndikon negativisht në mbikëqyrjen doganore dhe kontrollin e mallrave. Megjithatë, në rastin e lëvizjes së mallrave ndërmjet ambienteve të magazinimit të përkohshëm, ajo heqje dorë nuk zbatohet.

Neni 256
Lëvizja e mallrave në magazinim të përkohshëm
(Pika 5, e nenit 138, të Kodit)

1. Kur lëvizja bëhet mes ambienteve të magazinimit të përkohshëm, nën përgjegjësinë e autoriteteve të ndryshme doganore, mbajtësi i autorizimit për funksionimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm nga të cilat mallrat janë zhvendosur, informon:

a) autoritetet doganore përgjegjëse për mbikëqyrjen e ambientit të magazinimit të përkohshëm nga të cilat mallrat janë zhvendosur për lëvizjen e synuar në mënyrën e përcaktuar në autorizim dhe, pas mbërritjes së mallrave në ambientin e magazinimit të përkohshëm të destinacionit, në lidhje me përfundimin e lëvizjes në mënyrën e përcaktuar në autorizim;

b) mbajtësin e autorizimit për ambientet tek të cilat mallrat janë zhvendosur, që mallrat janë dërguar.

2. Kur lëvizja bëhet mes ambienteve të magazinimit të përkohshëm, nën përgjegjësinë e autoriteteve të ndryshme doganore, mbajtësi i autorizimit për ambientet tek të cilat mallrat janë zhvendosur, do të:

a) njoftojë autoritetet doganore përgjegjëse për ato ambiente, për mbërritjen e mallrave; dhe

b) pas mbërritjes së mallrave në ambientet e magazinimit të përkohshëm të destinacionit, informon mbajtësin e autorizimit të ambienteve të magazinimit të përkohshme të nisjes.

3. Informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2, do të përfshijë një referencë të deklaratës përkatëse të magazinimit të përkohshëm dhe të datës së fundit të magazinimit të përkohshëm.

4. Kur kryhet një lëvizje e mallrave nën magazinim të përkohshëm, mallrat mbeten nën përgjegjësinë e mbajtësit të autorizimit për funksionimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm nga e cila mallrat janë zhvendosur, deri sa mallrat të shënohen në regjistrat e mbajtësit të autorizimit për ambientet e magazinimit të përkohshëm në të cilën mallrat janë transferuar, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në autorizim.

Neni 257
Raste të tjera të lëvizjes së mallrave në magazinim të përkohshëm
(Shkronja "c", e pikës 5, të nenit 138, të Kodit)

Në përputhje me shkronjën "c", të pikës 5, të nenit 138, të Kodit, autoritetet doganore mund të autorizojnë lëvizjen e mallrave në magazinim të përkohshëm ndërmjet ambienteve të ndryshme të magazinimit të përkohshëm, të mbuluara nga autorizime të ndryshme të magazinimit të përkohshëm me kusht që mbajtësit e këtyre autorizimeve të jenë OEAD/OEAS.

Neni 258
Shitja me pakicë
(Pika 1, e nenit 138, të Kodit)

Autorizimet për funksionimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm të referuara në nenin 138, të Kodit, jepen në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) Ambientet e magazinimit të përkohshëm nuk përdoren për shitje me pakicë;

b) Kur mallrat e magazinuara përbëjnë rrezik ose mund të dëmtojnë mallrat e tjera apo kërkojnë kushte të veçanta për arsye të ndryshme, ambientet e magazinimit të përkohshëm janë të pajisura posaçërisht për ruajtjen e tyre;

c) Ambientet për magazinim të përkohshëm vihen në funksionim ekskluzivisht nga mbajtësi i autorizimit.

TITULLI V

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR STATUSIN DOGANOR, VENDOSJA E MALLRAVE NËN NJË REGJIM DOGANOR, VERIFIKIMI, ÇLIRIMI DHE TJETËRSIMI/SHKATËRRIMI I MALLRAVE

KREU 1
Statusi doganor i mallrave

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Nënseksioni 1
Statusi doganor i mallrave

Neni 259
Prezumimi i statusit doganor
(Nenet 142, pika 1, dhe 144, pika 2, të Kodit)

1. Prezumimi i statusit doganor të mallrave shqiptare nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme:

a) Mallrat e sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë nën mbikëqyrje doganore për të përcaktuar statusin e tyre doganor;

b) Mallrat në magazinim të përkohshëm;

c) Mallrat e vendosura në ndonjë nga regjimet e posaçme me përjashtim të transitit të brendshëm, të regjimit të përpunimit pasiv dhe të regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*);

ç) Produktet e peshkimit të kapura nga një anije/barkë peshkimi e Republikës së Shqipërisë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në ujëra të tjera përveç ujërave territoriale të një vendi tjetër, të cilat janë sjellë në territorin doganor të të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimit të nenit 281;

d) Mallrat e përftuara nga produktet e referuara në shkronjën "ç" në bordin e një anijeje/barke apo anije-fabrikë të Republikës së Shqipërisë, në prodhimin e të cilave mund të jenë përdorur produkte të tjera që kanë statusin doganor të mallrave shqiptare, të cilat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimit të nenit 281;

dh) Produkte të peshkimit detar dhe produkte të tjera të marra apo të kapura nga anijet/barkat që mbajnë flamurin e një vendi të tjetër në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Mallrat shqiptare mund të lëvizin, pa qenë objekt i një regjimi doganor, nga një pikë në tjetrën, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përkohësisht jashtë këtij territori, pa ndryshimin e statusit të tyre doganor në rastet e mëposhtme:

a) Kur mallrat janë transportuar në rrugë ajrore dhe janë ngarkuar ose transportuar në një aeroport të Republikës së Shqipërisë për dërgesë në një aeroport tjetër të Republikës së Shqipërisë, me kusht që ato të jenë transportuar përmes një dokumenti të vetëm transporti, të lëshuar në Republikën e Shqipërisë;

b) Kur mallrat janë transportuar në rrugë detare dhe janë dërguar ndërmjet porteve të ndryshme të Republikës së Shqipërisë përmes një shërbimi të rregullt të anijeve të autorizuara, në përputhje me nenin 311;

c) Kur mallrat janë transportuar në rrugë hekurudhore nëpërmjet një vendi të tjetër nën një regjim transiti të përbashkët, të mbuluar nga një dokument i vetëm transporti i lëshuar në Republikën e Shqipërisë, e parashikuar kjo nga një marrëveshje ndërkombëtare.

3. Mallrat shqiptare mund të lëvizin, pa qenë objekt i një regjimi doganor, nga një pikë në tjetrën, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përkohësisht jashtë këtij territori, pa ndryshimin e statusit të tyre doganor, në rastet e mëposhtme me kusht që të jetë provuar statusi doganor i tyre si mallra shqiptare:

a) Mallrat, të cilat janë transportuar nga një pikë në tjetrën brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe largohen përkohësisht nga ky territor në rrugë detare apo ajrore;

b) Mallrat, të cilat janë transportuar nga një pikë në tjetrën brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet një territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë pa u transborduar dhe janë të mbuluara nga një dokument i vetëm transporti, i lëshuar në të Republikën e Shqipërisë;

c) Mallrat, të cilat janë transportuar nga një pikë në tjetrën brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet një territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe janë transportuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë përmes një mjeti tjetër transporti përveç atij në të cilin ishin ngarkuar fillimisht, nëpërmjet lëshimit të një dokumenti të ri transporti, që mbulon transportin nga territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që dokumenti i ri të jetë i shoqëruar me një kopje të dokumentit të vetëm origjinal të transportit;

ç) Automjetet rrugore të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë larguar përkohësisht dhe kanë rihyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

d) Ambalazhet, paletat dhe pajisjet e tjera të ngjashme, duke përjashtuar kontejnerët që i përkasin një personi të vendosur ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të cilët janë përdorur për transportin e mallrave që janë larguar përkohësisht dhe kanë rihyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

dh) Mallrat në bagazhin e një pasagjeri, të cilat nuk janë të destinuara për përdorim tregtar që janë larguar përkohësisht dhe kanë rihyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 260
Periudha e vlefshmërisë së një dokumenti T2L, apo e një manifesti doganor mallrash
(Pika 5, e nenit 27, të Kodit)

Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare në formën e një dokumenti T2L ose një manifesti doganor mallrash është e vlefshme për 90 ditë nga data e regjistrimit ose kur, në përputhje me nenin 290, nuk ka asnjë detyrim për të regjistruar manifestin doganor të mallrave, nga data e krijimit. Me kërkesë të personit të interesuar dhe për shkaqe të arsyeshme, zyra doganore mund të caktojë një periudhë më të gjatë të vlefshmërisë së dokumentit.

Neni 261
Mjetet e komunikimit të Numrit Kryesor të Lëvizjes (MRN) së një dokumenti T2L ose një manifesti doganor mallrash
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. MRN i një dokumenti T2L ose një manifesti doganor mallrash mund të komunikohet me ndonjë prej mjeteve të mëposhtme, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave:

a) një bar kod;

b) një dokument të regjistrimit të statusit;

c) mjete të tjera të lejuara nga autoriteti doganor pritës.

2. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, pika 1 e këtij neni nuk do të zbatohet.

Nënseksioni 2
Mjetet, miratimi, regjistrimi dhe përdorimi i mjeteve të provës së statusit

Neni 262
Mjetet e provës së statusit doganor të mallrave shqiptare
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Për të provuar se mallrat kanë statusin doganor të mallrave shqiptare, sipas rastit, përdoret një nga mjetet në vijim:

a) Të dhënat e deklarimit transit të mallrave të vendosura nën regjimin e transitit të brendshëm. Në këtë rast, pika 3, e nenit 259, nuk do të zbatohet;

b) Të dhënat e dokumentit T2L të përmendura në nenin 269;

c) Manifesti doganor i mallrave i përmendur në nenin 270;

ç) Fatura apo dokumenti i transportit të përmendura në nenin 273;

d) Sipas rastit, regjistri i peshkimit, deklarata e zbarkimit në tokë, deklarata e transbordit dhe të dhënat e sistemit të monitorimit të anijes, të përmendur në nenin 28;

dh) Një mjet prove i përmendur në nenet 276 deri 279;

e) Etiketa e përmendur në nenin 608.

2. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të provës së Republikës së Shqipërisë sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, prova e statusit doganor të mallrave shqiptare mund të jepet përmes manifestit të kompanisë së transportit detar në lidhje me këto mallra.

3. Duke anashkaluar shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të provës së Republikës së Shqipërisë, sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, prova e statusit doganor të mallrave shqiptare mund të jepet përmes faturës ose një dokumenti transporti, që lidhet me mallrat, vlera e të cilave e tejkalon ekuivalentin në lekë të 15 000 eurove.

4. Kur mjetet e provave të referuara në pikën 1 janë përdorur për mallrat me status doganor të mallrave shqiptare, me një paketim që nuk ka statusin doganor të mallrave shqiptare, në mjetin e provës duhet të vendoset edhe shënimi: "Paketimi N - [kodi 98200]"

5. Kur mjetet e provave të përmendura në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, janë lëshuar në mënyrë retrospektive (*a-posteriori*), ato duhet të përfshijnë edhe shënimin: "Lëshuar në mënyrë retrospektive - [kodi 98201]"

6. Mjetet e provës të referuara në pikën 1 nuk do të përdoren në lidhje me mallrat për të cilat formalitetet e eksportit kanë përfunduar ose janë vendosur nën regjimin e përpunimit pasiv.

Neni 263
Miratimi, regjistrimi dhe përdorimi i mjeteve të caktuara të provës së statusit doganor të mallrave shqiptare
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Zyra doganore kompetente konfirmon dhe regjistron mjetet e provës së statusit doganor të mallrave shqiptare të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 262, me përjashtim të rasteve të përmendura në pikën 1, të nenit 290, dhe i komunikon MRN e këtyre mjeteve të provës personit të interesuar.

2. Një dokument që konfirmon regjistrimin e mjeteve të provës së përmendur në pikën 1, do të vihet në dispozicion me kërkesë të personit të interesuar nga zyra doganore kompetente. Ky dokument do të përgatitet duke përdorur formularin e aneksit 51-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Mjetet e provës të referuara në pikën 1, duhet të paraqiten në zyrën kompetente doganore ku mallrat janë paraqitur pas rihyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke treguar MRN e tyre.

4. Zyra doganore kompetente do të monitorojë përdorimin e mjeteve të provës të përmendur në pikën 1, me qëllim që të sigurojë në mënyrë të veçantë që mjetet e provës nuk janë përdorur për mallra të ndryshme nga ato për të cilat janë lëshuar.

Neni 264
Miratimi i një fature
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të provës së Republikës së Shqipërisë, sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, kur vlera e përgjithshme e mallrave shqiptare tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të 15 000 (pesëmbëdhjetë) eurove, fatura ose dokumenti i transportit i përmendur në pikën 3, të nenit 262, e plotësuar dhe e nënshkruar siç duhet nga personi në fjalë, do të miratohet (vërtetohen) nga zyra doganore kompetente.

Neni 265
Miratimi i dokumenteve T2L
(Pika 2, neni 142, të Kodit)

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të provës së Republikës së Shqipërisë, sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, kur DPD ka siguruar mundësinë e përdorimit të mjeteve të tjera nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave, zyra doganore kompetente miraton dokumentet T2L dhe kur është e nevojshme, çdo fletë plotësuese ose listë ngarkesat e përdorura.

Neni 266
Miratimi i manifestit të kompanisë së transportit detar
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të provës së Republikës së Shqipërisë, sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, me kërkesë të kompanisë së anijeve, manifesti i plotësuar dhe nënshkruar siç duhet, miratohet nga zyra kompetente doganore.

Neni 267
Autorizimi lidhur me manifestin "e ditës pasuese"
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të provës së Republikës së Shqipërisë, sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të autorizojnë që manifesti i përmendur në pikën 2, të nenit 262, që shërben për të treguar statusin doganor të mallrave shqiptare, të hartohet maksimumi një ditë pas largimit të anijes. Megjithatë, manifesti hartohet gjithmonë para ardhjes së anijes në portin e destinacionit.

Nënseksioni 3
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare

Neni 268
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare sipas një dokumenti "T2L"
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas planit të punës së ministrit të financave dhe kur lëshohet një dokument "T2L" në letër, do të zbatohen:

a) Personi i interesuar shënon "T2L" në nënndarjen e djathtë të kutisë 1, të formularit, dhe "T2Lbis" në nënndarjen e djathtë të kutisë 1, të çdo flete në vazhdim;

b) Autoritetet doganore mund të autorizojnë çdo person për të përdorur listëngarkesat, të cilat nuk janë në përputhje me të gjitha kërkesat, kur këta persona:

- janë vendosur në Republikën e Shqipërisë;
- lëshojnë rregullisht prova të statusit doganor të mallrave shqiptare ose autoritetet doganore vlerësojnë se këta persona plotësojnë detyrimet ligjore për përdorimin e këtyre provave;
- nuk kanë kryer shkelje serioze ose të përsëritura në fushën tatimore ose doganore.

c) Autorizimi i përmendur në shkronjën "b" jepet vetëm kur:

- autoritetet doganore janë në gjendje të mbikëqyrin procedurën dhe të kryejnë kontrolle pa një përpjekje - administrative joproporcionale me kërkesat e personit në fjalë; dhe
- personi në fjalë mban të dhënat të cilat mundësojnë autoritetet doganore të kryejnë kontrolle efektive.

ç) Dokumenti "T2L" duhet të hartohet në origjinal.

d) Kur miratohet nga autoriteti doganor, për aq sa është e mundur, duhet të paraqiten në kutinë "C", 'Zyra e nisjes', elementët e mëposhtëm:

- në rastin e dokumentit "T2L", emri dhe vula e zyrës kompetente, nënshkrimi i një zyrtari të kësaj zyre, - - data e nënshkrimit, por jo numri i regjistrimit ose numri i mbylljes së deklaratës, përveçse kur ajo kërkohet;
- në rastin e fletëve në vazhdim ose të listëngarkesës, numri i shfaqur në dokumentin "T2L" paraqitet me anë të një vule ose e shënuar me dorë, duke përfshirë emrin e zyrës kompetente. Kur numri i dokumentit shënohet me dorë, ajo duhet të shoqërohet me vulën zyrtare të zyrës në fjalë.

2. Dokumentet duhet t'i kthehen personit të interesuar.

Neni 269
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare në formën e të dhënave të dokumentit T2L
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Kur tregohet MRN për të vërtetuar statusin doganor si mallra shqiptare, të dhënat e dokumentit T2L, që shërbejnë si bazë për MRN, mund të përdoren vetëm për paraqitjen e parë të mallrave.

Kur dokumenti T2L përdoret vetëm për një pjesë të mallrave në paraqitjen e tyre të parë, një provë e re do të jepet për pjesën e mbetur të mallrave në përputhje me nenet 260 dhe 263.

2. Udhëtarët, të ndryshëm nga operatorët ekonomikë, do të dorëzojnë kërkesat e tyre për miratimin e një dokumenti T2L duke përdorur formularin e përcaktuar në aneksin 51-01, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 270
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare në formën e një manifesti doganor të mallrave
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Çdo manifest doganor i mallrave merr një MRN. Një manifest i tillë mund të marrë një MRN vetëm kur mbulon mallra që kanë statusin doganor të mallrave shqiptare, të ngarkuara në anije në një port të Republikës së Shqipërisë.

2. Autoritetet doganore mund të pranojnë që të përdoren sistemet informatike të operatorëve ekonomik, të portit apo të transportit, për paraqitjen e kërkesës për miratimin dhe regjistrimin e manifestit doganor të mallrave dhe paraqitjen e tij në zyrën doganore kompetente, me kusht që sisteme të tilla të përmbajnë gjithë informacionin e kërkuar për një manifest të tillë.

Nënseksioni 4
Provat e dorëzuara përmes mjeteve të tjera përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave

Neni 271
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për udhëtarë, të ndryshëm nga operatorët ekonomikë
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Një udhëtar, i cili nuk është operator ekonomik, mund të bëjë një kërkesë me shkrim në letër për të provuar statusin doganor të mallrave shqiptare.

Neni 272
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare nëpërmjet lëshimit të një fature apo dokumenti transporti
(Neni 17, pikat 2 e 3, shkronja "a", i Kodit)

1. Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare, vlera e të cilave nuk e tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, mund të paraqitet me ndonjë prej mjeteve të mëposhtme, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave:

a) faturë në lidhje me mallrat;
b) dokument transporti në lidhje me mallrat.

Fatura ose dokumenti i transportit, të përmendura në pikën 1, duhet të përfshijë të paktën emrin e plotë dhe adresën e dërguesit apo të personit të interesuar kur nuk ka dërgues, zyrën kompetente doganore, numrin e kolive, llojin, shenjat dhe numrat e referencës së tyre, përshkrimin e mallrave, peshën bruto (kg), vlerën e tyre dhe, nëse është e nevojshme, numrat e kontejnerëve.

2. Dërguesi ose personi i interesuar, kur nuk ka dërgues, do të identifikojë statusin doganor të mallrave shqiptare duke treguar kodin "T2L", sipas rastit, të shoqëruar me nënshkrimin e tij në faturë apo në dokumentin e transportit.

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, kur miratohet nga autoriteti doganor, dokumenti duhet të përmbajë emrin dhe vulën e

zyrës kompetente doganore, nënshkrimin e një zyrtari të kësaj zyre dhe datën e miratimit dhe numrin e regjistrimit ose numrin e mbylljes së deklaratës, kur kjo është e nevojshme.

Neni 273
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për mallrat, vlera e të cilave nuk i kalon 15 000 euro
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Në rastin e mallrave që kanë statusin doganor të mallrave shqiptare, vlera e të cilave nuk tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të 15 000 eurove, statusi doganor i mallrave shqiptare mund të provohet përmes paraqitjes së faturës apo dokumentit të transportit për këto mallra, me kusht që të lidhet vetëm me mallrat që kanë statusin doganor të mallrave shqiptare.

Neni 274
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare nga lëshimi i manifestit i një shoqërie të transportit detar
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, manifesti i shoqërive të transportit detar përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin dhe adresën e plotë shoqërisë së transportit detar;

b) Emrin e mjetit lundrues;

c) Vendin dhe datën e ngarkimit;

ç) Vendin e shkarkimit.

2. Manifesti, për çdo dërgesë, duhet të përfshijë gjithashtu:

a) referencën për faturën e ngarkimit ose çdo dokument tjetër tregtar;

b) numrin, përshkrimin, shenjat dhe numrat e referencës të pakove;

c) përshkrimin e mallrave, përfshirë detaje të mjaftueshme për të mundësuar identifikimin e tyre;

ç) peshën bruto në kg;

d) numrat e identifikimit të mjeteve lundruese kur është e aplikueshme;

dh) të dhënat për të përcaktuar statusin e mallrave, si më poshtë:

- Shkronja "C" (ekuivalente me "T2L"), për mallrat të cilat statusi doganor i mallrave shqiptare mund të vërtetohet;

- Shkronja "N" për të gjitha mallrat e tjera.

3. Kur miratohet nga autoriteti doganor, manifesti i shoqërisë së transportit detar duhet përfshijë emrin dhe vulën e zyrës kompetente doganore, nënshkrimin e një zyrtari të asaj zyre dhe datën e miratimit.

Neni 275
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare në Carnet TIR, Carnet ATA ose formularin 302
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Kur mallrat shqiptare transportohen në përputhje me Konventën TIR, Konventën ATA, Konventën e Stambollit ose marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, në lidhje me statusin e forcave të tyre, të nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, prova e statusit doganor të mallrave shqiptare mund të paraqitet me mjete të tjera përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 276
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare në Carnet TIR ose ATA apo formularin 302
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Në përputhje me nenin 275, mallrat shqiptare do të identifikohen në Carnet TIR apo ATA ose në formularin 302 me anë të kodit 'T2L'. Mbajtësi i regjimit, sipas rastit, mund të përfshijë një nga këto kode, shoqëruar me nënshkrimin e tij në dokumentet përkatëse në hapësirën e rezervuar për përshkrimin e mallrave para paraqitjes në zyrën doganore të nisjes për autentifikim. Kodi i përshtatshëm 'T2L' duhet të autentifikohet me vulën e zyrës doganore të nisjes, shoqëruar nga nënshkrimi i zyrtarit kompetent.

Në rast të një formulari elektronik 302, mbajtësi i regjimit mund të përfshijë edhe një nga këto kode në formularin 302 të të dhënave. Në këtë rast, autentifikimi nga zyra e nisjes, bëhet në rrugë elektronike.

2. Kur Carnet TIR, Carnet ATA ose formulari 302, mbulojnë si mallra shqiptare, ashtu dhe ato jo shqiptare, mallra të tillë do të jenë të listuara veçmas dhe kodi 'T2L', sipas rastit, do të vendoset në një mënyrë të tillë që, në mënyrë të qartë, të ketë të bëjë vetëm me mallrat shqiptare.

Neni 277
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për automjetet rrugore të motorizuara
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Në rastin e mjeteve rrugore të motorizuara të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë larguar përkohësisht dhe kanë rihyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, statusi doganor i mallrave shqiptare do të konsiderohet i provuar kur ato janë të shoqëruara nga targa e tyre dhe dokumentet e regjistrimit, dhe kur të dhënat e regjistrimit të treguara në targë dhe në dokumente tregojnë qartë këtë regjistrim.

2. Kur statusi doganor i mallrave shqiptare nuk mund të konsiderohet i provuar në përputhje me pikën 1, prova e statusit doganor të mallrave shqiptare do të sigurohet nga një prej mjeteve të tjera të renditura në nenin 262.

Neni 278
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për paketimin
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Në rastin e paketimit, paletat dhe pajisje të tjera të ngjashme, duke përjashtuar kontejnerët, që i përkasin një personi të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë përdorur për transportin e mallrave që janë larguar përkohësisht dhe rihyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë statusi doganor i mallrave shqiptare konsiderohet i provuar kur paketimi, paletat dhe pajisje të tjera të ngjashme mund të identifikohen se i përkasin atij personi, janë deklaruar se kanë statusin doganor të mallrave shqiptare dhe nuk ka dyshim te vërtetësia e deklarimit.

2. Kur statusi doganor i mallrave shqiptare nuk mund të konsiderohet i provuar në përputhje me pikën 1, prova e statusit doganor të mallrave shqiptare, do të sigurohet nga një prej mjeteve të tjera të renditura në nenin 262.

Neni 279
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për mallrat në bagazhet e mbajtura nga një pasagjer
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Në rastin e mallrave të bagazheve të mbajtura nga një pasagjer, të cilat nuk janë të destinuara për përdorim tregtar dhe janë larguar përkohësisht dhe rihyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, statusi doganor i mallrave shqiptare do të konsiderohet i provuar, kur udhëtari deklaron se ato kanë statusin doganor të mallrave shqiptare dhe nuk ka dyshime te vërtetësia e deklaratës.

Neni 280
Verifikimi i mjeteve të provës dhe ndihma administrative
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Degët doganore dhe autoritetet kompetente duhet të ndihmojnë në kontrollin e origjinalitetit dhe saktësinë e mjeteve të provës të përmendur në nenin 262 dhe në verifikimin se informacioni dhe dokumentet e dhëna në përputhje me dispozitat e këtij titulli dhe nenet 260, 261, 271 , 272, 275, 281, 282, 286, 287, 288, janë të sakta dhe se procedurat e përdorura për të vërtetuar statusin doganor të mallrave shqiptare janë zbatuar në mënyrë korrekte.

Nënseksioni 5
Dispozita të veçanta në lidhje me produktet e peshkimit dhe mallrat e përftuara nga produkte të tilla

Neni 281
Statusi doganor i produkteve të peshkimit dhe mallrave të përftuara nga produkte të tilla
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Për të provuar statusin doganor të produkteve dhe mallrave të listuara në shkronjat "ç" e "d", të pikës 1, të nenit 259, si mallra shqiptare, pranohet se këto mallra janë transportuar direkt në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Nga anijet e peshkimit të Republikës së Shqipërisë, të cilat kapin produktet dhe, në rastet kur është e mundur, bëjnë përpunimin e tyre;

b) Nga anijet e peshkimit të Republikës së Shqipërisë që transbordojnë produktet nga anijet e përmendura në shkronjën "a";

c) Nga anijet-fabrikë të Republikës së Shqipërisë, të cilat përpunojnë produktet pas transbordit të tyre nga anijet e referuara në shkronjën "a";

ç) Nga ndonjë anije tjetër, në të cilën produktet dhe mallrat janë transborduar nga anijet e përmendura në shkronjat "a", "b" ose "c", pa bërë ndonjë ndryshim të mëtejshëm;

d) Nga një mjet transporti që shoqërohet nga një dokument i vetëm transporti i lëshuar në një vend apo territor që nuk është pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin produktet apo mallrat janë shkarkuar nga anijet e përmendura në shkronjat "a", "b", "c" ose "ç".

Neni 282
Prova e statusit doganor të produkteve të peshkimit dhe mallrave të përftuara nga produkte të tilla
(Neni 17, pikat 2 e 3, shkronja "a", të Kodit)

1. Për të provuar statusin doganor në përputhje me nenin 281, ditari i peshkimit, deklarata e zbarkimit, deklarata e transbordit dhe të dhënat e sistemit të monitorimit të anijes, sipas rastit, siç kërkohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

a) Vendin, ku produktet e peshkimit janë kapur, duke lejuar që të përcaktohet se produktet apo mallrat kanë statusin doganor të mallrave shqiptare në përputhje me nenin 281;

b) Produktet e peshkimit (emri dhe lloji) dhe peshën bruto të tyre (kg);

c) Llojin e mallrave të përftuara nga produktet e peshkimit të përmendura në shkronjën "b", të përshkruara në një mënyrë të tillë që të lejojë klasifikimin e tyre sipas Nomenklaturës së Kombinuar dhe peshën e tyre bruto (kg).

2. Në rastin e transbordimit të produkteve dhe mallrave të përmendura në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 259, në një anije peshkimi të Republikës së Shqipërisë ose anije-fabrikë të Republikës së Shqipërisë (anije marrëse), në ditarin e peshkimit ose deklaratën e transbordit të një anijeje të tillë, nga e cila këto produkte dhe mallra janë transborduar, përfshihen, përveç informacionit të listuar në pikën 1, edhe emri, flamuri i shtetit, numri i regjistrimit dhe emir i plotë i kapitenit të anijes marrëse në të cilën janë transborduar produktet dhe mallrat.

Ditari i peshkimit ose deklarata e transbordit të anijes marrëse përfshin, përveç informacionit të listuar në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, edhe emrin, flamurin e shtetit, numrin e regjistrimit dhe emrin e plotë të kapitenit të anijes së peshkimit të Republikës së Shqipërisë ose anijes-fabrikë të Republikës së Shqipërisë nga e cila janë transborduar produktet apo mallrat.

3. Për qëllime të pikave 1 dhe 2, autoritetet doganore pranojnë të shkruar në letërditarin e peshkimit, deklaratën e zbarkimit ose të transbordimit, për anijet që kanë një gjatësi të përgjithshme të barabartë ose më shumë se 10 metra, por jo më shumë se 15 metra.

Neni 283
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për produktet e peshkimit detar dhe mallrave të përftuara nga produkte të tilla
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Ku produktet dhe mallrat e përmendura në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 259, janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 281, statusi doganor i mallrave shqiptare provohet nga regjistrimi në ditarin e udhëtimit të peshkimit, deklarata e zbarkimit në tokë, deklarata e transbordit dhe monitorimit të të dhënave të sistemit të anijes, sipas rastit, siç kërkohet në përputhje me legjislacionin për peshkimin.

Megjithatë, autoritetet doganore të cilat janë përgjegjëse për portin e shkarkimit në Republikën e Shqipërisë, në të cilin ato produkte dhe mallra janë transportuar drejtpërsëdrejti nga anija shqiptare e peshkimit, e cila ka kapur produktet dhe, kur është e zbatueshme, i ka përpunuar ato, mund të marrë në konsideratë se statusi doganor i mallrave shqiptare provohet në njërën nga rastet e mëposhtme:

a) Nuk ka asnjë dyshim në lidhje me statusin e këtyre produkteve dhe/ose mallrave;

b) Anija e peshkimit ka një gjatësi të përgjithshme prej më pak se 10 metra.

Neni 284
Produktet e peshkimit detar dhe mallrat e përftuara nga produkte të tilla të transborduara dhe të transportuara përmes një vendi apo territori i cili nuk është pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Kur, para mbërritjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë produktet apo mallrat e përmendura në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 259, janë transborduar dhe transportuar përmes një vendi ose territori, që nuk është pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një

certifikim nga organi doganor i atij vendi që produktet apo mallrat ishin nën mbikëqyrje doganore, ndërkohë që ishin në atë vend dhe nuk kanë pësuar asnjë përpunim tjetër veç përpunimit të nevojshëm të tyre për ruajtjen, do të paraqitet për ato produkte dhe mallra në hyrjen e tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Certifikimi për produktet dhe mallrat e transborduara dhe të transportuara përmes një vendi tjetër, do të bëhet në një kopje të ditarit të peshkimit të përmendur në nenin 288, shoqëruar, kur është rasti, nga një kopje e deklaratës së transbordimit.

Neni 285
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për produkte të peshkimit detar dhe produkte të tjera të marra ose të kapura nga anijet që mbajnë flamurin e një vendi tjetër në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për produkte të peshkimit detar dhe produkte të tjera të marra ose të kapura nga anijet që mbajnë flamurin e një vendi tjetër në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, do të sigurohet përmes ditarit të udhëtimit të peshkimit ose çdo mjeti tjetër të përmendur në nenin 262.

Neni 286
Transbordi
(Pika 3, e nenit 17, të Kodit)

1. Në rast të transbordit të produkteve dhe mallrave të përmendura në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 259, për anije të tjera marrëse, përveç anijeve të peshkimit të Republikës së Shqipërisë ose anijeve-fabrikë të Republikës së Shqipërisë, prova e statusit doganor të mallrave shqiptare jepet me anë të një kopjeje të deklaratës së transbordimit të anijes marrëse, e shoqëruar nga një kopje e ditarit të peshkimit, e deklaratës së transbordit dhe të dhënave të sistemit të monitorimit të anijes, sipas rastit, nga anijet e peshkimit të Republikës së Shqipërisë ose anijet-fabrikë të Republikës së Shqipërisë nga të cilat janë transborduar produktet apo mallrat.

2. Në rast se ka më shumë se një transbordim duhet të dorëzohet, gjithashtu, një kopje e të gjitha deklaratave të transbordit.

Neni 287
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për produkte të peshkimit dhe produkte të tjera të marra apo të kapura nga anijet që mbajnë flamurin e një vendi të tjetër, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare për produktet e peshkimit dhe produkte të tjera të marra ose të kapura nga anijet që mbajnë flamurin e një vendi të tjetër, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, mund të sigurohet me anë të një kopjeje të ditarit të peshkimit.

Neni 288
Produktet dhe mallrat e transborduara dhe të transportuara nëpërmjet një vendi apo territori, i cili nuk është pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

Kur produktet dhe mallrat e përmendura në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 259, janë transborduar dhe transportuar nëpërmjet një vendi apo territori që nuk është pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një kopje e ditarit të peshkimit të anijes së peshkimit të Republikës së Shqipërisë ose e anijes-fabrikë të Republikës së Shqipërisë, e shoqëruar nga një kopje e deklaratës së transbordimit, kur është e zbatueshme, duhet të sigurohet dhe të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) Miratimin nga autoritetet doganore të vendit tjetër;

b) Datën e mbërritjes dhe të nisjes nga vendi tjetër të produkteve dhe mallrave;

c) Mjetet e transportit të përdorura për ridërgim drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

ç) Adresën e autoritetit doganor të përmendur në shkronjën "a".

Nënseksioni 6
Sistemi elektronik lidhur me provën e statusit doganor

Neni 289
Sistemi elektronik lidhur me provën e statusit doganor të mallrave shqiptare
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

Për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit lidhur me provën e statusit doganor të mallrave shqiptare, parashikuar në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 262, do të ngrihet një sistem elektronik në bazë të pikës 1, të nenit 17, të Kodit.

Paragrafi i parë i këtij neni do të zbatohet nga implementimi i sistemit të informatizuar të statusit shqiptar, të përmendur në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Seksioni 2
Statusi i lëshuesit të autorizuar

Nënseksioni 1
Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare e lëshuar nga një lëshues i autorizuar

Neni 290
Lehtësira për lëshimin e një prove nga një lëshues i autorizuar
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Çdo person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që përmbush kriteret e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të nenit 41, të Kodit, mund të autorizohet të lëshojë:

a) dokumentin T2L, pa qenë e nevojshme të kërkojë miratim;

b) manifestin doganor të mallrave, pa qenë e nevojshme të kërkojë miratimin dhe regjistrimin e provës nga zyra doganore kompetente.

2. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të autorizojnë çdo person të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, që aplikon për të qenë i autorizuar të lëshojë statusin doganor të mallrave shqiptare me anë të një fature ose një dokumenti transporti, lidhur me statusin e mallrave, vlera ekuivalente në lekë e të cilave tejkalon 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, një dokument 'T2L' ose manifesti të një shoqërie të transportit detar, të përdorë këto dokumente, pa pasur nevojë për t'i paraqitur ato për miratim në zyrën doganore kompetente.

3. Autorizimet e përmendura në pikat 1 dhe 2 lëshohen nga zyra doganore kompetente me kërkesë të personit të interesuar.

4. Autorizimi, i referuar në pikën 2, jepet vetëm kur:

a) personi i interesuar nuk ka kryer asnjë shkelje serioze ose të përsëritur në fushën doganore apo tatimore;

b) autoritetet doganore janë në gjendje të mbikëqyrin procedurën dhe të kryejnë kontrolle pa një përpjekje administrative joproporcionale me kërkesat e personit të interesuar;

c) personi i interesuar mban të dhëna, të cilat u mundësojnë autoriteteve doganore të kryejnë kontrolle efektive; dhe

ç) personi i interesuar lëshon rregullisht vërtetimin e statusit doganor për mallrat shqiptare apo autoritetet doganore kompetente vlerësojnë se ai mund të përmbushë detyrimet ligjore për përdorimin e këtyre provave.

5. Kur personit të interesuar i është dhënë statusi i OEA, në përputhje me nenin 40 të Kodit, kushtet e listuara sipas shkronjave "a", deri "c", të pikës 4 të këtij neni, konsiderohen të përmbushura.

Neni 291
Formalitetet për lëshimin e një dokumenti "T2L", një fature ose dokumenti transporti nga një lëshues i autorizuar
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas Planit të punës së ministrit t përgjegjës për financat, lëshuesi i autorizuar duhet të bëjë një kopje të secilit dokument të lëshuar "T2L". Autoritetet doganore duhet të specifikojnë kushtet nën të cilat do të paraqitet kopja për qëllime doganore dhe të ruhet për të paktën tre vjet.

2. Autorizimi i përmendur në pikën 2, të nenit 290, duhet të specifikojë, në mënyrë të veçantë:

a) përgjegjësinë e zyrës doganore të caktuar për të vërtetuar, paraprakisht, formularët "T2L" të përdorur për hartimin e dokumenteve në fjalë, për qëllime të nenit 292, pika 1;

b) mënyrën sipas së cilës lëshuesi i autorizuar duhet të vendosë se formularët janë përdorur siç duhet;

c) kategoritë e përjashtuara ose lëvizjet e mallrave;

ç) periudhën brenda së cilës dhe mënyrën përmes së cilës lëshuesi i autorizuar njofton zyrën doganore kompetente në mënyrë që kryhen të gjitha kontrollet përpara nisjes së mallrave.

d) pjesën e përparme të dokumenteve tregtare në fjalë ose kutinë 'C', "Zyra e nisjes", në faqet e para të formularit, e përdorur për qëllimet e plotësimit të dokumenteve "T2L" dhe, sipas rastit, fletët në vazhdim:

i. e vulosur paraprakisht me vulën e zyrës doganore të referuar në shkronjën "a" të pikës 2 dhe e nënshkruar nga një zyrtar i asaj zyre; ose

ii. e vulosur nga një lëshues i autorizuar me një vulë të veçantë. Vula mund të vendoset paraprakisht në formular, nga një person i miratuar për këtë qëllim. Kutitë 1 dhe 2 dhe 4 deri në 6 në lidhje me vulën e veçantë duhet të plotësohet me informacionin e mëposhtëm:

- stemën apo ndonjë shenjë të tjera ose letër që karakterizon vendin;
- zyrën doganore kompetente;
- datën;
- lëshuesin e autorizuar; dhe
- numrin e autorizimit.

dh) Nga momenti i dërgimit të mallrave, lëshuesi i autorizuar plotëson dhe firmos formularin. Tregon gjithashtu kutinë "D. Kontrolli i zyrës doganore të nisjes" të dokumentit "T2L", ose në një pikë qartësisht të dukshme në dokumentin tregtar të përdorur, emrin e zyrës doganore kompetente, datën e hartimit të dokumentit dhe dërguesi i autorizuar.

Nënseksioni 2
Lehtësirat

Neni 292
Lehtësira për një lëshues të autorizuar
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas Planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, lëshuesi i autorizuar mund të autorizohet të mos nënshkruajë dokumentin 'T2L' ose dokumentet tregtare të përdorura që mbajnë vulën e veçantë sipas nënndarjes "ii", të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 291, të cilat janë hartuar nga një sistem elektronik i shkëmbimit dhe përpunimit të të dhënave. Për një autorizim të tillë lëshuesi i autorizuar i paraqet autoritetit doganor paraprakisht një marrëveshje me shkrim, ku njeh përgjegjësinë e tij për pasojat juridike që rrjedhin nga dokumenti 'T2L' ose dokumentet tregtare që mbajnë vulën e veçantë.

2. Dokumentet 'T2L' ose dokumentet tregtare të hartuara në përputhje me pikën 1 duhet të përmbajnë në vend të nënshkrimit të lëshuesit të autorizuar shënimin: - Firma hiqet.

Neni 293
Autorizimi për të plotësuar manifestin e shoqërive të transportit detar pas nisjes
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas Planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë mund të autorizojnë shoqëritë e transportit detar për të mos plotësuar manifestin e shoqërive të transportit detar përmendur në pikën 2, të nenit 262, që shërbejnë për të treguar statusin doganor të mallrave shqiptare, jo më vonë se një ditë pas largimit të anijes dhe, në çdo rast, para mbërritjes së saj në portin e destinacionit.

Neni 294
Kushtet për autorizimin për të plotësuar manifestin e shoqërive të transportit detar pas nisjes
(Pika 2, e nenit 142, të Kodit)

1. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar për provën e statusit doganor të mallrave sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, autorizimi për të mos plotësuar manifestin e shoqërive të transportit detar, që shërben për të vërtetuar statusin doganor të mallrave shqiptare jo më vonë se një ditë pas nisjes së mjetit të lundrimit dhe, në çdo rast, para ardhjes së tij në portin e destinacionit, do të jepet vetëm për shoqëritë e transportit detar ndërkombëtare, të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Janë vendosura në Republikën e Shqipërisë;

b) Personi i interesuar lëshon rregullisht vërtetimin e statusit doganor për mallrat shqiptare apo autoritetet doganore kompetente vlerësojnë se ai mund të përmbushë detyrimet ligjore për përdorimin e këtyre provave;

c) Nuk kanë kryer ndonjë shkelje serioze ose të përsëritur në fushën doganore apo tatimore;

ç) Përdorin sistemet elektronike të shkëmbimit të të dhënave për të shkëmbyer informacion midis portit të nisjes dhe destinacionit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

d) Ndërmarrin një numër të konsiderueshëm udhëtimesh në Republikën e Shqipërisë në rrugët e njohura.

2. Autorizimi i përmendur në pikën 1 jepet vetëm kur:

a) autoritetet doganore janë në gjendje të mbikëqyrin procedurën dhe të kryejnë kontrolle pa një përpjekje administrative joproporcionale me kërkesat e personit në fjalë; dhe

b) personi në fjalë mban të dhënat, të cilat umundësojnë autoriteteve doganore të kryejnë kontrolle efektive.

3. Kur personi i interesuar është mbajtës i një certifikate OEA, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 40, të Kodit, kërkesat e parashikuara në pikat 1, shkronja "c", dhe 2, shkronja "b", të këtij neni, konsiderohen të përmbushura.

4. Me marrjen e kërkesës, autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë, aty ku shoqëria e transportit detar është vendosur njofton autoritetet doganore të porteve të nisjes dhe destinacionit sipas kërkesës.

Nëse nuk ka kundërshtim brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, nga data e njoftimit, autoritetet doganore duhet të autorizojnë përdorimin e procedurës së thjeshtuar të përshkruar në nenin 293.

Ky autorizim është i vlefshëm në Republikën e Shqipërisë dhe zbatohet vetëm për transportin midis porteve të cilave i referohet.

5. Për thjeshtimin veprohet, si më poshtë vijon:

a) Manifesti për portin e nisjes transmetohet nga sistemi elektronik i shkëmbimit të të dhënave në portin e destinacionit;

b) Shoqëria e transportit detar përfshin në manifest informacionin e treguar në nenin 274;

c) Manifesti i transmetuar nëpërmjet sistemit elektronik të shkëmbimit të të dhënave (manifesti i shkëmbimit të të dhënave) paraqitet pranë autoriteteve doganore në portin e nisjes jo më vonë se ditën e punës pas ditës së nisjes së anijes dhe, në çdo rast, përpara mbërritjes në portin e destinacionit. Autoritetet doganore mund të kërkojnë të paraqitet një kopje në letër e manifestit të shkëmbimit të të dhënave, kur nuk kanë akses në një sistem informacioni të tillë, siç është miratuar nga autoritetet doganore që mbajnë këtë sistem të shkëmbimit të të dhënave të manifestit.

ç) Manifesti i paraqitur nëpërmjet sistemit elektronik të shkëmbimit të të dhënave paraqitet pranë autoriteteve doganore në portin e destinacionit. Autoritetet doganore mund të kërkojnë t'u paraqitet një kopje në letër e manifestit të paraqitur nëpërmjet sistemit të shkëmbimit të të dhënave, kur ata nuk kanë akses në një sistem informacioni të miratuara nga autoritetet doganore që përmbajnë manifestin e shkëmbimit të të dhënave.

6. Njoftimet duhet të bëhen, si më poshtë vijon:

a) Kompanitë dhe mjeteve të lundrimit duhet të njoftojnë të gjitha shkeljet e parregullsitë tek autoritetet doganore;

b) Autoritetet doganore në portin e destinacionit duhet të njoftojnë autoritetet doganore në portin e nisjes dhe autoritetin doganor që ka lëshuar autorizimin për të gjitha shkeljet dhe parregullsitë në rastin e parë.

Seksioni 3
Shërbimi i rregullt i transportit detar për qëllime doganore

Neni 295
Autorizimi për të lejuar shërbime të rregullta të transportit detar
(Pika 2, e nenit 144, të Kodit)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të japë një autorizim për një shoqëri të transportit detar për qëllime të shërbimeve të rregullta të transportit detar, duke i dhënë të drejtën e lëvizjes të mallrave shqiptare nga një pikë në tjetrën, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përkohësisht jashtë këtij territori, pa ndryshimin e statusit doganor të tyre.

2. Autorizimi i jepet shoqërisë së transportit detar vetëm në rastet kur:

a) është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) plotëson kriterin e përcaktuar në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit;

c) merr përsipër, t'i komunikojë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave informacionin që referohet në pikën 1, të nenit 296, pasi është

lëshuar autorizimi; dhe

ç) merr përsipër, të mos bëjë ndalesa në rrugët e shërbimit të rregullt të transportit detar, në asnjë port jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë apo në zonë të lirë të një porti të Republikës së Shqipërisë dhe që të mos kryejë transbordim të mallrave në det.

3. Shoqëria e transportit detar, që ka marrë një autorizim në përputhje me këtë nen, ofron shërbim të rregullt të transportit detar të përcaktuar në autorizim.

Shërbimi i rregullt i transportit detar sigurohet duke përdorur anije të regjistruara për këtë qëllim në përputhje me nenin 296.

Neni 296
Regjistrimi i anijeve dhe porteve
(Nenet 27, pika 4, dhe 144, pika 2, të Kodit)

1. Shoqëria e autorizuar për transportin detar, për të krijuar shërbime të rregullta të transportit detar për qëllime të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 259, duhet të regjistrojë anijet që do të përdorë dhe portet ku do të ndalet për qëllimet e këtij shërbimi, duke i komunikuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave informacionet e mëposhtme:

a) Emrat e anijeve që do të përdorë për shërbimin e rregullt të transportit detar;

b) Portin, ku anija fillon veprimtarinë e saj si një shërbim i rregullt i transportit detar;

c) Portet e ndalimit.

2. Regjistrimi i përmendur në pikën hyn në fuqi në ditën e parë të punës që pason atë të regjistrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Shoqëria e autorizuar për të ofruar shërbime të rregullta të transportit detar për qëllime të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 259, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo ndryshim në informacionin e përcaktuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1, si dhe datën e orën kur ky ndryshim hyn në fuqi.

Neni 297
Rrethana të paparashikuara gjatë shërbimeve të rregullta të transportit detar
(Nenet 142, pika 1, dhe 144, pika 2, të Kodit)

Kur një anije e regjistruar në një shërbim të rregullt të transportit detar për qëllimet e shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 259, si rezultat i rrethanave të paparashikuara gjatë transportit të mallrave në det, ndalon, ngarkon apo shkarkon mallra në një port jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në një port që nuk është pjesë e shërbimit të rregullt të transportit detar ose në një zonë të lirë të një porti të Republikës së Shqipërisë, atëherë statusi doganor i këtyre mallrave nuk do të ndryshohet, nëse ato ngarkohen apo shkarkohen në ato vende.

Kur autoritetet doganore kanë arsye për të dyshuar nëse mallrat i plotësojnë këto kushte, atëherë statusi doganor i këtyre mallrave duhet të provohet.

Neni 298
Konsultimi i autoriteteve doganore nga ana e shërbimit të rregullt të anijeve
(Neni 27 i Kodit)

Para dhënies së një autorizimi të përmendur në nenin 295, pasi janë shqyrtuar nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 295, për dhënien e autorizimit, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit do të konsultohet me autoritetet doganore që preken nga ana e shërbimit të rregullt të anijeve për qëllim të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 259, si dhe autoritetet e tjera doganore, për të cilat aplikanti deklaron të ketë plane për të ardhme për shërbime të transportit të rregullt, në plotësimin e kushteve të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 295.

Afati për konsultim do të jetë 15 ditë, nga data kur autoriteti doganor kompetent komunikon kushtet dhe kriteret që duhet të shqyrtohen nga autoritetet doganore të konsultuara.

Neni 299
Regjistrimi i anijeve dhe porteve
(Neni 27 i Kodit)

Informacioni i regjistrimit të anijeve dhe porteve do të jetë në dispozicion të autoriteteve doganore që preken nga ana e shërbimit të rregullt të anijeve.

Neni 300
Rrethana të paparashikuara gjatë transportit nga shërbimet e rregullta të transportit detar
(Pika 2, e nenit 144, të Kodit)

Kur një anije e regjistruar në një shërbim të rregullt të anijeve, si rezultat i rrethanave të paparashikuara, transbordon në det, ndalon ose ngarkon apo shkarkon mallra në një port jashtë

territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në një port që nuk është pjesë e shërbimit të rregullt të anijeve, ose në një zonë të lirë të një porti të Republikës së Shqipërisë, shoqëria e lundrimit informon menjëherë për ndalesën autoritetet doganore të porteve pasuese të Republikës së Shqipërisë, përfshirë ato përgjatë rrugës së planifikuar të kësaj anijeje.

Data në të cilën anija rifillon punën e saj në shërbim të rregullt të anijeve, paraprakisht do t'i komunikohet autoriteteve doganore.

Neni 301
Verifikimi i kushteve për shërbimet e rregullta të transportit detar
(Neni 142 i Kodit)

1. Autoritetet doganore mund të kërkojnë prova nga kompania e lundrimit se janë respektuar dispozitat e parashikuara në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 2, dhe pika 3, e nenit 295, pikat 1 dhe 3, të nenit 296 si dhe neni 300.

2. Kur një autoritet doganor përcakton se dispozitat e përmendura në pikën 1, nuk janë respektuar nga kompania e lundrimit, autoriteti informon menjëherë autoritetet doganore të tjera që preken nga shërbimi i rregullt i anijeve.

Këto autoritete duhet të marrin masat e nevojshme.

Seksioni 4
Formularët për provën e statusit doganor

Neni 302
Formularët për provën e statusit doganor të mallrave shqiptare

1. Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për 'statusin doganor të mallrave shqiptare', autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera të ndryshme nga teknika elektronike të përpunimit të të dhënave për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit në lidhje me vërtetimin e statusit doganor të mallrave shqiptare.

2. Kur përdoren mënyra të tjera të ndryshme nga teknika elektronike të përpunimit të të dhënave për të provuar statusin doganor të mallrave shqiptare, dokumenti T2L do të sigurohet duke përdorur formularin Kopje 4, Titulli III të aneksit B-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Kur është e nevojshme, ky formular mund të plotësohet nga një ose më shumë fletë të vazhdueshme që i korrespondojnë kopjes 4, kapitulli IV, aneksi B-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e listëngarkesave duke përdorur formularin e paraqitur në Kreun II, Kapitulli III të aneksit 72-04, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në vend të fletëve të vazhdueshme si pjesën përshkruese e dokumentit T2L.

5. Kur autoritetet doganore përdorin teknika elektronike të përpunimit të të dhënave për të prodhuar dokumentin T2L dhe kjo nuk lejon përdorimin e fletëve të vazhdueshme sipas formës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, ai do të plotësohet nga një ose më shumë formularë që korrespondojnë me kopjen 4, përcaktuar në titullin III, aneksi B-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Kur një lëshues i autorizuar përdor vulën e veçantë, të përmendur në nenin 291, vula duhet të miratohet nga autoritetet doganore dhe të korrespondojë me modelin e përcaktuar në kapitullin II të kreut II të aneksit 72-04, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij. Zbatohen pika 23 dhe 23.1 e këtij aneksi.

KREU 2
Vendosja e mallrave në një regjim doganor

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 303
Sistemi elektronik në lidhje me vendosjen e mallrave nën një regjim doganor
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

1. Për përpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për vendosjen e mallrave në një regjim doganor, do të përdoren sistemet elektronike të ngritura në bazë të pikës 1, të nenit 17, të Kodit.

2. Pika 1, e këtij neni do të zbatohet nga data e implementimit të sistemit të informatizuar të importit, sipas planit të punës të miratuar nga ministri i përgjegjës për financat.

3. Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për Importin, sipas Planit të Punës së

ministrit përgjegjës për financat, kur janë përdorur mjete të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave për regjimet doganore të përmendura në pikën 4, deklaratat doganore mund të depozitohen duke përdorur formularët përkatës në aneksin B-01, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Deri në datën e implementimit të kodeve dhe formateve në sistemin e informatizuar të Import/Eksportit, sipas planit të punës të ministrit të përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e kodeve dhe formateve të përpunimit të të dhënave sipas sistemit kompjuterik doganor dhe kodeve të parashikuara në aneksin 5, të shtojcës C, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për paraqitjen e një deklarate doganore për vendosjen e mallrave nën një nga regjimet doganore të mëposhtme:

a) Çlirimin në qarkullim të lirë;
b) Magazinimin doganor;
c) Lejimin e përkohshëm;
ç) Përdorimin e veçantë përfundimtar (*end-use*);
d) Përpunimin aktiv;
dh) Eksport;
e) Rieksport;
ë) Transit.

Neni 304
Deklarata me gojë për vendosjen në qarkullim të lirë
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

1. Deklarata doganore për vendosjen në qarkullim të lirë mund të bëhet me gojë, për mallrat e mëposhtme:

a) Mallrat e natyrës jotregtare;

b) Mallrat e natyrës tregtare që gjenden në bagazhin personal të udhëtarëve, me kusht që ato të mos kalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1 000 (një mijë) euro vlerë ose 1 000 kg në peshë neto;

c) Produktet e përftuara nga fermerët shqiptarë, produktet nga fermat e peshkimit dhe aktivitetet e gjuetisë, në prona të vendosura në një vend tjetër, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimeve sipas neneve 432 deri 435;

ç) Farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe kulturave të importuara nga prodhuesit bujqësorë në vendet e tjera për përdorim në pronat fqinje me ato vende, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimeve në bazë të neneve 436 dhe 437.

2. Deklaratat doganore për vendosjen në qarkullim të lirë mund të bëhen me gojë për mallrat e përmendura në pikën 1, të nenit 305, me kusht që mallrat të përfitojnë përjashtim nga detyrimi i importit si mallra të kthyera.

Neni 305
Deklarata me gojë për lejim të përkohshëm dhe rieksport
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

1. Deklarata doganore për lejim të përkohshëm mund të bëhet me gojë për mallrat e mëposhtme:

a) Paletat, kontejnerët dhe mjetet e transportit, si dhe pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për paletat, kontejnerët dhe mjetet e transportit, siç referohet në nenet 653 deri 658;

b) Sendet personale dhe mallrat për qëllime sportive të referuara në nenin 664;

c) Materialet ndihmëse që përdoren nga detarët në bordin e një anijeje të trafikut detar ndërkombëtar të referuar në shkronjën "a" të nenit 665;

ç) Pajisjet mjekësore, kirurgjikale dhe laboratorike të referuara në nenin 667;

d) Kafshët e referuara në nenin 668, me kusht që ato të jenë të destinuara për kullotje, për punë apo transport;

dh) Pajisjet e referuara në shkronjën "a", të nenit 669;

e) Instrumentet dhe aparatet e nevojshme për një mjek për t'i ofruar ndihmë pacientit në pritje për transplant organesh në përputhje me kushtet e parashikuara në pilën 1, të nenit 671;

ë) Materialet ndihmëse në raste fatkeqësish të përdorura në lidhje me masat e marra për përballimin e pasojave të fatkeqësive apo situatave të ngjashme që prekin territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

f) Instrumentet portative muzikore të importuara përkohësisht nga udhëtarët dhe të destinuara për t'u përdorur si pajisje profesionale;

g) Paketimet/ambalazhet të cilat importohen të mbushura nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe janë të destinuara për rieksport, bosh ose të mbushura, dhe që kanë shenja identifikuese të qëndrueshme;

gj) Materialet për realizimin e prodhimeve radiofonike e televizive, pajisjet e transmetimit si dhe automjetet e përshtatura posaçërisht për përdorim për qëllime të prodhimit dhe transmetimit radioteleviziv dhe pajisjeve të tyre, të importuara nga organizatat publike ose private, të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të miratuara nga autoritetet doganore që lëshojnë autorizimin për lejimin e përkohshëm të pajisjeve e të mjeteve të tilla;

h) Mallra të tjera, kur autorizohet nga autoritetet doganore.

2. Deklarata e rieksportit mund të bëhet me gojë kur mbyllet regjimi i lejimit të përkohshëm për mallrat e përmendura në pikën 1.

Neni 306
Deklarata me gojë për eksport
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

1. Deklarata doganore për eksport mund të bëhet me gojë për mallrat e mëposhtme:

a) Mallrat e natyrës jotregtare;

b) Mallrat e natyrës tregtare me kusht që ato të mos kalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1 000 (një mijë) euro në vlerë ose 1 000 kg në peshë neto;

c) Mjetet e transportit të regjistruara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të destinuara për riimport dhe pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për mjetet e transportit;

ç) Kafshët shtëpiake të eksportuara në kohën e transferimit të aktiviteteve bujqësore nga Republika e Shqipërisë në një vend tjetër, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit doganor në bazë të pikës 1, të nenit 425;

d) Produktet e përftuara nga prodhuesit bujqësorë në pronat që gjenden në Republikën e Shqipërisë, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit doganor në bazë të neneve 432-434;

dh) Fara të eksportuara nga prodhuesit bujqësorë për përdorim në prona që ndodhen në vende të tjera, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit doganor në bazë të neneve 436 dhe 437;

e) Foragjeret dhe lëndët ushqyese që shoqërojnë kafshët gjatë eksportimit të tyre dhe që përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit doganor në bazë të nenit të 510.

2. Deklarata doganore për eksport mund të bëhet me gojë për mallrat e referuara në pikën 1, të nenit 305, kur këto mallra janë të destinuara për riimport.

Neni 307
Lëshimi i faturës për deklaratat me gojë
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

Kur deklarata doganore bëhet me gojë në përputhje me nenet 304 ose 306, për mallrat që i nënshtrohen detyrimit të importit ose eksportit ose pagesave të tjera, autoritetet doganore do të lëshojnë një faturë për personin e interesuar kundrejt pagesës të shumës për ato detyrime ose pagesave të tjera.

Fatura duhet të përfshijë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

a) Një përshkrim të saktë të mallrave për të mundësuar identifikimin e tyre;

b) Vlerën e faturës ose, kur kjo nuk është në dispozicion, sasinë e mallrave;

c) Shumën e detyrimit dhe pagesave të tjera të mbledhura;

ç) Datën në të cilën ajo është lëshuar;

d) Zyrën doganore që e ka lëshuar atë.

Neni 308
Mallra që konsiderohen si të deklaruara për çlirim në qarkullim të lirë, në përputhje me nenin 311
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

1. Në rast se nuk janë deklaruar me mjete të tjera, mallrat e mëposhtme konsiderohen se janë deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë në përputhje me nenin 311:

a) mallrat e natyrës jotregtare që ndodhen në bagazhet personale të udhëtarëve, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit të importit sipas nenit 438, ose si mallra të rikthyera;

b) mallrat e referuara në shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 1, të nenit 304;

c) mjetet e transportit të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit të importit si mallra të rikthyera në përputhje me nenin 185 të Kodit;

ç) instrumentet portative muzikore të riimportuara nga udhëtarët dhe që përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit të importit si mallra të rikthyera në përputhje me nenin 185 të Kodit;

d) artikujt e korrespondencës;

dh) mallrat në një dërgesë postare, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit të importit në përputhje me nenet 420 deri 424, të Këshillit të Ministrave.

2. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të importit sipas Planit të punës të ministrit përgjegjës për financat, do të zbatohen të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Sipas përcaktimit të shkronjës "dh", të pikës 1, vetëm kur mallrat në fjalë përfitojnë nga çlirimi nga detyrimet e tjera; dhe

b) Mallra, vlera e të cilave nuk i kalon 22 euro konsiderohen të deklaruara për çlirim për qarkullim të lirë, në përputhje me nenin 311.

Neni 309
Mallra që konsiderohen si të deklaruara për lejim të përkohshëm dhe rieksport, në përputhje me nenin 311
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

1. Kur nuk deklarohen me mjete të tjera, mallrat e referuara në shkronjat "d" deri në "g" të pikës 1, të nenit 305, konsiderohen se janë deklaruar për lejim të përkohshëm, në përputhje me nenin 311.

2. Kur nuk deklarohen me mjete të tjera, mallrat e referuara në shkronjat "d" deri në "g", të pikës 1, të nenit 305, konsiderohen se janë deklaruar për rieksport në përputhje me nenin 311, duke mbyllur regjimin e lejimit të përkohshëm.

Neni 310
Mallra që konsiderohen të deklaruara për eksport, në përputhje me nenin 311
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

Kur nuk deklarohen me mjete të tjera, mallrat e mëposhtme konsiderohen se janë deklaruar për eksport, në përputhje me nenin 311:

a) Mallrat e referuara në nenin 306;

b) Instrumentet muzikore portative të udhëtarëve.

Neni 311
Veprimet e konsideruara si deklaratë doganore
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

1. Në lidhje me mallrat e referuara në shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 308, nenet 309 dhe 310, secili prej veprimeve të mëposhtme konsiderohet si deklaratë doganore:

a) Kalimi nëpër korsinë e gjelbër ose "asgjë për të deklaruar" në një zyrë doganore, ku sistemi i dy korsive është në funksionim;

b) Kalimi nëpër një zyrë doganore, ku nuk funksionon sistemi me dy korsi;

c) Vendosja e një etikete ngjitëse "asgjë për të deklaruar" në xhamin e përparmë të automjeteve të udhëtarëve, kur kjo mundësi parashikohet me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

2. Artikujt e korrespondencës konsiderohen të deklaruara për çlirim në qarkullim të lirë me hyrjen e tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Artikujt e korrespondencës konsiderohen të deklaruara për eksport ose rieksport me daljen e tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Mallrat në një dërgesë postare, të cilat përfitojnë nga përjashtimi prej detyrimit të importit në përputhje me nenet 420 deri 424, konsiderohen të deklaruara për hedhje në qarkullim të lirë me paraqitjen e tyre në doganë në përputhje me nenin 130 të Kodit, me kusht që të dhënat e kërkuara të jenë pranuar nga autoritetet doganore.

4. Mallrat në një dërgesë postare që nuk kalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1 000 (një mijë) euro, të cilat nuk kanë detyrim eksporti, konsiderohen të deklaruara për eksport me daljen e tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

5. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të importit sipas Planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, mallrat, vlera e të cilave nuk kalon 22 euro konsiderohen të deklaruara për çlirim për qarkullim të lirë me paraqitjen e tyre në doganë, në përputhje me nenin 130, të Kodit, me kusht që të dhënat e kërkuara të jenë pranuar nga autoritetet doganore.

Neni 312
Formalitetet doganore që konsiderohet se janë kryer me anë të një akti të përmendur në pikën 1, të nenit 311
(Nenet 17, pika 3, shkronja "a" dhe 146, pika 2, të Kodit)

Për qëllimet e neneve 308, 309 dhe 310, formalitetet e mëposhtme doganore do të konsiderohen se janë kryer nga një akt i përmendur në pikën 1, të nenin 311:

a) Transporti i mallrave, në përputhje me nenin 126, të Kodit dhe paraqitjen e mallrave në doganë në përputhje me nenin 130, të Kodit;

b) Paraqitja e mallrave në doganë në përputhje me nenin 239, të Kodit;

c) Pranimi i deklaratës doganore nga autoritetet doganore në përputhje me nenin 157, të Kodit;

ç) Çlirimi i mallrave nga autoritetet doganore, në përputhje me nenin 175, të Kodit.

Neni 313
Mallra të cilat nuk mund të deklarohen me gojë ose në përputhje me nenin 311
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

Nenet 304 deri në 310 nuk zbatohen për:

a) mallrat për të cilat janë kryer formalitetet me qëllim marrjen e rimbursimeve ose përparësive financiare në eksport në bazë të politikave bujqësore;

b) mallrat në lidhje me të cilat është bërë një aplikim për rimbursim të detyrimit ose pagesave të tjera;

c) mallrat, të cilat janë objekt i një ndalimi apo kufizimi;

ç) mallrat, të cilat i nënshtrohen çdo formaliteti tjetër të posaçëm të parashikuar në legjislacionin në fuqi, për të cilat kërkohet që autoritetet doganore t'i vënë në zbatim.

Neni 314
Rastet kur një deklaratë doganore nuk konsiderohet të jetë paraqitur në përputhje me nenin 311
(Nenet 17, pika 3, shkronja "a" dhe 146, pika 2, të Kodit)

Kur një kontroll tregon se është kryer një veprim në përputhje me nenin 311, por mallrat që hyjnë apo dalin, nuk janë mallrat e përmendura në nenet 308, 309 dhe 310, deklarata doganore për këto mallra do të konsiderohet se nuk është paraqitur.

Neni 315
Deklarata doganore në letër
(Pika 2, e nenit 146, të Kodit)

Udhëtarët mund të paraqesin një deklaratë doganore në letër në lidhje me mallrat që po transportojnë.

Neni 316
Deklarata doganore për mallrat në dërgesat postare
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

1. Një operator postar mund të paraqesë një deklaratë doganore për çlirim në qarkullim të lirë që përmban një grup të reduktuar të dhënash të përmendura në aneksin B, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në lidhje me mallrat në një dërgesë postare, kur ato përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vlera e tyre nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1 000 (një mijë) euro;

b) Nuk është bërë ndonjë aplikim për rimbursim ose falje në lidhje me to;

c) Nuk janë objekt i ndalimeve dhe kufizimeve.

2. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të importit, të nevojshëm për dorëzimin e paraqitjes së njoftimeve, sipas Planit të ministrit përgjegjës për financat, deklarata doganore për çlirimin për qarkullim të lirë, të cilës i referohet pika 1, konsiderohet e paraqitur dhe e pranuar me aktin e paraqitjes së saj në doganë, nëse mallrat janë të shoqëruara nga një deklaratë CN22 ose CN23 ose nga të dyja së bashku.

3. Në rastet e përmendura në paragrafin e parë, të pikës 2, të nenit 311, dhe në pikën 3, të këtij neni, marrës konsiderohet të jetë deklaruesi dhe, sipas rastit , si debitor. Në rastet e përmendura në paragrafin e dytë, të pikës 2, të nenit 311, dhe në pikën 4, të këtij neni, dërguesi konsiderohet të jetë deklaruesi dhe, sipas rastit, si debitor. Autoritetet doganore mund të sigurojnë që operatorët postarë të konsiderohen deklarues dhe, sipas rastit, si debitor.

Neni 317
Mallrat në një dërgesë postare
(Nenet 157 dhe 169, të Kodit)

1. Deklarata doganore për mallrat e përmendura në pikat 2, 3, 4, të nenit 311, do të konsiderohet se është pranuar dhe mallrat janë çliruar, si më poshtë:

a) Kur deklarimi doganor ka të bëjë me çlirimin për qarkullim të lirë, kur mallrat i janë dorëzuar pritësit;

b) Kur deklarata doganore ka të bëjë me eksportin dhe rieksportin, kur mallrat janë nxjerrë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Kur deklarata doganore ka të bëjë me çlirimin për qarkullim të lirë dhe nuk ka qenë e mundur t'i dorëzohet pritësit të mallrave të përmendur në pikat 2 dhe 3, të nenit 311, deklarata doganore do të konsiderohet se nuk është paraqitur.

Mallrat, të cilat nuk i janë dorëzuar pritësit do të konsiderohen se janë në magazinim të përkohshëm deri sa të shkatërrohen, rieksportohen ose të sistemohen ndryshe, në përputhje me nenin 179, të Kodit.

Neni 318
Zyra doganore kompetente për vendosjen e mallrave nën një regjim doganor
(Neni 147, i Kodit)

1. Për qëllimet të heqjes së detyrimit për të paraqitur mallrat në përputhje me pikën 3, të nenit 165, të Kodit, zyra doganore mbikëqyrëse e përmendur në shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 165, të Kodit do të jetë zyra kompetente doganore për vendosjen e mallrave nën një regjim doganor të përmendur në pikën 3, të nenit 147, të Kodit.

2. Zyrat e mëposhtme doganore janë kompetente për vendosjen e mallrave nën regjimin e eksportit:

a) Zyra doganore kompetente për vendin ku është vendosur eksportuesi;

b) Zyra doganore kompetente për vendin ku mallrat janë paketuar ose ngarkuar për eksport;

c) Një zyrë doganore tjetër, e cila është kompetente për arsye administrative për procedurat në fjalë.

Kur mallrat nuk kalojnë vlerën ekuivalente në lekë të 3 000 eurove për dërgesë dhe për deklarues dhe nuk janë objekt i ndalimeve ose kufizimeve, përveç zyrave doganore të identifikuara në pikën 1, zyra doganore kompetente për vendin e daljes së mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, do të jetë kompetente për vendosjen e mallrave nën regjimin e eksportit.

Në rastet kur është i përfshirë nën-kontraktuesi, përveç zyrave doganore të identifikuara në pikat 1, dhe 2, zyra doganore kompetente për vendin ku nënkontraktori është vendosur, do të jetë kompetente për vendosjen e mallrave nën regjimin e eksportit.

Kur justifikohet nga rrethanat e një rasti individual, një tjetër zyrë doganore e vendosur më mirë për paraqitjen e mallrave në doganë, do të jetë kompetente për vendosjen e mallrave nën regjimin e eksportit.

3. Deklaratat doganore me gojë për eksportin dhe rieksportin duhet të bëhen në zyrën doganore kompetente për vendin e daljes së mallrave.

Neni 319
Artikujt
(Neni 149, i Kodit)

1. Kur deklarata doganore mbulon dy ose më shumë artikuj, të dhënat e paraqitura në këtë deklaratë në lidhje me çdo artikull do të konsiderohen se përbëjnë një deklaratë të ndarë doganore.

2. Përveç rasteve kur mallrat e veçanta, të përfshira në një ngarkesë, janë objekt i masave të ndryshme, mallrat e përfshira në një dërgesë do të konsiderohen se përbëjnë një artikull të vetëm për qëllimet e pikës 1, kur plotësohet secili nga kushtet e mëposhtme:

a) Ato klasifikohen në një nënkre të vetëm tarifor;

b) Janë objekt i një aplikimi për thjeshtim, në përputhje me nenin 161, të Kodit.

Seksioni 2
Deklarata doganore të thjeshtuara

Neni 320
Formularët për deklarime doganore të thjeshtuara

Deri në datat e përmirësimit të sistemit të informatizuar sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, kur një deklaratë doganore e thjeshtuar, siç përmendet në nenin 152, të Kodit, është paraqitur duke përdorur mjete të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave për një regjim doganor të referuar në pikën 4, të nenit 303, kjo do të bëhet duke përdorur formularët që përmbajnë, të paktën, të dhënat për një deklarim të thjeshtuar (paplotë), të përcaktuar në aneksin B, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 321
Kushtet për autorizimin e përdorimit të vazhdueshëm të deklaratave doganore të thjeshtuara
(Pika 2, e nenit 152, të Kodit)

1. Autorizimi për t'i vendosur rregullisht mallrat nën një regjim doganor në bazë të deklaratës të thjeshtuar, në përputhje me pikën 2, të nenit 152, të Kodit, jepet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Aplikuesi është në përputhje me kriterin e parashikuar në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit;

b) Aplikuesi, kur është e zbatueshme, disponon procedura të përshtatshme për trajtimin e licencave dhe autorizimeve të dhëna në përputhje me masat e politikës tregtare ose në lidhje me tregtinë e produkteve bujqësore;

c) Aplikuesi siguron që punonjësit e tij janë udhëzuar të informojnë autoritetet doganore sa herë që hasin vështirësi në zbatimin e legjislacionit doganor dhe përcakton procedura për informimin e autoriteteve doganore për vështirësi të tilla;

ç) Aplikuesi, kur është e zbatueshme, disponon procedura të përshtatshme për trajtimin e licencave/lejeve të importit dhe eksportit lidhur me ndalimet dhe kufizimet, duke përfshirë masat për të dalluar mallrat që i nënshtrohen ndalimeve ose kufizimeve nga mallrat e tjera dhe për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi lidhur me këto ndalime dhe kufizime.

2. OEAD konsiderohet se i plotëson kushtet e përmendura në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, për sa kohë që të dhënat për këta operatorë janë në përputhje me qëllimet e vendosjes së mallrave nën një regjim doganor në bazë të deklaratës së thjeshtësuar.

Neni 322
Menaxhimi i kuotës tarifore në deklaratat e thjeshtuara doganore
(Neni 152 i Kodit)

1. Kur një deklaratë e thjeshtuar është paraqitur për çlirim për qarkullim të lirë të mallrave, subjekt i një kuote tarifore të menaxhuar në përputhje me rendin kronologjik të datave të pranimit të deklaratave doganore, deklaruesi mund të kërkojë dhënien e kuotës tarifore vetëm kur të dhënat e domosdoshme janë në dispozicion ose në deklaratën e thjeshtuar ose në një deklaratë plotësuese.

2. Kur aplikimi për dhënien e një kuote tarifore të menaxhuar në përputhje me rendin kronologjik të datave të pranimit të deklaratave doganore është bërë në një deklaratë plotësuese, aplikimi nuk mund të përpunohet deri kur deklarata plotësuese të jetë depozituar.

3. Për qëllime të ndarjes së kuotës tarifore, duhet të merret parasysh data e pranimit të deklaratës të thjeshtuar.

Neni 323
Dokumentet shoqëruese për deklaratat e thjeshtuara
(Neni 152 i Kodit)

Kur mallrat janë vendosur nën një regjim doganor në bazë të deklaratës së thjeshtuar, dokumentet shoqëruese të përmendura në pikën 2, të nenit 150, të Kodit i jepen autoriteteve doganore para çlirimit të mallrave.

Neni 324
Deklarata plotësuese
(Pika 1, e nenit 153, të Kodit)

1. Kur autoritetet doganore duhet të kontabilizojnë shumën e detyrimit të importit ose të eksportit për t'u paguar në përputhje me paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 99, të Kodit, deklarata plotësuese e referuar në paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 153, të Kodit, duhet të paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e çlirimit të mallrave.

2. Kur kontabilizimi kryhet në përputhje me paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 99, të Kodit, dhe deklarata plotësuese është e një natyre të përgjithshme, periodike apo përmbledhëse, periudha kohore e mbuluar nga deklarata plotësuese nuk duhet të kalojë një muaj kalendarik.

3. Afati për depozitimin e deklaratës plotësuese të referuar në pikën 2 është maksimumi 10 ditë nga përfundimi i afatit të mbuluar prej deklaratës plotësuese.

4. Deri në implementimin e sistemeve elektronike të eksportit dhe të importit, sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat dhe pa rënë ndesh me pikën 1, të nenit 99, të Kodit, autoritetet doganore mund të lejojnë afate kohore të tjera përveç atyre të përcaktuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni.

Neni 325
Afati brenda të cilit deklaruesi duhet të ketë në posedim dokumentet mbështetëse në rastin e deklaratave plotësuese
(Pika 1, e nenit 153, të Kodit)

1. Dokumentet mbështetëse, që mungonin në momentin e depozitimit të deklaratës së thjeshtuar, duhet të jenë në posedim të deklaruesit brenda afatit për depozitimin e deklaratës plotësuese, në përputhje me nenin 324, pika 1 ose 3.

2. Në raste të justifikuara, autoritetet doganore mund të autorizojnë zgjatjen e afatit kohor për vënien në dispozicion të dokumenteve mbështetëse, të parashikuara në pikën 1. Ky afat kohor nuk duhet t'i kalojë 120 (njëqind e njëzet) ditë nga data e çlirimit të mallrave.

3. Kur dokumenti mbështetës ka të bëjë me vlerën doganore, atëherë autoritetet doganore mund që, në raste plotësisht të justifikuara, të vendosin një afat kohor më të gjatë se ai i parashikuar në pikat 1 ose 2, duke marrë parasysh kufizimin e periudhës të referuar në pikën 1, të nenit 97, të Kodit.

Neni 326
Deklarata plotësuese në rastin e hyrjes në regjistrimet e deklaruesit
(Pika 4, e nenit 153, të Kodit)

Në rastin e hyrjes në regjistrimet e deklaruesit sipas nenit 165, të Kodit, kur deklarata plotësuese është e një natyre të përgjithshme, periodike apo përmbledhëse dhe operatori ekonomik është i autorizuar sipas vetëvlerësimit për të llogaritur shumën e detyrimit të importit dhe eksportit për t'u paguar, mbajtësi i autorizimit duhet të depozitojë një deklaratë plotësuese apo autoritetet doganore mund të lejojnë që deklarata plotësuese të vihet në dispozicion përmes aksesit të drejtpërdrejtë elektronik në sistemin e mbajtësit të autorizimit.

Seksioni 3
Dispozita të zbatueshme për të gjitha deklaratat doganore

Neni 327
Numri Kryesor i Lëvizjes (MRN)
(Neni 157 i Kodit)

Me përjashtim të rasteve kur deklarata doganore është paraqitur me gojë ose me anë të një veprimi, që konsiderohet të jetë një deklaratë doganore, apo kur deklarata doganore merr formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit në përputhje me nenin 165, të Kodit, autoritetet doganore do të njoftojnë deklaruesin për pranimin e deklaratës doganore dhe do ta pajisin atë me një MRN për atë deklaratë dhe datën e pranimit të saj.

Ky nen nuk do të zbatohet deri në implementimin dhe përmirësimin e sistemit të informatizuar kombëtar të importit të përmendur në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 328
Deklarata doganore e depozituar para paraqitjes së mallrave

1. Kur deklarata doganore është depozituar në përputhje me nenin 156, të Kodit, autoritetet doganore përpunojnë të dhënat e ofruara para paraqitjes së mallrave, në veçanti për qëllime të analizës së riskut.

2. Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për Eksportin/Importin, sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, kur një deklaratë doganore është depozituar përpara paraqitjes së mallrave sipas nenit 156 të Kodit, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të ndryshme nga teknika elektronike të përpunimit të të dhënave, për depozitimin e njoftimit të paraqitjes.

Neni 329
Anulimi i një deklarate doganore pas çlirimit të mallrave
(Pika 2, e nenit 159, të Kodit)

1. Kur vërtetohet se mallrat janë deklaruar gabimisht për një regjim doganor sipas të cilit lind një borxh doganor në import, në vend që të deklarohen për një regjim tjetër doganor, atëherë deklarata doganore anulohet pasi mallrat të jenë çliruar, përmes një aplikimi të arsyetuar nga deklaruesi, në qoftë se përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Aplikimi bëhet brenda 90 ditëve, nga data e pranimit të deklaratës;

b) Mallrat nuk janë përdorur në një mënyrë që nuk përputhet me regjimin doganor nën të cilin ato do të ishin deklaruar po të mos kishte ndodhur gabimi;

c) Në kohën e deklarimit të gabuar janë përmbushur kushtet për vendosjen e mallrave nën regjimin doganor nën të cilin ato do të ishin deklaruar po të mos kishte ndodhur gabimi;

ç) Është depozituar një deklaratë doganore për regjimin doganor nën të cilin mallrat do të ishin deklaruar po të mos kishte ndodhur gabimi.

2. Kur vërtetohet se mallrat janë deklaruar gabimisht në vend të mallrave të tjera, për një regjim doganor nën të cilin lind një borxh doganor në import, atëherë deklarata doganore anulohet edhe pasi të jenë çliruar mallrat, me aplikim të arsyetuar nga deklaruesi, në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Aplikimi bëhet brenda 90 ditëve, nga data e pranimit të deklaratës;

b) Mallrat e deklaruara gabimisht nuk janë përdorur në mënyra të tjera, përveç atyre të autorizuara në gjendjen e tyre fillestare dhe janë kthyer në gjendjen e tyre fillestare;

c) E njëjta zyrë doganore është kompetente në lidhje me mallrat e deklaruara në mënyrë të gabuar dhe mallrat që deklaruesi ka për qëllim të deklarojë;

ç) Mallrat deklarohen për të njëjtin regjim doganor si ato të deklaruara gabimisht.

3. Kur mallrat, të cilat janë shitur me një kontratë në distancë/largësi, sipas përcaktimit të nenit 32, të ligjit "Për mbrojtjen e konsumatorit", janë çliruar në qarkullim të lirë dhe janë kthyer, atëherë deklarata doganore anulohet pasi të jenë çliruar mallrat me aplikim të arsyetuar nga deklaruesi, në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Aplikimi bëhet brenda 90 ditëve nga data e pranimit të deklaratës doganore;

b) Mallrat janë eksportuar me qëllim kthimin e tyre në adresën e furnizuesit fillestar ose në një tjetër adresë të treguar nga ai furnizues.

4. Përveç rasteve të referuara në pikat 1, 2 dhe 3, deklaratat doganore anulohen edhe pasi mallrat të jenë çliruar me aplikim të arsyetuar nga deklaruesi, në ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) Kur mallrat janë çliruar për eksport, rieksport ose përpunim pasiv dhe nuk janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

b) Kur mallrat shqiptare janë deklaruar gabimisht në regjimin doganor të zbatueshëm për mallrat joshqiptare dhe statusi doganor i tyre si mallra shqiptare është provuar më pas me anë të një dokumenti T2L ose një manifesti doganor të mallrave;

c) Kur mallrat janë deklaruar gabimisht në më shumë se një deklaratë doganore;

ç) Kur një autorizim me efekt prapaveprues është dhënë në përputhje me pikën 2, të nenit 192, të Kodit;

d) Kur mallrat shqiptare janë vendosur nën regjimin e magazinimit doganor në përputhje me pikën 2, të nenit 210, të Kodit, dhe nuk mund të vendosen më nën atë regjim në përputhje me këtë nen të Kodit.

5. Deklarata doganore lidhur me mallrat që i nënshtrohen detyrimit të eksportit, aplikimit për rimbursim të detyrimit të importit për rimbursimet ose shumat e tjera të eksportit ose masave të tjera të posaçme për eksport mund të anulohet në përputhje me shkronjën "a", të pikës 4, në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Deklaruesi i dorëzon zyrës doganore të eksportit ose, në rastin e përpunimit pasiv, zyrës doganore të vënies nën regjim, provën se mallrat nuk janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

b) Kur deklarata doganore është në letër, deklaruesi kthen në zyrën doganore të eksportit ose, në rastin e përpunimit pasiv, në zyrën doganore të vënies nën regjim, të gjitha kopjet e deklaratës doganore, së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të lëshuara për të pas pranimit të deklaratës;

c) Deklaruesi i dorëzon zyrës doganore të eksportit provën se janë ripaguar të gjitha rimbursimet dhe shumat e tjera ose përfitimet financiare të parashikuara në eksport për mallrat në fjalë ose që nga autoritetet kompetente janë marrë masat e nevojshme për t'u siguruar që ato nuk janë paguar;

ç) Deklaruesi pajtohet me të gjitha detyrimet e tjera për sa u përket mallrave me të cilat ai është i lidhur;

d) Janë anuluar të gjitha rregullimet e bëra në një licencë/leje eksporti të paraqitur në mbështetje të deklaratës doganore.

Seksioni 4
Thjeshtësime të tjera

Nënseksioni 1
Mallrat që bien në nënkrerë të ndryshëm tariforë

Neni 330
Mallrat që klasifikohen në nënkrerë të ndryshëm tariforë të deklaruar në një nënkre të vetëm

(Pika 1, e nenit 161, të Kodit)

1. Për qëllimet e nenit 161, të Kodit, kur mallrat në një ngarkesë klasifikohen në nënkrerë tariforë, objekt i një detyrimi doganor specifik, që i referohet të njëjtës njësi mase, detyrimi doganor që do të zbatohet mbi të gjithë ngarkesën do të bazohet në nënkreun tarifor me nivelin tarifor më të lartë të detyrimit doganor specifik.

2. Për qëllimet e nenit 161, të Kodit, kur mallrat në një ngarkesë klasifikohen në nënkrerë tariforë,

objekt i një detyrimi doganor specifik që i referohet njësive të ndryshme të masës, detyrimi doganor specifik më i lartë për çdo njësi të masës, do të zbatohet për të gjithë mallrat e ngarkesës për të cilat detyrimi specifik shprehet duke iu referuar kësaj njësie dhe do të konvertohet në një detyrim *ad valorem* për secilin lloj të këtyre mallrave.

Detyrimi që do të zbatohet mbi të gjithë ngarkesën do të bazohet në nënkreun tarifor objekt i një niveli më të lartë të detyrimit doganor *ad valorem*, që rezulton nga konvertimi në përputhje me pikën 1.

3. Për qëllimet e nenit 161, të Kodit, kur mallrat në një ngarkesë që klasifikohen në nënkrerë tariforë që i nënshtrohen një detyrimi doganor *ad valorem* dhe një detyrimi doganor specifik, detyrimi specifik më i lartë i përcaktuar në përputhje me pikat 1 ose 2, do të konvertohet në një detyrim *ad valorem*, për secilin lloj të mallrave për të cilat detyrimi specifik shprehet duke iu referuar së njëjtës njësi.

Detyrimi që do të zbatohet mbi të gjithë ngarkesën do të bazohet në nënkreun tarifor, objekt i nivelit më të lartë të detyrimit doganor *ad valorem*, duke përfshirë detyrimin *ad valorem,* që rezulton nga konvertimi në përputhje me pikën 1.

Neni 331
Kushtet për dhënien e autorizimit për zhdoganim të centralizuar
(Pika 1, e nenit 163, të Kodit)

1. Aplikimi për autorizim të zhdoganimit të centralizuar, në përputhje me nenin 163 të Kodit, duhet t'i përkasë njërit prej regjimeve të mëposhtme:

a) Çlirimit në qarkullim të lirë;
b) Magazinimit doganor;
c) Lejimit të përkohshëm;
ç) Përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*);
d) Përpunimit aktiv;
dh) Përpunimit pasiv;
e) Eksportit;
ë) Rieksportit.

2. Kur deklarata doganore është në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit, zhdoganimi i centralizuar mund të autorizohet sipas kushteve të parashikuara në nenin 336.

Nënseksioni 2
Zhdoganimi i centralizuar

Neni 332
Procedura e konsultimit mes autoriteteve doganore në rastin e autorizimeve për zhdoganimin e centralizuar
(Neni 27 i Kodit)

1. Procedura e konsultimit referuar në nenin 32, do të ndiqet kur DPD merr një aplikim për një autorizim për zhdoganimin e centralizuar të përmendur në nenin 163, të Kodit, që përfshin më shumë se një zyrë doganore, përveç nëse DPD gjykon se kushtet për dhënien e një autorizimi të tillë nuk janë përmbushur.

2. Brenda 45 ditësh pas datës së pranimit të aplikimit, DPD do t'i komunikojë zyrave doganore të përfshira, sa më poshtë:

a) Aplikimin dhe draftautorizimin, duke përfshirë afatet kohore të përmendura në pikat 5 dhe 6, të nenit 334;

b) Kur është e përshtatshme, një plan kontrolli për kryerjen e kontrolleve të veçanta që do të kryhen nga zyrat doganore të përfshira, sapo të jetë dhënë një autorizim;

c) Çdo informacion tjetër, që konsiderohet i nevojshëm nga autoritetet doganore të përfshira.

3. Autoritetet doganore të konsultuara do ta komunikojnë miratimin ose kundërshtimet e tyre, si dhe çdo ndryshim në draftautorizimin ose në planin e kontrollit të propozuar, brenda 45 ditëve nga data në të cilën u është komunikuar draftautorizimi. Kundërshtimet duhet të justifikohen në mënyrë të arsyetuar.

Kur kundërshtimet janë komunikuar dhe nuk arrihet mirëkuptimi brenda 90 ditëve nga data në të cilën është komunikuar draftautorizimi, autorizimi nuk do të jepet për pjesët mbi të cilat janë ngritur kundërshtime. Kur autoritetet doganore të konsultuara nuk komunikojnë kundërshtime brenda afatit të caktuar, miratimi i tyre do të konsiderohet si i dhënë.

4. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të referuar në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, me përjashtim të pikës 2 dhe paragrafit të parë të pikës 3, të këtij neni, periudhat e referuara mund të zgjaten me 15 ditë nga autoritetet doganore kompetente për marrjen e këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafit të dytë të pikës 3 të këtij neni, periudha e përmendur në to mund të shtyhet me 30 ditë nga autoritetet doganore kompetente për marrjen e këtij vendimi.

5. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të vendimeve të përmendur në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, me përjashtim të shkronjës "b", të pikës 2, të këtij neni, do të komunikohet plani i kontrollit i përmendur aty.

Neni 333
Monitorimi i autorizimit
(Pika 5, e nenit 28, të Kodit)

1. Zyrat doganore duhet të informojnë pa vonesë DPD, mbi çdo faktor që lind pas dhënies së autorizimit për zhdoganimin e centralizuar, i cili mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen.

2. DPD, do të vërë të gjithë informacionin përkatës në dispozicion të zyrave doganore në lidhje me aktivitetet doganore të kryera nga operatori ekonomik, që përfiton nga zhdoganimi i centralizuar sipas autorizimit.

Neni 334
Formalitetet doganore dhe kontrollet në lidhje me zhdoganimin e centralizuar
(Pika 4, e nenit 163, të Kodit)

1. Mbajtësi i autorizimit për zhdoganimin e centralizuar duhet të paraqesë mallrat në zyrën doganore kompetente, siç është përcaktuar në këtë autorizim, duke depozituar në zyrën doganore mbikëqyrëse, një nga këto dokumente:

a) Një deklaratë standarde doganore, siç përmendet në nenin 149, të Kodit;

b) Një deklaratë e thjeshtuar doganore, siç përmendet në nenin 152, të Kodit;

c) Një njoftim paraqitje të përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 338.

2. Kur deklarata doganore merr formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit, do të zbatohen nenet 338, 339 dhe 340.

3. Përjashtimi nga detyrimi për paraqitjen e mallrave në përputhje me pikën 3, të nenit 165, të Kodit, do të aplikohet për zhdoganimin e centralizuar, me kusht që mbajtësi i autorizimit për të paraqitur një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit, ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në shkronjën "dh", të pikës 1, të nenit 338.

4. Kur zyra doganore mbikëqyrëse ka pranuar deklaratën doganore ose ka marrë njoftimin e përmendur në shkronjën "c", të pikës 1, do të:

a) kryejë kontrollet e duhura për verifikimin e deklaratës doganore ose njoftimin e paraqitjes;

b) transmetojë menjëherë në zyrën doganore të paraqitjes së deklaratës doganore apo njoftimit edhe rezultatet e analizës së riskut që lidhen me të;

c) informojë zyrën doganore të paraqitjes për secilën, sa më poshtë:

i) Që mallrat mund të vendosen për regjimin doganor në fjalë;

ii) Që kontrollet doganore janë të nevojshme në përputhje me shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 163, të kodit.

5. Kur zyra doganore mbikëqyrëse informon zyrën doganore të paraqitjes se mallrat mund të vendosen nën regjimin doganor në fjalë, zyra doganore e paraqitjes, brenda afatit kohor të përcaktuar në autorizim për zhdoganimin e centralizuar, informon zyrën mbikëqyrëse doganore nëse kontrollet e veta mbi mallrat, duke përfshirë kontrollet lidhur me ndalimet dhe kufizimet kombëtare, ndikojnë në një vendosje të tillë.

6. Kur zyra doganore mbikëqyrëse informon zyrën doganore të paraqitjes se kontrollet doganore janë të nevojshme në përputhje me shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 163, të Kodit, zyra doganore e paraqitjes, brenda afatit kohor të përcaktuar në autorizimin për zhdoganimin e centralizuar, konfirmon marrjen e kërkesës së zyrës doganore mbikëqyrëse për të kryer kontrollet e nevojshme dhe, sipas rastit, informon zyrën doganore mbikëqyrëse për kontrollet e veta mbi mallrat, duke përfshirë kontrollet lidhur me ndalimet dhe kufizimet.

7. Zyra doganore mbikëqyrëse duhet të informojë zyrën doganore të paraqitjes për çlirimin e mallrave.

8. Në eksport, zyra doganore mbikëqyrëse duhet, pas çlirimit të mallrave, të shënojë të dhënat e deklaratës së eksportit, të plotësuara sipas rastit, në përputhje me nenin 699, në dispozicion të zyrës doganore të daljes. Zyra doganore e daljes informon zyrën doganore mbikëqyrëse për daljen e mallrave në përputhje me nenin 704. Zyra doganore mbikëqyrëse vërteton daljen e mallrave deklaruesit në përputhje me nenin 705.

9. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të referuar në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, për mallrat e mbuluara nga një autorizim për zhdoganimin e centralizuar, mbajtësi i autorizimit ose deklaruesi duhet:

a) të paraqesë mallrat në vendet e përcaktuara në autorizim dhe të paracaktuara ose të miratuara nga autoritetet doganore, në përputhje me nenin 130, të Kodit, përveç kur detyrimi për paraqitjen e mallrave është hequr në përputhje me pikën 3, të nenit 165, të Kodit; dhe

b) të paraqesë një deklaratë doganore ose të regjistrojë mallrat në regjistrat e tij, në zyrën doganore të përcaktuar në autorizim.

10. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të referuar në planin e punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, autoritetet doganore kompetente duhet të zbatojnë planin e kontrollit, i cili përcakton një nivel minimal të kontrolleve.

11. Duke anashkaluar pikat 5 dhe 6, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të referuar në planin e punës të miratuar nga ministri i përgjegjës për financat, zyrat doganore ku mallrat janë paraqitur, mund të kryejnë kontrolle të tjera nga ato të përcaktuara në planin e kontrollit, me kërkesën e zyrës doganore mbikëqyrëse apo me nismën e tyre, duke komunikuar rezultatet në zyrën mbikëqyrëse.

Neni 335
Zhdoganimi i centralizuar që përfshin më shumë se një autoritet doganor
(Neni 163 i Kodit)

1. Zyra doganore mbikëqyrëse do ti transmetojë zyrës doganore të paraqitjes:

a) çdo ndryshim apo anulim të deklaratës standarde doganore që ka ndodhur pas çlirimit të mallrave;

b) kur një deklaratë plotësuese është paraqitur, atë deklaratë dhe çdo ndryshim apo anulim të saj.

2. Kur autoritetet doganore kanë akses në deklaratat plotësuese në sistemin elektronik të operatorëve në përputhje me nenin 326, zyra doganore mbikëqyrëse transmeton të dhënat, jo më vonë se 10 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar nga deklarata plotësuese dhe, çdo ndryshim apo anulim të asaj deklarate plotësuese të dhënë nga sistemi.

Nënseksioni 3
Hyrja në regjistrimet e deklaruesit

Neni 336
Kushtet për dhënien e autorizimit për hyrje në regjistrimet e deklaruesit
(Pika 1, e nenit 165, të Kodit)

1. Autorizimi për të depozituar një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit jepet kur aplikuesi tregon se i plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "ç", të nenit 41, të Kodit.

2. Në mënyrë që autorizimi për të depozituar një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit të jepet në përputhje me pikën 1, të nenit 165, të Kodit, aplikimi duhet t'i përkasë njërit prej regjimeve të mëposhtme:

a) Çlirimit në qarkullim të lirë;
b) Magazinimit doganor;
c) Lejimit të përkohshëm;
ç) Përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*);
d) Përpunimit aktiv;
dh) Përpunimit pasiv;
e) Eksportit dhe rieksportit.

3. Kur aplikimi për autorizim i përket çlirimit në qarkullim të lirë, autorizimi nuk mund të jepet për:

a) çlirim të njëkohshëm për qarkullim të lirë dhe hedhje për konsum të mallrave, të cilat janë të përjashtuara nga TVSH në përputhje me ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe, kur është e zbatueshme, me pezullim nga detyrimi i akcizës në përputhje me nenin 30, të ligjit nr.61/2014, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) riimport me njëkohësisht çlirim për qarkullim të lirë dhe hedhje për konsum të mallrave, të cilat janë të përjashtuara nga TVSH, në përputhje me ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe kur është e zbatueshme, me pezullim nga detyrimi i akcizës në përputhje me nenin 30, të ligjit nr.61/2014, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

4. Kur aplikimi për autorizim ka të bëjë me eksportin dhe rieksportin, autorizimi jepet vetëm kur plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

a) Është hequr dorë nga detyrimi për të

paraqitur një deklaratë para nisjes në përputhje me pikën 2, të nenit 236, të Kodit;

b) Zyra doganore e eksportit është dhe zyrë doganore e daljes ose zyra doganore e eksportit dhe zyra doganore e daljes kanë të përcaktuara procedura që sigurojnë mbikëqyrjen doganore të mallrave në dalje.

5. Kur aplikimi për autorizim ka të bëjë me eksportin dhe rieksportin, eksporti i mallrave të akcizës nuk lejohet.

6. Autorizimi për hyrje në regjistrimet e deklaruesit nuk jepet kur aplikimi ka të bëjë me një regjim për të cilin nevojitet një shkëmbim standard informacioni mes autoriteteve doganore, në përputhje me nenin 552, përveç rasteve kur autoritetet doganore bien dakord që të përdoren mjete të tjera të shkëmbimit elektronik të informacionit.

Neni 337
Plani i kontrollit
(Pika 5, e nenit 28, të Kodit)

1. Autoritetet doganore do të përcaktojnë një plan specifik kontrolli të operatorit ekonomik, kur jepet një autorizim për të paraqitur (depozituar) një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit në përputhje me pikën 1, të nenit 165, të Kodit, duke siguruar mbikëqyrjen e procedurave doganore që kryhen në bazë të autorizimit, që përcakton frekuencën e kontrolleve doganore dhe duke siguruar, ndër të tjera, se kontrollet doganore efektive mund të kryhen në të gjitha fazat e procedurës së hyrjes në regjistrimet e deklaruesit.

2. Sipas rastit, plani i kontrollit duhet të marrë parasysh periudhën e parashkrimit për njoftimin e borxhit doganor të përmendur në pikën 1, të nenit 97, të Kodit.

3. Plani i kontrollit do të sigurojë që kontrolli të kryhet në rast se është dhënë përjashtimi për mos paraqitjen e mallrave në përputhje me pikën 3, të nenit 165, të Kodit.

4. Në rast të zhdoganimit të centralizuar, plani i kontrollit që përcakton ndarjen e detyrave ndërmjet zyrës doganore mbikëqyrëse dhe zyrës doganore të paraqitjes, duhet të marrë parasysh ndalimet dhe kufizimet e zbatueshme në vendin ku ndodhet zyra doganore e paraqitjes.

Neni 338
Detyrimet e mbajtësit të autorizimit për të paraqitur një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit
(Pika 1, e nenit 165, të Kodit)

1. Mbajtësi i autorizimit për të paraqitur një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit duhet:

a) përveç rastit, kur zbatohet pika 3, e nenit 165, të Kodit, t'i paraqesë mallrat në doganë dhe të shënojë datën e njoftimit të paraqitjes në regjistra;

b) të shënojë në regjistra, së paku të dhënat e një deklarate doganore të thjeshtuar dhe dokumentet e mundshme mbështetëse;

c) me kërkesë të zyrës doganore mbikëqyrëse, të vërë në dispozicion të dhënat e deklaratës doganore të shënuar në regjistra dhe çdo dokument të mundshëm mbështetës, përveç rastit kur autoritetet doganore lejojnë që deklaruesi të ketë një akses të kompjuterizuar të drejtpërdrejtë në këtë informacion në regjistrat e veta;

ç) të vërë në dispozicion të zyrës mbikëqyrëse doganore informacionin për mallrat, të cilat i nënshtrohen ndalimeve dhe kufizimeve;

d) të pajisë zyrën doganore mbikëqyrëse me dokumente mbështetëse, siç përmendet në pikën 2, të nenit 150, të Kodit, para se mallrat e deklaruara të mund të çlirohen;

dh) kur zbatohet përjashtimi i përmendur në pikën 3, të nenit 165, të Kodit, të sigurojë që mbajtësi i autorizimit për funksionimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm ka informacionin e nevojshëm për të provuar përfundimin e magazinimit të përkohshëm;

e) përveç kur detyrimi për të paraqitur një deklaratë plotësuese është hequr në përputhje me pikën 2, të nenit 153, të Kodit, të paraqesë deklaratën plotësuese për zyrën doganore mbikëqyrëse në mënyrën dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në autorizim.

2. Autorizimi për të paraqitur një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit nuk zbatohet për deklaratat e mëposhtme:

a) Deklaratat doganore, të cilat përbëjnë një aplikim për një autorizim për një regjim të posaçëm në përputhje me nenin 142, të vendimit "Për miratimin e rregullave të detajuara të disa dispozitave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014,

"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"", të Këshillit të Ministrave;

b) Deklaratat doganore të paraqitura në vend të deklaratës përmbledhëse të hyrjes në përputhje me pikën 1, të nenit 122, të Kodit.

Neni 339
Çlirimi i mallrave kur deklarata doganore është paraqitur në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit
(Neni 165 i Kodit)

1. Kur autorizimi për të paraqitur një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit, përcakton një afat kohor për të informuar mbajtësin e këtij autorizimi për çdo kontroll që do të kryhet, mallrat do të konsiderohen se janë çliruar në momentin e përfundimit të këtij afati, përveç rasteve kur zyra doganore mbikëqyrëse ka njoftuar brenda atij afati kohor qëllimin e saj për të kryer një kontroll.

2. Kur autorizimi nuk përcakton një afat kohor, siç referohet në pikën 1, zyra doganore mbikëqyrëse do të çlirojë mallrat në përputhje me nenin 175, të Kodit.

Neni 340
Kuota tarifore
(Neni 165 i Kodit)

1. Kur deklarata doganore është paraqitur në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit për çlirim për qarkullim të lirë të mallrave që i nënshtrohen një kuote tarifore të menaxhuar në përputhje me rendin kronologjik të datave të pranimit të deklaratave doganore, mbajtësi i autorizimit që do të paraqesë një deklaratë doganore në atë formë, do të kërkojë dhënien e kuotës tarifore në një deklaratë plotësuese.

2. Kur kërkesa për dhënien e një kuote tarifore të menaxhuar në përputhje me rendin kronologjik të datave të pranimit të deklaratave doganore është bërë në një deklaratë plotësuese, kërkesa mund të përpunohet vetëm pas depozitimit të asaj deklarate. Megjithatë, data në të cilën mallrat janë regjistruar në regjistrimet e deklaruesit, do të merret parasysh për qëllime të shpërndarjes së kuotave tarifore.

3. Me përjashtim nga pika 1, e këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar kombëtar të deklaratave të importit, të përmendur në planin e punës të miratuar, nga ministri përgjegjës për financat, mundet që kërkesa për të përfituar nga një kuotë tarifore e menaxhuar në përputhje me nenet 92 deri 95, bëhet në një formë të ndryshme nga ajo e përmendur në pikën 1, të këtij neni, me kusht që të gjitha të dhënat e nevojshme të jenë në dispozicion për të gjykuar mbi vlefshmërinë e kërkesës.

Nënseksioni 4
Zhdoganimi në ambientet e operatorit ekonomik (zhdoganimi lokal)

Neni 341
Të përgjithshme

1. Në zbatim të neneve 6 (33), 130, 165 të Kodit, nenit 250, deri në funksionimin e sistemit të informatizuar për hyrjen në regjistrimet e deklaruesit do të zbatohen nenet e parashikuara në këtë nënseksion për zhdoganimin në ambientet e operatorit ekonomik (zhdoganimi lokal).

2. Për qëllime të këtij nënseksioni, me "zhdoganim lokal" do të kuptohet kryerja e formaliteteve doganore për vendosjen e mallrave nën regjimin doganor vijues në ambientet e operatorit ekonomik, apo në vende të tjera të caktuara ose të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas përcaktimeve në këtë nënseksion.

3. Çdo person mund të aplikojë për marrjen e një autorizimi për "zhdoganim lokal" për përdorim vetjak ose për përdorim si një përfaqësues, me kusht që të përmbushen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë nënseksion, dhe t'i mundësojë autoritetit doganor të identifikojë personat e përfaqësuar dhe të kryejë kontrollet e duhura doganore.

4. Përdorimi i "zhdoganimit lokal" kushtëzohet nga garantimi i detyrimeve të importit, eksportit dhe pagesat e tjera, sipas njërës prej formave të garancisë, të parashikuara në Kod.

5. Mbajtësi i autorizimit përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë nënseksion dhe detyrimet që përcaktohen nga autorizimi, pa cenuar detyrimet e deklaruesit dhe rregullat për lindjen e një borxhi doganor.

6. Përdorimi i "zhdoganimit lokal" kushtëzohet me përdorimin e sistemeve kompjuterike të përpunimit të të dhënave për paraqitjen e deklarimeve dhe njoftimeve doganore elektronike, duke zbatuar dispozitat përkatëse lidhur me këto teknika apo sisteme.

7. Megjithatë, në rastet kur sistemet e kompjuterizuara të autoriteteve doganore apo operatorëve ekonomikë nuk funksionojnë, autoritetet doganore mund të pranojnë forma të tjera deklarimesh apo njoftimesh, siç përcaktohet nga këto autoritete, me kusht që të kryhen analiza efektive risku.

8. Përdorimi i procedurës së "zhdoganimit lokal" kushtëzohet nga përfitimi i autorizimit për magazinim të përkohshëm.

Neni 342
Aplikimi dhe kriteret

1. Aplikimet për autorizimin e procedurës së "zhdoganimit lokal" paraqiten pranë DPD duke përdorur modelin e aplikimit të përcaktuar në aneksin 6, të shtojcës C bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në letër ose formatin elektronik që i korrespondon.

2. Kur DPD përcakton që aplikimi nuk përmban të gjitha hollësirat e kërkuara, duhet që, brenda 30 ditësh pas marrjes së aplikimit, t'i kërkojë aplikuesit informacionin përkatës, duke përcaktuar bazën ligjore për këtë kërkesë.

3. Aplikuesi, për të përfituar autorizimin për "zhdoganim lokal", duhet të plotësojë këto kritere:

a) të përmbushë kriterin e konformitetit të përcaktuar në nenin 49;

b) të përmbushë kriteret e përcaktuara në germat "dh", "ë" dhe "f" të pikës 1, të nenit 50;

c) të përmbushë kriterin e aftësisë paguese financiare të përcaktuar në nenin 51;

4. Aplikimi nuk pranohet, kur:

a) nuk është në përputhje me modelin e aplikimit;

b) nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;

c) aplikuesi është në procedurë falimentimi, ndarje apo bashkimi, në kohën e paraqitjes së aplikimit.

5. Përpara dhënies së autorizimit, autoritetet doganore auditojnë të dhënat e aplikuesit, përveç rasteve kur mund të përdoren rezultatet e një auditi të mëparshëm.

6. DPD për dhënien e autorizimit duhet të marrë parasysh karakteristikat e veçanta të operatorëve ekonomikë, në mënyrë të veçantë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

7. Kur aplikuesi ka një "Certifikatë OEAD", kushtet dhe kriteret e përmendura në pikën 3, të këtij neni, konsiderohen si të plotësuara.

8. Mbajtësi i autorizimit informon autoritetin doganor që ka lëshuar autorizimin për të gjithë faktorët e dalë pas dhënies së autorizimit, të cilët mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

9. Autoriteti doganor që ka lëshuar autorizimin bën rivlerësim të një autorizimi për "zhdoganim lokal", në rastet e:

a) ndryshimeve të mëdha në legjislacionin përkatës;

b) treguesve të arsyeshëm që kushtet përkatëse nuk përmbushen më nga mbajtësi i autorizimit.

Në rastin e lëshimit të një autorizimi për "zhdoganim lokal" për një aplikues të themeluar për më pak se tre vjet, gjatë vitit të parë pas lëshimit të tij autoriteti doganor duhet të kryejë një monitorim të detajuar.

Neni 343
Pezullimi

1. Një autorizim për "zhdoganim lokal" pezullohet nga DPD kur:

a) zbulohen mospërputhje me kushtet dhe kriteret e referuara në nenin 345;

b) autoriteti doganor ka arsye të mjaftueshme të besojë që një veprim, i cili mund të shkaktojë procedim penal lidhur me shkelje të legjislacionit doganor, është kryer nga mbajtësi i autorizimit, aplikuesi ose nga personat e përmendur në nenin 49;

2. Megjithatë, në rastin e përmendur në shkronjën "b" të pikës 1, DPD mund të vendosë që të mos e pezullojë autorizimin nëse konstaton shkelje me rëndësi të papërfillshme në raport me numrin apo madhësinë e operacioneve dhe nuk krijon dyshime që kanë të bëjnë me mirëbesimin apo vullnetin e mirë të operatorit ekonomik.

3. Para marrjes së vendimit për pezullim, DPD ia komunikon konstatimet e saj operatorit ekonomik. Operatori ekonomik ka të drejtë të korrigjojë situatën dhe /ose të shprehë qëndrimin e tij brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

4. Nëse mbajtësi i autorizimit nuk e rregullon situatën brenda afatit, DPD e njofton atë për pezullimin e autorizimit për një periudhë kohore prej 30 ditësh, për ti dhënë mundësi për rregullimin e situatës.

5. Në rastin e referuar në shkronjën "b" të pikës 1, DPD pezullon autorizimin deri në fund të procedimit në gjykatë, duke e njoftuar atë për pezullimin.

6. Kur mbajtësi i autorizimit nuk është në gjendje të rregullojë situatën brenda 30 ditësh, por mund të japë prova që mund të përmbushen kushtet nëse shtyhet periudha e pezullimit, DPD e pezullon autorizimin për një periudhë tjetër prej 30 ditësh kalendarike.

7. Pezullimi i një autorizimi nuk ndikon në asnjë procedurë tjetër doganore që ka filluar përpara datës së pezullimit, por që ende nuk ka përfunduar.

8. Kur DPD vlerëson se mbajtësi i autorizimit ka marrë masat e nevojshme për rregullimin e situatës heq pezullimin dhe e njofton atë. Pezullimi mund të hiqet përpara përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikat 4 ose 6, më sipër.

9. Nëse mbajtësi i autorizimit dështon përsëri për marrjen e masave për rregullimin e situatës brenda periudhës kohore të kërkuar, zbatohet pika 10.

10. Kur përkohësisht mbajtësi i autorizimit nuk është në gjendje të rregullojë situatën mund të kërkojë pezullimin e autorizimit. Në këtë rast, mbajtësi i autorizimit njofton DPD, duke përcaktuar datën kur ai do të jetë në gjendje të përmbushë kushtet dhe kriteret dhe duke paraqitur masat e planifikuara dhe afatet kohore të tyre.

11. Nëse mbajtësi i një autorizimi dështon të rregullojë situatën brenda periudhës kohore të përcaktuar në njoftimin e tij, DPD mund të autorizojë një shtyrje të arsyeshme, me kusht që ai të ketë vepruar me vullnet të mirë.

Neni 344
Revokimi

1. Pa cenuar dispozitat për vendimet e favorshme, autorizimi për zhdoganim lokal revokohet nga DPD në rastet e mëposhtme:

a) Kur mbajtësi i autorizimit dështon të rregullojë situatën e referuar në nenin 343;

b) Kur janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor nga mbajtësi i autorizimit ose personat e tjerë të përcaktuar në nenin 49 dhe kur ka shteruar e drejta e ankimit;

c) me kërkesë të mbajtësit të autorizimit.

2. Megjithatë, në rastin e përmendur në shkronjën "b" të pikës 1, DPD mund të vendosë që të mos e revokojë autorizimin nëse e konsideron shkeljen si të një rëndësie të papërfillshme në krahasim me numrin apo masën e operacioneve doganore dhe nuk krijon dyshime për vullnetin e mirë të mbajtësit të autorizimit.

Neni 345
Procedura e zhdoganimit lokal

1. Autorizimi për përdorimin e procedurës së "zhdoganimit lokal" jepet ndaj çdo aplikuesi që dëshiron të vendosë mallrat nën një regjim doganor, përveç transitit ose t'i rieksportojë ato në/nga ambientet e miratuara për këtë qëllim pas kryerjes së formaliteteve doganore të transitit në doganën hyrëse.

2. Mbajtësi i autorizimit për t'ju provuar autoriteteve doganore kryerjen e rregullt të operacioneve, përpara përfundimit të afatit kohor për vendosjen e mallrave nën një regjim doganor përveç transitit ose rieksportit të tyre, kryen procedurat në vijim:

a) njofton zyrën doganore mbikëqyrëse sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar prej saj për mbërritjen e mallrave dhe vendosjen e tyre nën regjimin doganor përkatës; Në eksport ose rieksport, mbajtësi i autorizimit duhet, përpara lëvizjes së mallrave nga ambientet e miratuara të depozitojë paraprakisht për zyrën doganore të eksportit një deklaratë eksporti për këtë lëvizje;

b) hedh të dhënat e mallrave në regjistrat e tij, të cilat duhet të përmbajnë datën kur është bërë hedhja e tyre dhe informacionin që përmban aneksi 7, të shtojcës C bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

i) në rastin e regjimit të magazinimit doganor hedh në regjistrin e magazinës doganore sasinë e mallrave dhe informacione për identifikimin e tyre;

ii) bën të disponueshëm për autoritetet doganore të gjitha dokumentet që kërkohen për regjimin doganor përkatës; Në eksport ose rieksport mbajtësi i autorizimit duhet të tregojë në çdo dokument shoqërues ose ndonjë mënyrë tjetër që e zëvendëson atë të dhëna lidhur me referencën për regjistrimin në regjistrat e tij, datën e regjistrimit dhe numrin e autorizimit.

c) depoziton deklaratën doganore;

3. Në autorizimin e referuar në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen rregullat specifike për zbatimin e procedurës dhe, në mënyrë të veçantë, përcaktohen:

a) mallrat për të cilat zbatohet;

b) detyrimet e operatorit ekonomik referuar në pikën 2, të këtij neni, si dhe referenca për garancinë kur kërkohet nga regjimi;

c) koha e çlirimit të mallrave;

ç) në rastin e eksportit ose rieksportit, përveç sa më lart edhe përmbajtja e çdo dokumenti shoqërues

ose çdo mënyrë tjetër që e zëvendëson atë dhe mënyrat se si do të bëhet i vlefshëm.

4. Autoritetet doganore, bazuar në analizën e riskut, njoftojnë operatorin ekonomik nëse do të procedohet me kontroll dokumentar apo fizik. Në rast se autoritetet doganore do të kryejnë kontrollin fizik të mallrave, operatori ekonomik është i detyruar të presë punonjësit doganorë për kryerjen e formaliteteve të nevojshme të kontrollit në mjediset e operatorit ekonomik pa cenuar elementet e sigurisë.

5. Në eksport ose rieksport, për të vërtetuar që mallrat aktualisht janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, shërben dokumenti i daljes së mallrave (urdhër çlirimi). Në autorizim duhet të përcaktohet që kopja nr. 3 e dokumentit të vetëm administrativ (DAV) të autentifikohet (vuloset) paraprakisht.

Autentifikimi paraprak mund të kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Kutia A e DAV mund të vuloset paraprakisht me vulën e zyrës doganore mbikëqyrëse dhe të nënshkruhet nga një zyrtar i kësaj zyre;

b) Eksportuesi i autorizuar mund të vulosë deklaratën duke përdorur një vulë speciale sipas modelit të treguar në aneksin 61, të shtojcës C bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Në eksport ose rieksport, autorizimi duhet të përfshijë detyrimin dhe angazhimin e eksportuesit për të marrë masa për ruajtjen e vulës speciale ose të formave që kanë stampën e vulës së zyrës doganore të eksportit, plumbçeve ose stampat e vulës speciale.

Nënseksioni 4
Vetëvlerësimi

Neni 346
Kushtet për dhënien e autorizimit për vetëvlerësim
(Pika 1, e nenit 167, të Kodit)

Kur aplikuesi i referuar në pikën 2, të nenit 167, të Kodit, është mbajtës i një autorizimi për hyrje në regjistrimet e deklaruesit, autorizimi për vetëvlerësim jepet me kusht që aplikimi të lidhet me regjimet doganore të referuara në pikën 2, të nenit 336, ose me rieksportin.

Neni 347
Formalitetet dhe kontrollet doganore bazuar në vetëvlerësim
(Pika 1, e nenit 167, të Kodit)

Mbajtësit e autorizimeve për vetëvlerësim mund të jenë të autorizuar për të kryer kontrolle nën mbikëqyrje doganore, lidhur me ndalimet dhe kufizimet siç përcaktohet në autorizim.

Neni 348
Përcaktimi i shumës së detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar
(Pika 1, e nenit 167, të Kodit)

1. Kur një operator ekonomik është i autorizuar për të përcaktuar shumën e detyrimit të importit ose eksportit që duhet paguar në përputhje me pikën 1, të nenit 167, të Kodit, ai operator, në fund të periudhës së caktuar nga autoritetet doganore në autorizim, do të përcaktojë shumën e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar për atë periudhë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në autorizim.

2. Brenda 10 ditëve pas përfundimit të periudhës së caktuar nga autoritetet doganore në autorizim, mbajtësi i këtij autorizimi duhet t'i paraqesë zyrës mbikëqyrëse doganore, detajet e shumës së përcaktuar në përputhje me pikën 1. Borxhi doganor konsiderohet i njoftuar në kohën e këtij dorëzimi.

3. Mbajtësi i autorizimit duhet të paguajë shumën e përmendur në pikën 2, brenda afatit të parashikuar në autorizim dhe jo më vonë se afati i parashikuar në pikën 1, të nenit 101, të Kodit.

KREU 3
Verifikimi dhe çlirimi i mallrave

Seksioni 1
Verifikimi

Neni 349
Vendi dhe koha e verifikimit të mallrave
(Neni 170 i Kodit)

Për të verifikuar nëse të gjitha mallrat që dalin nga një zonë doganore, korrespondojnë me të

dhënat në dokumentet doganore shoqëruese, autoritetet doganore organizojnë kontrollet që parashikohen në pikën 2, të nenit 10, të Kodit.

Kur autoritetet kompetente doganore kanë vendosur të verifikojnë mallrat në përputhje me shkronjën "c", të nenit 169, të Kodit, ose të marrë mostrat në përputhje me shkronjën "ç", të nenit 169, të Kodit, caktojnë kohën dhe vendin për këtë qëllim dhe informojnë deklaruesin e tyre.

Me kërkesë të deklaruesit, autoriteti doganor kompetent mund të caktojë një vend të ndryshëm nga ambientet doganore dhe një kohë jashtë orarit zyrtar për të kryer verifikimin.

Neni 350
Verifikimi i mallrave
(Nenet 170 dhe 171, të Kodit)

1. Kur autoritetet doganore vendosin të verifikojnë vetëm një pjesë të mallrave, informojnë deklaruesin për artikujt të cilët ata dëshirojnë të verifikojnë.

2. Kur deklaruesi refuzon të jetë i pranishëm në verifikimin e mallrave ose nuk siguron ndihmën e nevojshme, siç kërkohet nga autoritetet doganore, këto të fundit do të caktojnë një afat për praninë apo ndihmën e tij.

Kur deklaruesi nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e autoriteteve doganore me kalimin e afatit, autoritetet doganore do të vazhdojnë me verifikimin e mallrave, me risk dhe shpenzime të deklaruesit. Kur është e nevojshme, autoritetet doganore mund të kërkojnë edhe shërbimet e një eksperti të jashtëm të licencuar në përputhje me ligjin.

Neni 351
Marrja e mostrave
(Nenet 170 dhe 171, të Kodit)

1. Kur zyra doganore vendos të marrë mostrat e mallrave, ajo informon deklaruesin e tyre.

Kur deklaruesi refuzon të jetë i pranishëm kur mostrat merren ose nuk siguron ndihmën e nevojshme, siç kërkohet nga autoritetet doganore, këto të fundit do të caktojnë një afat për praninë apo ndihmën e tij.

2. Kur deklaruesi nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e autoriteteve doganore me kalimin e afatit, autoritetet doganore do të vazhdojnë me marrjen e mostrave, me risk dhe shpenzime të deklaruesit.

3. Mostrat duhet të merren nga vetë autoritetet doganore. Megjithatë, në raste specifike kur është e pamundur marrja e mostrave nga autoritetet doganore për shkak të llojit të mallit dhe ekspertizës apo mjeteve të posaçme që kërkohen për marrjen e mostrave, ato mund të kërkojnë që mostra të merret nga deklaruesi ose të thërrasin një ekspert të licencuar për të marrë mostrat, nën mbikëqyrjen e tyre. Eksperti duhet të jetë i licencuar në përputhje me ligjin.

4. Për analizat merren tre mostra, secila prej të cilave vendoset në një kuti/paketim dhe secila kuti vuloset/plumboset me vulën e doganës. Nga tre mostrat e marra një mbahet në zyrën doganore, tjetra dërgohet për analiza në laboratorin doganor dhe e treta i jepet deklaruesit. Sasitë e marra si mostra nuk duhet të tejkalojnë atë që është e nevojshme për analiza apo ekzaminim më të detajuar, duke përfshirë analizën e mundshme të mëpasshme.

5. Sasitë e marra si mostra nuk do të zbriten nga sasia e deklaruar.

6. Kur bëhet fjalë për një deklaratë të përpunimit pasiv ose të eksportit, deklaruesi mund të zëvendësojë sasinë e mallrave të marra si mostra nga mallrat identike, në mënyrë që të bëhet dërgesa.

Neni 352
Shqyrtimi i mostrave
(Nenet 170 dhe 171, të Kodit)

1. Kur shqyrtimi i mostrave të të njëjtave mallra, çon në rezultate të ndryshme që kërkojnë trajtim të ndryshëm doganor, kur është e mundur do të merren mostra të mëtejshme.

2. Kur rezultatet e shqyrtimit të mostrave të mëtejshme konfirmojnë rezultate të ndryshme, mallrat do të konsiderohen si të përbëra nga mallra të ndryshme në sasi që korrespondojnë me rezultatet e shqyrtimit. E njëjta gjë zbatohet kur nuk është e mundur të merren mostra të mëtejshme.

Neni 353
Kthimi ose asgjësimi i mostrave të marra
(Nenet 170 dhe 171, të Kodit)

1. Mostrat e marra i kthehen deklaruesit me kërkesën e tij, përveç në rastet e mëposhtme:

a) Kur mostrat janë shkatërruar nga analizimi apo verifikimi;

b) Kur mostrat duhet të mbahen nga autoritetet doganore për qëllimet e mëposhtme:

i) Shqyrtim i mëtejshëm;
ii) Ankimi ose procedura gjyqësore.

2. Kur deklaruesi nuk ka bërë një kërkesë për t'ia kthyer mostrat, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë deklaruesit të heqë mostrat që kanë mbetur ose t'i shkatërrojë ato në përputhje me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 179, të Kodit.

Neni 354
Rezultatet e verifikimit të deklaratës doganore dhe të kontrollit të mallrave
(Neni 172 i Kodit)

1. Kur autoritetet doganore verifikojnë saktësinë e të dhënave të një deklarate doganore, ato duhet të regjistrojnë faktin se është kryer një verifikim si dhe rezultatet e atij verifikimi. Në këtë rast, një punonjës doganor do të jetë përgjegjës për të shënuar në kutinë përkatëse të deklaratës doganore rezultatet e kontrolleve të kryera.

Kur vetëm një pjesë e mallrave është kontrolluar, mallrat e kontrolluara duhet të regjistrohen. Kur deklaruesi mungon, do të regjistrohet mungesa e tij.

2. Autoritetet doganore i informojnë deklaruesit rezultatet e verifikimit.

3. Kur rezultatet e verifikimit të deklaratës doganore nuk janë në përputhje me të dhënat e deklaratës, autoritetet doganore regjistrojnë të dhënat, të cilat janë detaje që duhet të merren parasysh për qëllimet, si më poshtë:

a) Llogaritjen e shumës së detyrimit të importit ose të eksportit dhe pagesave të tjera për mallrat;

b) Llogaritjen e çdo rimbursimi ose shumave të tjera apo avantazheve financiare të parashikuara në eksport në bazë të politikave bujqësore;

c) Aplikimin e të gjitha dispozitave që rregullojnë regjimin doganor nën të cilën janë vendosur mallrat.

4. Kur deklarimi i origjinës jopreferenciale konstatohet si i pasaktë, origjina që do të merret parasysh për qëllime të shkronjës "a", të pikës 3, do të vendoset në bazë të provave të paraqitura nga deklaruesi ose, kur kjo nuk është e mjaftueshme ose e pranueshme, mbi bazën e çdo informacioni në dispozicion.

Seksioni 2
Çlirimi i mallrave

Neni 355
Depozitimi i një garancie
(Neni 172 i Kodit)

Kur autoritetet doganore gjykojnë se verifikimi i deklaratës doganore mund të rezultojë në një shumë më të lartë të detyrimit të importit ose të eksportit ose të detyrimeve të tjera të pagueshme se ajo që rezulton nga të dhënat e deklaratës doganore, çlirimi i mallrave do të jetë i kushtëzuar me depozitimin e një garancie të mjaftueshme për të mbuluar diferencën midis shumës sipas deklaratës doganore dhe shumës e cila në fund mund të jetë e pagueshme.

Megjithatë, deklaruesi mund të kërkojë njoftimin e menjëhershëm të borxhit doganor, ndaj të cilit mallrat përfundimisht mund t'i nënshtrohen, në vend të depozitimit të kësaj garancie.

Neni 356
Çlirimi i pakushtëzuar nga dhënia e një garancie
(Pika 2, e nenit 176, të Kodit)

Nëse para çlirimit të mallrave që janë objekt i një kërkese për përfitim nga një kuotë tarifore dhe kjo kuotë tarifore nuk konsiderohet kritike, çlirimi i mallrave nuk kushtëzohet nga dhënia e një garancie në lidhje me ato mallra.

Neni 357
Çlirimi i mallrave pas verifikimit
(Nenet 172 dhe 175, pika 1, të Kodit)

1. Kur, në bazë të verifikimit të deklaratës doganore, autoritetet doganore përcaktojnë një shumë të detyrimit të importit ose të eksportit, të ndryshme nga shuma që rezulton nga të dhënat në deklaratë, pika 1, e nenit 176, të Kodit do të zbatohet lidhur me shumën e vlerësuar në këtë mënyrë.

2. Kur autoritetet doganore kanë dyshime nëse një ndalim apo kufizim do të zbatohet apo jo dhe kjo nuk mund të zgjidhet deri sa rezultatet e kontrolleve të kryera nga autoritetet doganore të jenë në dispozicion, mallrat në fjalë nuk do të çlirohen.

Neni 358
Regjistrimi dhe njoftimi i çlirimit të mallrave
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

Autoritetet doganore njoftojnë çlirimin e mallrave deklaruesit dhe regjistrojnë vendosjen e mallrave nën regjimin doganor në fjalë, duke treguar të paktën referencën e deklaratës doganore ose njoftimit dhe datën e çlirimit të mallrave.

Neni 359
Njoftimi i çlirimit të mallrave
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Kur deklarata për një regjim doganor ose rieksport është depozituar duke përdorur mjete të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave, autoritetet doganore me qëllim njoftimin e deklaruesit për çlirimin e mallrave mund të përdorin mjete të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

2. Kur mallrat kanë qenë në magazinim të përkohshëm para çlirimit të tyre dhe autoritetet doganore duhet të informojnë mbajtësin e autorizimit të magazinimit të përkohshëm për çlirimin e mallrave, informacioni mund të jepet duke përdorur mjete të tjera, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 360
Mallrat e pa çliruara
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

1. Kur, për ndonjë nga arsyet e renditura në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 179, të Kodit, mallrat nuk mund të çlirohen ose kur, pas çlirimit të tyre, konstatohet se mallrat nuk kanë plotësuar kushtet për këtë çlirim, autoritetet doganore do t'i japin deklaruesit një afat kohor të arsyeshëm për të korrigjuar situatën e mallrave.

2. Autoritetet doganore mund, me risk dhe shpenzime të deklaruesit, të transferojnë mallrat e përmendura në pikën 1, në ambiente të veçanta nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore.

KREU 4
Shkatërrimi i mallrave

Neni 361
Shkatërrimi i mallrave
(Neni 178 i Kodit)

Autoritetet doganore vendosin llojin dhe sasinë e çdo mbetjeje ose hedhurine, që rezulton nga shkatërrimi i mallrave me qëllim të përcaktimit të ndonjë detyrimi doganor dhe pagesave të të tjera të zbatueshme për atë mbeturinë apo hedhurinë, kur vendosen nën një regjim doganor ose rieksportohen.

Neni 362
Braktisja e mallrave
(Neni 180 i Kodit)

1. Autoritetet doganore mund të refuzojnë një kërkesë për leje për të braktisur mallrat në favor të shtetit, në përputhje me nenin 180, të Kodit, kur përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Mallrat nuk mund të shiten brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose kostoja e kësaj shitjeje do të jetë në disproporcion me vlerën e mallrave;

b) Mallrat do të shkatërrohen.

2. Një kërkesë për braktisje në favor të shtetit do të konsiderohet se është bërë në përputhje me nenin 180, të Kodit, kur autoritetet doganore kanë bërë një njoftim publik për pronarin e mallrave që të paraqitet dhe pronari nuk është paraqitur brenda 90 ditësh.

Neni 363
Shitja e mallrave dhe masa të tjera të marra nga autoritetet doganore
(Pika 1, e nenit 179, të Kodit)

1. Autoritetet doganore mund t'i shesin mallrat e braktisura ose të konfiskuara, vetëm me kusht që blerësi të kryejë menjëherë formalitetet për të vendosur mallrat nën një regjim doganor ose t'i rieksportojë ato.

2. Kur mallrat janë shitur me një çmim gjithëpërfshirës të shumës së detyrimit të importit dhe pagesave të tjera, mallrat konsiderohen se janë çliruar për qarkullim të lirë. Autoritetet doganore llogarisin shumën e detyrimeve dhe e shënojnë atë në llogari.

3. Mallrat e braktisura apo të konfiskuara shiten nga dega doganore kompetente që ka bërë

konfiskimin, në përputhje me legjislacionin ne fuqi për ankandin publik, me përjashtim të rastit kur Kodi Doganor apo akte të tjera ligjore parashikojnë ndryshe.

KREU 5
Pronësia intelektuale në doganë

Seksioni 1
Të përgjithshme

Neni 364
Objekti dhe fusha e zbatimit
(Nenet 125 dhe 131, të Kodit)

1. Ky kre përcakton kushtet dhe procedurat lidhur me veprimet që ndërmerren nga autoritetet doganore, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelet një e drejtë e pronësisë intelektuale nga mallra, të cilat janë ose duhet të ishin objekt i mbikëqyrjes doganore apo kontrollit doganor, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Kodin Doganor, në veçanti për mallrat në rrethana, si më poshtë:

a) Kur deklarohen për çlirim për qarkullim të lirë, eksport apo rieksport;

b) Kur hyjnë apo dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

c) Kur vendosen në regjim pezullimi apo në zonë ose magazinë të lirë.

2. Pa cenuar nenet 378 dhe 379, në përputhje me kriteret e analizës së riskut, me qëllim parandalimin e veprimeve që shkelin ligjin për pronësinë intelektuale në territorin e Republikës së Shqipërisë, autoritetet doganore kryejnë kontrollet e nevojshme doganore në lidhje me mallrat, objekt i mbikëqyrjes doganore ose kontrollit doganor, dhe marrin masat e duhura të identifikimit, siç parashikohet në nenet 10, 125, 131 dhe 239, të Kodit.

3. Ky kapitull nuk zbatohet për:

a) mallra, të cilat janë çliruar për qarkullim të lire nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*);

b) mallrat e natyrës jotregtare të mbajtura në bagazhet personale të udhëtarëve;

c) mallra, të cilat janë prodhuar nga një person me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës apo për mallra, të cilat janë prodhuar nga një person i autorizuar ligjërisht nga mbajtësi i së drejtës për prodhimin e një sasie të caktuar të mallrave, në tejkalim të sasive për të cilat është rënë dakord ndërmjet personit në fjalë dhe mbajtësit të së drejtës.

4. Për qëllime të këtij kreu, pa cenuar legjislacionin në fuqi:

a) "E drejtë e pronësisë intelektuale", nënkupton:

i. një markë tregtare;

ii. një dizenjo industriale;

iii. të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;

iv. një tregues gjeografik;

v. një patentë për shpikje, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi;

vi. një certifikatë mbrojtjeje shtesë për barnat, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi në lidhje me certifikatën e mbrojtjes shtesë për barnat;

vii. një certifikatë mbrojtjeje shtesë për produktet e mbrojtjes së bimëve, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi në lidhje me krijimin e një certifikate mbrojtjeje shtesë për produktet e mbrojtjes së bimëve;

viii. një e drejtë e varietetit bimor siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;

ix. një topografi e produkteve gjysmëkonduktorë sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi;

x. një model përdorimi i njohur si e drejtë e pronësisë intelektuale e mbrojtur nga legjislacioni në fuqi;

xi. një emër tregtar i njohur si e drejtë ekskluzive e pronësisë intelektuale e mbrojtur nga legjislacioni në fuqi.

b) "Markë tregtare", nënkupton:

i. një markë tregtare të regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

ii. një markë tregtare të regjistruar, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

c) "Dizenjo industriale", nënkupton:

i. një dizenjo industriale të regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

ii. një dizenjo industriale të regjistruar, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

ç) "Tregues gjeografik", nënkupton:

i. një tregues gjeografik të mbrojtur, sipas legjislacionit në fuqi;

ii. një tregues gjeografik për verërat, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

iii. një tregues gjeografik për pijet e aromatizuara të bazuara në produktet e verës, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi;

iv. një tregues gjeografik për pijet alkoolike, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi;

v. një tregues gjeografik, sipas përcaktimeve në marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera.

d) "Mallra të falsifikuara", nënkupton:

i. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare dhe pa lejen e mbajtësit të së drejtës mbajnë një shenjë identike me markën tregtare të regjistruar rregullisht për të njëjtat lloje mallrash ose që në thelb është e padallueshme nga kjo markë;

ii. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një tregues gjeografik dhe mbajnë ose janë të përshkruara me një emër ose term të mbrojtur në lidhje me atë tregues gjeografik;

iii. çdo paketim, etiketë, ngjitës, broshurë, udhëzues përdorimi, dokument garancie ose artikull tjetër i ngjashëm, edhe nëse paraqitet veçmas, që është objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare ose një tregues gjeografik, që përfshin një shenjë, emër ose term që është identik me një markë tregtare të regjistruar rregullisht ose tregues gjeografik të mbrojtur, ose që në thelb është e padallueshme nga një markë tregtare apo tregues gjeografik i tillë dhe që mund të përdoret për të njëjtin lloj mallrash si ai për të cilin është regjistruar marka tregtare ose treguesi gjeografik.

dh) "Mallra pirate", nënkupton mallrat, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të ose me një dizenjo industriale në Republikën e Shqipërisë dhe të cilat janë/ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të ose me dizenjon industriale apo të një personi të autorizuar prej mbajtësit, në vendin e prodhimit.

e) "Mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale", nënkupton mallrat e identifikuara në Republikën e Shqipërisë, të cilat pamje të parë kanë tregues të arsyeshëm se:

i. janë objekt i një veprimi që shkel një të drejtë të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë;

ii. kanë pajisje, produkte apo komponentë që janë projektuar, prodhuar apo përshtatur kryesisht, me qëllim për të mundësuar apo lehtësuar shmangien nga çdo teknologji, pajisje apo komponent, që në rrjedhën normale të operacionit të tij parandalon apo kufizon veprime lidhur me vepra të paautorizuara nga mbajtësi i të drejtave të autorit dhe çdo të drejte tjetër lidhur me të dhe e cila lidhet me një veprim që shkel këto të drejta në Republikën e Shqipërisë;

iii. kanë çdo format apo matricë të dizenjuar apo të përshtatur specifikisht për prodhimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, nëse këto formate apo matrica lidhen me një veprim që shkel të drejtën e pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë.

ë) "Mbajtës i së drejtës", nënkupton mbajtësin e një të drejte të pronësisë intelektuale.

f) "Aplikim", nënkupton kërkesën që paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të ndërmarrë veprime në lidhje me mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale.

g) "Aplikues", nënkupton një person, sipas përcaktimit në pikën 4, të nenit 6, të Kodit, ne emër të të cilit paraqitet një aplikim.

gj) "Mbajtës i vendimit", nënkupton një person ndaj të cilit është dhënë vendimi në bazë të aplikimit.

h) "Mbajtës i mallrave", nënkupton personin që ka në pronësi mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale apo që ka të drejta të ngjashme për tjetërsimin/shkatërrimin ose kontrollin fizik të këtyre mallrave.

i) "Deklarues", nënkupton deklaruesin sipas përcaktimit në pikën 15, të nenit 6, të Kodit.

j) "Shkatërrim", nënkupton shkatërrimin fizik, riciklimin ose asgjësimin e mallrave jashtë kanaleve tregtare në një mënyrë të tillë që të parandalojë dëmtimet ndaj mbajtësit të vendimit.

k) "Territor doganor", nënkupton territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimit në nenin 3, të Kodit.

l) "Çlirim i mallrave", nënkupton çlirimin e mallrave, sipas përcaktimit në pikën 26, të nenit 6, të Kodit.

ll) "Dërgesa të vogla", nënkupton dërgesa postare apo me korrier ekspres që:

i. përmbajnë tre apo më pak njësi; ose

ii. kanë një peshë bruto prej më pak se 2 kilogramë.

Me "njësi", nënkuptohen mallra sipas

klasifikimit në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave në fuqi, të paketuar ose jo, për mallra të shitura me pakicë ndaj konsumatorit përfundimtar.

Për qëllim të këtij përkufizimi, mallrat e ndara që përfshihen në të njëjtin kod të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave do të konsiderohen si njësi të ndryshme dhe mallrat e paraqitura si grup i klasifikuar në një kod të Nomenklaturës së Kombinuar do të konsiderohen si një njësi.

m) "Mallra që prishen shpejt", nënkupton mallrat që vlerësohen nga autoritetet doganore si mallra që prishen nga qëndrimi deri në 20 ditë, nga data e pezullimit të çlirimit të tyre apo ndalimit.

n) "Licencë ekskluzive", nënkupton një licencë (të përgjithshme ose të kufizuar) që autorizon personin e licencuar, duke përjashtuar çdo person tjetër, përfshirë edhe personin që e lëshon atë, për të përdorur një të drejtë të pronësisë intelektuale në mënyrën e autorizuar nga licenca.

Seksioni 2
Aplikimet

Neni 365
E drejta e paraqitjes së aplikimit
(Nenet 125 dhe 131, të Kodit)

Paraqesin aplikim, në masën që legjitimohen, për të filluar një procedurë që ka si qëllim të përcaktojë nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë personat fizikë dhe juridikë, si më poshtë vijon:

a) Mbajtësit e së drejtës;

b) Organet që administrojnë të drejtat kolektive të pronësisë intelektuale, sipas përcaktimeve të ligjit "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të";

c) Organet e mbrojtjes profesionale, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi;

ç) Grupet e prodhuesve të produkteve të mbrojtura si tregues gjeografikë apo përfaqësuesit e këtyre grupeve, personat me të drejtë për të përdorur treguesin gjeografik në fjalë;

d) Personat fizikë apo juridikë të autorizuar për të përdorur të drejtat e pronësisë intelektuale, të cilët janë autorizuar zyrtarisht nga mbajtësi i të drejtave për të filluar një procedurë me qëllim që të përcaktojnë nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

Neni 366
Paraqitja e aplikimeve
(Neni 27 i Kodit)

1. Aplikimet paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke përdorur formularin specifik për këtë qëllim, i cili përmban informacionin e përcaktuar në nenin 367.

2. Kur aplikimi paraqitet pas njoftimit nga autoritetet doganore për pezullimin e çlirimit apo ndalimin e mallrave, në përputhje me pikën 3, të nenit 379, aplikimi në fjalë duhet:

a) të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 4 ditëve pune nga data e njoftimit për pezullimin e çlirimit apo ndalimin e mallrave;

b) të jetë sipas formularit të përmendur në pikën 1, të nenit 367;

c) të përmbajë informacionin e përcaktuar në pikën 2, të nenit 367. Megjithatë, aplikuesi mund të mos përfshijë informacionin e përmendur në shkronjat "dh", "e" apo "ë", të pikës 2, të nenit 367.

3. Kur është e mundur, marrja dhe përpunimi i aplikimeve, si dhe dokumentet shoqëruese të nevojshme paraqiten duke përdorur teknika elektronike të përpunimit të të dhënave.

Neni 367
Formulari i aplikimit
(Neni 27 i Kodit)

1. Formulari i aplikimit është sipas aneksit 62, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në formularin e aplikimit duhet të përfshihet të paktën informacioni i mëposhtëm:

a) Detaje në lidhje me aplikuesin;

b) Statusi i aplikuesit, sipas kuptimit të nenit 365;

c) Dokumente që i vërtetojnë se aplikuesi ka të drejtë të paraqesë aplikimin;

ç) Kur aplikuesi paraqet aplikimin me anë të një përfaqësuesi, detajet e personit që e përfaqëson dhe provën se personi ka kompetenca të veprojë në cilësinë e përfaqësuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) E drejta apo të drejtat e pronësisë intelektuale që zbatohen;

dh) Të dhëna teknike dhe specifike për mallrat

origjinale, përfshirë shenjat, si bar-kodi dhe imazhet nëse është e nevojshme;

e) Informacioni i nevojshëm për t'u mundësuar autoriteteve doganore të identifikojnë menjëherë mallrat në fjalë;

ë) Informacioni që u duhet autoriteteve doganore për analizën dhe vlerësimin e riskut të shkeljeve të së drejtës apo të të drejtave të pronësisë intelektuale, i tillë si informacioni për distributorët e autorizuar;

f) Detajet e çdo përfaqësuesi të caktuar nga aplikuesi për të marrë përgjegjësi për çështjet teknike dhe ligjore;

g) Një deklaratë e aplikuesit që njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për një nga situatat e parashikuara në nenin 376;

gj) Një deklaratë dhe përditësimin e çdo informacioni që i duhet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për analizën dhe vlerësimin e riskut të shkeljeve të të drejtave apo të së drejtës së pronësisë intelektuale në fjalë;

h) Një deklaratë e aplikuesit, sipas së cilës ai merr përgjegjësitë sipas kushteve të përcaktuara në nenin 389;

i) Një deklaratë e aplikuesit, sipas së cilës ai merr përsipër kostot e referuara sipas kushteve të përcaktuara në nenin 390;

j) Një marrëveshje e aplikuesit, sipas së cilës të dhënat e vëna në dispozicion nga ai mund të përpunohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

k) Nëse aplikuesi kërkon përdorimin e procedurës së referuar në nenin 387 dhe në vijim të kërkesës së autoriteteve doganore, aplikuesi bie dakord të mbulojë kostot që lidhen me shkatërrimin e mallrave sipas kësaj procedure.

3. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, miraton udhëzimin për plotësimin e formularit të aplikimit.

Seksioni 3
Vendimet për aplikimet

Neni 368
Përpunimi i aplikimeve të paplota
(Neni 27 i Kodit)

1. Kur, pas marrjes së aplikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vlerëson se aplikimi nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar sipas pikës 2, të nenit 367, i kërkon aplikuesit të vërë në dispozicion informacionin që mungon brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit të kërkesës.

Në këto raste, afati përfundimtar i referuar në pikën 1, të nenit 370, pezullohet deri sa të merret informacioni i nevojshëm.

2. Kur aplikuesi nuk vë në dispozicion informacionin e munguar brenda afatit të referuar në paragrafin e parë, të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave refuzon aplikimin.

Neni 369
Pagesat
(Neni 53 i Kodit)

Aplikuesit nuk i kërkohet asnjë pagesë për të mbuluar kostot administrative për shqyrtimin e aplikimit.

Neni 370
Njoftimi i vendimeve të miratimit ose refuzimit të aplikimit
(Neni 27 i Kodit)

1. Aplikimi shqyrtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila merr vendim për miratimin apo refuzimin e aplikimit, që i njoftohet me shkrim kërkuesit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e marrjes të aplikimit. Në rast refuzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave jep arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi, si dhe vënë dukje të drejtën për ankim.

2. Nëse aplikuesi është njoftuar për pezullimin e çlirimit apo ndalimin e mallrave nga autoritetet doganore përpara paraqitjes së aplikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të njoftojë aplikuesin për vendimin e miratimit apo refuzimit të aplikimit, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit.

Neni 371
Vendime në lidhje me aplikimet
(Neni 27 i Kodit)

1. Vendimi për miratimin e aplikimit dhe çdo vendim për revokimin apo ndryshimin e tij kanë efekt nga e nesërmja e datës së marrjes së vendimit.

2. Vendimi, që zgjat afatin gjatë së cilit autoritetet doganore ndërmarrin veprime, ka efekt nga e nesërmja e datës së përfundimit të afatit që do të zgjatet.

Neni 372
Periudha gjatë së cilës autoritetet doganore ndërmarrin veprime
(Neni 28 i Kodit)

1. Kur miratohet një aplikim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave specifikon afatin gjatë së cilit autoritetet doganore do të ndërmarrin veprime.

Ky afat fillon ditën në të cilën fillon efektet vendimi i miratimit të aplikimit, sipas nenit 371, dhe nuk duhet të kalojë një vit nga e nesërmja e datës së marrjes të vendimit.

2. Kur aplikimi i paraqitur, pas njoftimit të autoritetit doganor për pezullimin e çlirimit apo ndalimit të mallrave në përputhje me pikën 3, të nenit 379, nuk përmban informacionin e përmendur në shkronjat "dh", "e" apo "ë", të pikës 2, të nenit 367, aplikimi miratohet vetëm për pezullimin e çlirimit apo ndalimin e mallrave në fjalë, përveçse kur ky informacion vihet në dispozicion brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas njoftimit për pezullimin e çlirimit apo ndalimin e mallrave.

3. Kur e drejta e pronësisë intelektuale nuk ka më efekt ligjor/pushon së qeni e vlefshme ose kur aplikuesi, për arsye të tjera, nuk ka më të drejtë të paraqesë aplikim, autoritetet doganore nuk ndërmarrin asnjë veprim. Vendimi për miratimin e aplikimit revokohet apo ndryshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përputhje me rrethanat.

Neni 373
Zgjatja e afatit gjatë të cilit autoritetet doganore ndërmarrin veprime
(Neni 28 i Kodit)

1. Me përfundimin e afatit gjatë të cilit autoritetet doganore duhet të ndërmarrin veprime dhe nëse paraprakisht është shlyer çdolloj detyrimi ndaj autoriteteve doganore, sipas këtij vendimi, në ngarkim të mbajtësit të vendimit, ky i fundit mund të kërkojë zgjatjen e afatit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që ka miratuar vendimin fillestar, mund të zgjatë afatin në fjalë.

2. Nëse kërkesa për zgjatje të afatit, gjatë të cilit autoritetet doganore ndërmarrin veprime, paraqitet në më pak se 30 (tridhjetë) ditë pune përpara përfundimit të afatit të miratuar me vendimin fillestar për ndërmarrjen e veprimeve, kërkesa mund të refuzohet.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i njofton mbajtësit të vendimit vendimin për zgjatjen e afatit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës së referuar në pikën 1.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave specifikon në vendim afatin gjatë të cilit do të ndërmarrë veprime. Afati i zgjatur gjatë të cilit autoritetet doganore ndërmarrin veprime fillon ne datën vijuese të datës së përfundimit të periudhës së mëparshme dhe nuk duhet të kalojë një vit.

5. Kur e drejta e pronësisë intelektuale nuk ka më efekt ligjor/pushon së qeni e vlefshme ose kur aplikuesi, për arsye të tjera, nuk ka më të drejtë të paraqesë aplikim, autoritetet doganore nuk marrin asnjë masë mbrojtëse. Vendimi që lejon zgjatjen e afatit revokohet ose ndryshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në përputhje me rrethanat.

6. Mbajtësit të vendimit nuk i kërkohet asnjë pagesë për të mbuluar kostot administrative për shqyrtimin e kërkesës për zgjatje të afatit.

7. Formulari i aplikimit është sipas aneksit 63, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, miraton udhëzimin për plotësimin e formularit të aplikimit për zgjatjen e afatit.

Neni 374
Ndryshimi i vendimit lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale
(Neni 27 dhe 28 i Kodit)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me kërkesë të mbajtësit të vendimit, mund të ndryshojë listën e të drejtave të pronësisë intelektuale të miratuara në atë vendim.

2. Kur shtohet një e drejtë e re e pronësisë intelektuale, kërkesa duhet të përmbajë informacionin e referuar në shkronjat "c", "d", "dh", "e", "ë", të pikës 2, të nenit 367.

Neni 375
Detyrimet për njoftim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
(Neni 28 i Kodit)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pranë të cilës është paraqitur një aplikim apo një kërkesë, menjëherë pas miratimit, njofton degët doganore për vendimet për:

a) miratimin e aplikimit;

b) revokimin e vendimeve që miratojnë aplikimin;

c) ndryshimin e vendimeve që miratojnë aplikimin;

ç) zgjatjen e afatit gjatë të cilit autoritetet doganore ndërmarrin veprime.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton degët doganore për vendimin për pezullimin e veprimeve, menjëherë pas miratimit, sipas pikës 2, të nenit 377.

Neni 376
Detyrimet për njoftim të mbajtësit të vendimit
(Neni 27 i Kodit)

Mbajtësi i vendimit duhet të njoftojë, menjëherë, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për secilin nga rastet e mëposhtme:

a) Kur një e drejtë e pronësisë intelektuale, për të cilën është miratuar aplikimi, pushon së qeni e vlefshme;

b) Kur mbajtësi i vendimit, për arsye të tjera, nuk ka më të drejtë të paraqesë një aplikim;

c) Kur ka ndryshime në informacionin e përmendur në pikën 2, të nenit 367.

Neni 377
Pamundësia e mbajtësit të vendimit për të përmbushur detyrimet e tij
(Neni 28 i Kodit)

1. Kur mbajtësi i vendimit përdor informacionin e vënë në dispozicion nga autoritetet doganore, për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 382 ose e keqpërdor atë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të revokojë vendimin me të cilin është miratuar një aplikim ndaj mbajtësit të vendimit dhe të refuzojë zgjatjen e afatit për ndërmarrjen e veprimeve nga autoritetet doganore.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë pezullimin e ndërmarrjes së veprimeve nga autoritetet doganore deri në përfundimin e afatit të kryerjes së këtyre veprimeve, kur mbajtësi i vendimit:

a) nuk përmbush detyrimet e njoftimit, të përcaktuara në nenin 376;

b) nuk përmbush detyrimet e kthimit të mostrave, të përcaktuara në pikën 3, të nenit 380;

c) nuk përmbush detyrimet për kostot dhe përkthimin, të përcaktuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 390;

ç) nuk fillon asnjë procedurë sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 384, apo pikës 9, të nenit 387 pa arsye të bazuar.

Seksioni 4
Pezullimi i çlirimit apo ndalimi i mallrave

Neni 378
Pezullimi i çlirimit apo ndalimi i mallrave pas miratimit të aplikimit
(Nenet 10, 27, 125, 131 të Kodit)

1. Kur autoritetet doganore identifikojnë mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale, për të cilën është miratuar një vendim për aplikimin në lidhje me këto mallra, ato pezullojnë apo ndalojnë çlirimin e mallrave në fjalë.

2. Përpara pezullimit të çlirimit apo ndalimit të mallrave, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë mbajtësit të vendimit që t'i vërë në dispozicion atyre informacionin e nevojshëm në lidhje me mallrat. Autoritetet doganore mund, gjithashtu, t'i vënë në dispozicion mbajtësit të të drejtave informacion për sasinë reale apo të vlerësuar të mallrave, imazhin dhe natyrën e tyre aktuale apo të supozuar, sipas nevojës.

3. Autoritetet doganore njoftojnë deklaruesin apo mbajtësin e mallrave për pezullimin e çlirimit të mallrave apo ndalimin e tyre, brenda 1 (një) ditë pune nga data e pezullimit apo ndalimit.

Kur autoritetet doganore vendosin të njoftojnë mbajtësin e mallrave dhe nëse dy apo më shumë persona konsiderohen si mbajtës të tyre, autoritetet doganore nuk kanë detyrim të njoftojnë më shumë se një nga personat në fjalë. Autoritetet doganore njoftojnë mbajtësin e vendimit për pezullimin e çlirimit të mallrave apo ndalimin e tyre në të njëjtën ditë ose menjëherë pas njoftimit të deklaruesit apo mbajtësit të mallrave. Njoftimet duhet të përfshijnë informacion për procedurën e përcaktuar në nenin 384.

4. Autoritetet doganore njoftojnë mbajtësin e vendimit dhe deklaruesin ose mbajtësin e mallrave për sasinë dhe natyrën reale apo të vlerësuar të mallrave, përfshirë imazhet e disponueshme, sipas nevojës, çlirimi i të cilave është pezulluar apo nëse mallrat në fjalë janë ndaluar. Autoritetet doganore, sipas kërkesës dhe kur është e mundur, njoftojnë

mbajtësin e vendimit për emrat dhe adresat e marrësit të ngarkesës, dërguesin dhe deklaruesin apo mbajtësin e mallrave, për procedurat doganore dhe origjinën, prejardhjen dhe destinacionin e mallrave, për të cilat është pezulluar çlirimi ose që janë ndaluar.

Neni 379
Pezullimi i çlirimit apo ndalimi i mallravepërpara miratimit të aplikimit
(Neni 10, 125, 131 i Kodit)

1. Kur autoritetet doganore identifikojnë mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale, por që nuk përfshihen në vendimin me të cilin është miratuar aplikimi, ato mund, përveç se në rastet e mallrave që prishen shpejt, të pezullojnë çlirimin e këtyre mallrave apo t'i ndalojnë ato.

2. Përpara pezullimit të çlirimit apo ndalimit të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë çdo personi fizik apo juridik, që mund të ketë të drejtë të paraqesë aplikim në lidhje me shkeljen e dyshuar të të drejtave të pronësisë intelektuale, për t'i ofruar atyre informacionin e nevojshëm, pa dhënë informacion tjetër përveç të dhënave për sasinë dhe natyrën reale apo të vlerësuar të mallrave, përfshirë imazhet e disponueshme, kur është e duhur.

3. Autoritetet doganore duhet të njoftojnë deklaruesin apo mbajtësin e mallrave për pezullimin e çlirimit të mallrave apo ndalimin e tyre brenda një dite pune nga data e pezullimit apo ndalimit. Kur autoritetet doganore vendosin të njoftojnë mbajtësin e mallrave dhe nëse dy apo më shumë persona konsiderohen si mbajtës të tyre, autoritetet doganore nuk kanë detyrim të njoftojnë më shumë se një nga personat në fjalë. Autoritetet doganore njoftojnë personat fizikë apo juridikë, që kanë të drejtë të paraqesin aplikim në lidhje me shkeljen e dyshuar të të drejtave të pronësisë intelektuale, për pezullimin e çlirimit të mallrave apo ndalimin e tyre në të njëjtën datë apo menjëherë pasi kanë njoftuar deklaruesin apo mbajtësin e mallrave.

Autoritetet doganore mund të konsultohen me autoritetet publike përgjegjëse, me qëllim identifikimin e personave fizikë apo juridikë që kanë të drejtë të paraqesin aplikim. Në njoftime duhet të përfshihet informacion për procedurën e përcaktuar në nenin 384.

4. Autoritetet doganore çlirojnë mallrat ose heqin masën e ndalimit të tyre menjëherë pas përfundimit të të gjitha formaliteteve doganore, në rastet e mëposhtme:

a) Kur nuk kanë identifikuar asnjë person fizik apo juridik që ka të drejtë të paraqesë aplikim në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të pronësisë intelektuale, brenda një dite pune nga data e pezullimit të çlirimit apo ndalimit të mallrave;

b) Kur nuk kanë marrë aplikim në përputhje me pikën 2, të nenit 366, apo nëse e kanë refuzuar një aplikim të tillë.

5. Kur miratohet aplikimi, autoritetet doganore, sipas kërkesës dhe kur është e mundur, njoftojnë mbajtësin e vendimit për emrat dhe adresat e marrësit të ngarkesës, dërguesin dhe deklaruesin apo mbajtësin e mallrave, për procedurat doganore dhe origjinën, prejardhjen dhe destinacionin e mallrave, për të cilat është pezulluar çlirimi ose që janë ndaluar.

Neni 380
Inspektimi dhe marrja e mostrave të mallrave për të cilat është pezulluar çlirimi apo që janë ndaluar
(Nenet 10, 131 të Kodit)

1. Autoritetet doganore i japin mundësi mbajtësit të vendimit dhe deklaruesit apo mbajtësit të mallrave që të kontrollojnë/të inspektojnë mallrat për të cilat është pezulluar çlirimi apo që janë ndaluar.

2. Autoritetet doganore mund të marrin mostra që përfaqësojnë mallrat. Ato mund t'ia dorëzojnë apo t'ia dërgojnë mostrat në fjalë mbajtësit të vendimit, në bazë të kërkesës së tij dhe vetëm për bërjen e analizave e përshpejtimin e procedurave në lidhje me mallrat e falsifikuara apo pirate. Çdo analizë e këtyre mostrave kryhet vetëm nën përgjegjësinë dhe me shpenzimet e mbajtësit të vendimit.

3. Mbajtësi i vendimit duhet, përveçse kur nuk e lejojnë rrethanat, t'ua kthejë mostrat e referuara në pikën 2 autoriteteve doganore, pas bërjes së analizave dhe jo më vonë se periudha kur mallrat janë çliruar apo ka përfunduar ndalimi i tyre.

Neni 381
Kushtet e magazinimit
(Neni 131 i Kodit)

Kushtet e magazinimit të mallrave gjatë periudhës së pezullimit të çlirimit apo ndalimit të tyre përcaktohen nga autoritetet doganore.

Neni 382
Përdorimi i lejuar i një informacioni të caktuar nga mbajtësi i vendimit
(Neni 20 i Kodit)

Kur mbajtësi i vendimit ka marrë informacionin e përmendur në pikën 4, të nenit 378, pikën 5, të nenit 379, nenin 380 ose pikën 8, të nenit 387, ai mund ta japë apo ta përdorë informacionin në fjalë vetëm për qëllimet e mëposhtme:

a) Për të filluar një procedim gjyqësor, që përcakton nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale, si dhe gjatë kohëzgjatjes së procedimit;

b) Në lidhje me hetimet penale për shkelje të një të drejte të pronësisë intelektuale, të kryera nga autoritete të tjera proceduese kompetente;

c) Për të filluar një procedim penal dhe gjatë procedimit;

ç) Për të kërkuar kompensim nga shkelësi apo persona të tjerë;

d) Për të rënë dakord me deklaruesin apo mbajtësin e mallrave që mallrat të shkatërrohen në përputhje me pikën 1, të nenit 384;

dh) Për të rënë dakord me deklaruesin apo mbajtësin e mallrave për shumën e garancisë, të referuar në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 385.

Neni 383
Shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave ndërmjet autoriteteve doganore
(Neni 20 i Kodit)

1. Pa cenuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe me qëllim dhënien e kontributit për shmangien e tregtisë ndërkombëtare të mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale, autoritetet doganore mund të shkëmbejnë informacionin dhe të dhënat që disponojnë me autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera, sipas përcaktimeve në marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi.

2. Informacioni dhe të dhënat e referuara në pikën 1, shkëmbehen për të lejuar zbatimin efikas të ligjit për dërgesat e mallrave që shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale. Informacioni dhe të dhënat e tilla mund të lidhen me konfiskime, tendencat dhe informacion të përgjithshëm për riskun, duke përfshirë edhe mallrat transit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që kanë origjinën nga/apo destinacion një vend tjetër jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Në këto të dhëna mund të përfshihet, kur është e nevojshme, informacion për:

a) natyrën dhe sasinë e mallrave;

b) të drejtën e pronësisë intelektuale që dyshohet se shkelet;

c) origjinën, prejardhjen dhe destinacionin e mallrave;

ç) lëvizjet e mjeteve të transportit, në veçanti:

i) emri i anijes dhe regjistrimi i mjetit të transportit;

ii) numrat e referencës së faturës së ngarkesës apo dokumente të tjera transporti;

iii) numri i kontejnerëve;

iv) pesha e ngarkesës;

v) përshkrimi dhe/ose kodi i mallrave;

vi) numri i rezervimit;

vii) numri i vulës;

viii) vendi i ngarkimit të parë;

ix) vendi i shkarkimit të fundit;

x) vendet e transbordimit;

xi) data e parashikuar e mbërritjes në vendin e shkarkimit të fundit.

d) lëvizjet e kontejnerëve, në veçanti:

i) numri i kontejnerit;

ii) statusi i ngarkesës së kontejnerit;

iii) data e lëvizjes;

iv) lloji i lëvizjes (ngarkim, shkarkim, transferim, hyrje, dalje etj.);

v) emri i anijes ose regjistrimi i mjetit të transportit;

vi) numri i udhëtimit/lundrimit;

vii) vendi;

viii) fatura e ngarkesës apo dokumente të tjera transporti.

3. Rregullat për shkëmbimin e të dhënave, të referuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përcaktohen në marrëveshjet ndërkombëtare dy dhe shumëpalëshe.

Seksioni 5
Shkatërrimi i mallrave, fillimi i procedurave dhe çlirimi i hershëm i mallrave

Neni 384
Shkatërrimi i mallrave dhe fillimi i procedurave
(Neni 178 i Kodit)

1. Mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale mund të shkatërrohen nën mbikëqyrje doganore, pa qenë e nevojshme të vërtetohet nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Mbajtësi i vendimit u konfirmon me shkrim autoriteteve doganore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ose 3 (tri) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen shpejt, nga data e njoftimit për pezullimin e çlirimit ose ndalimin e mallrave se, sipas bindjes së tij, është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale;

b) Mbajtësi i vendimit u jep me shkrim autoriteteve doganore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, ose 3 (tri) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen shpejt, nga data e njoftimit për pezullimin e çlirimit ose ndalimin e mallrave, pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave;

c) Deklaruesi apo mbajtësi i mallrave u jep me shkrim autoriteteve doganore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ose 3 (tri) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen shpejt, nga data e njoftimit për pezullimin e çlirimit ose ndalimin e mallrave, pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka njoftuar kundërshtimin e tij pranë autoriteteve doganore brenda këtyre afateve, autoritetet doganore mund të vlerësojnë se deklaruesi apo mbajtësi i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

Autoritetet doganore çlirojnë mallrat apo përfundojnë ndalimin e tyre, menjëherë pas përfundimit të të gjitha formaliteteve doganore, kur brenda afateve të përcaktuara në shkronjat "a", dhe "b", të pikës 1, ata nuk i kanë marrë të dyja, konfirmimin me shkrim nga mbajtësi i vendimit se, sipas bindjes së tij, është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale dhe pëlqimin e tij me shkrim për shkatërrimin e mallrave, përveçse kur këto autoritete janë informuar ligjërisht për fillimin e procedimit gjyqësor, nëpërmjet paraqitjes së një kopjeje të aktpadisë, të paraqitur pranë gjykatës kompetente për të vendosur nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

2. Shkatërrimi i mallrave kryhet nën kontrollin doganor dhe nën përgjegjësinë e mbajtësit të vendimit. Autoritetet doganore mund të marrin mostra përpara shkatërrimit të mallrave. Mostrat që merren mund të përdoren për qëllime edukative.

3. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe kur nuk vlerësohet se ai ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën "c", të paragrafit të parë, të pikës 1, autoritetet doganore njoftojnë për këtë menjëherë mbajtësin e vendimit. Mbajtësi i vendimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ose 3 (tri) ditëve pune në rastin e mallrave që prishen shpejt, nga njoftimi i pezullimit të çlirimit apo ndalimit të mallrave, duhet të fillojë procedimin gjyqësor, nëpërmjet paraqitjes së një kopjeje të aktpadisë, të paraqitur pranë gjykatës kompetente për të vendosur nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

4. Përveçse në rastin e mallrave që prishen shpejt, autoritetet doganore, në raste të përshtatshme, mund të zgjatin afatin e përcaktuar në pikën 3, deri në 10 (dhjetë) ditë pune, me kërkesë të justifikuar nga mbajtësi i vendimit.

5. Autoritetet doganore çlirojnë mallrat apo përfundojnë ndalimin e tyre, menjëherë pas përfundimit të të gjitha formaliteteve doganore, nëse, brenda afateve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, nuk janë informuar ligjërisht, në përputhje me pikën 3, për fillimin e procedimit gjyqësor, nëpërmjet paraqitjes së një kopjeje të aktpadisë, të paraqitur pranë gjykatës kompetente për të vendosur nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

Neni 385
Çlirimi i hershëm i mallrave
(Nenet 87 dhe 88, të Kodit)

1. Kur autoritetet doganore janë njoftuar për fillimin e procedurës gjyqësore për të përcaktuar nëse një dizenjo industriale, patentë për shpikje, model përdorimi, topografi e një produkti gjysmëpërçues apo varieteti bimor është shkelur, deklaruesi apo mbajtësi i mallrave mund t'u kërkojë

autoriteteve doganore çlirimin e mallrave përpara përfundimit të procedurave në fjalë.

2. Autoritetet doganore çlirojnë mallrat apo përfundojnë ndalimin e tyre vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Deklaruesi apo mbajtësi i mallrave depoziton një garanci me një vlerë të mjaftueshme për të mbrojtur interesat e mbajtësit të vendimit;

b) Gjykata kompetente, që përcakton nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale, nuk ka dhënë një masë për sigurim padie për mallrat në fjalë;

c) Kur janë kryer të gjitha formalitetet doganore.

3. Depozitimi i garancisë së referuar në shkronjën "a", të pikës 2, nuk cenon mjetet juridike në dispozicion të mbajtësit të vendimit.

Neni 386
Mallrat për shkatërrim
(Nenet 178 dhe 179, të Kodit)

1. Mallrat që do të shkatërrohen sipas nenit 384 ose nenit 387 nuk duhet:

a) të çlirohen për qarkullim të lirë, përveçse kur autoritetet doganore, me pëlqimin e mbajtësit të vendimit, vendosin se është e nevojshme, në rastin kur mallrat do të riciklohen apo do të asgjësohen /do të shkatërrohen jashtë kanaleve tregtare, përfshirë për qëllime ndërgjegjësimi dhe edukative.

Kushtet sipas të cilave mallrat mund të çlirohen për qarkullim të lirë përcaktohen nga autoritetet doganore;

b) të largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

c) të eksportohen;

ç) të rieksportohen;

d) të vendosen nën një regjim/procedure pezullimi;

dh) të vendosen në zonë të lirë apo magazinë të lirë.

2. Autoritetet doganore mund të lejojnë që mallrat e referuara në pikën 1, të lëvizin nën mbikëqyrje doganore brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë me qëllim shkatërrimin e tyre nën mbikëqyrje doganore.

Neni 387
Procedura për shkatërrimin e mallrave në dërgesa të vogla
(Nenet 178 dhe 179, të Kodit)

1. Ky nen zbatohet kur mallrat përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Dyshohet se mallrat janë të falsifikuara apo pirate;

b) Janë mallra që nuk prishen shpejt;

c) Ka një vendim që miraton aplikimin për mallrat;

ç) Mbajtësi i vendimit ka aplikuar për përdorimin e procedurës të përcaktuar në këtë nen;

d) Mallrat janë transportuar në dërgesa të vogla.

2. Kur zbatohet procedura e përcaktuar në këtë nen, pikat 3 dhe 4, të nenit 378, dhe pikat 2 dhe 3, të nenit 380, nuk zbatohen.

3. Autoritetet doganore njoftojnë deklaruesin apo mbajtësin e mallrave për pezullimin e çlirimit të mallrave apo ndalimin e tyre brenda 1 (një) dite pune nga data e pezullimit apo ndalimit në fjalë. Në njoftimin e pezullimit të çlirimit apo ndalimit të mallrave duhet të përfshihet:

a) informacioni se autoritetet doganore kanë për qëllim të shkatërrojnë mallrat;

b) të drejtat e deklaruesit apo të mbajtësit të mallrave sipas pikave 4, 5 dhe 6.

4. Deklaruesit apo mbajtësit të mallrave i jepet mundësia për t'u shprehur brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit të pezullimit të çlirimit apo ndalimit të mallrave.

5. Mallrat në fjalë mund të shkatërrohen kur, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit të pezullimit të çlirimit të mallrave apo ndalimit të tyre, deklaruesi apo mbajtësi i mallrave ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave, pranë autoriteteve doganore.

6. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave, por as nuk ka njoftuar kundërshtimin e tij pranë autoriteteve doganore, brenda afatit të referuar në pikën 5, autoritetet doganore mund të vlerësojnë se deklaruesi apo mbajtësi i mallrave ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e tyre.

7. Shkatërrimi duhet të kryhet nën mbikëqyrje doganore. Autoritetet doganore, sipas kërkesës dhe kur është e mundur, i vënë në dispozicion mbajtësit

të vendimit informacion për sasinë reale apo të vlerësuar të mallrave të shkatërruara dhe natyrën e tyre.

8. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij dhe kur nuk vlerësohet se ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave në përputhje me pikën 6, autoritetet doganore njoftojnë menjëherë mbajtësin e vendimit për këtë dhe për sasinë e natyrën e mallrave, përfshirë imazhet nëse është e nevojshme. Autoritetet doganore, gjithashtu, në bazë të një kërkese dhe nëse i disponon, i njoftojnë mbajtësit të vendimit emrat dhe adresat e pritësit të mallit, të dërguesit dhe deklaruesit apo mbajtësit të mallrave, procedurën doganore dhe origjinën, prejardhjen dhe destinancionin e mallrave, çlirimi i të cilave është pezulluar apo që janë ndaluar.

9. Autoritetet doganore çlirojnë mallrat apo përfundojnë ndalimin e tyre menjëherë pas përfundimit të të gjitha formaliteteve doganore, kur nuk kanë marrë informacion nga mbajtësi i vendimit për fillimin e procedimit gjyqësor, nëpërmjet paraqitjes së një kopjeje të aktpadisë, të paraqitur pranë gjykatës kompetente për të vendosur nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit të referuar në pikën 8.

Seksioni 6
Përgjegjësia, kostot dhe sanksionet

Neni 388
Përgjegjësia e autoriteteve doganore

Vendimi që miraton një aplikim nuk i jep të drejtë mbajtësit të vendimit për të kërkuar kompensim nëse mallrat që dyshohen për shkelje të një të drejte të pronësisë intelektuale nuk janë zbuluar nga zyra doganore dhe, si rrjedhojë, janë çliruar apo nuk është kryer asnjë veprim për ndalimin e tyre.

Neni 389
Përgjegjësia e mbajtësit të vendimit
(Neni 265 i Kodit)

Kur një procedurë gjyqësore e filluar sipas këtij vendimi ndërpritet/pushohet për shkak të një veprimi apo mosveprimi nga mbajtësi i vendimit, kur mostrat e marra sipas pikës 2, të nenit 380, nuk kthehen apo janë dëmtuar dhe janë jashtë përdorimit, për shkak të një veprimi apo mosveprimi nga mbajtësi i vendimit, apo kur vërtetohet se mallrat në fjalë nuk shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale, mbajtësi i vendimit është përgjegjës kundrejt çdo mbajtësi të mallrave apo deklaruesi, i cili ka pësuar dëm nga kjo situatë, në përputhje me legjislacionin specifik në fuqi.

Neni 390
Kostot
(Neni 53 i Kodit)

1. Kur kërkohet nga autoritetet doganore, mbajtësi i vendimit duhet të kompensojë kostot e përballuara nga autoritetet doganore apo palët e tjera që veprojnë për llogari të autoriteteve doganore, nga momenti i pezullimit të çlirimit të mallrave apo ndalimit të tyre, përfshirë magazinimin dhe trajtimin e mallrave, në përputhje me pikën 1, të nenit 378, pikën 1, të nenit 379, dhe pikat 2 e 3, të nenit 380, dhe kur përdoren masa korrigjuese, siç është shkatërrimi i mallrave, në përputhje me nenet 384 dhe 387. Mbajtësi i vendimit, të cilit i është njoftuar pezullimi i çlirimit të mallrave apo ndalimi i tyre, në bazë të kërkesës së tij, informohet nga autoritetet doganore për vendin dhe mënyrën e magazinimit të këtyre mallrave dhe për koston e parashikuar të magazinimit, referuar në këtë pikë. Informacioni për kostot e vlerësuara mund të shprehet në terma të kohës, produkteve, volumit, peshës ose shërbimit në varësi të rrethanave të magazinimit dhe natyrës së mallrave.

2. Ky nen nuk cenon të drejtën e mbajtësit të vendimit për të kërkuar kompensim nga shkelësi apo personat e tjerë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Mbajtësi i vendimit paguan çdo përkthim që kërkohet nga autoritetet doganore në lidhje me mallrat që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale.

Seksioni 7
Baza e të dhënave qendrore dhe mbrojtja e të dhënave

Neni 391
Krijimi dhe administrimi i bazës elektronike të të dhënave
(Neni 20 i Kodit)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave në formë elektronike. Baza e të dhënave përmban të dhëna

që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, përfshirë informacionin e përmendur në pikën 2, të nenit 367, dhe nenin 375.

2. Personeli doganor që administron bazën e të dhënave është përgjegjës për hedhjen dhe/ose ndryshimin e të dhënave, saktësinë, përshtatshmërinë, rëndësinë dhe konfidencialitetin e tyre.

Nëse është e nevojshme, ajo ndryshon, shton apo korrigjon të dhënat në fjalë. Të dhënat personale trajtohen në përputhje me dispozitat në fuqi, në veçanti, me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave.

3. Drejtori i Përgjithshëm miraton strukturat doganore dhe pozicionet e punës së punonjësve që kanë akses në bazën e të dhënave, sipas përgjegjësive dhe funksioneve që ato/ata kanë.

4. Baza e të dhënave është konfidenciale dhe në të kanë të drejtë të regjistrojnë të dhëna apo t'i përdorin ato vetëm punonjësit doganorë të autorizuar për këtë qëllim nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Neni 392
Dispozitat për mbrojtjen e të dhënave
(Neni 20 i Kodit)

1. Përpunimi i të dhënave personale nga autoriteti doganor kompetent do të kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave në Republikën e Shqipërisë.

2. Të dhënat personale merren dhe përdoren vetëm për qëllimet e këtij vendimi. Të dhënat personale të mbledhura duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që përfshin të dhëna personale në bazën e të dhënave, kontrollon përpunimin e këtyre të dhënave.

4. Një subjekt të dhënash ka të drejtë aksesi për të dhënat personale në lidhje me atë vetë, të cilat përpunohen nëpërmjet bazës të të dhënave, nëse është e nevojshme, si dhe ka të drejtë të ndryshojë, të fshijë apo të ndalojë të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Kërkesat për ushtrimin e të drejtave të aksesit, ndryshimit, fshirjes apo ndalimit të të dhënave duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e cila është organi kompetent që i shqyrton ato.

6. Të dhënat personale nuk ruhen për më shumë se gjashtë muaj nga data e revokimit të vendimit që miraton aplikimin apo nga data e përfundimit të afatit, gjatë të cilit autoritetet doganore duhet të kryejnë veprimet për mbrojtjen e një të drejte të pronësisë intelektuale.

7. Kur mbajtësi i vendimit ka filluar një procedim gjyqësor, në përputhje me pikën 3, të nenit 384, ose pikën 9, të nenit 387, dhe ka njoftuar autoritetet doganore për fillimin e procedurës në fjalë, të dhënat personale ruhen gjashtë muaj pas vendimit gjyqësor të formës së prerë, që përcakton nëse ka pasur shkelje të një të drejte të pronësisë intelektuale.

TITULLI VI
ÇLIRIMI PËR QARKULLIM TË LIRË DHE PËRJASHTIMI NGA DETYRIMI I IMPORTIT

KREU 1
Çlirimi për qarkullim të lirë

Neni 393
Autorizimi për hartimin e certifikatës për peshimin e bananeve
(Pika 3, e nenit 150, të Kodit)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave jep autorizim për hartimin e dokumentit shoqërues për deklaratat doganore standarde që vërteton peshën e bananeve të freskëta, të klasifikuara sipas kodit 0803 90 10 të NK, të cilat janë objekt i detyrimit së importit ('certifikatat e peshës së bananeve'), nëse aplikuesi përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Plotëson kriterin e përcaktuar në shkronjën "a", të nenit 41, të Kodit;

b) Është i përfshirë në importin, transportin, magazinimin ose trajtimin e bananeve të freskëta, të klasifikuara në kodin 0803 90 10 të NK, që janë objekt i taksës së importit;

c) Jep garancitë e nevojshme për zhvillimin e duhur të peshimit;

ç) Ka në dispozicion të tij pajisje peshimi të përshtatshme;

d) Mban regjistrime që u mundësojnë autoriteteve doganore kryerjen e kontrolleve të nevojshme.

Neni 394
Afati kohor
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

Vendimi mbi aplikimin për autorizimin e referuar në nenin 393 merret pa vonesë dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e depozitimit të aplikimit.

Neni 395
Certifikata e peshimit të bananeve
(Pika 1, e nenit 150, të Kodit)

1. Operatori ekonomik i autorizuar për të hartuar certifikata në përputhje me nenin 393 (certifikatat e peshimit të bananeve), i jep autoriteteve doganore njoftim paraprak të peshimit të një ngarkese bananesh të freskëta për qëllimin e hartimit të një certifikate, duke dhënë detajet e llojit të paketimit, origjinën, kohën dhe vendin e peshimit.

2. Certifikata e peshimit të bananeve do të jetë në posedim të deklaruesit dhe në dispozicion të autoriteteve doganore në kohën e depozitimit të deklaratës për çlirim për qarkullim të lirë të bananeve të freskëta me kodin NK 0803 90 10, objekt i detyrimit doganor të importit.

3. Duke anashkaluar pikën 2, me kërkesë të deklaruesit për një autorizim, siç përcaktohet në nenin 152, të Kodit, autoritetet doganore mund të vendosin, për çlirimin e dërgesave të bananeve të freskëta për qarkullim të lirë, në bazë të një deklarate të thjeshtuar të peshimit në kushtet e mëposhtme:

a) Autorizimi do të detyrojë importuesin t'i transportojë bananet në gjendjen e tyre të pandryshuar nga e njëjta ngarkesë e caktuar e peshimit të autorizuar, të përmendur në deklaratën e thjeshtuar, ku do të përcaktohet pesha dhe vlera e saktë;

b) Deklaruesi është përgjegjës për dorëzimin e certifikatës së peshimit në zyrën doganore për çlirim në qarkullimit të lirë brenda 10 ditëve kalendarike nga pranimi i deklaratës së thjeshtuar;

c) Deklaruesi duhet të paraqesë një garanci siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 176, të Kodit.

Pesha e përkohshme mund të përcaktohet duke u nisur nga një certifikatë e mëparshme e peshimit për bananet e të njëjtës lloj dhe origjinë.

4. Certifikata e peshimit të bananeve do të hartohet duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin 61-02, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 396
Mjetet e komunikimit të certifikatës për peshën e bananeve
(Neni 17, pikat 2 dhe 3, shkronja "a", të Kodit)

Certifikata e peshës së bananeve mund të hartohet dhe të dorëzohet duke përdorur mjete të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 397
Kontrolli i peshimit të bananeve të freskëta
(Neni 169 i Kodit)

Zyrat doganore do të kontrollojnë të paktën 5% të numrit të përgjithshëm të certifikatave të peshimit të bananeve të paraqitura çdo vit, duke qenë të pranishëm në peshimin e mostrave të bananeve nga operatori ekonomik i autorizuar për të hartuar certifikatat e peshimit të bananeve, ose duke peshuar ato mostra vetë në përputhje me procedurën e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të aneksit 61-03, të shtojcës B, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

KREU 2
Operacione të privilegjuara

Seksioni 1
Përjashtime nga detyrimi i importit

Neni 398
Fusha e zbatimit, të përgjithshme

1. Mbështetur në nenin 184 dhe 188 të Kodit, ky kre përcakton rregullat procedurale dhe rastet në të cilat, për shkak të rrethanave të veçanta, jepet përjashtimi nga detyrimet e importit kur mallrat çlirohen për qarkullim të lirë.

2. Kreu 2, zbatohet si për mallrat e deklaruara për qarkullim të lirë që vijnë direkt nga vendet e tjera, ashtu edhe për mallrat e deklaruara për qarkullim të lirë pasi i janë nënshtruar një regjim tjetër doganore.

3. Autoritetet kompetente doganore, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, kur përjashtimi nga detyrimet e importit është dhënë me kusht të vendosjes së mallrave në një përdorim të veçantë nga marrësi, të mos përdoren për qëllime të tjera pa paguar më parë detyrimet e importit, përveçse kur një përdorim i ndryshëm përputhet me kushtet e përcaktuara në këtë vendimi.

4. Kur i njëjti person në te njëjtën kohë plotëson kushtet e përcaktuara për dhënien e përjashtimit nga detyrimet e importit, në bazë të më shumë se një dispozite të këtij vendimi, këto të fundit zbatohen njëkohësisht.

5. Në rastet kur ky vendim parashikon që përjashtimi përfitohet kundrejt plotësimit të kushteve të caktuara, personi i interesuar duhet të paraqesë prova të mjaftueshme për autoritetet doganore mbi plotësimin e këtyre kushteve.

6. Në rast të importimit me përjashtim nga detyrimet e importit, që jepet brenda vlerës ekuivalente në lekë të shumës të përcaktuar në Euro, autoritetet kompetente doganore rrumbullakosin shumën e dalë nga këmbimi/ konvertimi i asaj shume në lekë.

Kursi i këmbimit aplikohet në përputhje me nenet 54 dhe 55 të ligjit nr. 102, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 399
Përkufizime

Për qëllim të këtij kreu me termat e mëposhtme nënkuptohen:

a) "detyrim importi", detyrimi doganor që bazohet në Tarifën Doganore të Republikës së Shqipërisë;

b) "sende vetjake", çdo pronë e destinuar për përdorim personal nga personat përkatës apo për plotësimin e nevojave të tyre shtëpiake.

Në veçanti, "sende vetjake" përbëjnë,:

i. sendet shtëpiake;

ii. biçikletat, motomjetet dhe ciklomotorët, automjetet private dhe rimorkiot, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private.

Sende shtëpiake përbëjnë gjithashtu dhe sendet e nevojshme shtëpiake, të cilat plotësojnë nevojat normale familjare, kafshët shtëpiake, manarët dhe kafshët me samar, si dhe instrumentet e mbartshëm të arteve të aplikuara, të cilat janë të nevojshme për të ushtruar profesionin apo zanatin e personit përkatës. Prona personale duhet të jetë e tillë që për nga natyra dhe sasia të tregojë se nuk importohet për qëllime tregtare.

c) "sende shtëpiake", sendet personale, shtresa dhe mbulesa për përdorim shtëpiak, mobilie, dhe pajisje për qëllime të përdorimit personal të të interesuarit ose për të plotësuar nevojat e tij shtëpiake;

ç) "produkte alkoolike", produktet (birrë, verë, aperitivë me përmbajtje vere ose alkooli, konjak ose brendi, liker, ose pije të tjera alkoolike etj.), që përfshihen në krerët nga 2203 deri 2208 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Nënseksioni 1
Sendet vetjake që u përkasin individëve, që ndryshojnë vendqëndrimin (vendbanimin) nga një vend tjetër për në Republikën e Shqipërisë

Neni 400
Sendet vetjake

1. Në përputhje me nenet 401 deri 408, sendet vetjake që importohet nga individë që ndryshojnë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm nga një vend tjetër për në Republikën e Shqipërisë, përjashtohet nga detyrimet e importit.

2. Në këto raste do të përdoret formulari i sigurimit të përjashtimit nga detyrimet e importit i përcaktuar në aneksin 8, të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 401
Kufizimi në sende vetjake

1. Përjashtimi kufizohet në sende vetjake të cilat:

a) kanë qenë në posedim nga individi i interesuar dhe në rastet e mallrave jo të konsumueshme të jenë përdorur nga individi i interesuar në vendin e mëparshëm të qëndrimit, për të paktën 6 muaj përpara datës në të cilën ai pushon së qeni banor i vendit prej nga është nisur, me përjashtim të rasteve të veçanta të justifikuara nga rrethanat;

b) kanë për qëllim të përdoren për të njëjtat qëllime edhe në vendbanimin e ri.

2. Për automjetet private dhe rimorkiot, motomjetet dhe ciklomotorët, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private, përjashtimi kufizohet nga përmbushja e kushteve të mëposhtme:

a) i interesuari ka qënë pronari i regjistruar për automjetin, motomjetin dhe ciklomotorin, rulotën, mjetin lundrues ose mjetin ajror, në vendet ku zbatohet një regjistrim mjetesh, për të paktën 12 muaj përpara transferimit të tij në Republikën e Shqipërisë;

b) ka qënë pronë e të interesuarit për të paktën 12 muaj, përpara se të sillej në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) ka qënë përdorur nga i interesuari në një vend tjetër normalisht për të pakten 12 muaj përpara se të sillej në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

ç) pasi të importohet duke u përjashtuar nga detyrimet e importit, nuk mund të jepen hua, vendosen si garanci, jepen me qira ose tjetërsohet/transferohen si kundrejt pagesës, ashtu edhe falas, deri në dy vjet pas kryerjes se formaliteteve doganore, përveçse kur paguan detyrimet e importit dhe gjithë taksat e tjera prej të cilave ishte përjashtuar;

d) përjashtimi nga detyrimet e importit i nënshtrohet depozitimit të një garancie.

Forma dhe shuma e garancisë përcaktohen nga autoritetet doganore kompetente. Garancia çlirohet pas kalimit të dy vjetëve nga momenti i depozitimit të saj në zyrën ku është bërë çlirimi i mallrave mbi bazën e paraqitjes së provave bindëse që personi i interesuar është dhe ka qënë gjatë gjithë kësaj periudhe kohe pronari i regjistruar i automjetit, motomjetit dhe ciklomotorit, ruletës, mjetit të lundrimit, ose mjetit të fluturimit për të cilin është dhënë përjashtimi.

Neni 402
Ratet kur jepet përjashtimi

1. Përjashtimi jepet vetëm për individët të cilët kanë pasur vendbanim të zakonshëm, për të paktën 12 muaj në mënyrë të vazhdueshme, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Megjithatë, autoritetet doganore kompetente mund të lejojnë anashkalim nga rregulli i parashikuar në pikën 1 të këtij neni me kusht që synimi i të interesuarit të ketë qenë qartësisht qëndrimi jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë të vazhdueshme prej të paktën 12 muaj.

Neni 403
Mallrat për të cilat nuk jepen përjashtime

Përjashtimi nuk jepet për:

a) produktet alkoolike;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) mjetet tregtare të transportit;

ç) artikuj për përdorim në ushtrimin e një tregtie ose profesioni, të ndryshëm nga instrumentet e mbartshëm të arteve të aplikuara ose të lira.

Neni 404
Hedhja në qarkullim të lirë

1. Përveç rasteve të veçanta, përjashtimi jepet vetëm për sendet vetjake të hedhura në qarkullim të lirë brenda 12 muajsh nga data në të cilën individi i interesuari është vendosur në vendbanimin e tij normal në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Sendet vetjake mund të vendosen në qarkullim të lirë, pjesë-pjesë, brenda afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 405
Kushtëzime

1. Me përjashtim të përcaktimit të shkonjës "ç", të pikës 2 të nenit 401, sendet vetjake që janë lejuar me përjashtim nga detyrimet e importit, deri në përfundimin e afatit prej 12 muajsh nga data në të cilën është pranuar deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë, nuk mund të jepen hua, vendosen si garanci, jepen me qira ose transferohen, si kundrejt pagesës, ashtu edhe falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet kompetente doganore për këtë qëllim.

2. Huadhënia, lënia si garanci, qiradhënia apo tjetërsimi përpara përfundimit të afatit të përmendur në pikën 1, sjell si pasojë zbatimin e detyrimeve përkatëse të importit për sendin në fjalë, sipas nivelit të detyrimeve të importit në fuqi në datën në të cilën kryhet huadhënia, dhënia si garanci, qiradhënia apo tjetërsimi, dhe në bazë të llojit të mallrave si dhe të vlerës doganore të verifikuar apo të pranuar në po atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 406
Caktimi i vendbanimit

1. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 1, të nenit 404, përjashtim mund të jepet për sendet vetjake të hedhura në qarkullim të lirë, përpara se i interesuari të caktojë vendbanimin e tij të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që ai të marrë përsipër të caktojë vendbanimin e zakonshëm në Shqipëri, brenda një afati 6 mujor. Marrja përsipër e këtij detyrimi shoqërohet nga dhënia e një garancie,

forma dhe shuma e së cilës përcaktohet nga autoritetet doganore kompetente.

2. Kur zbatohet pika 1 e këtij neni, afati i përcaktuar në shkronjën "a" të nenit 401, llogaritet nga data në të cilën sendet vetjake janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 407
Angazhimet profesionale

1. Kur, për shkak të angazhimeve profesionale, individi i interesuar largohet nga vendi ku ka patur vendbanimin e përhershëm, pa u vendosur në vendbanimin e tij në Republikën e Shqipërisë, edhe pse qëllimi i tij është ta bëjë këtë, autoriteti doganor mund të lejojë përjashtimin nga detyrimet doganore për sendet vetjake të cilat ai i transferon në Republikën e Shqipërisë.

2. Përjashtimi nga detyrimet e importit për sendet vetjake të përmendura në pikën 1 do të lejohet, sipas kushteve të parashikuara në nenet 400 deri 405, me kushtin që:

a) afatet e përcaktuara në shkronjën "a" të nenit 401 dhe pikës 1 të nenit 404, të llogariten prej datës në të cilën sendet vetjake janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) afati i përcaktuar në pikën 1 të nenit 405, të llogaritet nga data kur individi i interesuar realisht përcakton vendbanimin e tij normal në Republikën e Shqipërisë.

3. Përjashtimi nga detyrimet është subjekt i deklarimit nga individi i interesuar se ai më të vërtetë do të vendoset në Republikën e Shqipërisë, brenda një afati të caktuar nga autoriteti doganor, në përputhje me rrethanat. Autoriteti doganor kompetent mund të kërkojë që deklarimi të shoqërohet me depozitimin e një garancie, forma dhe shuma e së cilës përcaktohet nga këto autoritete.

Neni 408
Rrethanat politike të veçanta

Autoriteti doganor kompetent mund të anashkalojë dispozitat e shkronjave "a" dhe "b" të nenit 401, shkronjave "c" dhe "ç" të nenit 403, dhe nenit 405, kur një individ transferon vendbanimin e tij nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë, si rezultat i rrethanave politike të veçanta.

Nënseksioni 2
Mallrat e importuara në raste martese

Neni 409
Përjashtime në raste martese

1. Në përputhje me nenet 410 deri 413, veshjet martesore dhe sendet shtëpiake, të reja ose jo, që i përkasin një individi që me rastin e martesës së tij/saj transferon vendbanimin e tij të zakonshëm nga një vend tjetër, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, importohen duke u përjashtuar nga detyrimet importit.

2. Në të njëjtat kushte, dhuratat e dhëna me rastin e martesës dhe që janë marre nga një individ i cili plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1, që e ka vendbanimin e tij të zakonshëm në një vend tjetër, përjashtohet gjithashtu nga detyrimet e importit. Megjithatë, vlera e çdo dhurate që përjashtohet nga detyrimet e importit, nuk duhet të kalojë vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1 000 Euro.

Neni 410
Kushtëzime

Përjashtimi i referuar në nenin 409, mund të jepet vetëm për individë:

a) vendbanimi i zakonshëm i të cilëve ka qenë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për të paktën 12 muaj të vazhdueshme. Megjithatë, përjashtime nga ky rregull mund të jepen, me kusht që i interesuari të provojë qartë se synonte të qëndronte jashtë territorit doganor të Republikës se Shqipërisë për një periudhë të pandërprerë kohe prej të paktën 12 muajsh;

b) që paraqesin prova të martesës së tyre.

Neni 411
Produktet alkoolike dhe duhani

Asnjë përjashtim nuk duhet të jepet për produktet alkoolike, duhanin dhe produktet e duhanit.

Neni 412
Hedhja në qarkullim të lirë

1. Me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, përjashtimi nga detyrimet e importit jepet vetëm për mallrat e vendosura në qarkullim të lirë:

a) jo më herët se dy muaj përpara datës së caktuar për martesë (në këtë rast përjashtimi jepet

vetëm kundrejt depozitimit të garancisë përkatëse, forma dhe shuma e të cilës caktohet nga autoritetet doganore kompetente); dhe

b) jo me vonë se katër muaj pas datës së martesës.

2. Mallrat e referuara në nenin 409, mund të vendosen në qarkullim të lirë në disa dërgesa të veçanta, brenda afatit të përmendur në pikën 1.

Neni 413
Kushtëzime

1. Mallrat që janë lejuar me përjashtim nga detyrimet e importit në përputhje me nenin 409, deri në përfundimin e afatit prej 12 muajsh nga data në të cilën është pranuar deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë, nuk mund të jepen hua, vendosen si garanci, jepen me qira ose transferohen, si kundrejt pagesës, ashtu edhe falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet kompetente doganore për këtë qëllim.

2. Huadhënia, dhënia si garanci, qiradhënia ose tjetërsimi përpara përfundimit të periudhës 12 mujore bëhet vetëm kundrejt pagesës së detyrimeve përkatëse të importit për mallrat në fjalë, duke zbatuar nivelin e detyrimeve të importit në fuqi në datën në të cilën kryhet huadhënia, lënia si garanci, qiradhënia ose tjetërsimi, në baze të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të tyre, të verifikuar apo të pranuar në po atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 3
Sendet personale të fituara nga trashëgimia

Neni 414
Sendet personale

1. Në përputhje me nenet 415, 416 dhe 417, sendet personale të fituara nëpërmjet trashëgimisë, nga një individ me vendbanim të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lejohet të importohet me përjashtim nga detyrimet e importit.

2. Për qëllim të pikës 1, "sende personale" do të thotë gjithë pasuria e referuar në shkronjën "b" të nenit 399, të cilat përbëjnë pasurinë e trashëgimlënësit.

Neni 415
Mallrat për të cilat nuk jepen përjashtime

Përjashtimi nuk jepet për:

a) produktet alkoolike;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) mjetet e transportit tregtar;

ç) artikuj për përdorim gjatë ushtrimit të një tregtie apo profesioni, të ndryshme nga instrumentet e arteve të aplikuara ose të lira, të cilat i nevojiteshin trashëgimlënësit për ushtrimin e tregtisë ose të profesionit;

d) stoqet e lëndëve të para dhe produkteve ose gjysmë produkteve;

dh) stoqet e produkte bujqësore dhe blegtorale, përfshi bagëtitë, që kalojnë sasitë e përshtatshme për nevoja të përdorimit familjar.

Neni 416
Kufizime

1. Përjashtimi lejohet vetëm për sendet personale të vendosur në qarkullim të lirë jo më vonë se dy vjet nga data në të cilën i interesuari fiton të drejtën e pronësisë mbi këto sende (ndarja përfundimtare e trashëgimisë).

Megjithatë, për raste të veçanta, kjo periudhë mund të zgjatet nga autoritetet doganore kompetente.

2. Sendet personale mund të importohen në disa dërgesa të veçanta brenda afatit të përmendur në pikën 1.

Neni 417
Trashëgimia nga personat juridikë

Nenet 414, 415 dhe 416, zbatohen rast pas rasti në mënyrë analoge, për sendet personale të fituara me trashëgimi nga personat juridikë që merren me aktivitet jo fitimprurës, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Nënseksioni 4
Uniformat shkollore, materialet e studimit dhe pajisjet shtëpiake për përdorim nga nxënës e studentë

Neni 418
Përjashtime për nxënësit dhe studentët

1. Uniformat shkollore, materialet e studimit dhe pajisjet shtëpiake që përbëjnë në vetvete materiale të zakonshme për dhomat studentore dhe

që i përkasin nxënësve ose studenteve të huaj që do të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për qëllime studimi dhe u nevojiten atyre për përdorim vetjak gjatë kohës së studimeve të tyre, përjashtohen nga detyrimet e importit.

2. Për qëllim të pikës 1:

a) "nxënës ose student", është çdo person i regjistruar në një institucion edukimi për të ndjekur me kohë të plotë mësimet e ofruara në këtë institucion;

b) "uniformë" është veshmbathje, shtresa shtëpiake si dhe veshje, të reja ose jo;

c) "materiale shkollore", janë sendet dhe instrumentet (përfshirë makinat llogaritëse dhe makinat e shkrimit), që zakonisht përdoren nga nxënësit apo studentët për nevoja të studimeve të tyre.

Neni 419
Kufizim

Përjashtimi lejohet të paktën një herë për çdo vit shkollor.

Nënseksioni 5
Dërgesat me vlerë të papërfillshme

Neni 420
Mallra me vlerë të papërfillshme

1. Në përputhje me nenin 421, çdo dërgesë mallrash me karakter jotregtar, e përbërë nga mallra me vlerë të papërfillshme, të dërguara drejtpërdrejt nga një vend tjetër te një marrës në Republikën e Shqipërisë, përjashtohet nga detyrimet e importit.

2. Për qëllime të pikës 1, mallra me vlerë të papërfillshme janë:

a) mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga interneti, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 22 euro;

b) dërgesat e mallrave nga një individ jashtë Republikës së Shqipërisë për një individ në Republikën e Shqipërisë, të një natyre rastësore, pa pagesë dhe që përmbajnë vetëm mallrat e destinuara për përdorim personal ose familjar prej marrësit, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 euro.

Neni 421
Mallrat për të cilat nuk jepen përjashtime

Përjashtimi nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme:

a) produktet alkoolike;
b) parfumet dhe ujë tualeti;
c) duhanet dhe produktet e duhanit.

Nënseksioni 6
Dërgesa të dërguara falas nga një individ tek një tjetër

Neni 422
Përjashtime për dërgesa të dërguara falas

1. Në përputhje me nenet 423 dhe 424, mallrat që përbëjnë dërgesat që dërgohen nga një individ nga një vend tjetër tek një individ tjetër që jeton në territorin doganor të Republikës së Shqipëri përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që këto importe nuk janë të natyrës tregtare.

2. Për qëllime të pikës 1, dërgesat e importuara janë 'mallra të natyrës jotregtare" nëse ato:

a) janë të një natyre rastësore;

b) përmbajnë mallra që ekskluzivisht janë për përdorim personal të pritësit të dërgesës apo familjes së tij dhe të cilat sipas natyrës apo sasisë së tyre, nuk lënë dyshim se do të përdoren për qëllime tregtare;

c) i dërgohen pritësit nga dërguesi pa asnjë lloj pagese.

Neni 423
Vlera e dërgesës

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 422, zbatohet për dërgesa vlera e së cilës nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 Euro, duke përfshirë edhe vlerën e mallrave të përmendur në nenin 424.

2. Kur vlera e përgjithshme për një dërgesë e përbërë prej dy ose më shumë artikujve e kalon shumën e përmendur në pikën 1, përjashtimi deri në atë shumë jepet për këta artikuj, nëse të importuar veçmas do t'u jepej përjashtimi, me kusht që vlera e një artikulli individual nuk mund të ndahet.

Neni 424
Kufizime

Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 422, duhet të kufizohet, për dërgesë, në sasitë e dhëna për çdo mall të listuar si më poshtë:

a) produkte të duhanit:

- 50 cigare,
- 25 cigarillos (puro e hollë e vogël me peshë maksimale deri në tri gramë secila),
- 10 cigare puro,
- 50 gramë duhan për tymosje, ose
- një përzgjedhje proporcionale nga këto produkte të ndryshme;

b) alkool dhe pije alkoolike:

- pije të distiluara dhe pije alkoolike me përbërje alkooli mbi 22% të vëllimit; etil alkool jo i denatyruar me vëllim 80% e më tepër: 1 liter, ose
- pije të distiluara dhe pije alkoolike, si dhe aperitivë me bazë vere apo alkooli, rum, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli që nuk kalon 22% të vëllimit; verëra me gaz, verëra likeri: një litër apo një përzierje proporcionale nga këto produkte të ndryshme, dhe
- verë e pa gazuar: dy litra;

c) parfume:

- 50 gram, ose
- ujëra tualeti: 0,25 litra.

Nënseksioni 7
Mjetet kyesore të prodhimit dhe pajisjet e tjera të importuara gjatë transferimit të aktiviteteve nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë

Neni 425
Përjashtime për mjetet kyesore të prodhimit dhe pajisjet e tjera

1. Pa cenuar legjislacionin në fuqi lidhur me politikën industriale dhe tregtare dhe në përputhje me nenet 426 deri 430, përjashtohen nga detyrimet e importit mjetet kryesore dhe pajisjet e tjera që u përkasin ndërmarrjeve që përfundimisht mbyllin aktivitetin e tyre në një vend tjetër dhe transferohen në territorin doganor të Republikës së Shqipëri, në mënyrë që të kryejnë një aktivitet të ngjashëm.

Në rastet kur ndërmarrja e transferuar është investim bujqësor, atëherë edhe gjëja e gjallë e cila i përket këtij investimi, po ashtu përjashtohet nga detyrimet e importit.

2. Për qëllime të pikës 1, "ndërmarrje" nënkupton një njësi të pavarur ekonomike që merret me veprimtari prodhuese ose industri shërbimi.

Neni 426
Kufizime

Përjashtimi nga detyrimet e importit kufizohet për mjetet kryesore dhe pajisje të tjera të cilat:

a) përveç rasteve të veçanta që justifikohen nga rrethanat, kanë qenë aktualisht të përdorura në ndërmarrje për një minimum prej 12 muajsh përpara datës në të cilën ndërmarrja pushoi së funksionuari në vendin tjetër nga i cili ka transferuar aktivitetin;

b) janë të destinuara që të përdoren për të njëjtin qëllim pas transferimit;

c) janë të përshtatshme për natyrën dhe madhësinë e ndërmarrjes në fjalë.

Neni 427
Raste kur nuk jepet përjashtimi

Përjashtimi nuk jepet për ndërmarrje, transferimi i të cilave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë është rrjedhojë ose ka për qëllim shkrirjen me, ose përthithjen nga, një ndërmarrje e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, pa vendosur / ngritur/ krijuar një aktivitet të ri.

Neni 428
Raste të tjera kur nuk jepet përjashtimi

Përjashtimi nuk do të jepet për:

a) mjetet e transportit që nuk janë të natyrës së instrumenteve të prodhimit apo të industrisë së shërbimit;

b) furnizimet e çfarëdo lloji që janë të destinuara për konsum njerëzor apo për ushqim për kafshët;

c) karburantet dhe stoku i lëndës së parë apo i produkteve finale, apo gjysmë produkteve;

ç) gjëja e gjallë në posedim nga tregtarët.

Neni 429
Kufizime lidhur me afatin kohor

Përveç rasteve të veçanta të justifikuara nga rrethanat, përjashtimi i referuar në nenin 425, jepet vetëm për mjete kryesore të prodhimit dhe pajisje të tjera të vendosura në qarkullim të lirë, përpara

mbarimit të një afati kohor prej 12 muajsh nga data kur ndërrmarja mbyll aktivitetin e saj në vendin tjetër të nisjes.

Neni 430
Kushtëzime

1. Mjetet themelore dhe pajisjet tjera të përjashtuara nga detyrimet e importit nuk mund të jepen hua, si garanci, me qira ose të tjetërsohen përpara kalimit të afatit 12 mujor, nga data kur është pranuar deklarata për hedhjen në qarkullim të lirë, pa informuar paraprakisht autoritetin doganor kompetent.

Në rastet e dhënies për përdorim apo transferim, kur ka rrezik për abuzim, ky afat mund të zgjatet deri në 36 muaj.

2. Çdo dhënie hua, si garanci, dhënie në përdorim apo transferim para kalimit të afatit të përmendur në pikën 1 bëhet vetëm kundrejt pageses së detyrimeve të importit për mallrat përkatëse, sipas normës që zbatohet në datën e dhënies hua, dhënies si garanci, dhënies në përdorim apo transferim, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoriteti doganor kompetent.

Neni 431
Transferimi i personave të angazhuar në profesione të lira dhe personave juridikë të angazhuar në aktivitete jo-fitimprurëse

Nenet 425 deri në 430, zbatohen rast pas rasti në mënyrë analoge për mjetet themelore dhe pajisjet e tjera që u përkasin personave të angazhuar në profesione të lira dhe personave juridikë të angazhuar në aktivitete jofitimprurëse që e transferojnë këtë aktivitet nga një vend tjetër për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Nënseksioni 8
Produktet e përftuara nga fermerët e Republikës së Shqipërisë në prona të vendosura në vende kufitare me Republikën e Shqipërisë

Neni 432
Përjashtime për produktet bujqësore, blegtorale, të bletarisë, të kopshtarisë dhe pyjeve

1. Në përputhje me nenet 433 dhe 434, produktet bujqësore, blegtorale, të bletarisë, të kopshtarisë dhe pyjeve të përfituara nga prona të vendosura në një vend tjetër fqinj me territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të cilat punohen nga një prodhues bujqësor që ka ndërmarrjen e tij kryesore brenda territorit shqiptar dhe e kryen këtë veprimtari në tokën që është në kufirin ngjitur me vendin tjetër, përjashtohen nga detyrimet doganore.

2. Për të përfituar nga dispozitat e pikës 1, produktet blegtorale duhet të përfitohen nga kafshë të origjinuara në Republikën e Shqipërisë ose që janë vendosur në qarkullim të lirë aty.

Neni 433
Kufizime

Përjashtimi kufizohet për produkte të cilat nuk i janë nënshtruar trajtimeve të tjera përveç atyre që kryhen normalisht pas korrjes/vjeljes apo prodhimit të tyre.

Neni 434
Lejimi

Përjashtimi lejohet vetëm për produkte që janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga prodhuesi bujqësor apo për llogari të tij.

Neni 435
Produktet e peshkimit apo të kultivimit të peshkut

Nenet 432, 433 dhe 434, zbatohen rast pas rasti në mënyrë analoge për produktet e peshkimit apo të kultivimit të peshkut, aktivitete të cilat kryhen në liqenet apo lumenjtë e lundrueshëm që kufizojnë një vend tjetër me Republikën e Shqipërinë nga peshkatarë shqiptar, apo edhe për produktet e aktivitetit të gjuetisë, që zhvillohet në liqene apo lumenj të tillë nga gjahtarët për sport të Shqipërisë.

Nënseksioni 9
Farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të të mbjellave, të importuara nga prodhuesit bujqësorë të vendeve të tjera, për përdorim në pronat fqinje me këto vende

Neni 436
Përjashtime për farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të të mbjellave

Në përputhje me nenin 437, farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të mbjellave, të destinuara për t'u përdorur në prona të vendosura në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, fqinj me një vend tjetër dhe e cila punohet nga një prodhues bujqësor që ka ndërmarrjen e tij kryesore brenda këtij vendi tjetër dhe në kufi ngjitur me territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 437
Kufizime

1. Përjashtimi kufizohet për ato sasi farash, plehrash dhe produkte të tjera që nevojiten për punimin e pronës.

2. Përjashtimi jepet vetëm për ato fara, plehra apo produkte tjera të importuara drejtpërdrejt për në territorin doganor të Republikë së Shqipëri nga prodhuesi bujqësor apo për llogari të tij.

3. Këshilli i Ministrave mund të vendosë kushte për përjashtimin bazuar në parimin e reciprocitetit.

Nënseksioni 10
Mallrat që gjenden në bagazhin personal të udhëtarit

Neni 438
Mallrat që gjenden në bagazhin personal

1. Në përputhje me nenet 438 deri 445, mallrat që gjenden në bagazhin personal të udhëtarëve, që vijnë nga një vend tjetër, përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që këto importe të jenë të natyrës jo tregtare.

2. Për qëllime të këtij nënseksioni:

a) "bagazh personal" është tërësia e bagazhit që udhëtari i paraqet autoriteteve doganore me mbërritjen e tij në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo bagazh që i paraqitet këtyre autoriteteve në një datë të mëvonshme, me kusht që të paraqiten prova që ditën e largimit të udhëtarit, ishte regjistruar si bagazh shoqërues, në momentin e nisjes, pranë shoqërisë që ka siguruar transportin nga vendi i nisjes për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Karburanti i ndryshëm nga ai i referuar në nenin 443, nuk përbën bagazh personal;

b) "importe me natyrë jo tregtare" janë importe, të cilat:

i) kanë natyrë rastësore;

ii) përbëhen vetëm prej mallrash për përdorim vetjak të udhëtarëve ose familjeve të tyre ose prej mallratve për dhurata.

Lloji dhe sasia e mallrave nuk duhet të jetë e tillë që të tregojë se kanë për qëllim përdorimin tregtar.

c) "udhëtar ajror" dhe "udhëtar detar" janë çdo pasagjer që udhëton në rrugë ajrore apo detare, ndryshe nga fluturimi privat për argëtim apo udhëtimi detar për argëtim.

ç) "fluturim privat për argëtim" dhe "udhëtim detar për argëtim" nënkupton përdorimin e një mjeti ajror apo një mjeti ujor nga pronari ose personi fizik ose juridik i cili ka të drejtën e përdorimit qoftë nëpërmjet qirasë ose me çdo mjet tjetër, për qëllime të ndryshme nga ato tregtare dhe në mënyrë të veçantë të ndryshme nga transporti i udhëtarëve ose mallrave ose për furnizimin e shërbimeve për qëllime të autoriteteve publike;

d) "zonë kufitare" është: pa cenuar konventat ekzistuese në këtë fushë, një zonë, shtrirja e së cilës në vije të drejtë ajrore, nuk i kalon 10 km nga kufiri.

dh) "punonjës zone kufitare" nënkupton çdo person aktiviteti normal i të cilit kërkon që ai të shkojë në anën tjetër kufitare gjatë ditëve të punës.

Neni 439
Kufijtë monetarë

1. Përjashtimet e parashikuara në nenin 438, jepet për mallra vlera e përgjithshme e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 300 euro për çdo udhëtar për mallra të ndryshme nga ato të renditura në nenet 440 dhe 441.

Në rastin e udhëtarëve me rrugë ajrore dhe rrugë detare, shuma e përmendur në paragrafin e parë do të jetë vlera ekuivalente në lekë e shumës 430 euro.

2. Për udhëtarët nën 15 vjeç, kjo shumë reduktohet në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 euro.

3. Për qëllime të zbatimit të kufirit monetar të mësipërm, vlera e një artikulli të veçantë nuk mund të ndahet.

4. Vlera e bagazhit personal të udhëtarit, që është importuar përkohësisht ose është ri-importuar pas eksportit të përkohshëm, dhe vlera e produkteve mjekësore të nevojshme për të përmbushur nevojat personale të udhëtarit nuk merren në konsideratë për qëllime të zbatimit të përjashtimit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2.

Neni 440
Kufijtë sasiorë për produktet e duhanit

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 438, për produktet e duhanit, zbatohet në varësi të kufizimeve sasiore në jo më shumë se:

a) 200 cigare;
b) 100 cigarillo;
c) 50 puro;
ç) 250 gram duhan.

Secila sasi e specifikuar në shkronjat "a" deri "ç" për qëllimet e pikës 2 të këtij neni, përbën 100 % të përjashtimit total për produktet e duhanit.

Cigarillo janë cigare pesha maksimale e të cilave është 3 gram secila.

2. Për një udhëtar, përjashtimi mund të zbatohet për çdo kombinim të produkteve të duhanit, me kushtin që totali i sasisë (përqindjes) së përdorur nga individi të mos kalojë 100%.

Neni 441
Kufijtë sasiorë për produktet e alkoolit dhe pijet alkoolike

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 438, për alkoolin dhe pijet alkoolike, ndryshe nga verërat e qeta dhe birra, zbatohet mbi bazën e kufizimeve sasiore të mëposhtme:

a) 1 litër alkool dhe pije alkoolike me fortësi alkoolike më të lartë se 22% ndaj volumit, ose alkool etilik i pa denatyruar me fortësi alkoolike 80% ndaj volumit dhe më shumë;

b) 2 litra: alkool dhe pije të distiluara me fortësi alkoolike që nuk e kalon 22% ndaj volumit.

Secila sasi e specifikuar në shkronjat "a" dhe "b" për qëllimet e pikës 2 të këtij neni, përbën 100 % të përjashtimit total për produktet e alkoolit dhe pijeve alkoolike.

2. Për një udhëtar, përjashtimi mund të zbatohet për çdo kombinim të produkteve të alkoolit dhe pijeve alkoolike të përcaktuara në pikën 1, me kushtin që totali i sasisë (përqindjes) së përdorur nga individi të mos kalojë 100%.

3. Përjashtohen nga detyrimet e importit edhe 2 litra verë e qetë dhe 10 litra birrë.

Neni 442
Udhëtarët nën moshën 17 vjeç

Nuk jepet përjashtim për mallrat e përmendura në nenet 440 dhe 441, për udhëtarët nën moshën 17 vjeç.

Neni 443
Karburanti që ndodhet në serbatorë

Përjashtohet nga detyrimet e importit, për çdo mjet transporti motorik, karburanti që ndodhet në serbatorë/depozita standard si dhe jo më shumë se 10 litra karburant në serbatorë të lëvizshëm.

Neni 444
Vlera e mallrave që nuk do të merren në konsideratë

Vlera e mallrave e përmendur në Nenet 440, 441 ose 443, nuk do të merren në konsideratë për qëllime të zbatimit të përjashtimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 439.

Neni 445
Raste të veçanta

1. Ministri përgjegjës për financat me Urdhër mund të zvogëlojë kufijtë monetarë ose kufizimet sasiore, apo të dyja, në rastet e udhëtarëve sipas kategorive të mëposhtme:

a) personave që banojnë në një zonë kufitare;
b) punonjësve të zonës kufitare;
c) ekuipazhet e mjeteve të transportit të përdorura për të udhëtuar nga një vend tjetër.

2. Pika 1 nuk zbatohet kur një udhëtar i njërës prej kategorive të mësipërme provon që po kalon përtej zonës kufitare të Republikës së Shqipërisë ose nuk po kthehet nga një zonë kufitare e një vendi fqinj.

Megjithatë, pika 1 zbatohet kur punonjësit e zonave kufitarë apo ekuipazhi i mjeteve të transportit të përdorur në udhëtim ndërkombëtar, importojnë mallra kur bëjnë udhëtime, gjatë punës së tyre.

Nënseksioni 11
Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore; Instrumentet dhe aparaturat shkencore

Neni 446
Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore

Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore të listuara në aneksit 9, të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, përjashtohen nga detyrimet e importit, pavarësisht se cili është pranuesi i dërgesës apo për çfarë qëllimi mund të përdoren këto materiale.

Neni 447
Kushtëzime

Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore të listuara në aneksin 10, të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, përjashtohen nga detyrimet e importit me kusht që ato kanë për qëllim të përdoren nga:

a) institucione apo organizata publike arsimore, shkencore apo kulturore, ose

b) institucione apo organizata që i përkasin kategorive të specifikuara në kolonën e 3 (tretë) të aneksit 10, të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, me kusht që ato të jenë të miratuara nga autoritetet kompetente doganore për të marrë artikuj të tillë me detyrime importi të përjashtuara.

Neni 448
Instrumentet dhe aparatet shkencore

1. Në përputhje me nenet 449 deri 453, instrumentet dhe aparatet shkencore, të cilat nuk janë përfshirë në nenin 447, përjashtohen nga detyrimet e importit, nëse ato importohen ekskluzivisht për qëllime jotregtare.

2. Përjashtimi sipas pikës 1, kufizohet për instrumentet dhe aparatet shkencore, të cilat kanë për qëllim të përdoren nga:

a) institucione/ente publike që merren kryesisht me arsimimin apo kërkime shkencore dhe për ato departamente të institucioneve publike, që merren kryesisht me arsimimin apo kërkime shkencore, ose

b) institucione private që merren kryesisht me arsimimin apo kërkime shkencore dhe të miratuara nga autoritetet kompetente për të marrë artikuj të tillë me detyrime importi të përjashtuara.

Neni 449
Pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse

Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 448, zbatohet gjithashtu për:

a) Pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse që i përshtaten posaçërisht instrumenteve apo aparateve shkencore, me kusht që këto pjesë këmbimi/ rezervë, pjesë përbërëse apo pjesë ndihmëse importohen në të njëjtën kohë me instrumentet apo aparatet e tilla ose, nëse ato importohen më pas, me kushtin që ato të mund të identifikohen si pjesë që i përkasin dhe janë të destinuara për instrumentet apo aparatet të cilat:

i. janë përjashtuar më parë nga detyrimet e importit, me kusht që këto instrumente apo aparate janë ende të një natyre shkencore në momentin kur kërkohet përjashtimi për pjesët përkatëse këmbimi / rezervë, pjesët përbërëse apo ato ndihmëse, ose;

ii. të cilat do të përjashtoheshin në momentin kur kërkohet një përjashtim i tillë për pjesët rezervë përkatëse, pjesët përbërëse apo ato ndihmëse;

b) Veglat që përdoren për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e instrumenteve apo aparateve shkencore, me kusht që këto vegla të importohen në të njëjtën kohë me instrumentet apo aparatet e tilla ose nëse ato importohen më pas, me kusht që ato të mund të identifikohen si pjesë që i përkasin dhe janë të destinuara për instrumentet apo aparatet të cilat:

i. janë përjashtuar më parë nga detyrimet e importit, me kusht që këto instrumente apo aparate janë ende të një natyre shkencore në momentin kur kërkohet përjashtimi për veglat ose;

ii. të cilat do të përjashtoheshin, në momentin kur është bërë kërkesa për përjashtim për veglat.

Neni 450
Përkufizime

Për qëllime të neneve 448 dhe 449:

a) "instrumente apo aparate shkencore" nënkuptohet çdo instrument apo aparat i cili, për shkak të karakteristikave objektive teknike të tij dhe për shkak të rezultateve që arrihen me të, është

kryesisht apo ekskluzivisht i përshtatshëm për veprimtari shkencore;

b) "të importuara për qëllime jotregtare", nënkuptohen instrumentet apo aparatet shkencore që destinohen për t'u përdorur për kërkime shkencore apo qëllime edukative jofitimprurëse.

Neni 451
Mos përjashtimi nga detyrimet e importit

Nëse është e nevojshme, disa instrumente apo aparate mund të mos përjashtohen nga detyrimet e importit, nëse vërtetohet se përjashtimi nga detyrimet e importit dëmton interesat e industrisë së vendit, në sektorin përkatës të prodhimit.

Neni 452
Kushtëzime

1. Artikujt e përcaktuar në nenin 447 dhe instrumentet apo aparatet shkencore të cilat janë përjashtuar nga detyrimet e importit në përputhje me kushtet e parashikuara me nenin 449, 450 dhe 451, nuk mund të huazohen, të jepen në shfrytëzim apo të transferohen, qoftë me apo pa pagesë, pa njoftuar paraprakisht autoritetin doganor kompetent.

2. Nëse, një artikull huazohet, jepet në përdorim apo transferohet në një institucion apo organizatë që përfiton nga përjashtimi sipas nenit 447 ose pikës 2 të nenit 448, përjashtimi vazhdon të jepet me kusht që institucioni apo organizata ta përdorë atë artikull, instrument apo aparat për qëllime, për të cilin është dhënë përjashtimi.

Në raste të tjera, huazimi, dhënia në përdorim apo transferimi kërkon pagesën paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën e huazimit, dhënies në përdorim apo transferimit, në bazë të llojit të mallit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

Neni 453
Ndërprerja e përmbushjes së kushteve

1. Institucionet apo organizatat e përmendura në nenet 447 dhe 448, të cilat nuk përmbushin më kushtet mbi bazën e të cilave kanë fituar të drejtën e përjashtimit, apo synojnë t'i përdorin artikujt e përjashtuar nga detyrimet e importit, për qëllime të tjera nga ato të parashikuara nga dispozitat e këtij Nënseksioni duhet të njoftojnë autoritetin doganor kompetent.

2. Artikujt që mbesin në posedim të institucioneve apo organizatave të cilat ndërpresin përmbushjen e kushteve për përfitimin e përjashtimit, do t'i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën, në të cilën ndërpritet përmbushja e atyre kushteve, në bazë të llojit të artikullit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

3. Artikujt e përdorur nga institucionet ose organizatat përfituese të përjashtimit, për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet 447 dhe 448, i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, që zbatohen në datën kur ato janë vënë në një përdorim tjetër, në bazë të llojit të artikullit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

Neni 454
Kushtëzime të tjera

Nenet 451, 452 dhe 453, zbatohen rast pas rasti në mënyrë analoge për produktet e referuara në nenin 449.

Neni 455
Pajisje të importuara për qëllime jo-tregtare

1. Pajisjet e importuara për qëllime jo-tregtare nga apo në emër të një institucioni apo organizate për kërkime shkencore të vendosur jashtë Shqipërisë, përjashtohen nga detyrimet e importit.

2. Përjashtimi do të lejohet me kusht që pajisjet:

a) të jenë të destinuara për t'u përdorur nga apo me miratimin e pjesëtarëve ose përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave të përmendura në pikën 1, në kontekst dhe brenda kufijve të marrëveshjeve për bashkëpunim shkencor, qëllimi i të cilave është që të kryhen programe kërkimesh shkencore ndërkombëtare në institucione për kërkime shkencore të bazuara dhe të vendosura në Shqipëri.

b) të mbeten pronë e personit fizik apo juridik me vendqëndrim jashtë Shqipërisë, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Shqipëri.

3. Në kuptim të këtij neni dhe nenit 456:

a) "pajisje", janë instrumentet, aparatet, makinat dhe pjesët e tyre, përfshirë pjesët e këmbimit/rezervë dhe veglat e projektuara posaçërisht për mirëmbajtjen, kontrollimin, kalibrimin apo riparimin e tyre, që përdoren për nevoja kërkimi shkencor;

b) pajisjet e destinuara për t'u përdor për qëllime të kërkimeve shkencore të kryera për qëllime jo- fitimprurëse, konsiderohen se janë "të importuara për qëllime jo-tregtare".

Neni 456
Kushtëzime

1. Pajisjet e përjashtuara nga detyrimet e importit në përputhje me kushtet e parashikuara me nenin 455, nuk mund të huazohen, të jepen për përdorim apo të transferohen, me pagesë ose jo, pa lajmëruar paraprakisht autoritetin doganor kompetent.

2. Nëse pajisjet huazohen, jepen në përdorim apo transferohen në një institucion apo organizatë që përfiton nga përjashtimi sipas nenit 455, përjashtimi vazhdon të jepet me kusht që institucioni apo organizata ta përdorë atë artikull, instrument apo aparat për qëllime, për të cilin është dhënë përjashtimi

Në raste të tjera dhe pa cenuar nenet 448 dhe 449, huazimi, dhënia në përdorim apo transferimi i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën e huazimit, dhënies në përdorim apo transferimit, në bazë të llojit të pajisjeve dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

3. Institucionet apo organizatat e referuara në pikën 1 të nenit 455, të cilat nuk i përmbushin më kushtet për përjashtim, apo të cilat synojnë t'i përdorin pajisjet e përjashtuara nga detyrimet e importit për qëllime të tjera nga ato të parashikuara nga ky nen, duhet të njoftojnë për këtë autoritetin doganor kompetent.

4. Pajisjet e përdorura nga institucionet ose organizatat të cilat nuk përmbushin më kushtet për të përfituar nga përjashtimi, i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën, në të cilën ndërpritet përmbushja e atyre kushteve, në bazë të llojit të artikullit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

Pa rënë ndesh me nenet 448 dhe 449, pajisjet e përdorura nga institucionet apo organizatat përfituese të përjashtimit për qëllime tjera nga ato të parashikuara me nenin 455, i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit që zbatohen në datën në të cilën ato janë përdorur për një qëllim tjetër, në bazë të llojit të pajisjes dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 12
Kafshët laboratorike dhe lëndët biologjike ose kimike që nevojiten për kërkime

Neni 457
Kafshët laboratorike dhe lëndët biologjike

1. Përjashtimi nga detyrimet e importit jepet për:

a) kafshët e posaçme për përdorim laboratorik;

b) lëndët biologjike ose kimike që nevojiten për kërkime, të cilat importohen ekskluzivisht për qëllime jotregtare.

2. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 kufizohet për kafshët dhe lëndët biologjike ose kimike, të cilat destinohen për:

a) institucione publike që merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore dhe ato departamente ose institucione publike të cilat merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore; ose

b) institucione private që merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore dhe të autorizuara nga autoritetet kompetente doganore të Republikës së Shqipërisë të marrin artikuj të tillë me përjashtim nga detyrimet e importit.

3. Lëndët e përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 1, mund të përfshijnë vetëm lëndët biologjike ose kimike, për të cilat nuk ekziston prodhimi ekuivalent në Shqipëri dhe të cilat, për arsye të specifikimit ose shkallës së pastërtisë, kryesisht ose ekskluzivisht janë të përshtatshme për kërkime shkencore.

Nënseksioni 13
Substanca terapeutike me origjinë njerëzore dhe reagentët për analizat e gjakut dhe indeve

Neni 458
Substanca terapeutike dhe reagentët

1. Në përputhje me nenin 459, përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) substancat terapeutike me origjinë njerëzore;

b) reagentët për përcaktimin e grupit të gjakut;

c) reagentët për përcaktimin e përbërjes së indeve.

2. Për qëllime të pikës 1:

a) "substanca terapeutike me origjinë njerëzore", janë gjaku i njeriut dhe derivatet e tij (gjaku i njeriut në gjendje të natyrshme, plazmë e tharë, albumina dhe solucione të qëndrueshme të proteinave plazmatike njerëzore, imunoglobulin dhe fibrinogjeni i njeriut);

b) "reagentët për përcaktimin e grupit të gjakut", janë të gjitha reagentët, qoftë të origjinës njerëzore, shtazore, bimore ose të ndonjë origjine tjetër, që përdoren për përcaktimin e grupit të gjakut dhe për zbulimin e anomalive të gjakut;

c) "reagentët për përcaktimin e përbërjes së indeve", janë të gjithë reagentët qoftë të origjinës njerëzore, shtazore, bimore apo të një origjine tjetër që përdoren për përcaktimin e përbërjes së indeve të njeriut.

Neni 459
Kufizime

Përjashtimi kufizohet për produkte të cilat:

a) destinohen për institucione ose laboratorë të miratuara nga autoritetet doganore kompetente, për t'u përdorur ekskluzivisht për qëllime jo-tregtare mjekësore ose shkencore;

b) shoqërohen nga një çertifikatë e konformitetit e lëshuar nga organi i autorizuar në vendin e nisjes;

c) janë të vendosura në enë, me etiketë të veçantë identifikuese;

Neni 460
Paketimi

Përjashtimi nga detyrimet e importit përfshin, paketimin special të domosdoshëm për transportin e substancave terapeutike me origjinë njerëzore apo të reagentëve për përcaktimin e grupeve të gjakut apo të përbërjes së indeve dhe gjithashtu çdo tretës dhe aksesorë të nevojshëm për përdorimin e tyre, që mund të përfshihen në dërgesë.

Nënseksioni 14
Instrumentet dhe aparaturat e destinuara për kërkime mjekësore, për përcaktimin e diagnozës mjekësore ose për kryerjen e trajtimeve mjekësore

Neni 461
Instrumentet dhe aparaturat e destinuara për kërkime, diagnozë ose trajtime mjekësore

1. Përjashtohen nga detyrimet e importit, instrumentet dhe aparaturat që destinohen për kërkime mjekësore, për përcaktim diagnoze ose kryerje të trajtimit mjekësor, të cilat dhurohen nga një organizatë filantropike ose bamirëse ose nga një individ privat, autoriteteve të shëndetësisë, spitaleve ose institucioneve kërkimore mjekësore të miratuara nga autoritetet kompetente doganore të marrin këta artikuj me përjashtim të detyrimeve të importit, ose pajisje e instrumente të blera nga këto autoritete shëndetësore, spitale ose institucione kërkimore mjekësore krejtësisht me fonde të dhuruara nga organizata bamirësie apo filantropike ose me kontribute vullnetare, me kusht që gjithmonë të provohet se:

a) dhurimi i instrumenteve ose aparateve në fjalë nuk fsheh në vetvete asnjë synim tregtar nga ana e dhuruesit; dhe

b) dhuruesi nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me prodhuesin e instrumenteve ose aparateve për të cilat kërkohet përjashtim.

2. Përjashtimi zbatohet gjithashtu, duke iu nënshtruar të njëjtave kushte, për:

a) pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse ose aksesorët e përshtatshëm pikërisht për instrumentet ose aparatet e përmendura më sipër, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse ose pjesë ndihmëse të importohen në të njëjtën kohë me ato instrumente ose aparate, ose kur janë importuar me vonë, të mund të identifikohen se destinohen për instrumente ose aparate të importuara më parë më përjashtim nga detyrimet e importit;

b) veglat që përdoren për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin ose riparimin e instrumenteve apo aparateve, me kusht që këto vegla të importohen në të njëjtën kohë me instrumentet ose aparatet në fjalë, ose kur importohen më pas, të mund të identifikohen si vegla që destinohen për instrumente ose aparate të importuara më parë me përjashtim nga detyrimet e importit.

Neni 462
Të tjera

Për qëllim të nenit 461 dhe posaçërisht në lidhje me instrumentet apo aparatet dhe subjektet përfituese të përmendura më lart, zbatohen nenet 451, 452 dhe 453, rast pas rasti në mënyrë analoge.

Nënseksioni 15
Substancat referuese për kontrollin e cilësisë së produkteve mjekësore

Neni 463
Substancat referuese

Përjashtohen nga detyrimet e importit dërgesat, të cilat përmbajnë mostra të substancave referuese të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, për kontrollin cilësor të materialeve të përdorura në prodhimin e produkteve mjekësore dhe të cilat i adresohen pritësve të autorizuar nga autoritetet doganore kompetente të Republikës së Shqipërisë për të marrë të tilla dërgesa.

Nënseksioni 16
Produktet farmaceutike për t'u përdorur në veprimtari sportive ndërkombëtare

Neni 464

Përjashtohen nga detyrimet e importit produktet farmaceutike për përdorim mjekësor njerëzor apo veterinar, nga personat ose kafshët që vijnë nga vende të tjera për të marrë pjesë në aktivitete sportive ndërkombëtare, të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të arsyeshëm për të plotësuar kërkesat gjatë gjithë qëndrimit në këtë territor.

Nënseksioni 17
Mallra për organizata bamirësie ose filantropike; artikuj të destinuar për të verbrit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara

Nënseksioni 17.1
Për organizata bamirësie ose filantropike

Dispozitat e këtij nënseksioni trajtojnë përjashtimin për mallrat e importuara nga organizata bamirësie ose filantropike.

Neni 465
Mallra për organizata bamirësie ose filantropike

1. Në përputhje me nenet 467 dhe 468, importohen me përjashtim nga detyrimet e importit, për aq sa të mos krijojnë mundësi për abuzime ose shtrembërime të konkurrencës:

a) mallra të nevojave bazë, të importuara nga institucione shtetërore, organizata bamirëse, filantropike ose fetare të miratuara nga autoritetet doganore kompetente, për t'u shpërndarë falas personave në nevojë;

b) mallra të çfarëdolloj përshkrimi, të dërguara falas nga një person apo organizatë e vendosur në një vend jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për qëllime jo tregtare nga ana e dërguesit, për institucione shtetërore apo organizata të tjera, bamirëse, filantropike ose fetare të miratuara nga autoritetet doganore kompetente, për t'u përdorur për mbledhje fondesh në evente/ngjarje të posaçme bamirësie, për personat në nevojë;

c) materiale dhe pajisje zyre të dërguara falas, nga një person ose një organizatë e vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe pa qëllime tregtare nga ana e dërguesit, për institucione shtetërore, organizata bamirëse, filantropike ose fetare të miratuara nga autoritetet doganore kompetente, mallra këto për t'u përdorur vetëm për të plotësuar nevojat e ushtrimit të aktivitetit të tyre bamirës apo filantropik;

ç) materiale dhe pajisje për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve fetare të kultit, të institucioneve me karakter fetar, dhe mallra të tjera, të nevojshme për t'u përdorur nga këto institucione, vetëm për zhvillimin e veprimtarive fetare;

d) materiale dhe pajisje për ndërtimin, rikonstruksionin e ujësjellësve, centraleve elektrike, shkollave, spitaleve, që financohen nga institucionet fetare.

2. Për qëllim të shkronjës "a" të pikës 1, "nevoja bazë" nënkupton ato mallra të cilat nevojiten për të plotësuar nevojat elementare të qenieve njerëzore, si për shembull ushqime, barna, veshje dhe shtresa ose mbulesa krevati.

Neni 466
Mallra për të cilat nuk jepet përjashtim

Nuk jepet përjashtim për:

a) produktet e alkoolit;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) kafen dhe çajin;

ç) automjetet që janë të ndryshme nga ambulancat dhe zjarrfikësit.

Neni 467
Kushtëzime

Përjashtim përfitojnë vetëm organizatat, të cilat kanë procedura kontabiliteti, të cilat i lejojnë

autoritetet doganore kompetente të mbikëqyrin veprimtarinë e tyre dhe që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme.

Neni 468
Kushtëzime të tjera

1. Organizatat që përfitojnë nga përjashtimi, nuk mund të japin hua, me qira, të tjetërsojnë, falas apo kundrejt pagesës, mallrat apo pajisjet e referuara në nenin 465, për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 465, pa njoftuar më parë autoritetet doganore kompetente.

2. Në rast se mallrat dhe pajisjet e përmendura me sipër i jepen hua, me qira apo i tjetërsohen një organizate që ka të drejtë të përfitojë përjashtim sipas neneve 465 dhe 467, përjashtimi vazhdon të jepet me kusht që organizata e fundit të përdorë mallrat dhe pajisjet për qëllime që përputhen me arsyen e dhënies së përjashtimit.

Në rast të kundërt, huadhënia, qiradhënia apo tjetërsimi bëhet vetëm pas pagesës të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën e dhënies hua, dhënies me qira apo tjetërsimit, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar ose të pranuar nga autoritetet doganore kompetente në atë datë.

Neni 469
Mos përmbushja e kushteve për të përfituar përjashtim

1. Organizatat e përmendura në nenin 465, të cilat nuk përmbushin më kushtet për të përfituar përjashtimin, ose të cilat propozojnë përdorimin e mallrave dhe pajisjeve të përjashtuara nga detyrimet e importit, për qëllime të ndryshme nga ato të përshkruara në nenin në fjalë, duhet të njoftojnë për këtë qëllim autoritetet doganore kompetente.

2. Mallrat dhe pajisjet që mbeten në posedim të organizatave të cilat nuk përmbushin më kushtet për të përfituar përjashtim, janë objekt i pagesës së detyrimeve përkatëse të importit, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën në të cilën kushtet pushuan së ekzistuari, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar ose pranuar nga autoritetet kompetente doganore në atë datë.

3. Mallrat dhe pajisjet e përdorura nga organizatat që përfitojnë nga përjashtimi, për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në nenin 465, i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor të zbatueshëm, në datën në të cilën ato janë vendosur në një përdorim tjetër, mbi bazën e llojit të mallrave dhe pajisjeve si dhe të vlerës doganore të verifikuar ose pranuar në datën në fjalë nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 17.2
Për personat me aftësi të kufizuara

Në këtë nënseksion:

- Nenet 470 dhe 471 trajtojnë përjashtimin për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar që nuk shikojnë;
- Nenet 472 dhe 473 trajtojnë përjashtimin për kategorinë e personave të tjerë me aftësi të kufizuar;
- Nenet 474 deri 477 trajtojnë përjashtimin për të dy kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 470
Artikujt për përdorim nga të verbrit

Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 11, të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 471
Kushtëzime

1. Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 12, të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, do të përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që të importohen nga:

a) vetë personat e verbër për nevojat e tyre; ose

b) institucione apo organizata që merren me edukimin apo dhënien e ndihmës për persona të verbër, të autorizuara nga autoritetet doganore kompetente të marrin këta artikuj me përjashtim nga detyrimet e importit.

2. Përjashtimi i përcaktuar në pikën 1, zbatohet edhe për pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse përkatëse të artikujve në fjalë dhe për veglat që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë

përbërëse, pjesë ndihmëse apo vegla janë importuar në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë ose, nëse janë importuar më vonë, me kusht që ato mund të identifikohen se janë të destinuara për artikujt që janë lejuar më parë me përjashtim nga detyrimet e importit, apo të cilat do të përfitonin nga përjashtimi në momentin kur një përjashtim i tillë, kërkohet për pjesët specifike të këmbimit/rezervë, komponentët apo pajisjet ndihmëse dhe veglat në fjalë.

Neni 472
Artikujt për përdorim të personave të tjerë me aftësi të kufizuara

1. Artikujt e projektuar posaçërisht për arsimim, punësimin apo për zhvillim shoqëror të personave me aftësi të kufizuara, pa përfshirë personat e verbër, do të përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që të importohen nga:

a) vetë personat me aftësi të kufizuar për nevojat e tyre personale; ose

b) institucione apo organizata të angazhuara kryesisht me edukimin apo dhënien e ndihmës për personat me aftësi të kufizuara të autorizuara nga autoritetet kompetente doganore për të marrë këta artikuj me përjashtim nga detyrimet e importit.

2. Përjashtimi i përcaktuar në pikën 1, zbatohet edhe për pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse posaçërisht për artikujt në fjalë dhe për veglat, që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse, pajisje ndihmëse apo vegla janë importuar në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë ose, nëse janë importuar më vonë, me kusht që ato mund të identifikohen se janë të destinuara për artikujt që janë përjashtuar më parë nga detyrimet e importi, apo të cilat do të përfitonin nga përjashtimi në momentin kur një përjashtimi i tillë kërkohet për pjesë këmbimi/rezervë, komponentë apo pajisje ndihmëse dhe vegla specifike në fjalë.

Neni 473
Mbrojtja e interesave të industrisë

Nëse është e nevojshme, disa artikuj mund të përjashtohen nga e drejta për përjashtim, nëse vërtetohet se përjashtimi i këtyre artikujve nga detyrimet është i dëmshëm për interesat e industrisë së Shqipërisë, për sektorin përkatës të prodhimit.

Neni 474
Statusi i personave të verbër ose me aftësi të kufizuara

Dhënia e përjashtimit të drejtpërdrejtë për personat e verbër apo për persona të tjerë me aftësi të kufizuara, për përdorimin e tyre personal, siç është përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 471 dhe në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 472, do t'i nënshtrohet kushteve të legjislacionit në fuqi për përcaktimin statusit të tyre si persona të verbër ose me aftësi të kufizuara që i jep të drejtën për një përjashtim të tillë.

Neni 475
Kushtëzime

1. Artikujt e importuar me detyrime importi të përjashtuara nga një person i përmendur në nenin 471 dhe 472, nuk mund të huazohen, jepen me qira apo të transferohen, me apo pa pagesë, pa i njoftuar paraprakisht autoritetet doganore kompetente.

2. Nëse një artikull jepet hua, me qira apo transferohet tek një person, institucion apo organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga përjashtimi në përputhje me nenet 471 dhe 482, atëherë përjashtimi jepet me kusht që personi, institucioni ose organizata të përdorë artikullin, për qëllime që i japin të drejtën për një përjashtim të tillë.

Në raste të tjera huazimi, dhënie me qira apo transferimi, do t'i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, në nivelin tarifor që zbatohet në ditën e dhënies hua, me qira apo transferim, në bazë të llojit të mallrave apo pajisjeve dhe vlerës doganore të verifikuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 476
Kushtëzime të tjera

1. Artikujt e importuar nga institucionet ose organizatat të autorizuara për përjashtim nga detyrimet e importit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 471 dhe 472, mund të huazohen, jepen me qira apo transferohen, me pagesë ose jo, nga këto institucione ose organizata jo-fitimprurëse tek personat e verbër ose me aftësi të kufizuara me të cilët ato kanë lidhje, pa paguar detyrimet përkatëse të importit.

2. Asnjë huadhënie, dhënie me qira apo transferim nuk mund të jepet nën kushte të tjera nga ato të parashikuara në pikën 1, nëse nuk janë informuar më parë autoritetet kompetente doganore.

Nëse një artikull që huazohet, jepet me qira apo transferohet tek një person, institucion ose organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga përjashtimi sipas pikës 1 të nenit 471 ose pikës 1 të nenit 472, përjashtimi jepet me kusht që personi, institucioni ose organizata të përdorë artikullin, për qëllime që i japin të drejtën për një përjashtim të tillë.

Në raste të tjera, huadhënia, dhënia me qira apo transferimi do t'i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor të zbatuar në datën e huadhënies, dhënies me qira ose transferimit, në bazë të llojit të mallrave dhe pajisjeve, si edhe vlerës doganore të verifikuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 477
Mos përmbushja e kushteve për të përfituar përjashtim

1. Institucionet apo organizatat e përmendura në nenen 471 dhe 472, të cilat nuk përmbushin më kushtet që i japin të drejtën për përjashtim, ose që synojnë të përdorin artikujt e pranuar pa detyrime importi për qëllime të tjera nga ato të parashikuara nga këto nene, duhet të informojnë autoritetet kompetente doganore.

2. Artikujt, që mbeten në posedim të institucioneve apo organizatave, të cilat pushojnë së përmbushuri kushtet për përfitimin e përjashtimit do t'u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën kur nuk plotësohen më kushte, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore, të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

3. Artikujt e përdorur nga institucioni apo organizata përfituese nga përjashtimi për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në nenet 471 dhe 472, u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas normës që zbatohet në datën kur ato janë vendosur për një përdorim tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 17.3
Për viktimat e fatkeqësive

Dispozitat e këtij nënseksioni trajtojnë përjashtimin për mallrat e importuara për viktimat e fatkeqësive.

Neni 478
Mallra në dobi të viktimave të fatkeqësive

1. Në përputhje me nenet 479 deri 484, mallrat e importuara, nga institucionet publike ose institucionet buxhetore shtetërore apo nga organizata të tjera bamirëse, filantropike ose fetare, të miratuara prej autoriteteve doganore kompetente, për këtë qëllim, përjashtohen nga detyrimet e importit, kur destinohen:

a) për shpërndarje falas viktimave të fatkeqësive, që godasin territorin doganor të Republikës së Shqipërisë; ose

b) për ti vënë në dispozicion falas të viktimave të fatkeqësive të tilla, ndonëse mbeten pronë e organizatave në fjalë.

2. Mallrave të importuara për qarkullim të lirë nga agjencitë, shoqatat apo strukturat e miratuara, që ndihmojnë për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë, për plotësimin e nevojave të tyre gjatë periudhës së veprimtarisë, gjithashtu do t'u jepet përjashtimi i përmendur në pikën 1, nën të njëjtat kushte.

Neni 479
Kufizime

Asnjë përjashtim nuk do të jepet për materiale dhe pajisje që kanë për qëllim rindërtimin e zonave të fatkeqësive.

Neni 480
Dhënia e përjashtimit

Dhënia e përjashtimit për qëllime të nënseksionit 17.3, do të jetë objekt i një Vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave. Ky vendim, sipas nevojës, përcakton qëllimin dhe kushtet e përjashtimit.

Neni 481
Procedurat e kontabilitetit

Përjashtim përfitojnë vetëm organizatat të cilat përdorin procedura kontabiliteti të cilat lejojnë autoritetet doganore kompetente të mbikëqyrin veprimtarinë e tyre dhe që ofrojnë të gjitha garancitë që konsiderohen të nevojshme.

Neni 482
Kushtëzime

1. Organizatat që përfitojnë nga përjashtimi nuk mund të huazojnë, japin me qira apo transferojnë, me apo pa pagesë, mallrat e referuara në pikën 1 të neni 478, në kushte të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 478, pa njoftuar më parë autoritetet kompetente doganore.

2. Nëse mallrat jepen hua, me qira apo transferohen tek një organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga përjashtimi sipas nenit 478, atëherë përjashtimi vazhdon të jepet me kusht që kjo organizatë ti përdori mallrat për të njëjtin qëllim për të cilin jepet e drejta e përjashtimit.

Në raste të tjera, dhënia hua, me qira apo transferimi i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në ditën e dhënies hua, me qira apo transferimit, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 483
Kushtëzime të tjera

1. Mallrat e referuara në shkronjën "b" pika 1 të nenit 478, në momentin që nuk përdoren më nga të dëmtuarit në katastrofa, nuk mund të jepen hua, me qira apo të transferohen me pagesë apo falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet doganore kompetente.

2. Nëse mallrat jepen hua, me qira apo i transferohen organizatës e cila vetë gëzon të drejtën e përfitimit të përjashtimit sipas nenit 478 ose sipas rastit i jepet organizatës e cila gëzon të drejtën e përfitimit të përjashtimit sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 465, përjashtimi vazhdon të jepet me kusht që organizatat e tilla t'i përdorin ato për të njëjtat qëllime për të cilat jepet përjashtimi.

Në rastet të tjera, huazimi, dhënia me qira apo transferimi i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit sipas nivelit tarifor, që zbatohet në datën e dhënies hua, me qira apo të transferimit në bazë të llojit të mallrave dhe të vlerës doganore të konstatuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 484
Mos përmbushja e kushteve për të përfituar përjashtim

1. Organizatat e referuara në nenin 478, të cilat nuk vazhdojnë të përmbushin kushtet për të përfituar përjashtim, apo të cilat dëshirojnë të përdorin mallrat e përjashtuara nga detyrimet e importit për qëllime tjera nga ato të parashikuara nga ai nen, duhet të njoftojnë për këtë autoritetet doganore kompetente.

2. Mallrat që mbeten në posedim të organizatave të cilat nuk vazhdojnë t'i plotësojnë kushtet e përfitimit të përjashtimit, kur këto mallra transferohen tek një organizatë, e cila po ashtu gëzon të drejtën e përjashtimit sipas nenit 478, ose, sipas rastit, tek një organizatë që gëzon të drejtën e përjashtimi në zbatim të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 465, atëherë përjashtimi vazhdon të jepet me kusht që kjo organizatë i shfrytëzon mallrat për ato qëllime për të cilat ajo gëzon të drejtën e përjashtimit. Në raste të tjera mallrat do t'i nënshtrohen pagesës së detyrimeve përkatëse të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën kur kushtet e tilla nuk vazhdojnë të përmbushen, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore, të konstatuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

3. Mallrat e përdorura nga organizata që kanë përfituar nga përjashtimi për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në nenin 478, i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, sipas nivelit tarifor të zbatuar në datën në të cilën ato janë vendosur për një përdorim tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar ose pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 18
Dekoratat apo çmimet e nderit

Neni 485
Kufizime

1. Përjashtohen nga detyrimet e importit, nëse paraqiten prova të mjaftueshme pranë autoritetit doganor kompetent nga personat përkatës dhe me kusht që veprimet e përfshira, nuk janë në ndonjë mënyrë të karakterit tregtar:

a) dekoratat e dhëna nga qeveritë e huaja për ata persona vendqëndrimi (vendbanimi) i të cilëve

është në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) kupat, medaljet dhe artikujt e ngjashëm të një natyre tërësisht simbolike, të cilat i janë dhënë shpërblim jashtë Republikës së Shqipërisë, personave që kanë vendqëndrimin (vendbanimin) në Republikën e Shqipërisë, si shenjë nderi për veprimtarinë e tyre në fushën e artit, shkencës, sportit apo shërbimeve publike apo si një mirënjohje për suksesin e arritur në një ngjarje të veçantë, të cilat importohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga vetë ata persona;

c) kupat, medaljet dhe artikujt e ngjashëm të një natyre tërësisht simbolike, të cilat jepen falas nga autoritete apo persona jashtë Republikës së Shqipërisë, për t'u prezantuar në Shqipëri për të njëjtat qëllime si ato të përcaktuara në shkronjën "b";

ç) çmime, trofe dhe dhurata të një natyre simbolike dhe me vlerë të kufizuar të destinuara për shpërndarje falas personave me vendbanim normal jashtë Republikës së Shqipërisë, në konferenca biznesi ose aktivitete të ngjashme ndërkombëtare; natyra e tyre, vlera për njësi ose karakteristika të tjera, nuk duhet të jenë të tilla që mund të tregojnë se ato janë importuar për aresye tregtare.

Nënseksioni 19
Dhurata të marra në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare

Neni 486
Përjashtimi për dhurata në kuadrin e marrëdhënieve Ndërkombëtare

Kur është rasti, pa cenuar nenin 438, dhe në përputhje me nenet 487 dhe 488, përjashtimi jepet për mallra të cilat:

a) janë importuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga persona që kanë bërë një vizitë zyrtare në një vend tjetër dhe të cilët i kanë marrë ato mallra si dhurata nga autoritetet mikpritëse;

b) janë importuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga persona që vijnë për vizitë zyrtare në Shqipëri dhe që kanë për qëllim t'i ofrojnë mallrat si dhurata për autoritetet mikpritëse;

c) janë dërguar si dhuratë, në shenjë të miqësisë apo të vullnetit të mirë, nga një organ zyrtar apo autoritet publik, që kryen një aktivitet në interes të publikut, i cili është vendosur në një vend tjetër, për një organ zyrtar ose autoritet publik që kryen një aktivitet në interes të publikut, i cili ndodhet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të aprovuara nga autoritetet kompetente doganore për të marrë artikuj të tillë me përjashtim nga detyrimet e importit.

ç) janë dërguar si dhuratë për përdorim nga njësitë ushtarake të Forcave të Armatosura dhe strukturave të Policisë së Shtetit si: instrumente, aparate dhe pjesët e tyre, veshmbathje si dhe materiale logjistike, shëndetësore, makineri dhe pajisje.

Neni 487
Produkte që nuk përfitojnë përjashtim

Nuk përfitojnë përjashtim produktet e alkoolit, duhani apo produktet e duhanit.

Neni 488
Kushtëzime

Përjashtimi nga detyrimet e importit jepet vetëm nëse:

a) artikujt e destinuar si dhurata ofrohen mbi baza rastësore;

b) artikujt nuk pasqyrojnë qoftë për nga natyra, vlera apo sasia e tyre, ndonjë interes tregtar;

c) artikujt nuk përdoren për qëllime tregtare.

Nënseksioni 20
Mallra për t'u përdorur nga personalitetet e larta të shtetit

Neni 489
Përjashtimi për personalitetet e larta të shtetit

1. Do të përjashtohen nga detyrimet e importit;

a) dhurata për krerët e shtetit;

b) mallra për t'u përdorur apo konsumuar nga monarkët në pushtet dhe krerët e shtetit të vendeve të tjera, ose persona që zyrtarisht përfaqësojnë ata, gjatë qëndrimeve të tyre zyrtare në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, përjashtimi mund të bëhet në varësi të parimit të reciprocitetit.

2. Përcaktimet e pikës 1, janë gjithashtu të zbatueshme për personat që gëzojnë privilegje në nivele ndërkombëtare analoge me ato që gëzojnë monarkët në pushtet ose Krerët e Shtetit.

Nënseksioni 21
Mallra të importuara me qëllim nxitjen e tregtisë

Nënseksioni 21.1
Mostra të mallrave me vlerë të papërfillshme

Neni 490
Mostrat e mallrave

1. Pa cenuar shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 494, mostrat e mallrave të cilat janë të një vlerë të papërfillshme dhe të cilat mund të përdoren vetëm për të nxitur porosinë e mallrave të llojit që ato përfaqësojnë, me qëllim të importimit të tyre në Shqipëri, do të përjashtohen nga detyrimet e importit.

2. Autoriteti doganor kompetent, mund të kërkojnë që disa artikuj, për t'u përjashtuar sipas këtij neni, të bëhen përgjithmonë të papërdorshme, duke u grisur, shpuar, apo duke vendosur shenja të qarta dhe që nuk hiqen, ose me ndonjë proces tjetër, me kusht që këto veprime nuk dëmtojnë karakteristikat thelbësore të mostrave.

3. Për qëllime të pikës 1, "mostra të mallrave" janë çdo artikull që përfaqëson një lloj malli, që nga mënyra e prezantimit dhe sasia e tyre, për mallra të njëjtë ose cilësi njëjtë, nuk mundëson përdorimin e tyre për asnjë qëllim tjetër përveç asaj të nxitjes së porosive për atë mall.

Nënseksioni 21.2
Material i shtypur/printuar dhe ai reklamues

Neni 491
Materialet e shtypura reklamuese

Në përputhje me nenin 492, materialet e shtypura/printuara reklamuese siç janë katalogët, listat e çmimeve, udhëzimet për përdorim apo broshurat do të përjashtohen nga detyrimet e importi, me kusht që ato të kenë lidhje me:

a) mallrat për shitje apo dhënie me hua; ose

b) shërbimet e transportit, sigurimit tregtar apo shërbime bankare, që ofrohen nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 492
Kufizime

Përjashtimi i parashikuar me nenin 491, kufizohet për materialet reklamuese të shtypura që plotësojnë kushtet në vijim:

a) materiali i shtypur të paraqesë në mënyrë të qartë emrin e ndërmarrjes e cila prodhon, shet apo jep me qira mallrat, apo e cila ofron shërbimet që u referohet;

b) secila dërgesë nuk duhet të përmbajë më tepër se një dokument ose një kopje të secilit dokument nëse përbëhet nga disa dokumente; dërgesat që përmbajnë disa kopje të të njëjtit dokument, po ashtu përjashtohen, nëse pesha e përgjithshme e tyre, nuk është më e madhe se një kilogram;

c) materiali i shtypur nuk duhet të jetë pjesë e dërgesave në grup nga i njëjti dërgues për të njëjtin pranues.

Neni 493
Artikujt për qëllime reklamuese

Artikujt për qëllime reklamuese, që nuk kanë një vlerë të vërtetë tregtare dhe që dërgohen falas nga furnitorët për klientët e tyre, të cilat, përveç funksionit reklamues nuk mund të shfrytëzohen për diçka tjetër, përjashtohen nga detyrimet e importi.

Nënseksioni 21.3
Produktet e përdorura apo të konsumuara në një panair tregtar apo në ngjarje të ngjashme

Neni 494
Përjashtime për panaire tregtare apo në ngjarje të ngjashme

1. Në përputhje me nenet 495 deri 498, përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) mostra të vogla përfaqësuese të mallrave të prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, që destinohen për panaire tregtare apo për ngjarje të ngjashme;

b) mallrat e importuara vetëm për t'u demonstruar apo për të demonstruar makineritë dhe aparaturat e prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të ekspozuara në një panair tregtar apo në një ngjarje të ngjashme;

c) lëndë të ndryshme të një vlere të vogël siç

janë ngjyrat, bojërat, letër muri etj., që përdoren për ndërtimin, rregullimin dhe dekorimin e stendave, ku janë vendosur përfaqësuesit e huaj në një panair tregtar apo një ngjarje të ngjashme, të cilat shkatërrohen duke u përdorur;

ç) material i shtypur, katalogë, prospekte, lista çmimesh, afishe reklame, kalendarë, me ilustrime apo jo, fotografi pa korniza si dhe artikuj të tjerë të ofruar falas për reklamimin e mallrave të prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të ekspozuara në një panair tregtar apo në një ngjarje të ngjashme.

2. Për qëllime të pikës 1, "panair tregtar apo ngjarje e ngjashme" nënkupton:

a) ekspozita, panaire, shfaqje dhe ngjarje të ngjashme që kanë të bëjnë me tregtinë, industrinë, bujqësinë apo artizanatin;

b) ekspozita dhe ngjarje që mbahen kryesisht për arsye bamirësie;

c) ekspozita dhe ngjarje që mbahen kryesisht për arsye shkencore, teknike, artizanati, artistike, edukative ose kulturore, apo sportive, për arsye fetare apo kulti, aktivitete të sindikatave apo për turizëm, apo me qëllim të promovimit të njohjes ndërkombëtare;

ç) takime të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare apo organeve kolegjiale;

d) ceremoni dhe mbledhje zyrtare ose përkujtimore.

Nuk përfitojnë ekspozita për qëllime private në dyqanet apo objektet tregtare për të shitur mallra të vendeve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 495
Kufizime

Përjashtimet e parashikuara me shkronjën "a" pika 1 e nenit 494, kufizohen në mostra të cilat:

a) janë importuar pa pagesë si të tilla nga vende të tjera apo janë përfituar në ekspozitë nga mallra të importuara me shumicë nga ato vende;

b) ekskluzivisht shpërndahen falas për publikun nëpër ekspozita për përdorim apo konsumim nga personat të cilëve u janë ofruar;

c) janë të identifikueshme si mostra reklamuese me vlera të ulëta për njësi;

ç) nuk tregtohen lehtë dhe, kur paraqitet rasti, paketohen në atë mënyrë që sasia e artikullit përkatës është më e ulët se sasia më e vogël e të njëjtit artikull që shitet në treg;

d) në rastin e ushqimeve dhe pijeve që nuk janë të paketuara në mënyrën e përmendur në shkronjën "ç", konsumohen aty për aty në ekspozitë;

dh) për nga vlera dhe sasia e përgjithshme e tyre, i përshtaten natyrës së ekspozitës, numrit të vizitorëve dhe kapacitetit të pjesëmarrjeve ne ekspozitë.

Neni 496
Kufizime të tjera

Përjashtimet e përcaktuara në shkronjën "b" pika 1 e nenit 494, do të kufizohen për mallra të cilat:

a) janë konsumuar apo shkatërruar në ekspozitë, dhe

b) janë të përshtatshme, për nga vlera totale dhe sasia, natyra e ekspozitës, numrit të vizitorëve dhe kapacitetit të pjesëmarrësve në ekspozitë.

Neni 497
Kufizime

Përjashtimet e parashikuara në shkronjën "ç" pika 1 e nenit 494, kufizohen për materialet e shtypur dhe artikujt për qëllime reklamimi, të cilat:

a) ekskluzivisht kanë për qëllim që të shpërndahen falas për publikun në vendin ku mbahet ekspozita;

b) për nga vlera dhe sasia totale e tyre, i përshtaten natyrës së ekspozitës, numrit të vizitorëve dhe kapacitetit të pjesëmarrësve në ekspozitë.

Neni 498
Ndalime

Përjashtimet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 494, nuk lejohen për:

a) produktet e alkoolit;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) karburantet, qoftë në gjendje të ngurtë, lëngët apo të gaztë.

Nënseksioni 22
Mallrat e importuara për qëllime ekzaminimi, analizash ose testi

Neni 499
Përjashtime për mallrat të cilat i nënshtrohen ekzaminimeve, analizave apo testeve

Në përputhje me nenet 500 deri 505, mallrat të cilat i nënshtrohen ekzaminimeve, analizave apo testeve për të përcaktuar përbërjen, cilësinë apo karakteristikat e tjera teknike të tyre për qëllime informimi apo për kërkime industriale ose tregtare përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 500
Kushtëzime

Pa cenuar nenin 503, përjashtimet e përcaktuara në nenin 499, jepen vetëm me kusht që mallrat që do të ekzaminohen, analizohen apo testohen do të shfrytëzohen apo shkatërrohen plotësisht gjatë ekzaminimit, analizës apo testimit.

Neni 501
Mallra që nuk përjashtohen

Mallrat e përdorura gjatë ekzaminimit, analizës apo testimit të cilat në vetvete paraqesin qëllimin e promovimit të shitjes, nuk përjashtohen.

Neni 502
Kushtëzime për sasinë e mallrave

Përjashtimi jepet vetëm për ato sasi mallrash të cilat janë në mënyrë strikte të nevojshme për qëllimin për të cilin importohen. Këto sasi do të përcaktohen për secilin rast nga autoritetet doganore, duke marrë parasysh qëllimin në fjalë.

Neni 503
Kushtëzime të tjera

1. Përjashtimet e përcaktuara në nenin 499, përfshijnë mallrat të cilat nuk janë konsumuar tërësisht apo shkatërruar gjatë ekzaminimit, analizës apo testimit, me kusht që produktet e mbetura, me marrëveshje dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore kompetente:

a) janë shkatërruar krejtësisht apo janë bërë të pavlefshme nga ana tregtare me përfundimin e ekzaminimit, analizës apo testimit; ose

b) janë dorëzuar pranë Rezervave të Shtetit pa shkaktuar ndonjë shpenzim; ose

c) janë eksportuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në rrethana tërësisht të justifikuara.

2. Për qëllime të pikës 1, "produktet e mbetura" nënkuptohen produktet që rezultojnë nga ekzaminimi, analiza apo testimi apo mallrat që nuk janë përdorur.

Neni 504
Produktet e mbetura pas përfundimit të ekzaminimit, analizës apo testimit

1. Me përjashtim të rasteve kur zbatohet pika 1 e nenit 503, produktet e mbetura pas përfundimit të ekzaminimit, analizës apo testimit të referuara në nenin 499, janë objekt i detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën e përfundimit të ekzaminimit, analizës apo testimit, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar dhe pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

2. Megjithatë, pala e interesuar me marrëveshje dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore kompetente mund t'i shndërrojë produktet e mbetura në mbeturina apo skrap. Në këtë rast, detyrimet e importit janë ato që zbatohen për mbeturina të tilla ose skrap në momentin e shndërrimit.

Neni 505
Afatet kohore

Afatet kohore brenda të cilës duhet të kryhen ekzaminimet, analizat apo testet, si edhe të përfundohen formalitetet administrative, për të garantuar përdorimin e mallrave për qëllimet e destinuara, përcaktohet nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 23
Dërgesat për organizatat që mbrojnë të drejtat e autorit ose patentës industriale dhe tregtare

Neni 506
Përjashtimi për markat tregtare, modelet, disenjot dhe dokumentet shoqëruese të tyre

Markat tregtare, modelet apo dizenjot, si dhe dokumentet shoqëruese të tyre, si edhe aplikimet për patentë për shpikje apo të ngjashme me të, që i dorëzohen organeve kompetente për mbrojtën e të

drejtave të autorit apo për mbrojtjen e të drejtave të patentave industriale apo tregtare, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Nënseksioni 24
Botimet informuese me karakter turistik

Neni 507
Përjashtimi për botimet informuese me karakter turistik

Pa cenuar nenet 446 deri 454, përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) dokumentacioni (fletëpalosjet, broshurat, librat, revistat, librat udhëzues, posterat/afishet në kornizë ose jo, fotografitë pa kornizë dhe zmadhimet fotografike, hartat të ilustruara apo jo, letrat transparente për xhamat/dritaret dhe kalendarë të ilustruar) për t'u shpërndarë falas dhe qëllimi kryesor i të cilëve është të nxisë publikun të vizitojë vende të tjera, veçanërisht për të ndjekur takime ose aktivitete kulturore, turistike, sportive, fetare ose tregtare apo profesionale, me kusht që një literature e tille të mos përmbajë më shumë se 25% reklamë tregtare private, duke përjashtuar gjithë reklamën private tregtare për shoqëritë e Republikës së Shqipërisë, dhe që nga vetë natyra e këtyre aktiviteteve të pasqyrohet dukshëm qëllimi i nxitjes së tregtisë;

b) lista hotelesh të huaja dhe vjetar të botuar nga agjenci turistike zyrtare, ose nën kujdesin e tyre, orari për shërbimin e huaj të transportit, kur një literature e tillë destinohet të shpërndahet falas dhe nuk përmban më shumë se 25% reklamë private tregtare, duke përjashtuar gjithë reklamat tregtare për shoqëritë e Republikës së Shqipërisë;

c) materiale reference të paraqitura nga përfaqësues të akredituar ose korrespondentë të emëruar nga agjenci turistike kombëtare zyrtare, të cilat nuk destinohen për shpërndarje, si p.sh. vjetarë, listat e abonentëve telefonik ose teleksit, lista e hoteleve, katalogët e panaireve, modele të mallrave të artizanatit me vlerë të papërfillshme, dhe literaturë mbi muzetë, universitetet, qendrat termale ose institucione analoge.

Nënseksioni 25
Dokumente dhe artikuj të ndryshëm

Neni 508
Përjashtime për artikuj të ndryshëm

Përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) dokumentet e dërguara falas për institucionet publike të Republikës së Shqipërisë;

b) publikime të qeverive të huaja dhe publikime zyrtare të institucioneve ndërkombëtare, për t'u shpërndarë falas;

c) fletë votime për zgjedhje të organizuara nga institucione të ngritura në vende të tjera;

ç) objekte për t'u paraqitur si provë ose për qëllime të ngjashme në gjykata dhe agjenci të tjera zyrtare të Republikës së Shqipërisë;

d) modele nënshkrimesh dhe qarkore që kanë të bëjnë me nënshkrimet e dërguara si pjesë e shkëmbimeve të zakonshme të informacionit midis shërbimeve publike ose institucioneve bankare;

dh) materiale zyrtare të shtypura që i dërgohen Bankës së Shqipërisë;

e) raporte, deklarata, shënime, prospekt, formularë aplikimesh dhe dokumente të tjera të hartuara nga shoqëri të regjistruara në vende të tjera dhe të dërguara mbajtësve ose nënshkruesve të titujve të lëshuar prej këtyre shoqërive;

ë) regjistrimet mediatike (skeda me vrima, regjistrime zanore, mikrofilma etj.) të përdorura për transmetimin e informacionit të dërguar falas pritësve, me kusht që përjashtimi nga detyrimet e importit nuk krijon mundësi për abuzime ose shtrembërime të mëdha të parimeve të konkurrencës;

f) fashikuj, arkiva, formularë të shtypur dhe dokumente të tjera për t'u përdorur në mbledhje, konferenca ose kongrese ndërkombëtare dhe raporte mbi këto mbledhje;

g) plane, skica teknike, dizenjo në kalk, përshkrime dhe dokumente të tjera të ngjashme të importuara për të tërhequr ose kryer porosi në vende të tjera ose për të marrë pjesë në konkurse të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

gj) dokumente që përdoren gjatë provimeve të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga institucione me qendër në vende të tjera;

h) formularë të shtypur për t'u përdorur si dokumente zyrtare në qarkullimin ndërkombëtar të

automjeteve ose mallrave, në kuadrin e konventave ndërkombëtare;

i) formularë, etiketa, bileta dhe dokumente të ngjashme të dërguara nga agjenci transporti ose nga sipërmarrje të industrisë së hotelerisë në një vend tjetër për agjenci udhëtimi të krijuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

j) formularë dhe bileta, dokumente transporti (*bill of lading* ose *way-bills*) dhe dokumente të tjera tregtare ose zyrtare, të përdorura;

k) formularë zyrtare të shtypur nga një vend tjetër ose nga autoritete ndërkombëtare, dhe materiale të shtypura në përputhje me standardet ndërkombëtare, të dërguara për shpërndarje nga shoqata të vendeve të tjera në adresë të shoqatave homologe që gjenden në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

l) fotografi, diapozitivë dhe kartonë për matrica fotografish, që mund të përmbajnë edhe udhëzime të dërguara nga agjenci shtypi ose agjenci botuese gazetash dhe revistash;

ll) pulla takse dhe pulla të ngjashme që tregojnë pagimin e detyrimeve në vende të tjera;

m) kartëmonedha dhe monedha në përdorim, që i dërgohen bankave ose organeve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Nënseksioni 26
Materiale të ndryshme, për të fiksuar dhe ruajtur mallrat gjatë transportit të tyre

Neni 509
Përjashtime për materialet që përdoren për ruajtjen e mallrave gjatë transportit

Përjashtohen nga detyrimet e importit materialet e ndryshme të tilla si litarë, kashtë, copa tekstili, letër dhe karton, lëndë drusore dhe plastike, të cilat përdoren për sistemimin dhe mbrojtjen, përfshirë këtu edhe mbrojtjen nga nxehtësia, për mallrat gjatë transportit, nga një vend tjetër, për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të pa ripërdorshme.

Nënseksioni 27
Shtrojat, foragjeret dhe ushqimet që nevojiten gjatë transportit të kafshëve

Neni 510
Përjashtime për shtrojat, foragjeret dhe ushqimet që nevojiten gjatë transportit të kafshëve

Përjashtohen nga detyrimet e importit shtrojat, foragjeret dhe ushqimet për kafshët, të çdo lloji, të cilat janë ngarkuar në mjetin e transportit që përdoret për transportimin e kafshëve nga një vend tjetër për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, për t'u përdorur/konsumuar gjatë udhëtimit.

Nënseksioni 28
Karburanti dhe lubrifikantët në depozitën e mjeteve motorike tokësore, si dhe në depozita për përdorim të veçantë

Neni 511
Përjashtime për karburantin dhe lubrifikantët

1. Në përputhje me nenet 512, 513 dhe 514, përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) karburanti që mbahet në serbatorët e zakonshëm të:

i. automjeteve tregtare apo private, dhe motoçikletave;

ii. depozitave të posaçme,

që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

b) karburanti që mbahet në serbatorë të lëvizshëm, që transportohen nga automjete private dhe motoçikleta, me një maksimum prej 10 litra për mjet dhe pa cenuar legjislacionin në fuqi lidhur me mbajtjen dhe transportin e karburantit.

2. Për qëllime të pikës 1:

a) "automjet tregtar" është çdo automjet rrugor i motorizuar (përfshirë traktorët rrugorë me ose pa rimorkio), i cili nga vetë lloji i ndërtimit dhe i pajisjeve që ka është i projektuar dhe është në gjendje për transportim, me ose pa pagesë, të:

i. më shumë se nëntë persona, përfshirë shoferin,

ii. mallrave, si dhe çdo automjet rrugor për qëllime të posaçme, që në thelb është i ndryshëm nga një transport i tillë;

b) "automjet privat" është çdo automjet, përveç

atyre të cilët përfshihen në përkufizimin e referuar në shkronjën "a";

c) "serbatorë të zakonshëm" janë:

i. serbatorët e vendosur në mënyrë të përhershme nga prodhuesi tek të gjithë automjetet e të njëjtit lloj me automjetin në fjalë dhe ndërtimi i të cilëve lejon përdorimin e drejtpërdrejtë të karburantit, si për lëvizjen e automjeteve, ashtu edhe kur është rasti, për funksionimin, gjatë transportit, të sistemeve të ftohjes dhe të sistemeve të tjerë,

ii. serbatorët e gazit të vendosur në automjete të projektuara për përdorimin direkt të gazit si karburant, si dhe serbatorët që i përshtaten sistemeve të tjera, me të cilat është pajisur automjeti,

iii. serbatorët e vendosur në mënyrë të përhershme nga prodhuesi tek të gjithë mbajtësit e të njëjtit lloj me mbajtësin në fjalë dhe vendosja e përhershme e të cilit mundëson përdorimin e drejtpërdrejtë të karburantit, gjatë transportit, të sistemeve të ftohjes dhe të sistemeve të tjerë me të cilët mbajtësi i posaçëm është pajisur;

ç) "depozitë e posaçme", është çdo mbajtës i pajisur me aparate veçanërisht të dizenjuara për sistemet e ftohjes, sistemet e oksigjenimit, sistemet e termike të izolimit ose sisteme të tjera.

Neni 512
Kufizime

Për sa i përket karburantit që mbajnë serbatorët e zakonshëm dhe depozitat e posaçme të automjeteve tregtare, me urdhër të ministrit përgjegjës për financat mund të kufizohet zbatimi i përjashtimit deri në kufirin 200 litra për automjet, depozitat e posaçme dhe për çdo udhëtim.

Neni 513
Kufizime të tjera

Me Urdhër të ministrit përgjegjës për financat mund të kufizohet sasia e karburantit të lejuar me përjashtim, në rastin e:

a) automjeteve tregtare që kryejnë transport ndërkombëtar nëpër zonën e tyre kufitare me thellësi maksimale prej 15 km në vijë ajrore, me kusht që udhëtimet të kryhen nga banues të zonës kufitare;

b) automjete private që i përkasin banuesve të zonës kufitare.

Neni 514
Karburantet e përjashtuara që nuk mund të përdoren

1. Karburantet e përjashtuara nga detyrimet e importit, në bazë të neneve 511, 512 dhe 513, nuk mund të përdoren në një automjet të ndryshëm prej atij në të cilin gjendeshin kur u importuan, as të transferohen nga ai automjet dhe të ruhen në vend tjetër, me përjashtim të rasteve kur duhen kryer riparime të nevojshme në atë automjet, dhe as nuk mund të transferohen nga vetë personi që përfiton prej përjashtimit, si kundrejt pagesës ashtu edhe falas.

2. Mosrespektimi i kësaj dispozite sjell zbatimin e detyrimeve të importit lidhur me produktet në fjalë, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën kur ndodhi mosrespektimi, llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar ose pranuar prej autoriteteve doganore kompetente në atë datë.

Neni 515
Vajrat lubrifikues

Përjashtimi i referuar në nenin 511, zbatohet edhe për vajrat lubrifikues që gjenden në automjete dhe nevojiten për funksionimin normal të tyre gjatë udhëtimit.

Nënseksioni 29
Materiale për ndërtimin, mirëmbajtjen apo zbukurimin e përmendoreve apo varrezave të viktimave të luftës

Neni 516
Përjashtimet për viktimat e luftës

Përjashtohen nga detyrimet e importit mallrat e çdo lloji, të importuara nga organizma të autorizuar për këtë qëllim nga autoritetet doganore kompetente, për t'u përdorur për ndërtimin, mirëmbajtjen ose zbukurimin e varrezave, varreve, si dhe përmendoreve për të rënët në luftë të vendeve të tjera, të cilët janë varrosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Nënseksioni 30
Arkivole, urnat funerale dhe artikujt dekorativ për funerale

Neni 517
Përjashtimet për funeralet

Përjashtohen nga detyrimet e importit artikujt e mëposhtëm:

a) arkivolet që mbajnë trupa dhe urnat me hirin e të vdekurve si dhe lulet, zbukurimet funerale dhe objekte të tjera zbukurimi që i shoqërojnë;

b) lulet, kurorat dhe objekte të tjera dekorative të sjella nga persona banues në vendet e tjera që marrin pjesë në një funeral, ose të ardhura për të dekoruar varret në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto importe nuk kanë, për nga natyra dhe sasia e tyre, qëllime tregtare.

Nënseksioni 31
Përjashtime të tjera sipas ligjeve të veçanta

Neni 518
Përjashtime për deputetët

1. Për qëllime të pikës 2 të nenit 184 të Kodit, në përputhje me nenet 519 dhe 520 deputeti, vetëm në një rast gjatë mandatit të tij, gëzon të drejtën e përjashtimit nga detyrimet e importit, për mjetet e punës që lidhen me veprimtarinë e tij si deputet.

2. Për qëllime të pikës 1, mjete pune janë:

a) automjeti;
b) kompjuteri;
c) faksi;
ç) telefoni;
d) projektori;
dh) fotokopja;
e) diktofoni;
ë) mobilje dhe ndriçues zyre.

Neni 519
Procedura e përjashtimit

E drejta e përjashtimit për mjetet e punës, që lidhen me veprimtarinë e tij si deputet fitohet pas paraqitjes pranë autoriteteve doganore kompetente, të kërkesës për përjashtim të shoqëruar me dokumentin e ushtrimit aktualisht të mandatin si deputet.

Neni 520
Kushtëzime

1. Deputeti që përfiton nga përjashtimi nuk mund ta huazojnë, japi me qira apo transferojë, me apo pa pagesë, automjetin e përjashtuar nga detyrimet e importit sipas nenit 518.

2. Nëse automjeti jepet hua, me qira apo transferohen tek një deputet tjetër apo person që gëzon të drejtën e përjashtimit nga detyrimet e importit sipas Kodit, atëherë përjashtimi vazhdon të jepet.

3. Nëse automjeti jepet hua, me qira apo transferohet tek një person tjetër i cili nuk përjashtohet nga detyrimet e importit, automjeti i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në ditën e dhënies hua, me qira apo transferimit, në bazë të llojit të automjetit dhe vlerës doganore të konstatuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente. Pas pagimit të detyrimit të importit, deputeti fiton të drejtën e e përjashtimin nga detyrimi i importit për automjetin tjetër.

4. Deputeti nuk mund të ketë, brenda një mandati, më shumë se një automjet, të përjashtuar nga detyrimet e importit.

Nënseksioni 32
Përjashtime për makineri dhe pajisje të tjera të importuara për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike

Neni 521
Përjashtimi i makinerive dhe pajisjeve për ndërtimin e burimeve të energjisë
(Pikat 2 dhe 5, të nenit 184, të Kodit)

1. Për qëllime të nenit 2, të ligjit nr. 8987, datë 24.12.2002, "Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike", përjashtohen nga taksat doganore makineritë dhe pajisjet që bëjnë pjesë në objektin e prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta dhe pa kufizim për burimet e tjera të rinovueshme të prodhimit.

2. Operatori ekonomik i cili ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, pasi të ketë marrë nga organet shtetërore përkatëse lejen për

ndërtimin e një objekti gjenerues, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë, 6 muaj para fillimit të importimit, listën e plotë e të specifikuar të makinerive dhe të pajisjeve që do të importohen vetëm për këtë objekt. Ministri përgjegjës për sektorin e energjisë e miraton këtë listë, pas shqyrtimit dhe verifikimit të saj.

3. Lista e makinerive duhet të përmbajë, për çdo makineri dhe pajisje që importohet, këto specifikime:

a) Emërtimin dhe shenjat e njësisë së makinerisë/pajisjes;

b) Karakteristikat kryesore teknike të makinerisë/pajisjes, sasinë dhe çmimin e blerjes;

c) Karakteristikat e lëndëve djegëse, që përdoren, duke specifikuar llojin dhe konsumin e shprehur për njësi;

ç) Specifikime të tjera sqaruese (konsumi specifik i burimit etj.).

4. Lista e miratuar përgatitet në pesë kopje, nga të cilat një kopje i dërgohet operatorit ekonomik, një kopje Ministrisë përgjegjëse për financat, një kopje Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, një kopje Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe një kopje ruhet në ministrinë përgjegjëse për sektorin e energjisë.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e dërgon listën e makinerive në zyrën doganore mbikëqyrëse të operatorit ekonomik, për të zbatuar të gjitha procedurat e parashikuara nga legjislacioni doganor për përjashtimin e makinerive dhe të pajisjeve të përfshira në këtë listë.

6. Institucionet e përmendura në pikën 4, për çdo ndryshim në listën e specifikuar të makinerive dhe të pajisjeve që importohen, veprojnë në përputhje me dokumentet zyrtare që kërkojnë ndryshimin dhe për këtë japin miratimin përkatës. Në rast se në listën e miratuar më parë është përfshirë një makineri/pajisje që nuk i takon këtij objekti, veprimet doganore kryhen vetëm pasi të shlyhet dhe të dokumentohet pagesa e taksës doganore që nuk ishte paguar, në zbatim të këtij vendimi.

Seksioni 2
Mallrat e rikthyera

Neni 522
Mallrat që konsiderohen të rikthyera në gjendjen në të cilën ishin eksportuar
(Pika 5, e nenit 185, të Kodit)

1. Mallrat konsiderohen të rikthyera në gjendjen në të cilën ishin eksportuar, kur pas eksportimit nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ato nuk kanë pësuar asnjë trajtim apo përpunim tjetër, përveç atij që i ndryshon pamjen ose që është i nevojshëm për riparimin, mbajtjen ose ruajtjen e tyre në gjendje të mirë.

2. Mallrat konsiderohen të rikthyera në gjendjen në të cilën ishin eksportuar, kur pas eksportimit nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ato kanë pësuar një trajtim ose përpunim tjetër, të ndryshëm nga ai që i ndryshon pamjen apo që është i nevojshëm për riparimin, mbajtjen ose ruajtjen e tyre në gjendje të mirë, por pas fillimit të këtij trajtimi ose përpunimi rezultoi se ky i fundit nuk ndryshoi qëllimin e përdorimit për të cilin ishin destinuar mallrat.

3. Kur mallrat e referuara në pikat 1 ose 2 i janë nënshtruar trajtimit ose përpunimit që do t'i bënte ato objekt të detyrimit të importit, nëse do të kishin qenë të vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv, këto mallra konsiderohen të rikthyera në gjendjen në të cilën ishin eksportuar vetëm me kusht që trajtimi ose përpunimi, duke përfshirë edhe trupëzimin e pjesëve të këmbimit, nuk tejkalon atë që është e nevojshme për t'u mundësuar mallrave që të përdoren në të njëjtën mënyrë si në kohën e eksportimit nga territori doganor i i Republikës së Shqipërisë.

Neni 523
Informacioni i kërkuar
(Pika 6, e nenit 185, të Kodit)

1. Deklaruesi informon zyrën doganore ku është depozituar deklarata doganore për çlirimin për qarkullim të lirë, që kushtet për përjashtimin nga detyrimet e importit janë plotësuar.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1, mund të sigurohet me një nga mjetet e mëposhtme:

a) Aksesi në të dhënat përkatëse të deklaratës doganore apo rieksportit, në bazë të së cilës mallrat e kthyera janë eksportuar apo rieksportuar fillimisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

b) Një kopje e vërtetuar nga zyra doganore kompetente e deklaratës doganore apo të rieksportit, në bazë të së cilës mallrat e kthyera janë eksportuar apo rieksportuar fillimisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë

c) Një dokument i lëshuar nga zyra doganore kompetente me të dhënat përkatëse të kësaj deklarate doganore ose deklaratës së rieksportit;

ç) Një dokument i lëshuar nga autoritetet doganore, që vërteton se janë përmbushur kushtet për përjashtimin nga detyrimi i importit (informacionit fletë INF3).

3. Kur informacioni në dispozicion të autoriteteve doganore kompetente vërteton se mallrat e deklaruara për çlirim për qarkullim të lirë janë eksportuar fillimisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe në atë kohë kishin përmbushur kushtet për t'i dhënë përjashtim nga detyrimi i importit si mallra të rikthyera, informacioni i referuar në pikën 2 nuk do të kërkohet.

4. Pika 2 nuk do të zbatohet kur mallrat deklarohen për çlirim për qarkullim të lirë, me gojë ose me anë të ndonjë veprimi tjetër. Nuk do të zbatohet as për qarkullimin ndërkombëtar të materialeve të paketimit/ambalazheve, mjeteve të transportit ose disa mallrave të vendosura nën një regjim doganor të posaçëm, përveç kur parashikohet ndryshe.

Neni 524
Mallrat që përfitojnë në eksport nga masat e politikës bujqësore
(Neni 186 dhe pika 6, e nenit 185 të Kodit)

1. Mallrat e rikthyera, që përfitojnë në eksport nga masat e politikës bujqësore, përjashtohen nga detyrimi i importit kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Janë rikthyer shumat e paguara në bazë të këtyre masave dhe autoritetet kompetente kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për të tërhequr shumat e përfituara në bazë të politikës bujqësore në lidhje me këto mallra apo janë anuluar përfitimet e tjera financiare të dhëna;

b) Mallrat janë në një nga situatat e mëposhtme:

i. nuk mund të hidhen në treg në vendin ku janë dërguar;

ii. janë kthyer nga marrësi për arsye defektesh ose nuk janë në përputhje me kontratën;

iii. janë rikthyer në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë sepse nuk mund të përdoreshin për qëllimet e destinuara për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të eksportuesit;

c) mallrat janë deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë në territorin doganor Republikës së Shqipërisë brenda 12 muajve nga data e përfundimit të formaliteteve doganore lidhur me eksportimin e tyre.

2. Rrethanat e referuara në nënndarjen "iii", rë shkronjës "b", të pikës 1, janë, si më poshtë vijon:

a) Mallrat e rikthyera në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë si pasojë e dëmeve të vetë mallrave ose të mjetit të transportit me të cilin janë transportuar, të ndodhura para marrjes në dorëzim nga marrësi;

b) Mallrat e eksportuara fillimisht për qëllime të konsumit ose shitjes në një panair tregtar apo rast të ngjashëm, që nuk janë konsumuar apo shitur;

c) Mallrat, të cilat nuk mund t'i dorëzoheshin marrësit për shkak të paaftësisë së tij fizike ose ligjore për të respektuar kontratën, sipas së cilës u eksportuan mallrat;

ç) Mallrat, të cilat për shkak të çrregullimeve natyrore, politike apo shoqërore, nuk mund t'i dorëzohen marrësit ose i janë dorëzuar atij pas datës së dorëzimit kontraktual;

d) Frutat dhe perimet, të eksportuara për qëllime shitjeje, por të cilat nuk janë shitur në tregun e vendit të destinacionit.

3. Deklarata për çlirim për qarkullim të lirë në lidhje me mallrat e rikthyera, eksportimi i të cilave ka përmbushur formalitetet për marrjen e rimbursimeve ose pagesave të tjera të përcaktuara në bazë të masave të politikave bujqësore, duhet të mbështetet nga dokumentet e përmendura në nenin 523 dhe nga një certifikatë e lëshuar nga autoritetet kompetente për dhënien e rimbursimit apo pagesave të tilla në Republikën e Shqipërisë.

4. Kur autoritetet e zyrës doganore ku mallrat janë deklaruar për çlirim për qarkullim të lirë kanë informacion që vërteton se asnjë rimbursim ose pagesë tjetër e parashikuar në eksport në bazë të masave të politikave bujqësore nuk janë dhënë dhe nuk mund të jepen, certifikata nuk do të jetë e nevojshme.

Neni 525
Lëshimi i fletës së informacionit INF 3
(Nenet 17, pika 3, shkronja "a" dhe 185, pika 6, të Kodit)

1. Eksportuesi mund të kërkojë një fletë informacioni INF 3 nga zyra doganore e eksportit.

2. Kur eksportuesi kërkon fletën e informacionit INF 3 në kohën e eksportit, fleta e informacionit INF 3 do të lëshohet nga zyra doganore e eksportit në kohën e përfundimit të formaliteteve të eksportit për mallrat.

Kur është e mundur që mallrat e eksportuara të rikthehen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet disa zyrave doganore, eksportuesi mund të kërkojë disa fletë informuese INF 3, ku secila mbulon një pjesë të sasisë totale të mallrave të eksportuara.

3. Kur eksportuesi kërkon një fletë informacioni INF 3 për mallrat pas përfundimit të formaliteteve të eksportit, fleta e informacionit INF 3 mund të lëshohet nga zyra doganore e eksportit, nëse informacioni në lidhje me mallrat e deklaruara nga eksportuesi korrespondon me informacionin në dispozicion të zyrës doganore të eksportit në lidhje me mallrat e eksportuara dhe asnjë rimbursim ose pagesa të tjera të parashikuara në eksport në bazë të masave të politikave bujqësore nuk janë dhënë, dhe nuk mund të jepen , në lidhje me këto mallra.

4. Kur një fletë informacioni INF 3 është lëshuar, eksportuesi mund të kërkojë që zyra doganore e eksportit ta zëvendësojë atë me disa fletë informative INF 3 ku secila mbulon një pjesë të sasisë totale të mallrave të përfshira në fletën informacioni INF 3 të lëshuar fillimisht.

5. Eksportuesi mund të kërkojë që një fletë informative INF 3 të lëshohet vetëm në lidhje me një pjesë të mallrave të eksportuara.

6. Kur lëshohet në letër një fletë informacioni INF 3, një kopje mbahet nga zyra doganore e eksportit që e ka lëshuar atë.

7. Kur fleta origjinale e informacionit INF 3 e lëshuar në letër është vjedhur, humbur ose shkatërruar, zyra doganore e eksportit që e ka lëshuar atë, mund të lëshojë një dublikatë me kërkesë të eksportuesit.

Zyra doganore e eksportit shënon në kopjen e fletës së informacionit INF 3 në zotërim të saj, që një dublikatë është lëshuar.

8. Fleta e informacionit INF 3 do të hartohet duke përdorur formularin e përcaktuar në aneksin 62-02, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 526
Mjetet e komunikimit të fletës së informacionit INF 3
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Dokumenti që vërteton se janë përmbushur kushtet për përjashtim nga detyrimi i importit ('fleta e informacionit INF 3') mund të komunikohet duke përdorur mjete të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 527
Komunikimi ndërmjet autoriteteve
(Pika 6, e nenit 185, të Kodit)

Me kërkesë të zyrës doganore ku mallrat e rikthyera janë deklaruar për çlirim për qarkullim të lirë, zyra doganore e eksportit dërgon çdo informacionin në dispozicion të saj, në të cilin përcaktohet se kushtet për përjashtimin nga detyrimi i importit janë plotësuar në lidhje me ato mallra.

Seksioni 3
Produktet e peshkimit detar dhe produkte të tjera të nxjerra nga deti

Neni 528
Përjashtimi nga detyrimi i importit
(Pika 2, e nenit 189, të Kodit)

Prova që kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 189, të Kodit, janë përmbushur mund të jepet, sipas rastit në përputhje me dispozitat e neneve 162 deri 165 dhe neneve 483 deri 485.

TITULLI VII
REGJIMET E POSAÇME

KREU 1
Dispozita të përgjithshme

Seksioni 1
Aplikimi për autorizim

Neni 529
Aplikuesi i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 192, të Kodit)

Duke anashkaluar përcaktimet e shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 192, të Kodit, autoritetet doganore në raste të caktuara, kur e konsiderojnë të justifikuar, mund t'i japin autorizim për regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use)* ose regjimin e përpunimit aktiv personave të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 530
Vendi për dorëzimin e aplikimeve, kur aplikuesi është i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë
(Pika 1, e nenit 27, të Kodit)

1. Duke anashkaluar paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 27, të Kodit, në rastet kur aplikuesi për autorizimin e regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) është i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, autoriteti doganor kompetent për depozitimin e aplikimit është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

2. Duke anashkaluar paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 27, të Kodit, në rastet kur aplikuesi për autorizim i regjimit të përpunimit aktiv është i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, autoriteti doganor kompetent për depozitimin e aplikimit është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 531
Aplikimi për autorizim bazuar në një deklaratë doganore
(Nenet 17, pikat 1, 2 e 3, shkronja "a", dhe 192, pika 1, të Kodit)

1. Deklarata doganore, me kusht që të plotësohet me të dhëna shtesë, siç përcaktohet në aneksin A, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, konsiderohet si një aplikim për autorizim në secilin prej rasteve të mëposhtme:

a) Kur mallrat duhet të vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm, nëse autoritetet doganore kërkojnë një aplikim formal në rastet e përcaktuara nga shkronja "b", e nenit 681;

b) Kur mallrat duhet të vendosen nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar *(end-use*) dhe aplikuesi ka për qëllim t'i vendosë tërësisht mallrat e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*), të parashikuara;

c) Kur mallra të tjera nga ato të renditura në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, duhet të vendosen nën regjimin e përpunimit aktiv;

ç) Kur mallra të tjera nga ato të renditura në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, duhet të vendosen nën regjimin e përpunimit pasiv;

d) Kur është dhënë një autorizim për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv dhe produktet zëvendësuese duhet të hidhen në qarkullim të lirë duke përdorur sistemin e shkëmbimit standard, i cili nuk mbulohet nga ky autorizim;

dh) Kur produktet e përpunuara hidhen në qarkullim të lirë pas përpunimit pasiv dhe operacioni i përpunimit ka të bëjë me mallra të natyrës jotregtare.

2. Pika 1, nuk zbatohet në rastet:

a) e deklaratës së thjeshtuar;

b) e zhdoganimit të centralizuar;

c) e hyrjes në regjistrimet e deklaruesit;

ç) e aplikimit për një autorizim, të ndryshëm nga ai për lejim të përkohshëm, që përfshin më shumë se një zyrë doganore;

d) e aplikimit për përdorim të mallrave ekuivalente në përputhje me nenin 201 të Kodit;

dh) kur autoriteti doganor kompetent informon deklaruesin se është i nevojshëm shqyrtimi i kushteve ekonomike në përputhje me pikën 5, të nenit 192, të Kodit;

e) kur zbatohet shkronja "dh", e pikës 1, të nenit 537;

ë) kur zbatohet autorizimi me efekt prapaveprues në përputhje me pikën 2, të nenit 192, të Kodit, me përjashtim të rasteve të referuara në shkronjat "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni.

3. Kur autoritetet doganore gjykojnë se vendosja e mjeteve të transportit ose e pjesëve të këmbimit, aksesorëve dhe pajisjeve për mjetet e transportit në regjimin e lejimit të përkohshëm do të përbënte një rrezik serioz të mospërmbushjes së një prej detyrimeve të parashikuara në legjislacionin doganor, deklarata doganore e përmendur në pikën 1, nuk duhet të bëhet me gojë ose në përputhje me nenin 304. Në këtë rast, pas paraqitjes së mallrave në doganë, autoritetet doganore informojnë deklaruesin pa vonesë.

4. Detyrimi për të paraqitur të dhëna shtesë të referuara në pikën 1 nuk zbatohet në deklaratat e mëposhtme:

a) deklaratën doganore për çlirim në qarkullim të lirë të bëra me gojë në përputhje me nenin 304;

b) deklaratën doganore për lejim të përkohshëm ose deklaratën e rieksportit, të bëra me gojë në përputhje me nenin 305;

c) deklaratën doganore për lejim të përkohshëm ose deklaratën e rieksportit në përputhje me nenin 309, të konsideruara si të bëra në përputhje me nenin 311.

5. Carnet ATA dhe Carnet CPD konsiderohen aplikime për autorizim për lejimin e përkohshëm, kur ato përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Carnet-i është lëshuar në një palë kontraktuese të Konventës ATA ose Konventës së Stambollit dhe është miratuar e garantuar nga një shoqëri, e cila është pjesë e një zinxhiri garantues, sipas përcaktimit të shkronjës "d", të nenit 1, të aneksit A, të Konventës së Stambollit;

b) Carnet-i lidhet me mallrat dhe përdorimet e parashikuara nga Konventa sipas së cilës është lëshuar;

c) Carnet-i është i certifikuar nga autoritetet doganore;

ç) Carnet-i është i vlefshëm në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 532
Aplikimi për rinovimin ose ndryshimin e një autorizimi
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Autoritetet doganore mund të lejojnë që aplikimi për rinovimin ose ndryshimin e një autorizimi të referuar në pikën 1, të nenit 192, të Kodit, të paraqitet me shkrim.

Neni 533
Dokumentet shoqëruese për një deklaratë doganore me gojë në regjimin e lejimit të përkohshëm
(Nenet 17, pikat 2 e 3, shkronja "a", dhe 192, pika 1, të Kodit)

Kur një deklaratë doganore me gojë është konsideruar si një aplikim për një autorizim për lejim të përkohshëm në përputhje me nenin 531, deklaruesi duhet të paraqesë një dokument shoqërues, sipas përcaktimit të aneksit 71-01, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 534
Dokumenti mbështetës për një deklaratë doganore me gojë për lejim të përkohshëm
(Pika 2, e nenit 27, të Kodit)

Kur një aplikim për një autorizim për lejim të përkohshëm është bazuar në një deklaratë doganore me gojë, deklaruesi paraqet dokumentin mbështetës të përmendur në nenin 533, në dy kopje dhe, një kopje e miratuar nga autoriteti doganor do t'i jepet mbajtësit të autorizimit.

Seksioni 2
Marrja e vendimit për aplikimin

Neni 535
Shqyrtimi i kushteve ekonomike
(Pikat 3 dhe 4, të nenit 192, të Kodit)

1. Kushti i përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 192, të Kodit, nuk zbatohet për autorizime të përpunimit aktiv, përveç rasteve të mëposhtme:

a) Kur llogaritja e shumës së detyrimit të importit është bërë në përputhje me pikën 3, të nenit 81, të Kodit, ekziston prova se interesat thelbësorë të prodhuesve shqiptarë mund të ndikohen negativisht dhe rasti nuk parashikohet nga shkronjat "a" deri "dh", të pikës 1, të nenit 537;

b) Kur llogaritja e shumës së detyrimit të importit është bërë në përputhje me nenin 80 të Kodit, mallrat e destinuara për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv do t'i nënshtrohen një mase të politikës bujqësore ose tregtare, një detyrimi të përkohshëm ose të përhershëm antidumping, një detyrimi kundërbalancues, një

mase mbrojtëse apo një detyrimi shtesë që rezulton nga një pezullim i koncesioneve, nëse do të ishin deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë dhe ky rast nuk parashikohet nga shkronjat "ë", "f" "i", "l" ose "n", të pikës 1, të nenit 537;

c) Kur llogaritja e shumës së detyrimit të importit është bërë në përputhje me nenin 80 të Kodit, mallrat e destinuara për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv nuk do t'i nënshtrohen një mase të politikës bujqësore ose tregtare, një detyrimi të përkohshëm ose të përhershëm antidumping, një detyrimi kundërbalancues, një mase mbrojtëse apo detyrimi shtesë që rezulton nga një pezullim i koncesioneve, nëse do të ishin deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë, atëherë ekziston prova se interesat thelbësore të prodhuesve shqiptarë mund të ndikohen negativisht dhe ky rast nuk mbulohet nga shkronjat "e" – "n", të pikës 1, të nenit 537.

2. Kushti i përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 192, të Kodit, nuk zbatohet për autorizimet për përpunim pasiv, përveç rasteve kur ekziston prova se interesat thelbësore të prodhuesve shqiptarë për mallrat e listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, ka mundësi të ndikohen negativisht dhe mallrat nuk janë të destinuara për riparim.

Neni 536
Procedura e shqyrtimit të kushteve ekonomike
(Shkronja "a" e pikës 1, të nenit 32 dhe pika 5, e nenit 192, të Kodit)

1. Kur pas një aplikimi për autorizim të përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 192, të Kodit shqyrtimi i kushteve ekonomike është i nevojshëm në përputhje me pikën 5, të nenit 192, të Kodit, autoriteti doganor kompetent për të marrë vendim për aplikimin do t'ia transmetojë pa vonesë dosjen DPD, për një shqyrtim të tillë.

2. Kur, pas lëshimit të një autorizimi për përdorimin e regjimit të përpunimit, autoriteti doganor vihet në dijeni që përdorimi i këtij autorizimi mund të cenojë interesat thelbësore të prodhuesve të Republikës së Shqipërisë, autoriteti doganor do t'ia transmetojë dosjen DPD duke kërkuar shqyrtim të kushteve ekonomike.

3. Një shqyrtim i kushteve ekonomike në nivel kombëtar mund të bëhet me iniciativën e DPD, kur ka prova se interesat thelbësore të prodhuesve të Republikës së Shqipërisë mund të cenohen nga përdorimi i një autorizimi.

4. DPD do të caktojë një grup ekspertësh, të përbërë nga përfaqësues të administratës doganore, të cilët këshillojnë DPD për të përcaktuar nëse kushtet ekonomike janë plotësuar apo jo.

5. Përfundimi i arritur nga shqyrtimi i kushteve ekonomike do të merret parasysh nga autoriteti doganor në fjalë dhe nga çdo autoritet tjetër doganor që ka të bëjë me aplikime apo autorizime të ngjashme.

Mund të specifikohet në përfundimet e arritura në shqyrtim të kushteve ekonomike, që rasti në shqyrtim është unik dhe për këtë arsye nuk mund të shërbejë si precedent për aplikime apo autorizime të tjera.

6. Kur është konstatuar se kushtet ekonomike nuk përmbushen më, autoritetet doganore kompetente do të revokojnë autorizimin përkatës. Revokimi hyn në fuqi jo më vonë se 1 vit nga e nesërmja e datës në të cilën mbajtësi i autorizimit ka marrë dijeni për vendimin e revokimit.

Neni 537
Rastet në të cilat kushtet ekonomike konsiderohen të plotësuara për regjimin e përpunimit aktiv
(Pika 5, e nenit 192, të Kodit)

1. Kushtet ekonomike për regjimin e përpunimit aktiv konsiderohen të plotësuara kur aplikimi lidhet me një nga operacionet e mëposhtme:

a) Përpunimin e mallrave që nuk janë të listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

b) Riparimin;

c) Përpunimin e mallrave të vëna direkt ose indirekt në dispozicion të mbajtësit të autorizimit, i kryer sipas specifikave në emër të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, përgjithësisht vetëm kundrejt pagesës së shpenzimeve të përpunimit;

ç) Përpunimin e grurit të fortë (durum) në makarona;

d) Vendosjen e mallrave në përpunimin aktiv brenda kufijve të sasisë së përcaktuar mbi bazën e një ekuilibri në përputhje me legjislacionin e posaçëm që përcakton një gjë të tillë;

dh) Përpunimin e mallrave të cilat janë të listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në një nga situatat e mëposhtme:

i. mungesa e mallrave të prodhuara në Republikën e Shqipërisë që kanë të njëjtin kod 8-shifror të Nomeklaturës së Kombinuar të Mallrave, të njëjtën cilësi tregtare dhe karakteristika teknike si mallrat e destinuara për t'u importuar për operacionet e parashikuara të përpunimit;

ii. diferencat në çmim mes mallrave të prodhuara në Republikën e Shqipërisë dhe atyre të destinuara për importim, kur mallra të krahasueshme nuk mund të përdoren për shkak se çmimi i tyre nuk do ta bënte veprimin tregtar ekonomikisht të mundur;

iii. detyrimet kontraktuale kur mallrat e krahasueshme nuk janë në përputhje me kërkesat kontraktuale të blerësit të një vendi tjetër për produktet e përpunuara ose kur, në përputhje me kontratën, produktet e përpunuara duhet të jenë përftuar nga mallrat e destinuara për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv, në mënyrë që të përputhen me dispozitat në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale ose tregtare;

iv. vlera totale e mallrave për t'u vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv për aplikues, vit kalendarik dhe për çdo kod tetëshifror të Nomeklaturës së Kombinuar të Mallrave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro;

e) Përpunimin e mallrave për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat teknike për çlirimin në qarkullim të lirë;

ë) Përpunimin e mallrave të natyrës jotregtare;

f) Përpunimin e mallrave bazuar në një autorizim të mëparshëm, lëshimi i të cilit ishte objekt i shqyrtimit të kushteve ekonomike;

g) Përpunimin e fraksioneve të ngurta dhe të lëngshme të vajit të palmës, vajit të kokosit, fraksionet e lëngshme të vajit të kokosit, të vajit të palmës kernel, të vajit babassu ose vajit të recinit në produkte të cilat nuk janë të destinuara për sektorin ushqimor;

gj) Përpunimin e produkteve që trupëzohen ose përdoren në aviacionin civil për të cilin është lëshuar certifikata e vlefshmërisë ajrore;

h) Përpunimin e produkteve që përfitojnë nga pezullimi autonom i detyrimit të importit të armëve dhe pajisjeve ushtarake të caktuara, në përputhje me legjislacionin e posaçëm që përcakton një gjë të tillë;

i) Përpunimin e mallrave në mostra;

j) Përpunimin e çdo lloji të komponentëve elektronikë, pjesëve, bashkimeve apo ndonjë materiali tjetër në produkte të teknologjisë së informacionit;

k) Përpunimin e mallrave që klasifikohen në kodet e Nomeklaturës së Kombinuar të Mallrave 2707 ose 2710 në produkte që klasifikohen në kodet e Nomeklaturës së Kombinuar të Mallrave 2707, 2710 ose 2902;

l) Reduktimin në mbeturina dhe skrap, shkatërrimin, rikuperimin e pjesëve ose komponentëve;

ll) Denatyrimin;

m) Format e zakonshme të trajtimit të përmendura në nenin 199 të Kodit;

n) Vlerën totale të mallrave për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv për aplikues, vit kalendarik dhe për çdo kod tetëshifror të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro në lidhje me mallrat e listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij dhe vlerën ekuivalente në lekë të shumës 300 000 (treqind mijë) euro për mallra të tjera, me përjashtim të rasteve kur mallrat e destinuara për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv do t'i nënshtrohen detyrimit të përkohshëm ose përfundimtar antidumping, detyrimit kundërbalancues, një mase mbrojtëse apo një detyrimi shtesë që rezulton nga një pezullim i koncesioneve, nëse do të ishin deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë.

2. Mungesa e mallrave të përmendura në nënndarjen "i", të shkronjës "dh", të pikës 1, ka të bëjë me rastet e mëposhtme:

a) mungesën totale të prodhimit të mallrave të krahasueshme brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) mungesën e një sasie të mjaftueshme të këtyre mallrave, në mënyrë që të kryhen operacionet e parashikuara të përpunimit;

c) mallrat shqiptare të krahasueshme nuk mund të vihen në kohë në dispozicion të aplikuesit për operacionin tregtar të propozuar për t'u kryer, pavarësisht nga fakti se aplikimi është bërë në kohën e duhur.

Neni 538
Llogaritja e shumës së detyrimit të importit në raste të caktuara të regjimit të përpunimit aktiv
(Pika 4, e nenit 81, të Kodit)

1. Kur nuk kërkohet shqyrtimi i kushteve ekonomike dhe mallrat e destinuara për t'u vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv do të jenë objekt i një mase të politikës bujqësore ose tregtare, një detyrimi të përkohshëm ose përfundimtar antidumping, një detyrimi kundërbalancues, një mase mbrojtëse apo një detyrimi shtesë që rezulton nga një pezullim i koncesioneve nëse do të deklaroheshin për çlirim në qarkullim të lirë, shuma e detyrimit të importit do të llogaritet në përputhje me pikën 3, të nenit 81, të Kodit.

Paragrafi i parë nuk zbatohet nëse kushtet ekonomike konsiderohen të plotësuara në rastet e përcaktuara në shkronjat "ë", "f", "i", "l" ose "n", të pikës 1, të nenit 537.

2. Kur produktet e përpunuara që rezultojnë nga regjimi i përpunimit aktiv janë të importuara direkt ose indirekt nga mbajtësi i autorizimit dhe janë çliruar për qarkullim të lirë brenda një periudhe prej një viti pas rieksportimit të tyre, shuma e detyrimit të importit duhet të përcaktohet në përputhje me pikën 3, të nenit 81, të Kodit.

Neni 539
Procedura e konsultimit mes autoriteteve doganore
(Neni 27 i Kodit)

1. Kur është paraqitur një aplikim për një autorizim të përmendur në pikën 1, të nenit 192, të Kodit dhe përfshin më shumë se një autoritet doganor, zbatohen nenet 27 dhe 31, si dhe pikat 2 deri 5, të këtij neni, përveçse kur autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit gjykon të arsyeshme se kushtet për dhënien e një autorizimi të tillë nuk janë përmbushur.

2. Autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit do t'i komunikojë autoriteteve të tjera doganore të përfshira aplikimin dhe draftautorizimin, jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të aplikimit.

3. Në rastet kur është iniciuar konsultimi, asnjë autorizim që përfshin më shumë se një autoritet doganor nuk do të lëshohet pa pëlqimin paraprak të autoriteteve doganore përkatëse mbi draftautorizimin.

4. Autoritetet e tjera doganore kompetente duhet të komunikojnë miratimin ose kundërshtimet e tyre brenda 30 ditëve pas datës në të cilën u është komunikuar draftautorizimi. Kundërshtimet duhet të justifikohen në mënyrë të arsyetuar.

Kur kundërshtimet janë komunikuar dhe nuk arrihet mirëkuptimi brenda 60 ditëve nga data në të cilën është komunikuar draftautorizimi, autorizimi nuk do të jepet për pjesët mbi të cilat janë ngritur kundërshtime.

5. Nëse autoritetet e tjera doganore të përfshira nuk kanë komunikuar kundërshtime brenda 30 ditëve nga data në të cilën është komunikuar draftautorizimi, miratimi i tyre do të konsiderohet i dhënë.

Neni 540
Rastet në të cilat nuk është e nevojshme procedura e konsultimit
(Neni 27 i Kodit)

1. Autoriteti doganor kompetent merr një vendim për një aplikim, pa konsultimin e autoriteteve të tjera doganore të përfshira, siç është përcaktuar në nenin 549, në rastet e mëposhtme:

a) Një autorizim që përfshin më shumë se një autoritet doganor është:
i) rinovuar;
ii) nënshtruar ndryshimeve të vogla;
iii) anuluar;
iv) pezulluar;
v) revokuar;

b) Dy ose më shumë autoritete doganore të përfshira kanë rënë dakord me to;

c) Aktiviteti i vetëm që përfshin autoritetet e ndryshme doganore është një operacion ku zyra doganore e vendosjes nën regjim dhe zyra doganore e mbylljes së regjimit nuk janë të njëjta;

ç) Një aplikim për autorizim për lejim të përkohshëm,i cili përfshin më shumë se një autoritet doganor do të bëhet në bazë të një deklarate doganore në formën standarde.

Në raste të tilla, autoriteti doganor pasi ka marrë vendimin,vë në dispozicion të autoriteteve të tjera doganore, të dhënat e autorizimit.

2. Autoriteti doganor kompetent merr një vendim për një aplikim pa konsultimin e autoriteteve të tjera doganore të përfshira, siç është

përcaktuar në nenin 539 dhe pa vënien në dispozicion të të dhënave të autorizimit ndaj autoriteteve të tjera doganore në përputhje me pikën 1, në rastet e mëposhtme:

a) Kur përdoren Carnet ATA ose Carnet CPD;

b) Kur një autorizim për lejim të përkohshëm është dhënë nga çlirimi i mallrave për vendosjen nën regjimin përkatës doganor, në përputhje me nenin 555;

c) Kur dy ose më shumë autoritete doganore të përfshira, kanë shprehur miratimin;

ç) Ku i vetmi aktivitet që përfshin autoritetet e ndryshme doganore, lidhet me lëvizjen e mallrave.

Neni 541
Autorizimi për përdorimin e mallrave ekuivalente

(Neni 201, pikat 1, 2 e 3, shkronja "c", të Kodit)

1. Për qëllim të dhënies së autorizimit në përputhje me pikën 2, të nenit 201, të Kodit, nuk përbën rëndësi nëse përdorimi i mallrave ekuivalente është sistematik apo jo.

2. Përdorimi i mallrave ekuivalente, sipas përcaktimit të paragrafit të parë, të pikës 1, të nenit 201, të Kodit, nuk autorizohet kur mallrat e vendosura në regjimin e posaçëm do të jenë objekt i një detyrimi të përkohshëm ose përfundimtar antidumping, një detyrimi kundërbalancues, një detyrimi mbrojtës apo shtese që rezulton nga një pezullim i koncesioneve nëse do të ishin deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë.

3. Përdorimi i mallrave ekuivalente, sipas përcaktimit të paragrafit të dytë, të pikës 1, të nenit 201, të Kodit, nuk do të autorizohet kur mallrat joshqiptare të përpunuara në vend të mallrave shqiptare të vendosura në regjimin e përpunimit pasiv do të jenë objekt i një detyrimi të përkohshëm ose përfundimtar antidumping, një detyrimi kundërbalancues, një mase mbrojtëse apo një detyrimi shtesë që rezulton nga një pezullim i koncesioneve nëse do të ishin deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë.

4. Përdorimi i mallrave ekuivalente nën regjimin e magazinimit doganor nuk autorizohet kur mallrat joshqiptare të vendosura nën regjimin e magazinimit doganor janë ato të listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Përdorimi i mallrave ekuivalente nuk autorizohet për mallrat ose produktet që janë të modifikuara gjenetikisht ose përmbajnë elemente që u janë nënshtruar modifikimit gjenetik.

6. Duke anashkaluar paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 201, të Kodit, do të konsiderohen si mallra ekuivalente për regjimin e përpunimit aktiv:

a) mallrat në një fazë më të avancuar të fabrikimit se mallrat joshqiptare të vendosura në regjimin e përpunimit aktiv, kur pjesa thelbësore e përpunimit të këtyre mallrave ekuivalente kryhet nën sipërmarrjen e mbajtësit të autorizimit ose në atë sipërmarrje ku operacioni është kryer në emër të tij;

b) në rastin e riparimit, mallrat e reja në vend të mallrave të përdorura ose të mallrave në një gjendje më të mirë se mallrat joshqiptare të vendosura në regjimin e përpunimit aktiv;

c) mallrat me karakteristika teknike të ngjashme me mallrat të cilat ato zëvendësojnë, me kusht që të kenë të njëjtin kod tetëshifror të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe të njëjtën cilësi tregtare.

7. Duke anashkaluar paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 201, të Kodit, për mallrat e listuara në aneksin 71-04, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, do të zbatohen dispozitat e posaçme të përcaktuara në këtë aneks.

8. Në rast të regjimit të lejimit të përkohshëm, mallrat ekuivalente mund të përdoren vetëm kur autorizimi për lejim të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimi i importit jepet në përputhje me nenet 653 deri në 656.

Neni 542
Formalitetet për përdorimin e mallrave ekuivalente

(Neni 201 i Kodit)

1. Përdorimi i mallrave ekuivalente nuk do të jetë subjekt i formaliteteve për vendosjen e mallrave nën një regjim të posaçëm.

2. Mallrat ekuivalente mund të ruhen së bashku me mallra të tjera shqiptare ose mallra joshqiptare. Në raste të tilla, autoriteti doganor mund të përcaktojë metoda të veçanta të identifikimit të mallrave ekuivalente, me qëllim dallimin e tyre nga mallrat e tjera shqiptare ose joshqiptare.

Kur është i pamundur ose do të ishte e mundur vetëm me kosto joproporcionale, identifikimi në çdo moment për çdo lloj malli do të kryhet ndarja kontabël në lidhje me secilin lloj të mallrave,

statusin doganor dhe kur është e përshtatshme, origjinën e mallit.

3. Në rastin e regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*), mallrat të cilat janë zëvendësuar nga mallrat ekuivalente, nuk do të jenë më nën mbikëqyrjen doganore në secilin nga rastet e mëposhtme:

a) Mallrat ekuivalente janë përdorur për qëllime të përcaktuara për aplikimin e përjashtimit ose reduktimit të detyrimit;

b) Mallrat ekuivalente eksportohen, shkatërrohen ose braktisen për llogari të shtetit;

c) Mallrat ekuivalente janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në aplikimin për zbatimin e përjashtimit apo reduktimin e normës të detyrimit dhe është paguar detyrimi i zbatueshëm në import.

Neni 543
Statusi i mallrave ekuivalente
(Neni 201 i Kodit)

1. Në rastin e magazinimit doganor dhe lejimit të përkohshëm, mallrat ekuivalente do të bëhen mallra joshqiptare dhe mallrat të cilat ato kanë zëvendësuar do të bëhen mallra shqiptare në kohën e çlirimit të tyre nën regjimin pasues doganor, për mbylljen e regjimit ose në kohën kur mallrat ekuivalente janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Në rastin e përpunimit aktiv, mallrat ekuivalente dhe produktet e përpunuara prej tyre do të bëhen mallra joshqiptare dhe mallrat të cilat ato kanë zëvendësuar do të bëhen mallra shqiptare në kohën e çlirimit të tyre nën regjimin pasues doganor, për mbylljen e regjimit ose në kohën kur produktet e përpunuara janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Megjithatë, kur mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv janë vënë në treg para se regjimi të jetë mbyllur, statusi i tyre do të ndryshojë në kohën kur ato janë vënë në treg. Në raste të jashtëzakonshme, kur mallrat ekuivalente pritet të mos jenë të disponueshme në kohën kur mallrat vendosen në treg, autoritetet doganore mund të lejojnë, me kërkesë të mbajtësit të regjimit, që mallrat ekuivalente të jenë në dispozicion në një kohë të mëvonshme brenda një periudhe të arsyeshme që do të përcaktohet nga ana e tyre.

3. Në rastin e eksportimit paraprak të produkteve të përpunuara në bazë të përpunimit aktiv, mallrat ekuivalente dhe produktet e përpunuara të përftuara prej tyre do të bëhen mallra joshqiptare me efekt prapaveprues në kohën e çlirimit të tyre për regjimin e eksportit, nëse mallrat që do të importohen janë vendosur nën këtë regjim.

Kur mallrat që do të importohen janë vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv, ato në të njëjtën kohë do të bëhen mallra shqiptare.

Neni 544
Produktet e përpunuara ose mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv IM / EX
(Pika 1, e nenit 192, të Kodit)

1. Autorizimi për përpunimin aktiv IM/EX, me kërkesë të aplikuesit, duhet të specifikojë se produktet e përpunuara ose mallrat e vendosura nën këtë regjim të përpunimit aktiv IM/EX, të cilat nuk janë deklaruar për një regjim doganor pasues ose rieksportuar në përfundim të periudhës për mbyllje, do të konsiderohen se janë vendosur në qarkullim të lirë në datën e mbarimit të afatit për mbyllje.

2. Pika 1, nuk zbatohet për aq kohë sa produktet apo mallrat i nënshtrohen masave ndaluese ose kufizuese.

Neni 545
Afati për marrjen e vendimit lidhur me aplikimin për autorizim referuar pikës 1, të nenit 192, të Kodit
(Pika 3, e nenit 27, të Kodit)

1. Kur aplikimi për autorizim i referohet shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 192, të Kodit, vendimi për këtë aplikim, me përjashtim të paragrafit të parë, të pikës 3, të nenit 27, të Kodit, merret pa vonesë dhe jo më vonë se brenda 30 ditëve nga data e pranimit të aplikimit.

Kur aplikimi për autorizim i referohet shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 192, të Kodit, vendimi për këtë aplikim, duke anashkaluar paragrafin e parë, të pikës 3, të nenit 27, të Kodit, merret pa vonesë dhe jo më vonë se brenda 60 ditëve nga data e pranimit të aplikimit.

2. Kur kushtet ekonomike duhet të shqyrtohen në përputhje me pikën 4, të nenit 192, të Kodit, afati i përmendur në paragrafin e parë, të pikës 1, të këtij neni, zgjatet deri në një vit nga data në të cilën dosja depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Autoritetet doganore informojnë aplikuesin ose mbajtësin e autorizimit për nevojën e shqyrtimit të kushteve ekonomike dhe, në rast se nuk është lëshuar autorizimi, për zgjatjen e afatit kohor në përputhje me paragrafin e parë.

Neni 546
Efekti prapaveprues
(Pika 4, e nenit 27, të Kodit)

1. Në rastet kur autoritetet doganore japin një autorizim me efekt prapaveprues në përputhje me pikën 2, të nenit 192, të Kodit, autorizimi duhet të hyjë në fuqi jo më parë se data e pranimit të aplikimit.

2. Në raste të veçanta, autoritetet doganore mund të lejojnë që autorizimi i referuar në pikën 1, të hyjë në fuqi të paktën një vit para datës së pranimit të aplikimit dhe në rast të mallrave të listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, tre muaj para datës së pranimit të aplikimit.

3. Në qoftë se aplikimi ka të bëjë me rinovimin e autorizimit për të njëjtin lloj operacioni dhe mallrash, autorizimi mund të jepet me efekt prapaveprues nga data në të cilën ka përfunduar autorizimi i mëparshëm.

Kur, në përputhje me pikën 4, të nenit 192, të Kodit, shqyrtimi i kushteve ekonomike është i nevojshëm në lidhje me rinovimin e autorizimit për të njëjtin lloj operacioni dhe mallrash, një autorizim me efekt prapaveprues hyn në fuqi të paktën në datën në të cilën është dhënë vendimi mbi kushtet ekonomike.

Neni 547
Vlefshmëria e autorizimit
(Pika 5, e nenit 27, të Kodit)

1. Në rastet kur është lëshuar një autorizim në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 192, të Kodit, periudha e vlefshmërisë së autorizimit nuk duhet t'i kalojë pesë vjet nga data në të cilën autorizimi hyn në fuqi.

2. Periudha e vlefshmërisë e përmendur në pikën 1 nuk duhet t'i kalojë tre vjet, në rastet kur autorizimi ka të bëjë me mallrat e listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 548
Afati për mbylljen e një regjimi të posaçëm
(Pika 4, e nenit 195, të Kodit)

1. Me kërkesën e mbajtësit të regjimit, afati për mbylljen e përcaktuar në një autorizim të dhënë në përputhje me pikën 1, të nenit 192, të Kodit, mund të zgjatet nga autoritetet doganore, edhe pas përfundimit të afatit të vendosur fillimisht.

2. Kur afati për mbyllje përfundon në një datë të caktuar për të gjitha mallrat e vendosura nën regjim në një periudhë të caktuar, autoritetet doganore mund të vendosin në autorizim, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 192, të Kodit, se afati për mbyllje zgjatet automatikisht për të gjitha mallrat që janë ende nën regjim në atë datë. Autoritetet doganore mund të vendosin që të ndërpresin zgjatjen automatike të afatit në lidhje me të gjitha ose disa nga mallrat e vendosura nën regjim.

Neni 549
Mbyllja e një regjimi të posaçëm
(Neni 195 i Kodit)

1. Kur mallrat janë vendosur nën një regjim të posaçëm duke përdorur dy ose më shumë deklarata doganore në bazë të një autorizimi të vetëm, vendosja e mallrave të tilla ose produkteve të përftuara prej tyre nën një regjim doganor pasues, ose vendosja në regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*), do të konsiderohet si mbyllje e regjimit të posaçëm për mallrat në fjalë të vendosura nën deklaratat doganore më të hershme.

2. Kur mallrat janë vendosur nën një regjim të posaçëm duke përdorur dy ose më shumë deklarata doganore në bazë të një autorizimi të vetëm dhe ky regjim i posaçëm është mbyllur duke nxjerrë mallrat jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose me anë të shkatërrimit të mallrave pa lënë asnjë mbetje, nxjerrja e mallrave ose shkatërrimi pa lënë asnjë mbetje do të konsiderohet si mbyllje e regjimit të posaçëm për mallrat në fjalë të vendosura nën deklaratat doganore më të hershme.

3. Duke anashkaluar pikat 1 dhe 2, mbajtësi i autorizimit ose mbajtësi i regjimit mund të kërkojë që mbyllja të bëhet në lidhje me mallra të veçanta të vendosura nën regjim.

4. Aplikimi i pikave 1 dhe 2 nuk mund të sjellë si pasojë përfitime të pajustifikuara të detyrimit të importit.

5. Kur mallrat nën regjimin e posaçëm janë vendosur së bashku me mallra të tjera dhe në rast të një shkatërrimi të plotë ose humbje të pazëvendësueshme, autoritetet doganore mund të pranojnë provat e paraqitura nga mbajtësi i regjimit që tregojnë sasinë e vërtetë të mallrave nën regjim, të cilat u shkatërruan ose humbën.

Kur mbajtësi i regjimit nuk mund të paraqesë prova të pranueshme për autoritetet doganore, sasia e mallrave të cilat janë shkatërruar ose kanë humbur do të përcaktohet në raport me atë pjesë të mallrave të të njëjtit lloj të vendosura nën regjim në kohën kur shkatërrimi ose humbja kanë ndodhur.

Neni 550
Dokumenti i mbylljes
(Pika 2 dhe shkronja "a", e pikës 3 të nenit 17, pika 1, e nenit 192, dhe neni 195 të Kodit)

1. Autorizimet për përdorimin e përpunimit aktiv IM/EX, përpunimit aktiv EX/ IM pa përdorimin e shkëmbimit standard të informacionit, siç referohet në nenin 551, ose të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*), duhet të përcaktojnë se mbajtësi i autorizimit duhet të paraqesë dokumentin e mbylljes në zyrën doganore mbikëqyrëse, brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas skadimit të afatit kohor për mbyllje.

Megjithatë, zyra doganore mbikëqyrëse mund të heqë dorë nga detyrimi për paraqitjen e dokumentit të mbylljes, kur ajo e konsideron të panevojshme.

2. Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit, autoritetet doganore mund ta zgjasin afatin e përmendur në pikën 1 në 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Në raste të veçanta, autoritetet doganore mund të zgjasin afatin edhe në qoftë se ai ka përfunduar.

3. Dokumenti i mbylljes duhet të përmbajë të dhënat e listuara në aneksin 71-06, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga zyra doganore mbikëqyrëse.

4. Kur produktet e përpunuara ose mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv IM/EX konsiderohen se janë çliruar për qarkullim të lirë në përputhje me pikën 1, të nenit 544, ky fakt duhet të shënohet në dokumentin e mbylljes.

5. Kur autorizimi për përpunimin aktiv IM/EX specifikon se produktet e përpunuara ose mallrat e vendosura nën këtë regjim konsiderohen se janë çliruar për qarkullim të lirë në datën e përfundimit të afatit për mbyllje, mbajtësi i autorizimit duhet të paraqesë dokumentin e mbylljes në zyrën doganore mbikëqyrëse siç përmendet në pikën 1, të këtij neni.

6. Pa rënë ndesh me nenet 47 dhe 49, të Kodit, zyra doganore mbikëqyrëse do të kontrollojë pa vonesë dokumentin e mbylljes, siç përmendet në pikën 1, të këtij neni.

Zyra doganore mbikëqyrëse mund të pranojë shumën e detyrimit të importit që duhet paguar,siç është përcaktuar nga mbajtësi i autorizimit.

7. Shuma e detyrimit të importit që duhet paguar do të evidentohet në kontabilitet, siç përmendet në nenin 98, të Kodit, brenda 14 ditëve nga data në të cilën dokumenti i mbylljes i është komunikuar zyrës doganore mbikëqyrëse.

8. Autoritetet doganore mund të lejojnë që dokumenti i mbylljes të paraqitet me mjete të tjera përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 551
Shkëmbimi standard i informacionit dhe detyrimet e mbajtësit të autorizimit për përdorimin e një regjimi përpunimi
(Pika 1, e nenit 192, të Kodit)

1. Në autorizimet për përdorimin e përpunimit aktiv EX/IM ose të përpunimit pasiv EX/IM, të cilët përfshijnë një ose më shumë se një zyrë doganore dhe autorizimet për përdorimin e përpunimit aktiv IM/EX ose të përpunimit pasiv IM/EX të cilët përfshijnë më shumë se një zyrë doganore përcaktohen detyrimet e mëposhtme:

a) Përdorimi i shkëmbimit standard të informacionit (INF), sipas parashikimit të nenit 552, përveç rasteve kur autoritetet doganore bien dakord për mjete të tjera të shkëmbimit elektronik të informacionit;

b) Mbajtësi i autorizimit i siguron zyrës doganore mbikëqyrëse informacionet e referuara në seksionin A, të aneksit 71-05, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

c) Kur depozitohen deklaratat apo njoftimet e mëposhtme, ato i referohen numrit përkatës INF:

i. deklaratat doganore për përpunim aktiv;

ii. deklaratat e eksportit për përpunimin aktiv EX/IM ose përpunimin pasiv;

iii. deklaratat doganore për çlirim për qarkullim të lirë pas përpunimit pasiv;

iv. deklaratat doganore për mbylljen e regjimit së përpunimit;

v. deklaratat e rieksportit ose njoftimet e rieksportit.

2. Autorizimet për përdorimin e përpunimit aktiv IM/EX të cilët përfshijnë vetëm një zyrë doganore duhet të përcaktojnë se, me kërkesë të zyrës doganore mbikëqyrëse, mbajtësi i autorizimit i siguron asaj informacion të mjaftueshëm në lidhje me mallrat e vendosura në regjimin e përpunimit aktiv duke i mundësuar zyrës doganore mbikëqyrëse të llogarisë shumën e detyrimit të importit në përputhje me pikën 3, të nenit 81, të Kodit.

Neni 552
Shkëmbimi standard i informacionit
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

1. Zyra doganore mbikëqyrëse duhet të bëjë të disponueshme elementet përkatëse të të dhënave të përcaktuara në seksionin A, të aneksit 71-05 bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, të shtojcës A, në sistemin elektronik që do të ngrihet për qëllime të shkëmbimit standard të informacionit (INF) për:

a) përpunimin aktiv EX/IM ose përpunimin pasiv EX/IM që përfshin një ose më shumë se një zyrë doganore;

b) përpunimin aktiv IM/EX ose përpunimin pasiv IM/EX që përfshin më shumë se një zyrë doganore.

2. Kur autoriteti përgjegjës doganor, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 95, të Kodit, ka kërkuar një shkëmbim standard të informacionit mes autoriteteve doganore në lidhje me mallrat e vendosura në përpunimin aktiv IM/EX që përfshin vetëm një zyrë doganore, zyra doganore mbikëqyrëse duhet të bëjë të disponueshme elementet përkatëse të të dhënave, të përcaktuara në seksionin B të aneksit 71-05, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në sistemin elektronik që do të ngrihet për qëllimet e INF.

3. Kur deklarata doganore, deklarata e rieksportit ose njoftimi i rieksportit i referohet një INF, autoritetet doganore kompetente duhet të bëjnë të disponueshme elementet specifike të të dhënave të përcaktuara në seksionin A, të aneksit 71-05, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në sistemin elektronik që do të ngrihet për qëllimet e INF.

4. Autoritetet doganore, me kërkesë të mbajtësit të autorizimit, duhet të japin informacion të përditësuar në lidhje me INF.

5. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar INF për procedura të veçanta sipas Planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, me përjashtim të pikës 1, të këtij neni, mund të përdoren mënyra të tjera të ndryshme nga teknikat e përpunimit të të dhënave elektronike.

Neni 553
Sistemi elektronik në lidhje me shkëmbimin standard të informacionit
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

1. Sistemi elektronik i informacionit dhe komunikimit në bazë të pikës 1, të nenit 17, të Kodit, do të përdoret për shkëmbimin e informacionit standard (INF) që ka të bëjë me secilën nga regjimet e mëposhtme:

a) Përpunimin aktiv EX/IM ose përpunimin pasiv EX/IM;

b) Përpunimin aktiv IM/EX ose përpunimin pasiv EX/IM, ku më shumë se një zyrë doganore është përfshirë;

c) Përpunimin aktiv IM/EX ku një zyrë doganore është përfshirë dhe autoriteti përgjegjës doganor, siç përmendet në pikën 1, të nenit 95, të Kodit, ka kërkuar një INF.

Një sistem i tillë do të përdoret edhe për përpunimin dhe ruajtjen e informacionit përkatës. Kur një INF kërkohet, informacioni do të vihet në dispozicion, pa vonesë, përmes këtij sistemi nga zyra doganore mbikëqyrëse. Kur deklarata doganore, deklarata e rieksportit apo njoftimi i rieksportit i referohet një INF, autoritetet doganore kompetente duhet ta përditësojnë INF pa vonesë.

Përveç kësaj, sistemi elektronik i informacionit dhe komunikimit do të përdoret për shkëmbimin standard të informacionit që ka të bëjë me masat e politikave tregtare.

2. Pika 1, e këtij neni do të zbatohet nga implementimi sistemit të informatizuar të INF sipas Planit të punës të miratuar nga ministri i përgjegjës për financat.

Neni 554
Magazinimi i mallrave shqiptare, së bashku me mallrat joshqiptare në një ambient magazinimi
(Pika 1, e nenit 192, të Kodit)

Kur mallrat shqiptare mbahen së bashku me mallrat joshqiptare në një ambient për magazinim doganor dhe identifikimi në çdo kohë i mallrave është i pamundur ose mundësohet vetëm me kosto joproporcionale, autorizimi, siç referohet në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 192, të Kodit, duhet të përcaktojë se ndarja në kontabilitet do të kryhet sipas llojit të mallit, statusit doganor dhe, kur është rasti, sipas origjinës së mallit.

Neni 555
Autorizimi për çlirimin e mallrave
(Pika 1, e nenit 27, të Kodit)

Kur një aplikim për një autorizim është bërë në bazë të një deklarate doganore në përputhje me pikat 1 dhe 5, të nenit 531, autorizimi jepet me çlirimin e mallrave për vendosjen nën regjimin përkatës doganor.

Seksioni 3
Dispozita të tjera

Neni 556
Depozitimi i deklaratës doganore në një zyrë tjetër doganore
(Pika 2, e nenit 147, të Kodit)

Autoriteti doganor kompetent mund të lejojë, në raste të veçanta, që deklarata doganore të paraqitet në një zyrë doganore që nuk është specifikuar në autorizim. Në këtë rast, autoriteti doganor kompetent duhet të informojë zyrën doganore mbikëqyrëse pa vonesë.

Neni 557
Regjistrimet
(Nenet 192, pika 1, dhe 194, pika 1, të Kodit)

1. Regjistrimet e referuara në pikën 1, të nenit 194, të Kodit, duhet të përmbajnë sa më poshtë:

a) Kur është rasti, referimin në autorizimin e kërkuar për vendosjen e mallrave nën një regjim të posaçëm;

b) MRN ose, kur kjo nuk ekziston, ndonjë numër ose kod tjetër që identifikon deklaratat doganore përmes së cilit mallrat janë vendosur nën regjimin e posaçëm dhe në rastet kur regjimi është mbyllur në përputhje me pikën 1, të nenit 195, të Kodit, informacionin për mënyrën në të cilën është mbyllur regjimi;

c) të dhënat që qartësisht mundësojnë identifikimin e të gjitha dokumenteve të tjera doganore për vendosjen e mallrave në një regjim të posaçëm dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me mbylljen përkatëse të regjimit, përveç deklaratave doganore;

ç) të dhënat mbi shenjat, numrat identifikues, numrin dhe llojin e pakove/kolive, sasinë dhe përshkrimin tregtar apo teknik të mallrave dhe, sipas rastit, shenjat e identifikimit të kontejnerit që janë të nevojshme për identifikimin e mallrave;

d) vendndodhjen e mallrave dhe informacionin në lidhje me çdo lëvizje të tyre;

dh) statusin doganor të mallrave;

e) të dhënat mbi format e zakonshme të trajtimit dhe, kur është e zbatueshme, klasifikimin e ri tarifor që rezulton nga format e zakonshme të trajtimit;

ë) veçoritë e lejimit të përkohshëm ose përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use);*

f) të dhënat e përpunimit aktiv ose pasiv, duke përfshirë informacionin në lidhje me natyrën e përpunimit;

g) në rastet kur zbatohet pika 1, e nenit 81, të Kodit, shpenzimet për magazinimin ose format e zakonshme të trajtimit;

gj) normën e rendimentit ose mënyrën e llogaritjes, sipas rastit;

h) të dhënat që mundësojnë mbikëqyrjen dhe kontrollet doganore të përdorimit të mallrave ekuivalente, në përputhje me nenin 201 të Kodit;

i) në rastet kur nevojitet ndarja kontabile, informacionin në lidhje me llojin e mallrave, statusin doganor dhe, kur është rasti, origjinën e mallit;

j) në rastet e lejimit të përkohshëm të referuar në nenin 685, të dhënat e kërkuara nga ky nen;

k) në rastet e përpunimit aktiv të referuar në nenin 688, të dhënat e kërkuara nga ky nen;

l) kur kërkohet, të dhënat e ndonjë transferimi të të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me nenin 197 të Kodit;

ll) në rastet kur të dhënat nuk janë pjesë e kontabilitetit për qëllime doganore, referencën në këtë kontabilitet për qëllime doganore;

m) në raste të veçanta, për shkaqe të arsyeshme informacione shtesë, me kërkesë të autoriteteve doganore.

2. Në rastin e zonave të lira, në vijim të informacionit të parashikuar në pikën 1, regjistrimet duhet të përmbajnë:

a) të dhënat identifikuese të dokumenteve të transportit për mallrat që hyjnë ose dalin nga zonat e lira;

b) të dhënat në lidhje me përdorimin ose konsumimin e mallrave, për të cilat çlirimi në qarkullim të lirë ose lejimi i përkohshëm nuk sjell aplikimin e detyrimit të importit ose të masave të përcaktuara në bazë të politikave bujqësore ose tregtare, në përputhje me pikën 2, të nenit 220, të Kodit.

3. Autoritetet doganore mund të heqin dorë nga kërkesa për një pjesë të informacionit të parashikuar në pikat 1 dhe 2, kur kjo nuk ndikon negativisht në mbikëqyrjen dhe kontrollin doganor gjatë përdorimit të një regjimi të posaçëm.

4. Në rastin e lejimit të përkohshëm, të dhënat duhet të mbahen vetëm nëse kërkohen nga autoritetet doganore.

Neni 558
Lëvizja e mallrave ndërmjet vendeve të ndryshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Neni 198 i Kodit)

1. Lëvizja e mallrave të vendosura nën përpunim aktiv, lejim të përkohshëm ose përdorim të veçantë përfundimtar (*end-use)* mund të bëhet ndërmjet vendeve të ndryshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë pa formalitete doganore, me përjashtim të atyre të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 557.

2. Lëvizja e mallrave të vendosura nën përpunim pasiv mund të kryhet brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nga zyra doganore e vendosjes në regjim në zyrën doganore të daljes.

3. Lëvizja e mallrave të vendosura nën magazinim doganor mund të bëhet brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë pa formalitete doganore, ndryshe nga ato të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 557, si më poshtë vijon:

a) ndërmjet ambienteve të ndryshme të magazinimit, të përcaktuara në të njëjtin autorizim;

b) nga zyra doganore e vendosjes nën regjim në ambientet e magazinimit; ose

c) nga ambientet e magazinimit deri në zyrën doganore të daljes ose në ndonjë zyrë doganore të përcaktuar në autorizimin e regjimit të posaçëm, siç referohet në pikën 1, të nenit 192, të Kodit, për çlirimin e mallrave në regjimin pasues doganor ose për të pranuar deklaratën e rieksportit për qëllime të mbylljes së regjimit të posaçëm.

Lëvizjet në magazinimin doganor duhet të përfundojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve pasi mallrat të jenë larguar nga magazina doganore.

Me kërkesë të mbajtësit të regjimit, autoritetet doganore mund ta zgjasin periudhën deri në 30 (tridhjetë) ditë.

4. Kur mallrat në magazinimin doganor janë zhvendosur nga ambientet e magazinimit në zyrën doganore të daljes, regjistrimet e referuara në pikën 1, të nenit 194, të Kodit, duhet të sigurojnë informacionin në lidhje me daljen e mallrave brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pasi mallrat të jenë larguar nga magazina doganore.

Me kërkesë të mbajtësit të regjimit, autoritetet doganore mund ta zgjasin periudhën deri në 100 ditë.

Neni 559
Lëvizja e mallrave nën një regjim të posaçëm
(Neni 198 i Kodit)

1. Lëvizja e mallrave në zyrën doganore të daljes me qëllim mbylljen e një regjimi të posaçëm të ndryshëm nga ai i përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) dhe përpunimi pasiv, duke nxjerrë mallrat jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, kryhet sipas deklaratës së rieksportit.

2. Kur mallrat janë zhvendosur nën përpunimin pasiv nga zyra doganore e vendosjes te zyra doganore e daljes, mallrat do t'i nënshtrohen dispozitave që do të kishin qenë të zbatueshme nëse mallrat do të ishin vendosur nën procedurën e eksportit.

3. Kur mallrat janë zhvendosur nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*) në zyrat doganore të daljes, ato do t'i nënshtrohen dispozitave që do të kishin qenë të zbatueshme nëse mallrat do të ishin vendosur nën procedurën e eksportit.

4. Formalitete doganore të tjera të ndryshme nga regjistrimi, siç përmendet në nenin 194, të Kodit, nuk janë të nevojshme për zhvendosje që nuk përmenden nga pikat 1 deri në 3.

5. Kur zhvendosja e mallrave ndodh në përputhje me pikat 1 ose 3, mallrat mbeten nën regjimin e posaçëm deri sa ato të jenë nxjerrë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë

Neni 560
Format e zakonshme të trajtimit
(Neni 199 i Kodit)

Format e zakonshme të trajtimit të parashikuara në nenin 199 të Kodit janë ato të përcaktuara në aneksin 71-03, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 561
Statusi doganor i kafshëve të lindura prej kafshëve të vendosura nën një regjim të posaçëm
(Pika 3, e nenit 142, të Kodit)

Kur vlera e përgjithshme e kafshëve, të lindura në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë prej kafshëve që janë objekt i një deklarate doganore dhe që janë të vendosura në regjimin e magazinimit, regjimin e lejimit të përkohshëm ose regjimin e përpunimit aktiv, e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 100 (njëqind) euro, këto kafshë konsiderohen si mallra joshqiptare dhe vendosen në të njëjtin regjim si kafshët prej të cilave kanë lindur.

Neni 562
Heqja dorë nga detyrimi për të paraqitur një deklaratë plotësuese
(Shkronja "b", e pikës 2, të nenit 153, të Kodit)

Detyrimi për të paraqitur një deklaratë plotësuese do të hiqet për mallrat, për të cilat është mbyllur një regjim i posaçëm i ndryshëm nga transiti, duke i vendosur ato nën një regjim pasues të posaçëm, i ndryshëm nga transiti, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Mbajtësi i autorizimit të regjimit të parë të posaçëm dhe i atij pasues është i njëjti person;

b) Deklarata doganore për regjimin e parë të posaçëm është depozituar në formën standarde ose deklaruesi ka paraqitur një deklaratë plotësuese në përputhje me paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 153, të Kodit, në lidhje me regjimin e parë të posaçëm;

c) Regjimi i parë i posaçëm mbyllet me vendosjen e mallrave nën një regjim pasues të posaçëm, i ndryshëm nga përdorimi i veçantë përfundimtar (*end-use*) ose përpunimi aktiv, pas depozitimit të një deklarate doganore në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit.

Neni 563
Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve
(Neni 197 i Kodit)

Autoriteti doganor kompetent vendos nëse një transferim i të drejtave dhe detyrimeve të referuara në nenin 197, të Kodit mund të bëhet apo jo. Në qoftë se një transferim i tillë mund të bëhet, autoriteti doganor kompetent përcakton kushtet në të cilat lejohet transferimi.

Neni 564
Sistemi elektronik në lidhje me Carnet ATA
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

Një sistem elektronik i informacionit dhe komunikimit (Sistemi i Carnet ATA) i ngritur në bazë të pikës 1, të nenit 17, të Kodit, do të përdoret për përpunimin, shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit që ka të bëjë me Carnet ATA lëshuar në bazë të nenit 21a të Konventës së Stambollit. Informacioni do të vihet në dispozicion përmes këtij sistemi nga autoritetet doganore kompetente pa vonesë.

Neni 565
Formulari për aplikimet dhe autorizimet lidhur me regjimet e posaçme përveç transitit

Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për vendimet doganore, kur një aplikim për një autorizim siç përmendet në nenin 192 (1) të Kodit nuk është i bazuar në një deklaratë doganore dhe kur është paraqitur me mjete të tjera të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave, aplikimi duhet të bëhet duke përdorur formularin sipas aneksit 8 dhe autorizimi sipas aneksit 9, të shtojcës C bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

KREU 2
Transiti

Seksioni 1
Regjimi i transitit të jashtëm dhe të brendshëm

Nënseksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 566
Mjetet e komunikimit të MRN të operacionit të transitit dhe të MRN të operacionit TIR ndaj autoriteteve doganore
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. MRN e një deklarate transiti ose e një operacioni TIR mund të paraqitet pranë autoriteteve doganore përmes njërës prej mënyrave të mëposhtme, përveç teknikave elektronike të përpunimit të të dhënave:

a) një barkodi;

b) një dokumenti shoqërues transiti;

c) një dokumenti shoqërues transiti/të sigurisë;

ç) në rast të ndonjë operacioni TIR, me një Carnet TIR;

d) mjeteve të tjera të lejuara nga autoriteti doganor pritës.

2. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të transitit sipas Planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, MRN e një deklarate të transitit paraqitet në doganë më një nga mënyrat e referuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1.

Neni 567
Dokumenti shoqërues i transitit dhe dokumenti shoqërues i transitit/sigurisë
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

Kërkesat e përbashkëta për të dhënat shoqëruese të transitit dhe, nëse është e nevojshme, për listën e artikujve, si dhe për dokumentin shoqërues të transitit/të sigurisë dhe për listën e artikujve të transitit/sigurisë janë të përcaktuara në aneksin B-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 568
Kontrollet dhe formalitetet për mallrat që dalin dhe rihyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Nenet 203, pika 3, shkronjat "b", "c", "ç", "d" dhe 204, pika 2, "b", "c", "ç", "d", të Kodit)

Kur, në rrjedhën e lëvizjes së mallrave nga një pikë në tjetrën, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, mallrat dalin dhe rihyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, kontrollet doganore dhe formalitetet që zbatohen në përputhje me Konventën TIR, Konventën ATA, Konventën e Stambollit, Marrëveshjen ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut lidhur me Statusin e Forcave të tyre, nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951 ose në përputhje me aktet e Bashkimit Postar Universal, duhet të kryhen në pikat ku mallrat largohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe ku ato rihyjnë sërish në këtë territor.

Neni 569
Sistemi elektronik lidhur me transitin
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

1. Për shkëmbimin e të dhënave të Carnet TIR, për operacionet TIR dhe kryerjen e formaliteteve doganore të regjimit të transitit, përdoret një sistem elektronik, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 17, të Kodit (sistemi informatik i transitit).

2. Në rast mospërputhjesh ndërmjet të dhënave që përmban Carnet TIR dhe atyre të sistemit informatik të transitit, kanë përparësi të dhënat e Carnet TIR.

3. Duke anashkaluar pikën 1, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të ri të informatizuar, në përputhje me nenin 286, të Kodit, Republika e Shqipërisë përdor sistemin aktual informatik të transitit.

Neni 570
Aplikimet për statusin e pritësit të autorizuar për operacionet TIR
(Neni 205 i Kodit)

Për qëllime të operacioneve TIR, aplikimi për statusin e pritësit të autorizuar të përmendur në nenin 205 të Kodit, paraqitet pranë DPD.

Neni 571
Autorizimet për statusin e pritësit të autorizuar për operacionet TIR
(Neni 205 i Kodit)

1. Statusi i pritësit të autorizuar i përcaktuar në nenin 205 të Kodit jepet për aplikuesit që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Aplikuesi është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Aplikuesi deklaron se do të presë rregullisht mallra që lëvizin sipas një operacioni TIR;

c) Aplikuesi plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "d", të nenit 41, të Kodit.

2. Autorizimi duhet të jepet vetëm me kusht që autoriteti doganor të jetë në gjendje të mbikëqyrë operacionet TIR dhe të kryejë kontrolle pa pasur nevojë marrjen e masave administrative në disproporcion me nevojat e personit të interesuar.

3. Autorizimi në lidhje me statusin e pritësit të autorizuar zbatohet për operacionet TIR që do të mbyllen në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në autorizim.

Nënseksioni 2
Lëvizja e mallrave nën operacionin TIR

Neni 572
Operacioni TIR në rrethana të veçanta
(Shkronja "b", e pikës 3, të nenit 17, shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Autoritetet doganore do të pranojnë një Carnet TIR pa shkëmbimin e të dhënave të Carnet për operacionin TIR në rast të defekteve të përkohshme të:

a) sistemit elektronik të transitit;

b) sistemit të kompjuterizuar të përdorur nga mbajtësi i Carnet TIR për depozitimin e të dhënave të Carnet TIR me teknika informatike të përpunimit të të dhënave;

c) lidhjes elektronike mes sistemit të kompjuterizuar të përdorur nga mbajtësi i Carnet TIR për depozitimin e të dhënave të Carnet TIR me anë të teknikave informatike të përpunimit të të dhënave dhe të sistemit elektronik të transitit.

Pranimi i Carnet TIR pa shkëmbimin e të dhënave të Carnet TIR në rast të një defekti të përkohshëm siç është referuar në shkronjat "b" ose "c" do t'i nënshtrohet miratimit të autoriteteve doganore.

Neni 573
Itinerari për lëvizjet e mallrave nën një operacion TIR
(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Mallrat që transportohen nën një operacion TIR, duhet të transferohen në zyrën doganore të destinacionit ose të daljes sipas një itinerari të justifikuar ekonomikisht.

2. Kur zyra doganore e nisjes apo hyrjes e konsideron të nevojshme, do të caktojë një itinerar për operacionin TIR, duke marrë parasysh çdo informacion përkatës të komunikuar nga mbajtësi i Carnet TIR.

Kur bëhet caktimi i një itinerari, zyra doganore do të shënojë në sistemin elektronik të transitit dhe në Carnet TIR të paktën treguesin e shteteve përmes së cilave operacioni TIR do të zhvillohet.

Neni 574
Formalitetet për t'u plotësuar në zyrën doganore të nisjes ose hyrjes për lëvizjet e mallrave nën një operacion TIR
(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Mbajtësi i Carnet TIR do të paraqesë të dhënat e Carnet TIR për operacionin TIR në zyrën doganore të nisjes apo hyrjes.

2. Zyra doganore tek e cila janë paraqitur të dhënat e Carnet TIR, do të caktojë një afat kohor brenda të cilit mallrat duhet të paraqiten në zyrën doganore të destinacionit ose të daljes, duke marrë parasysh:

a) itinerarin;

b) mjetet e transportit;

c) legjislacionin e transportit ose çdo legjislacion tjetër që mund të kenë ndikim në përcaktimin e një afati kohor;

ç) çdo informacion tjetër të komunikuar nga mbajtësi i Carnet TIR.

3. Kur afati është caktuar nga DPD, do të jetë detyrues për autoritetet doganore dhe afati nuk mund të ndryshojë.

4. Kur mallrat janë çliruar për operacionin TIR, zyra doganore e nisjes ose hyrjes do të regjistrojë MRN e operacionit TIR në Carnet TIR. Zyra doganore që çliron këto mallra do të njoftojë mbajtësin e Carnet TIR për çlirimin e mallrave për operacionin TIR.

Me kërkesë të mbajtësit të Carnet TIR zyra doganore e nisjes ose hyrjes do të sigurojë një dokument shoqërues transiti ose, kur është e përshtatshme, një dokumentacion shoqërues të transit/sigurie të mbajtësit të Carnetit TIR.

Dokumentacioni përcjellës i transitit duhet të sigurohet duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin B-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe nëse është e nevojshme, të plotësohet nga lista e artikujve në formën e përcaktuar në aneksin B-03, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij. Dokumenti i transit/sigurisë shoqërues duhet të sigurohet duke përdorur formularin e paraqitur në aneksin B-04 të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe të plotësohet me listën e transit/sigurisë të artikujve në formën e përcaktuar në aneksin B-05, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Zyra doganore e nisjes ose hyrjes do të transmetojë të dhënat e operacionit TIR në zyrën e deklaruar doganore të destinacionit ose daljes.

Neni 575
Incidente gjatë lëvizjes së mallrave nën operacionin TIR

(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Transportuesi duhet të paraqesë menjëherë pas incidentit mallrat së bashku me mjetin rrugor, kombinimin e mjetit rrugor me kontejner, Carnet TIR dhe MRN të operacionit TIR, në zyrën doganore më të afërt pranë së cilës ndodhet mjeti transportit kur:

a) transportuesi është i detyruar të devijojë nga itinerari i përcaktuar sipas nenit 573, për shkak të rrethanave që nuk varen nga ai;

b) ka ndodhur një incident ose aksident në kuptim të nenit 25, të Konventës TIR.

2. Nëse zyra doganore pranë së cilës ndodhet mjeti i transportit vlerëson që operacioni TIR në fjalë mund të vazhdojë, ajo duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme.

Informacioni në lidhje me incidentin, siç referohet në pikën 1, duhet të regjistrohet në sistemin elektronik të transitit nga ajo zyrë doganore.

3. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar NCTS sipas Planit të Punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, informacioni lidhur me incidentin siç referohet në pikën 1, regjistrohet në sistemin e transitit nga zyra doganore e destinacionit ose e daljes.

4. Deri në implementimin e sistemit të informatizuar NCTS sipas Planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, paragrafi i dytë i pikës 2, të këtij neni, nuk do të zbatohet.

Neni 576
Paraqitja e mallrave që lëvizin nën një operacion TIR te zyra doganore e destinacionit ose e daljes

(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur mallrat që lëvizin nën një operacion TIR arrijnë tek zyra doganore e destinacionit ose e daljes, zyrës doganore i paraqiten:

a) mallrat së bashku me mjetin rrugor, kombinimin e mjetit me kontejnerin;

b) Carnet TIR;

c) MRN e operacionit TIR;

ç) çdo informacion tjetër i kërkuar nga zyra doganore e destinacionit ose daljes.

Paraqitja duhet të bëhet gjatë orarit zyrtar të punës. Megjithatë zyra doganore e destinacionit ose e daljes me kërkesë të personit të interesuar, mundet të lejojë paraqitjen e mallrave jashtë orarit zyrtar të punës ose në një vend tjetër të miratuar nga autoritetet doganore.

2. Nëse paraqitja e mallrave pranë zyrës doganore të destinacionit ose daljes ka ndodhur pas kalimit të afatit të përcaktuar nga zyra doganore e nisjes ose e hyrjes, në përputhje me pikën 2, te nenit 574, mbajtësi i Carnet TIR do të konsiderohet se ka respektuar afatin kohor në rastet kur ai ose transportuesi i provojnë zyrës doganore të destinacionit ose daljes që vonesa nuk ka ndodhur për faj të tij.

3. Operacioni TIR mund të mbyllet në një zyrë doganore të ndryshme nga ajo e përcaktuar në deklaratën e transitit. Kjo zyrë doganore do të konsiderohet zyrë doganore e destinacionit ose e daljes.

Neni 577
Formalitetet në zyrën doganore të destinacionit ose të daljes për lëvizjen e mallrave nën një operacion TIR
(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Zyra doganore e destinacionit ose e daljes duhet të njoftojë zyrën doganore të nisjes ose hyrjes për mbërritjen e mallrave në ditën kur mallrat së bashku me mjetin rrugor, kombinimin e mjetit me kontejner, Carnet TIR dhe MRN të operacionit TIR, janë paraqitur në përputhje me pikën 1, të nenit 576.

2. Kur operacioni TIR është mbyllur në një zyrë doganore të ndryshme nga ajo e paraqitur në deklaratën e transitit, zyra doganore që konsiderohet si zyrë doganore e destinacionit ose daljes në përputhje me pikën 3, të nenit 576, do ti njoftojë mbërritjen zyrës doganore të nisjes apo hyrjes në ditën kur mallrat janë paraqitur në përputhje me pikën 1, të nenit 576.

Zyra doganore e hyrjes njofton mbërritjen në zyrën doganore të destinacionit apo të daljes, të përcaktuara në deklaratën e transitit.

3. Zyra doganore e destinacionit apo daljes njofton për rezultatet e kontrollit zyrën doganore të hyrjes apo nisjes, jo më vonë se tre ditë nga dita e paraqitjes të mallrave në zyrën doganore të destinacionit apo daljes ose në ndonjë vend tjetër të miratuar nga autoritetet doganore, në përputhje me pikën 1, të nenit 576. Në raste përjashtimore afati mund të zgjatet deri në 6 ditë.

Megjithatë, kur mallrat janë marrë nga një pritës i autorizuar sipas nenit 205, të Kodit, zyra doganore e nisjes apo hyrjes njofton, jo më vonë se gjashtë ditë, pas ditës së paraqitjes të mallrave tek pritësi i autorizuar.

4. Zyra doganore e destinacionit ose daljes përfundon operacionin TIR, në përputhje me nenet 1, shkronja "d" dhe 28, pika 1, të Konventës TIR. Ajo plotëson kundër fletën nr. 2 të Carnet TIR dhe mban kuponin nr. 2 të Carnet TIR. Carnet TIR i kthehet mbajtësit të Carnet TIR ose personit që vepron në emër të tij.

Neni 578
Procedura hetimore për lëvizjen e mallrave nën një operacion TIR
(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur zyra doganore e nisjes apo e hyrjes nuk ka marrë rezultatet e kontrollit brenda 6 ditëve pas marrjes së njoftimit të mbërritjes së mallrave, kërkon menjëherë rezultatet e kontrollit nga zyra doganore e destinacionit apo daljes, e cila dërgoi njoftimin e mbërritjes së mallrave.

Zyra doganore e destinacionit apo daljes dërgon rezultatet e kontrollit menjëherë pas marrjes së kërkesës nga zyra doganore e nisjes apo hyrjes.

2. Kur zyra doganore e nisjes apo hyrjes nuk ka marrë ende informacion që lejon mbylljen e operacionit TIR ose për rikuperimin e borxhit doganor, kërkon informacion nga mbajtësi i Carnet TIR, ose kur të dhënat e disponueshme janë të mjaftueshme në vendin e destinacionit apo daljes, nga zyra doganore e destinacionit apo daljes, në rastet e mëposhtme:

a) zyra doganore e nisjes apo hyrjes nuk ka marrë njoftimin e mbërritjes së mallrave nga përfundimi i afatit për paraqitjen e mallrave të përcaktuar në përputhje me pikën 2, të nenit 574;

b) zyra doganore e nisjes apo hyrjes nuk ka marre rezultatet e kontrollit të kërkuara në përputhje me pikën 1;

c) zyra doganore e nisjes apo hyrjes konstaton se njoftimi i mbërritjes së mallrave ose te rezultateve te kontrollit janë dërguar gabimisht.

3. Zyra doganore e nisjes apo hyrjes dërgon kërkesat për informacion në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2, brenda një afati prej 7 ditësh, pas përfundimit të afatit kohor, siç është përcaktuar dhe kërkesat për informacion në përputhje me shkronjën "b", të pikës 2, brenda një afati prej 7 ditësh pas përfundimit të afatit të referuar në pikën 1.

Megjithatë, nëse para përfundimit të këtyre afateve, zyra doganore e nisjes apo hyrjes ka marrë informacion se operacioni TIR nuk është përfunduar në mënyrë korrekte, ose ka dyshime të ndodhë kështu, ajo do të dërgojë kërkesën pa vonesë.

4. Përgjigjet e kërkesave të bëra në përputhje me pikën 2, do të dërgohen brenda 28 ditëve nga data që është dërguar kërkesa.

5. Kur, pas një kërkese në përputhje me pikën 2, zyra doganore e destinacionit apo daljes nuk ka marre informacion të mjaftueshëm për mbylljen e operacionit TIR, zyra doganore e nisjes apo hyrjes i kërkon mbajtësit të Carnet TIR të japë informacion, jo më vonë se 35 ditë pas fillimit të procedurës hetimore.

Megjithatë, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të NCTS sipas Planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, autoriteti doganor kërkon nga mbajtësi i Carnet TIR ketë informacion, jo më vonë se 28 ditë pas fillimit të procedurës hetimore.

Mbajtësi i Carnet TIR i përgjigjet kësaj kërkesë brenda 28 ditëve nga data e dërgimit. Me kërkesën e mbajtësit të Carnet TIR kjo periudhë mund të zgjatet edhe për 28 ditë të tjera.

6. Kur një Carnet TIR është pranuar pa shkëmbimin e të dhënave Carnet TIR për një operacion TIR, në përputhje me nenin 574, zyra doganore e nisjes apo hyrjes fillon një procedure hetimore për marrjen e informacioneve të nevojshme për mbylljen e operacionit TIR, nëse nuk e ka marrë informacionin se operacioni TIR është mbyllur. Kjo zyrë i përgjigjet kësaj kërkesë brenda 28 ditëve nga data në të cilën është dërguar.

Megjithatë, nëse para përfundimit të kësaj periudhe, zyra doganore e nisjes apo hyrjes merr informacion se operacioni TIR nuk është përfunduar në mënyrë korrekte, ose ka dyshime të ndodhë kështu, ajo do të fillojë procedurën hetimore pa vonesë.

Procedura e hetimit, gjithashtu, fillon prej zyrës doganore të nisjes apo hyrjes në rast se informacioni për përfundimin e operacionit TIR është falsifikuar dhe procedura e hetimit është e nevojshme që të arrihen objektivat e pikës 9.

7. Zyra doganore e nisjes apo hyrjes informon shoqatën garantuese se nuk ka qenë e mundur të kryhet mbyllja e operacionit TIR dhe e fton atë për të paraqitur prova për mbylljen e operacionit TIR. Ky informacion nuk do të konsiderohet si një njoftim brenda kornizës së pikës1,të nenit 11, të Konventës TIR.

8. Kur gjatë procedurës hetimore të përcaktuar në pikat 1 deri 7, konstatohet se operacioni TIR është mbyllur me korrektësi, zyra doganore e nisjes apo hyrjes mbyll operacionin TIR dhe, menjëherë, informon shoqatën garantuese dhe mbajtësin e Carnet TIR dhe kur është e përshtatshme çdo autoritet doganor që mund të ketë nisur një procedure rikuperimi.

9. Kur gjatë procedurës hetimore të përcaktuar në pikat 1 deri 7, konstatohet se nuk mund të mbyllet operacioni TIR, zyra doganore e nisjes apo hyrjes vendos nëse ka lindur borxhi doganor.

Nëse borxhi doganor ka lindur, zyra doganore e nisjes apo hyrjes, duhet të marrë të gjitha masat në përputhje me pikën 1, të nenit 96, të Kodit.

Neni 579
Prova alternative të përfundimit të operacionit TIR

(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Operacioni TIR do të konsiderohet që është mbyllur në mënyrë korrekte, brenda afatit kohor të caktuar në përputhje me pikën 2, të nenit 576, kur mbajtësi i Carnet TIR ose shoqata garantuese, sipas kërkesës, paraqet pranë zyrës doganore të nisjes apo hyrjes, një nga dokumentet e mëposhtëm që të identifikojë mallrat:

a) Dokument të vërtetuar nga autoriteti doganor i destinacionit apo daljes, që identifikon mallrat dhe përcakton se mallrat janë paraqitur në zyrën doganore të destinacionit apo daljes, ose i janë dorëzuar një pritësi të autorizuar sipas nenit 205, të Kodit;

b) Një dokument i regjistrimit doganor, i vërtetuar nga autoritetet doganore, i cili përcakton se mallrat kanë dalë fizikisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

c) Një dokument doganor të lëshuar në një vend tjetër ku mallrat janë vendosur nën një regjim doganor,

ç) Një dokument të lëshuar në një vend tjetër, vulosur ose vërtetuar nga autoritetet doganore të atij vendi dhe që përcakton se mallrat janë hedhur për qarkullim të lirë në atë vend.

2. Në vend të dokumenteve të përmendura në pikën 1, mund të jepen si prove, kopje të njësuara me origjinalin nga organi i cili vërteton dokumentet origjinale.

3. Njoftimi i mbërritjes së mallrave të përmendura në pikat 1 dhe 2, të nenit 577, nuk konsiderohet si provë se operacioni TIR ka përfunduar në mënyrë korrekte.

Neni 580
Formalitetet për lëvizjen e mallrave nën operacionin TIR të pranuara nga një pritës i autorizuar
(Shkronja "b" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "b", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur mallrat mbërrijnë në një vend të përcaktuar në autorizimin e përmendur në nenin 205 të Kodit, pritësi i autorizuar duhet:

a) menjëherë, të njoftojë zyrën doganore të destinacionit të mbërritjes së mallrave dhe të njoftojë atë për ndonjë parregullsi apo incident që ka ndodhur gjatë transportit;

b) të shkarkojë mallrat vetëm pas marrjes së lejes nga zyra doganore e destinacionit;

c) pas shkarkimit, të regjistrojë pa vonesë në regjistrat e tij rezultatet e inspektimit dhe çdo informacion tjetër në lidhje me të dhënat e shkarkimit;

ç) të njoftojë zyrën doganore të destinacionit për rezultatet e inspektimit të mallrave dhe të njoftojë atë për ndonjë parregullsi, jo me vonë se tre ditë pas ditës kur ai ka marrë lejen për shkarkimin e mallrave.

2. Kur zyra doganore e destinacionit merr njoftimin e mbërritjes së mallrave në ambientet e pritësit të autorizuar, ajo njofton zyrën doganore të nisjes apo hyrjes për mbërritjen e mallrave.

3. Kur zyra doganore e destinacionit merr rezultatet e inspektimit të mallrave të përmendura në pikën 1, shkronja "ç", ajo dërgon rezultatet e kontrollit në zyrën doganore të nisjes apo hyrjes jo më vonë se gjashtë ditë nga dërgimi i mallrave tek pritësi i autorizuar.

4. Me kërkesë të mbajtësit të Carnet TIR, pritësi i autorizuar do të lëshojë një faturë, e cili vërteton mbërritjen e mallrave në vendin e përcaktuar në autorizimin e përmendur në nenin 205, të Kodit dhe përmban MRN e operacionit TIR dhe Carnet TIR. Fatura nuk konsiderohet si provë nëse operacioni TIR është përfunduar në përputhje me pikën 4, të nenit 577.

5. Pritësi i autorizuar, siguron që Carnet TIR bashkë me MRN e operacionit TIR, janë paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në autorizimin e zyrës doganore të destinacionit për qëllime të mbylljes të operacionit TIR, në përputhje me pikën 4, të nenit 577.

6. Mbajtësi i Carnet TIR, konsiderohet të ketë përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 1(o) të Konventës TIR, kur Carnet TIR bashkë me mjetin rrugor, kombinimin e mjeteve me kontejnerët dhe mallrat janë paraqitur të paprekura tek pritësi i autorizuar në vendin e përcaktuar në autorizim.

Nënseksioni 3
Zbatimi i Konventës për një regjim transiti të përbashkët

Neni 581
Zbatimi i Konventës për një regjim transiti të përbashkët në raste të veçanta
(Pika 2, dhe shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur mallrat shqiptare eksportohen në një vend tjetër, i cili është palë kontraktuese e Konventës në një regjim transiti të përbashkët ose kur mallrat shqiptare eksportohen dhe kalojnë përmes një ose më shumë vendeve të transitit të përbashkët si dhe zbatohen dispozitat e konventës për një regjim transiti të përbashkët, atëherë mallrat vendosen nën regjimin e transitit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 203, të Kodit, në rastet e mëposhtme:

a) kur mallrat shqiptare i janë nënshtruar formaliteteve doganore të eksportit, me qëllim rimbursimin që u është dhënë me eksportin në vende të tjera nën politikat e përbashkëta bujqësore;

b) kur mallrat shqiptare kanë ardhur nga rezervat e emergjencës, që janë objekt i masave të kontrollit për përdorimin ose destinacionin e tyre dhe i janë nënshtruar formaliteteve doganore për eksport drejt vendeve të tjera nën politikën e përbashkët bujqësore;

c) kur mallrat shqiptare kanë përfituar të drejtën për rimbursim ose falje të detyrimit të importit, me kusht që ato të jenë vendosur nën transitin e jashtëm, në përputhje me pikën 4, të nenit 111, të Kodit.

2. Nëse zbatohen dispozitat e Konventës së transitit të përbashkët dhe mallrat shqiptare kalojnë një ose më shumë vende të transitit të përbashkët, mallrat vendosen në regjimin e transitit të brendshëm sipas shkronjës "a", të pikës 2 të nenit 204, të Kodit, me përjashtim të atyre mallrave që transportohen tërësisht në rrugë detare apo ajrore.

3. Nëse mbajtësi i mallrave përdor procedurën e transitit të përbashkët, zbatohet pika 1 dhe 2, e këtij neni. Megjithatë, mallrat që qarkullojnë brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë konsiderohen të vendosura nën regjimin e transitit, në përputhje me pikën 2, të nenit 1, të Konventës së transitit të përbashkët.

Neni 582
Vërtetim i miratuar nga zyra doganore e destinacionit
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Një vërtetim i miratuar nga zyra doganore e destinacionit, me kërkesë të personit që paraqet mallrat dhe informacionin e kërkuar nga kjo zyrë, duhet të përmbajë të dhënat e përmendura në aneksin 72-03, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Nënseksioni 4
Thjeshtimet e përdorura nën regjimin e transitit

Neni 583
Dispozita të përgjithshme mbi autorizimet e thjeshtimeve
(Pika 4, e nenit 207, të Kodit)

1. Autorizimet e përmendura në pikën 4, të nenit 207, të Kodit, do t'i jepen aplikuesit që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Deklaron se do të përdorë rregullisht regjimin e transitit;

c) Plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "ç", të nenit 41, të Kodit.

2. Autorizimet duhet të jepen vetëm me kusht që autoriteti doganor konsideron se është në gjendje të mbikëqyrë regjimin e transitit dhe të kryejë kontrolle pa një përpjekje administrative joproporcionale ndaj aplikuesit në fjalë.

Neni 584
Fusha e zbatimit territorial të thjeshtimeve
(Pika 4, e nenit 207, të Kodit)

1. Thjeshtimi i përmendur në nenin 207, pika 4, shkronjat "a" dhe "c", të Kodit Doganor zbatohet vetëm për operacione transiti të filluara në Republikën e Shqipërisë, ku është dhënë autorizimi për thjeshtim.

2. Thjeshtimi i përmendur në nenin 207, pika 4, shkronja "b", të Kodit, zbatohet vetëm për operacione transiti që përfundojnë në Republikën e Shqipërisë, ku është dhënë autorizimi për thjeshtim.

3. Thjeshtimi i përmendur në nenin 207, pika 4, shkronja "d", të Kodit zbatohet vetëm në zyrat doganore të specifikuara në autorizimin për thjeshtim.

Neni 585
Aplikimi për statusin e dërguesit të autorizuar për vendosjen e mallrave në regjimin e transitit
(Paragrafi i tretë, i pikës 1, të nenit 27, të Kodit)

Për vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit, aplikimet për statusin e dërguesit të autorizuar të përmendur në shkronjën "a", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Neni 586
Autorizimi për statusin e dërguesit të autorizuar për vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit
(Pika 4, e nenit 207, të i Kodit)

Statusi i dërguesit të autorizuar i përmendur në shkronjën "a", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, u jepet vetëm aplikuesve, të cilët janë të autorizuar për të depozituar një garanci globale në përputhje me pikën 5, të nenit 84, të Kodit, ose për të përfituar një përjashtim nga depozitimi i garancisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 90, të Kodit.

Neni 587
Vendosja e mallrave nën regjimin e transitit nga dërguesi i autorizuar
(Shkronja "a", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

1. Kur dërguesi i autorizuar ka për qëllim të vendosë mallrat nën regjimin e transitit, paraqet një deklaratë transiti në zyrën doganore të nisjes. Dërguesi i autorizuar nuk mund të nisë regjimin e transitit deri në përfundimin e afatit kohor të përcaktuar në autorizimin e përmendur në nenin 207, pika 4, shkronja "a", të Kodit.

2. Dërgues i autorizuar regjistron të dhënat e mëposhtme në sistemin elektronik të transitit:

a) itinerarin nëse është përcaktuar në përputhje me nenin 615;

b) afatin kohor të përcaktuar, në përputhje me nenin 614, brenda të cilit mallrat duhet të paraqiten në zyrën doganore të destinacionit;

c) numrin e plumbçeve dhe numrin identifikues të çdo plumbçeje sipas nevojës.

3. Dërguesi i autorizuar mund të printojë dokumentin shoqërues të transitit ose dokumentin shoqërues të transit/sigurisë vetëm pas marrjes së njoftimit të çlirimit të mallrave për regjimin e transitit nga zyra doganore e nisjes.

Pas implementimit të sistemit të informatizuar të NCTS sipas planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, dërguesi i autorizuar do t'i printojë ato dokumente.

Neni 588
Aplikimet për statusin e pritësit të autorizuar për mallrat që lëvizin nën regjimin e transitit
(Paragrafi i tretë, i pikës 1, të nenit 27, të Kodit)

Me qëllim pritjen e mallrave që lëvizin nën regjimin e transitit, aplikimi për statusin e pritësit të autorizuar të përmendur në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Neni 589
Autorizimet për statusin e pritësit të autorizuar për mallrat që lëvizin nën regjimin e transitit
(Pika 4, e nenit 207, të Kodit)

Statusi i pritësit të autorizuar të përmendur në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, jepet vetëm për aplikuesit, të cilët deklarojnë se do të presin rregullisht mallrat që janë vendosur nën regjimin e transitit.

Neni 590
Formalitetet për mallrat që lëvizin nën regjimin e transitit të mbërritura pranë pritësit të autorizuar
(Shkronja "b", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

1. Kur mallrat mbërrijnë në vendin e specifikuar në autorizim, sipas nenit 207, pika 4, shkronja "b", të Kodit, pritësi i autorizuar duhet:

a) të njoftojë menjëherë zyrën doganore të destinacionit për mbërritjen e mallrave dhe për ndonjë parregullsi apo aksident që ka ndodhur gjatë transportit;

b) të shkarkojë mallrat vetëm pas marrjes së lejes nga zyra doganore e destinacionit;

c) pas shkarkimit, të regjistrojë pa vonesë në regjistrat e tij, rezultatet e kontrollit dhe çdo informacion tjetër në lidhje me shkarkimin;

ç) të njoftojë zyrën doganore të destinacionit për rezultatet e kontrollit të mallrave dhe ta informojë atë për çdo parregullsi, brenda tre ditëve, pas datës kur ai ka marrë lejen për shkarkimin e mallrave.

2. Kur zyra doganore e destinacionit merr njoftim për mbërritjen e mallrave në ambientet e pritësit të autorizuar, njofton zyrën doganore të nisjes për mbërritjen e mallrave.

3. Kur zyra doganore e destinacionit merr rezultatet e kontrollit të mallrave, sipas shkronjës "ç", të pikës 1, dërgon rezultatet e kontrollit në zyrën doganore të nisjes, brenda gjashtë ditësh, pas datës së marrjes së mallrave nga pritësi i autorizuar;

Neni 591
Mbyllja e regjimit të transitit për mallrat e marra nga pritësi i autorizuar
(Shkronja "b", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

1. Mbajtësi i regjimit konsiderohet se ka përmbushur detyrimet e tij dhe regjimi i transitit konsiderohet i mbyllur në përputhje me pikën 2, të nenit 207, të Kodit, kur mallrat janë paraqitur të paprekura pranë pritësit të autorizuar sipas shkronjës "b", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, në vendin e specifikuar në autorizim, brenda afatit kohor të përcaktuar në përputhje me pikën 1, të nenit 614.

2. Me kërkesë të transportuesit, pritësi i autorizuar lëshon një vërtetim që konfirmon mbërritjen e mallrave në vendin e specifikuar në autorizim sipas shkronjës "b", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit dhe përmban referencën MRN të operacionit transit. Vërtetimi duhet të lëshohet në përputhje me formatin e përcaktuar në aneksin 72-03, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 592
Vërtetimi i lëshuar nga pritësi i autorizuar
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Vërtetimi i lëshuar nga pritësi i autorizuar për transportuesin në lidhje me dërgimin e mallrave duhet të përmbajë të dhënat dhe informacionin e kërkuar e përmendura në aneksin 72-03, të

shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 593
Autorizimi për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë
(Pika 4, e nenit 207, të Kodit)

1. Autorizimet, sipas përcaktimit të shkronjës "c", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë për mjetet e transportit, kontejnerët ose pakot që përdoren nën regjimin e transitit jepen kur autoritetet doganore miratojnë plumbçet e përcaktuara në aplikimin për autorizim.

2. Autoriteti doganor mund të pranojë plumbçe të një lloji të veçantë sipas autorizimit të miratuar nga një shtet tjetër me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare për transitin, përveç rasteve kur ka informacion se këto plumbçe të veçanta nuk janë të përshtatshme për qëllime doganore.

Neni 594
Formalitetet për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë
(Shkronja "c", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

1. Plumbçet e një lloji të veçantë duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 618.

Plumbçet e certifikuara nga një organ kompetent në përputhje me Standardin Ndërkombëtar ISO 17712:2013 "kontejnerë për transport - plumbçet mekanike", konsiderohen si plumbçe që përmbushin këto kërkesa.

Për transportin me kontejnerë përdoren, për sa është e mundur, plumbçet me elementë të lartë të sigurisë

2. Plumbçet e një lloji të veçantë përmbajnë një nga treguesit e mëposhtëm:

a) emrin e personit të autorizuar për ta përdorur atë, në përputhje me nenin shkronjën "c", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit;

b) një shkurtim ose kodin përkatës mbi bazën e të cilit autoritetet doganore të nisjes mund të identifikojnë personin e interesuar.

3. Mbajtësi i regjimit shënon numrin e plumbçeve të llojit të veçantë dhe numrin identifikues të secilit prej tyre në deklaratën e transitit dhe i vendos plumbçet jo më vonë se momenti i nisjes së mallrave në regjimin e transitit.

Neni 595
Mbikëqyrja doganore për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë
(Shkronja "c", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kryen, sa më poshtë:

a) i njofton zyrave doganore plumbçet e një lloji të veçantë në përdorim dhe plumbçet e llojit të veçantë, të cilat ka vendosur të mos miratojë për arsye të parregullsive ose mangësive teknike;

b) rishqyrton plumbçet e një lloji të veçantë të miratuara e në përdorim;

c) mund të kërkojë të konsultohet me zyrat doganore me qëllim që të arrihet një vlerësim i përbashkët;

Zyrat doganore mbikëqyrin përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë nga personat e autorizuar në përputhje me nenin 593.

Neni 596
Autorizimi për përdorimin e një deklarate transiti me të dhëna të reduktuara
(Shkronja "ç", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

Autorizimet, në përputhje me shkronjën "ç", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, për përdorimin e një deklarate doganore me të dhëna të reduktuara për të vendosur mallrat nën regjimin e transitit jepen për:

a) transportin e mallrave në rrugë hekurudhore;

b) transportin e mallrave në rrugë ajrore dhe detare, nëse dokumenti elektronik i transportit nuk përdoret si deklaratë transiti.

Neni 597
Autorizimet për përdorimin e një dokumenti elektronik të transportit si deklaratë transiti në transportin ajror
(Shkronja "d", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

Për qëllime të transportit ajror, autorizimet për përdorimin e një dokumenti elektronik të transportit si deklaratë transiti për t'i vendosur mallrat nën regjimin e transitit, në përputhje me shkronjën "d", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, jepen vetëm kur aplikuesi:

a) kryen një numër të konsiderueshëm fluturimesh ndërmjet aeroporteve të Republikës së Shqipërisë;

b) vërteton që është në gjendje të sigurojë se të dhënat e dokumentit elektronik të transportit janë

të disponueshme në zyrën doganore të nisjes në aeroportin e nisjes dhe në zyrën doganore të destinacionit në aeroportin e destinacionit dhe se këto të dhëna janë të njëjta si në zyrën doganore të nisjes ashtu edhe në zyrën doganore të destinacionit.

Neni 598
Autorizimet për përdorimin e një dokumenti elektronik të transportit si deklaratë transiti në transportin detar
(Shkronja "d", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

Për qëllime të transportit detar, autorizimet për përdorimin e një dokumenti elektronik të transportit si deklaratë transiti për t'i vendosur mallrat nën regjimin e transitit, në përputhje me shkronjën "d", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, jepen vetëm kur:

a) aplikuesi kryen një numër të konsiderueshëm lundrimesh ndërmjet porteve në Republikës së Shqipërisë;

b) aplikuesi tregon se ai është në gjendje të sigurojë që të dhënat e dokumentit elektronik të transportit janë të disponueshme në zyrën doganore të nisjes në portin e nisjes dhe në zyrën doganore të destinacionit në portin e destinacionit, dhe se këto të dhëna janë të njëjta si në zyrën doganore të nisjes ashtu edhe në zyrën doganore të destinacionit.

Neni 599
Konsultime para autorizimit për përdorimin e një dokumentit elektronik transporti, si deklaratë transiti për transportin ajror ose detar
(Neni 27 i Kodit)

Pasi është shqyrtuar përmbushja e kushteve për lëshimin e autorizimit, të parashikuara në nenin 583, dhe përkatësisht neneve 597, (për transportin ajror) apo 598, (për transportin detar), autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit konsultohet me autoritetin doganor pranë aeroporteve të nisjes dhe të destinacionit (në rast të transportit ajror) apo me autoritetin doganor pranë porteve të nisjes apo destinacionit (në rastin e transportit detar).

Afati kohor për konsultimin caktohet 45 ditë nga komunikimi sipas nenit 31, nga ana e autoritetit doganor kompetent për marrjen e vendimit, në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të shqyrtohen nga autoritetet doganore me të cilat janë konsultuar.

Neni 600
Formalitetet për përdorimin e dokumentit elektronik të transportit si një deklaratë transiti për transportin në rrugë ajrore apo detare
(Shkronja "d", e pikës 4, të nenit 207, të Kodit)

1. Mallrat do të vendosen nën regjimin e transitit kur të dhënat e dokumentit elektronik të transportit, janë vënë në dispozicion të zyrës doganore të nisjes në aeroport, në rast të transportit në rrugë ajrore apo në zyrën doganore të nisjes në port, në rastin e transportit në rrugë detare, në përputhje me mënyrat e përcaktuara në autorizim.

2. Kur mallrat do të vendosen nën regjimin e transitit, mbajtësi i regjimit shënon kodet përkatëse në të gjithë fushat, në dokumentin elektronik të transportit.

Regjimi i transitit përfundon kur mallrat paraqiten në zyrën doganore të destinacionit në aeroport, në rastin e transportit në rrugë ajrore apo në zyrën doganore të destinacionit në port, në rastin e transportit në rrugë detare dhe të dhënat e dokumentit elektronik të transportit janë vënë në dispozicion të kësaj zyre doganore, sipas mënyrave të përcaktuara në autorizim.

4. Mbajtësi i regjimit njofton menjëherë zyrat doganore të nisjes dhe destinacionit për të gjitha shkeljet apo parregullsitë.

5. Regjimi i transitit konsiderohet i mbyllur me përjashtim kur autoritetet doganore nuk janë informuar ose kanë arritur në përfundimin se regjimi nuk është mbyllur në mënyrë korrekte.

Nënseksioni 5
Lëvizja e mallrave në përputhje me Konventën ATA dhe Konventën e Stambollit

Neni 601
Njoftimi i veprave penale dhe parregullsive
(Shkronja "c" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "c", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

Kur një vepër penale apo parregullsi është kryer gjatë ose në lidhje me transitin ATA, DPD njofton mbajtësin e Carnet ATA dhe shoqatën garantuese për veprën penale apo parregullsitë, brenda një viti nga data e përfundimit të vlefshmërisë së Carnet.

Neni 602
Prova alternative të përfundimit të operacionit transit ATA
(Shkronja "c" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "c", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Operacioni transit ATA konsiderohet i përfunduar me korrektësi kur mbajtësi i Carnet ATA paraqet, brenda afateve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, te nenit 7, të Konventës ku Carnet lëshohet nën Konventën ATA dhe në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 9, të aneksit A të Konventës së Stambollit, kur Carnet lëshohet nën Konventën e Stambollit dhe për të bindur autoritetet doganore, një nga dokumentet e mëposhtme që identifikon mallrat:

a) dokumentet e përmendura në nenin 8, të Konventës ATA, kur Carnet lëshohet nën Konventën ATA dhe në nenin 10, të aneksit A, të Konventës së Stambollit, kur Carnet lëshohet nën Konventën e Stambollit;

b) një dokument i vërtetuar nga autoritetet doganore, që përcakton se mallrat janë paraqitur në zyrën doganore të destinacionit apo daljes;

c) një dokument i lëshuar nga autoritetet doganore në një vend tjetër ku mallrat janë vendosur nën një regjim doganor.

2. Në vend të dokumenteve te përmendura në pikën 1, mund të jepet si provë, kopje e njësuar me origjinalin nga organi i cili vërteton dokumentet origjinale.

Nënseksioni 6
Lëvizja e mallrave nën formatin/formularin 302

Neni 603
Zyra doganore kompetente
(Shkronja "ç" e pikës 3, të nenit 203, shkronja "ç" e pikës 2, të nenit 204, dhe pika 2, e nenit 147, të Kodit)

DPD me udhëzim përcakton zyrën doganore ose zyrat përgjegjëse për formalitetet doganore dhe kontrollet për lëvizjen e mallrave të kryera nga ose në emër të forcave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), që kanë të drejtë të përdorin formularin 302.

Neni 604
Furnizimi i forcave të NATO me formularët 302
(Shkronja "ç" e pikës 3, të nenit 203, shkronja "ç" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

Zyra doganore e nisjes e caktuar nga DPD do të furnizojë forcat e NATO të vendosura në zonën e saj me formularët 302 që:

a) janë paravërtetuar, vulosur dhe nënshkruar nga kryetari i kësaj zyre;

b) kanë numër serial;

c) kanë adresën e plotë të zyrës doganore në fjalë për kthimin e kopjeve të formularit 302.

Neni 605
Rregullat procedurale që zbatohen për përdorimin e formularit 302
(Shkronja "ç" e pikës 3, të nenit 203, shkronja "ç" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Në kohën e dërgimit të mallrave, forcat e NATO do të kryejnë një nga veprimet e mëposhtme:

a) të depozitojnë formularin 302, në formë elektronike në zyrën doganore të nisjes apo hyrjes;

b) plotësojnë formularin 302 me një deklaratë që vërteton se mallrat janë transportuar nën kontrollin e tyre dhe të verifikojë këtë deklaratë me nënshkrimin e tyre, vulën dhe datën.

2. Kur forcat e NATO, depozitojnë formularin 302 në formë elektronike, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 1, nenet 611, 613, 621, 623, 587, 590 dhe 591 do të aplikohen *mutatis mutandis*.

3. Kur forcat e NATO veprojnë në përputhje me shkronjën "b" të pikës 1, një kopje e formularit 302 jepet pa vonesë në zyrën doganore përgjegjëse për formalitetet doganore dhe kontrollet, që kanë të bëjnë me forcat e NATO që dërgojnë mallrat ose në emër të cilave mallrat do të dërgohen.

Kopjet e tjera të formularit 302, do të shoqërojnë ngarkesën në destinacionin e forcave të NATO, ku formularët do të vulosen dhe nënshkruhen nga ato forca të NATO.

Në kohën e mbërritjes së mallrave, dy kopje të formularit do t'i jepen zyrës doganore kompetente të përcaktuar për formalitetet doganore dhe kontrollet e zbatueshme të forcave të NATO të destinacionit.

Zyra doganore e përcaktuar duhet të mbajë një kopje dhe do ta kthejë kopjen e dytë në zyrën

doganore përgjegjëse për formalitetet doganore dhe kontrollet që kanë të bëjnë me forcat e NATO, e cila dërgon mallrat ose në emër të së cilës janë dërgohen mallrat.

Nënseksioni 7
Transiti i mallrave të transportuara nën sistemin postar

Neni 606
Lëvizja e mallrave joshqiptare në dërgesat postare nën regjimin e transitit të jashtëm
(Shkronja "d", e pikës 3, të nenit 203, të Kodit)

Kur mallrat joshqiptare qarkullojnë nën regjimin e transitit të jashtëm në përputhje me shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 203, të Kodit, dërgesat postare dhe te gjitha dokumentet shoqëruese do të mbajnë një etiketë sipas aneksit 72-01, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 607
Lëvizja e dërgesave postare që përmbajnë mallra shqiptare dhe joshqiptare
(Shkronja "d" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "d" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur një dërgesë postare përmban mallra shqiptare dhe jo shqiptare, ngarkesa dhe çdo dokument do të mbajnë etiketën e përcaktuar në aneksin 72-01, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Për mallrat shqiptare të një dërgese siç referohet në pikën 1, prova për statusin doganor të mallrave ose MRN mund ti dërgohen më vete operatorit postar të destinacionit ose së bashku me dërgesën.

Kur prova e statusit doganor të mallrave shqiptare i dërgohet më vete operatorit postar të destinacionit, operatori postar paraqet prova të statusit doganor të mallrave shqiptare në zyrën doganore të destinacionit së bashku me dërgesën.

Ku prova e statusit doganor të mallrave shqiptare ose MRN e saj, është bashkëngjitur në dërgesë, kjo do të tregohet qartë në pjesën e jashtme të paketimit.

Neni 608
Lëvizja e dërgesave postare nën regjimin e transitit të brendshëm në situata të veçanta
(Shkronja "d", e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

Kur mallrat shqiptare lëvizin nën regjimin e transitit të brendshëm në përputhje me nenin shkronjën "d", të pikës 2, të nenit 204, të Kodit, nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, në një vend transiti të përbashkët, për të rihyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ato mallra shoqërohen me provën e statusit doganor shqiptar të përcaktuar me një nga mënyrat e listuara në nenin 563.

Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare paraqitet në zyrën doganore të rihyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë

Seksioni 2
Dispozita të tjera për regjimin e transitit të brendshëm dhe të jashtëm

Nënseksioni 1
Dispozita të tjera

Neni 609
Operacione transiti në rrethana të veçanta
(Shkronja "b", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

1. Autoriteti doganor pranon një deklaratë transiti në letër në rast të defekteve të përkohshme të:

a) sistemit informatik të transitit;

b) sistemit informatik të përdorur nga mbajtësi i regjimit për depozitimin e deklaratës së transitit nëpërmjet teknikave informatike të përpunimit të të dhënave;

c) lidhjes elektronike ndërmjet sistemit informatik të transitit dhe sistemit informatik të përdorur nga mbajtësi i regjimit për depozitimin e deklaratës transit nëpërmjet teknikës informatike të përpunimit të të dhënave.

Rregullat për përdorimin e deklaratës transit në letër përcaktohen në aneksin 72-04 'Procesi i Vazhdimësisë së Punës (PVP)', të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Pranimi i deklaratës transit në letër në rast të defekteve të përkohshme sipas shkronjave "b" dhe "c", i nënshtrohet miratimit të autoriteteve doganore.

Neni 610
Kontrolli dhe asistenca administrative
(Neni 49 i Kodit)

1. Autoriteti doganor kompetent mund të kryejë kontroll pas çlirimit për transit (*a-posteriori*), të informacioneve të dhëna, si dhe të çdo dokumenti, formulari, autorizimi ose të dhëne në lidhje me operacionin e transitit, për të kontrolluar vërtetësinë e të dhënave të regjistruara, informacionit të shkëmbyer dhe vulave. Këto kontrolle bëhen në rast dyshimesh për saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë ose në rast dyshimi për mashtrim. Ato mund të bëhen gjithashtu në bazë të analizës së riskut ose me përzgjedhje të rastësishme.

2. Autoriteti doganor kompetent përgjigjet menjëherë pas marrjes së një kërkese për kontroll *a-posteriori*.

3. Nëse autoriteti doganor kompetent i vendit të nisjes i bën një kërkesë autoritetit doganor kompetent për një kontroll *a-posteriori* të informacioneve në lidhje me operacionin e transitit të përbashkët, kushtet e parashikuara në pikën 2, të nenit 195, të Kodit, për mbylljen e regjimit të transitit nuk konsiderohen të përmbushura derisa të konfirmohet vërtetësia dhe saktësia e të dhënave.

Neni 611
Dërgesa të përziera
(Shkronja "b", e pikës 1, të nenit 207, të Kodit)

Një dërgesë mund të përmbajë njëkohësisht si mallra që duhet të vendosen nën regjimin e transitit të jashtëm në përputhje me nenin 203, të Kodit, ashtu dhe mallra që duhet të vendosen nën regjimin e transitit të brendshëm në përputhje me nenin 204, të Kodit, me kusht që çdo artikull i mallrave të jetë saktësisht i identifikueshëm në deklaratën e transitit.

Neni 612
Fusha e zbatimit
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

Regjimi i transitit është i detyrueshëm në rastet e mëposhtme:

a) nëse mallrat joshqiptare të transportuara në rrugë ajrore janë ngarkuar ose shkarkuar në një aeroport të Republikës së Shqipërisë;

b) nëse mallrat joshqiptare të transportuara në rrugë detare përdorin një shërbim të rregullt të transportit detar të autorizuar në përputhje me nenin 295.

Nënseksioni 2
Formalitetet në zyrën doganore të nisjes

Neni 613
Deklarata e transitit dhe mjetet e transportit
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Çdo deklaratë transiti do të përfshijë vetëm mallrat e vendosura nën regjimin e transitit që lëvizin ose duhet të lëvizin nga zyra doganore e nisjes në zyrën doganore të destinacionit në një mjet të vetëm transporti, në një kontejner apo në një koli/pako.

Megjithatë, një deklaratë e vetme transiti mund të përfshijë mallra që lëvizin ose duhet të lëvizin nga zyra doganore e nisjes në zyrën doganore të destinacionit, në më shumë se një kontejner apo në më shumë se një pako/koli, me kusht që kontejnerët apo pakot/kolitë janë ngarkuar në një mjet të vetëm transporti.

2. Për qëllime të këtij neni, mjetet e mëposhtme do të konsiderohen se përbëjnë një mjet të vetëm transporti, me kusht që të transportojnë mallra të cilat lëvizin së bashku:

a) një automjet rrugor i shoqëruar nga rimorkio/t ose gjysmërimorkio/t e tij;

b) një varg vagonësh hekurudhorë apo vagonë që bashkëshoqërohen;

c) mjete lundruese që përbëjnë një zinxhir të vetëm.

3. Kur për qëllime të regjimit të transitit, një mjet i vetëm transporti është përdorur për ngarkimin e mallrave në më shumë se një zyrë doganore nisjeje si dhe për shkarkimin e tyre ne me shume se një zyre doganore destinacioni, depozitohen deklarata transiti të veçanta për secilën ngarkesë.

Neni 614
Afati për paraqitjen e mallrave
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Zyra doganore e nisjes përcakton afatin kohor brenda të cilit mallrat do të paraqiten në zyrën doganore të destinacionit, duke marrë parasysh sa më poshtë:

a) itinerarin;

b) mjetin e transportit;

c) legjislacionin e transportit apo të gjitha aktet e tjera ligjore që mund të ndikojë në përcaktimin e afatit;

ç) çdo informacion që konsiderohet i rëndësishëm, i komunikuar nga mbajtësi i regjimit.

2. Afati kohor, i përcaktuar nga zyra doganore e nisjes do të jetë detyrues për autoritetet doganore të përfshira në operacionin e transitit dhe ky afat nuk mund të ndryshohet nga këto të fundit.

Neni 615
Itinerari për lëvizjen e mallrave nën regjimin e transitit

(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Mallrat e vendosura nën regjimin transitit, do të lëvizin për në zyrën doganore të destinacionit përgjatë një itinerari të justifikuar ekonomikisht.

2. Kur zyra doganore e nisjes ose mbajtësi i regjimit e konsideron të nevojshme, kjo zyrë doganore do të përcaktojë një itinerar për lëvizjen e mallrave nën regjimin e transitit, duke marrë parasysh çdo informacion të rëndësishëm të komunikuar nga mbajtësi i regjimit.

Kur përcaktohet itinerari, zyra doganore e pasqyron atë në sistemin elektronik të transitit.

Neni 616
Plumbosja si masë identifikuese

(Nenet 173, shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur mallrat do të vendosen nën regjimin e transitit, zyra doganore e nisjes plumbos si më poshtë:

a) hapësirën që mban mallrat, kur mjetet e transportit ose kontejneri është i pranuar nga zyra doganore e nisjes si i përshtatshëm për plumbosje.

b) çdo paketim individual, në raste të tjera.

2. Zyra doganore e nisjes do të regjistrojë numrin e plumbçeve dhe numrin identifikues të çdo plumbçeje në sistemin elektronik te transitit.

Neni 617
Përshtatshmëria për plumbosje

(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Zyra doganore e nisjes konsideron të përshtatshëm për plumbosje, mjetet e transportit ose kontejnerët që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të plumbosen thjeshtë dhe në mënyrë efikase;

b) të jenë ndërtuar në mënyrë të tillë që kur mallrat hiqen apo vendosen, heqja ose vendosja e mallrave në fjalë lë gjurmë të dukshme, plumbçet thyhen, tregojnë shenja manipulimi, ose një sistem elektronik i mbikëqyrjes regjistron heqjen ose vendosjen;

c) të mos përmbajnë hapësira të fshehta ku mund të fshihen mallra;

ç) hapësirat e rezervuara për vendosjen e mallrave, të jenë lehtësisht të arritshme për kryerjen e kontrollit, nga autoritetet doganore.

2. Automjetet rrugore, rimorkiot, gjysmërimorkiot dhe kontejnerët e miratuar për transportin e mallrave nën plumbosje doganore në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare në të cilën Republika e Shqipërisë është palë, konsiderohen si të përshtatshme për plumbosje.

Neni 618
Karakteristikat e plumbçeve doganore

(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Plumbçet doganore duhet të kenë së paku karakteristikat thelbësore si vijon:

a) të mbeten të pandryshueshme, të fiksuara në mënyrë solide, gjatë përdorimit normal;

b) të jenë lehtësisht të kontrollueshme dhe të identifikueshme;

c) të jenë prodhuar në mënyrë të tillë që çdo thyerje, manipulim apo heqje të lërë gjurmë të dukshme me sy të lirë;

ç) të jenë projektuar për një përdorim ose, nëse janë për disa përdorime, të projektohen në mënyrë të tillë që çdo rivendosje e tyre të jetë qartësisht e identifikueshme nëpërmjet një treguesi unik për çdo ripërdorim;

d) të kenë identifikim unik të përhershëm, lehtësisht të lexueshëm dhe të shfaqin tregues unik në çdo përdorim;

2. Plumbçet doganore duhet të të plotësojnë së paku specifikimet teknike si vijon:

a) forma dhe përmasat e plumbçeve mund të ndryshojnë në varësi të plumbosjes, por përmasat duhet të jenë te tilla që të garantojnë një tregues identifikimi lehtësisht të lexueshëm;

b) treguesit identifikues të plumbçeve duhet të jenë të pafalsifikueshëm dhe vështirësisht të riprodhueshëm;

c) materiali i përdorur të jetë rezistent ndaj thyerjeve aksidentale si dhe i tillë që të parandalojë falsifikimin ose ripërdorimin.

3. Plumbçet e certifikuara nga një organ kompetent në përputhje me Standardin Ndërkombëtar ISO 17712:2013 "kontejnerë për transportin e mallrave - plumbçe mekanike", konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2.

Për transportet me kontejner, do të përdoren plumbçe me elementë të lartë të sigurisë, në masën më të gjerë të mundshme.

4. Plumbçja doganore duhet të mbajë treguesit e mëposhtëm:

a) fjalën "Dogana";

b) kodin e shtetit shqiptar 'AL', në përputhje me standardet ISO-alpha-2;

c) simbolin e flamurit shqiptar (jo detyrues).

ç) Republika e Shqipërisë në marrëveshje me shtete të tjera mund të vendosë të përdorë elemente sigurie dhe teknologjie të përbashkëta.

5. Sa herë që duhet të hiqet një plumbçe me qëllim kryerjen e një kontrolli doganor, autoritetet doganore duhet të kryejnë riplumbosjen në mënyrën e duhur, me plumbçe doganore që përmbajnë të paktën elemente sigurie ekuivalente dhe të shënojnë detajet e veprimeve të kryera në dokumentacionin e ngarkesës, përfshirë edhe numrin e ri të plumbçes.

Neni 619
Masa identifikuese alternative për plumbosjen

(Nenet 173, shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Duke anashkaluar nenin 616, zyra doganore e nisjes mund të vendosë të mos plumbosë mallrat nën regjimin e transitit por të mbështetet në përshkrimin e mallrave në deklaratën e transitit apo në dokumentet plotësuese, me kusht që përshkrimi të jetë mjaftueshmërisht i saktë, në mënyrë që të lejojë identifikimin e mallrave lehtësisht, të përcaktojë sasinë dhe natyrën e tyre si dhe karakteristikat e veçanta sikundër numrat serial të mallrave.

2. Duke anashkaluar nenin 616, përveç se kur zyra doganore e nisjes vendos ndryshe, as mjeti i transportit, dhe as paketimet individuale që përmbajnë mallra nuk do të plumbosen nëse:

a) mallrat transportohen në rrugë ajrore, dhe çdo ngarkese i ngjiten etiketa që përmbajnë numrin e faturës shoqëruese të avionit (AWB), ose dërgesa përbën një njësi ngarkese mbi të cilën tregohet numri i faturës shoqëruese të avionit;

b) mallrat transportohen në rrugë hekurudhore dhe masat identifikuese zbatohen nga kompanitë hekurudhore.

Neni 620
Çlirimi i mallrave për regjimin e transitit

(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Vetëm mallrat që plumbosen në përputhje me nenin 616, ose kur respektohen masat identifikuese alternative për plumbosjen e mallrave në përputhje me nenin 619, çlirohen për regjimin e transitit.

2. Lidhur me çlirimin e mallrave për transit, zyra doganore e nisjes dërgon të dhënat e operacionit të transitit:

a) në zyrën doganore të destinacionit të deklaruar;

b) në çdo zyrë doganore transiti të deklaruar;

Këto të dhëna do të bazohen në informacionet e marra nga deklarata e transitit, me ndryshimet përkatëse kur është e nevojshme.

3. Zyra doganore e nisjes njofton mbajtësin e regjimit të transitit për çlirimin e mallrave për regjimin e transitit .

4. Me kërkesë të mbajtësit të regjimit, zyra doganore e nisjes duhet t'i sigurojë një dokument shoqërues transiti apo nëse është e nevojshme një dokument shoqërues transiti/sigurisë.

Dokumenti shoqërues i transitit është modeli i përcaktuar në aneksin B-02, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe nëse është e nevojshme plotësohet me listën e artikujve sipas modelit të përcaktuar në aneksin B-03, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij. Dokumenti shoqërues i transitit/sigurisë është modeli i përcaktuar në aneksin B-04, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe nëse është e nevojshme plotësohet me listën e artikujve të modelit të përcaktuar në aneksin B-05, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Deri në implementimin e sistemeve të reja të informatizuara, në përputhje me nenin 286, të Kodit nuk do të përdoret DSHT (dokumenti shoqërues i transitit) dhe DSHTS (dokumenti shoqërues i transitit/sigurisë).

Nënseksioni 3
Formalitetet gjatë regjimit të transitit

Neni 621
Paraqitja e mallrave që lëvizin nën regjimin e transitit në zyrën doganore të transitit
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Mallrat, së bashku me MRN e deklaratës së transitit do të paraqiten në çdo zyrë doganore transiti.

2. Në lidhje me paraqitjen e MRN të deklaratës së transitit në çdo zyrë doganore transiti, do të zbatohet shkronja "b", e nenit 566.

3. Zyra doganore e transitit duhet të regjistrojë kalimin në kufi të mallrave për operacionin e transitit, në bazë të të dhënave të marra nga zyra doganore e nisjes. Ky kalim do ti njoftohet zyrës doganore të nisjes nga zyrat doganore të transitit.

4. Kur mallrat lëvizin përmes një zyre doganore transiti të ndryshme nga ajo e deklaruar, zyra doganore aktuale e transitit do ti kërkojë të dhëna për operacionin transit zyrës doganore të nisjes dhe do ta njoftojë atë për kalimin në kufi të mallrave.

5. Zyra doganore e transitit mund të kontrollojë mallrat. Çdo kontroll i mallrave bëhet bazuar kryesisht në të dhënat e operacionit transit, të marra nga zyra doganore e nisjes.

6. Pikat 1 deri 4, nuk do të zbatohen për transportin e mallrave në rrugë hekurudhore, me kusht që zyra doganore e transitit të verifikojë kalimin në kufi të mallrave me mjete të tjera. Një verifikim i tillë do të kryhet vetëm në rast se është e nevojshme. Verifikimi mund të bëhet në retrospektive (*a-posteriori*).

Neni 622
Incidentet gjatë lëvizjes së mallrave nën një operacion transit
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Transportuesi pas incidentit paraqet menjëherë pa vonesë, mallrat bashkë me MRN e deklaratës transit pranë autoritetit doganor më të afërt në territorin e të cilit ndodhen mjetet e transportit në rastet kur:

a) transportuesi është i detyruar të devijojë nga itinerari i përcaktuar në përputhje me nenin 615, për rrethana që nuk varen prej tij;

b) plumbçet janë thyer ose manipuluar për shkaqe që nuk varen prej transportuesit;

c) mallrat transferohen nga një mjetet transporti në një mjet tjetër transporti, nën mbikëqyrjen e autoritetit doganor;

ç) një rrezik evident kërkon shkarkimin e menjëhershëm të plotë apo të pjesshëm të mallrave nga mjeti i plumbosur i transportit;

(d) nëse ka ndodhur një incident që mund të kushtëzojë aftësinë e mbajtësit të regjimit ose të transportuesit për të përmbushur detyrimet e tij;

(dh) nëse është ndryshuar ndonjë prej elementëve/pjesëve që përbëjnë një mjet të vetëm transporti siç përmendet në pikën 2, të nenit 613.

2. Nëse autoriteti doganor, në territorin e të cilit ndodhet mjeti i transportit, konsideron se operacioni transit në fjalë mund të vazhdojë, ndërmerr të gjitha masat që i konsideron të nevojshme.

Autoriteti doganor i lartpërmendur regjistron informacionet përkatëse në sistemin elektronik të transitit lidhur me incidentet e përmendura në pikën 1.

3. Në rast të një incidenti, siç përmendet në pikën1, shkronja "c", autoritetet doganore nuk kërkojnë paraqitjen e mallrave, së bashku me MRN e deklaratës transit nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) mallrat transferohen nga një mjet transporti që nuk është i plumbosur;

b) mbajtësi i regjimit ose transportuesi për llogari të mbajtësit të regjimit siguron informacionet përkatëse lidhur me transferimin e mallrave pranë autoritetit doganor në territorin e të cilit ndodhet mjeti i transportit;

c) autoriteti i lartpërmendur regjistron informacionet përkatëse në sistemin elektronik të transitit.

4. Në rast të një incidenti, siç përmendet në në pikën 1, shkronja "dh", transportuesi mund të vazhdojë operacionin e transitit nëse një ose më shumë karroca ose vagonë hekurudhorë janë hequr nga një grup karrocash ose vagonësh hekurudhore për shkak të problemeve teknike.

5. Në rast të një incidenti, siç përmendet në

pikën 1, shkronja "dh", nëse kabina e një mjeti rrugor zëvendësohet pa iu ndryshuar rimorkiot ose gjysmë-rimorkiot, autoriteti doganor nuk kërkon paraqitjen e mallrave dhe të MRN të deklaratës transit nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) mbajtësi i regjimit ose transportuesi për llogari të mbajtësit të regjimit i siguron informacionin përkatës në lidhje me përbërjen e mjetit rrugor autoritetit doganor në territorin e të cilit ndodhet mjeti rrugor;

b) autoriteti i lartpërmendur regjistron informacionet përkatëse në sistemin elektronik të transitit.

6. Deri në implementimin e sistemeve të reja të informatizuara, në përputhje me nenin 286 të Kodit, në rastet e përmendura në pikën 1, transportuesi do të plotësojë deklaratën e transitit me informacionin e duhur dhe pas incidentit paraqet menjëherë pa vonesë mallrat bashkë me deklaratën e transitit pranë autoritetit doganor më të afërt në territorin e të cilit ndodhet mjeti rrugor.

Në rastet e përmendura në pikat 3, shkronjat "a" dhe "b", 4 dhe 5, shkronja "a" transportuesi çlirohet nga detyrimi i paraqitjes së mallrave dhe të MRN të deklaratës së transitit pranë autoritetit doganor të përmendur më lart.

Informacionet përkatëse në lidhje me incidentet gjatë operacionit të transitit do të regjistrohen në sistemin elektronik të transitit nga zyra doganore e transitit ose nga zyra doganore e destinacionit.

7. Deri në implementimin e sistemeve të reja të informatizuara, në përputhje me nenin 286, të Kodit nuk do të zbatohet paragrafi i dytë i pikës 2 të këtij neni.

Nënseksioni 4
Formalitetet në zyrën doganore të destinacionit

Neni 623
Paraqitja e mallrave të vendosura nën regjimin e transitit në zyrën doganore të destinacionit

(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur mallrat e vendosura nën një regjim transiti mbërrijnë në zyrën doganore të destinacionit, kësaj zyre i paraqiten:

a) mallrat;

b) MRN e deklaratës së transitit;

c) çdo informacion i kërkuar nga zyra doganore e destinacionit.

Paraqitja bëhet gjatë orarit zyrtar të funksionimit të zyrave doganore. Megjithatë, zyra doganore e destinacionit, me kërkesë të personit të interesuar, mund të lejojë që paraqitja e tyre të bëhet jashtë orarit zyrtar të funksionimit ose në çdo vend tjetër që konsiderohet i përshtatshëm prej tyre.

2. Paraqitja e MRN së deklaratës transit në çdo zyrë doganore të transitit kryhet në përputhje me nenin 566.

3. Nëse paraqitja bëhet pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar nga zyra doganore e nisjes në përputhje me pikën 1, të nenit 614, mbajtësi i regjimit konsiderohet se ka respektuar afatin kohor kur ai vetë ose transportuesi është në gjendje t'i provojë në mënyrë bindëse zyrës doganore të destinacionit, që vonesa nuk është për faj të tij.

4. Regjimi i transitit mund të mbyllet në një zyrë doganore të ndryshme nga ajo e deklaruar në deklaratën transit. Në këtë rast, zyra doganore e lartpërmendur konsiderohet zyra doganore e destinacionit.

5. Me kërkesë të personit që paraqet mallrat në zyrën doganore të destinacionit, kjo zyrë doganore lëshon vërtetim të nënshkruar dhe vulosur që konfirmon paraqitjen e mallrave në këtë zyrë doganore dhe i referohet MRN të deklaratës transit.

Vërtetimi përgatitet duke përdorur formularin sipas aneksit 72-03, të shtojcës B bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe plotësohet paraprakisht nga personi i interesuar.

Vërtetimi nuk mund të përdoret si provë alternative e mbylljes së regjimit të transitit në përputhje me nenin 629.

Neni 624
Njoftimi i mbërritjes së mallrave nën regjimin e transitit

(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Zyra doganore e destinacionit njofton zyrën doganore të nisjes për mbërritjen e mallrave në ditën kur mallrat dhe MRN e deklaratës transit paraqiten në përputhje me pikën 1, të nenit 623.

2. Në rast se regjimi i transitit përfundon në një zyrë doganore të ndryshme nga ajo e deklaruar në deklaratën transit, zyra doganore e konsideruar si

zyra doganore e destinacionit në përputhje me pikën 4, të nenit 623, i njofton mbërritjen zyrës doganore të nisjes në ditën kur mallrat dhe MRN e deklaratës transit paraqiten në përputhje me pikën 1, të nenit 623.

Zyra doganore e nisjes i njofton mbërritjen zyrës doganore të destinacionit të deklaruar në deklaratën transit.

Neni 625
Kontrollet dhe dhënia e provës alternative
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur regjimi i transitit mbyllet, zyra doganore e destinacionit bën kontrollet doganore në bazë të të dhënave të operacionit të transitit të marra nga zyra doganore e nisjes.

2. Nëse pas përfundimit të regjimit të transitit, nuk janë konstatuar parregullsi nga zyra doganore e destinacionit, dhe mbajtësi i regjimit paraqet një dokument shoqërues transiti ose një dokument shoqërues transiti/sigurie, kjo zyrë nënshkruan dhe vulos dokumentin e lartpërmendur me kërkesë të mbajtësit të regjimit me qëllim që të japë një provë alternative në përputhje me nenin 622. Vërtetimi përmban vulën e zyrës së lartpërmendur doganore, nënshkrimin e nëpunësit, datën dhe shënimin e mëposhtëm:

'Provë alternative — 99202'.

Neni 626
Dërgimi i rezultateve të kontrollit
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Zyra doganore e destinacionit i njofton rezultatet e kontrollit zyrës doganore të nisjes brenda tre ditësh nga e nesërmja e ditës kur mallrat paraqiten në zyrën doganore të destinacionit ose në një vend tjetër në përputhje me pikën 1, të nenit 623. Në raste të jashtëzakonshme, ky afat kohor mund të zgjatet deri në një maksimum prej gjashtë ditësh.

2. Duke anashkaluar pikën 1, nëse mallrat merren nga një pritës i autorizuar sipas shkronjës "b", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit, zyra doganore e nisjes njoftohet brenda gjashtë ditësh pas ditës kur mallrat i janë dorëzuar pritësit të autorizuar.

Në rast se mallrat transportohen me tren dhe një ose më shumë karroca apo vagonë tërhiqen nga një grup karrocash ose vagonësh treni për shkak të problemeve teknike, siç parashikohet nga pika 4, e nenit 622, zyra doganore e nisjes njoftohet maksimumi brenda 12 ditësh pas ditës në të cilën pjesa e parë e mallrave është paraqitur.

3. Deri në implementimin e sistemeve të reja të informatizuara të sistemit elektronik të transitit në përputhje me pikën 1, të nenit 17, dhe nga nenet 203, deri në 209, të Kodit, nuk do të aplikohet paragrafi i dytë i pikës 2, të këtij neni.

Nënseksioni 5
Procedura hetimore dhe vjelja e borxhit doganor

Neni 627
Procedura hetimore për mallrat që lëvizin nën regjimin e transitit
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur zyra doganore e nisjes nuk ka marrë rezultatin e kontrollit brenda 6 ditëve në përputhje me pikën 1, të nenit 626, ose paragrafin e parë të pikës 2, të nenit 626 ose brenda 12 ditësh në përputhje me paragrafin e dytë të pikës 2, të nenit 626, pas marrjes së njoftimit të mbërritjes së mallrave, kjo zyrë doganore do të kërkojë menjëherë rezultatet e kontrollit nga zyra doganore e destinacionit që dërgoi njoftimin e mbërritjes së mallrave.

Zyra doganore e destinacionit do të dërgojë rezultatet e kontrollit menjëherë pas marrjes së kërkesës nga zyra doganore e nisjes.

2. Kur autoritetet doganore të nisjes nuk kanë marrë ende informacionin që lejon mbylljen e regjimit të transitit ose të dhëna për vjeljen e borxhit doganor, ato do ti kërkojnë informacionin përkatës mbajtësit të regjimit ose, kur në vendin e destinacionit janë të disponueshme të dhëna të mjaftueshme, zyrës doganore të destinacionit, në rastet e mëposhtme:

a) Zyra doganore e nisjes nuk ka marrë njoftimin e mbërritjes së mallrave deri në përfundimin e afatit të përcaktuar për paraqitjen e mallrave në përputhje me nenin 614,

b) Zyra doganore e nisjes nuk ka marrë rezultatet e kontrollit të kërkuara në përputhje me pikën 1;

c) Zyra doganore e nisjes konstaton se njoftimi i mbërritjes së mallrave ose rezultatet e kontrollit janë dërguar gabimisht.

3. Autoritetet doganore të nisjes do të dërgojnë kërkesë për informacion në përputhje me pikën 2, shkronja "a", brenda një afati prej 7 ditësh pas përfundimit të afatit kohor të përmendur më lart dhe kërkesë për informacion në përputhje me pikën 2, shkronja "b", brenda një afati prej 7 ditësh pas skadimit të afatit të zbatueshëm të referuar në pikën 1.

Megjithatë, nëse para përfundimit të këtyre afateve kohore, autoritetet doganore të nisjes marrin informacion se regjimi transit nuk është mbyllur në mënyrë të rregullt, ose dyshojnë për një rast të tillë, ato do të dërgojnë kërkesën për informacion pa vonesë.

4. Përgjigjet për kërkesat e bëra në përputhje me pikën 2 duhet të dërgohen brenda 28 ditëve nga data në të cilën dërguar kërkesa.

5. Kur, pas një kërkese në përputhje me pikën 2, zyra doganore e destinacionit nuk ka dhënë informacion të mjaftueshëm për mbylljen e regjimit të transitit, autoritetet doganore të nisjes do t'ia kërkojnë këtë informacion mbajtësit të regjimit, jo më vonë se 35 ditë pas fillimit të procedurës hetimore.

Megjithatë, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të NCTS sipas Planit të Punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, autoritetet doganore do të kërkojnë nga mbajtësi i regjimit të sigurojë informacion, jo më vonë se 28 ditë pas fillimit të procedurës hetimore.

Mbajtësi i regjimit do ti përgjigjet kësaj kërkese brenda 28 ditëve nga data në të cilën është dërguar.

6. Nëse informacionet e dhëna në një përgjigje nga mbajtësi i regjimit në përputhje me pikën 5, nuk janë të mjaftueshme për mbylljen e regjimit transit, por autoriteti doganor i nisjes konsideron se janë të mjaftueshme në mënyrë që të vazhdojë procedurën hetimore, ky autoritet do t'i dërgojë menjëherë një kërkesë për informacion plotësues zyrës doganore të përfshirë.

Kjo zyrë doganore do t'i përgjigjet kërkesës brenda 40 ditëve nga data në të cilën ajo është dërguar.

7. Kur gjatë një procedure hetimore të përcaktuar në pikat nga 1 deri 6 është vendosur se regjimi transit është mbyllur në mënyrë korrekte, autoriteti doganor i nisjes mbyll regjimin e transitit dhe menjëherë do të informojë mbajtësin e regjimit dhe, sipas nevojës, çdo autoritet doganor që mund të ketë nisur një procedurë vjelje.

8. Kur gjatë një procedure hetimore të përcaktuar në pikat nga 1 deri 6 është vendosur se regjimi transit nuk mund të mbyllet, autoriteti doganor i nisjes do të vendosë nëse ka lindur një borxh doganor.

Nëse ka lindur një borxh doganor, autoriteti doganor i nisjes do të marrë masat si më poshtë:

a) identifikon debitorin;

b) përcakton autoritetin doganor përgjegjës për njoftimin e borxhit doganor në përputhje me pikën 1, të nenit 96, të Kodit.

Neni 628
Kërkesa për të transferuar vjeljen e borxhit doganor
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Kur autoriteti doganor i nisjes, gjatë procedurës hetimore, dhe para përfundimit të afatit të referuar në shkronjën "a", të nenit 175, merr prova se vendi ku ngjarjet nga të cilat ka lindur borxhi doganor, është në një zyrë doganore tjetër, ai autoritet menjëherë dhe në çdo rast brenda këtij afati kohor ia dërgon të gjithë informacionin në dispozicion autoritetit doganor kompetent në atë vend.

2. Autoriteti doganor kompetent në atë vend do të pranojë marrjen e njoftimit dhe informon autoritetin doganor të nisjes nëse është përgjegjës për vjeljen. Nëse autoriteti doganor i nisjes e merr informacionin brenda 28 ditëve, vazhdon menjëherë procedurat hetimore ose fillon vjeljen.

Neni 629
Prova alternative për të mbyllur regjimin e transitit
(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Regjimi i transitit konsiderohet i mbyllur në mënyrë korrekte kur mbajtësi i regjimit, në bindje të autoritetit doganor të nisjes, paraqet një nga dokumentet e mëposhtme për identifikimin e mallrave:

a) një dokument të vërtetuar nga autoriteti doganor i destinacionit që identifikon mallrat dhe vërteton se mallrat janë paraqitur në zyrën doganore të destinacionit, ose janë dërguar pranë

një pritësi të autorizuar, siç referohet në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 207, të Kodit;

b) një dokument ose një regjistrim doganor, i vërtetuar nga autoriteti doganor, i cili përcakton se mallrat kanë lënë fizikisht territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) një dokument doganor të lëshuar nga një vend tjetër ku mallrat janë vendosur nën një regjim doganor,

ç) një dokument të lëshuar në një vend tjetër, të vulosur ose të vërtetuar në një mënyrë tjetër nga autoriteti doganor i atij vendi dhe që vërteton se mallrat konsiderohen të jenë në qarkullim të lirë në atë vend.

2. Në vend të dokumenteve te përmendura në pikën 1, mund të paraqiten si provë kopjet e vërtetuara si kopje të njehsuara me origjinalin nga organi që vërteton dokumentet origjinale nga autoriteti i vendit tjetër në fjalë.

3. Njoftimi i mbërritjes së mallrave, siç referohet në nenin 617, nuk do të konsiderohet provë që regjimi i transitit është mbyllur në mënyrë korrekte.

Nënseksioni 5
Mallrat e transportuara me instalime fikse transporti

Neni 630
Transporti me instalime fikse transporti dhe funksionimi i regjimit të transitit

(Shkronja "a" e pikës 3, të nenit 203, dhe shkronja "a" e pikës 2, të nenit 204, të Kodit)

1. Në rastin kur mallrat e transportuara me një instalim fiks transporti, hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet strukturës së lartpërmendur, këto mallra konsiderohen të vendosura nën regjimin e transitit në momentin e hyrjes në këtë territor.

2. Në rastin kur mallrat gjenden tashmë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe janë transportuar me një instalim fiks transporti, këto mallra konsiderohen të vendosura nën regjimin e transitit në momentin e futjes në instalimin fiks të transportit.

3. Për qëllime të regjimit të transitit, në rast se mallrat janë transportuar me instalim fiks transporti, mbajtësi i regjimit është operatori i instalimit fiks të transportit, i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet të cilit mallrat hyjnë në këtë territor, në rastin e përmendur në pikën 1, ose operatori i instalimit fiks të transportit në vendin në të cilën lëvizja fillon, në rastin e përmendur në pikën 2.

Mbajtësi i regjimit dhe autoritetet doganore bien dakord mbi mënyrën e mbikëqyrjes doganore për mallrat e transportuara.

4. Për qëllime të pikës 3, të nenit 207, të Kodit, transportues konsiderohet operatori i instalimit fiks të transportit, i vendosur në Republikës së Shqipërisë, përmes territorit të së cilës mallrat qarkullojnë me instalim fiks transporti.

5. Regjimi i transitit konsiderohet i mbyllur kur është bërë regjistrimi i duhur në regjistrat tregtar të pritësit ose të operatorit të instalimit fiks të transportit, i cili vërteton se mallrat e transportuara me instalim fiks të transportit:

a) kanë mbërritur në impiantin e pritësit;

b) janë pranuar në rrjetin e shpërndarjes të pritësit, ose

c) kanë lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

KREU 3
Magazinimi doganor

Seksioni 1
Magazinimi doganor dhe tipet e magazinave

Neni 631
Shitja me pakicë

(Shkronja "b", e pikës 1, të nenit 192, të Kodit)

Autorizimi për përdorimin e ambienteve për magazinim doganor të mallrave jepet me kusht që ambientet e magazinimit të mos përdoren për shitje me pakicë, përveç rasteve kur mallrat janë shitur me pakicë në ndonjë nga situatat e mëposhtme:

a) Me përjashtim nga detyrimi i importit për udhëtarët që shkojnë ose kthehen nga vende ose territore jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Me përjashtim nga detyrimi i importit për anëtarët e organizatave ndërkombëtare;

c) Me përjashtim nga detyrimi i importit për forcat e NATO;

ç) Me përjashtim nga detyrimi i importit sipas marrëveshjeve diplomatike apo konsullore;

d) Në distancë, përfshirë edhe përmes internetit.

Neni 632
Ambientet e magazinimit të pajisura posaçërisht
(Shkronja "b", e pikës 1, të nenit 192, të Kodit)

Kur mallrat paraqesin rrezik ose ka mundësi të dëmtojnë mallrat e tjera apo kërkojnë kushte të veçanta për arsye të tjera, në autorizimet për funksionimin e ambienteve për magazinim doganor të mallrave mund të specifikohet se mallrat mund të magazinohen vetëm në ambientet e magazinimit, të pajisura posaçërisht për mbajtjen e tyre.

Neni 633
Tipet e magazinave
(Shkronja "b", e pikës 1, të nenit 192, të Kodit)

Në autorizimet për funksionimin e ambienteve për magazinimin doganor të mallrave duhet të përcaktohet se cili nga tipet e mëposhtme të magazinave doganore duhet të përdoret nën secilin autorizim:

a) magazinë doganore publike e tipit I;
b) magazinë doganore publike e tipit II;
c) magazinë doganore private.

Seksioni 2
Magazinat doganore private-dyqane të çliruara nga detyrimet (*duty free shop*)

Neni 634
Kushtet e përgjithshme për pajisjen me autorizim
(Nenet 192, pika 1, shkronja "b", 28 dhe 213, pika 2, të Kodit)

1. Pa rënë ndesh me dispozitat e këtij seksioni, dispozitat lidhur me regjimin e magazinimit doganor, të referuara në këtë vendim zbatohen edhe për qëllime të këtij seksioni.

2. Çdo person i vendosur në Republikën e Shqipërisë mund të aplikojë për marrjen e një autorizimi për dyqan *duty free shop*, me kusht që të përmbushë kushtet si dhe detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në legjislacionin në fuqi.

3. Përfitimi i autorizimit për dyqan *duty free shop* kushtëzohet nga:

a) garantimi i detyrimeve dhe pagesave të tjera, përmes një garancie bankare, jo më të vogël se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) përdorimi nga mbajtësi i autorizimit i sistemeve kompjuterike të përpunimit të të dhënave për paraqitjen e deklarimeve dhe njoftimeve doganore elektronike në sistemin informatik të doganës apo në sisteme specifike të krijuara për këtë qëllim, duke zbatuar dispozitat përkatëse lidhur me këto teknika apo sisteme.

c) përdorimi i sistemeve të monitorimit me videokamera. Mbajtësi i autorizimit *duty free shop*, për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli nga autoritetet doganore është i detyruar që më shpenzimet e tij të bëjë instalimin, vendosjen, mirëmbajtjen, furnizimin me energji të pandërprerë etj. të sistemeve mbikëqyrëse me videokamera dhe të sigurojë transmetimin *online* dhe ruajtjen e pacenuar të imazheve të regjistruara nga sistemet mbikëqyrëse me videokamera. Sitemi i videokamerave duhet të mundësojë kontrollin e perimetrit të jashtëm të magazinave *dyty free shop*, si dhe ambientet e brendshme të tyre. Mbajtësi i autorizimit siguron të gjitha pajisjet e nevojshme për autoritetet doganore, shikueshmërinë *online* të imazheve dhe ruajtjen e imazheve për një periudhë të paktën prej tre muajsh. Në rast se ka filluar procedura hetimore/gjyqësore, këto imazhe ruhen deri në përfundim të procesit hetimor dhe/ose gjyqësor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përcakton këndet e pozicionimit të kamerave në këto ambiente;

ç) përdorimi i sistemit të skanimit të inventarit si në hyrje dhe në dalje;

d) përdorimi i sistemit të skanimit të *Bording pass* dhe "Pasaportës", të pasagjerëve/blerës që udhëtojnë nga ajri apo deti, për *duty free shop* që kërkohet të hapen në aeroportet për fluturime ndërkombëtare dhe portet për destinacionet ndërkombëtare.

4. Mbajtësi i autorizimit duhet të përmbushë në vazhdimësi kushtet dhe kriteret e përcaktuara, pa cenuar detyrimet dhe rregullat mbi lindjen e një borxhi doganor.

5. Mbajtësi i autorizimit duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe rregullat e përcaktuara në autorizim në lidhje me kontrollin doganor, çlirimin e mallrave, regjistrat e magazinimit të mallrave dhe dispozita të tjera relevante. Në rast se nuk përmbushen të gjitha këto kushte, kjo gjë sjell revokimin e menjëhershëm të autorizimit dhe për të gjitha mallrat e ruajtura në këtë magazinë duhet t'u caktohet menjëherë një destinacion doganor.

6. Mbajtësi i autorizimit duhet të informojë ministrin përgjegjës për financat dhe Drejtorinë e

Përgjithshme të Doganave për të gjithë faktorët e dalë pas dhënies së autorizimit të cilët mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

7. Mbajtësi i autorizimit duhet të plotësojë të gjitha kushtet e punës për autoritetet doganore kur ata vijnë për kontroll, pa asnjë shpenzim nga këto të fundit. Ambientet e punës të ofruara autoriteteve doganore duhet të plotësojnë standardet e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 635
Aplikimi
(Pika 1, e nenit 27, të Kodit)

1. Aplikuesi për të përfituar autorizimin për magazinë doganore private (*duty free shop*), paraqet aplikimin pranë Zyrës Doganore kufitare, ku mendohet të vendoset/të hapet dyqani i çliruar nga detyrimet" (*duty free shop*).

2. Aplikimi bëhet me shkrim sipas aneksit 13, të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Aplikimi duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme (në formë shkresore dhe elektronike "CD"):

a) Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit i cili vërteton gjendjen e shoqërisë dhe statusin e saj, i cili duhet të jetë aktiv;

b) Dokumentet e pronësisë ose kontratës së qirasë për ambientin/godinën që do të përdoret për këtë qëllim;

c) Vërtetim nga Ministria e Drejtësisë, që nuk është dënuar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit ndonjë nga personat e mëposhtëm:

i. Aplikuesi;

ii. Aksionerët e shoqërisë në rast se operatori ekonomik aplikues, është një shoqëri aksionare;

iii. Personi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore,

iv. Personeli që do të operojë në magazinë / dyqanin *duty free* (përgjegjësi, shitësi /t, mirëmbajtësi/t etj.);

ç) Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që shoqëria (Operatori ekonomik aplikues), administratori dhe aksionarët e shoqërisë (në rast se operatori ekonomik aplikues është një shoqëri aksionare), nuk kanë detyrime tatimore të papaguara dhe nuk kanë kryer shkelje në fushën e tatimeve për një periudhë trevjeçare nga data e lëshimit të vërtetimit;

d) Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që shoqëria (Operatori ekonomik aplikues), administratori dhe aksionarët e shoqërisë (në rast se operatori ekonomik aplikues është një shoqëri aksionare) nuk kanë detyrime doganore të papaguara dhe nuk kanë kryer shkelje në fushën doganore dhe të akcizës për një periudhë trevjeçare nga data e lëshimit të vërtetimit;

dh) Planbiznesin, ku argumentohet qarkullimi vjetor i parashikuar, si dhe numri/lista e mallrave, që do të tregtohen;

e) Planin e organizimit të punës dhe listën e personelit që do të operojë në magazinë/dyqanin *duty free*, që do të ndjekë zbatimin e këtij plani. Listës duhet t'i bashkëlidhet kopje e letërnjoftimeve të personelit;

ë) Planin e menaxhimit të fluksit të udhëtarëve dhe masat që parashikohen për të garantuar pengimin e rifutjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të udhëtarëve që mbartin mallra të blera në dyqanin *duty free shop;*

f) Të dhëna mbi sistemin e skanimit të inventarit si në hyrje dhe në dalje;

g) Të dhëna mbi sistemin e skanimit të *Bording pass* dhe "Pasaportave" të pasagjerëve/blerës që udhëtojnë nga ajri apo deti;

gj) Genplani/planvendosje të dyqanit dhe vendit të magazinimit, kushteve të ruajtjes së sigurisë së mallrave në këto mjedise, mundësinë e mbikëqyrjes nga autoriteti doganor dhe zyra /ambienti që i ofrohet këtij të fundit në rast nevoje;

h) Garanci bankare për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në shumën 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

i) Të gjithë projektet/planet kur ambienti /godina nuk janë ekzistuese, të cilat sigurojnë plotësimin e të gjitha kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë kre.

4. Aplikimi duhet t'i referohet dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë në origjinal apo kopje të noterizuara të origjinalit, si prova mbështetëse apo dokumente që kane lidhje me hollësitë e dhëna në aplikim, paraqitja e të cilave nevojitet për vlerësimin e aplikimit dhe të plotësimit të kushteve e të kritereve.

5. Aplikimi shoqërohet nga dokumente shtesë në të cilat jepet informacion provues mbi plotësimin e kushteve dhe kërkesave të përcaktuara

në këtë vendim. Të gjitha këto dokumente, prova apo fletë shtesë konsiderohen pjesë përbërëse e aplikimit që ato shoqërojnë. Në aplikim shënohet edhe numri i anekseve.

Neni 636
Procedurat përpara dhënies së autorizimit
(Neni 27, pika 1, dhe 213 të Kodit)

1. Zyra doganore, me marrjen e aplikimit përmes sektorit që administron regjimet doganore, verifikon informacionin e paraqitur. Kur konstatohet se aplikimi nuk përmban të gjitha të dhënat/dokumentet/informacionet e kërkuara, zyra doganore, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit i kërkon aplikuesit (operatorit ekonomik) të plotësojë të dhënat /dokumentet /informacionet e duhura, duke i dhënë edhe arsyet e kësaj kërkese. Personi i interesuar duhet të plotësojë informacionin brenda 15 ditësh nga data e marrjes së kësaj kërkese, në të kundërt aplikimi konsiderohet i refuzuar dhe personi i interesuar mundet të aplikojë si për herë të parë.

2. Zyra doganore, brenda 30 ditësh nga data e konstatimit se plotësohen të gjitha kushtet dhe dokumentacioni/ informacionet e sipër-përmendura procedon me:

a) verifikimin në vend (kur ambienti/godina janë ekzistuese) të vendndodhjes/ambienteve të dyqanit. Vendndodhja e dyqanit duhet të sigurojë hapësira të mjaftueshme të lëvizjes në dalje nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe duhet të jetë mbas mjediseve të kryerjes së veprimeve me policinë dhe doganën; Korsia e rrugës drejt *duty free shop* duhet të jetë e ndarë në mënyrë të tillë që të mos lejojë aksesin drejt saj të udhëtarëve që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) analizimin e nevojave në bazë të fluksit të udhëtarëve;

c) kushtet e ruajtjes së sigurisë së mallrave në këto ambiente, numrin e dyerve dhe mundësinë e plumbosjes, mbylljen e dritareve etj., (kur ambienti /godina janë ekzistuese) dhe përshtatshmërinë e vendosjes dhe projektit në rastin kur ambienti/godina do të ndërtohet e re;

ç) mundësinë e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit, inventarizimit të mallrave etj. nga autoritetet doganore;

d) verifikimin e vërtetësisë (kur gjykohet e arsyeshme) e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik;

dh) verifikimin e plotësimit të kushtëzimeve të përgjithshme sipas përcaktimeve të neneve 634 dhe 635.

3. Kur konstatohen mosvërtetësi të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, aplikimi refuzohet dhe zyra doganore duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e përcaktuar në legjislacionin në fuqi, përfshirë këtu edhe kallëzimin penal, kur është rasti.

4. Kur zyra doganore konstaton parregullsi, i kërkon aplikuesit që të plotësojë apo të rregullojë situatën duke marrë masat e duhura brenda një periudhe kohore prej 15 ditësh. Zyra doganore, në varësi të rrethanave dhe specifikave të ambientit për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli, mund të kërkojë dokumentacion shtesë apo të vendosë kushte të tjera përtej atyre të përcaktuara në këtë vendim.

5. Brenda 15 ditësh nga përfundimi i procesit të verifikimit apo përfundimi i afatit për rregullimin e situatës, zyra doganore e përcjell të gjithë dokumentacionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, së bashku me një relacion ku sqarohet në mënyrë të detajuar e gjithë procedura e ndjekur deri në këtë moment, përfundimin e verifikimeve të kryera, opinionin e zyrës doganore lidhur me mundësinë e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit etj. në rast të dhënies së autorizimit, plotësimit ose jo të masave shtesë të kërkuara aplikuesit etj.

6. Brenda 60 ditëve nga data e dorëzimit të dokumentacionit nga zyra doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shqyrton dokumentacionin e ardhur. Në shqyrtimin e dokumentacionit përfshihet edhe vizita dhe mbikëqyrja/testimi në vend se si parashikohet të funksionojë dyqani *duty free shop* sipas aplikimit të propozuar nga aplikuesi (kur ambienti/godina janë ekzistuese).

7. Kur konstatohen parregullsi, pamundësi mbikëqyrjeje/kontroll ose gjenden me vend rekomandimet e zyrës doganore lidhur me kushtet apo kërkesat e paplotësuara nga aplikuesi, aplikimi refuzohet dhe i gjithë dokumentacioni i kthehet zyrës doganore që e ka dërguar në mënyrë që kjo e fundit t'ia komunikojë aplikuesit. Aplikuesi, brenda 30 ditësh nga data e marrjes së njoftimit, ka të drejtë t'i drejtohet ministrit përgjegjës për financat me një ankim të arsyetuar lidhur me këtë refuzim duke paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur që e mbështet atë, përfshirë edhe provat nëse i ka

plotësuar apo jo masat shtesë të kërkuara nga autoritetet doganore.

8. Kur konstatohet se aplikimi është i rregullt dhe në përputhje me kushtet dhe kërkesat e këtij vendimi si dhe legjislacionin doganor në fuqi si dhe konkludohet mbi mundësinë për mbikëqyrje dhe kontroll të magazinës doganore private *(duty free shop*), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e përcjell të gjithë dokumentacionin pranë Ministrisë përgjegjës për financat, së bashku me një opinion të sajin lidhur me plotësimin e kushteve, kritereve, kërkesave nga ana e aplikuesit.

Neni 637
Dhënia e autorizimit
(Neni 27, pika 1, dhe 213 të Kodit)

1. Ministri përgjegjës për financat, brenda 60 ditësh nga data e depozitimit të ankimit sipas përcaktimit të pikës 7, të nenit 636, apo dorëzimit të dokumentacionit sipas përcaktimit të pikës 8, të nenit 636, në Ministrinë përgjegjëse për financat, miraton ose jo autorizimin, duke njoftuar aplikuesin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Në rastin e mosmiratimit të autorizimit, ministri përgjegjës për financat shpjegon arsyet e refuzimit si dhe të drejtën e ankimit në gjykatën administrative kompetente.

3. Brenda 10 ditësh nga data e marrjes së njoftimit për dhënien e autorizimit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kryen aktivizimin në sistemin kompjuterik të fillimit të funksionimit të dyqanit *duty free shop*.

4. Në rastet kur kemi të bëjmë me ambiente/godina joekzistuese, pra aplikuesi ka paraqitur vetëm projekte të ambienteve/godinës dhe sistemeve e të mënyrës së menaxhimit të fluksit të udhëtarëve apo të skanimit të inventarit në hyrje/dalje si dhe *bording pass* apo "pasaportave" në aeroporte dhe porte, autorizimi jepet jodefinitiv (provizor) dhe nuk aktivizohet, por thjesht shërben si dokument mbështetës për aplikuesin për të marrë lejet e nevojshme për realizimin e projektit.

5. Me përfundimin e projektit, aplikuesi informon për këtë zyrën doganore ku është bërë aplikimi, duke paraqitur të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 635, të rifreskuar dhe që nga ky moment fillojnë të ndiqen të gjithë hapat dhe afatet e përcaktuara në nenin 636. Ministri përgjegjës për financat, shprehet për miratimin definitiv të këtij autorizimi dhe njofton për këtë qëllim aplikuesin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Aktivizimi i autorizimit bëhet sipas pikës 3, të këtij neni, kur është rasti.

Neni 638
Afati dhe numri i autorizimeve
(Neni 27, pika 1, dhe 213 të Kodit)

1. Për qëllime sigurie, mbikëqyrjeje dhe kontrolli, magazinat doganore private *(duty free shop),* do të lejohen*:*

a) në aeroportet për fluturime ndërkombëtare, maksimumi 2 (dy) *duty free shop;*

b) në portin e Durrësit për destinacionet ndërkombëtare brenda zonës, 1 (një) *duty free shop*;

2. Autorizimi për magazinat doganore private (*duty free shop*) është i vlefshëm për 5 vjet, me të drejtë rinovimi. Minimumi 60 ditë përpara përfundimit të afatit 5-vjeçar, ministri përgjegjës për financat duhet të njoftojë mbajtësin e autorizimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave lidhur me mosrinovimin e autorizimit. Nëse ministri përgjegjës për financat nuk njofton mbajtësin e autorizimit, atëherë rinovimi konsiderohet i mirëqenë.

3. Në përfundim të afatit të autorizimit dhe nëse autorizimi nuk rinovohet, të gjitha mallrave në dyqanet *duty free shop* duhet t'u jetë dhënë një destinacion.

Neni 639
Përgjegjësitë e mbajtësit të autorizimit për magazinë "duty free shop"
(Nenet 28 dhe 213 të Kodit)

Operatori ekonomik që autorizohet për magazinë doganore të tipit (*duty free shop*) ka këto përgjegjësi:

a) Përgjigjet për mallrat e magazinuara në ambientet e autorizuara si "duty free shop".

b) Merr aprovimin paraprak nga autoritetet doganore për çdo ndryshim strukturor në ambientet e autorizuara si "duty free shop".

c) Merr masat për sigurinë e mjediseve të "duty free shop".

ç) Siguron që të gjitha hyrje/daljet në dhe nga "duty free shop" të jenë të sigurta.

d) Vepron në përputhje me përcaktimet e legjislacionit doganor apo tatimor lidhur me regjimin e magazinës doganore dhe/ose regjime apo procedura të tjera të nevojshme sipas rastit si

dhe zbaton gjithashtu rregullat e kushtet e tjera të vendosura prej autoriteteve doganore për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli.

dh) Mirëmban dhe përditëson të dhënat e inventarit dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve doganore sa herë që kërkohen për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli.

e) Informon zyrtarisht me shkrim, pa vonesë, zyrën doganore mbikëqyrëse, nëse konstaton mospërputhje mes stokut faktik në magazinën "duty free shop" dhe stokut sipas sistemit të skanimit të inventarit (elektronik) të kësaj magazine.

Neni 640
Pezullimi i autorizimit
(Nenet 28 dhe 213 të Kodit)

1. Një autorizim për dyqan *"duty free shop"* pezullohet nga ministri përgjegjës për financat kur:

nga Ministria përgjegjëse për financat apo autoritetet doganore zbulohen mospërputhje me përcaktimet e neneve 634, 635 dhe 636;

a) Ministria përgjegjëse për financat apo autoriteti doganor ka arsye të mjaftueshme të besojë që një veprim, i cili mund të shkaktojë procedim penal lidhur me shkelje të legjislacionit doganor, akcizës apo atë tatimor, është kryer nga mbajtësi i autorizimit, aksionarët e shoqërisë në rast se operatori ekonomik aplikues është një shoqëri aksionare a personi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore.

2. Para marrjes së vendimit, ministri përgjegjës për financat ia komunikon konstatimet mbajtësit të autorizimit. Mbajtësi i autorizimit ka të drejtë të korrigjojë situatën dhe/ose të shprehë qëndrimin e tij brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

3. Nëse mbajtësi i autorizimit nuk e rregullon situatën e përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, brenda 30 ditësh, ministri përgjegjës për financat njofton mbajtësin e autorizimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave që autorizimi për dyqan *duty free shop* pezullohet për një periudhë kohore prej 30 ditësh për t'i mundësuar mbajtësit të autorizimit të marrë masat e kërkuara për të rregulluar situatën.

4. Në rastet e referuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, ministri i përgjegjës për financat pezullon autorizimin deri në fund të procedimit në gjykatë. Ai njofton mbajtësin e autorizimit për këtë qëllim dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

5. Kur mbajtësi i autorizimit nuk është në gjendje të rregullojë situatën brenda 30 ditësh, por mund të japë prova që kushtet mund të përmbushen nëse shtyhet periudha e pezullimit, ministri përgjegjës për financat pezullon autorizimin për një periudhë tjetër prej 30 ditësh kalendarike. Për këtë qëllim njoftohet mbajtësi i autorizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

6. Gjatë periudhës së pezullimit të autorizimit, magazina doganore private *duty free shop* mbyllet/plumboset nga zyra doganore mbikëqyrëse. Vetëm nën mbikëqyrjen e zyrës doganore dyqani *duty free shop* mundet të hapet dhe mbajtësi i autorizimit mund të kryejë vetëm veprime që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e dyqanit apo mallrave si dhe t'u japë destinacion tjetër mallrave që janë në prag të skadencës.

Neni 641
Heqja e pezullimit
(Nenet 28 dhe 213 të Kodit)

1. Kur mbajtësi i autorizimit vlerësohet se ka marrë masat e nevojshme për të plotësuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për autorizimin e "duty free shops", ministri përgjegjës për financat heq pezullimin dhe informon mbajtësin e autorizimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Pezullimi mund të hiqet përpara përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikat 4 ose 6, të nenit 640.

2. Nëse mbajtësi i autorizimit dështon të marrë masat e nevojshme brenda periudhës kohore të pezullimit të parashikuar në pikën 4 ose 6, të nenit 640, zbatohet neni 643.

Neni 642
Pezullimi me kërkesë
(Nenet 28 dhe 213 i Kodit)

1. Kur mbajtësi i një autorizimi nuk është në gjendje të përmbushë përkohësisht ndonjë nga kushtet dhe kriteret e përcaktuara për një autorizim për magazinë doganore private (*duty free shop*), ai mund të kërkojë pezullimin e autorizimit. Në raste të tilla, mbajtësi i një autorizimi njofton ministrin përgjegjës për financat dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duke specifikuar datën kur ai do të jetë në gjendje të përmbushë kushtet dhe kriteret përsëri. Ai, gjithashtu, njofton për masat e planifikuara dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre.

2. Nëse mbajtësi i një autorizimi dështon të rregullojë situatën brenda periudhës kohore të përcaktuar në njoftimin e tij, ministri përgjegjës për financat mund të autorizojë një shtyrje të arsyeshme, me kusht që mbajtësi i autorizimit të ketë vepruar me vullnet të mirë. Për këtë qëllim njoftohet mbajtësi i autorizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 643
Revokimi
(Nenet 32 dhe 213 të Kodit)

1. Autorizimi për magazinë doganore private (*duty free shop*) revokohet nga ministri përgjegjës për financat në rastet e mëposhtme:

Kur mbajtësi i autorizimit dështon të rregullojë situatën e referuar në pikën 4, të nenit 640, dhe në pikën 1, të nenit 642;

a) Kur janë identifikuar në mënyrë të përsëritur raste kundërvajtjeje në plotësimin e kushteve për hyrje-daljen e mallrave dhe regjistrimin e tyre;

b) Kur janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura në lidhje me legjislacionin doganor, akcizën apo atë tatimor nga mbajtësi i autorizimit ose personat e tjerë të përcaktuar në në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 640 dhe kur ka shteruar e drejta e ankimimit;

ç) Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit.

2. Ministri përgjegjës për financat mund të vendosë revokimin e një autorizimi për magazinë doganore private (*duty free shop),* kur kjo e fundit nuk përdoret në masën e mjaftueshme për të justifikuar ekzistencën, sepse nuk justifikohet me fluksin e udhëtarëve, i cili ka rënë me 40% nga viti i parë i fillimit të aktivitetit në magazinën doganore private *(duty free shop*).

3. Revokimi i njoftohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe mbajtësit të autorizimit duke i shpjeguar arsyet e revokimit si dhe të drejtën e ankimit në gjykatën administrative kompetente.

4. Brenda 15 ditësh nga data e marrjes së njoftimit të revokimit, mallrave në dyqanet *duty free shop* duhet t'u jetë dhënë një destinacion doganor.

Neni 644
Anulimi
(Nenet 31 dhe 213 të Kodit)

1. Ministri i përgjegjës për financat, anulon një autorizim për magazinë doganore private (*duty free shop)*, në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Autorizimi është dhënë bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë;

b) Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i pasaktë ose i paplotë.

2. Personi, ndaj të cilit është dhënë autorizimi, duhet të njoftohet për anulimin e tij.

3. Anulimi i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit fillestar, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin doganor, në vendim specifikohet ndryshe.

Neni 645
Mallrat që lejohet të magazinohen
(Nenet 28 dhe 213 të Kodit)

Lejohet të magazinohen në magazinë doganore private *(duty free shop*):

a) mallra joshqiptare të llojit të mëposhtëm:

i. çokollata dhe ëmbëlsira të tjera;

ii. parfume, prodhime kozmetike dhe kolonjë;

iii. pajisje për përdorim personal të llojit që normalisht mbahet me vete, p.sh. kollare, shall, orë, bizhuteri, lapsa, çakmak, çanta, portofola etj.;

iv. punime artizanale dhe suvenire;

v. pije alkoolike, verë dhe birrë;

vi. duhan dhe produkte duhani.

b) mallra shqiptare të pataksueshme të llojit të mëposhtëm:

i. çokollata dhe ëmbëlsira të tjera;

ii. parfume, prodhime kozmetike dhe kolonjë;

iii. pajisje për përdorim personal të llojit që normalisht mbahet me vete, p.sh. kollare, shall, orë, bizhuteri, lapsa dhe çakmak, çanta, portofola etj.;

iv. punime artizanale dhe suvenire;

v. pije alkoolike, verë dhe birrë;

vi. duhan dhe produkte duhani.

Neni 646
Hyrja/dalja e mallrave në/nga dyqanet *duty free shop*
(Nenet 28 dhe 213 të Kodit)

1. Dyqanet *duty free shop* mund t'u shesin mallra vetëm udhëtarëve që largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, kundrejt pagesës në valutë të huaj ose të shumës së konvertuar në lekë.

2. Në dyqanet *duty free shop* zbatohen të gjitha ndalimet apo kufizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Me qëllim mbikëqyrjen e regjimit të daljes së mallrave nga *duty free shop,* periodikisht të hënën e parë të çdo muaji bëhet deklaratë përmbledhëse eksporti për mallrat e shitura.

4. Për mallrat shqiptare që hyjnë në një dyqan *duty free shop* duhet të paraqitet një deklaratë në zyrën doganore mbikëqyrëse.

5. Kur hyrja e mallrave shqiptare në një dyqan *duty free shop* ka nevojë të vërtetohet, autoritetet doganore mbikëqyrëse të *duty free shop* mund të firmosin dhe të vulosin faturën e mallrave nëse një gjë e tillë i kërkohet nga personi i interesuar.

Neni 647
Kufizime specifike në shitje
(Neni 213 i Kodit)

1. Dyqanet *duty free shop* mund të shesin cigare vetëm me konfeksion "stekë" e cila të ketë të shënuar në karton mbishkrimin *for duty free sales only.*

2. Ndalohet shitja në dyqanet *duty free shop* e cigareve në paketa dhe *master box.*

3. Ndalohet shitja me shumicë në dyqanet *duty free shop* e produkteve të tjera.

Neni 648
Kontrolle specifike në shitje në *duty free shops*
(Neni 213 i Kodit)

1. Zyra doganore kompetente për mbikëqyrjen e *duty free shop* çdo muaj bën rakordimin midis pasaportave të skanuara, kuponit tatimor dhe bazës të të dhënave të personave që hyjnë e dalin në/dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë (TIMS).

2. Në rast të mospërputhjes së këtyre të dhënave apo tejkalimit të sasive të shitura bazuar në fluksin e udhëtarëve dhe sasive të lejuara në shitje për çdo udhëtar sipas produkteve specifike, zyra doganore njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila më pas informon menjëherë ministrin e përgjegjës për financat.

KREU 4
Përdorimi i veçantë

Seksioni 1
Lejimi i përkohshëm

Nënseksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 649
Dispozita të përgjithshme për përdorimin e regjimit
(Shkronja "a", të pikës 1, të nenit 192, të Kodit)

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, autorizimet për përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm duhet të jepen me kusht që gjendja e mallrave të vendosura nën regjim të mbetet e njëjtë.

Megjithatë, pranohen riparimet dhe mirëmbajtja, duke përfshirë rregullimet dhe përshtatjet apo masat për të ruajtur mallrat ose për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat teknike për përdorimin e tyre nën regjim.

Neni 650
Vendi për paraqitjen e aplikimit
(Pika 1, e nenit 27, të Kodit)

1. Duke anashkaluar paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 27, të Kodit, aplikimi për autorizim për lejim të përkohshëm duhet të paraqitet pranë autoritetit doganor kompetent për vendin ku mallrat do të hyjnë ose do të përdoren.

2. Duke anashkaluar paragrafin e tretë, të pikës 1, të nenit 27, të Kodit, kur një aplikim për autorizim për lejim të përkohshëm është bërë me anë të një deklarate doganore me gojë në përputhje me nenin 305, një veprim në përputhje me nenin 309 ose me një Carnet ATA ose Carnet CPD në përputhje me nenin 531, aplikimi do të bëhet në vendin ku mallrat janë paraqitur dhe deklaruar për lejim të përkohshëm.

3. Policisë Kufitare dhe Migracionit i delegohet e drejta për vendosjen nën regjimin e lejimit të përkohshëm të automjeteve rrugore për përdorim privat, të cilat plotësojnë kushtet për dhënien e këtij regjimi.

Vendosja nën këtë regjim, si rast specifik, bëhet nëpërmjet regjistrimit në rrugë elektronike, në sistemin TIMS.

Mbikëqyrja dhe mbyllja e këtij regjimi bëhen nga autoritetet doganore, në bashkëpunim me Policinë

Kufitare dhe Migracionit, sipas kompetencave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 651
Lejimi i përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit
(Nenet 192, pika 1, dhe 223, pika 2, shkronja "ç", të Kodit)

1. Autorizimi për përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit jepet në lidhje me mallrat të cilat nuk i plotësojnë të gjitha kërkesat përkatëse për përjashtim të plotë nga detyrimi i importit të përcaktuara në nenet 654 deri në 661 dhe nenet 664 deri në 681.

2. Autorizimi për përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit, nuk jepet për mallrat për konsum.

3. Autorizimi për përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit jepet me kusht që shuma përkatëse e detyrimit të importit në përputhje me paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 225, të Kodit, të paguhet kur të jetë mbyllur regjimi.

Nënseksioni 2
Mjetet e transportit, paletat dhe kontejnerët përfshirë aksesorët dhe pajisjet e tyre

Neni 652
Dispozita të përgjithshme
(Pika 3, e nenit 192, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit mund të jepet për mallrat, siç referohet në nenet 653 deri në 656 dhe në nenin 658, dhe nëse aplikuesi dhe mbajtësi i regjimit janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 653
Paletat
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për paletat.

Neni 654
Pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për paletat
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për paletat kur ato janë importuar përkohësisht për t'u rieksportuar më vete ose si pjesë e paletave.

Neni 655
Kontejnerët
(Nenet 24, pika 2, dhe 223, pika 2, shkronja "ç", të Kodit)

1. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për kontejnerët kur kanë të shënuar në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm të gjithë informacionin e mëposhtëm:

a) Identifikimin e pronarit ose përdoruesit, të cilët mund të tregohen ose me emrin e tyre të plotë ose me një sistem të përcaktuar identifikimi, duke përjashtuar simbolet, si emblemat ose flamujt;

b) Shenjat identifikuese dhe numrat e kontejnerit, të vendosura nga pronari ose operatori;

c) Peshën e kontejnerit, duke përfshirë edhe të gjitha pajisjet e tij të fiksuara në mënyrë të përhershme.

Për kontejnerët transportues që përdoren në rrugë detare apo për ndonjë kontejner tjetër që përdor një prefiks standard ISO të përbërë nga katër shkronja të mëdha që përfundojnë me "U", identifikimi i pronarit ose i operatorit kryesor, numri serial i kontejnerit dhe shifra e kontrollit të kontejnerit duhet t'i përmbahen standardit ndërkombëtar ISO 6346 dhe anekseve të tij.

2. Kur aplikimi për autorizim është bërë në përputhje me pikën 1, të nenit 531, kontejnerët monitorohen nga një person i vendosur ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një përfaqësues në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Personi, sipas kërkesës i jep autoriteteve doganore, informacione të detajuara në lidhje me lëvizjet e secilit kontejner të cilit i është dhënë regjimi i lejimit të përkohshëm, duke përfshirë datat dhe vendet e hyrjes dhe të mbylljes së regjimit.

Neni 656
Pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për kontejnerë
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për kontejnerët kur ato janë importuar përkohësisht për t'u rieksportuar më vete ose si pjesë të kontejnerëve.

Neni 657
Kushtet për dhënien e përjashtimit të plotë nga detyrimi i importit për mjetet e transportit
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

1. Për qëllime të këtij neni, termi "mjete transporti" përfshin pjesë këmbimi normale, aksesorë dhe pajisje që shoqërojnë mjetet e transportit.

2. Kur mjetet e transportit janë deklaruar për lejim të përkohshëm me gojë në përputhje me nenin 305 ose me veprim tjetër në përputhje me nenin 309, autorizimi i jepet personit, i cili ka kontrollin fizik të mallrave në momentin e çlirimit të mallrave për regjimin e lejimit të përkohshëm, përveç rasteve kur ai person vepron në emër të një personi tjetër. Në këtë rast, autorizimi i jepet këtij të fundit.

3. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet edhe për mjetet e transportit rrugor, hekurudhor, ajror, detar dhe ujor të brendshëm, kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Janë të regjistruar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në emër të një personi të vendosur jashtë këtij territori ose kur mjetet e transportit nuk janë regjistruar dhe janë në zotërim të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Janë përdorur nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pa rënë ndesh me nenet 659, 660 dhe 661.

Kur mjetet e transportit janë përdorur privatisht nga një person i tretë i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit do të lejohet me kusht që ky person të jetë i autorizuar me shkrim nga mbajtësi i autorizimit.

Neni 658
Pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për mjetet e transportit që janë joshqiptare
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për pjesë të këmbimit, aksesorët dhe pajisjet për mjetet e transportit në rastet kur ato janë importuar përkohësisht për t'u rieksportuar më vete ose si pjesë të mjeteve të transportit.

Neni 659
Kushtet për dhënien e përjashtimit të plotë nga detyrimi i importit personave të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Personat e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, përfitojnë nga përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit, në rastet kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Në rastin e mjeteve të transportit hekurudhor, ato vihen në dispozicion të personave të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas një marrëveshjeje përmes së cilës çdo person mund të përdorë mjetet hekurudhore të tjetrit;

b) Në rastin e mjeteve të transportit rrugor të regjistruar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, një rimorkio që lidhet me mjetin e transportit;

c) Kur mjetet e transportit përdoren në lidhje me një situatë emergjente;

ç) Kur mjetet e transportit përdoren nga një shoqëri profesionale me qira për qëllime rieksporti.

Neni 660
Përdorimi i mjeteve të transportit nga individët që kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

1. Individët, që kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, përfitojnë përjashtim të plotë nga detyrimi i importit në lidhje me mjetet e transportit që përdorin privatisht dhe herë pas here, me kërkesë të personit në emër të të cilit është regjistruar mjeti, me kusht që ky i fundit të jetë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në kohën e përdorimit.

2. Individët që kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, përfitojnë përjashtim të plotë nga detyrimi i importit në lidhje me mjetet e transportit që kanë marrë me qira sipas një kontrate të shkruar dhe e përdorin privatisht për një nga qëllimet e mëposhtme:

a) Për t'u kthyer në vendin e tyre të banimit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Për t'u larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Individët që kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, përfitojnë përjashtim të plotë nga detyrimi i importit në lidhje me mjetet e transportit, që përdorin për qëllime tregtare ose private me kusht që të jenë punësuar nga pronari, qiramarrësi ose marrësi me leasing i mjetit të transportit dhe që punëdhënësi të jetë i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Përdorimi privat i mjeteve të transportit lejohet për udhëtimet mes vendit të punës dhe vendbanimit të punonjësit ose me qëllim kryerjen e një detyre profesionale të punonjësit, siç përcaktohet në kontratën e punësimit.

Me kërkesë të autoriteteve doganore, personi që përdor mjetet e transportit, duhet të paraqesë një kopje të kontratës së punës.

4. Për qëllime të këtij neni:

a) përdorimi privat nënkupton çdo përdorim përveç atij tregtar të mjeteve të transportit;

b) përdorimi tregtar nënkupton përdorimin e mjeteve të transportit për transportin e personave për qëllime përfitimi ose transportin industrial apo tregtar të mallrave, qofshin me apo pa përfitim.

Neni 661
Përjashtimi nga detyrimi i importit në lidhje me mjetet e transportit në raste të tjera
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

1. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet kur mjetet e transportit regjistrohen përkohësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me qëllim rieksportimin në emër të:

a) një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) një individi i cili e ka vendbanimin e tij/të saj të zakonshëm brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe është duke transferuar vendbanimin e zakonshëm në një vend jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit, në raste të jashtëzakonshme mund të jepet për mjetet e transportit të përdorura për qëllime tregtare për një periudhë të kufizuar nga ana e personave të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 662
Afatet për mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm në rastin e mjeteve të transportit dhe kontejnerëve
(Pika 4, e nenit 195, të Kodit)

Mbyllja e regjimit të lejimit të përkohshëm në rastin e mjeteve të transportit dhe kontejnerëve bëhet brenda afateve të mëposhtme, duke filluar nga koha që mallrat janë vendosur në regjim:

a) për mjetet e transportit hekurudhor 12 muaj;

b) për mjetet e transportit për përdorim tregtar, përveç transportit hekurudhor, për periudhën që nevojitet për kryerjen e operacioneve të transportit;

c) për mjetet e transportit rrugor për përdorim privat:

i. nga studentët, për periudhën që ata qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për qëllimin e vetëm të ndjekjes së studimeve;

ii. nga persona të ngarkuar me detyra me kohëzgjatje të caktuar, për periudhën që qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me qëllimin e vetëm të plotësimit të detyrës së tyre;

iii. në raste të tjera, duke përfshirë kuajt e shalës apo kafshët e punës dhe mjetet e tërhequra prej tyre, 6 muaj;

ç) për mjetet e transportit ajror që përdoren privatisht, 6 muaj;

d) për mjetet transportit detar dhe ujor që përdoren privatisht, 18 muaj;

dh) për kontejnerët, pajisjet dhe aksesorët e tyre, 12 muaj.

Neni 663
Afatet kohore për rieksport në rastin e shërbimeve profesionale të qirasë
(Nenet 192, pika 1, dhe 195, pika 4, të Kodit)

1. Kur një mjet transporti ka qenë i importuar përkohësisht në Republikën e Shqipërisë me përjashtim të plotë nga detyrimi i importit në përputhje me nenin 657 dhe i është kthyer një

shoqërie shërbimi profesional të qirasë, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, rieksporti për mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm duhet të kryhet brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes së mjeteve të transportit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Kur mjeti i transportit merret sërish në përdorim nga shërbimi profesional i qirasë për një person të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ose për individë që e kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, rieksportimi që bën mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm duhet të kryhet brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes së mjeteve të transportit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe brenda tri javëve nga përfundimi i kontratës për rimarrje me qira.

Datë e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë konsiderohet të jetë data e lidhjes të kontratës së qiramarrjes, sipas së cilës mjeti i transportit është përdorur në kohën e hyrjes në këtë territor, përveç rastit kur provohet data aktuale e hyrjes.

2. Autorizimi për lejimin e përkohshëm të mjeteve të transportit për përdorim, siç përmendet në pikën 1, jepet me kusht që mjetet e transportit të rieksportohen.

3. Në rastin e referuar në pikën 2, të nenit 660, nëse mjeti i transportit është përdorur nga një individ për t'u kthyer në vendin e tij të banimit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose rieksportohet për t'u larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, brenda tre javëve nga data e lidhjes së kontratës së qiramarrjes ose kontratës së rimarrjes me qira, duhet t'i kthejë mjetin e transportit shoqërisë së shërbimit profesional të qirasë, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Nënseksioni 3
Mallra të ndryshme nga mjetet e transportit, paletat dhe kontejnerët

Neni 664
Sendet personale dhe mallrat për qëllime sportive të importuara nga udhëtarët
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet në lidhje me mallrat e importuara nga udhëtarët që janë banues jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Mallrat janë sende personale të nevojshme për udhëtim;

b) Mallrat janë të destinuara për t'u përdorur për qëllime sportive.

Neni 665
Materialet e nevojshme për detarët
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për materialet e nevojshme për detarët në rastet e mëposhtme:

a) Kur ato janë përdorur në një anije në trafikun ndërkombëtar detar;

b) Kur ato shkarkohen nga një anije e tillë dhe përdoren përkohësisht në breg nga ekuipazhi;

c) Kur ato janë përdorur nga ana e ekuipazhit të një anijeje të tillë në qendra kulturore ose sociale të menaxhuara nga organizata jofitimprurëse ose në vende kulti, ku mbahen rregullisht shërbimet fetare për detarët.

Neni 666
Materialet e ndihmave në raste fatkeqësish
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për materialet e ndihmave në raste fatkeqësish kur ato përdoren për përballimin e pasojave të fatkeqësive apo situatave të ngjashme që ndikojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Aplikuesi dhe mbajtësi i regjimit mund të jenë të vendosur brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 667
Pajisjet mjekësore, kirurgjikale dhe laboratorike
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për pajisjet mjekësore, kirurgjikale dhe laboratorike, të cilat janë dërguar hua me kërkesë të një spitali apo institucioni tjetër mjekësor i cili ka nevojë urgjente për pajisje të tilla për të plotësuar pamjaftueshmërinë e pajisjeve të veta si dhe kur ato përdoren për qëllime diagnostikimi ose terapeutike. Aplikuesi dhe mbajtësi i regjimit mund të jenë të vendosur brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 668
Kafshët
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për kafshët në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 669
Mallrat për përdorim në zonat kufitare
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mallrat e mëposhtme që kanë për qëllim përdorimin në zonat kufitare:

a) pajisjet në pronësi dhe të përdoruara nga persona të vendosur në një zonë kufitare të një vendi tjetër ngjitur me zonën kufitare të Republikës së Shqipërisë, ku do të përdoren mallrat;

b) mallrat e përdorura për projekte ndërtimi, riparimi ose mirëmbajtjeje të infrastrukturës së një zone të tillë kufitare në Republikën e Shqipërisë, nën përgjegjësinë e autoriteteve publike.

Neni 670
Mbajtëse audiovizive ose informacioni si dhe materiale reklame
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi nga detyrimi i importit jepet për mallrat e mëposhtme:

a) mbajtëse audiovizive (figure-zëri) ose informacioni që ofrohen pa pagesë dhe përdoren për qëllime të demonstrimit para tregtimit, të destinuara për të prodhuar kolona zanore, dublime ose riprodhime;

b) materiale të përdorura vetëm për qëllime reklame, përfshirë mjetet e transportit të pajisura posaçërisht për këto qëllime.

Neni 671
Pajisje profesionale
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

1. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për pajisje profesionale të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Janë në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Janë importuar ose nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose nga një i punësuar i tij, i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) Janë përdorur nga importuesi ose nën mbikëqyrjen e tij, përveç rasteve të bashkëprodhimeve audiovizive.

2. Duke anashkaluar pikën 1, përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për instrumentet muzikore portative të importuara përkohësisht nga udhëtarët me qëllim që të përdoren si pajisje profesionale. Udhëtarët mund të jenë banues brenda ose jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit nuk jepet në lidhje me pajisje profesionale të cilat përdoren, si më poshtë:

a) për prodhimin industrial të mallrave;

b) për paketimin industrial të mallrave;

c) për shfrytëzimin e burimeve natyrore;

ç) për ndërtimin, riparimin ose mirëmbajtjen e ndërtesave;

d) për punime të tokës dhe punime të ngjashme.

Shkronjat "c", "ç" dhe "d" nuk zbatohen për veglat e dorës.

Neni 672
Materiali pedagogjik dhe pajisjet shkencore
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për materiale pedagogjike dhe pajisje shkencore në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Kur ato janë në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Kur ato importohen nga institucione shkencore publike ose private, mësimore apo të formimit profesional, jofitimprurëse dhe përdoren vetëm në mësimdhënie, formim profesional apo kërkime shkencore nën përgjegjësinë e institucionit importues;

c) Kur ato importohen në sasi të arsyeshme, duke pasur parasysh qëllimin e importit;

ç) Kur ato nuk janë përdorur për qëllime ekskluzivisht tregtare.

Neni 673
Paketimet
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mallrat e mëposhtme:

a) paketimet e importuara të mbushura me qëllim për rieksport, qoftë bosh ose të mbushura;

b) paketimet e importuara bosh me qëllim për rieksport të mbushura.

Neni 674
Format, stampat, kallëpet, vizatimet, skicat, instrumentet e matjes, kontrollit dhe testimit si dhe artikuj të tjerë të ngjashëm
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për format, stampat, kallëpet, vizatimet, skicat, instrumentet e matjes, kontrollit dhe testimit si dhe artikujt e tjerë të ngjashëm, në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Kur ato janë në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Kur ato janë përdorur në prodhim nga një person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe më shumë se 50% e prodhimit që rezulton nga përdorimi i tyre eksportohet.

Neni 675
Mjetet dhe instrumentet e posaçme
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mjetet dhe instrumentet e posaçme kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Kur ato janë në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Kur ato janë vënë në dispozicion të një personi të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për prodhimin e mallrave dhe më shumë se 50% e mallrave që rezulton nga përdorimi i tyre eksportohen.

Neni 676
Mallrat e përdorura për kryerjen e testeve apo që i nënshtrohen testeve
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mallrat në një nga situatat e mëposhtme:

a) Kur ato i nënshtrohen testeve, eksperimenteve apo demonstrimeve;

b) Kur ato i nënshtrohen një testi si kusht pranimi të parashikuar në kontratën e shitjes;

c) Kur ato janë përdorur për kryerjen e testeve, eksperimenteve apo demonstrimeve pa përfitim financiar.

Neni 677
Mostrat
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mostrat që përdoren vetëm për t'u ekspozuar ose demonstruar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që sasia e mostrave të jetë e arsyeshme duke pasur parasysh përdorimin.

Neni 678
Mjetet zëvendësuese të prodhimit
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mjetet zëvendësuese të prodhimit të cilat janë vënë përkohësisht në dispozicion të klientit nga furnizuesi ose riparuesi në pritje të dorëzimit ose riparimit të mallrave të ngjashme.

Neni 679
Mallrat për panaire ose për shitje në situata të caktuara
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

1. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mallrat që do të ekspozohen ose do të përdoren në një panair publik që nuk është organizuar ekskluzivisht për shitjen tregtare të mallrave ose për mallrat që janë marrë në evente të tilla nga mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Në raste të veçanta, autoritetet doganore mund të japin përjashtim të plotë nga detyrimi i importit për mallrat që do të ekspozohen ose do të përdoren në evente të tjera ose që janë marrë në këto evente të tjera nga mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

2. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për mallrat e dorëzuara nga pronari për provë te një person në Republikën e Shqipërisë, i cili ka të drejtën për t'i blerë ato pas kryerjes së provës.

3. Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për sa më poshtë:

a) veprat e artit, sendet e koleksionistëve dhe ato antike, siç përcaktohet në aneksin 72-04 të shtojcës A bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë

përbërëse e tij, të importuara për qëllime të ekspozitës, me synim shitjen e mundshme;

b) mallra të tjera, përveç atyre të sapoprodhuara që janë importuar me qëllim shitjen e tyre në ankand.

Neni 680
Pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit jepet për pjesët e këmbimit, aksesorët dhe pajisjet të cilat përdoren për riparim dhe mirëmbajtje, duke përfshirë ndreqjen, rregullimin dhe ruajtjen e mallrave të vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Neni 681
Mallra të tjera
(Shkronja "ç", e pikës 2, të nenit 223, të Kodit)

Përjashtimi i plotë nga detyrimi i importit mund të jepet për mallra të tjera, përveç atyre të referuara në nenet 653 deri në 661 dhe 664 deri në 680 apo që nuk janë në përputhje me kushtet e këtyre neneve, në njërën nga situatat e mëposhtme:

a) Mallrat importohen në mënyrë rastësore për një periudhë jo më shumë se tre muaj;

b) Mallrat janë importuar në situata të veçanta dhe duke mos sjellë asnjë efekt ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 682
Afate të posaçme për mbylljen e regjimit
(Pika 4, e nenit 195, të Kodit)

1. Për mallrat e referuara në shkronjën "c" të nenit 676, nenin 678, dhe pikën 2, të nenit 679, afati për mbyllje është 6 muaj nga momenti kur mallrat vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

2. Për kafshët e referuara në nenin 668, afati për mbyllje do të jetë jo më pak se 12 muaj nga momenti kur kafshët vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Neni 683
Mbyllja e regjimit të lejimit të përkohshëm në rastet që kanë të bëjnë me mjetet e transportit hekurudhor, paleta dhe kontejnerë
(Neni 195 i Kodit)

1. Për mjetet e transportit hekurudhor që përdoren bashkërisht në kuadrin e një marrëveshjeje midis transportuesve të Republikës së Shqipërisë dhe të vendeve të tjera që ofrojnë shërbime të transportit hekurudhor, regjimi i lejimit të përkohshëm mbyllet kur mjetet e transportit hekurudhor të llojit të njëjtë ose të njëjtës vlerë me ato të vëna në dispozicion të një personi të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, janë eksportuar ose rieksportuar.

2. Për paletat, regjimi i lejimit të përkohshëm mbyllet kur paleta e llojit të njëjtë apo të njëjtës vlerë si ato që kanë qenë të vendosura nën regjim, janë eksportuar ose rieksportuar.

3. Për kontejnerët, në përputhje me marrëveshjen për trajtimin doganor të kontejnerëve të përdorur në transportin ndërkombëtar, regjimi i lejimit të përkohshme mbyllet kur kontejnerët e llojit të njëjtë apo të njëjtës vlerë si ato që kanë qenë të vendosura nën regjim janë eksportuar ose rieksportuar.

Neni 684
Mbyllja regjimit për mallrat për ekspozita/panaire apo për shitje
(Neni 195 i Kodit)

Për qëllime të mbylljes së regjimit të lejimit të përkohshëm të mallrave të përmendura në pikën 1, të nenit 679, me përjashtim të mallrave të përmendura në nenin 1, të ligjit nr.61/2012, "Për akcizat në Republikës së Shqipërisë", konsumi i tyre, shkatërrimi apo shpërndarja falas për publikun në aktivitet do të konsiderohet si rieksportim me kusht që sasia e tyre të përputhet me natyrën e ekspozitës/panairit, numrin e vizitorëve dhe shkallën e pjesëmarrjes së mbajtësit të regjimit.

Neni 685
Të dhëna për t'u përfshirë në deklaratën doganore
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

1. Kur mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, më pas vendosen në një regjim doganor që mundëson mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm, në përputhje me pikën 1, të nenit 195, të Kodit, atëherë deklarata doganore për regjimin pasues doganor, përveç Carnet ATA/CPD, duhet të përmbajë edhe shënimin "LP" si dhe numrin përkatës të autorizimit, në rast se është e mundur.

2. Kur mallrat e vendosura në regjimin e lejimit të përkohshëm janë rieksportuar në përputhje me

pikën 1, të nenit 195, të Kodit, atëherë deklarata e rieksportit, përveç se Carnet ATA/CPD, duhet të përmbajë të dhënat e referuara në pikën 1.

Seksioni 2
Përdorimi i veçantë përfundimtar *(end-use*)

Neni 686
Detyrimi i mbajtësit të autorizimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use*)
(Shkronja "a", e pikës 1, të nenit 192, të Kodit)

Autorizimi për përdorimin e regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (*end-use)* jepet me kusht që mbajtësi i autorizimit të përmbushë njërin prej detyrimeve të mëposhtme:

a) Të përdorë mallrat për qëllimet e parashikuara për zbatimin e përjashtimit prej detyrimeve ose të normës së reduktuar të detyrimeve;

b) Për të transferuar detyrimin, siç referohet në shkronjën "a", te një person tjetër sipas kushteve të përcaktuara nga autoritetet doganore.

KREU 5
Përpunimi
Neni 687
Autorizimi
(Neni 192 i Kodit)

1. Autorizimi për regjimin e përpunimit duhet të plotësojë një nga masat e mëposhtme:

a) që produktet e përpunuara të jenë përftuar nga përpunimi i mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit;

b) që të jenë plotësuar kushtet për përdorimin e mallrave ekuivalente në përputhje me nenin 201 të Kodit ose sistemin e shkëmbimit standard në përputhje me nenin 234 të Kodit.

2. Autorizimi për përpunim aktiv mund të jepet për aksesorët e prodhimit në kuptim të shkronjës "d", të pikës 37, të nenit 6, të Kodit, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) Karburantet dhe burimet e energjisë, përveç atyre që nevojiten për kontrollin e produkteve të përpunuara ose evidentimin e defekteve në mallrat e vendosura në regjim dhe që kanë nevojë për riparim;

b) Lubrifikantet, përveç atyre që nevojiten për testimin, rregullimin apo deformimin e produkteve të përpunuara;

c) Pajisjet dhe mjetet.

3. Autorizimi për përpunim aktiv jepet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Mallrat nuk mund të rikthehen ekonomikisht pas përpunimit në gjendjen ose përshkrimin e tyre, ashtu siç kanë qenë kur u vendosën nën regjim;

b) Përdorimi i regjimit nuk mund të sjellë shmangien e rregullave në lidhje me origjinën dhe kufizimet sasiore të zbatueshme për mallrat e importuara.

Shkronja "a", e kësaj pike nuk zbatohet nëse shuma e detyrimit të importit është e përcaktuar në bazë të pikës 3, të nenit 81, të Kodit.

Neni 688
Të dhëna për t'u përfshirë në deklaratën doganore për përpunim aktiv
(Pika 2, e nenit 17, të Kodit)

1. Kur mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv apo produktet e përpunuara që përftohen prej tyre janë vendosur më pas në një regjim doganor që mundëson mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv në përputhje me pikën 1, të nenit 195, të Kodit, deklarata doganore për regjimin pasues doganor, pa përfshirë Carnet ATA/CPD, duhet të përmbajë shënimin "PA" dhe numrin përkatës të autorizimit ose numrin INF.

Kur mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv janë objekt i masave të politikave të veçanta tregtare dhe masa të tilla vazhdojnë të jenë të zbatueshme në kohën kur mallrat qoftë në formën e produkteve të përpunuara ose jo, janë vendosur në një regjim doganor pasues, deklarata doganore për regjimin doganor pasues duhet të përmbajë të dhënat e përmendura në paragrafin e parë, si dhe shënimin "MPT".

2. Kur mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv janë rieksportuar, në përputhje me pikën 1, të nenit 242, të Kodit, deklarata e rieksportit duhet të përmbajë të dhënat e përmendura në pikën 1.

Neni 689
Raste të veçanta mbylljes të përpunimit aktiv IM/EX
(Neni 195 i Kodit)

1. Për qëllime të mbylljes të regjimit të përpunimit aktiv IM/EX, të mëposhtmet do të konsiderohen si rieksportime:

a) produktet e përpunuara i janë dërguar personave që kanë të drejtë për t'u përjashtuar nga

detyrimi i importit në përputhje me Konventën e Vjenës të datës 18 prill 1961, mbi Marrëdhëniet Diplomatike, ose në Konventën e Vjenës të 24 prillit 1963, për Marrëdhëniet Konsullore, ose Konventën e Nju Jork-ut, më 16 dhjetor 1969, për misionet e posaçme, siç përmendet në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 184, të Kodit;

b) produktet e përpunuara i janë dërguar forcave të armatosura të vendeve të tjera të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur jepet përjashtimi nga detyrimet e importit në përputhje me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë";

c) furnizimi i avionëve;

ç) furnizimi i anijeve kozmike dhe pajisjeve përkatëse;

d) dërgimi i produkteve kryesore të përpunuara për të cilën detyrimi i importi *erga omnes* është i përjashtuar ose për të cilat është lëshuar një certifikatë vlefshmërie ajrore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) asgjësimi, në përputhje me dispozitat përkatëse, të produkteve dytësore të përpunuara, shkatërrimi i të cilave nën mbikëqyrjen doganore është i ndaluar për arsye mjedisore.

2. Pika 1 nuk zbatohet:

a) kur mallrat joshqiptare të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv IM/EX, janë objekt i masave të politikave bujqësore ose tregtare, detyrimi të përkohshëm ose përfundimtar anti-dumping, një mase kundërbalancuese, një mase mbrojtëse ose një detyrimi shtesë që rrjedhin nga pezullimi i përjashtimeve nëse do të ishin deklaruar për çlirim për qarkullim të lire;

b) kur lind një borxh doganor në përputhje me pikën 1, të nenit 73, të Kodit për mallrat joorigjinuese të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv IM/EX, nëse mbajtësi i autorizimit synon të rieksportojë produktet e përpunuara.

3. Në rastin e shkronjës "c", të pikës 1, zyra doganore mbikëqyrëse lejon mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv IM/EX pasi mallrat e vendosura nën regjim janë përdorur për herë të parë për prodhimin, riparimin duke përfshirë mirëmbajtjen, modifikimin apo shndërrimin e avionëve ose pjesëve të tyre, por me kusht që të dhënat e mbajtësit të regjimit janë të tilla që bëjnë të mundur verifikimin nëse regjimi është zbatuar në mënyre korrekte.

4. Në rastin e shkronjës "ç", të pikës 1, zyra e mbikëqyrjes doganore lejon mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv IM/EX pasi mallrat e vendosura nën regjim janë përdorur për herë të parë për prodhimin, riparimin duke përfshirë mirëmbajtjen, modifikimin apo shndërrimin e satelitëve hapësinor, anijet e tyre kozmike nisëse dhe pajisjet e stacionit bazë hapësinor dhe pjesët e tyre që janë pjesë integrale të sistemeve, me kusht që të dhënat e mbajtësit të regjimit janë të tilla që bëjnë të mundur verifikimin nëse regjimi është zbatuar në mënyre korrekte.

5. Në rastin e shkronjës "d", të pikës 1, zyra doganore e mbikëqyrjes lejon mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv IM/EX pasi mallrat e vendosura nën regjim janë përdorur për herë të parë në operacionet e përpunimit të produkteve të përpunuara e dërguara ose të pjesëve të tyre, por me kusht që të dhënat e mbajtësit të procedurës janë të tilla që bëjnë të mundur verifikimin nëse regjimi është zbatuar në mënyre korrekte.

6. Në rastin e shkronjës "dh", të pikës 1, mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv duhet të provojë se mbyllja e procedurës së përpunimit aktiv në përputhje me rregullat normale është ose e pamundur ose e parrealizueshme nga ana ekonomike.

Neni 690
Produktet e përpunuara apo mallrat që konsiderohet se janë çliruar për qarkullim të lirë
(Neni 195 i Kodit)

1. Kur autorizimi për regjimin e përpunimit aktiv IM/EX ka përcaktuar se prodhimet e përpunuara apo mallrat e vendosura nën regjim konsiderohen se janë çliruar për qarkullim të lirë, nëse nuk kanë qenë të vendosura nën një regjim doganor të më passhëm ose të rieksportuara në përfundim të afatit për mbyllje, deklarata doganore për çlirimin për qarkullim të lirë, do të konsiderohet të jetë paraqitur dhe pranuar dhe çlirimi është dhëne në datën e përfundimit të afatit për mbyllje.

2. Në rastet e përmendura në pikën 1, produktet apo mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv IM/EX do të konsiderohen mallrat shqiptare kur ato të hidhen në treg.

Neni 691
Përpunimi pasiv IM/EX
(Pika 1, e nenit 192, të Kodit)

1. Në rastin e përpunimit pasiv IM/EX, autorizimi duhet të specifikojë afatin brenda të cilit mallrat shqiptare, të cilat janë zëvendësuar nga mallrat ekuivalente, do të vendosen nën përpunimin pasiv. Ky afat nuk duhet t'i kalojë gjashtë muaj.

2. Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit, afati mund të zgjatet edhe pas mbarimit të tij, me kusht që afati në total të mos e kalojë një vit.

3. Në rast të importit paraprak të produkteve të përpunuara duhet të sigurohet një garanci për mbulimin e shumës së detyrimit të importit, e cila do të jetë e pagueshme në rast se mallrat shqiptare të zëvendësuara nuk do të vendoseshin nën përpunimin pasiv në përputhje me pikën 1.

Neni 692
Riparimi nën përpunimin pasiv
(Pika 1, e nenit 192, të Kodit)

Në rastet kur regjimi i përpunimit pasiv kërkohet për riparim, mallrat e eksportuara përkohësisht duhet të jenë të riparueshme dhe regjimi nuk mund të përdoret për të përmirësuar performancën teknike të mallrave.

TITULLI VIII
DALJA E MALLRAVE NGA TERRITORI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU 1
Formalitetet para daljes së mallrave

Seksioni 1
Afatet e paraqitjes dhe rastet kur nuk kërkohet paraqitja e një deklarate të paranisjes

Neni 693
Sistemi elektronik lidhur me daljet
(Pika 1, e nenit 17, të Kodit)

Për përpunimin dhe shkëmbimit e informacioneve në lidhje me daljen e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, do të përdoret sistemi elektronik i ngritur në përputhje me pikën 1, të nenit 17, të Kodit.

Paragrafi i parë i këtij neni do të zbatohet sipas Planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 694
Mallra që nuk mbulohen nga një deklaratë para-nisjes
(Neni 239 i Kodit)

Nëse konstatohet se mallrat që kanë për të dalë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, nuk janë të mbuluara nga një deklaratë paranisje, përveçse kur ky detyrim është hequr, dalja e mallrave duhet të shoqërohet nga një deklaratë e tillë.

Neni 695
Afati për paraqitjen e deklaratës të paranisjes
(Pika 1, e nenit 236, të Kodit)

1. Deklarata e paranisjes referuar nenit 236 të Kodit depozitohet në zyrën doganore kompetente, brenda afateve kohore të mëposhtme:

a) në rastin e trafikut detar:

i. për lëvizjet e ngarkesave me kontejnerë, përveç atyre të përmendura në nënndarjet "ii" dhe "iii", jo më vonë se 24 orë përpara se mallrat të ngarkohen në anijen me të cilën do të largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

ii. për lëvizjet e ngarkesave me kontejnerë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në drejtim të Groenlandës, Ishujve Faroe, Islandës apo porteve në Detin Baltik, Detin e Veriut, Detin e Zi apo të Mesdheut si dhe të gjitha porteve të Marokut, të paktën dy orë para nisjes nga porti i territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

iii. për lëvizjet që nuk përfshijnë ngarkesa në kontejnerë, të paktën 2 orë para nisjes nga porti i territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) në rastin e trafikut ajror, të paktën 30 minuta para nisjes nga aeroporti i territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) në rastin e trafikut rrugor dhe atij të brendshëm ujor, jo më vonë se një orë para se mallrat të largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

ç) në rastin e trafikut hekurudhor:

i. kur udhëtimi me tren nga stacioni i fundit i trenit për te zyra doganore e daljes zgjat më pak se dy orë, të paktën një orë para mbërritjes së mallrave në vendin për të cilin zyra doganore e daljes është kompetente;

ii. në të gjitha rastet e tjera, të paktën dy orë para se mallrat të largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Pavarësisht nga pika 1, kur deklarata e paranisjes ka të bëjë me mallra, për të cilat kërkohet rimbursim në përputhje me legjislacionin e posaçëm lidhur me rimbursimet për produktet bujqësore, ajo depozitohet në zyrën doganore kompetente jo më vonë se koha e ngarkimit të mallrave në përputhje me përcaktimet specifike të legjislacionit të posaçëm.

3. Në situatat e mëposhtme, afati i fundit për depozitimin e deklaratës së paranisjes është ai që zbatohet për mjetin aktiv të transportit të përdorur për t'u larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë:

a) kur mallrat kanë mbërritur në zyrën doganore të daljes me një mjet tjetër transporti nga i cili janë transferuar para se të largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë (transporti inter-modal);

b) kur mallrat kanë mbërritur në zyrën doganore të daljes me një mjet transporti i cili në vetvete është transportuar me një mjet aktiv transporti, në rastet kur largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë (transporti i kombinuar).

4. Afatet e referuara në pikat 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen në rastet e forcave madhore.

Neni 696
Përjashtim nga detyrimi për të paraqitur një deklaratë paranisjeje
(Shkronja "b", e pikës 2, të nenit 236, të Kodit)

1. Pa rënë ndesh me detyrimin për të depozituar një deklaratë doganore në përputhje me pikën 1, të nenit 146, të Kodit, apo një deklarate të rieksportit në përputhje me pikën 1, të nenit 242, të Kodit, depozitimi i një deklarate të paranisjes nuk kërkohet për mallrat e mëposhtme:

a) energjinë elektrike;

b) mallrat që dalin me tubacione;

c) artikujt e korrespondencës;

ç) mallrat e lëvizura sipas rregullave të akteve të Bashkimit Postar Universal;

d) pajisjet/sendet shtëpiake, siç përcaktohen në shkronjën "c", të nenit 399, me kusht që ato të mos jenë transportuar sipas një kontrate transporti;

dh) mallrat e ndodhura në bagazhin personal të udhëtarëve;

e) mallrat e referuara në pikën 1, të nenit 310, me përjashtim të rasteve kur kryhet në bazë të një kontrate transporti, të:

i. paletave, pjesëve të këmbimit, aksesorëve dhe pajisjeve për paleta;

ii. kontejnerëve, pjesëve të këmbimit, aksesorëve dhe pajisjeve për kontejnerët;

iii. mjeteve të transportit, pjesëve të këmbimit, aksesorëve dhe pajisjeve për mjetet e transportit;

ë) mallrat e mbuluara nga Carnet ATA dhe Carnet CPD;

f) mallrat e lëvizura sipas formularit 302 të parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut në lidhje me statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951;

g) mallrat e transportuara me anije që lëvizin mes porteve të Republikës së Shqipërisë pa ndaluar në asnjë port jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

gj) mallrat e transportuara me avion mes aeroporteve të Republikës së Shqipërisë pa ndaluar në asnjë aeroport jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

h) armët dhe pajisjet ushtarake të nxjerra jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nga autoritetet përgjegjëse të mbrojtjes ushtarake të Republikës së Shqipërisë, me transport ushtarak ose transport për përdorim vetëm të autoriteteve ushtarake;

i) mallrat e mëposhtme të nxjerra jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë direkt në instalimet në det të hapur që operohen nga një person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë:

i.1) mallrat që do të përdoren për ndërtimin, riparimin, mirëmbajtjen ose këmbimin e instalimeve në det të hapur;

i.2) mallrat që do të përdoren për të përshtatur ose pajisur instalimet në det të hapur;

i.3) furnizimet për t'u përdorur apo konsumuar në instalimet në det të hapur;

j) mallrat për të cilat përjashtimi prej detyrimeve mund të kërkohet në bazë të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të 18 prillit 1961, Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të datës 24 prill 1963, konventave të tjera konsullore ose Konventës së Nju Jorkut të datës 16 dhjetor 1969 për misione të posaçme;

k) mallrat të cilat janë furnizuar për t'u

trupëzuar si pjesë ose aksesorë në anije ose avionë dhe për funksionimin e motorëve, makinave dhe pajisjeve të tjera të anijeve ose të avionëve, si dhe ushqime dhe artikuj të tjerë që do të konsumohen ose do të shiten në bord.

2. Depozitimi i deklaratës para nisjes nuk do të kërkohet për mallrat në situatat e mëposhtme:

a) Kur një anije që transporton mallra mes porteve të Republikës së Shqipërisë ndalon në një port jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe mallrat mbeten të ngarkuara në bordin e anijes gjatë ndalesës në portin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Kur një avion që transporton mallra ndërmjet aeroporteve të Republikës së Shqipërisë ndalon në një aeroport jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe mallrat mbeten të ngarkuara në bordin e avionit gjatë ndalesës në aeroportin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) kur, në një port ose aeroport, mallrat nuk janë shkarkuar nga mjeti i transportit me të cilin u transportuan në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që do t'i transportojë jashtë këtij territori;

ç) kur mallrat janë ngarkuar në një port ose aeroport të mëparshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ku është depozituar një deklaratë e paranisjes ose zbatohet përjashtimi nga detyrimi për të depozituar një deklaratë të paranisjes dhe mallrat qëndrojnë në mjetet e transportit me të cilat do të dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

d) kur mallrat, që janë në magazinim të përkohshëm ose nën regjimin e zonës së lirë, transbordohen nën mbikëqyrjen e së njëjtës zyrë doganore nga mjetet e transportit që i sollën ato në këto ambiente, në anijen, avionin apo hekurudhën që do t'i transportojë ato jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. transbordimi të kryhet brenda 14 ditëve nga data e paraqitjes së mallrave në përputhje me nenet 134 ose 218 të Kodit ose në rrethana të jashtëzakonshme, brenda një periudhe më të gjatë të autorizuar nga autoritetet doganore, kur periudha prej 14 ditësh nuk është e mjaftueshme për të përballuar këto rrethana;

ii. informacioni në lidhje me mallrat vihet në dispozicion të autoriteteve doganore;

iii. për sa ka dijeni transportuesi destinacioni i mallrave dhe marrësi nuk ndryshojnë;

dh) kur mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, por ato janë refuzuar nga autoritetet kompetente doganore dhe janë kthyer menjëherë në vendin e eksportit.

Neni 697
Analiza e riskut
(Neni 237 i Kodit)

1. Analiza e riskut kryhet para çlirimit të mallrave brenda afatit kohor që korrespondon me periudhën midis përfundimit të afatit për të paraqitur deklaratën e paranisjes të përcaktuar në nenin 384, dhe ngarkimit ose nisjes të mallrave, sipas rastit.

2. Kur zbatohet heqja e detyrimit për të paraqitur një deklaratë paranisjes në bazë të nenit 385, analiza e riskut kryhet në momentin e paraqitjes së mallrave në bazë të deklaratës doganore apo deklaratës të ri-eksportit që mbulon ato mallra ose, kur nuk është e mundur, në bazë të informacioneve të tjera për mallrat.

KREU 2
Formalitetet për daljen e mallrave

Seksioni 1
Zyra doganore e daljes, komunikimi dhe mjetet e komunikimit ndërmjet zyrave doganore të eksportit dhe daljes

Neni 698
Përcaktimi i zyrës doganore të daljes
(Pika 2, e nenit 147, të Kodit)

1. Përveç kur zbatohen pikat 2 deri në 7, zyra doganore e daljes është zyra doganore kompetente për vendin nga ku mallrat lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një destinacion jashtë këtij territori.

2. Në rastin e largimit të mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë përmes një instalimi fiks transporti, zyra doganore e daljes është zyra doganore e eksportit.

3. Kur mallrat janë ngarkuar në një anije apo një avion për transport në një destinacion jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, zyra doganore e daljes është zyra doganore kompetente për vendin ku mallrat janë ngarkuar mbi këtë anije apo avion.

4. Kur mallrat janë ngarkuar mbi një anije që nuk është caktuar për një shërbim transporti të rregullt detar të referuar në nenin 295, zyra doganore e daljes është zyra doganore kompetente për vendin ku mallrat janë ngarkuar në këto anije.

5. Kur, pasi është çliruar për eksport, mallrat janë vendosur nën regjimin e transitit të jashtëm, zyra doganore e daljes është zyra doganore e nisjes të transitit.

6. Kur, pasi është çliruar për eksport, mallrat janë vendosur nën regjim transiti të ndryshëm nga transiti i jashtëm, zyra doganore e daljes është zyra doganore e nisjes së transitit nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) zyra doganore e destinacionit të transitit ndodhet në një vend transiti të përbashkët;

b) zyra doganore e destinacionit të transitit ndodhet në pikën kufitare në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe mallrat dalin nga ky territor doganor, pasi kalojnë nëpër një vend apo territor jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

7. Me kërkesë, zyrë doganore e daljes do të jetë zyra doganore kompetente për vendin ku mallrat janë ngarkuar sipas një kontrate për transportin e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nga shoqëritë e hekurudhave, operatorët postar ose shoqëritë ajrore apo detare të transportit, me kusht që mallrat të largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në rrugë hekurudhore, postare, ajrore ose detare.

8. Pikat 4, 5 dhe 6 nuk do të zbatohen në rastet e mallrave me akcizë të pezulluar ose mallrat që i nënshtrohen formaliteteve të eksportit me qëllim rimbursimin, që jepet për eksport në kuadër të masave të politikave bujqësore.

9. Ku një njoftim reksporti duhet të depozitohet në përputhje me pikën 1, të nenin 246, të Kodit, zyra doganore e daljes është zyra doganore kompetente për vendin ku mallrat janë në zonën e lirë apo në magazinim të përkohshëm.

Neni 699
Komunikimi ndërmjet zyrave doganore të eksportit dhe daljes
(Pika 1, e nenit 239, të Kodit)

Përveç rasteve kur deklarata doganore merr formën e hyrjes në regjistrimet e deklaruesit në përputhje me nenin 165, të Kodit, për çlirimin e mallrave, zyra doganore e eksportit, transmeton informacionet e deklaratës së eksportit në zyrën doganore të daljes. Këto të dhëna do të bazohen në të dhënat që rrjedhin nga deklarata e eksportit, me ndryshime sipas rastit.

Neni 700
Mjetet për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit për daljen e mallrave
(Neni 17, i Kodit)

Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar sipas Planit të Punës së ministrit përgjegjës për financat, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të tjera të ndryshme nga teknika elektronike e përpunimit të të dhënave për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit që ka të bëjë në daljen e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 701
Mjetet për shkëmbimin e informacionit në rastet e paraqitjes së mallrave në zyrën doganore të daljes
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Kur mallrat janë paraqitur në zyrën doganore të daljes në përputhje me pikën 2, të nenit 239, të Kodit, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave për shkëmbimin e informacionit, mund të përdoren mjete të tjera për:

a) identifikimin e deklaratës së eksportit;

b) komunikimet në lidhje me mospërputhjet mes mallrave të deklaruara dhe të çliruara për eksport dhe mallrave të paraqitura.

Neni 702
Paraqitja e mallrave në zyrën doganore të daljes
(Neni 239 i Kodit)

1. Personi që paraqet mallrat në dalje, në momentin e paraqitjes së mallrave në zyrën doganore të daljes, duhet:

a) të tregojë MRN e deklaratës të eksportit apo rieksportit

b) të tregojë mospërputhjet midis mallrave të deklaruara dhe çliruara për eksport dhe atyre të paraqitura, duke përfshirë edhe rastet kur mallrat janë ripaketuar apo shkarkuar dhe ringarkuar në kontejner ,para paraqitjes të tyre në zyrën doganore të daljes;

c) të tregojë gjithashtu dhe sasinë aktuale të

mallrave, kur vetëm një pjesë e mallrave mbulohet nga një deklaratë eksporti apo rieksporti

Megjithatë, kur këto mallra janë paraqitur në koli ose kontejner, njofton për numrin e kolive dhe kur është rasti numrin identifikues të kontejnerit.

2. Mallrat e deklaruara për eksport apo rieksport mund të paraqiten në një zyrë tjetër doganore të daljes, përveç asaj që deklarohet në deklaratën e eksportit apo rieksportit.

Neni 703
Formalitetet për daljen e mallrave
(Neni 239 i Kodit)

1. Kur mallrat që do të dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen kontrolleve doganore, zyra doganore e daljes kontrollon mallrat në bazë të informacionit të marrë nga zyra doganore e eksportit.

2. Kur personi që paraqet mallrat informon, ose zyra doganore e daljes konstaton, se disa nga mallrat e deklaruara për eksport apo rieksport ose përpunim pasiv mungojnë në momentin e paraqitjes në zyrën doganore të daljes, kjo zyrë doganore informon zyrën doganore të eksportit për mallrat që mungojnë.

3. Kur personi që paraqet mallrat informon, ose zyra doganore e daljes konstaton, se disa nga mallrat e paraqitura në zyrën doganore të daljes janë në sasi më të mëdha se ato të deklaruara për eksport, rieksport ose regjim të përpunimit pasiv, kjo zyrë doganore refuzon daljen e mallrave deri sa për këto mallra të paraqitet një deklaratë eksporti ose rieksporti. Kjo deklaratë eksporti apo rieksporti mund të paraqitet në zyrën doganore të daljes.

4. Kur personi që paraqet mallrat informon, ose zyra e doganave e daljes konstaton, se ka një mospërputhje në natyrën e mallrave të deklaruara për eksport, rieksport ose regjim të përpunimit pasiv në krahasim me ato të paraqitura në zyrën doganore të daljes, zyra doganore e daljes refuzon daljen e këtyre mallrave deri sa një deklaratë eksporti apo rieksporti paraqitet për to dhe informon zyrën doganore të eksportit. Kjo deklarate eksporti apo rieksporti mund të paraqitet në zyrën doganore të daljes.

5. Transportuesi do të njoftojë për daljen e mallrave në zyrën doganore të daljes, duke ofruar të gjithë informacionin e mëposhtëm:

a) Numrin unik të ngarkesës ose numrin e referencës të dokumentit të transportit,

b) Kur mallrat janë paraqitur në koli ose kontejner, numrin e kolive dhe kur është rasti numrat identifikues të kontejnerëve ;

c) MRN e deklaratës të eksportit apo rieksportit kur është rasti.

Ky detyrim nuk zbatohet për aq sa ai informacion është në dispozicion të autoriteteve doganore përmes sistemeve të informimit ekzistuese tregtare, portuale apo të lidhura me transportin.

6. Për qëllime të pikës 5, personi që dorëzon mallrat tek transportuesi i siguron këtij të fundit të dhënat e përmendura në atë pikë.

Transportuesi mund të ngarkojë mallra për transport në dalje nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, kur disponon të dhënat e përmendura në pikën 5.

Neni 704
Mbikëqyrja e mallrave të çliruara për dalje dhe shkëmbimi i informacionit midis zyrave doganore
(Neni 239 i Kodit)

1. Sapo të jenë çliruar mallrat për dalje, zyra doganore e daljes do t'i mbikëqyrë ato deri sa ato të kenë dalë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Kur zyra doganore e daljes dhe eksportit janë të ndryshme, zyra doganore e daljes njofton zyrën doganore të eksportit për daljen e mallrave jo më vonë se në ditën e punës pas ditës kur mallrat kanë lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Megjithatë, në rastet e referuara në pikat 3 deri 7 të nenit 698, afati kohor që zyra doganore e daljes të njoftojë zyrën doganore të eksportit për daljen e mallrave do të jetë si vijon:

a) në rastet e përmendura në pikat 3 dhe 4, të nenit 698, jo më vonë se në ditën e punës nga dita në të cilën anija apo avioni në të cilin mallrat janë ngarkuar ka lënë portin ose aeroportin e ngarkimit;

b) në rastet e përmendura në pikën 5, të nenit 698, jo me vonë se në ditën e punës pas ditës kur mallrat janë vendosur nën regjimin e transitit të jashtëm;

c) në rastet e përmendura në pikën 6, të nenit 698, jo me vonë se në ditën e punës pas ditës kur procedura e transitit është mbyllur;

ç) në rastet e përmendura në pikën 7, të nenit 698, jo më vonë se në ditën e punës pas ditës kur mallrat janë marrë përsipër nga një kontratë e vetme transporti.

3. Ku zyra doganore e daljes dhe eksportit janë të ndryshme dhe dalja e mallrave është refuzuar, zyra doganore e daljes informon zyrën doganore të eksportit jo më vonë se në ditën e punës pasi dalja e mallrave është refuzuar.

4. Në rrethana të paparashikuara, nëse mallrat e mbuluara nga një deklaratë eksporti apo rieksporti janë transferuar në një zyrë doganore dalje dhe në vijim do të lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga më shumë se një zyrë doganore dalje, çdo zyrë doganore dalje, ku mallrat janë paraqitur do ta mbikëqyrë daljen e mallrave të cilat duhet të lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Zyra doganore e daljes informon zyrën doganore të eksportit për daljen e mallrave nën mbikëqyrjen e tyre.

5. Nëse mallrat e mbuluara nga një deklaratë eksporti apo rieksporti janë transferuar në një zyrë doganore dalje dhe në vijim, lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në më shumë se një dërgesë, për shkak të rrethanave të paparashikuara, zyra doganore e daljes informon zyrën doganore të eksportit për daljen e çdo dërgese.

6. Kur mallrat janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në rastin e përmendur në pikën 7, të nenit 698, transportuesi me kërkesë nga autoritetet kompetente doganore në pikën e daljes siguron informacion në lidhje me ato mallra.

Ky informacion do të konsistojë në një nga të mëposhtmet:

a) MRN të deklaratës së eksportit;

b) një kopje të kontratës së vetme të transportit për mallrat përkatës;

c) numrin unik të ngarkesës apo numri referencë i dokumentit të transportit dhe kur mallrat janë paraqitur në koli ose kontejner, numri i kolive dhe kur është rast numri identifikues i kontejnerit.

7. Duke anashkaluar shkronjën "c", të pikës 2, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të eksportit sipas Planit të punës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat, në rastet e përmendura në pikën 6, të nenit 698, afati kohor që zyra doganore e daljes të lajmërojë zyrën doganore të eksportit për daljen e mallrave do të jetë dita e parë e punës pas ditës kur mallrat janë vendosur në regjimin e transitit ose mallrat dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë apo regjimi i transitit është mbyllur.

8. Duke anashkaluar pikën 4, të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të eksportit sipas Planit të punës, të miratuar nga ministri i përgjegjës për financat, zyra doganore e daljes ku ngarkesa u paraqit fillimisht mbledh rezultatet e daljes nga zyrat e tjera doganore të daljes dhe informon zyrën doganore të eksportit për daljen e mallrave. Ato e bëjnë këtë vetëm kur të gjitha mallrat janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

9. Duke anashkaluar pikën 5 të këtij neni, deri në implementimin e sistemit të informatizuar të eksportit sipas Planit të punës, të miratuar nga ministri i përgjegjës për financat, kur mallrat e mbuluara nga një deklaratë eksporti apo rieksporti janë transferuar në një zyrë doganore të daljes dhe në vijim dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në më shumë se një dërgesë për shkak të rrethanave të paparashikuara, zyra doganore e daljes informon zyrën doganore të eksportit për daljen e mallrave vetëm kur të gjitha mallrat janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 705
Vërtetimi i daljes së mallrave
(Neni 239 i Kodit)

1. Zyra doganore e eksportit i vërteton daljen e mallrave deklaruesit ose eksportuesit në rastet e mëposhtme:

a) kur kjo zyrë është informuar për daljen e mallrave nga zyra doganore e daljes;

b) kur kjo zyrë është e njëjtë me zyrën doganore të daljes dhe mallrat kanë dalë;

c) nëse zyra në fjalë vlerëson se provat e siguruara në përputhje me pikën 4, të nenit 707, janë të mjaftueshme.

2. Ku zyra doganore e eksportit ka vërtetuar daljen e mallrave në përputhje me shkronjën "c", të pikës 1, ajo informon zyrën doganore të daljes.

Neni 706
Mjetet për dhënien e provës që mallrat janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Me qëllim vërtetimin e daljes së mallrave, prova se mallrat janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë mund t'i sigurohet zyrës doganore të eksportit duke përdorur mënyra të

tjera nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

Neni 707
Procedura hetimore
(Neni 239 i Kodit)

1. Nëse pas 90 ditëve nga çlirimi i mallrave për eksport, zyra doganore e eksportit nuk është njoftuar për daljen e mallrave, ajo mund t'i kërkojë deklaruesit t'i informojë datën kur kanë dalë mallrat dhe zyrën doganore të daljes nga e cila mallrat kanë lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Deklaruesi me iniciativë, mund të njoftojë datën kur kanë dalë mallrat dhe zyrën doganore të daljes nga e cila mallrat kanë lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Kur deklaruesi informon në zyrën doganore të eksportit në përputhje me pikat 1 ose 2, mund t'i kërkojë zyrës doganore të eksportit të vërtetojë daljen. Për këtë qëllim, zyra doganore e eksportit kërkon informacion për daljen e mallrave nga zyra doganore e daljes, e cila do të përgjigjet brenda 10 ditëve.

Kur zyra doganore e daljes nuk përgjigjet brenda kësaj kohe, zyra doganore e eksportit informon deklaruesin.

4. Kur zyra doganore e eksportit njofton deklaruesin që zyra doganore e daljes nuk jep përgjigje brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 3, deklaruesi mund të paraqesë në zyrën doganore të eksportit provat se mallrat kanë lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Provat mund të ofrohen, në veçanti, përmes njërit prej këtyre instrumenteve apo një kombinim të tyre, të vërtetuara nga autoritetet doganore të një shteti tjetër:

a) Një kopje të fletëngarkesës të nënshkruar ose verifikuar nga pritësi jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) Dëshminë e pagesës;

c) Fatura;

ç) Fletë ngarkesa/dërgesa;

d) Një dokument i nënshkruar ose vërtetuar nga operatori ekonomik që ka nxjerrë mallrat nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

dh) Një dokument i lëshuar nga autoritetet doganore të një shteti tjetër në përputhje me rregullat dhe procedurat e zbatuara në atë shtet;

e) Regjistrimet e operatorëve ekonomik lidhur me mallrat e furnizuara për në anije, avionë ose instalimet në det të hapur.

KREU 3
Eksporti dhe rieksporti

Seksioni 1
Deklarata e eksportit, rieksportit, deklarimi prapaveprues, anulimi

Neni 708
Deklarata e eksportit apo rieksportit për mallrat në disa dërgesa
(Neni 149 i Kodit)

Kur mallrat janë të destinuara të dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në më shumë se një dërgesë, çdo dërgesë individuale do të mbulohet nga një deklaratë e veçantë e eksportit apo rieksportit.

Neni 709
Anulimi i deklaratës doganore ose e deklaratës së rieksportit
(Neni 159 i Kodit)

1. Kur ekziston një mospërputhje në natyrën e mallrave të çliruara për eksport, rieksport ose përpunim pasiv në krahasim me ato të paraqitura në zyrën doganore të daljes, atëherë zyra doganore e eksportit anulon deklaratën në fjalë.

2. Kur, pas një periudhe prej 150 ditësh nga data e çlirimit të mallrave për regjimin e eksportit, regjimin e përpunimit pasiv ose të rieksportit, zyra doganore e eksportit nuk ka marrë asnjë informacion për daljen e mallrave si dhe as prova që mallrat janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, zyra doganore e eksportit mund ta anulojë deklaratën në fjalë.

Neni 710
Paraqitja e mëvonshme e një deklarate eksporti apo rieksporti
(Nenet 149 dhe 239 të Kodit)

1. Kur kërkohet një deklarate eksporti apo rieksporti por mallrat kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, pa këtë deklaratë, eksportuesi duhet të paraqesë një deklaratë të mëvonshme eksporti apo rieksporti. Këtë deklaratë e paraqet në zyrën doganore kompetente për vendin, ku është vendosur

eksportuesi. Kjo zyrë doganore provon daljen e mallrave për eksportuesin me kusht që çlirimi do të ishte dhënë nëse deklarata do të ishte paraqitur përpara daljes së mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe se ka prova në dispozicion se mallrat kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Kur mallrat të cilat ishin të destinuara për riimport janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, por nuk kanë më qëllim të riimportohen dhe një lloj tjetër e deklaratës doganore do të ishte përdorur nëse nuk ka pasur qëllim të riimportohen, eksportuesi mund të paraqesë një deklarate eksporti të mëvonshme, duke zëvendësuar deklaratat origjinale, në zyrën doganore të eksportit. Kjo zyrë doganore duhet ti vërtetojë daljen e mallrave eksportuesit.

Megjithatë, kur mallrat shqiptare kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, të mbuluara me një Carnet ATA dhe CPD, zyra doganore e eksportit duhet ti vërtetojë daljen e mallrave eksportuesit me kusht që kuponi (*voucher*) dhe kundërfleta ATA dhe CPD për riimportimin janë anuluar.

Neni 711
Mjetet për depozitimin prapaveprues të një deklarate eksporti ose rieksporti
(Shkronja "a", e pikës 3, të nenit 17, të Kodit)

Kur është kërkuar një deklaratë eksporti ose rieksporti, por mallrat janë nxjerrë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pa një deklaratë të tillë, përveç teknikave informatike të përpunimit të të dhënave mund të përdoren mjete të tjera për shkëmbimin e informacionit për depozitimin prapaveprues të kësaj deklarata eksporti ose rieksporti.

Neni 712
Paraqitje e një deklarate rieksporti për mallrat qe mbulohen nga një Carnet ATA dhe CPD
(Pika 2, e nenit 147, të Kodit)

Përveç zyrës doganore të përmendur në nenin pikën 2, të nenit 318, zyra doganore kompetente për rieksportin e mallrave që mbulohet nga një Carnet ATA dhe CPD, do të jetë zyra doganore e daljes.

Neni 713
Përdorimi i një Carneti ATA dhe CPD si deklaratë eksporti
(Neni 149 i Kodit)

1. Një Carnet ATA dhe CPD konsiderohet një deklaratë eksporti kur Carnet është lëshuar në një shtet palë kontraktuese e Konventës ATA apo e Konventës të Stambollit, miratuar dhe garantuar nga një shoqatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë, pjesë e një zinxhiri garantues, siç është përcaktuar në shkronjën "d", të nenit 1, të aneksit A, të Konventës së Stambollit.

2. Carnet ATA dhe CPD nuk do të përdoret si një deklaratë eksporti në lidhje me mallrat shqiptare, kur:

a) ato mallra i nënshtrohen formaliteteve të eksportit me qëllim rimbursimin për eksport në sipas masave të politikave bujqësore;

b) mallrat që kanë qenë pjesë e rezervave për ndërhyrje, i nënshtrohen masave të kontrollit të përdorimit dhe/ose të destinacionit dhe i kanë kaluar formalitetet doganore për eksport në territore jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në kuadër të masave të politikave bujqësore;

c) mallrat përfitojnë nga rimbursimi ose falja e detyrimit të importit, me kusht që ato eksportohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

ç) këto mallra qarkullojnë në regjim pezullimi nga akciza në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë".

3. Kur një Carnet ATA është përdorur si një deklaratë eksporti, zyra doganore e eksportit kryen formalitetet, si më poshtë:

a) Verifikon informacionin e dhënë në kutitë A deri në G të kuponit të eksportit të mallrave nën mbulimin e Carnet;

b) Plotëson, sipas nevojës, kutinë "certifikuar nga autoritetet doganore" në faqen e parë të Carnet;

c) Plotëson kundërfletën dhe kutinë H të kuponit të eksportit;

ç) Identifikon zyrën doganore të eksportit në kutinë H (b) të kuponit të riimportimit;

d) Mban kuponin e eksportit.

4. Ku zyra doganore e eksportit nuk është zyra doganore e daljes, zyra e doganave e eksportit kryen formalitetet e përmendura në pikën 3, por

nuk plotëson kutinë 7 të kundërfletës, e cila plotësohet në zyrën doganore të daljes.

5. Afatet kohore për riimportin e mallrave të përcaktuara nga zyra doganore e eksportit në kutinë (b) të kuponit të eksportit nuk mund të kalojë vlefshmërinë e Carnet.

Neni 714
Mallrat për eksport apo rieksport që nuk largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë
(Neni 239 i Kodit)

1. Ku mallrat për eksport apo rieksport nuk janë më të destinuara të dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, deklaruesi njofton, menjëherë, zyrën doganore të eksportit.

2. Pa rënë ndesh me pikën 1, kur mallrat janë paraqitur në zyrën doganore të daljes, personi që i tërheq këto mallra nga zyra doganore e dalje për ti transportuar në një vend brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, informon zyrën doganore të daljes se mallrat nuk do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe përcakton MRN e deklaratës të eksportit apo të rieksportit.

3. Kur, në rastet e përmendura në nenin 698, shkronjat 5, 6 dhe 7, një ndryshim në kontratën e transportit ka si pasojë përfundimin brenda në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të një operacioni transporti, i cili duhet të përfundonte jashtë këtij territori, kompanitë apo shoqëritë në fjalë mund të kryejnë ndryshimin e kontratës me një miratim paraprak të zyrës doganore të daljes.

4. Në rastin e anulimit të deklaratës së eksportit apo ri-eksportit në përputhje me nenin 709, zyra doganore e eksportit informon deklaruesit dhe zyrën doganore të daljes për anulimin.

KREU 4
Deklarata përmbledhëse e daljes

Seksioni 1
Depozitimi i deklaratës përmbledhëse të daljes

Neni 715
Masat që merren pas depozitimit të deklaratës përmbledhëse të daljes
(Neni 243 i Kodit)

Zyra doganore e daljes ku është depozituar deklarata përmbledhëse në përputhje me pikën 1, të nenit 243, të Kodit duhet të:

a) regjistrojë deklaratën përmbledhëse të daljes menjëherë pas marrjes së saj;

b) japë një MRN deklaruesit;

c) sipas nevojës, çlirojë mallrat për dalje nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 716
Mallra që nuk largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë për të cilat është depozituar një deklaratë përmbledhëse e daljes
(Neni 159 i Kodit)

Kur, mallrat për të cilat një deklaratë përmbledhëse e daljes është paraqitur nuk janë më të destinuara për të dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, personi që i tërheq këto mallra nga zyra doganore e daljes për t'i transportuar në një vend brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, informon zyrën doganore të daljes se mallrat nuk do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe përcakton MRN e deklaratës përmbledhëse të daljes.

KREU 5
Njoftimi i rieksportit

Seksioni 1
Regjistrimi i njoftimit të rieksportit

Neni 717
Masat që do të merren me marrjen e njoftimit të rieksportit
(Neni 246 i Kodit)

Zyra doganore e daljes duhet të:

a) regjistrojë njoftimin e rieksportit menjëherë pas marrjes së tij;

b) japë një MRN deklaruesit;

c) sipas nevojës, çlirojë mallrat për dalje nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 718
Mallrat që nuk largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë për të cilat është depozituar një njoftim rieksporti
(Neni 159 i Kodit)

Kur, mallrat për të cilat një njoftim rieksporti është paraqitur nuk janë më të destinuara për dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, personi që i tërheq këto mallra nga zyra doganore e daljes për ti transportuar në një vend brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, informon zyrën doganore të daljes se mallrat nuk do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe përcakton MRN e njoftimit të rieksportit.

TITULLI IX
DISPOZITA TË TJERA PËR KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS DOGANORE

KREU 1
ORARI I FUNKSIONIMIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE, SEKUESTRIMI I SKEDARËVE KOMPJUTERIKË, I REGJISTRAVE, BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Seksioni 1
Orari i funksionimit

Neni 719
Orari i funksionimit të zyrave doganore
(neni 9 i Kodit)

1. Për qëllime të nenit 9 të Kodit dhe pa cenuar dispozitat në fuqi për orarin ditor të punës të administratës publike, në parim zyrat doganore, kufitare tokësore e ujore dhe në aeroporte ofrojnë shërbim për të gjitha ditët, duke përfshirë edhe ditët e festave, gjatë gjithë harkut kohor 24 orësh, përmes kryerjes së të gjitha kontrolleve dhe formaliteteve të parashikuara nga Kodi.

2. Orari i punës së zyrave të Administratës Doganore është nga ora 8 deri në orën 18 për ditët nga e hëna deri të premten, duke përjashtuar ditët e festave.

3. Për mbulimin e shërbimeve doganore, duke marrë në konsideratë llojin e trafikut/transportit të mallrave, regjimet doganore nën të cilat vendosen mallrat dhe me qëllim që të mos pengohet dhe të mos vështirësohet trafiku ndërkombëtar i mallrave, Drejtori i Përgjithshëm mund të caktojë turne pune ose të autorizojë kryerjen e punës nga personeli jashtë orarit normal ditor përmes orëve shtesë.

4. Drejtori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me administratat homologe, mund të vendosë një orar pune të ndryshëm ose mund të shkurtojë orarin e mbajtjes hapur të zyrave doganore, kur e kërkojnë nevojat e punës.

Seksioni 2
Sekuestrimi, kontrolli dhe analizimi i dokumentacionit dhe i pajisjeve elektronike, konfidencialiteti

Neni 720
Sekuestrimi i skedarëve kompjuterikë, regjistrave, dokumentacionit tjetër të nevojshëm, tregtar apo fiskal
(Pika 7, e nenit 10, të Kodit)

1. Për qëllime të pikës 7 të nenit 10 të Kodit, autoritetet doganore, në rastet e dyshimeve të arsyeshme për tentativë ose për kryerjen e ndonjë prej shkeljeve të parashikuara nga Kodi, mund të sekuestrojnë dokumente, skedarë kompjuterik ose regjistrat përkatës, kompjuter si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm tregtar apo fiskal (sende/materiale) të ndodhura në ambientet e operatorëve ekonomikë.

2. Autoritetet doganore, për qëllimin e sekuestrimit, duhet të mbajnë një procesverbal në tri kopje, në të cilin shënohen të gjitha sendet/materialet të cilat po sekuestrohen dhe arsyeja se përse po bëhet ky sekuestrim. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë, të cilët po kryejnë sekuestrimin dhe nga operatori ekonomik ose përfaqësuesi i tij. Një kopje e këtij procesverbali i dorëzohet operatorit ekonomik ose përfaqësuesit të tij. Dy kopjet e tjera administrohen nga autoritetet doganore.

3. Nëse është e mundur, dokumentet origjinale fotokopjohen dhe kopja e vulosur me vulën e doganës i lihet në administrim operatorit ekonomik. Kjo procedurë duhet të përshkruhet edhe në procesverbal.

4. Në mënyrë që të ruhet integriteti i tyre, sendet/materialet e sipërpërmendura duhet të

trajtohen me kujdes duke u vendosur nga punonjësit doganorë që i sekuestrojnë në një dosje ose kuti mbajtëse etj., në të cilën duhet të shënohen qartë:

a) emri i plotë i operatorit ekonomik të cilit i sekuestrohen sendet/materialet;

b) emri dhe mbiemri i punonjësve që kanë bërë sekuestrimin;

c) data dhe vendi i saktë ku u sekuestrua sendi/materiali;

ç) përshkrimi i përgjithshëm i sendit/materialit të sekuestruar.

5. Dosjet ose kutitë mbajtëse duhet të dërgohen në zyrën doganore mbikëqyrëse, në të cilën punonjësi i autorizuar i inventarizon këto sende /materiale. Para se të transportohet dosja ose kutia, duhet të vuloset me shirita ngjitës ose të plumboset, për të shmangur heqjen e sendeve / materialeve të sekuestruara. Sendet/materialet e sekuestruara në vende të ndryshme nuk duhet të vendosen në të njëjtën qese ose kuti.

6. Kur transportohen dhe ruhen sendet/materialet e sekuestruara, duhet të tregohet kujdesi i duhur, sipas llojit të tyre, për të shmangur faktorët mjedisorë, si të nxehtin, të ftohtin dhe lagështirën, të cilat mund të kenë ndikim tek ato.

7. Kompjuterat ose pajisje të tjera elektronike mund të ndryshohen, të fshihen ose të shkatërrohen lehtësisht dhe për sekuestrimin dhe marrjen e tyre duhet të sigurohet që të mos ndryshojë gjendja e pajisjeve elektronike. Kjo do të thotë që nuk duhet të fiket një kompjuter që gjendet në punë dhe që nuk duhet të ndizet një kompjuter ose pajisje elektronike që gjendet e fikur.

8. Përveç mbledhjes së informacionit të përgjithshëm nga personat që janë në vendin që kontrollohet, punonjësit doganorë duhet të përpiqen të marrin edhe informacion specifik mbi sistemet kompjuterike, duke përfshirë:

a) emrat e të gjithë përdoruesve të kompjuterëve dhe të pajisjeve;

b) emrat hyrës dhe fjalëkalimet për përdoruesit e kompjuterit dhe të internetit;

c) emrat hyrës dhe fjalëkalimet e postës elektronike dhe llogarive në internet;

ç) qëllimin e përdorimit të kompjuterëve dhe të pajisjeve;

d) ekzistencën e serverave ose serverave në distancë;

dh) të gjitha fjalëkalimet;

e) aplikime automatike që janë në përdorim;

ë) llojet e aksesit në internet;

f) ofruesin e shërbimit të internetit;

g) mjetet e ruajtjes së informacionit elektronik që mund të ndodhen diku tjetër;

gj) dokumentet e programeve kompjuterike të instaluara;

h) masat e sigurisë që zbatohen për pajisjet;

i) kufizimet për aksesin ndaj të dhënave;

j) të gjitha pajisjet ose programet kompjuterike të instaluara që mund të shkatërrojnë informacionin.

9. Për të parandaluar ndryshimin që mund t'u ndodhë dokumenteve digjitale gjatë marrjes së tyre, punonjësi doganor, së pari duhet:

a) të dokumentojë çdo veprimtari në kompjuter, përbërësit e tij ose në pajisje;

b) të konfirmojë nëse kompjuteri është i ndezur apo jo.

10. Rekomandohet heqja e menjëhershme e energjisë /burimit të ushqimit kur:

a) informacioni në ekran tregon se po fshihen të dhëna ose se mbi të dhënat e vjetra po shkruhen të dhëna të tjera;

b) ka arsye për të besuar se në pajisjet e ruajtjes së të dhënave të kompjuterit po kryhet një proces shkatërrues.

11. Heqja e kabllos së ushqimit nga kompjuteri do të ruajë informacionin e përdoruesit të fundit dhe kohën kur ai ka pasur akses, dokumentet e përdorura së fundi, si dhe informacione të tjera të vlefshme.

12. Në situatat e mëposhtme, nuk rekomandohet heqja e menjëhershme e kabllos së ushqimit:

a) Në ekran janë shfaqur të dhëna që duket se kanë vlerë si dokumente;

b) Ka të dhëna se janë aktive ose në përdorim:

i) dhoma *chat-room*;

ii) dokumente të hapura;

iii) pajisje të lëvizshme të ruajtjes së të dhënave;

iv) programe të mesazheve të çastit;

v) dokumente financiare;

vi) kodimi i të dhënave;

vii) veprimtari haptazi të paligjshme.

13. Nëse kompjuteri është i fikur: Për kompjutera tavoline, tover dhe minikompjutera duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

a) Dokumentohet dhe etiketohen të gjitha kabllot dhe pajisjet e tjera të lidhura në kompjuter, si dhe hyrjen përkatëse që zë në kompjuter secili kordon, kabllo, telat përcjellës apo USB;

b) Hiqen dhe ruhen kordoni elektrik nga pas kompjuterit dhe nga ushqyesi në mur ose nga zgjatuesi apo bateria;

c) Shkëputen dhe ruhen kabllot, telat përcjellës dhe USB nga kompjuteri dhe dokumentohet aparati apo pajisja e lidhur nëpërmjet tyre;

ç) Mbyllet me shirit ngjitës vendi ku vendoset disketa, nëse ka një të tillë;

d) Sigurohet që vendi i CD/DVD të jetë i mbyllur, kontrollohet nëse është bosh, ka disk apo nuk është kontrolluar dhe mbyllet me shirit ngjitës, në mënyrë që të mos hapet;

dh) Sigurohet me shirit ngjitës çelësi i ndezjes /fikjes;

e) Regjistrohen marka, modeli, numrat serialë dhe çdo shenjë apo

identifikim të vendosur nga përdoruesi;

ë) Inventarizohen kompjuteri dhe të gjithë kordonët, kabllot, telat përcjellës dhe përbërësit.

14. Gjatë transportimit të provave digjitale punonjësi duhet:

a) të mbajë provat digjitale larg fushave magnetike, si ato të prodhuara nga transmetuesit e radios, magnetet e altoparlantëve dhe dritat e emergjencës, të fiksuara me magnet. Rreziqe të tjera të mundshme që punonjësi duhet të ketë parasysh janë ngrohësit e sediljeve dhe pajisje apo materiale të tjera që mund të prodhojnë elektricitet statik;

b) të shmangë mbajtjen e provave digjitale në makinë për periudha të gjata kohe, sepse të nxehtët, të ftohtët dhe lagështira mund të dëmtojnë ose të shkatërrojnë provat digjitale;

c) të kujdeset që kompjuterat dhe pajisjet digjitale të paketohen dhe të sigurohen gjatë transportimit për të parandaluar dëmtimin nga tronditjet dhe dridhjet;

ç) të dokumentojë transportimin e provave digjitale dhe të mos shkëpusë zinxhirin e ruajtjes së tyre.

15. Gjatë magazinimit të provave digjitale, punonjësit doganorë duhet:

a) të sigurohen që provat inventarizohen, në përputhje me rregullat e administratës doganore;

b) të sigurohen që provat ruhen në një mjedis të sigurt, me kushte të kontrolluara dhe që nuk preket nga temperatura apo lagështia ekstreme;

c) të sigurohen se provat nuk ekspozohen ndaj fushave magnetike, lagështirës, pluhurit, dridhjeve ose ndonjë faktori që mund t'i dëmtojë ose t'i shkatërrojë.

Neni 721
Kontrolli dhe analizimi i dokumenteve të sekuestruara
(Neni 10, i Kodit)

1. Pas sekuestrimit, çdo kontroll apo verifikim i dokumenteve duhet të kryhet në mënyrë që të shmanget humbja ose përzierja e tyre me të tjera dokumente. Nëse është e nevojshme që të hiqet shiriti vulosës për të lejuar kontrollin, duhet që qesja ose kutia të ri vuloset pas shqyrtimit, si dhe të dokumentohet se cili punonjës verifikoi apo kontrolloi dokumentet.

2. Dokumentet origjinale fotokopjohen ose skanohen dhe në të ardhmen punohet vetëm me kopjet.

Neni 722
Kontrolli dhe analiza e pajisjeve dhe dokumenteve elektronike/digjitale
(Neni 10, i Kodit)

1. Pajisjet dhe dokumentet elektronike duhet të ruhen me kujdes për të shmangur pretendimet se ato janë manipuluar dhe, për këtë qëllim, ato duhet të analizohen vetëm nga persona të trajnuar në mënyrë të posaçme.

2. Punonjësit e përfshirë në analiza dhe kontroll duhet të tregohen të kujdesshëm pasi të dhënat kompjuterike dhe provat e tjera digjitale janë delikate, prandaj punonjësit e pa trajnuar dhe pa aftësitë e nevojshme nuk duhet të këqyrin përmbajtjen e tyre ose të përpiqen të rikuperojnë informacion. I vetmi veprim që ata mund të kryejnë është të regjistrojnë atë çka është e dukshme në ekran.

Seksioni 3
Kthimi i sendeve

Neni 723
Kthimi i sendeve të sekuestruara dhe konfidencialiteti
(Neni 10, i Kodit)

1. Autoritetet doganore, në përfundim të analizës/ekspertizës që i bëjnë dokumentacionit dhe ose pajisjeve, mjeteve të sekuestruara, i përfshijnë rezultatet në raportin përfundimtar të kontrollit, në funksion të të cilit u krye sekuestrimi, dhe sendet /materialet e sekuestruara i dorëzohen përfaqësuesit të operatorit ekonomik me procesverbal.

2. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga autoritetet doganore si rezultat i analizave të sipërpërmendura janë konfidenciale. Çdo punonjës i administratës doganore, që ka akses në këto të dhëna, që është njohur me këto të dhëna gjatë dhe për shkak të kryerjes së detyrave të tij funksionale apo për çfarëdo arsye tjetër, është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e tyre përkundrejt çdo personi të tretë.

3. Nëse dokumentacioni dhe/ose pajisjet, mjetet e sekuestruara (sende/materiale) lidhen me një vepër penale dhe mundet të shërbejnë si prova, ato, së bashku me dosjen përkatëse, u dërgohen autoriteteve kompetente proceduese.

KREU 2
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Seksioni 1
Koordinimi, shkëmbimi i informacionit

Neni 724
Koordinimi i procedurave të kontrollit
(Neni 10, i Kodit)

1. Për qëllime të nenit 10 të Kodit, për të siguruar respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, zbatimi i të cilave u është ngarkuar autoriteteve të tjera kompetente, punonjësit e administratës doganore, në bashkëpunim me këto autoritete, mund të kryejnë kontrolle të përbashkëta periodike duke ndërmarrë masat e nevojshme administrative dhe organizative.

2. Rregullat e bashkëpunimit për zbatimin korrekt të dispozitave në lidhje me kontrollet e përbashkëta do të përcaktohen në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta ndërinstitucionale.

Neni 725
Shkëmbimi i informacionit
(shkronja "b", e pikës 11, të nenit 10, të Kodit)

1. Për qëllime të shkronjës "b" të pikës 11, të nenit 10, të Kodit, për zbatimin korrekt të legjislacionit doganor në fuqi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbledh informacion duke ja kërkuar këtë shoqërive tregtare, institucioneve të kreditimit, administratës postare ose çdo organizmi publik e privat.

2. Shoqëritë tregtare, Institucionet e kreditimit, administrata postare apo çdo organizëm publik e privat, në përputhje me legjislacionin në fuqi vënë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuara rast pas rasti sipas kërkesës në formën e kërkuar prej saj. Ky informacion në rast se kërkohet i tillë mund të jepet edhe në formën e aksesit në raporte të gatshme informatike periodike. Rregullat e aksesit do të përcaktohen në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta.

3. Shkëmbimi i të dhënave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, kryhet për arsye verifikimi dhe hetimi në lidhje me import-eksportin e mallrave, për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna lidhur me regjimet e posaçme, operacionet e privilegjuara ose për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna nga vetë operatorët ekonomikë për të përfituar thjeshtësi dhe lehtësi doganore.

4. Të dhënat e shkëmbyera sipas këtij neni janë konfidenciale dhe trajtohen si të tilla.

Neni 726
Aksesi në bazën e të dhënave të administratave të tjera
(Shkronja "dh", e pikës 11, të nenit 10, të Kodit)

1. Për qëllime të shkronjës "dh", të pikës 11, të nenit 10, të Kodit, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetet doganore autorizohen të kenë akses në bazat e të dhënave të administratave të tjera, përkatësisht:

a) në bazën e të dhënave të personave që hyjnë dhe dalin në/dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) në bazën e të dhënave të deklarimit të kapitaleve dhe llogarive bankare, për efekt hetimi;

c) në bazën e të dhënave të precedentëve policorë;

ç) në bazën e të dhënave të automjeteve të vjedhura.

2. Autoriteteve doganore u mundësohet akses në kohë reale në bazën e të dhënave, në raportet e krijuara paraprakisht apo përmes ndërveprimit të sistemeve si mënyrë komunikimi dhe shkëmbimi të dhënash, sipas nevojave të autoritetit doganor. Aksesi do të jetë vetëm në cilësinë e leximit dhe printimit pa pasur mundësi për të shtuar apo pakësuar të dhënat. Modalitet teknike për mundësimin e aksesit përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura për këtë qëllim.

3. Shkëmbimi i të dhënave sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet për arsye verifikimi dhe hetimi në lidhje me import-eksportin e mallrave, për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna lidhur me regjimet e posaçme, operacionet e privilegjuara ose për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna nga vetë operatorët ekonomikë për të përfituar thjeshtësi dhe lehtësi doganore.

4. Të dhënat e shkëmbyera sipas këtij neni janë konfidenciale dhe trajtohen si të tilla.

TITULLI IX
DISPOZITAT E FUNDIT

KREU 1

Vlefshmëria e vendimeve, autorizimeve dhe rivlerësimi i autorizimeve

Neni 727
Rivlerësimi i autorizimeve në fuqi

1. Autorizimet e dhëna para datës 1 qershor 2017, të cilat janë të vlefshme datën që fillon zbatimi i Kodit dhe që nuk kanë një periudhë të kufizuar vlefshmërie, duhet të rivlerësohen.

Vendimet për rivlerësimin e një autorizimi në përputhje me paragrafin e parë duhet të merren përpara datës 1 maj 2020. Këto vendime revokojnë autorizimet objekt rivlerësimi dhe, sipas nevojës, jepen autorizime të reja. Vendimet i komunikohen, pa vonesë, mbajtësit të autorizimit.

2. Duke anashkaluar pikën 1, nuk janë objekt rivlerësimi autorizimet:

a) e eksportuesve për të bërë deklarata faturë /deklarata origjine, siç referohet në legjislacionin në fuqi;

b) për administrimin e materialeve duke përdorur metodën e ndarjes kontabile më vete, siç referohet në legjislacionin në fuqi.

Neni 728
Vlefshmëria e autorizimeve në fuqi

1. Autorizimet e dhëna para datës 1 qershor 2017, që janë të vlefshme datën që fillon zbatimi i Kodit, vazhdojnë të mbeten në fuqi sipas përcaktimeve në vijim:

a) për autorizimet që kanë një afat të kufizuar vlefshmërie, deri në fund të kësaj periudhe ose më 1 maj 2020;

b) për të gjitha autorizimet e tjera, deri sa autorizimi të jetë rivlerësuar në përputhje me pikën 1, të nenit 727.

2. Duke anashkaluar pikën 1, autorizimet e referuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 727, mbeten të vlefshme deri sa të tërhiqen nga autoritetet kompetente që i kanë dhënë ato.

3. Kur autorizimet e përmendura në pikat 1 dhe 2 përmbajnë referenca të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Kodi doganor i R.SH", ose vendimi nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar, ato duhet të lexohen në përputhje me tabelën e aneksit 90, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 729
Vlefshmëria e vendimeve për informacionin detyrues në fuqi

Vendimet lidhur me informacionin detyrues të miratuara para datës 1 qershor 2017 vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në këto vendime.

Neni 730
Përdorimi i autorizimeve dhe vendimeve në fuqi

Nëse një vendim apo një autorizim, në përputhje me nenet 728 dhe 729, mbetet i vlefshëm pas ditës që fillon zbatimi i Kodit, kushtet e përcaktuara në atë vendim ose autorizim duhet të jenë sipas Kodit dhe këtij vendimi, siç përcaktohet në tabelën e përputhshmërisë së referuar në

aneksin 90, të shtojcës A, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 731
Dispozita kalimtare lidhur me aplikimet për autorizime të paraqitura përpara 1 Qershorit 2017

Autoritetet doganore kompetente për marrjen e vendimit mund të japin autorizime në përputhje me Kodin dhe këtë vendim, për aplikime të paraqitura përpara datës 1 qershor 2017. Megjithatë, këto autorizime nuk do të jenë të vlefshme përpara datës 1 qershor 2017.

Neni 732
Dispozitat kalimtare për përdorimin e plumbçeve

Plumbçet doganore mund të vazhdojnë të përdoren derisa rezervat të mbarojnë ose deri më 1 maj 2021.

Neni 733
Dispozita kalimtare lidhur me vlerën e transaksionit

1. Vlera e transaksionit të mallrave mund të përcaktohet në bazë të një shitjeje që ndodh para shitjes referuar në pikën 1, të nenit 149, kur personi në emër të të cilit është paraqitur deklarata doganore është i lidhur me një kontratë të përfunduar para datës 18 janar 2017.

2. Ky nen zbatohet deri më 31 dhjetor 2018.

Neni 734
Dispozitat kalimtare lidhur me çlirimin e mallrave

Kur mallrat janë deklaruar për çlirim për qarkullim të lirë, magazinim doganor, përpunim aktiv, përpunim nën kontroll doganor, import i përkohshëm, transit, eksport ose përpunim pasiv përpara datës 1 qershorit 2017, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi doganor i R.SH", dhe nuk janë çliruar deri në atë datë, ato do të çlirohen për regjimin e përcaktuar në deklaratë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit dhe të këtij vendimi.

Neni 735
Dispozita kalimtare për mallrat e vendosura nën disa regjime doganore të caktuara, të cilat nuk janë mbyllur përpara datës 1 qershor 2017

1. Kur mallrat janë vendosur nën regjimet doganore të mëposhtme përpara datës 1 qershor 2017 dhe regjimi në fjalë nuk është mbyllur para kësaj date, regjimi do të përfundojë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit dhe këtij vendimi:

a) çlirimi i mallrave për qarkullim të lirë me një trajtim tarifor favorizues ose me detyrime të tyre të reduktuara ose zero, për shkak të përdorimit final;

b) magazinimi doganor të tipit A, B, C, D, E dhe F;

c) regjimi i përpunimit aktiv në formën e sistemit me pezullim;

ç) përpunimi nën kontroll doganor.

2. Kur mallrat janë vendosur nën regjimet doganore të mëposhtme përpara datës 1 qershor 2017 dhe regjimi në fjalë nuk është mbyllur para kësaj date, regjimi do të përfundojë në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Kodi doganor i R.SH", dhe vendimit nr.205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave:

a) magazinimi doganor të tipit D;

b) importi i përkohshëm;

c) regjim i përpunimit aktiv në formën e sistemit me rimbursim;

ç) përpunimi pasiv.

Megjithatë, nga data 1 janar 2020, regjimi i magazinimit doganor të tipit D do të mbyllet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit dhe të këtij vendimi.

3. Në përputhje me shkronjën "a" të pikës 1, të nenit 728, mallrat në një zonë të lirë apo në një magazinë të lirë vijojnë të trajtohen në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Kodi doganor i R.SH", dhe vendimit nr.205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, deri më 1 maj 2020. Për shkeljet që konstatohen, do të konsiderohet se mallrat janë nën regjimin e magazinimit doganor.

4. Kur mallrat janë çliruar për një operacion transit përpara datës 1 qershor 2017 dhe operacioni në fjalë nuk është mbyllur deri në atë datë, transiti do të mbyllet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi doganor i R.SH", dhe vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave.

Neni 736
Dispozitë kalimtare për shkeljet doganore të kryera para datës 1 qershor 2017

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për shkeljet doganore të kryera para datës 1 qershor 2017, por që konstatimi është kryer pas kësaj date:

- në përcaktimin e llojit dhe masës së shkeljes do jetë i aplikueshëm ligji që ka qenë në fuqi në momentin e kryerjes së shkeljes doganore;

- procedurat e verifikimit dhe ankimimit të shkeljeve doganore, do të zbatohen sipas kreut IV, dhe V, të titullit IX, të Kodit.

Neni 737
Akte nënligjore

1. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, mbështetur në parimet e përcaktuara në Kod, miraton udhëzime, rregullore apo manuale udhëzuese etj., për zbatimin në praktikë apo në sistemin kompjuterik/elektronik doganor të këtij vendimi.

2. Aktet e nivelit të tretë që rregullojnë elementët procedurale, të dala në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi doganor i R.SH", dhe vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, do të vijojnë të zbatohen për aq sa nuk bien ndesh me përcaktimet e Kodit dhe të këtij vendimi, deri në shfuqizimin e tyre në mënyrë nominative.

Neni 738
Shfuqizime

Vendimi nr.205, datë 13.4.1999, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar dhe vendimi nr.919, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 739
Institucionet zbatuese

Ngarkohen ministria përgjegjëse për financat dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 740
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 15 ditë pas hyrjes në fuqi të tij.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA A

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

ANEKSI A	Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për kërkesat dhe vendimet
ANEKSI B	Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për deklaratat, njoftimet si dhe prova e statusit doganor të mallrave shqiptare
ANEKSI B-01	Deklarata standarde në letër - shënimet dhe formularët që përdoren
ANEKSI B-02	Dokumenti shoqërues transit
ANEKSI B-03	Lista e artikujve
ANEKSI B-04	Dokumenti shoqërues transitit / siguri (TSAD)
ANEKSI B-05	Lista e artikujve transitit / siguri (TSLoI)
ANEKSI 12-01	Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe personave të tjerë

KREU II

FAKTORËT NË BAZË TË TË CILËVE ZBATOHEN DETYRIMET E IMPORTIT DHE EKSPORTIT SI DHE MASAT E TJERA NË LIDHJE ME TREGTINË E MALLRAVE

ANEKSI 22-01	Shënime hyrëse dhe lista e operacioneve të punimit ose përpunimit thelbësor që japin origjinë jo-preferenciale
ANEKSI 22-11	Shënimet prezantuese dhe lista e punimit apo e përpunimit që kërkohen për t'u kryer mbi materialet jo-origjinuese në mënyrë që produkti i prodhuar të marrë statusin origjinues
ANEKSI 22-13	Dekalarata faturë

KREU III

BORXHET DOGANORE DHE GARANCITË

ANEKSI 32-01	Dorëzania e garantuesit— Garancia individuale

ANEKSI 32-02	Dorëzania e garantuesit — Garancia individuale në formën e kuponit (voucher)
ANEKSI 32-03	Dorëzania e garantuesit — Garancia globale
ANEKSI 32-04	Njoftimi i garantuesit mbi mos-mbylljen e regjimit të transitit
ANEKSI 32-05	Njoftimi i garantuesit për detyrimin e borxhit në regjimin e transitit
ANEKSI 33-01	Kërkesa/Pretendimi për pagesë drejtuar shoqatave garantuese të borxhit nën regjimin transit nën dokumentin doganor ndërkombëtar Carnet ATA/e-ATA
ANEKSI 33-02	Njoftimi i garantuesit për detyrimin e borxhit nën regjimin e transitit me Carnet CPD
ANEKSI 33-03	Model i memos informuese mbi pretendimin/kërkesën për pagesë drejtuar shoqatave garantuese për borxhin nën regjimin e transitit me Carnet ATA/e- ATA
ANEKSI 33-04	Formulari i taksimit për llogaritjen e detyrimeve dhe taksave që rezultojnë nga kërkesa/pretendimi për pagesë drejtuar shoqatës garantuese të borxhit nën regjimin e transitit nën Carnet ATA/e-ATA
ANEKSI 33-05	Modeli i mbylljes që tregon që kanë filluar proçedurat kërkuese/pretenduese në lidhje me shoqatën garantuese në RSh ku ka lindur borxhi doganor nën regjimin e transitit nën Carnetin ATA/e-ATA
ANEKSI 33-06	Kërkesa për informacion shtesë kur mallrat ndodhen në një vend tjetër
ANEKSI 33-07	Falja/Rimbursimi

KREU IV

MALLRAT E SJELLA NË TERRITORIN DOGANOR TË R.SH

Nuk ka Aneks

KREU V

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR STATUSIN DOGANOR, VENDOSJEN E MALLRAVE NËN NJË REGJIM DOGANOR, VERIFIKIMI, LËSHIMI DHE ASGJËSIMI I MALLRAVE

Nuk ka Aneks

KREU VI

ÇLIRIMI PËR QARKULLIM TË LIRË DHE PËRJASHTIMI NGA DETYRIMET E

IMPORTIT

ANEKSI 61-01 Certifikatat e peshimit të bananeve — kërkesat e të dhënave

ANEKSI 62-01 Fleta e informacionit INF 3 — kërkesat e të dhënave

KREU VII

REGJIME TË VEÇANTA

ANEKSI 71-01 Dokument mbështetës kur mallrat janë deklaruar me gojë për lejim të përkohshëm

ANEKSI 71-02 Mallrat dhe produktet sensitive

ANEKSI 71-03 Lista e formave të zakonshme të lejueshme të trajtimit

ANEKSI 71-04 Dispozita të veçanta në lidhje me mallrat ekuivalente

ANEKSI 71-05 Shkëmbimi standard i informacionit (INF)

ANEKSI 71-06 Informacioni për t'u dhënë në dokumentin e mbylljes

ANEKSI 72-03 Vërtetimi TC 11

ANEKSI 72-04 Vepra arti, antikat dhe pjesë të koleksionistëve

ANEKSI 13 Aplikimi për të përfituar autorizimin për magazinë doganore private (duty free shops)

KREU VIII

MALLRAT E NXJERRA NGA TERRITORI DOGANOR I RSH

Nuk ka Aneks

KREU IX

ANEKSI 90 Tabela e korrespondencës

ANEKSI A

KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË TË DHËNAVE PËR APLIKIMET DHE VENDIMET

Përmbajtja e tabelave me kërkesat e të dhënave për aplikimet dhe vendimet

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Dispozitat e përfshira në këto shënime janë të zbatueshme për të gjithë krerët e këtij Aneksi.

2. Tabelat me kërkesat e të dhënave në Kreun I deri në Kreun XXI përfshijnë të gjitha elementet e të dhënave të nevojshme për aplikimet dhe vendimet që trajtohen në këtë Aneks.

3. Formatet, kodet dhe, sipas rastit, strukturat e kërkesave për të dhëna të përshkruara në këtë Aneks janë të specifikuara në këtë vendim.

4. Kërkesat për të dhëna, të përcaktuara në këtë Aneks do të zbatohen si për aplikimet dhe vendimet e marra, duke përdorur një teknikë elektronike të përpunimit të të dhënave, ashtu dhe për aplikimet dhe vendimet të bazuara në letër.

5. Elementet e të dhënave të cilat mund të ofrohen për disa aplikime dhe vendime, janë dhënë në tabelën e kërkesave të të dhënave të Kapitullit 1, Kreu I i këtij Aneksi.

6. Elementët e të dhënave specifike për lloje të caktuara aplikimesh dhe vendimesh, janë përcaktuar në Kreun II deri në Kreun XXI të këtij Aneksi.

7. Dispozita të veçanta në lidhje me çdo element të të dhënave siç janë të përshkruara në Kapitullin 2 të Kreut I deri në XXI të këtij Aneksi, zbatohen pa paragjykuar statusin e elementit të të dhënave të përcaktuara në tabelat e kërkesave të të dhënave. Për shembull D.E 5/8 Identifikimi i mallrave është shënuar si i detyrueshëm (statusi 'A') në tabelën e kërkesave të të dhënave në Kreun I, Kapitulli 1 të këtij Aneksi për autorizimet e përpunimit aktiv (kolona 8a) dhe të përpunimit pasiv (kolona 8b); por ky informacion nuk është i detyrueshëm në rast të përpunimit aktiv ose pasiv me mallra ekuivalente dhe në rast të përpunimit pasiv me sistemin e shkëmbimit standard, siç përshkruhet në Kreun I, Kapitulli 2 të këtij Aneksi.

8. Nëse nuk tregohet ndryshe nga shenjat që kanë të bëjnë me elementin e të dhënave në fjalë, atëherë elementet e të dhënave të renditura në tabelën përkatëse për kërkesat për të dhëna, mund të përdoren si për qëllimet e aplikimeve ashtu edhe të vendimeve.

9. Statusi i shënuar në tabelën e mëposhtme për kërkesat për të dhëna, nuk ka asnjë ndikim në faktin se disa të dhëna sigurohen vetëm në rrethana të justifikuara. Për shembull, D.E. 5/6 Mallrat ekuivalente duhet të përdoren vetëm nëse kërkohet përdorimi i mallrave ekuivalente në përputhje me nenin 201 të Kodit.

10. Në rast se aplikimi për përdorimin e një regjimi të posaçëm përveç transitit, është bërë në përputhje me nenin 531, përveç kërkesave për të dhëna të deklaratës doganore, siç parashikohet në Kreun I, Kapitulli 3, i nenit 1 të Aneksit B SHTOJCA A në lidhje me regjimin në fjalë, duhet të sigurohet dhe grupi i të dhënave siç është përcaktuar në kolonën 8 f të tabelës për kërkesat për të dhëna në Kreun I të këtij Aneksi.

KREU I

Aplikimet dhe Vendimet

KAPITULLI 1

Legjenda e tabelës

Kolonat	Lloji i aplikimit / vendimit	Referenca ligjore	Nr. i Kreut për kërkesat e veçanta të të dhënave
D.E. Numri i urdhrit	Numri i urdhërit për elementin e të dhënave në fjalë		
D.E. Emri	Emri i elementit të të dhënave në fjalë		
Vendimet që lidhen me informacionin detyrues			
1a	Aplikimi dhe vendimi i lidhur me informacionin detyrues tarifor (vendimi IDT)	Neni 36 i Kodit	Kreu II
1b	Aplikimi dhe vendimi i lidhur me informacionin detyrues të origjinës (vendimi IDO)	Neni 36 i Kodit	Kreu III
Operatori i autorizuar ekonomik			
2	Aplikimi dhe autorizimi për statusin e operatorit të autorizuar ekonomik	Neni 40 i Kodit	Kreu IV
Vlerësimi doganor			
3	Aplikimi dhe autorizimi për thjeshtësimet e përcaktimit të shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave	Neni 69 i Kodit	Kreu V
Garancia globale dhe shtyrja e pagesës			
4a	Aplikimi dhe autorizimi për depozitimin e një garancie globale duke përfshirë reduktime të mundshme ose heqjen dorë	Neni 90 i Kodit	Kreu VI
4b	Aplikimi dhe autorizimi për shtyrjen e afatit të pagesës për detyrimet e pagueshme për sa kohë që leja nuk është dhënë në lidhje me një operacion të vetëm	Neni 103 i Kodit	Kreu VII
4c	Aplikimi dhe vendimi për shlyerje ose përjashtim të shumës të detyrimit të importit ose eksportit	Neni 109 i Kodit	Kreu VIII
Formalitetet lidhur me mbërritjen e mallrave			
5	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e ambjenteve të magazinimit të përkohshëm	Neni 138 i Kodit	Kreu IX
Statusi doganor i mallrave			
6a	Aplikimi dhe autorizimi për të lejuar shërbime të rregullta të transportit detar	Neni 295	Kreu X
6b	Aplikimi dhe autorizimi për statusin e lëshuesit të autorizimit	Neni 290	Kreu XI

Kolonat	Lloji i aplikimit / Vendimit	Referenca ligjore	Nr. i Kreut për kërkesat e veçanta të të dhënave
	Formalitetet doganore		
7a	Aplikimi dhe autorizimi për të përdorur deklaratën e thjeshtuar	Neni 152(2) i Kodit	Kreu XII
7b	Aplikimi dhe autorizimi për zhdoganimin e centralizuar	Neni 163 i Kodit	Kreu XIII
7c	Aplikimi dhe autorizimi për të bërë një deklaratë doganore përmes hyrjes në regjistrimet e deklaruesit duke përfshirë regjimin e eksportit	Neni 165 i Kodit	Kreu XIV
7d	Aplikimi dhe autorizimi për vetëvlerësim	Neni 167 i Kodit	Kreu XV
7e	Aplikimi dhe autorizimi për hartimin e certifikatës për peshimin e bananeve	Neni 393	Kreu XVI
	Regjime të posaçme		
8a	Aplikimi dhe autorizimi për të përdorur regjimin e përpunimit aktiv	Neni 192(1)a) i Kodit	Kreu XVII
8b	Aplikimi dhe autorizimi për të përdorur regjimin e përpunimit pasiv	Neni 192(1)a) i Kodit	Kreu XVIII
8c	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use)	Neni 192(1)a) i Kodit	([1])
8d	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm	Neni 192(1)a) i Kodit	([1])
8e	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e ambjenteve të magazinimit për magazinimin doganor të mallrave	Neni 192 (1)b) i Kodit	Kreu XIX
8f	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e lejimit të përkohshëm, përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), përpunimit aktiv ose pasiv në situatat kur zbatohet Neni 531	Neni 192(1)a) i Kodit dhe Neni 531	([1])
	Transiti		
9a	Aplikimi dhe autorizimi për statusin e pritësit të autorizuar për qëllime të TIR	Neni 205 i Kodit	([1])
9b	Aplikimi dhe autorizimi për statusin e dërguesit të autorizuar për regjimin e transitit	Neni 207(4)a) i Kodit	Kreu XX

Kolonat	Lloji i aplikimit/ vendimit	Referenca ligjore	Nr. i Kreut për kërkesat e veçanta të të dhënave
9c	Aplikimi dhe autorizimi për statusin e pritesit të autorizuar për regjimin e transitit	Neni 207(4)b) i Kodit	(1)
9d	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë	Neni 207(4)c) i Kodit	Kreu XXI
9e	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e deklaratës së transitit me të dhëna të reduktuara	Neni 207(4)ç) i Kodit	(1)
9f	Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e një dokumenti transporti elektronik si deklaratë doganore	Neni 207(4)d) i Kodit	—

(1) Nuk kërkohen të dhëna të veçanta

Simbolet në legjendë

Simboli	Përshkrimi i simbolit
A	I detyrueshëm: Të dhënat e kërkuara nga autoriteti kompetent
B	Fakultativ për Autoritetet Doganore : Të dhënat që autoriteti kompetent mund të vendosë për t'i hequr.
C	Fakultativ për aplikuesin : Të dhënat që aplikuesi mund të vendosë për t'i plotësuar, por të cilat nuk mund të kërkohen nga autoriteti kompetent.

Grupet e të dhënave

Grupi	Emërtimi i grupit
Grupi 1	Informacioni për aplikimin / vendimin
Grupi 2	Referencat e dokumenteve mbështetëse, certifikatave dhe autorizimeve
Grupi 3	Palët
Grupi 4	Datat, orët, periudhat dhe vendet
Grupi 5	Identifikimi i mallrave
Grupi 6	Kushtet dhe afatet
Grupi 7	Aktivitetet dhe regjimet
Grupi 8	Të tjera

Shenjat

Lloji i shenjës	Përshkrimi i shenjës
[*]	Ky element i të dhënave përdoret vetëm për aplikimin në fjalë.
[+]	Ky element i të dhënave përdoret vetëm për vendimin në fjalë.

Tabela për kërkesat e të dhënave

D.E.Nr i urdhrit	D.E. emri	1a	1b	2	3	4a	4b	4c	5	6a	6b	7a	7b	7c	7d	7e	8a	8b	8c	8d	8e	8f	9a	9b	9c	9d	9e	9f
Group 1 — Application/Decision information																												
1/1	Lloji I kodit të aplikimit/vendimit	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A		A	A	A	A	A	A
1/2	Nënshkrimi /vërtetimi	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A		A	A	A	A	A	A
1/3	Lloji i aplikimit			A [*]	A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]
1/4	Vlefshmëria territorial/gjeografike					A	A		A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A		A	A	A	A		A
1/5	Vlefshmëria territorial/gjeografike në transit					A [1]																						A
1/6	Numri referencë i vendimit	A [+]	A [+]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]		A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]	A [2]
1/7	Autoriteti doganor për marrjen e vendimit	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]		A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]
Group 2 — Referencat e dokumentave mbështetëse , certifikatave dhe autorizimeve																												
2/1	Aplikime dhe vendime të tjera që lidhen me Informacionin e detyrueshëm	A [*]	A																									
2/2	Vendime qe lidhen me informacionin e detyrueshëm të lëshuar ndaj mbajtësve të tjerë	A [*]	A																									
2/3	Proçedurat ligjore ose administrative në process ose të mbyllura	A [*]	A [*]																									
2/4	Dokumentat shoqëruese	A [*]	A [*]	A [*]	A	A	A	A [3]	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A		A	A	A	A	A	A
2/5	Numri identifikues i magazinimit të përkohshëm								A [+]												A [+]							
Group 3 — Palët																												
3/1	Aplikuesi/mbajtësi i autorizimit ose vendimit	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]		A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]
3/2	Identifikimi I aplikuesit/mbajtësit të autorizimit ose vendimit	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A		A	A	A	A	A	A
3/3	Përfaqësuesit	A [*] [4]	A [*] [4]		A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]		A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]	A [4]
3/4	Identifikimi i përfaqësuesit	A [*]	A [*]		A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A		A	A	A	A	A	A
3/5	Emri dhe detajet e kontaktit të personit përgjegjës për çështjet			A [*]	A [*]	A [*] [5]				A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]		A [*] [5]							A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]

	doganore				[5]																								
3/6	Personi I kontaktit përgjegjës për aplikimin	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	C [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]
3/7	Personi përgjegjës për shoqërinë aplikuese ose për ushtrimin e kontrollit ndaj menaxhimit			A [*]	A [*] [5]	A [*] [5]				A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]		A [*] [5]							A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]
3/8	Pronari i mallrave																				A		A [6]						
	Group 4 —Datat, orët, periudhat dhe vendet																												
4/1	Vendi	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]		A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]	A [7]
4/2	Data	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A		A	A	A	A	A	A
4/3	Veni ku mbahen ose aksesohen llogaritë kryesore për qëllime doganore	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]		A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]		A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5] [8]					A [*] [5]	A [*] [5]	A [*] [5]
4/4	Vendi ku mbahen të dhënat				A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*] [9]	A [*]	A [*] [9]	A [*]	A [*] [8]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]
4/5	Vendi i parë i përdorimit ose i përpunimit																	A [*] [10]		A [*] [10]	A [*] [10]		A [*] [10]						
4/6	[E kërkuar] Data e fillimit të vendimit	A [+]	A [+]	A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]		C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*]A [+]	C [*]A[+]	C [*]A[+]	C [*]A [+]	C [*]A[+]		C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]	C [*] A [+]
4/7	Data e përfundimit të vendimit	A [+]	A [+]		A													A [+]	A [+]	A [+]	A [+]								
4/8	Vendodhja e mallrave								A [*] [11]					A	A	A	A							A	A	A			
4/9	Vendi I përpunimit ose I përdorimit																	A	A	A	A		A						
4/10	Zyra doganore e vendosjes nën regjim																	A	A	A	A	A							
4/11	Zyra doganore e mbylljes																	A	A	A	A	A	A						
4/12	Zyra doganore e garancisë					A [+]	A		A									A	A [12]	A	A	A							
4/13	Zyra doganore mbikëqyrëse								A [+]			A [+]	A [+]	A [+]	A [+]		A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]						
4/14	Zyra doganore e destinacionit																							C [*] A [+]		C [*] A [+]			A
4/15	Zyra doganore e nisjes																								C [*]				A

																							A [+]					
4/16	Afati kohor										A [+]		A [+]	A [+] [13]									A [+]	A [+]	A [+]			
4/17	Afati i mbylljes																A	A	A	A		A						
4/18	Dokumenti i mbylljes																A [+] [14]		A [+]			A [+] [15]						
Group 5 — Identifikimi i mallrave																												
5/1	Kodi i mallrave	C [*] A [+]	A		A			A [*]					A	A	A		A	A	A	A	C [*]							
5/2	Përshkrimi i mallrave	A	A		A		B	A [*]	A			A	A	A	A		A	A	A	A	A							
5/3	Sasia e mallrave	A [+]						A [*]					A		A		A	A	A	A								
5/4	Vlera						B										A	A	A	A								
5/5	Koeficienti i shfrytëzimit																A	A	A			A [16]						
5/6	Mallrat ekuivalente																A	A	A	A	A							
5/7	Produktet e përpunuara																A	A	A			A [17]						
5/8	Identifikimi i mallrave																A	A	A	A	A	A						
5/9	Kategoritë e përjashtuara ose lëvizja e mallrave																						A [+]	A [+]	A [+]			
Group 6 — Kushtet dhe afatet																												
6/1	Ndalimet dhe kufizimet											A [*]	A	A	A													
6/2	Kushtet ekonomike																A	A				A [17]						
6/3	Vërejtje të përgjithshme	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A[+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]	A [+]
Group 7 — Aktivitetet dhe regjimet																												
7/1	Lloji i transaksionit	A [*]	A																									
7/2	Lloji i regjimit doganor					A	A					A	A	A	A													
7/3	Lloji i deklaratës												A		A													
7/4	Numri i operacioneve					B[*]						A [*]	A [*]	A [*]	A [*]								A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]
7/5	Detajet e aktiviteteve të												A				A	A	A	A	A	A						

	planifikuara																													
Group 8 – Others																														
8/1	Lloji i llogarive kryesore për qëllime doganore					A [*]			A [*]		A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*] [8]					A [*]	A [*]	A [*]
8/2	Lloji i të dhënave					A [*]			A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*] [8]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]
8/3	Aksesi ndaj të dhënave														A														A
8/4	Mostrat etj.	A [*]	A																										
8/5	Informacioni shtesë	C [*]	C [*]		C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]	C [*]
8/6	Garancia							A		A								A [18]	A [12]	A	A	A							
8/7	Shuma e garancisë									A								A [18]	A [12]	A	A	A							
8/8	Transferimi I të drejtave dhe detyrimeve																	A	A	A	A	A							
8/9	Fjalët kyçe	A [+]	A [+]																										
8/10	Detaje rreth magazinimit të përkohshëm									A												A							
8/11	Magazinimi i mallrave shqiptare									A												A							
8/12	Miratimi për publikim në listën e mbajtësve të autorizimit			A [*]	A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]		A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]	A [*]
8/13	Llogaritja e shumës së detyrimit të importit në përputhje me nenin 78(3) i Kodit																	A					A [19]						

Shënime

Nr. i shënimit	Përshkrimi i shënimit
[1]	Ky element i të dhënave do të plotësohet vetëm në rastet kur autorizimi për të siguruar një garanci globale do të përdoret për vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit.
[2]	Ky element i të dhënave do të përdoret në aplikim vetëm në rast aplikimi për ndryshim, rinovim ose revokim të vendimit.
[3]	Pa cënuar dispozitat e veçanta të miratuara në bazë të politikës së përbashkët bujqësore, aplikimi në lidhje me mallrat, për të cilat është lëshuar një liçensë importi apo eksporti, kur është parashtruar deklarata përkatëse doganore, do të mbështetet nga çertifikimi prej autoriteteve përgjegjëse për dhënien e liçensës së tillë që vërteton se janë marrë hapat e nevojshme për të anuluar efektet e saj. Çertifikimi i mësipërm nuk është i detyrueshëm, kur: (A) autoriteti doganor për të cilin është paraqitur aplikimi, e ka lëshuar vetë liçensën; (B) arsyeja e aplikimit është një gabim që nuk ka asnjë efekt në dhënien e licenses/autorizimit. Dispozitat e mësipërme zbatohen edhe në rastin e ri-eksportimit, vendosjes së mallrave në një magazinë doganore ose në një zonë të lirë, ose në rastin e shkatërrimit të mallrave.
[4]	Ky informacion është i detyrueshëm vetëm në rastet kur numri RIOE i personit nuk është nevojshëm. Kur është dhënë numri RIOE, emri dhe adresa nuk duhet të jepen, vetëm nëse është përdorur një aplikim apo vendim i bazuar në letër.
[5]	Ky informacion nuk do të jepet nëse aplikuesi është një operator ekonomik i autorizuar.
[6]	Ky informacion nuk do të jepet nëse aplikimi lidhet me përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm si dhe informacioni kërkohet në bazë të ligjislacionit doganor.
[7]	Ky informacion do të përdoret vetëm në rast aplikimi me letër.
[8]	Nëse synohet të përdoret një magazinë doganore publike e tipit II, atëherë ky element i të dhënave nuk do të përdoret.
[9]	Ky informacion nuk do të kërkohet në rast se zbatohet Neni 530.
[10]	Ky informacion do të jepet vetëm nëse zbatohet Neni 530.
[11]	Ky informacion mund të mos jepet në rastet kur legjislacioni doganor i R.SH. nuk parshikon detyrimin për të paraqitur mallrat.
[12]	Në rast aplikimi për përdorim e regjimit të përpunimit pasiv, ky element i të dhënave nuk do të përdoret, me përjashtim të rastit kur zbatohet para importimit të produkteve zëvendësuese ose produkteve të përpunuara.
[13]	Ky informacion do të jepet në vendim vetëm në rast se mbajtësi i autorizimit nuk është përjashtuar nga detyrimi për të paraqitur mallrat.
[14]	Ky informacion do të përdoret vetëm në rast autorizimi për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv IM/EX.
[15]	Ky informacion do të përdoret vetëm në rast të një autorizimi që lidhet me përdorimin e përpunimit aktiv IM/EX, përpunimit aktiv EX/IM pa përdorimin e INF ose përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use).
[16]	Ky informacion do të përdoret vetëm në rast se kërkesa lidhet me përdorimin e përpunimit aktiv ose pasiv ose përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use), dhe përdorimi i veçantë përfundimtar (end-use) përfshin përpunimin e mallrave.
[17]	Ky informacion do të jepet vetën në rast se aplikimi lidhet me përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv ose pasiv.

[18]	Në rast kërkese për përdorim të regjimit të përpunimit aktiv EX/IM, ky element i të dhënave nuk do ~~të përdoret, përveç rastit kur zbatohen detyrimet e eksportit.~~
[19]	Ky informacion do të përdoret vetëm në rast se kërkesa lidhet me përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv.

KAPITULLI 2
Shënime që lidhen me kërkesat për të dhëna

Hyrje
Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat për të dhëna në Kapitullin1.

Kërkesat për të dhëna

Grupi 1 – Informacioni i Aplikimit / Vendimit

1/1. Lloji i kodit të Aplikimit / Vendimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikimi:
Duke përdorur kodet përkatëse, tregoni autorizimin ose vendimin për të cilin aplikohet.

Vendimi:
Duke përdorur kodet përkatëse, tregoni llojin e autorizimit ose vendimit.

1/2. Nënshkrimi / Vërtetimi

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikimi:

Aplikimet e bazuara në letër duhet të nënshkruhen nga personi që dorëzon aplikimin. Nënshkruesi duhet të saktësojë pozicionin e tij.

Aplikimet e bëra duke përdorur një teknikë elektronike të përpunimit të të dhënave, do të vërtetohen nga personi që dorëzon aplikimin (aplikuesi ose përfaqësuesi).

Vendimi:
Nënshkrimi ose autentifikimi i vendimeve të bazuara në letër, përveçse vendimeve të dhëna duke përdorur teknikën elektronike të përpunimit të të dhënave, nga ana e personit i cili merr vendimin për dhënien e autorizimit për informacionet e detyrueshme , rimbursimin ose faljen e detyrimeve të importit ose të eksportit.

Kolona 1a e tabelës:

Nëse aplikuesi ka një referencë, ajo duhet të plotësohet
këtu.

Kolona 2 e tabelës:

Nënshkruesi duhet të jetë personi i cili përfaqëson aplikuesin si një i tërë.

1/3. Lloji i aplikimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Duke përdorur kodin përkatës, tregoni llojin e aplikimit. Në rast të aplikimit për ndryshim ose, nëse është e zbatueshme, të rinovimit të autorizimit , gjithashtu tregoni numrin e duhur të vendimit në D.E. 1/6 Numri i referencës së vendimit.

1/4. Vlefshmëria territoriale e autorizimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Duke përjashtuar nenin 30 të Kodit, tregoni se efekti i vendimit është i kufizuar në një ose disa zyra doganore, duke **përmendur** në mënyrë të shprehur zyrën doganore përkatëse.

1/5. Vlefshmëria territoriale – regjimi i transitit të përbashkët në raste të veçanta

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni vendet e transitit të përbashkët ku mund të përdoret autorizimi.

1/6. Numri i referencës së vendimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Referenca unike e dhënë nga autoriteti doganor kompetent që merr vendimin.

1/7. Autoriteti doganor për marrjen e vendimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Numri i **identifikimit** ose emri dhe adresa e autoritetit doganor i cili merr vendimin.

Kolona 1b e tabelës:

Numri i **identifikimit** apo **nënshkrimi** dhe emri i **autoritetit** doganor kompetent që ka dhënë vendimin.

Kolona 2 e tabelës:

Vërtetimi dhe emri i zyrës doganore kompetente. Emri i zyrës doganore kompetente mund të përmendet në nivel rajonal, në qoftë se struktura organizative e **administratës** doganore e kërkon atë.

Grupi 2 - Referencat e dokumenteve shoqëruese, certifikatave dhe autorizimeve

2/1. Aplikime dhe vendime të tjera në lidhje me informacionin e detyrueshëm

Kolona 1a e tabelës:

Shënoni (po / jo), nëse aplikuesi ka aplikuar apo ka marrë një vendim/autorizim IDT për mallrat identike ose të ngjashme në R.SH. me ato të përshkruara në D.E. 5/2 Përshkrimi i mallrave në këtë Kre dhe D.E. II / 3 Emërtimi tregtar dhe **informacioni** shtesë në Kreun II. Nëse po, duhet të plotësohet **informacioni** i mëposhtëm:

Autoriteti kompetent i aplikimit:
Autoritetikompetent ku është paraqitur kërkesa

Vendi i aplikimit: Vendi ku është paraqitur aplikimi

Data e aplikimit: data në të cilën autoriteti doganor kompetent i përmendur në nenin 27 (1) nënparagrafi 3 i Kodit, ka pranuar aplikimin.

Numri i referencës së vendimit/autorizimit IDT: Numri i referencës së vendimit/autorizimit IDT, të cilën **aplikuesi** e ka marrë tashmë. Kjo pjesë është e **detyrueshme** nëse aplikuesi ka marrë vendime IDT pas aplikimit të tij.

Data e fillimit të **vendimit/autorizimit** : Data në të cilën fillon vlefshmëria e

vendimit/autorizimit IDT.

Kodi i Mallit: Kodi i **nomenklaturës** i treguar në vendimin IDT.

Kolona 1b e tabelës:

Tregoni nëse aplikuesi ka aplikuar apo ka marrë një vendim/autorizim IDO dhe / ose një vendim/autorizim IDT për mallrat ose materialet identike ose të ngjashme me ato të referuara në D.E. 5/1 Kodi i Mallrave dhe D.E. 5/2.

Pershkrimi i mallrave ne kete Kre ose D.E. Ill / 3 ne Kreun Ill; duke dhene detajet perkatese. Nese po, duhet te jepet gjithashtu numri i references i **vendimitlautorizimit** IDO dhe / ose **vendimitlautorizimit** IDT ne fjale.

2/2. Vendimet/autorizimet në lidhje me informacionin detyrues të lëshuar ndaj mbajtësve të tjerë

Kolona 1a e tabelës:

Tregoni nëse aplikuesi është ose jo në dijeni të vendimeve/autorizimeve IDT të lëshuara për mbajtësit e tjerë për mallra identike ose të ngjashme me ato të përshkruara në D.E. 5/2 Përshkrimi i mallrave në këtë Kre dhe D.E. II / 3 Emërtimi tregtar dhe informacioni shtesë në Kreun II. Informacioni në lidhje me vendimet/autorizimet ekzistuese IDT mund të konsultohet në bazë të të dhënave publike që janë të **disponueshme** në internet.

Nëse po, elementet e **mëposhtme** shtesë janë opsionale:
Numri i referencës së vendimit/autorizimit IDT: Numri i referencës së vendimit/autorizimit IDT për të cilin aplikuesi është në dijeni
Data e fillimit të **vendimit/autorizimit**: Data në të cilën fillon vlefshmëria e vendimit/autorizimit IDT
Kodi i Mallit: Kodi i **nomenklaturës** i treguar në **vendimin/autorizimin** IDT.

Kolona 1b e tabelës:
Tregoni nëse, në dijeni të aplikuesit, është aplikuar apo lëshuar një vendim/autorizim IDO dhe / ose IDT për mallra identike apo të ngjashme në R.SH.

Nëse po, elementet e **mëposhtme** shtesë janë opsionale:

Numri i referencës së **vendimit/autorizimit** IDO dhe / ose IDT: numri i referencës së vendimit/autorizimit IDO dhe / ose IDT për të cilin aplikuesi është në dijeni.
Data e fillimit të **vendimit/autorizimit** : Data në të cilën fillon vlefshmëria e **vendimit/autorizimit** IDO dhe / ose IDT.
Kodi i Mallit: kodi i **nomenklaturës** i treguar në vendimin IDO dhe / ose IDT.

2/3. Proçedurat ligjore ose administrative në proçes ose të mbyllura
Kolona 1a e tabelës:

Tregoni nëse aplikuesi është ose jo në dijeni për çdo proçedurë ligjore ose administrative në lidhje me klasifikimin tarifor në proçes, ose një vendim gjykate të marrë mbi klasifikimin tarifor, në lidhje me mallrat e përshkruara nën D.E. 5/2. Përshkrimi i mallrave dhe D.E. II / 3 Emërtimi tregtar dhe **informacioni** shtesë në Kreun II.
Nëse po, elementet e mëposhtme shtesë janë opsionale:

Shkruani emrin dhe adresën e gjykatës, numrin e referencës së rastit në proçes dhe / ose vendimit, dhe çdo **informacion** tjetër përkatës.

Kolona 1b e tabelës:

Tregoni nëse, në dijeni të aplikuesit, mallrat e përshkruara në D.E. 5/1. Kodi i Mallrave dhe D.E. 5/2. Përshkrimi i mallrave në këtë Kre, apo në D.E. III / 3 Kushtet që mundësojnë përcaktimin e origjinës në Kreun III janë subjekt i ndonjë proçedure gjyqësore ose administrative në proçes lidhur me origjinën ose një vendim gjykate i marrë mbi origjinën.

Shkruani emrin dhe adresën e gjykatës, numrin e referencës së rastit në proçes dhe / ose vendimit, dhe çdo **informacion** tjetër përkatës.

2/4. Dokumentet bashkëngjitur

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Jepni informacion mbi llojin dhe, nëse është e zbatueshme, numrin e identifikimit dhe / ose datën e lëshimit të dokumentit(eve) bashkëngjitur aplikimit ose vendimit. Tregoni edhe numrin e përgjithshëm të dokumenteve të bashkëngjitura.

Nëse dokumenti përmban vazhdimin e informacionit të dhënë diku tjetër në aplikim apo vendim, tregoni një referencë për elementin e të dhënave në fjalë.

2/5. Numri i identifikimit të magazinimit të përkohshëm

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Nëse është e zbatueshme, shënoni çdo numër identifikues të caktuar nga autoritetet doganore të vendim-marrjes për magazinimin e përkohshëm.

Grupi 3 - Palët

3/1. Aplikuesi/ Mbajtësi i autorizimit ose vendimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikimi:
Aplikuesi është personi i cili aplikon tek autoritetet doganore për autorizim.
Shënoni emrin dhe adresën e personit në fjalë.

Vendimi/autorizimi:
Mbajtësi i vendimit është personi të cilit i është lëshuar vendimi.

Mbajtësi i autorizimit është personi të cilit i është lëshuar autorizimi.

3/2. Aplikuesi/ mbajtësi i autorizimit ose identifikimi i vendimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikuesi:
Aplikuesi është personi i cili aplikon pranë autoriteteve doganore për një vendim.

Shënoni numrin e regjistrimit dhe numrin e identifikimit të operatorëve ekonomikë (numri RIOE), të personit në fjalë, siç parashikohet në nenin 1 (26).

Në rast të një aplikimi të bërë duke përdorur teknikën elektronike të përpunimit të të dhënave, numri RIOE i aplikuesit jepet gjithmonë.

Vendimi:
Mbajtësi i vendimit është personi për të cilin është lëshuar vendimi.

Mbajtësi i autorizimit është personi për të cilin është lëshuar

autorizimi.

3/3. Përfaqësuesi

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Nëse aplikuesi i treguar në D.E. 3/1 Aplikuesi/ Mbajtësi i autorizimit ose vendimit ose D.E. 3/2 Aplikuesi/ mbajtësi identifikimit të autorizimit ose vendimit është i përfaqësuar, siguroni informacionet përkatëse për përfaqësuesin.

Nëse kërkohet nga autoriteti doganor i vendim-marrjes në përputhje me nenin 25 (2) të Kodit, siguroni një kopje të kontratës përkatëse, autorizimin apo ndonjë dokument tjetër i cili vërteton statusin e përfaqësuesit.

3/4. Identifikimi i përfaqësuesit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Nëse aplikuesi i treguar në D.E. 3/1 Aplikuesi / Mbajtësi i autorizimit ose vendimit ose D.E. 3/2 Aplikuesi/ mbajtësi i identifikimit të autorizimit ose vendimit, ka përfaqësues, shkruani numrin RIOE të përfaqësuesit.

Nëse kërkohet nga autoriteti doganor i vendim-marrjes në përputhje me nenin 25 (2) të Kodit, siguroni një kopje të kontratës përkatëse, autorizimin apo ndonjë dokument tjetër i cili vërteton statusin e përfaqësuesit.

3/5. Emri dhe detajet e personit përgjegjës për çështjet doganore

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Informacioni i kontaktit, duke përfshirë edhe numrin e faksit, nëse është e zbatueshme, të personit në fjalë, i cili mund të përdoret për kontakt dhe komunikim të mëtejshëm në lidhje me çështjet doganore.

3/6. Personi i kontaktit përgjegjës për aplikimin

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Personi i kontaktit do të jetë përgjegjës për mbajtjen në kontakt me doganën për sa i përket aplikimit.

Ky informacion do të sigurohet vetëm nëse është i ndryshëm nga personi përgjegjës për çështjet doganore, siç parashikohet në D.E. 3/5 Emri dhe detajet e personit të kontaktit përgjegjës për çështjet doganore.

Shënoni emrin e personit të kontaktit si dhe secilën prej këtyre në vijim:
numrin e telefonit, adresën e e-mailit (mundësisht të një llogarie funksionale) dhe, nëse është e aplikueshme, numrin e faksit.

3/7. Personi përgjegjës i shoqërisë aplikuese ose ushtron kontroll mbi menaxhimin

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Për qëllime të Nenit 41 (a) të Kodit, shkruani emrin (at) dhe detajet e plota të personit (ave) në fjalë në bazë të themelimit / formës ligjore të shoqërisë aplikuese, në mënyrë të veçantë: drejtori / menaxheri i shoqërisë, drejtorët e këshillit dhe anëtarët e këshillit, nëse ka ndonjë të tillë. Detajet duhet të përmbajnë: emrin e plotë dhe adresën, datën e lindjes dhe numrin e identifikimit.

3/8. Pronari i mallrave

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Kur është e aplikueshme sipas nenit përkatës, shkruani emrin dhe adresën e pronarit jo shqiptar të mallrave për t'u vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm, siç përshkruhet në D.E. 5/1. Kodi Mallrave dhe D.E. 5/2. Përshkrimi i mallrave.

Grupi 4 – Datat, orët, periudhat dhe vendet

4/1. Vendi
Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikimi:
Vendi në të cilin aplikimi është nënshkruar ose ndryshe autentifikuar.

Vendimi:
Vendi në të cilin është dhënë autorizimi apo vendimi në lidhje me informacionin detyrues të origjinës ose rimbursimin ose faljen e detyrimeve të importit ose të eksportit.

4/2. Data

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikimi:
Datën në të cilën aplikuesi ka nënshkruar ose autentifikuar aplikimi.

Vendimi:
Data në të cilën është marrë autorizimi apo vendimi në lidhje me informacionin detyrues ose rimbursimin ose faljen e detyrimeve të importit ose të eksportit.

4/3. Vendi ku mbahen ose aksesohen llogaritë kryesore për qëllime doganore

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Llogaritë kryesore për qëllime doganore të përmendura në nenin 27 (1) nënparagrafi 3 i Kodit janë ato llogari që konsiderohen nga autoritetet doganore si llogari kryesore për qëllime doganore duke i lejuar autoriteteve doganore të mbikëqyrin dhe monitorojnë të gjitha aktivitetet të cilat mbulohen nga autorizimi në fjalë. Materialet ekzistuese tregtare, tatimore të aplikuesit ose materiale të tjera të kontabilitetit, mund të pranohen si llogari kryesore për qëllime doganore, në qoftë se ata lehtësojnë kontrollet e auditimit.

Shkruani adresën e plotë të vendndodhjes, duke përfshirë **vendin** ku llogaritë kryesore janë të destinuara për t'u mbajtur ose janë të destinuara të jenë të aksesueshme. OKB-ja / LOCODE mund të zëvendësojnë adresën, në qoftë se ajo u siguron një identifikim të qartë të **vendndodhjes** në fjalë.

Kolona 1a dhe 1b e tabelës:

Në rast të informacionit detyrues, informacioni duhet të jepet vetëm kur vendi është i ndryshëm nga të dhënat e siguruara për **identifikimin** e aplikuesit.

4/4. Vendin ku mbahen të dhënat

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shkruani adresën e plotë të vendndodhjes(ve) duke përfshirë degën doganore ku mbahen ose synohen të mbahen të dhënat e kërkuesit. OKB-ja / LOCODE mund ta zëvendësojë adresën, në qoftë se ajo i siguron një identifikim të qartë të **vendndodhjes** në fjalë.

Ky informacion është i nevojshëm për të identifikuar vendndodhjen e të dhënave që kanë të bëjnë me mallrat e vendosura nën adresën e **parashikuar** në D.E. 4/8. **Vendndodhja** e mallrave.

4/5. Vendi i parë i përdorimit ose përpunimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Duke **përdorur** kodin **përkatës**, shkruani adresën e vendit në fjalë.

4/6. [E kërkuar] Data e fillimit të vendimit

Kolonat 1a dhe 1b të tabelës:

Data në të cilën fillon **vlefshmëria** e vendimit në lidhje me **informacionin** detyrues.

Kolona 2 e tabelës:

Tregoni ditën, muajin dhe vitin, në përputhje me nenin 47.

Kolonat 3; 4a; 5; 6a; 6b; 7a për 7E, 8a të 8E dhe 9a në 9F të tabelës:

Aplikimi:
Aplikuesi mund të kërkojë që vlefshmëria e autorizimit të fillojë në një ditë të caktuar. Kjo datë megjithatë duhet të marrë parasysh afatet e përcaktuara në nenin 27 (2) dhe (3) të Kodit dhe data e kërkuar nuk mund të jetë më e hershme se data e shënuar në nenin 27 (4) të Kodit.

Vendimi:
Data në të cilën autorizimi hyn në fuqi.

Kolona 4b e tabelës:

Aplikimi:
Aplikuesi mund të kërkojë që vlefshmëria e autorizimit të fillojë në një ditë të caktuar. Kjo datë megjithatë duhet të marrë parasysh afatet e përcaktuara në nenin 27 (2) dhe (3) të Kodit dhe nuk mund të jetë më e hershme se data e shënuar në nenin 27 (4) të Kodit.

Vendimi:
Data e fillimit të periudhës së parë operative e caktuar nga autoriteti për qëllime të llogaritjes së afatit të shtyrë për pagesë.

4/7. Data e përfundimit të vendimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Data në të cilën **përfundon** vlefshmëria e autorizimit ose vendimit në lidhje me **informacionin** detyrues.

4/8. Vendndodhja e mallrave

Kolona 4c e tabelës:

Shënoni emrin dhe adresën e vendndodhjes në fjalë, duke përfshirë kodin postar, nëse kjo është e aplikueshme. Në rast se aplikimi paraqitet duke përdorur teknikën elektronike të përpunimit të të dhënave, atëherë kodi përkatës mund të zëvendësojë adresën, në qoftë se ajo i siguron një identifikim të qartë të vendndodhjes në fjalë.

Kolona 7e e tabelës:

Duke përdorur kodin përkatës, shënoni identifikuesin e vendndodhjes ku bëhet peshimi i bananeve.

Kolonat nga 7B deri në 7D të tabelës:

Duke përdorur kodin përkatës, shënoni identifikuesin e vendit ku mallrat mund të gjenden kur vendosen nën një regjim doganor.

Kolona 9a e tabelës:

Duke përdorur kodin përkatës, shkruani identifikuesin e vendit (eve) ku mallrat do të merren sipas operacionit TIR.

Kolona 9b e tabelës:

Duke përdorur kodin përkatës, shënoni identifikuesin e vendit (eve) ku mallrat do të vendosen nën regjimin e transitit të Bashkimit.

Kolona 9c e tabelës:

Duke përdorur kodin përkatës, shënoni identifikuesin e vendit (eve) ku mallrat do të merren nën regjimin e transitit të Bashkimit.

4/9. Vendi(et) i përpunimit apo përdorimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Duke përdorur kodin përkatës, tregoni adresën e vendit (eve) përkatës.

4/10. Zyra(at) doganore e vendosjes në regjim

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shëno zyrën(at) e propozuar doganore siç parashikohet në nenin 1 (23).

4/11. Zyra(at) doganore të shfuqizimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shëno zyrën(at) e propozuar doganore.

4/12. Zyra doganore e garancisë

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni zyrën doganore në fjalë.

4/13. Zyra doganore mbikqyrëse

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni zyrën doganore kompetente, siç parashikohet në nenin 1 (49).

4/14. Zyra(at) doganore të destinacionit

Kolonat 9a dhe 9c të tabelës:

Tregoni zyrën(at) doganore të **destinacionit** përgjegjës për vendin ku mallrat janë pranuar nga pritësi i autorizuar.

Kolona 9f e tabelës:

Tregoni zyrën(at) doganore të **destinacionit kompetent** për **aeroportin(et)**/ portin(et) e destinacionit.

4/15. Zyra(at) doganore të nisjes

Kolona 9b e tabelës:

Tregoni zyrën(at) doganore të nisjes përgjegjëse për vendin ku mallrat do të vendosen nën regjimin e transitit

Kolona 9f e tabelës:

Tregoni zyrën(at) doganore të nisjes **kompetente** për **aeroportin(et)**/ portin(et) e nisjes.

4/16. Afati

Kolona 6b e tabelës:

Tregoni afatin kohor në minuta gjatë së cilës zyra doganore mund të kryejë kontrolle para nisjes së mallrave.

Kolona 7b e tabelës:

Tregoni afatit në minuta gjatë së cilës zyra doganore e paraqitjes do të informojë zyrën doganore mbikëqyrese për qëllimin e saj për të kryer një kontroll para se të **lëshohen** mallrat.

Kolona 7c e tabelës:

Tregoni afatit në minuta gjatë së cilës zyra doganore mund të tregojë synimin e saj për të kryer një kontroll para se të lëshohen mallrat.

Kolona 9a dhe 9c e tabelës:

Tregoni afat kohor në minuta gjatë së cilës pritësi i **autorizuar** duhet të marrë lejen e shfuqizimit.

Kolona 9b e tabelës:

Tregoni afatin kohor të shprehur në minuta që është në dispozicion të zyrës doganore të nisjes pas depozitimit të deklaratës së transitit nga dërgues të autorizuar brenda së cilit ky organ mund të kryejë të gjitha kontrollet e **nevojshme** para lëshimit dhe daljes së mallrave.

4/17. Periudha e mbylljes

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shëno periudhën e përafërt të shprehur në muaj që është e nevojshme për operacionet që duhet të kryhen apo përdoren brenda regjimit të posaçëm të kërkuar.

Tregoni nëse është e **zbatueshme** zgjatja **automatike** e **periudhës** për mbyllje në pajtim me nenin 548 (2).

Kolona 8a e tabelës:

Autoriteti vendimmarrës doganor mund të përcaktojë në autorizim që periudha e shfuqizimit përfundon në ditën e fundit të muajit / tremujorit / semestrit pasues pas muajit / tremujorit / semestrit gjatë së cilit ka filluar periudha e mbylljes.

4/18. Dokumenti i mbylljes

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni, nëse është i nevojshëm përdorimi i **dokumentit** të mbylljes.

Nëse po, shënoni afatin siç parashikohet në Nenin 550 (1), brenda së cilit mbajtësi i autorizimit do t'i ofrojë zyrës doganore të mbikëqyrjes dokumentin e mbylljes.

Nëse është e **aplikueshme,** përcaktoni **përmbajtjen** e **dokumentit** të mbylljes, në përputhje me nenin 550 (3).

Grupi 5 - Identifikimi i mallrave

5/1. Kodi i mallrave

Kolona 1a e tabelës:

Aplikimi:
Shënoni kodin e **nomenklaturës** doganore sipas së cilës aplikuesi pret që të **klasifikohen** mallrat.

Vendimi:
Kodi i **Nomenklaturës** doganore, sipas së cilit mallrat duhet të **klasifikohen** në **nomenklaturën** doganore.

Kolona 1b e tabelës:

Aplikimi:
Titulli / nëntitulli (kodi i nomenklaturës doganore) sipas së cilit mallrat janë klasifikuar në një nivel të mjaftueshëm të detajuar për të mundësuar identifikimin e rregullit për përcaktimin e origjinës. Kur Kërkuesi për IDO është mbajtës i një **IDT** për të njëjtat mallra, tregoni kodin 8-shifror të **Nomenklaturës** së Kombinuar.

Vendimi:
Titulli / nëntitulli ose kodi 8-shifror i **Nomenklaturës** së kombinuar siç tregohet në kërkesë.

Kolona 3 e tabelës:

Shënoni kodin 8-shifror të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave.

Kolona 4c e tabelës:

Shënoni kodin 8-shifror të Nomenklaturës së Kombinuar, kodin(et) TARIC dhe, nëse është e aplikueshme, kodin(et) TARIC shtesë si dhe kodin(et) kombëtar shtesë të mallrave në fjalë.

Kolonat nga 7c deri në 7d të tabelës:

Shënoni të paktën 4 shifrat e para të kodit të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave në fjalë.

Kolonat nga 8a deri në 8b të tabelës:

Tregoni 4 shifrat e para të kodit të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave për t'u vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv ose pasiv.

Kodi 8 shifror i **Nomenklaturës** së kombinuar duhet të jepet kur:

do të përdoren mallrat **ekuivalente** ose sistemi i **shkëmbimeve** standarde,

mallrat mbulohen nga Aneksi 71-02,

mallrat nuk mbulohen nga Aneksi 71-02 dhe është përdorur kodi 22 i kushteve ekonomike (rregulli *de minimis*).

Kolona 8c e tabelës:

(1) Në qoftë se aplikimi ka të bëjë me mallrat që do të vendosen nën regjimin e posaçëm, përveç atyre që janë nën (2) si më poshtë, atëherë shënoni, sipas rastit, kodin 8-shifror të Nomenklaturës së Kombinuar (nënndarja 1), Kodin TARIC (nënndarja 2) dhe, nëse është e **aplikueshme,** kodin(et) TARIC shtesë (nënndarja 3).

(2) Në qoftë se aplikimi ka të bëjë me mallrat sipas dispozitave të posaçme (Pjesa A dhe B) të përfshira në pjesën e parë, Dispozitat paraprake, seksionin II të Nomenklaturës së Kombinuar (mallrat për kategori të caktuara të anijeve, varkave dhe barkave të tjera dhe për platformat shpuese apo të prodhimit / avion civil dhe mallrat për përdorim në aviacionin civil), atëherë kodet e nomenklaturës së kombinuar nuk janë të nevojshme.

Kolona 8d e tabelës:

Tregoni 4 shifrat e para të kodit të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave për t'u vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Kolona 8e e tabelës:

Tregoni 4 shifrat e para të kodit të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave për t'u vendosur nën regjimin e magazinimit doganor.

Nëse aplikimi mbulon një numër artikujsh të mallrave të ndryshëm, atehere elementi i të dhënave nuk mund të plotësohet. Në këtë rast, përshkruani natyrën e mallrave që do të ruhen në objektin e magazinimit në fjalë në D.E. 5/2. Përshkrimi i mallrave.

Kur mallrat ekuivalente përdoren nën magazinim doganor, atëherë duhet të jepet kodi 8 shifror i Nomenklaturës së kombinuar të mallrave.

5/2. Përshkrimi i mallrave

Kolona 1a e tabelës:

Aplikimi:
Përshkrim i detajuar i mallrave që lejojnë identifikimin e tyre dhe përcaktimin e klasifikimit të tyre në nomenklaturen doganore. Kjo duhet të përfshijë detaje të përbërjes së mallrave dhe çdo mënyrë ekzaminimi të përdorur për përcaktimin e saj, ne rastet kur klasifikimi varet nga kjo. Çdo detaj që aplikuesi konsideron si konfidencial, duhet të futet në D.E. II / 3 Emërtimi tregtar dhe informacionet shtesë të Kreut II.

Vendimi:
Përshkrimi i mallrave në detaje të mjaftueshme për të lejuar njohjen e tyre pa asnjë dyshim dhe duke bërë të mundur lehtësisht lidhjen e mallrave të përshkruara në vendimin IDT me mallrat e paraqitura për zhdoganim. Ai nuk duhet të përmbajë ndonjë detaj që aplikuesi ka shënuar si konfidencial në kërkesën IDT.

Kolona 1b e tabelës:

Aplikimi:
Përshkrim i detajuar i mallrave duke lejuar identifikimin e tyre.

Vendimi:
Përshkrimi i mallrave në detaje të mjaftueshme për të lejuar njohjen e tyre pa asnjë dyshim dhe duke bërë të mundur lehtësisht lidhjen e mallrave të përshkruara në vendimin IDO me mallrat e paraqitura.

Kolona 3 e tabelës:

Tregoni përshkrimin tregtar të mallrave.

Kolona 4c e tabelës:

Tregoni një përshkrim të zakonshëm tregtar të mallrave ose përshkrimin e tyre tarifor. Përshkrimi duhet të korrespondojë me atë të përdorur në deklaratën doganore të përmendur në D.E. Kreu VIII/1, për shlyerjen. Deklaroni numrin, llojin, shenjat dhe numrat e identifikimit të pakove. Në rastin e mallrave të paketuara, tregoni numrin e objekteve ose shpreheni "në masë".

Kolonat 7a deri në 7d dhe 8d të tabelës:

Tregoni përshkrimin tregtar dhe / ose teknik të mallrave. Përshkrimi tregtar dhe / ose teknik duhet të jetë mjaft i qartë dhe i detajuar për të mundësuar marrjen e vendimit për aplikimin.

Kolona 8a dhe 8b e tabelës:

Tregoni **përshkrimin** tregtar dhe / ose teknik të mallrave.

Përshkrimi tregtar dhe / ose teknik duhet të jetë mjaft i qartë dhe i detajuar për të mundësuar marrjen e vendimit për aplikimin. Kur është planifikuar për të përdorur mallrat ekuivalente ose sistemin standard të këmbimit, jepni detaje në lidhje me cilësinë tregtare dhe **karakteristikat** teknike të mallrave.

Kolona 8c e tabelës:

Tregoni përshkrimin tregtar dhe / ose teknik të mallrave. Përshkrimi tregtar dhe / ose teknik duhet të jetë mjaft i qartë dhe i detajuar për të mundësuar marrjen e vendimit për aplikimin.

Nëse aplikimi lidhet me mallrat sipas dispozitave të veçanta (Pjesa A dhe B) të përfshira në pjesën e parë, Dispozitat paraprake, seksionin II të Nomenklaturës së Kombinuar (mallrat për kategori të caktuara të anijeve, varkave dhe barkave të tjera dhe për platformat shpuese apo të prodhimit / avionët civilë dhe mallrat për përdorim në aviacionin civil), atëherë aplikuesi duhet të deklarojë për shembull: "Aviacioni civil dhe pjesët e tyre / dispozita të veçanta, pjesa B e Nomenklaturës së kombinuar '.

Kolona 5 dhe 8e e tabelës:

Shënoni të paktën nëse mallrat janë mallrat bujqësore dhe / ose industriale.

5/3. Sasia e mallrave

Kolona 1a e tabelës:

Ky element i të dhënave do të përdoret vetëm në rastet kur është dhënë periudha e përdorimit të zgjatur, duke treguar sasinë e mallrave që mund të zhdoganohen përmes doganës gjatë kësaj periudhe të përdorimit të zgjatur, si dhe njësitë e saj. Njësitë duhet të shprehen në njësi shtesë brenda kuptimit të Nomenklaturës së Kombinuar (Aneksi I i Rregullores së Këshillit (KEE) Nr 2658/87).

Kolona 4c e tabelës:

Shkruani sasinë neto të mallrave të shprehur në njësi shtesë brenda kuptimit të Nomenklaturës së Kombinuar (Aneksi I i Rregullores së Këshillit (KEE) Nr 2658/87).

Kolona 7b dhe 7d e tabelës:

Shkruani sasinë e përafërt të mallrave për t'u vendosur nën regjimin doganor duke përdorur thjeshtëzimin e dhënë, në baza mujore.

Kolonat 8a deri në 8d të tabelës:

Shkruani sasinë e përafërt totale të mallrave të destinuara për t'u vendosur nën regjimin e posaçëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së autorizimit.

Nëse kërkesa ka të bëjë me mallra sipas dispozitave të posaçme (Pjesa A dhe B) të përfshira në pjesën e parë, Dispozitat paraprake, seksionin II i Nomenklaturës së Kombinuar (mallrat për kategori të caktuara të anijeve, varkave dhe barkave të tjera dhe për platforma shpuese apo të prodhimit / avionët civilë dhe mallrat për përdorim në aviacionin civil), atëherë nuk është e nevojshme për të dhënë detaje në lidhje me sasinë e mallrave.

5/4. Vlera e mallrave

Kolona 4b e tabelës:

Jepni informacion në lidhje me vlerën e mallrave të destinuara për t'u mbuluar nga autorizimi.

Kolonat 8a; 8b dhe 8d të tabelës:

Shkruani vlerën maksimale të përafërt në euro të mallrave të destinuara për t'u vendosur nën regjimin e posaçëm. Vlera mund të tregohet gjithashtu në një tjetër monedhë përveç euros.

Kolona 8c e tabelës:

Shkruani vlerën maksimale të përafërt në euro të mallrave të destinuara për t'u vendosur nën regjimin e posaçëm. Vlera mund të tregohet **gjithashtu** në një tjetër monedhë përveç euros.

5/5. Norma e prodhimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni normën e përafërt të prodhimit apo normë mesatare të përafërt të prodhimit, ose kur është e nevojshme, metodën e **përcaktimit** të kësaj norme.

5/6. Mallrat ekuivalente

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Mallrat ekuivalente konsistojnë në mallrat shqiptare të cilat janë ruajtur, përdorur ose përpunuar në vend të mallrave të vendosura nën një regjim të posaçëm përveç transitit.

Aplikimi:
Kur planifikohet që të përdoren mallrat ekuivalente, deklaroni kodin 8-shifror të Nomenklaturës së Kombinuar, cilësinë tregtare dhe karakteristikat teknike të mallrave ekuivalente për t'u mundësuar autoriteteve doganore të bëjnë krahasimet e **nevojshme** mes mallrave **ekuivalente** dhe mallrave që ato zëvendësojnë.

Kodet përkatëse të parashikuara D.E. 5/8. Identifikimi i mallrave mund të përdoret për të sygjeruar masa **mbështetëse,** të cilat mund të jenë të **dobishme** për këtë krahasim.

Tregoni nëse mallrat jo-shqiptare do të jenë subjekt i detyrimeve anti-dumping, kundërbalancuese, të mbrojtjes ose ndonjë detyrimi tjetër shtesë që rezulton nga një pezullim i koncesioneve, në qoftë se ata janë deklaruar për vendosje në **qarkullim** të lirë.

Autorizimi:
Specifikoni masat që duhen vendosur në mënyrë që të **përmbushen** kushtet për përdorimin e mallrave ekuivalente.

Kolona 8a e tabelës:

Nëse mallrat ekuivalente janë në një fazë më të avancuar të prodhimit, ose janë në një gjendje më të mirë se sa mallrat **shqiptare** (në rastin e riparimit), shënoni të dhënat përkatëse.

5/7. Produktet e përpunuara

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shkruani detajet e të gjitha produkteve të përpunuara që rezultojnë nga operacionet, duke treguar produktin kryesor të përpunuar dhe produktet dytësore të përpunuara të cilat janë nënproduktet e operacioneve të **përpunimit,** përveç **produktit** kryesor të **përpunuar,** sipas rastit.

Kodi i Nomenklaturës së kombinuar dhe Përshkrimi: shënime në lidhje me D. E. 5/1. do të zbatohet Kodi i mallrave dhe 5/2. **Përshkrimi** i mallrave.

5/8. Identifikimi i mallrave

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shkruani masat e synuara të **identifikimit,** duke përdorur të paktën një nga kodet përkatëse.

Kolonat 8a; 8b dhe 8e të tabelës:

Ky informacion nuk përfundon në rastin e regjimit të magazinimit doganor, përpunimit aktiv ose përpunimit pasiv me mallrat **ekuivalente**. D. E. 5/6. Në vend të tyre duhet të përdoren mallrat ekuivalente.

Ky informacion nuk do të jepet në rastin e regjimit të përpunimit pasiv me sistemin standard të shkëmbimit. D.E. XVIII / 2 Në vend të tyre do të plotësohet **zëvendësimi** i produkteve në Kreun XVIII.

5/9. Kategoritë e përjashtuara ose lëvizja e mallrave

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Duke përdorur kodin 6-shifror të **nomenklaturës** për sistemin e **harmonizuar**, përcaktoni mallrat e përjashtuara nga thjeshtëzimi.

Grupi 6 - Kushtet dhe afatet

6/1. Ndalimet dhe kufizimet

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni ndonjë ndalim apo kufizim në nivel kombëtar të cilët janë të zbatueshëm për mallrat dhe/ose për regjimin përkatës.

Specifikoni autoritetet kompetente të cilat janë përgjegjëse për kontrollet apo **formalitetet** që duhet të kryhen para lëshimit të mallit.

6/2. Kushtet ekonomike

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Regjimi i përpunimit aktiv ose pasiv mund të përdoret vetëm kur interesat thelbësore të prodhuesve shqipatë, nuk do të ndikohen negativisht nga ndonjë autorizim për regjimin e përpunimit (kushtet ekonomike).

Në shumicën e rasteve nuk nevojitet ndonjë shqyrtim i kushteve ekonomike. Megjithatë, në raste të caktuara një shqyrtim i tillë duhet të kryhet në nivel kombëtar.

Të paktën një prej kodeve përkatëse të përcaktuara për kushtet ekonomike duhet të përdoret për çdo kod të Nomenklaturës së Kombinuar i cili tregohet në D.E. 5/1. Kodi i mallrave. Aplikuesii mund të japë detaje të tjera, në mënyrë të veçantë, kur nevojitet shqyrtimi i kushteve ekonomike.

6/3. Vërejtje të përgjithshme

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Informacione të **përgjithshme** mbi detyrimet dhe / ose formalitetet që **rezultojnë** nga autorizimi.

Detyrimet që rrjedhin nga autorizimi, me lidhje të veçantë me detyrimin për të informuar autoritetin vendim-marrës për çdo ndryshim në faktet dhe kushtet **themelore**, siç **parashikohet** në nenin 23 (2) të Kodit.

Autoritetet doganore të **vendim-marrjes** do të **specifikojnë** detajet që lidhen me të drejtën e ankimimit, në përputhje me nenin 44 të Kodit.

Kolona 4c e tabelës:

Tregoni të dhënat e të gjitha aplikimeve për të cilat mallrat mbeten objekt në pritje të zbatimit të vendimit.

Nëse është e mundur, vendimi duhet të përmbajë një njoftim që informon mbajtësin e vendimit se ky i fundit duhet t'i japë kopjen origjinale të vendimit zyrës doganore **ekzekutuese** të zgjedhur prej tij, gjatë paraqitjes së mallrave.

Kolonat 7a dhe 7c të tabelës:

Autorizimi duhet të specifikojë se detyrimi për të paraqitur një deklaratë plotësuese do të hiqet në rastet e **përshkruara** në nenin 325 (2) të Kodit.

Detyrimi për të paraqitur një deklaratë plotësuese mund të hiqet në qoftë se përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 325 (3).

Kolonat 8a dhe 8b të tabelës:

Autorizimet për përdorimin e përpunimit aktiv EX / IM ose të përpunimit pasiv EX / IM të cilat përfshijnë një ose më shumë se një degë doganore dhe autorizimet për përdorimin e përpunimit aktiv IM / EX ose të përpunimit pasiv IM / EX të cilat përfshijnë më shumë se një degë doganore, përfshijnë detyrimet e **parashikuara** në nenin 551(1).

Autorizimet për përdorimin e përpunimit aktiv IM / EX të cilat përfshijnë një shtet anëtar, do të **përfshijnë** detyrimin e **parashikuar** në nenin 550 (5).

Specifikoni nëse produktet e përpunuara ose mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv IM / EX **konsiderohen** të jenë lëshuar në qarkullim të lirë në përputhje me nenin 544 (1).

Kolonat 9a dhe 9c të tabelës:

Specifikoni nëse ndonjë veprim është i nevojshme para se pritësi i autorizuar të mund të bëjë shkatërrimin e mallrave të marra.

Tregoni masat operative dhe të kontrollit me të cilat duhet të pajtohet pritësi i autorizuar. Nëse është e aplikueshme, tregoni ndonjë kusht specifik që lidhet me marrëveshjet e transitit të kryera jashtë orarit zyrtar të punës së zyrës (ave) doganore të destinacionit.

Kolona 9b e tabelës:

Specifikoni se dërguesi i autorizuar duhet të paraqesë një deklaratë transiti në zyrën doganore të nisjes para çlirimit të mallit.

Tregoni masat operative dhe të kontrollit me të cilat duhet të pajtohet dërguesi i autorizuar. Nëse është e aplikueshme, tregoni ndonjë kusht specifik që lidhet me marrëveshjet e transitit të kryera jashtë orarit zyrtar të punës së zyrës (ave) doganore të nisjes.

Kolona 9d e tabelës:

Specifikoni se praktikat e lidhura me sigurinë të përcaktuara në Aneksin A të ISO 17712 zbatohen për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë:

Përshkruani të dhënat e kontrollit të duhur në mbajtjen e të dhënave në lidhje me plumbçet para aplikimit dhe përdorimit të tyre.

Përshkruani veprimet që do të ndërmerren, nëse vërehet ndonjë anomali apo ngatërrim.

Specifikoni trajtimin e **plumbçeve** pas përdorimit.

Përdoruesi i plumbçeve të një lloji të veçantë nuk do të ri-porosisë, ri-përdorë ose kopjojë numrat ose identifikuesit unikë të plumbçeve, përveç rasteve kur **autorizohet** nga autoritetet doganore.

Kolona 9f e tabelës:

Tregoni masat operative dhe të kontrollit me të cilat duhet të pajtohet mbajtësi i autorizimit.

Grupi 7 - Aktivitetet dhe regjimet

7/1. Lloji i transaksionit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shënoni (po / jo) nëse aplikimi lidhet me një transaksion importi ose eksporti duke specifikuar transaksionin e **parashikuar** për të cilin synohet të përdoret vendimi IDTose IDO. Lloji i regjimit të posaçëm duhet të specifikohet.

7/2. Lloji i regjimeve doganore

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni regjimin(et) doganor përkatës për të cilin ka aplikuar. Nëse është e aplikueshme, shënoni numrin e referencës së autorizimit përkatës, nëse ky i fundit nuk mund të rrjedhë nga ndonjë informacion tjetër në aplikim. Në rast se nuk është dhënë akoma autorizimi përkatës, tregoni numrin e **regjistrimit** të aplikimit në fjalë.

7/3. Lloji i deklaratave

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni llojin e deklaratës doganore (standard, i thjeshtuar apo hyni në të dhënat e deklaruesit) për të cilin ka aplikuar.

Për deklaratat e thjeshtësuara, tregoni numrin e referencës së autorizimit, nëse ky i fundit nuk mund të rrjedhë nga ndonjë informacion tjetër në aplikim. Në rast se nuk është dhënë akoma autorizimi për deklarimin e thjeshtuar, tregoni numrin e **regjistrimit** të aplikimit në fjalë.

Për të hyrë në të dhënat, tregoni numrin e referencës së autorizimit, nëse ky i fundit nuk mund të rrjedhë nga ndonjë informacion tjetër në aplikim. Në rast se nuk është dhënë akoma autorizimi për të hyrë në të dhënat, tregoni numrin e regjistrimit të aplikimit në fjalë.

7/4. Numri i operacioneve (dërgesave)

Kolona 4a e tabelës:

Kur garancia e plotë përdoret për të mbuluar borxhet ekzistuese doganore ose vendosjen e mallrave nën një regjim të posaçëm tregoni numrin e dërgesave që lidhen me periudhën e fundit 12-mujore.

Kolonat 6b; 7a, 7c dhe 7d të tabelave:

Shkruani një vlerësim se sa herë në muaj aqplikuesi do të përdorë thjeshtëzimin.

Kolona 7b e tabelës:

Shkruani një vlerësim se sa herë në muaj dhe për cilën degë doganore, aplikuesi do të përdorë thjeshtëzimin.

Kolona 9a e tabelës:

Jepni një vlerësim se sa herë në muaj aplikuesi do të marrë mallra sipas **operacionit TIR**.

Kolona 9b e tabelës:

Jepni një vlerësim se sa herë në muaj aplikuesi do të dërgojë mallra nën regjimin e transitit.

Kolona 9c e tabelës:

Jepni një vlerësim se sa herë në muaj aplikuesi do të marrë mallra nën regjimin e transitit.

Kolonat 9d deri në 9f të tabelës:

Jepni një vlerësim se sa herë në muaj aplikuesi do të përdorë **marrëveshjet** e transitit.

7/5. Detajet e aktiviteteve të planifikuara

Kolonat 8a; 8b; 8c; 8e dhe 8f të tabelës:

Përshkruani natyrën e aktiviteteve ose përdorimeve të planifikuara (p.sh. detajet e operacioneve sipas një kontrate të punës, përpunimit apo ndonjë lloj forme të zakonshme të trajtimit në bazë të përpunimit aktiv), që duhet të kryhen ndaj mallrave në një regjim të posaçëm.

Nëse Aplikuesi dëshiron të kryejë përpunimin e mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv apo të përdorimit t të veçantë **përfundimtar (end-use)** në një magazinë doganore, në pajtim me nenin 214 të Kodit, ai duhet të japë detajet përkatëse.

Kur është e **përshtatshme,** tregoni emrin, adresën dhe funksionin e **personave** të tjerë të përfshirë.

Format e zakonshme të trajtimit lejojnë që mallrat e vendosura nën regjimin e magazinimit doganor ose regjimin e përpunimit, të ruhen, të përmirësojnë pamjen e jashtme ose cilësinë e tregtimit ose të përgatiten për shpërndarje ose rishitje. Kur format e zakonshme të trajtimit janë të destinuara të kryhen në bazë të përpunimit aktiv ose pasiv, duhet të bëhet një referencë në pikën (a) përkatëse të Aneksit 71-03.

Kolona 7b e tabelës:

Jepni një pasqyrë të transaksioneve të biznesit / operacioneve dhe lëvizjes së mallrave në zhdoganim të centralizuar.

Kolona 8d e tabelës:

Përshkruani natyrën e përdorimit të planifikuar të mallrave për t'u vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Tregoni nenin përkatës i cili duhet të aplikohet për të përfituar nga **përjashtimi** i plotë prej **detyrimeve** të importit.

Kur përfitimi nga **përjashtimi** i plotë prej detyrimeve të importit zbatohet në përputhje me nenet 674 ose 675, jepni **përshkrimin** dhe sasitë e mallrave që do të prodhohen.

Grupi 8 - Të tjera

8/1. Lloji i llogarive kryesore

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Specifikoni llojin e llogarive kryesore, duke dhënë detaje rreth sistemit që synohet të përdoret, duke përfshirë softëare.

8/2. Lloji i të dhënave

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Specifikoni llojin e të dhënave, duke dhënë detaje rreth sistemit që synohet të përdoret, duke përfshirë softëare.

Të dhënat duhet t'u mundësojnë autoriteteve doganore mbikëqyrjen e regjimit në fjalë, në veçanti në lidhje me **identifikimin** e **mallrave** të vendosura nën këtë regjim, statusin e tyre doganor si dhe lëvizjet e tyre.

8/3. Qasja/akesesi ndaj të dhënave

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Specifikoni mënyrat se si të dhënat e doganave ose deklaratave të transitit do të bëhen të disponueshme për **autoritetet** doganore.

8/4. Mostrat etj.

Kolona 1a e tabelës:

Shënoni (po / jo) nëse ndonjë mostër, fotografi, broshurë apo dokument tjetër i disponueshëm, i cili mund të ndihmojë autoritetet doganore për të bërë klasifikimin e saktë të mallrave në nomeklaturën **dogan** ore, është **bashkëngjitur** si Aneks.

Nëse ka ndnjë mostër, duhet të tregohet nëse ajo duhet kthyer apo jo.

Kolona 1b e tabelës:

Tregoni ndonjë mostër, fotografi, broshurë apo dokument tjetër i disponueshëm në përbërjen e mallrave dhe materialeve përbërëse të tyre si dhe i cili mund të ndihmojë në përshkrimin e proçesit të prodhimit ose përpunimit që i **nënshtrohen** materialet.

8/5. Informacioni shtesë

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shkruani çdo **informacion** shtesë, nëse **konsiderohet** i dobishëm.

8/6. Garancia

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni nëse nevojitet ndonjë garanci për autorizimin në fjalë. Nëse po, shkruani Numrin e Referencës së garancisë së dhënë në lidhje me **autorizimin** përkatës.

8/7. Shuma e garancisë

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Paraqesni shumën e garancisë individuale ose, në rastin e garancisë globale, shumën ekuivalente ndaj pjesës së shumës referencë të përcaktuar për autorizim të posaçëm për magazinimin e **përkohshëm** apo regjimin e posaçëm.

8/8. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve

Të gjitha shtyllat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikimi:
Kur aplikohet për një autorizim për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet mbajtësve të regjimit, në përputhje me nenin 197 të Kodit, jepni informacion në lidhje transferuesit dhe formalitetet e sygjeruara të transferimit. Një aplikim i tillë mund t'i dorëzohet autoritetit kompetent doganor në një fazë të mëvonshme, pasi të jetë pranuar aplikimi dhe të jetë dhënë autorizimi për një regjim të posaçëm.

Autorizimi:
Specifikoni kushtet në të cilat mund të kryhet kalimi i të drejtave dhe **detyrimeve**. Nëse aplikimi për **transferimin** e të drejtave dhe **detyrimeve** është **refuzuar**, specifikoni arsyet e refuzimit.

8/9. Fjalët kyçe

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Tregoni fjalët kyçe përkatëse, me të cilat autoriteti doganor kompetent kanë indeksuar vendimin në lidhje me informacionin e detyrueshëm. Ky indeksim (duke shtuar fjalët kyçe) lehtëson identifikimin e vendimeve përkatëse në lidhje me **informacionin** detyrues të lëshuar nga autoritetet doganore.

8/10. Detajet rreth depove

Të gjitha kolonat **përkatëse** të përdorura të tabelës:

Jepni **informacionin** në lidhje me **objektin** ose ndonjë vend tjetër për ruajtje të **përkohshme** ose magazinim doganor i cili synohet të përdoret si depo.

Ky informacion mund të përfshijë detaje për karakteristikat fizike të objekteve, pajisjeve të përdorura për aktivitetet e magazinimit dhe, në rast të objekteve të magazinimit të pajisura posaçërisht, të dhënat e tjera të nevojshme për të verifikuar përputhjen **respektivisht** me nenin 258 (b) dhe 632.

8/11. Magazinimi i mallrave shqiptare

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shënoni ("po / jo") nëse është planifikuar për të ruajtur mallrat shqipatre në një magazinë doganore ose ambient **magazinimi** të përkohshëm.

Kërkesa për ruajtjen e mallrave shqiptare mund t'i dorëzohet autoritetit doganor të vendim-marrjes në një fazë të **mëvonshme** pasi është pranuar aplikimi dhe është dhënë autorizimi për **funksionimin** e depove.

Kolona 8e e tabelës:

Autorizimi:
Në qoftë se objekti ka për qëllim të ruajë mallrat shqiptare në një strukturë magazinimi për **magazinimin** doganor, si dhe të zbatohen kushtet e **parashikuara** në nenin 554, atëherë përcaktoni rregullat për ndarjen e kontabilitetit.

8/12. Pëlqimi për publikim në listën e mbajtësve të autorizimit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Shënoni (po / jo) nëse aplikuesi pranon të ketë në listën publike të mbajtësve të autorizimit, të dhënat e **mëposhtme** të autorizimit që ai / ajo aplikon:

Mbajtësi i autorizimit

Lloji i autorizimit

Data e efektit ose, sipas rastit,, periudha e vlefshmërisë

Autoritetit doganor i vendimmarrjes

Zyra doganore kompetente / mbikqyrëse

8/13. Llogaritja e shumës së detyrimeve të importit në përputhje me nenin 81 (3) të Kodit

Të gjitha kolonat përkatëse të përdorura të tabelës:

Aplikimi:
Shënoni ("po / jo") nëse aplikuesi dëshiron të llogarisë detyrimet e importit në përputhje me nenin 81 (3) të Kodit.

Nëse përgjigja është "jo", atëherë zbatohet neni 80 i Kodit, që do të thotë, se llogaritja e shumës së detyrimeve të importit bëhet në bazë të klasifikimit tarifor, vlerës doganore, sasisë, natyrës dhe origjinës së mallrave në kohën kur ka lindur borxhi doganor në lidhje me to.

Vendimet:
Në rast se mbajtësi i autorizimit dëshiron të llogarisë detyrimet e importit në përputhje me nenin 81 (3) të Kodit, atëherë autorizimi për regjimin e përpunimit aktiv do të parashikojë që produktet përkatëse të përpunuara nuk mund të importohen direkt ose indirekt nga mbajtësi i autorizimit si dhe të hidhen në qarkullim të lirë brenda një periudhe prej një viti pas ri-eksportimit të tyre. Megjithatë, produktet e përpunuara mund të importohen direkt ose indirekt nga mbajtësi i autorizimit dhe të hidhen në qarkullim të lirë brenda një periudhe prej një viti pas ri-eksportimit të tyre, nëse shuma e **detyrimeve** të importit **përcaktohet** në përputhje me nenin 81 (3) të Kodit.

KREU II

Aplikimi dhe vendimi që lidhet me informacionin detyrues tarifor

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe vendimin që lidhet me informacionin detyrues tarifor

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. I urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
II/1.	Ri-lëshimi i vendimit IDT	A [*]
II/2.	Nomenklatura doganore	A [*]
II/3.	Emërtimi tregtar dhe informacioni shtesë	C [*]A [+]
II/4.	Arsyetimi i klasifikimit të mallrave	A [+]
II/5.	Materiali i siguruar nga aplikuesi në bazë të të cilit është lëshuar vendimi IDT	A [+]
II/6.	Imazhet	B
II/7.	Data e aplikimit	A [+]
II/8.	Data e përfundimit të përdorimit të zgjatur	A [+]
II/9.	Arsyet e pavlefshmërisë	A [+]
II/10	Numri i regjistrimit të aplikimit	A [+]

Statusi dhe shenjat e treguara në tabelën me kërkesat e të dhënave si më sipër korrespondojnë me përshkrimet e dhëna në Kreun I, Kapitulli I.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe vendimin në lidhje me informacion detyrues tarifor

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën e kërkesave të të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

II / 1. Ri-lëshimi i vendimit BTI

Shënoni (po / jo), nëse aplikimi ka të bëjë me ri-lëshimin e një vendimi IDT. Nëse po, jepni detajet përkatëse.

II / 2. Nomenklatura doganore

Shënoni se në cilën nomenklaturë klasifikohen mallrat, duke vendosur 'x' në vetëm një kuti.

Nomenklaturat e listuara janë si më poshtë:

- Nomenklatura e Kombinuar (NK), e cila përcakton klasifikimin tarifor të mallrave në R.SH. sipas nivelit 8-shifror,

- TARIC, i cili përbëhet nga një shtesë prej 9 dhe 10 shifrash të cilat pasqyrojnë masat tarifore dhe jo-tarifore në R.SH, të tilla si pezullimet e tarifave, kuotave tarifore, detyrimeve anti-dumping, etj, dhe mund të përbëhet edhe nga kodet shtesë TARIC dhe Kodet kombëtare shtesë nga shifra e 11-të e në vazhdim,

- Nomenklatura e rimbursimit, e cila i referohet nomenklaturës së produktit bujqësor për rimbursimet e eksportit.

Nëse nomenklatura nuk është një nga ato të listuara, përcaktoni nomenklaturën në fjalë.

II / 3. Emërtimi tregtar dhe informacioni shtesë

Aplikimi:
Tregoni të dhënat të cilat aplikuesi dëshiron të trajtohen si konfidenciale, duke përfshirë numrin e markës tregtare dhe numrin e modelit të mallit.

Në raste të caktuara, duke përfshirë edhe ato ku mostrat janë dhënë, administrata e interesuar mund të marrë fotografi (psh të mostrave të siguruara), ose të kërkojë një laborator për analizë. Aplikuesi duhet të shprehë në mënyrë të qartë, nëse këto fotografi, rezultatet e analizës, etj, si një e tërë ose pjesërisht, do të trajtohen si konfidenciale. Çdo informacion i tillë, që nuk është projektuar si konfidencial, do të publikohet në bazën e të dhënave publike online dhe do të jetë i **disponueshëm** në internet.

Vendimi:
Kjo fushë e të dhënave do të përmbajë të gjitha të dhënat të cilat aplikuesi ka shënuar si konfidenciale në aplikimin IDT, si dhe çdo informacion të shtuar nga autoriteti doganore kompetent, që ky autoritet i konsideron të jenë konfidenciale.

II / 4. Arsyetimi i klasifikimit të mallrave

Treguesi i dispozitave përkatëse të akteve apo masave në bazë të të cilit mallrat janë klasifikuar në nomenklaturën doganore, tregohet në elementin e të dhënave 5/1 Kodi i Mallrave në Kreun I.

II / 5. Materiali i dhënë nga aplikimi në bazë të të cilit është lëshuar vendimi IDT

Tregoni, nëse vendimi IDT është lëshuar në bazë të një përshkrimi, broshure, fotografie, mostre ose dokumenti tjetër të ofruar nga aplikuesi.

II / 6. Imazhet

Kur është e **përshtatshme,** çdo imazh lidhet me mallrat që klasifikohen.

II / 7. Data e aplikimit

Data në të cilën autoriteti kompetent doganor i përmendur në nenin 27 (1) nënparagrafi 3 i Kodit, ka pranuar kërkesën.

II / 8. Data e fundit e përdorimit të zgjatur

Vetëm në rastet kur është dhënë periudha e përdorimit të zgjatur, shënoni datën e përfundimit të **periudhës** kohore për të cilën mund të përdoret ende vendimi IDT.

II / 9. Arsyet e pavlefshmërisë

Vetëm në rastet kur vendimi IDT shfuqizohet para përfundimit normal të vlefshmërisë së tij, tregoni arsyen e **pavlefshmërisë** duke futur kodin përkatës.

II / 10. Numri i regjistrimit të aplikimit

Referenca unike e aplikimit të pranuar, që është caktuar nga autoriteti kompetent doganor.

KREU III

Aplikimi dhe vendimi në lidhje me informacionin detyrues të origjinës

KAPITULLI 1

Kërkesat e të dhënave **specifike** për aplikimin dhe vendimin në lidhje me **informacionin** detyrues të **origjinës**

Tabela me kërkesat e të **dhënave**

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
III/1.	Bazat ligjore	A [*]
III/2.	Përbërja e mallrave	A
III/3.	Informacioni që mundëson përcaktimin e origjinës	A [*]

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
III/4.	Tregoni cilat të dhëna duhet të trajtohen si konfidenciale	A
III/5.	Vendi i origjinës dhe kuadri ligjor	A [+]
III/6.	Arsyetimi i vlerësimit të origjinës	A [+]
III/7.	Çmimi EXW	A
III/8.	Materialet e përdorura, vendi i origjinës, kodi dhe vlera e Nomenklaturës së kombinuar	A [+]
III/9.	Përshkrimi i përpunimit të kërkuar me qëllim marrjen e origjinës	A [+]
III/10.	Gjuha	A [+]

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikim dhe vendimin në lidhje me informacionin detyrues të origjinës

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave

III / 1. Bazat ligjore

Tregoni bazën ligjore në fuqi, për qëllimet e neneve 59 dhe 63 të Kodit.

III / 2. Përbërja e mallrave

Tregoni përbërjen e mallrave dhe çdo mënyrë shqyrtimi të përdorur për të përcaktuar këtë dhe çmimin e tyre EXW, sipas nevojës.

III / 3. Informacioni që mundëson përcaktimin e origjinës

Jepni informacion duke mundësuar përcaktimin e origjinës, materialet e përdorura dhe origjinën e tyre, klasifikimin tarifor, vlerat korresponduese dhe një përshkrim të rrethanave (rregullat për ndryshimin tarifor, vlerën e shtuar, përshkrimin e operacionit ose procesit, ose ndonjë rregull tjetër të veçantë) duke bërë të mundur plotësimin e kushteve që lidhen me përcaktimin e origjinës. Në veçanti, duhet të përmendet rregulli i saktë i zbatuar i origjinës si dhe origjina e **parashikuar** për mallrat.

III / 4. Tregoni se cilat të dhëna duhet të trajtohen si konfidenciale

Aplikues :
Aplikuesi mund të tregojë ndonjë nga të dhënat që duhet të trajtohen si konfidenciale.

Çdo informacion, që nuk tregohet si konfidencial në aplikim, mund të bëhet i disponueshëm në internet pasi të jetë lëshuar vendimi.

Vendimi:
Të dhënat të cilat aplikuesi ka treguar si konfidenciale në aplikimin IDO, si dhe çdo informacion i shtuar nga autoriteti doganor kompetent, informacion që ky autoritet e konsideron si konfidencial, duhet të shënohet si i tillë në vendim.

Çdo **informacion,** që nuk tregohet si **konfidencial** në vendim, mund të bëhet i **disponueshëm** në internet.

III / 5. Vendi i origjinës dhe kuadri ligjor

Vendi i origjinës i përcaktuar për mallrat nga autoriteti doganor, për të cilin është lëshuar vendimi si dhe **treguesi** i kuadrit ligjor **(jo-preferencial / preferencial,** referenca për **marrëveshje,** konventë, vendim, rregullore, etj).

Në rast se origjina preferenciale nuk mund të përcaktohet për mallrat në fjalë, atëherë termi "pa origjinë 'dhe një tregues i kuadrit ligjor duhet të **përmenden** në vendimin IDO.

III / 6. Arsyetimi i vlerësimit të origjinës

Arsyetimi i vlerësimit të origjinës nga autoriteti doganor (mallra të përfituara tërësisht, transformimi i fundit i **konsiderueshëm, punime** apo proçese të **mjaftueshme,** kumulimi i origjinës, etj).

III / 7. Çmimi EXW

Nëse kërkohet për **përcaktimin** e origjinës, ai është një element i **detyrueshëm** i të dhënave.

III / 8. Materialet e përdorura, vendi i origjinës, kodi dhe vlera e Nomenklaturës së Kombinuar

Nëse kërkohet për **përcaktimin** e origjinës, ai është një element i **detyrueshëm** i të dhënave.

III / 9. Përshkrimi i përpunimit i kërkuar me qëllim marrjen e origjinës

Nëse kërkohet për **përcaktimin** e origjinës, ai është një element i **detyrueshëm** i të dhënave.

III / 10. Gjuha

Treguesi i gjuhës në të cilën lëshohet IDO.

TITULLI IV

Aplikimi dhe autorizimi për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar

KAPITULLI 1

Kërkesat specifike të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
IV/1.	Statusi ligjor i **aplikuesit**	A [*]
IV/2.	Data e **themelimit**	A [*]
IV/3.	Roli(et) i aplikuesit në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit	A [*]
IV/4.	Degët doganore ku zhvillohen aktivitetet e lidhura me doganën	A [*]
IV/5.	Informacioni për kalimin e kufirit	A [*]
IV/6.	Thjeshtëzimet dhe lehtësirat e dhëna tashmë, certifikatat e sigurisë dhe / ose të sigurisë të nxjerra në bazë të konventave ndërkombëtare, për standardin ndërkombëtar të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin, ose standardin evropian të organeve Evropiane për Standardizimin, ose certifikatat e barasvlershme OEA të lëshuara në vendeve të treta.	A [*]
IV/7.	Pëlqimi për shkëmbimin e informacionit në autorizimin OEA në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i sistemeve të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare / marrëveshjeve me vendet e treta që lidhen me përkufizimin e njohjes reciproke të statusit të operatorit të autorizuar ekonomik dhe masave që lidhen me sigurinë.	A [*]
IV/8.	Vendndodhja e përhershme e biznesit	A
IV/9.	Zyra(at) ku mbahen dhe aksesohen dokumentat doganore	A [*]
IV/10.	Vendi ku zhvillohen aktivitetet e përgjithshme të menaxhimit logjistik	A [*]
IV/11.	Aktivitetet e biznesit	A [*]

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme, korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat specifike të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar

Hyrja

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

IV / 1. Statusi ligjor i aplikuesit

Statusi ligjor siç është përmendur në dokumentin e themelimit.

IV / 2. Data e themelimit

Me numra - ditën, muajin dhe vitin e themelimit.

IV / 3. Roli (et) i aplikimit në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit

Duke përdorur kodin e duhur, tregoni rolin e aplikuesit në zinxhirin e furnizimit.

IV / 4. Vendet ku zhvillon aktivitetet që lidhen me doganën

Futni kodin(et) e vendit përkatës. Në rast se aplikuesi vepron me një magazinë ose nëse ka objekte të tjera në një vend tjetër, shkruani adresën (at) si dhe llojin (et) e objektit (eve).

IV / 5. Informacioni i kalimit të kufirit

Shkruani numrin(at) e referencës së zyrës(ave) doganore të përdorur rregullisht për kalimin e kufirit. Në rast se aplikuesi është një përfaqësues doganor, jepni numrin(at) e referencës së zyrës(ave) doganore të përdorur rregullisht nga ky përfaqësues doganor për kalimin e kufirit.

IV / 6. Thjeshtëzimet dhe lehtësirat e dhëna tashmë, certifikatat e sigurisë dhe / ose të sigurisë të nxjerra në bazë të konventave ndërkombëtare, të një Standardi Ndërkombëtar të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin, ose të një standardi evropian të organeve Evropiane për Standardizimin, ose certifikatat ekuivalente OEA të lëshuara nga vendet të tjera.

Në rast të thjeshtëzimeve të dhëna tashmë, tregoni llojin e thjeshtëzimit, proçedurën doganore përkatëse, si dhe numrin e autorizimit. Në rast të lehtësirave të dhëna tashmë, tregoni llojin e lehtësimit dhe numrin e certifikatës. Në rastin e një agjenti rregullues të miratuar ose dërguesi të njohur, tregoni miratimin e dhënë: agjentin rregullues ose dërguesin e njohur si dhe tregoni numrin e miratimit. Në rast se aplikuesi është mbajtës i një certifikate ekuivalente OEA të lëshuar nga vende të tjera, atëherë tregoni numrin e kësaj certifikate si dhe vendin e lëshimit.

IV / 7. Pëlqimi për shkëmbimin e informacionit në autorizimin OEA në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i sistemeve të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare / marrëveshjeve me vendet e tjera që lidhen me njohjen e ndërsjellë të statusit të operatorit ekonomik të autorizuar dhe masave që lidhen me sigurinë

Shënoni (po / jo) nëse aplikuesi është i gatshëm të bie dakord për shkëmbimin e informacionit në autorizimin OEA për të siguruar funksionimin e duhur të sistemeve të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare / marrëveshjet me vendet e tjera që lidhen me njohjen e ndërsjelltë të statusit të operatorit ekonomik të autorizuar dhe masat që kanë të bëjnë me sigurinë.

Nëse përgjigja është po, aplikuesi duhet të japë **informacion** mbi emrin dhe adresën e kompanisë.

IV / 8. Vendndodhja e përhershme e biznesit

Në rast se aplikimi është dorëzuar në përputhje me nenin 45 (4), atëherë duhet të jepet emërtimi i plotë Vendndodhja e **përhershme** e biznesit dhe numri i **identifikimit** të TVSH-së.

IV / 9. Zyra(at), ku mbahen dhe aksesohen dokumentat doganore

Shkruani adresën e plotë të zyrës(ave) përkatëse. Në rast se ka një tjetër zyrë përgjegjëse për sigurimin e të gjitha **dokumentave** që lidhen me doganën përveç asaj ku mbahen, atëherë shkruani edhe adresën e saj të plotë.

IV / 10. Vendi ku zhvillohen aktivitetet e përgjithshme të menaxhimit logjistik

Ky element i të dhënave do të përdoret vetëm, kur autoriteti kompetent doganor nuk mund të përcaktohet në bazë të **nënparagrafit** të tretë të nenit 27 (1) të Kodit. Në raste të tilla, shkruani adresën e plotë të vendit përkatës.

IV / 11. Aktivitetet e biznesit

Shkruani **informacionin** mbi aktivitetin e biznesit të kërkuesit.

KREU V

Aplikimi dhe autorizimi për thjeshtësimin e përcaktimit të shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave

KAPITULLI 1

Kërkesat specifike të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për thjeshtësimin e përcaktimit të shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
V/1.	Subjekti dhe natyra e thjeshtëzimeve	A

Statusi i treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondon me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për thjeshtësimin e përcaktimit të shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1**.

Kërkesat e të dhënave

V/1. Subjekti dhe natyra e thjeshtëzimit

Tregoni se për cilat elemente që duhet të shtohen ose zbriten nga vlera doganore në pajtim me nenet 67 dhe 68 të Kodit ose për cilat elemente që janë pjesë e çmimit realisht të paguar ose të pagueshëm në pajtim me nenin 66 (2) të Kodit, zbatohet thjeshtëzimi (p.sh. ndihmat, tatimet, shpenzimet e transportit, etj) i ndjekur nga një referencë për mënyrën e **llogaritjes** për përcaktimin e shumave përkatëse.

TITULLI VI

Aplikimi dhe autorizimi për dhënien e garancisë globale, duke përfshirë një reduktim të mundshëm apo heqje dorë

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për dhënien e garancisë globale, duke përfshirë një reduktim të mundshëm apo heqje dorë

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
VI/1.	Shuma e detyrimeve dhe pagesat e tjera	A [*]
VI/2.	Periudha mesatare ndërmjet vendosjes së mallrave nën regjim dhe përfundimit të regjimit	A [*]
VI/3.	Niveli i garancisë	A
VI/4.	Forma e garancisë	C [*]
VI/5.	Shuma e referencës	A
VI/6.	Afati kohor i pagesës	A

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për dhënien e garancisë globale, duke përfshirë një reduktim të mundshëm apo heqje dorë

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

VI / 1. Shuma e detyrimeve dhe pagesat e tjera

Shënoni shumën më të madhe të detyrimeve dhe pagesat e tjera të zbatueshme për çdo ngarkesë të vetme, në lidhje me periudhën e fundit 12 mujore. Nëse ky informacion nuk është i disponueshëm, atëherë tregoni shumën e mundshme më të madhe të detyrimeve dhe pagesat e tjera të zbatueshme për çdo dërgesë në periudhën e ardhshme 12-mujore.

VI / 2. Periudha mesatare ndërmjet vendosjes së mallrave nën regjim dhe shfuqizimit të regjimit

Tregoni periudhën mesatare ndërmjet vendosjes së mallrave nën regjim dhe shfuqizimit të regjimit, që lidhet me periudhën e fundit 12-mujore. Ky informacion duhet të jepet vetëm kur garancia e plotë përdoret për vendosjen e mallrave nën një regjim të posaçëm.

VI / 3. Niveli i garancisë

Tregoni nëse niveli i garancisë i cili mbulon borxhet ekzistuese doganore dhe, kur është e zbatueshme, pagesa të tjera, është 100% ose 30% e pjesës përkatëse të shumës së referencës dhe / ose nëse niveli i garancisë që mbulon borxhet e mundshme doganore dhe, kur është e zbatueshme, pagesa të tjera, është 100%, 50%, 30% ose 0% e pjesës përkatëse të shumës së referencës.

Nëse është e zbatueshme, autoriteti autorizues doganor mund të japë komente.

VI / 4. Forma e garancisë

Tregoni formën që merr garancia.

Në rast se garancia është dhënë në formën e një d o r ë z a n i e, tregoni emrin dhe të dhënat e adresës së plotë të garantuesit.

Kur garancia është e vlefshme në më shumë se një Shtet, tregoni emrin e plotë dhe adresën e **përfaqësuesit** të **garantuesit** në Shtetin tjetër.

VI / 5. Shuma e referencës

Aplikimi:

Jepni informacion mbi shumën e referencës që mbulon të gjitha veprimet, deklaratat apo regjimet e aplikuesit, në pajtim me nenin 84 (5) të Kodit.

Autorizimi:

Shkruani shumën e referencës që mbulon të gjitha veprimet, deklaratat apo regjimet e mbajtësit të autorizimit, në përputhje me nenin 84 (5) të Kodit.

Nëse shuma e referencës e vendosur nga organi doganor i vendim-marrjes është i ndryshëm nga ajo e treguar në aplikim, jepni arsyet për ndryshimin.

VI / 6. Afati kohor i pagesës

Kur garancia globale është dhënë për të mbuluar detyrimet e pagueshme të importit apo eksportit në rastin e çlirimit në qarkullim të lirë ose përdorimit të veçantë përfundimtar **(end-use)**, tregoni nëse garancia mbulon:

Periudhën normale para pagesës, dmth **maksimumi** 10 ditë pas njoftimit të debitorit për borxhin doganor, në pajtim me nenin 101 të Kodit.

KREU VII

Aplikimi dhe autorizimi i shtyrjes së pagesës së detyrimeve për t'u paguar, për sa kohë që leja nuk është dhënë në lidhje me një operacion/veprim të vetëm

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin e shtyrjes së pagesës së detyrimeve për t'u paguar, për sa kohë që leja nuk është dhënë në lidhje me një operacion të vetëm

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
VII/1.	Lloji i shtyrjes së pagesës	A

Statusi dhe emërtimi i treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të **mësipërme** korrespondojnë me **përshkrimin** e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave të shtyrjes së pagesës së detyrimeve për t'u paguar, për aq kohë sa leja nuk është dhënë në lidhje me një operacion/veprim të vetëm

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave

VII / 1. Lloji i shtyrjes së pagesës

Tregoni mënyrën se si aplikuesi dëshiron të zbatojë shtyrjen e pagesës së detyrimeve për t'u paguar.

Neni 103 (b) i Kodit, dmth globalisht në lidhje me çdo shumë të detyrimeve të importit ose të eksportit të hyrë në llogaritë në përputhje me paragrafin e parë të nenit 96 (1) i Kodit gjatë një periudhe të caktuar që nuk i tejkalon 31 ditë.

Neni 103 (c) i Kodit, dmth globalisht në lidhje me të gjitha shumat e detyrimeve të importit ose të eksportit që krijojnë një hyrje të vetme në përputhje me **nënparagrafin** e dytë të nenit 96 (1) i Kodit.

KREU VIII

Aplikimi dhe vendimi për rimbursim ose përjashtim të shumave të detyrimeve të importit ose të eksportit

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe vendimin për rimbursim ose përjashtim të shumave të detyrimeve të importit ose të eksportit

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
VIII/1.	Kreu për shlyerjen	A
VIII/2.	Zyra doganore ku njoftohet borxhi doganor	A
VIII/3.	Zyra doganore përgjegjëse për vendin ku vendosen mallrat	A
VIII/4.	Komentet e zyrës doganore përgjegjëse për vendin ku vendosen mallrat	A [+]
VIII/5	Regjimi doganor (kërkesa për plotësim paraprak të formaliteteve)	A
VIII/6.	Vlera doganore	A
VIII/7.	Shuma e detyrimeve të importit ose eksportit për t'u shlyer ose përjashtuar	A
VIII/8.	Lloji i detyrimeve të importit ose eksportit	A
VIII/9.	Bazat ligjore	A
VIII/10	Përdorimi ose destinacioni i mallrave	A [+]
VIII/11	Afati kohor për plotësimin e formaliteteve	A [+]
VIII/12	Deklarata e autoritetit doganor të vendim-marrjes	A [+]
VIII/13	Përshkrimi i arsyeve për shlyerje ose përjashtim	A
VIII/14	Të dhënat e bankës dhe llogarisë	A [*]

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe vendimin për shlyerje ose përjashtim të shumave prej detyrimeve të importit ose eksportit

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave

VIII / 1. Kreu për shlyerjen

Futni MRN-në e deklaratës doganore ose referencën për çdo dokument tjetër i cili i ka dhënë shtysë njoftimit të detyrimeve të importit ose eksportit, për të cilët është kërkuar shlyerje ose përjashtim.

VIII / 2. Zyra doganore ku njoftohet borxhi doganor

Shënoni identifikuesin e zyrës doganore ku janë njoftuar detyrimet e importit apo eksportit të cilëve u referohet aplikimi.

Në rastin e një aplikimi të bazuar me letër, shënoni emrin dhe adresën e plotë, duke përfshirë edhe kodin postar, në rast se ka, të zyrës doganore në fjalë.

VIII / 3. Zyra doganore përgjegjëse për vendin ku vendosen mallrat

Ky informacion do të jepet vetëm nëse është i ndryshëm nga zyra doganore e treguar në D.E. VIII / 2 Zyra doganore ku është njoftuar borxhi doganor.

Shënoni identifikuesin e zyrës doganore përkatëse.

Në rastin e një kërkese të printuar, futni emrin dhe adresën e plotë, duke përfshirë edhe kodi postar, në rast se ka, të zyrës doganore në fjalë.

VIII / 4. Komentet e zyrës doganore kompetente për vendin ku vendosen mallrat

Ky element i të dhënave do të plotësohet në rastet, kur shlyerja apo përjashtimi është objekt i shkatërrimit, braktisjes së shtetit, ose vendosjes nën një regjim të posaçëm ose regjimin e eksportit të një artikulli, por formalitetet përkatëse plotësohen vetëm për një apo më shumë pjesë ose komponentë të këtij neni.
Në këtë rast, shënoni sasinë, natyrën dhe vlerën e mallrave të cilat do të qëndrojnë në territorin doganor të R.Sh.
Kur mallrat do t'i shpërndahen një organizate bamirëse, shënoni emrin dhe adresën e plotë, duke përfshirë edhe kodin postar, në rast se ka, të subjektit në fjalë.

VIII / 5. Regjimi doganor (aplikimi për plotësimin paraprak të formaliteteve)

Me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 255 (1) nënparagrafi 1 (a), shënoni kodin përkatës të regjimit doganor nën të cilin aplikuesi dëshiron të vendosë mallrat.

Kur proçedura doganore i nënshtrohet një autorizimi, shënoni identifikuesin e autorizimit në fjalë. Tregoni, nëse kërkohet plotësimi paraprak i formaliteteve.

VIII / 6. Vlera doganore
Tregoni vlerën doganore të mallrave.

VIII / 7. Shuma e detyrimeve të importit ose eksportit që do të shlyhen ose përjashtohen

Duke përdorur kodin e duhur për monedhën vendase, futni shumën e detyrimeve të importit ose eksportit që do të shlyhen ose përjashtohen.

VIII / 8. Lloji i detyrimeve të importit ose eksportit

Duke përdorur kodet përkatëse, shënoni llojin e detyrimeve të importit ose eksportit që do të shlyhen ose përjashtohen.

VIII / 9. Bazat ligjore

Duke përdorur kodin përkatës, shënoni bazën ligjore të aplikimit për shlyerje ose përjashtim prej detyrimeve të importit ose eksportit.

VIII / 10. Përdorimi ose destinacioni i mallrave
Shënoni informacionin mbi përdorimin e mallrave ose destinacionin ku do të dërgohen, në varësi të mundësive në dispozicion në rast të veçantë sipas Kodit dhe nëse është e përshtatshme, në bazë të një autorizimi të veçantë nga autoritetet doganore të vendim-marrjes.

VIII / 11. Afati kohor për përfundimin e formaliteteve

Shënoni afatin e shprehur në ditë për kryerjen e formaliteteve që kanë për subjekt shlyerjen apo përjashtimin prej detyrimeve të importit ose eksportit.

VIII / 12. Deklarata e autoritetit doganor të vendim-marrjes

Nëse është e aplikueshme, autoriteti doganor i vendim-marrjes tregon se detyrimet e importit apo eksportit nuk do të shlyhen ose përjashtohen derisa zyra zbatuese doganore të ketë informuar autoritetet doganore të vendim-marrjes që janë përfunduar formalitetet të cilat kanë për subjekt shlyerjen ose përjashtimin.

VIII / 13. Përshkrimi i arsyeve për shlyerje ose përjashtim

Aplikimi:
Përshkrim i detajuar i arsyetimit që formon bazën e aplikimit për përjashtim apo shlyerje të detyrimeve të importit ose eksportit.

Ky element i të dhënave duhet të plotësohet në të gjitha rastet kur informacioni nuk mund të rrjedhë nga vende të tjera në aplikim.

Vendimi:
Kur arsyet për përjashtim ose falje të detyrimeve të importit ose eksportit janë të ndryshme për vendimin në krahasim me ato të aplikimit, shkruani një përshkrim të detajuar të arsyetimit që formon bazën e vendimit.

VIII / 14. Të dhënat e Bankës dhe llogarisë

Nëse është e aplikueshme, shënoni të dhënat e llogarisë bankare, ku do të shlyhen ose shuhen detyrimet e importit apo eksportit.

KREU IX

Aplikimi dhe autorizimi për ambiente të magazinimit të përkohshëm

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për ambiente të magazinimit të përkohshëm
Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emertimi	Statusi
IX/1	Lëvizja e mallrave	A

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin ambiente të magazinimit të përkohshëm

Hyrje
Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave
IX / 1. Lëvizja e mallrave

Tregoni bazën ligjore për lëvizjen e mallrave.
Tregoni adresën e destinacionit të objektit ose objekteve të magazinimit të përkohshëm.
Nëse lëvizja e mallrave është planifikuar të zhvillohet në përputhje me nenin 138 (5) (c) të Kodit, atëherë futni numrin RIOE të mbajtësit të autorizimit për të operuar me objektin ose ambienteve të përkohshëm të destinacionit.

KREU X

Aplikimi dhe autorizimi i shërbimit të rregullt transportit detar

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin e shërbimit të rregullt të transportit detar

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
X/1	Dega doganore që lidhet me shërbimin e rregullt të anijeve	A
X/2	Emërtimi i anijeve	C[*]
X/3	Portet e ndalimit	C[*]
X/4	Sipërmarrja	A [*]

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin e shërbimit të rregullt të transportit detar

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

X / 1. Dega doganore që lidhet me shërbimin e rregullt të anijeve

Tregoni degën doganore përkatëse të përfshirë apo potencialisht të përfshirë

X / 2. Emërtimi i anijeve

Shkruani informacionin e duhur mbi anijet e caktuara për shërbimin e rregullt të anijeve.

X / 3. Portet e ndalimit

Shkruani referencën për zyrat doganore përgjegjëse për portet e ndalimit të anijeve, të caktuara ose të parashikuara për t'u caktuar për shërbimin e rregullt të anijeve.

X / 4. Sipërmarrja

Shënoni (po / jo) nëse aplikuesi merr përsipër:

- t'i komunikojë autoritetit doganor të vendim-marrjes informacionin e përmendur në nenin 269 (1), dhe
- që në rrugët e shërbimeve të rregullta të transportit detar, të mos bëhet asnjë ndalim në ndonjë port të një territori jashtë territorit doganor të R.SH. ose në ndonjë zonë të lirë në një port të R.SH, dhe që nuk do të bëhet asnjë transportim mallrash me anije në det.

KREU XI

Aplikimi dhe autorizimi për statusin e lëshuesit të autorizuar

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për kërkesën dhe autorizimin për statusin e lëshuesit të autorizuar

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XI/1	Zyra(at) doganore përgjegjëse për regjistrimin e dëshmisë të statusit doganor të mallrave të RSH	A [+]

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për kërkesën dhe autorizimin për statusin e lëshuesit të autorizuar

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

XI / 1. Zyra(at) doganore përgjegjëse për regjistrimin e dëshmisë së statusit doganor të mallrave të Bashkimit

Tregoni zyrën(at) doganore për të cilin lëshuesi i autorizuar duhet të transmetojë dëshminë e statusit doganor të mallrave shqiptare me qëllim regjistrimin e tij.

KREU XII

Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e deklaratës së thjeshtëzuar

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për të përdorur deklaratën e thjeshtëzuar

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XII/1.	Afati kohor për dorëzimin e deklaratës plotësuese	A [+]
XII/2.	Nënkontraktori	A [1][2]
XII/3.	Identifikimi i nënkontraktorit	A [2]

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

Shënime

Numri i shënimit	Përshkrimi i shënimit
[1]	Ky informacion është i detyrueshëm vetëm në rastet kur numri RIOE i nënkontraktorit nuk është i disponueshëm. Kur jepet numri RIOE, emri dhe adresa nuk duhen dhënë.
[2]	Ky informacion mund të përdoret vetëm për regjimin e eksportit në rastet kur deklarata doganore do të dorëzohet nga nënkontraktori.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për të përdorur deklaratën e thjeshtëzuar

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

XII / 1. Afati kohor për dorëzimin e deklaratës plotësuese

Nëse është e zbatueshme, autoriteti autorizues doganor përcakton afatin përkatës të shprehur në ditë.

XII / 2. Nënkontraktori

Nëse është e zbatueshme, shkruani emrin dhe adresën e nënkontraktorit.

XII / 3. Identifikimi i nënkontraktorit

Futni numrin RIOE të personit në fjalë.

KREU XIII

Aplikimi dhe autorizimi për zhdoganimin e centralizuar

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për zhdoganimin e centralizuar

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XIII/1	Shoqëritë e përfshira në autorizim	A [1]
XIII/2	Shoqëritë e përfshira në autorizim, lidentifikimi	A
XIII/3	Zyra(at) doganore e paraqitjes	A
XIII/4	Identifikimi i TVSH-së, aksizës dhe autoriteteve statistikore	C [*] A [+]
XIII/5	Metoda e pagesës së TVSH-së	A[+]
XIII/6	Përfaqësuesi tatimor	A [1]
XIII/7	Identifikimi i përfaqësuesit tatimor	A
XIII/8	Kodi i statusit të përfaqesuesit tatimor	A
XIII/9	Personi përgjegjës për formalitetet e akcizës	A [1]
XIII/10	Personi përgjegjës për identifikimin eformaliteteve të akcizës	A

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

Shënime

Numri i shënimit	Pershkrimi i shënimit
[1]	Ky informacion është i detyrueshëm vetëm në rastet kur numri RIOE i personit në fjalë nuk është i disponueshëm. Në rast se jepet numri RIOE , atëherë nuk duhet dhënë emri dhe adresa.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për zhdoganimin e centralizuar

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

XIII / 1. Shoqëritë e përfshira në autorizim

Nëse është e zbatueshme, shkruani emrin dhe adresën e shoqërive në fjalë.

XIII / 2. Shoqëritë e përfshira në autorizim, identifikimi

Nëse është e zbatueshme, shkruani numrin RIOE të kompanive në fjalë.

XIII / 3. Zyra(at) doganore e paraqitjes

Tregoni zyrën(at) doganore në fjalë.

XIII / 4. Identifikimi i TVSH-së, akcizës dhe autoriteteve statistikore

Shkruani emrin dhe adresën e TVSH-së, akcizës dhe autoriteteve statistikore të përfshira në autorizim si dhe të treguara në D.E. 1/4 Vlefshmëria gjeografike

XIII / 5. Metoda e pagesës së TVSH-së

Shtetet Anëtare pjesëmarrëse do të specifikojnë kërkesat e tyre përkatëse në lidhje me paraqitjen e të dhënave të TVSH-ës së importit, duke treguar metodën e zbatueshme për pagesën e TVSH-së.

XIII / 6. Përfaqësuesi tatimor

Shkruani emrin dhe adresën e përfaqësuesit tatimor të kërkuesit

XIII / 7. Identifikimi i përfaqësuesit tatimor

Shënoni numrin e TVSH-së së përfaqësuesit tatimor të aplikuesit në zyrën doganore të paraqitjes. Në qoftë se nuk është caktuar asnjë përfaqësues tatimor, atëherë duhet të jepni numrin e TVSH-së së aplikuesit.

XIII / 8. Kodi i statusit të përfaqësuesit tatimor

Tregoni nëse aplikuesi do të veprojë në emër të vet në çështjet fiskale ose do të caktojë një përfaqësues tatimor në zyrën doganore të paraqitjes.

XIII / 9. Personi përgjegjës për formalitetet e akcizës

Shënoni emrin dhe adresën e personit përgjegjës për pagesën ose dorëzimin e garacisë për detyrimet e akcizës.

XIII / 10. Personi përgjegjës për identifikimin e formaliteteve të akcizës

Shënoni numrin RIOE të personit në fjalë, në qoftë se ky person ka një numër të vlefshëm RIOE dhe është në dispozicion të aplikuesit.

KREU XIV

Aplikimi dhe autorizimi për të bërë një deklaratë doganore përmes futjes së të dhënave në regjistrat e deklaruesit, duke përfshirë edhe regjimin e eksportit

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për të bërë një deklaratë doganore përmes futjes së të dhënave në regjistrat e deklaruesit, duke përfshirë edhe regjimin e eksportit

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XIV/1.	Heqja e njoftimit të paraqitjes	A
XIV/2.	Heqja e deklaratës së para-nisjes	A
XIV/3.	Zyra doganore përgjegjëse për vendin ku mallrat janë të disponueshme për kontroll	C [*]A [+]
XIV/4.	Afati i fundit për dorëzimin e të dhënave të deklaratës së plotë doganore	A [+]

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për të bërë një deklaratë doganore përmes futjes së të dhënave në regjistrat e deklaruesit, duke përfshirë edhe për regjimin e eksportit

Hyrje
Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave

XIV / 1. Heqja e njoftimit të paraqitjes

Aplikimi:
Shënoni (po / jo) nëse tregtari dëshiron të përfitojë nga heqja dorë prej njoftimit të disponueshmërinë së mallrave për kontrollet **doganore.** Nëse po, specifiko arsyet.

Vendimi:
Në rast se autorizimi nuk parashikon heqjen e njoftimit, atëherë autoriteti autorizues doganor përcakton afatin kohor mes marrjes së njoftimit dhe çlirimit të mallrave.

XIV / 2. Heqja e deklaratës së para-nisjes

Në rast se aplikimi lidhet me regjimin e eksportit ose ri-eksportit, arsyetoni se janë plotësuar kushtet e përshkruara në nenin 236 (2) të Kodit.

XIV / 3. Zyra doganore përgjegjëse për vendin ku mallrat janë të disponueshme për kontroll

Shkruani identifikuesin e zyrës doganore përkatëse.

XIV / 4. Afati i fundit për dorëzimin e të dhënave të deklaratës së plotë doganore

Autoritetet doganore të **vendim-marrjes** do të sigurojnë afatin e fundit në autorizimin brenda së cilit mbajtësi i autorizimit do t'i dërgojë të dhënat e deklaratës së plotë doganore zyrës doganore mbikqyrese.
Afati i fundit duhet të shprehet në ditë.

KREU XV
Aplikimi dhe autorizimi për vetëvlerësim
KAPITULLI 1
Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për vetë-vlerësim
Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XV/1.	Identifikimi i formaliteteve dhe kontrolleve për t'u deleguar ndaj operatorëve ekonomikë	A

Statusi i treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondon me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2
Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për vetë-vlerësim
Hyrje
Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave
XV / 1. Identifikimi i formaliteteve dhe kontrolleve që do t'i delegohen operatorit ekonomik
Tregoni kushtet nën të cilat **bëhet** kontrolli i pajtueshmërisë me ndalimet dhe kufizimet, të specifikuara në D.E. 6/1 Ndalimet dhe kufizimet mund të kryhen nga mbajtësi i autorizimit.

KREU XVI

Aplikimi dhe autorizimi për statusin e peshuesit të autorizuara të bananeve

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për statusin e peshuesit të autorizuar të bananeve

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XVI/1.	Aktiviteti ekonomik	A
XVI/2.	Pajisjet e peshimit	A
XVI/3.	Garancitë shtesë	A
XVI/4.	Njoftimi i avancuar ndaj autoriteteve doganore	A

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për statusin e peshuesit të autorizuara të bananeve

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

XVI / 1. Aktiviteti ekonomik

Tregoni aktivitetin ekonomik në lidhje me tregtinë e bananeve të freskëta.

XVI / 2. Pajisjet e peshimit

Jepni përshkrimin e pajisjeve të peshimit.

XVI / 3. Garancitë shtesë

Dëshmia e përshtatshme siç njihet në përputhje me ligjin kombëtar që:

- vetëm makina të cilat janë të kalibruara siç duhet dhe në përputhje me standardet teknike përkatëse, sigurojnë një përcaktim të saktë të peshës neto të bananeve,

- peshimi i bananeve kryhet vetëm nga peshues të autorizuar në vende të mbikëqyrura nga autoritetet doganore,

- pesha neto e bananeve, origjina dhe paketimi i bananeve, si dhe koha e peshimit dhe vendi i shkarkimit reflektohen menjëherë në certifikatën e peshimit të bananeve,

- bananet janë peshuar në përputhje me proçedurën e përcaktuar në Aneksin 61-03,

- rezultatet e peshimit janë vënë menjëherë në certifikatën e peshimit siç kërkohet nga legjislacioni doganor shqiptar.

XVI / 4. Njoftimi i avancuar ndaj autoriteteve doganore

Jepni llojin e njoftimit si dhe një kopje të njoftimit.

KREU XVII

Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv

Tabela me kërkesat e të dhënave

Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XVII/1	Eksportimi paraprak (IP EX/IM)	A
XVII/2	Çlirimi në qarkullim të lirë përmes përdorimit të dokumentit të mbylljes	A

Statusi i treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondon me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

XVII / 1. Eksportimi paraprak

Shënoni ("po / jo") nëse është planifikuar eksportimi i produkteve të përpunuara të përfituara nga mallrat ekuivalente para importimit të mallrave që ato zëvendësojnë (IP EX / IM). Nëse po, tregoni periudhën e sugjeruar të shprehur në muaj, brenda të cilit mallrat jo-shqiptare duhet të deklarohen për përpunim aktiv duke marrë parasysh kohën e kërkuar për prokurimin e mallrave dhe transportin e tyre në R.SH.

XVII / 2. Lëshimi në qarkullim të lirë përmes përdorimit të dokumentit të shfuqizimit

Shënoni ("po / jo") nëse produktet e përpunuara ose mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv IM / EX konsiderohen se janë në qarkullim të lirë në qoftë se ato nuk janë vendosur nën një regjim doganor pasues ose ri-eksportohen pas skadimit të periudhës për shfuqizim, dhe deklarata doganore për vendosjen në qarkullim të lirë, do të konsiderohet se është paraqitur dhe pranuar dhe çlirimi është dhënë në datën e përfundimit të afatit për mbyllje.

KREU XVIII

Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv

Tabela me kërkesat e të dhënave

Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XVIII/1	Sistemi standard i shkëmbimit	A
XVIII/2	Produktet zëvendësuese	A
XVIII/3	Importi paraprak i produkteve zëvendësuese	A
XVIII/4	Importi paraprak i produkteve të përpunuara (OP IM/EX),	A

Statusi i treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondon me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave

XVIII / 1. Sistemi standard i shkëmbimeve

Aplikimi:

Në rast të riparimit të mallrave, një produkt i importuar (produkti zëvendësues) mund të zëvendësojë një produkt të **përpunuar** (i **ashtuquajturi** sistemi standard i shkëmbimeve).

Shënoni {"po / jo") nëse synohet të përdoret sistemi standard i shkëmbimit. Nëse po, shënoni kodin(et) përkatës.

Autorizimi:

Specifikoni masat për të vendosur nese janë përmbushur kushtet për sistemin standard të shkëmbimit.

XVIII / 2. Produktet zëvendësuese

Në rastet kur planifikohet përdorimi i sistemit standard të shkëmbimit (që është i mundur vetëm në rast të riparimit), deklaroni kodin 8-shifror të Nomenklaturës së Kombinuar, cilësinë tregtare dhe karakteristikat teknike të produkteve zëvendësuese për t'u mundësuar autoriteteve doganore të bëjnë krahasimet e nevojshme mes eksportit të përkohshëm të mallrave dhe produkteve zëvendësuese. Për këtë krahasim, përdorni të paktën një nga kodet përkatëse të parashikuara në lidhje me **D.E. 5/8 Identifikimi** i mallrave.

XVIII / 3. Importi paraprak i produkteve zëvendësuese

Shënoni { "po / jo") nëse planifikohet importimi i produkteve zëvendësuese para eksportit të produkteve të dëmtuara. Nëse po, tregoni periudhën e shprehur në muaj, brenda së cilës mallrat shqiptare duhet të deklarohen për përpunim pasiv.

XVIII / 4. Importi paraprak i produkteve të përpunuara (OP IM / EX)

Shënoni { "po / jo") nëse planifikohet importimi i produkteve të përpunuara të përfituara nga mallrat ekuivalente para vendosjes së mallrave shqiptare nën përpunimin pasiv. Nëse po, tregoni periudhën e shprehur në muaj, brenda së cilës mallrat shqiptare duhet të deklarohen për përpunim pasiv duke pasur parasysh kohën e kërkuar për prokurimin e mallrave shqiptare dhe **transportin** e tyre në zyrën e eksportit.

KREU XIX

Aplikimi dhe autorizimi për funksionimin e depove për magazinimin doganor të mallrave

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për funksionimin e depove për magazinimin doganor të mallrave

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XIX/1	Largimi i përkohshëm	A
XIX/2	Norma e humbjes	A

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e **dhënë** në Kreun I, Kapitulli **1.**

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për funksionimin e depove për magazinimin doganor të mallrave

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave

XIX / 1. Largimi i përkohshëm

Aplikimi:

Shënoni ("po / jo") nëse planifikohet largimi i përkohshëm i mallrave të vendosura nën regjimin e magazinimit doganor nga depo doganore. Jepni të gjitha detajet e nevojshme që konsiderohen se kanë të bëjnë me heqjen e përkohshme të mallrave.

Kërkesa për largimin e përkohshëm mund t'i paraqitet autoritetit doganor të vendim-marrjes në një fazë të mëvonshme pasi të jetë pranuar aplikimi dhe të jetë dhënë autorizimi për **funksionimin** e depove.

Autorizimi:

Specifikoni kushtet në të cilat mund të kryhet largimi i mallrave të vendosura nën regjimin e magazinimit doganor. Nëse aplikimi është refuzuar, **specifikoni** arsyet e refuzimit.

XIX / 2. Norma e humbjes

Jepni detaje, kur është e **përshtatshme,** për normën(at) e humbjes.

KREU XX

Aplikimi dhe autorizimi për statusin e dërguesit të autorizuar për regjimin e transitit

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për statusin e dërguesit të autorizuar për regjimin e transitit

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XX/1	Masat e identifikimit	A [+]
XX/2	Garancia globale	A

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e **dhënë** në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për statusin e dërguesit të autorizuar për regjimin e transitit

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në **Kapitullin 1.**

Kërkesat e të dhënave

XX / 1. Masat e identifikimit

Të dhënat e masave të identifikimit që do të zbatohen nga dërguesi i autorizuar. Kur dërguesit të autorizuar i është dhënë një autorizim për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë në pajtim me nenin 207 (4) (c) të Kodit, autoritetet doganore të vendim-marrjes mund ta përshkruajnë përdorimin e plumbçevë të tilla si masë identifikimi. Duhet të jepet numri i referencës së vendimit për **përdorimin** e plkumbçeve të një lloji të veçantë.

XX / 2. Garancia globale

Tregoni numrin e referencës së vendimit për dhënien e garancisë globale apo heqjen dorë prej garancisë. Në rast se autorizimi përkatës nuk është dhënë akoma, tregoni numrin e **regjistrimit** të aplikimit në fjalë.

KREU XXI

Aplikimi dhe autorizimi për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë

KAPITULLI 1

Kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë

Tabela me kërkesat e të dhënave

D.E. Nr. i urdhërit	D.E. emërtimi	Statusi
XXI/1.	Lloji i plumbçes	A

Statusi dhe shenja e treguar në tabelën me kërkesat e të dhënave të mësipërme korrespondojnë me përshkrimin e dhënë në Kreun I, Kapitulli 1.

KAPITULLI 2

Shënime në lidhje me kërkesat e veçanta të të dhënave për aplikimin dhe autorizimin për përdorimin e vulave të një lloji të veçantë

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë kapitull zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 1.

Kërkesat e të dhënave

XXI / 1. Lloji plumbçes

Aplikimi:

Shkruani të gjitha detajet mbi plumbçen (p.sh., modeli i prodhimit, dëshmia e çertifikimit nga autoriteti kompetent në pajtim me Standardet Ndërkombëtare ISO Nr. 17712: 2013 "Plumbçet mekanike të kontenierëve").

Vendimi:

Konfirmimi nga autoriteti doganor i vendim-marrjes se plumbçi plotëson karakteristikat thelbësore dhe është në përputhje me specifikimet e nevojshme teknike dhe se përdorimi i plumbçeve të një lloji të veçantë është i dokumentuar, dmth që është ngritur gjurma e auditimit si dhe është miratuar nga autoritetet kompetente.

ANEKSI B

KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË TË DHËNAVE PËR DEKLARATAT, NJOFTIMET SI DHE PROVA E STATUSIT DOGANOR TË MALLRAVE SHQIPTARE

KREU I

Kërkesat per të dhënat

KAPITULLI 1

Shënimet hyrëse të tabelës me kërkesat për të dhënat

(1) Mesazhet e deklaratës përmbajnë një sërë elementesh të të dhënave ku vetëm disa prej të cilëve do të përdoren, në varësi të **regjimit(eve)** doganor në fjalë.

(2) Elementet e të dhënave të cilat mund të ofrohen për çdo regjim janë paraqitur në tabelën me kërkesat e të dhënave. Dispozitat e veçanta në lidhje me çdo element të dhënave siç janë përshkruar në Kreun II, zbatohen pa paragjykuar statusin e elementeve të të dhënave të përcaktuara në tabelën me kërkesat e të dhënave. Dispozitat që zbatohen për të gjitha situatat kur kërkohet elementi i të dhënave në fjalë, janë të përfshira në Kreun "Të gjitha kolonat e përdorura të tabelës me kërkesat përkatëse të të dhënave ". Përveç kësaj, dispozitat që zbatohen për kolona të veçanta të tabelës janë të përfshira në seksione të veçanta që kanë të bëjnë pikërisht me këto kolona. Dy grupe të **dispozita** ve duhet të kombinohen për të **pasqyruar** gjendjen e çdo kolone të tabelës.

(3) Simbolet "A", "B" ose 'C' të renditura në Kapitullin 2, seksioni 3 si më poshtë nuk kanë asnjë ndikim në faktin se të dhënat e caktuara mblidhen vetëm kur rrethanat e justifikojnë këtë gjë. Për shembull, njësitë plotësuese (statusi 'A') do të mblidhet vetëm kur kjo të kërkohet nga TARIC.

(4) Simbolet "A", "B" ose 'C' të përcaktuara në Kapitullin 2, seksioni 3 mund të plotësohen nga kushtet apo sqarimet e listuara në shënimet **bashkëngjitur** tabelës me kërkesat e të **dhënave** të kapitullit 3, seksioni 1 si më poshtë.

(5) Nëse zyra doganore e pranimit të deklaratës doganore e lejon, një deklaratë doganore (seritë e kolonave B dhe H) ose një deklaratë e thjeshtuar (seritë e kolonave C dhe I) mund të përmbajnë artikuj të mallrave që i nënshtrohen kodeve të ndryshme të regjimit, duke siguruar që të gjitha këto kode të regjimit përdorin të njëjtin grup të dhënash siç përcaktohet në kapitullin 3, seksioni 1 dhe i përkasin të njëjtës kolonë të matricës siç përcaktohet në Kapitullin 2. Megjithatë, kjo mundësi nuk do të përdoret për deklaratat doganore të parashtruara në kuadrin e zhdoganimit të centralizuar në përputhje me nenin 163 të Kodit.

(6) Pa marrë parasysh detyrimet për sigurimin e të dhënave sipas këtij Aneksi dhe pa rënë ndesh me nenin 23 të Kodit, përmbajtja e të dhënave që i jepet doganës në lidhje me një kërkesë të caktuar, do të bazohet në informacionin ashtu siç njihet nga operatori ekonomik që e ofron atë në kohën që i është dhënë Doganës.

(7) Deklaratat përmbledhëse të daljes apo hyrjes që duhet të paraqiten për mallrat në daljen ose hyrjen e tyre në territorin doganor të R.SH, përmbajnë informacion të detajuar në kolonat A1 dhe A2 dhe F1a me F5 të tabelës me kërkesat e të dhënave në kapitullin 3, Seksioni 1 si më poshtë, për secilën nga situatat ose llojet e transportit në fjalë.

(8) Përdorimi brenda këtij Aneksi i fjalëve deklaratat përmbledhëse të hyrjes dhe daljes, i referohen përkatësisht **deklaratave përmbledhëse** të hyrjes dhe daljes të **parashikuara** në nenet 6 (9) dhe 6 (10) të Kodit.

(9) Kolonat A2, F3a dhe F3b të tabelës me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 3, Seksioni 1 si më poshtë, mbulojnë të dhënat e kërkuara të cilat i jepen autoriteteve doganore kryesisht për qëllime të analizës së riskut për sigurinë dhe mbrojtjen , para nisjes, mbërritjes ose ngarkimit të dërgesave të shpejta.

(10) Për qëllime të këtij Aneksi, dërgesa të shpejta nënkuptojnë një njësi individuale të transportuar përmes një shërbimi të integruar të mbledhjes, transportit, zhdoganimit dhe dërgimit në mënyrë të shpejtë dhe me datë përfundimi të saktë, që mundëson gjurmimin, vendndodhjen dhe mbajtjen nën kontroll të njësive të tilla përgjatë të gjithë ofrimit të shërbimit.

(11) Kur kolona F5 e tabelës me kërkesat e të dhënave në Kapitullit 3, Seksioni 1 si më poshtë, zbatohet për transportin rrugor, ajo gjithashtu përfshin rastet e transportit multimodal, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Kreun II.

(12) Deklaratat e thjeshtuara të përmendura në nenin 152 të Kodit, përmbajnë informacion të detajuar në kolona C1 dhe I1.

(13) Lista e reduktuar e elementeve të të dhënave e siguruar për regjimet në kolonat C1 dhe I1, nuk kufizon apo ndikon në kushtet e përcaktuara për regjimet në kolonat e tjera të tabelës me kërkesat e të dhënave, sidomos në lidhje me informacionin që do të ofrohet në deklaratat shtesë.

(14) Formatet, kodet dhe, nëse është e zbatueshme, strukturat e kërkesave të të dhënave të përshkruara në këtë Aneks, janë të specifikuara në këtë vendim.

(15) Zyra doganore do të njoftojë DPD për listen e të dhënave që kërkojnë për secilin nga regjimet e referuara në këtë Aneks. DPD do të publikojë listën e këtyre të dhënave.

ANEKSI B

KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË TË DHËNAVE PËR DEKLARATAT, NJOFTIMET SI DHE PROVA E STATUSIT DOGANOR TË MALLRAVE SHQIPTARE

KREU I

Kërkesat për të dhënat

KAPITULLI 1

Shënimet hyrëse të tabelës me kërkesat për të dhënat

(1) Mesazhet e deklaratës përmbajnë një sërë elementesh të të dhënave ku vetëm disa prej të cilëve do të përdoren, në varësi të regjimit(eve) doganor në fjalë.

(2) Elementet e të dhënave të cilat mund të ofrohen për çdo regjim janë paraqitur në tabelën me kërkesat e të dhënave. Dispozitat e veçanta në lidhje me çdo element të dhënave siç janë përshkruar në Kreun II, zbatohen pa paragjykuar statusin e elementeve të të dhënave të përcaktuara në tabelën me kërkesat e të dhënave. Dispozitat që zbatohen për të gjitha situatat kur kërkohet elementi i të dhënave në fjalë, janë të përfshira në Kreun "Të gjitha kolonat e përdorura të tabelës me kërkesat përkatëse të të dhënave ". Përveç kësaj, dispozitat që zbatohen për kolona të veçanta të tabelës janë të përfshira në seksione të veçanta që kanë të bëjnë pikërisht me këto kolona. Dy grupe të dispozitave duhet të kombinohen për të pasqyruar gjendjen e çdo kolone të tabelës.

(3) Simbolet "A", "B" ose 'C' të renditura në Kapitullin 2, seksioni 3 si më poshtë nuk kanë asnjë ndikim në faktin se të dhënat e caktuara mblidhen vetëm kur rrethanat e justifikojnë këtë gjë. Për shembull, njësitë plotësuese (statusi 'A') do të mblidhet vetëm kur kjo të kërkohet TARIC/TARISH

(4) Simbolet "A", "B" ose 'C' të përcaktuara në Kapitullin 2, seksioni 3 mund të plotësohen nga kushtet apo sqarimet e listuara në shënimet bashkëngjitur tabelës me kërkesat e të dhënave të kapitullit 3, seksioni 1 si më poshtë.

(5) Nëse zyra doganore e pranimit të deklaratës doganore e lejon, një deklaratë doganore (seritë e kolonave B dhe H) ose një deklaratë e thjeshtuar (seritë e kolonave C dhe I) mund të përmbajnë artikuj të mallrave që i nënshtrohen kodeve të ndryshme të regjimit, duke siguruar që të gjitha këto kode të regjimit përdorin të njëjtin grup të dhënash siç përcaktohet në kapitullin 3, seksioni 1 dhe i përkasin të njëjtës kolonë të matricës siç përcaktohet në Kapitullin 2. Megjithatë, kjo mundësi nuk do të përdoret për deklaratat doganore të parashtruara në kuadrin e zhdoganimit të centralizuar në përputhje me nenin 163 të Kodit.

(6) Pa marrë parasysh detyrimet për sigurimin e të dhënave sipas këtij Aneksi dhe pa rënë ndesh me nenin 23 të Kodit, përmbajtja e të dhënave që i jepet doganës në lidhje me një kërkesë të caktuar, do të bazohet në informacionin ashtu siç njihet nga operatori ekonomik që e ofron atë në kohën që i është dhënë Doganës.

(7) Deklaratat përmbledhëse të daljes apo hyrjes që duhet të paraqiten për mallrat në daljen ose hyrjen e tyre në territorin doganor të R.SH, përmbajnë informacion të detajuar në kolonat A1 dhe A2 dhe F1a me F5 të tabelës me kërkesat e të dhënave në kapitullin 3, Seksioni 1 si më poshtë, për secilën nga situatat ose llojet e transportit në fjalë.

(8) Përdorimi brenda këtij Aneksi i fjalëve deklaratat përmbledhëse të hyrjes dhe daljes, i referohen përkatësisht deklaratave përmbledhëse të hyrjes dhe daljes të parashikuara në nenet 6 (9) dhe 6 (10) të Kodit.

(9) Kolonat A2, F3a dhe F3b të tabelës me kërkesat e të dhënave në Kapitullin 3, Seksioni 1 si më poshtë, mbulojnë të dhënat e kërkuara të cilat i jepen autoriteteve doganore kryesisht për qëllime të analizës së riskut për sigurinë dhe mbrojtjen , para nisjes, mbërritjes ose ngarkimit të dërgesave të shpejta.

(10) Për qëllime të këtij Aneksi, dërgesa të shpejta nënkuptojnë një njësi individuale të transportuar përmes një shërbimi të integruar të mbledhjes, transportit, zhdoganimit dhe dërgimit në mënyrë të shpejtë dhe me datë përfundimi të saktë, që mundëson gjurmimin, vendndodhjen dhe mbajtjen nën kontroll të njësive të tilla përgjatë të gjithë ofrimit të shërbimit.

(11) Kur kolona F5 e tabelës me kërkesat e të dhënave në Kapitullit 3, Seksioni 1 si më poshtë, zbatohet për transportin rrugor, ajo gjithashtu përfshin rastet e transportit multimodal, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Kreun II.

(12) Deklaratat e thjeshtuara të përmendura në nenin 152 të Kodit, përmbajnë informacion të detajuar në kolona C1 dhe I1.

(13) Lista e reduktuar e elementeve të të dhënave e siguruar për regjimet në kolonat C1 dhe I1, nuk kufizon apo ndikon në kushtet e përcaktuara për regjimet në kolonat e tjera të tabelës me kërkesat e të dhënave, sidomos në lidhje me informacionin që do të ofrohet në deklaratat shtesë.

(14) Formatet, kodet dhe, nëse është e zbatueshme, strukturat e kërkesave të të dhënave të përshkruara në këtë Aneks, janë të specifikuara në vendim.

(15) Autoriteti kompetent do të publikojë listen e të dhënave që kërkohet për secilin nga regjimet e referuara në këtë Aneks.

KAPITULLI 2
Legjenda e tabelës

Seksioni 1
Titujt e kolonave

Kolonat	Deklaratat / njoftimet / prova e statusit doganor të mallrave Shqiptare	Baza ligjore
Nr. i elementit të të dhënave	Numri i urdhërit i dhwnw elementit të të dhënave në fjalë	
Emërtimi i elementit të të dhënave	Emërtimi i elementit të të dhënave në fjalë	
Numri i kutisë	Referenca e dhënë ndaj kutisë që përmban elementin e të dhënave në fjalë në deklaratat doganore të bazuara nw letwr. Referenca korrespondojnë me kutinë DAV apo, kur ato fillojnë me një "S" me elementet që lidhen me sigurinë.	
A1	Deklarata përmbledhëse e daljes	Nenet 6(10) dhe 243 të Kodit
A2	Dekalata përmbledhëse e daljes --- Dërgesat e shpejta	Nenet 6(10) dhe 243 të Kodit
A3	Njoftimi i ri-eksportit	Nenet 6(14) dhe 246 të Kodit
B1	Deklarata e eksportit dhe deklarata e ri-eksportit	Deklarata e eksportit: Nenet 6(12), 149 dhe 241 të Kodit Deklarata e ri-eksportit: Nenet 6(13) dhe 242 të Kodit
B2	Regjimi i veçantë – përpunimi – deklarata e përpunimit pasiv	Nenet 6(12), 149, 191 dhe 232 të Kodit
B3	Deklarata për magazinimin doganor të mallrave të Shqiptare	Nenet 6(12), 149, 191 dhe 210(2) të Kodit

Kolonat	Deklaratat / njoftimet / prova e statusit doganor të mallrave Shqiptare	Baza ligjore
C1	Deklarata e thjeshtuar e eksportit	Nenet 6(12) dhe 152 të Kodit
C2	Paraqitja e mallrave në doganë në rast të hyrjes në regjistrin e të dhënave të deklaruesit ose në kuadër të deklaratave doganore të paraqitura para prezantimit të mallrave për eksport	Nenet 6(33), 156 dhe 165 të Kodit
D1	Regjimi i posaçëm --- deklarata e transitit	Nenet 6(12), 149, 191, 203 dhe 204 të Kodit
D2	Regjimi i posaçëm --- deklarata e transitit me grupe të reduktuara të dhënash --- (transporti hekurudhor, ajror dhe detar)	Nenet 6(12), 149, 191 dhe 233(4)d) të Kodit
D3	Regjimi i posaçëm --- Transiti --- Përdorimi i dokumentit elektronik të transportit si deklaratë doganore --- (transporti ajror dhe detar)	Nenet 5(12), 162, 210 dhe 207(4)d) të Kodit
E1	Prova e statusit doganor të mallrave shqiptare (T2L / T2LF)	Nenet 6(23) dhe 141(2) dhe 144 të Kodit
E2	Manifesti doganor i mallrave	Nenet 6(23) dhe 141(2) dhe 144 të Kodit
F1a	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Rrugët detare dhe ujore të brendshme – Grupi i plotë i të dhënave	Nenet 6 (9) dhe 119 të Kodit
F1b	Deklarata përmbledhëse e hyrjes --- Rrugët detare dhe ujore të brendshme – Grupi i pjesshëm i të dhënave të paraqitura nga transportuesi	Nenet 6(9) dhe 119 te Kodit
F1c	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Rrugët detare dhe ujore të brendshme – Grupi i pjesshëm i të dhënave nga një person sipas Nenit 119(6) të Kodit dhe në përputhje me Nenin 243 (1) nënparagrafi i pare.	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F1d	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Rrugët detare dhe ujore të brendshme – Grupi i pjesshëm i të dhënave nga një person sipas Nenit 119 (6) të Kodit dhe në përputhje me Nenin 243 (1) nënparagrafi i dytë.	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F2a	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Ngarkesa ajrore (e përgjithshme) – Grupi i plotë i të dhënave	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F2b	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Ngarkesa ajrore (e përgjithshme) – Grupi i pjesshëm i të dhënave të dorëzuara nga transportuesi	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit

Kolonat	Deklaratat / njoftimet / provae statusit doganor të mallrave shqiptare	Baza ligjore
F2c	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – ngarkesa ajrore (e përgjithshme) – Grupi i pjesshëm i të dhënave të siguruara nga një person sipas Nenit 119 (6) të Kodit dhe në përputhje me Nenin 244 (1)	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F2d	Deklarata përmbledhese e hyrjes – Ngarkesa ajrore (e përgjithshme) – grupi minimal i të dhënave që do të paraqiten para ngarkimit në përputhje me situatat e përcaktuara në Nenin 137(1) nënparagrafi i dytë dhe në përputhje me Nenin 244(1).	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F3a	Deklarata përmbledhëse e hyrjes– Dërgesat e shpejrta – Grupi i plotë i të dhënave	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F3b	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Dërgesat e shpejta – Grupi minimal i të dhënave që duhet të paraqiten para ngarkimit në lidhje me situatat e përcaktuara në Nenin 137 (1) nënparagrafi i dytë	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F4a	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Dërgesat postare – Grupi i plotë i të dhënave	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F4b	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Dërgesat postare – Grupi i pjesshëm i të dhënave të dorëzuara nga transportuesi	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F4c	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Dërgesat postare – Grupi minimal i të dhënave që duhet të paraqiten para ngarkimit në lidhje me situatat e përcaktuara në Nenin 137 (1) nënparagrafi i dytë ([1]) dhe në përputhje me Nenin 244 (2)	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F4d	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Dërgesat postare – Grupi i pjesshëm i të dhënave në nivel kutie që duhet të paraqiten para ngarkimit në lidhje me situatat e përcaktuara në Nenin 137(1) nënparagrafi i dytë ([1]) dhe në përputhje me Nenin 244(2)	Nenet 6(9) dhe 119 të Kodit
F5	Deklarata përmbledhëse e hyrjes – Rrugore dhe hekurudhore	Nenet 6(9) dhe 119 tëKodit
G1	Njoftimi i devijimit	Neni 124 i Kodit
G2	Njoftimi i mbërritjes	Neni 124 i Kodit
G3	Paraqitja e mallrave në doganë	Nenet 6 (33) dhe 130 të Kodit
G4	Deklarata e magazinimit të përkohshëm	Nenet 6(17) dhe 135 të Kodit
G5	Njoftimi i mbërritjes në rast të lëvizjes së mallrave nën regjimin e magazinimit të përkohshëm	Neni 138 (5)(b) dhe (c) të Kodit

Kolonat	Deklaratat / njoftimet / prova e statusit doganor të mallrave shqiptare	Baza ligjore
H1	Deklarata për çlirimin e mallrave në qarkullim të lirë dhe regjimi i posaçëm – Përdorimi i veçantë – Deklarata për përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use)	Deklarata për çlirim në qarkullim te lirë: Nenet 6(12), 149 dhe 182 të Kodit, Deklarata për përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use): Nenet 6(12), 149, 227 të Kodit 210 dhe 254 të Kodit
H2	Regjimi i posaçëm – magazinimi – deklarata për magazinim doganor	Nenet 6 (12), 149, 191 dhe 213 të Kodit
H3	Regjimi i posaçëm – përdorim i veçantë – deklarata për lejim të përkohshëm	Nenet 6(12), 149,191 dhe 223 te Kodit
H4	Regjimi i posaçëm – përpunimi – deklarata për përpunimin aktiv	Nenet 6(12), 149, 191 dhe 229 të Kodit
H6	Deklarata doganore në trafikun postar për çlirim në qarkullim të lirë	Nenet 6(12), 149 dhe 182 t ë K o d i t
I1	Deklarata e thjeshtuar e importit	Nenet 6(12) dhe 152 të Kodit
I2	Prezantimi i mallrave në doganë në rast të hyrjes në regjistrin e të dhënave të deklaruesit ose në kuadër të deklaratave doganore të dorëzuara para paraqitjes së mallrave për import	Nenet 6(33), 156 dhe 165 të Kodit

(1) Të dhënat minimale para ngarkimit korrespondojnë me të dhënat e CN 23.

Seksioni 2

Grupet e të dhënave

Grupi	Emërtimi i grupit
Grupi 1	Informacioni i mesazhit (duke përfshirë kodet e regjimit)
Grupi 2	Referencat e mesazheve, dokumentat, çertifikatat, autorizimet
Grupi 3	Palët
Grupi 4	Informacioni i vlerësimit / Taksat
Grupi 5	Datat/ Orët/ Periudhat/ Vendet/ zyrat doganore/
Grupi 6	Identifikimi i mallrave
Grupi 7	Informacioni i transportit (mënyrat, mjetet dhe pajisjet)
Grupi 8	Elementet e tjera të të dhënave (të dhënat statistikore, garancitë, të dhënat që lidhen me tarifat)

Seksioni 3

Simbolet në qelizat

Simboli	Përshkrimi i simbolit
A	I detyrueshëm: të dhënat e kërkuara nga autoriteti kompetent
B	Fakultativ për autoritetin kompetent: të dhënat që autoriteti mund të vendosë për t'i hequr
C	Fakultativ për operatorët ekonomikë: të dhënat të cilat operatorët ekonomikë mund të vendosin për t'i dhënë, por që nuk mund të kërkohen nga autoriteti kompetent.
X	Elementi i të dhënave në nivel artikulli të deklaratës së mallrave. Informacioni i shënuar në nivel artikulli të mallrave është i vlefshëm vetëm për artikujt e mallrave në fjalë.
Y	Elementi i të dhënave të kërkuara në nivelin kryesor të deklaratës së mallrave. Informacioni i shënuar në nivel kryesor është i vlefshëm për të gjithë artikujt e deklaruar të mallrave.

Çdo kombinim i simboleve "X" dhe "Y" nënkupton se elementi i të dhënave mund të jepet nga deklaruesi në secilin prej niveleve në fjalë.


KAPITULLI 3
Seksioni 1
Tabela me kërkesat për të dhënat


(Shënimet për këtë tabelë ndodhen menjëherë pas tabelës)

Grupi 1 – Informacioni i mesazhit (duke përfshirë kodet e regjimeve)

			A			B				C		D			E		F												G					H						I	
Nr. D.E	D.E. Emërtimi i të dhënës	Nr. futurë	1	2	3	1	2	3	4	1	2	1	2	3	1	2	1 a	1 b	1 c	1 d	2 a	2 b	2 c	2 d	3 a	3 b	4 a	4 b	4 c	4 d	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	6	1	2
1/1	Lloji i deklaratës	1/1				AY	AY	AY	AY	AY																											AY	AY	AY	AY	AY	AY	AY	
1/2	Lloji i deklaratës shtesë	1/2				AY	AY	AY		AY																											AY	AY	AY	AY		AY	AY	
1/3	Dekalarata e transitit/ prova e llojit të statusit doganor	1/3										AXY	AXY	AXY	AXY	AXY																										
1/4	Formularët	3										B [1] [2] Y	B [1] [2] Y		B [1] [2] Y																													
1/5	Listat e ngarkimeve	4										B [1] Y	B [1] Y		B [1] Y																													
1/6	Numrat e artikujve të mallrave	32	AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX	A [3] X	A [2] X	A [2] X		A [2] X	AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX		AX		AX	AX	AX	AX	AX			AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX	AX	A [3] X
1/7	Treguesit e rrethanave të veçanta			A [4] Y													A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y	A [4] Y												
1/8	Nënshkrimi/	54	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A

| | Vërtetimi | | Y | Y | Y





| | | |

| | | |

| | | |

| | | |

| | | |

| | | |

| | | |

| | | |

| | | |

Seksioni 2

Shënime

Numri i shënimit	Përshkrimi i shënimit
[1]	Autoriteti kompetent mund ta kërkojë këtë element të të dhënave vetëm në kuadër të regjimit të bazuar në letër.
[2]	Kur deklarata në letër mbulon vetëm një artikull të mallrave, atëherë autoriteti kompetent mund të parashikojë që kjo kuti të mbetet bosh, numri "1" të ketë hyrë në kutinë 5.
[3]	Ky informacion nuk do të kërkohet në rast se deklarata doganore është dorëzuar para paraqitjes së mallrave në përputhje me Nenin 156 të Kodit.
[4]	Ky element nuk ka nevojë të sigurohet kur mund të rrjedhë automatikisht dhe në mënyrë të qartë nga elemente të tjera të të dhënave të siguruara nga operatori ekonomik.
[5]	Në rastet kur zbatohet Neni 153 (2) i Kodit (deklaratat e thjeshtësuara bazuar te autorizimet), atëherë autoriteti kompetent mund të heqë dorë nga detyrimi për të siguruar këtë informacion, kur kushtet e përcaktuara në autorizimet që lidhen me regjimet përkatëse, e lejojnë atë të shtyjë mbledhjen e këtij elementi të të dhënave në deklaratën plotësuese.
[6]	Ky element i të dhënave duhet të sigurohet, kur të paktën mungon një nga të dhënat e mëposhtme: - Identifikimi i mjeteve të transportit që kalojnë kufirin - Data e mbërritjes në zyrën doganore të hyrjes në territorin doganor të R.SH, sic është përmendur në Deklaratën përmbledhëse të hyrjes të depozituar për mallrat në fjalë.
[7]	Autoriteti kompetent mund të heqë dorë nga ky detyrim, nëse sistemet e tyre i lejojnë ata që ta nxjerrin këtë informacion automatikisht dhe në mënyrë të qartë nga informacione të tjera në deklaratë.
[8]	Ky element është një alternativë ndaj numrit unik të referencës së ngarkesës /NUR [UCR unic consignment reference number] kur ky i fundit nuk është në dispozicion. Ai siguron një lidhje ndaj burimeve të tjera të dobishme të informacionit.
[9]	Ky informacion duhet të sigurohet vetëm kur zbatohet Neni 153 (2) i Kodit (deklaratat e thjeshtuara bazuar te autorizimet); në këtë rast, është numri i autorizimit për regjimin e thjeshtuar. Megjithatë, ky element i të dhënave mund të përmbajë numrin e dokumentit të transportit në fjalë.
[10]	Ky informacion duhet të jepet kur numri i dokumentit të transportit nuk është i disponueshëm.
[11]	Ky informacion është i nevojshëm, kur deklarata e vendosjes së mallrave nën një regjim doganor është përdorur për të mbyllur një regjim të magazinimit doganor.
[12]	Ky informacion është i detyrueshëm vetëm në rastet kur nuk është dhënë numri RIOE ose një numër identifikimi unik i vendit tjetër i njohur nga R.SH., i personit në fjalë. Kur është dhënë numri RIOE ose një numër identifikimi unik i vendit tjetër të njohur nga R.SH, atëherë nuk duhet të jepet emri dhe adresa.
[13]	Ky informacion është i detyrueshëm vetëm në rastet kur nuk është dhënë numri RIOE ose një numër identifikimi unik i vendit tjetër i njohur nga R.SH, i personit në fjalë. Kur është dhënë numri RIOE ose një numër identifikimi unik i vendi tjetër të njohur nga R.SH, atëherë emri dhe adresa nuk do të jepet nëse përdoret një deklaratë të bazuar në letër.
[14]	Ky informacion do të jepet kur është i disponueshëm.
[15]	Ky informacion nuk do të jepet në lidhje me ngarkesën e mbetur në bord (FROB cargo remaining on board) ose me ngarkesën e transportuar për të cilën destinacioni ndodhet jashtë territorit doganor të R.SH.

Nr. i shënimit	Përshkrimi i shënimit
[16]	Autoriteti kompetent mund të heqë dorë nga këto të dhëna, kur vlera doganore e mallrave në fjalë nuk mund të përcaktohet sipas dispozitave të nenit 66 të Kodit. Në raste të tilla deklaruesi duhet të sigurojë ose duhet t'i dorëzojë autoriteteve doganore informacione të tjera që mund të kërkohen për qëllime të përcaktimit të vlerës doganore.
[17]	Ky informacion nuk duhet të sigurohet kur administratat doganore i llogarisin detyrimet në emër të operatorëve ekonomikë mbi bazë të dhënave të tjera në deklaratë. Në raste të tjera është fakultative për autoritetin kompetent.
[18]	Ky informacion nuk është i nevojshëm për mallra të përshtatshme për përjashtim nga detyrimet e importit, vetëm nëse autoriteti doganor e konsideron të nevojshëm për zbatimin e dispozitave që rregullojnë çlirimin për qarkullim të lirë të mallrave në fjalë.
[19]	Ky informacion nuk duhet të sigurohet kur administrata doganore i llogarit detyrimet në emër të operatorëve ekonomikë mbi bazë të të dhënave të tjera në deklaratë në deklaratë.
[20]	Përveç rasteve kur kjo është e domosdoshme për përcaktimin e saktë të vlerës doganore, autoriteti kompetent i pranimit të deklaratës do të heqë dorë nga detyrimi për të siguruar këtë informacion, - Kur vlera doganore e mallrave të importuara në një ngarkesë, nuk i kalon ekivalentin ne LEK të 20 000 EUR me kusht që ato të mos përbëjnë ndarje ose dërgesa të shumëfishta nga i njëjti dërgues për të njëjtin pranues, ose - Kur importimi është i natyrës jo-tregtare apo në rast të trafikut të vazhdueshëm në mallrat e furnizuara nga i njëjti shitës ndaj të njëjtit blerës sipas kushteve të njëjta tregtare.
[21]	Ky informacion do të sigurohet vetëm nëse detyrimi doganor llogaritet në përputhje me nenin 81 (3) të Kodit.
[22]	Autoriteti kompetent mund ta kërkojë këtë informacion vetëm në rastet kur norma e këmbimit është fiksuar paraprakisht nga një kontratë mes palëve në fjalë.
[23]	Për përfundim vetëm në rastet kur parashikohet nga legjislacioni i R.SH.
[24]	Ky element i të dhënave nuk është i nevojshëm të sigurohet kur MRN është dhënë në D.A. 2/1 Deklarata e thjeshtësuar / Dokumentet e mëparshme.
[25]	Ky informacion do të kërkohet vetëm kur deklarata e thjeshtuar nuk është paraqitur së bashku me një deklaratë përmbledhëse të daljes.
[26]	Ky element i të dhënave është i detyrueshëm për produktet bujqësore të eksportit me rimbursim.
[27]	Ky element i të dhënave është i detyrueshëm për produktet bujqësore që i nënshtrohen rimbursimit
[28]	Ky informacion është i nevojshëm, kur (A) nuk zbatohet asnjë trajtim preferencial; ose (B) vendi i origjinës jo-preferenciale është i ndryshëm nga vendi i origjinës preferenciale.
[29]	Ky informacion është i nevojshëm, kur një trajtim preferencial zbatohet duke përdorur kodin e duhur në D.E. 4/17 Preferenca.
[30]	Ky informacion do të përdoret vetëm në rast të zhdoganimit të centralizuar.

Nr. i shënimit	Përshkrimi i shënimit
[31]	Ky informacion do të përdoret vetëm në rastet kur deklarata për magazinim të përkohshëm ose deklarata doganore për t'i vendosur mallrat nën një regjim të posaçëm përveç transitit, depozitohet në një zyrë doganore të ndryshme nga zyra doganore mbikëqyrëse siç tregohet në autorizimin përkatës.
[32]	Ky informacion do të kërkohet vetëm në rastin e transaksioneve tregtare që përfshijnë të paktën dy zyra doganore.
[33]	Ky informacion do të sigurohet vetëm nëse vendosja e mallrave nën magazinimin e përkohshëm lidhet vetëm me pjesë të deklaratës për magazinim të përkohshëm të depozituar më parë në lidhje me mallrat në fjalë.
[34]	Ky element i të dhënave është një alternativë për kodin e Mallrave, në rastet kur ky i fundit nuk është dhënë.
[35]	Ky element i të dhënave mund të sigurohet për të identifikuar mallrat e mbuluara nga një njoftim për ri- eksportimin e mallrave nën magazinim të përkohshëm, kur nuk është eksportuar një pjesë e mallrave të mbuluara nga deklarata për magazinimin e përkohshëm në fjalë.
[36]	Ky element i të dhënave është një alternativë për përshkrimin e mallrave, kur ky i fundit nuk është dhënë.
[37]	Kjo nënndarje duhet të plotësohet në rastet kur: - Deklarata e transitit është bërë nga i njëjti person në të njëjtën kohë, ose pas deklaratës doganore e cila përfshin një kod të mallrave, ose - kur parashikohet nga legjislacioni i R.Sh.
[38]	Ky informacion është dhënë vetëm në lidhje me deklaratat e bazuara në letër.
[39]	Autoriteti kompetent mund të heqë dorë nga kjo kërkesë për llojet e transportit përveç atij në rrugë hekurudhore.
[40]	Ky informacion nuk duhet të jepet kur formalitetet e eksportit kryhen në momentin e daljes nga territori doganor i R.SH.
[41]	Ky element i të dhënave nuk duhet të jepet kur formalitetet e importit janë kryer në pikën e hyrjes në territorin doganor të R.SH.
[42]	Ky element i të dhënave është i detyrueshëm për produktet bujqësore me rimbursim të eksportit, nëse ato janë kryer përmes postës ose instalimeve fikse të transportit. [Në rastet e transportit me postë ose instalimeve fikse, ky informacion nuk do të jetë i nevojshëm.]
[43]	Jo për përdorim në rastet e dërgesave postare ose transportin nga instalimet fikse të transportit.
[44]	Kur mallrat janë transportuar nga njësitë e transportit multimodal, të tilla si kontenierë, kuti të lëvizshme dhe gjysmë-rimorkiot, atëherë autoritetet doganore mund ta autorizojnë mbajtësin e regjimit të transitit që të mos e japë këtë informacion, kur modeli logjistik në pikën e nisjes nuk lejon të përcaktojë identitetin dhe shtetësinë e mjeteve të transportit të dhënë në kohën kur mallrat janë çliruar për transit, me kusht që njësië e transportit multimodal të mbajnë numra unikë dhe të tilla numra shënohen në DE 7/10 Numri i identifikimit të kontenierit.
[45]	Në rastet e mëposhtme, autoriteti kompetent duhet të heqë dorë nga detyrimi për të dhënë këtë informacion në një deklaratë transiti të depozituar në zyrën e nisjes në lidhje me mjetet e transportit në të cilat mallrat janë ngarkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë: - Kur modeli logjistik nuk e lejon që të jepet ky element i të dhënave dhe kur mbajtësi i regjimit të transitit ka statusin OEAD, dhe - kur informacionet përkatëse mund të gjurmohen në rastet kur nevojitet nga autoritetet doganore përmes të dhënave të mbajtësit të regjimit të transitit.

Nr. i shënimit	Përshkrimi i shënimit
[46]	Jo për përdorim në rastet e dërgesave postare ose transportit nga instalimet fikse të transportit apo në rrugë hekurudhore.
[47]	Ky element i të dhënave është i detyrueshëm për produktet bujqësore me rimbursim të eksportit, nëse ato janë transportuar me anë të postës, instalimeve fikse të transportit, ose në rrugë hekurudhore. [Në rast të transportit me postë, instalimeve fikse ose në rrugë hekurudhore, ky informacion nuk do të jetë i nevojshëm.]
[48]	Autoriteti kompetent nuk do ta kërkojë këtë informacion, në rastet kur lidhet me mënyrën e transportit në rrugë ajrore.
[49]	Ky informacion duhet të jepet vetëm në rast të vendosjes së mallrave nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), ose në rastin e importimit fillestar të produkteve të përpunuara ose importimit fillestar të mallrave zëvendësuese.
[50]	Autoriteti kompetent i pranimit të deklaratës mund të heqë dorë nga detyrimi për të siguruar këtë informacion kur është në gjendje ta vlerësojë atë saktë dhe ka zbatuar sistemet e llogaritjes për të siguruar një rezultat në përputhje me kërkesat statistikore.

KREU II

Shënime në lidhje me kërkesat për të dhënat

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë Kre zbatohen për elementet e të dhënave të përmendura në tabelën me kërkesat e të dhënave në Kreun I, Kapitulli 3, Seksioni 1 i këtij Aneksi.

Kërkesat për të dhënat

Grupi 1 – Informacioni i mesazhit (duke përfshirë kodet e regjimit)

1/1. Lloji i deklaratës

Të gjitha kolonat përkatëse të tabelës të përdorura për kërkesat e të dhënave:

Shkruani kodin përkatës

1/2. Lloji i Deklaratës shtesë

Të gjitha kolonat përkatëse të tabelës të përdorura për kërkesat e të dhënave:

Shkruani kodin përkatës

1/3. Deklarata e transitit / Prova e llojit të statusit doganor

Të gjitha kolonat përkatëse të tabelës të përdorura për kërkesat e të dhënave:

Shkruani kodin përkatës.

1/4.
Formularët

Të gjitha kolonat përkatëse të tabelës të përdorura për kërkesat e të dhënave:

Kur përdoren deklarata të bazuara në letër, shkruani numrin e nëngrupit në raport me numrin e përgjithshëm të nëngrupeve të formularëve dhe formularëve të vazhdimit të përdorur. Për shembull, në qoftë se ka një formular IM dhe dy formularë IM / c, futni "1/3" në formularin IM, "2/3" në formularin e parë IM / c dhe "3/3" në formularin e dytë IM/c.

Kur deklarata e bazuar në letër përbëhet nga dy grupe me katër kopje në vend të një grupi prej tetë kopjesh, dy grupet do të trajtohen si një me qëllim krijimin e numrit të formularëve.

1/5. Listat e ngarkesave

Të gjitha kolonat përkatëse të tabelës të përdorura për kërkesat e të dhënave:

Kur përdoren deklarata të bazuara në letër, shënoni në shifra numrin e çdo liste ngarkesash të bashkëngjitur, ose të listave tregtare përshkruese kur këto janë të autorizuara nga autoriteti kompetent.

1/6. Numri i artikullit të mallrave

Kolonat A1-A3, B1-B3, C1, D1, D2, E1, E2 F1a deri në F1d, F2A deri F2c, F3a, F4a, F4b, F4d, F5, G3 deri G5, H1 deri H6 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri i artikullit në raport me numrin e përgjithshëm të artikujve që përmbahen në deklaratë, në deklaratën përmbledhëse, njoftimin apo provën e statusit doganor të mallrave shqiptare, kur ka më shumë se një artikull të mallrave.

Kolonat C2 dhe I2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri i artikullit i caktuar për mallrat sipas hyrjes në regjistrat e deklaruesit.

Kolona F4c e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri i artikullit i caktuar për mallrat brenda CN 23 në fjalë.

1/7. Treguesi i veçantë i rrethanave:

Kolona A2 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse, tregoni rrethanat e posaçme, përfitimi i së cilave pretendohet nga deklaruesi.

Kolonat F1a deri në F1d, F2A deri në F2d, F3a, F3b, F4a deri në F4d dhe F5 të tabelës me kërkesat e të dhënave:

Duke përdorur kodet përkatëse, tregoni grupin e të dhënave të deklaratës përkatëse përmbledhëse të hyrjes ose kombinimin e grupeve të të dhënave të paraqitura nga deklaruesi.

1/8. Nënshkrimi / Vërtetimi

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Nënshkrimi ose vertetimi i deklaratës përkatëse, njoftimi ose prova e statusit doganor të mallrave shqiptare.

Në rastet e deklaratave të bazuara në letër, origjinali i nënshkrimit me dorë të personit në fjalë duhet të jepet në kopjen e deklaratës e cila do të mbetet në zyrën e eksportit / dërgimit / importit, e ndjekur nga emri i plotë i personit. Nëse ky person nuk është person fizik, nënshkruesi duhet të shtojë kompetencën e tij pas nënshkrimit të tij dhe emrit të plotë.

1/9. Numri i përgjithshëm i artikujve:

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Numri i përgjithshëm i artikujve të mallrave të deklaruara në deklaratën, ose provën e statusit doganor të mallrave shqiptare në fjalë. Artikulli i mallrave është përcaktuar si mallra brenda një deklarate apo prove të statusit doganor të mallrave shqiptare që kanë të përbashkët të gjitha të dhënat me atributin 'X' në tabelën me kërkesat për të dhënat në Kreun I, Kapitulli 3, Seksioni 1 i këtij Aneksi.

1/10. Regjimi

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, shënoni regjimin në të cilin janë deklaruar mallrat.

1/11. Regjimi shtesë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani kodet përkatëse të R.Sh. ose kodin shtesë të regjimit të parashikuar nga autoriteti doganor i përfshirë.

Grupi 2 - Referencat e mesazheve, dokumenteve, çertifikatave, autorizimeve

2/1. Deklarata e thjeshtuar / Dokumentet e mëparshme

Kolonat A1 dhe A2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky informacion do të jepet vetëm nëse janë ri-eksportuar mallrat e vendosura nën magazinimin e përkohshëm ose në zonë të lirë.

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, shënoni MRN-në e deklaratës për magazinimin e përkohshëm në të cilin janë vendosur mallrat.

Komponenti i katërt i elementit të të dhënave (identifikuesi i artikullit të mallrave) i referohet numrit të artikujve të mallrave në deklaratën për magazinimin e përkohshëm për të cilat është depozituar njoftimi i ri -eksportit. Kjo duhet të sigurohet në të gjitha rastet, kur nuk është ri-eksportuar një pjesë e mallrave të mbuluara nga deklarata për magazinimin e përkohshëm në fjalë.

Kolona A3 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, shënoni MRN-në e deklaratës për magazinimin e përkohshëm në të cilin janë vendosur mallrat.

Komponenti i katërt i elementit të të dhënave (identifikuesi i artikullit të mallrave) i referohet numrit të artikujve të mallrave në deklaratën për magazinimin e përkohshëm për të cilat është depozituar njoftimi i ri -eksportit. Kjo duhet të sigurohet në të gjitha rastet, kur nuk është ri-eksportuar një pjesë e mallrave të mbuluara nga deklarata për magazinimin e përkohshëm në fjalë.

Kolonat B1 deri në B3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, shënoni në të dhënat e referencës së dokumenteve të mëparshme që paraprijnë eksportin në një vend tjetër / dërgimin drejt një zyre tjetër doganore.

Kur deklarata ka të bëjë me mallra të ri-eksportuara, shënoni në të dhënat referuese të deklaratës për vendosjen e mallrave nën regjimin e mëparshëm doganor në të cilin ishin vendosur mallrat. Identifikuesi i artikullit të mallrave do të jepet vetëm në rastet kur është e nevojshme për identifikimin e qartë të artikullit të mallrave në fjalë.

Kolonat D1 deri në D3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Në rastin e deklaratës së transitit, jepni referenca për magazinimin e përkohshëm ose regjimin e mëparshëm doganor ose dokumentet përkatëse doganore.

Kur, në rastin e deklaratës të bazuar në letër të transitit, hyn më shumë se një reference, atëherë autoriteti kompetent mund të sigurojë që kodi përkatës të shënohet në këtë kuti dhe lista e referencave në fjalë të shoqërojë deklaratën e transitit.

Kolona E1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:
Nëse është e aplikueshme, shënoni referencën e deklaratës doganore me të cilën mallrat janë çliruar në qarkullim të lirë. Kur MRN-ja e deklaratës doganore për çlirim në qarkullim të lirë është dhënë dhe prova e statusit doganor të mallrave shqiptare nuk ka të bëjë me të gjithë artikujt e mallrave të deklaratës doganore, atëherë shkruani numrat përkatës të artikujve në deklaratën doganore.

Kolona E2 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani MRN-në e deklaratës(ave) përmbledhëse të hyrjes të paraqitur në lidhje me mallrat para mbërritjes së tyre në territorin doganor të R.SH.

Kur MRN-ja e deklaratës përmbledhëse të hyrjes është dhënë dhe lista e mallrave doganore nuk ka të bëjë me të gjitha artikujt e mallrave të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, atëherë shkruani numrat përkatës të artikujve në deklaratën përmbledhëse të hyrjes, në rastet kur janë të disponueshme ndaj personit që paraqet manifestin elektronik.

Kolonat G1 deri në G2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani MRN-në e deklaratës(ave) përmbledhëse të hyrjes në lidhje me dërgesën në fjalë sipas kushteve të parashikuara në Kreun I, Kapitulli 3 të këtij Aneksi.

Kolona G3 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Pa rënë ndesh me nenin 130 (4) të Kodit, shënoni MRN-në e deklaratës(ave) përmbledhëse të hyrjes ose, në rastet e referuara nenit 122 të Kodit, të deklaratës për magazinim të përkohshëm ose të deklaratës(ave) doganore që është paraqitur në lidhje me mallrat.

Kur është dhënë MRN-ja e deklaratës përmbledhëse të hyrjes dhe paraqitja e mallrave nuk ka të bëjë me të gjitha artikujt e mallrave të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, ose, në rastet e referuara në Nenin 122 të Kodit, të deklaratës së magazinimit të përkohshëm ose të një deklarate doganore, atëherë personi që ka paraqitur mallrat duhet të sigurojë numrin(at) përkatës të artikullit qe i atribuohet mallrave në deklaratën origjinale përmbledhëse të hyrjes, në deklaratën e magazinimit të përkohshëm ose deklaratën doganore.

Kolona G4 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Pa rënë ndesh me nenin 135 (4) të Kodit, shënoni MRN-në e deklaratës(ave) përmbledhëse të hyrjes lidhur me dërgesën në fjalë.

Kur një deklaratë e magazinimit të përkohshëm paraqitet pas përfundimit të regjimit të transitit në përputhje me nenin 135 (11) të Kodit, atëherë duhet të sigurohet MRN-ja e deklaratës së transitit.

Kur është dhënë MRN-ja e deklaratës përmbledhëse të hyrjes, deklaratës së transitit, ose, në rastet e përmendura në nenin 122 të Kodit, e deklaratës doganore, dhe deklarata për magazinimin e përkohshëm nuk ka të bëjë me të gjitha artikujt e mallrave të Deklaratës përmbledhëse të hyrjes, Deklaratës së transitit apo deklaratës doganore, atëherë deklaruesi duhet të sigurojë numrin(at) përkatës të artikullit që i atribuohet mallrave në deklaratën origjinale përmbledhëse të hyrjes, deklaratën e transitit ose deklaratën doganore.

Kolona G5 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani MRN-në e deklaratës(ave) së magazinimit të përkohshëm të paraqitur në lidhje me mallrat në vendin ku ka filluar lëvizja.

Kur MRN-ja e deklaratës së magazinimit të përkohshëm nuk ka të bëjë me të gjithë artikujt e mallrave të deklaratës së magazinimit të përkohshëm në fjalë, atëherë personi që njofton ardhjen e mallrave pas lëvizjes nën magazinimin e përkohshëm duhet të sigurojë numrin(at) përkatës të artikullit që i atribuohet mallrave në deklaratën origjinale të magazinimit të përkohshëm.

Kolonat H1 deri në H4, I1 dhe I2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, shënoni MRN-në e deklaratës së magazinimit të përkohshëm, ose referenca të tjera për çdo dokument të mëparshëm.

Identifikuesi i artikullit të mallrave do të jepet vetëm në rastet kur është e nevojshme për identifikimin e qartë të artikullit të mallrave në fjalë.

2/2. Informacioni shtesë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani kodin përkatës të R.SH, dhe, nëse është e aplikueshme, kodin(et) e parashikuar nga autoriteti doganor i përfshirë.

Kur ligji i R.SH nuk arrin të përcaktojë fushën në të cilën duhet të shënohet informacioni, atëherë ky informacion duhet të shënohet në D.E. 2/2 Informacioni shtesë.

Kolonat A1 deri në A3, F1a deri në F1c të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur mallrat janë transportuar në bazë të një fature ngarkese që është "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed", si dhe kur pritësi është i panjohur, atëherë të dhënat e tij do të zëvendësohen me kodin përkatës.

2/3. Dokumentet e prodhuara, certifikatat dhe autorizimet, referencat shtesë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat e të dhënave:

(a) Identifikimi ose numri i referencës së R.SH ose dokumentet ndërkombëtare, çertifikatat dhe autorizimet të prodhuara në mbështetje të deklaratës si dhe referenca të tjera.

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, shënoni të dhënat e kërkuara nga rregulla të veçanta të zbatueshme së bashku me të dhënat e referencave të dokumenteve të paraqitura/ prodhuara në mbështetje të deklaratës si dhe referenca të tjera.

Në rastet kur deklaruesi ose importuesi për deklaratat e importit apo eksportuesi për deklaratat e eksportit, është mbajtës i një IDT të vlefshme dhe / ose vendimi IDO që mbulon mallrat në fjalë nga deklarata, ateherë deklaruesi duhet të tregojë numrin e referencës së vendimit IDT dhe / ose IDO.

(b) Identifikimi ose numri i referencës së dokumenteve kombëtare, çertifikatave dhe autorizimeve të prodhuara në mbështetje të deklaratës si dhe referenca të tjera.

Kolonat A1, A3, F5 dhe G4 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Referenca e dokumentit të transportit që mbulon transportin e mallrave në ose jashtë territorit doganor të R.SH.

Ai përfshin kodin përkatës për llojin e dokumentit të transportit, të ndjekur nga numri i identifikimit të dokumentit në fjalë.

Kur deklarata është depozituar nga një person tjetër në vend të transportuesit, atëherë duhet të sigurohet edhe numri i dokumentit të transportit të transportuesit.

Kolonat B1 deri në B3, C1, H1 deri në H4 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri i referencës së autorizimit për zhdoganim të centralizuar. Ky informacion duhet të sigurohet vetëm me përjashtim të rastit kur nuk mund të rrjedhë pa paqartësi nga elemente të tjera të të dhënave, të tilla si numri RIOE i mbajtësit të autorizimit.

Kolonat C1 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri i referencës së autorizimit për deklaratat e thjeshtuara. Ky informacion duhet të sigurohet vetëm me përjashtim të rastit kur nuk mund të rrjedhë pa paqartësi nga elemente të tjera të të dhënave, të tilla si numri RIOE i mbajtësit të autorizimit.

Kolona D3 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky element i të dhënave përfshin llojin dhe referencën e dokumentit të transportit që është përdorur si deklaratë transiti.

Përveç kësaj, ajo gjithashtu përmban referenca për numrin përkatës të autorizimit të mbajtësit të regjimit të transitit. Ky informacion duhet të sigurohet, vetëm me përjashtim të rastit kur nuk mund të rrjedhë pa paqartësi nga elemente të tjera të të dhënave, të tilla si numri RIOE i mbajtësit të autorizimit.

Kolona E1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Nëse është e aplikueshme, shënoni numrin e autorizimit të lëshuesit të autorizuar. Ky informacion duhet të sigurohet me përjashtim të rastit kur nuk mund të rrjedhë pa paqartësi nga elemente të tjera të të dhënave, të tilla si numri RIOE i mbajtësit të autorizimit.

Kolona E2 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, shkruani referencën e dokumentit të transportit që mbulon transportin e ardhshëm të mallrave në territorin doganor të R.SH. pas dorëzimit të listës së mallrave doganore në Doganë.

Në rastin e trafikut në rrugë detare në bazë të një marrëveshje për përdorim ose kontraktim të një anije, atëherë numri i dokumentit të transportit që duhet të sigurohet, i referohet dokumentit të transportit të lëshuar nga personi i cili ka lidhur kontratën, dhe ka lëshuar faturën e ngarkimit ose faturën e transportit, për transportin aktual të mallrave në territorin doganor të R.SH.

Numri i Dokumentit të transportit është një alternativë për numrin unik të referencës së dërgesës/NUR (UCR unic consignment reference number), kur ky i fundit nuk është i disponueshëm.

Nëse është e aplikueshme, shënoni numrin e autorizimit të lëshuesit të autorizuar. Ky informacion duhet të sigurohet me përjashtim të rastit kur nuk mund të rrjedhë pa paqartësi nga elemente të tjerë të të dhënave, të tilla si numri RIOE i mbajtësit të autorizimit.

Kolonat F1a, F2A, F2B, F3a dhe F3b të tabelës me kërkesat për të dhënat

Referenca e dokumentit(eve) të transportit që mbulon transportin e mallrave në territorin doganor të R.SH. Në qoftë se transporti i mallrave është i mbuluar nga dy ose më shumë dokumente të transportit dmth niveli master, niveli House, të kontratës së transportit, atëherë duhet të përmenden si kontrata e transportit përkatësisht në nivel master ashtu edhe në nivel House. Numri i referencës së faturës së ngarkimit në nivel master, fatura përkatëse e ngarkimit, fatura e ngarkesës ajrore në nivel master si dhe ajo në nivel House do të mbeten unike për një minimum prej tre vjetësh pas lëshimit nga ana e operatorëve ekonomikë në fjalë. Ai përfshin kodin përkatës për llojin e dokumentit të transportit, të ndjekur nga numri i identifikimit të dokumentit në fjalë.

Kolona F1b e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Referenca e faturës së ngarkimit në nivel master që mbulon transportin e mallrave në territorin doganor të R.SH. Ai përfshin kodin përkatës për llojin e dokumentit të transportit, të ndjekur nga numri i identifikimit të dokumentit në fjalë. Numri i referencës së faturës së ngarkimit në nivel master të lëshuar nga transportuesi do të mbetet unik për një minimum prej tre vjetësh pas lëshimit.

Kolonat F1c dhe F2c të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur në bazë të nenit 243 (1) nënparagrafi i parë dhe 244 (2), një person tjetër përveç transportuesit, paraqet të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes, atëherë duhet të sigurohet edhe numri i faturës përkatëse të ngarkimit në nivel master ose fatura e transportit ajror në nivel master, përveç faturës së ngarkesës në nivel House apo faturës së transportit ajror në nivel House.

Kolona F1d e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur në bazë të nenit 243 (1) nënparagrafi i dytë, marrësi paraqet të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes, atëherë numri përkatës i:

(a) faturës përkatëse të ngarkesës të lëshuar nga transportuesi duhet të sigurohet; ose kur është e zbatueshme

(b) faturës së ngarkesës në nivel master të lëshuar nga transportuesi si dhe faturës më të ulët të ngarkesës të lëshuar nga një person tjetër në përputhje me nenin 243 (1) nënparagrafi i parë, në rastin kur fatura shtesë e ngarkesës është lëshuar për të njëjtat mallra që janë objekt i faturës në nivel master nga transportuesi.

Kolona F2d e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri i referencës së faturës së transportit ajror në nivel House dhe i asaj në nivel master duhet të sigurohet, nëse është e mundur në kohën e dorëzimit. Nga ana tjetër, në rast se referenca në nivel master nuk është e disponueshme në kohën e dorëzimit, personi në fjalë mund të sigurojë numrin e referencës së transportit ajror në nivel master veç e veç, sidoqoftë përpara se mallrat të ngarkohen në avion. Në këtë rast, informacioni përmban edhe referencat për të gjitha faturat e transportit ajror në nivel House që i përkasin kontratës së transportit në nivel master. Numri i referencës së faturës së transportit ajror në nivel master dhe i asaj në nivel House do të mbeten unik e për një minimum prej tre vjetësh pas lëshimit nga ana e operatorëve ekonomik në fjalë.

Kolonat F4a dhe F4b të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Referenca e numrit të transportit ajror postar duhet të sigurohet. Ajo përfshin kodin përkatës për llojin e dokumentit të transportit, të ndjekur nga numri i identifikimit të dokumentit në fjalë.

Kolona F4c e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri ITMATT që korrespondon me CN 23 në fjalë.

Kolona F4d e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Numri(at) ITMATT që korrespondon me CN 23 që mbulon mallrat e përfshira në kontenierin në të cilin po transportohet.

Kolona F5 e tabelës me kërkesat e të dhënave:

Në rast të transportit rrugor, ky informacion do të jepet në masën e disponueshme dhe mund të përfshijë të dy referencat si për Carnet TIR ashtu edhe për CMR.

Kolona H1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur kontrata e shitjes së mallrave në fjalë ka një numër identifikimi, ky numër duhet të shënohet. Nëse është e zbatueshme, shënoni edhe datën e kontratës së shitjes.

Përveç rastit kur kjo është e domosdoshme për përcaktimin e saktë të vlerës doganore, autoriteti kompetent i pranimit të deklaratës do të heq dorë nga detyrimi për të dhënë informacion për datën dhe numrin e kontratës së shitjes.

- Kur vlera doganore e mallrave të importuara në një ngarkesë nuk i kalon ekuivalentin në LEK të 20 000 EUR me kusht që ato të mos përbëjnë ndarje apo dërgesa të shumëfishta nga i njëjti dërgues për të njëjtin marrës, ose

- Kur importimi është i një natyre jo tregtare, ose

- Në rast të trafikut të vazhdueshëm në mallrat e furnizuara nga i njëjti shitës ndaj të njëjtit blerës sipas kushteve të njëjta tregtare.

Autoriteti kompetent mund të heqë detyrimin për të dhënë informacion mbi datën dhe numrin e kontratës së shitjes, kur vlera doganore e mallrave në fjalë nuk mund të përcaktohet sipas dispozitave të nenit 66 të Kodit. Në raste të tilla deklaruesi duhet të sigurojë ose do t'u dorëzojë autoriteteve doganore informacione të tjera të tilla që mund të kërkohen për qëllime të përcaktimit të vlerës doganore.

Kolona I1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur kërkohet përfitimi nga kuota e parë tarifore për mallrat e deklaruara në deklaratën e thjeshtuar, atëherë duhet të deklarohen të gjitha dokumentet e kërkuara në deklaratën e thjeshtuar si dhe të jenë në dispozicion të deklaruesit dhe autoriteteve doganore me qëllim për t'i lejuar deklaruesit të përfitojë nga kuota tarifore, sipas datës së pranimit të deklaratës së thjeshtuar.

2/4. Numri i referencës UCR / NUR (UCR unic consignment reference number)

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Kjo hyrje ka të bëjë me numrin unik tregtar të referencës të caktuar nga personi në fjalë për dërgesën në fjalë. Kjo mund të marrë formën e kodeve OBD (ISO 15459) ose të ngjashme me to. Kjo siguron qasje në të dhënat themelore tregtare me interes për doganat.

2/5. LRN/NLR
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Numri lokal i referencës (LRN Local reference number) duhet të përdoret. Ai është i përcaktuar në shkallë kombëtare dhe i alokuar nga deklaruesi në marrëveshje me autoritetet kompetente për të identifikuar çdo deklaratë të vetme.

2/6. Pagesa e shtyrë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shënoni, kur është e zbatueshme, të dhënat e referencës së autorizimit në fjalë; pagesa e shtyrë këtu mund t'i referohet si pagesës së shtyrë të detyrimit të importit dhe eksportit ashtu edhe kreditimit të taksave.

2/7. Identifikimi i magazinës

Kolonat B1 deri në B3, G4 dhe H1 deri në H4 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të R.SH, shkruani llojin e objektit të magazinimit, të ndjekur nga numri i autorizimit të magazinës ose objektit të magazinimit të përkohshëm në fjalë.

Kolona G5 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të R.SH, shkruani llojin e objektit të magazinimit të përkohshëm të destinacionit, të ndjekur nga numri përkatës i autorizimit.

Grupi 3 – Palët

3/1. Eksportuesi

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Eksportuesi është personi i përcaktuar në nenin 1 (27).

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e personit në fjalë.

Kolona D1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Në kuadër të regjimit së transitit, eksportuesi është personi i cili vepron si dërgues.

Në rastin e dërgesave grupazh, kur përdoret deklarata e bazuar në letër e transitit apo prova e bazuar në letër e statusit doganor të mallrave shqiptare, autoritetet kompetente mund të sigurojnë se do të përdoret kodi përkatës, dhe lista e eksportuesve do t'i bashkëngjitet deklaratës.

Kolonat H1, H3, H4 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e shitësit të fundit të mallrave para importimit të tyre në R.SH.

3/2. Numri i identifikimit të eksportuesit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Eksportuesi është personi i përcaktuar në nenin 1 (27).

Futni numrin RIOE të personit në fjalë, siç përmendet në nenin 1 (26).

Kolonat B1, B2 deri në B3, C1, D1 dhe E1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur eksportuesi nuk ka një numër RIOE, atëherë administrata doganore mund t'i caktojë një numër *ad hoc* për deklaratën në fjalë.

Kolonat H1 deri në H4 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shënoni i numrin RIOE të shitësit të fundit të mallrave para importimit të tyre në R.SH.
Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjeëtr që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit të tretë i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin .

Kolonat H1 dhe H3 deri në H6 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur kërkohet një numër identifikimi, futni numrin RIOE të personit në fjalë, siç përmendet në nenin 1 (26). Në qoftë se për eksportuesin nuk është caktuar një numër RIOE, shkruani numrin e kërkuar nga legjislacioni i Shtetit Shqiptar.

3/3. Dërguesi - Kontrata e transportit në nivel Master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në kontratën e transportit nga ana e palës që porosit transportin. Shkruani emrin e plotë dhe adresën e dërguesit, kur numri i tij RIOE nuk është i disponueshëm për deklaruesin. Një numër kontakti i palës në fjalë mund të sigurohet.

Kolona F3a e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në faturën e transportit ajror në nivel master.

Kolonat F4a dhe F4b të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky element nuk ka nevojë të sigurohet në rastet kur mund të konkludohet automatikisht nga D.E. 7/20 Numri i identifikimit të kontenierit.

3/4. Numri i dentifikimit të dërguesit - kontrata e transportit në nivel Master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në kontratën e transportit nga pala që porosit transportin.

Shkruani numrin e dërguesit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) sa herë që ky numër të jetë i disponueshëm për deklaruesin.
Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të një vendi tjetër, i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

3/5. Dërguesi - Kontrata e transportit në nivel House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në kontratën e transportit në nivel House nga ana e porositësit të transportit. Shkruani emrin e plotë dhe adresën e dërguesit, kur numri i tij RIOE nuk është i disponueshëm për deklaruesin.

Një numër kontakti i palës në fjalë mund të sigurohet.

Kolonat F1c, F2c, F2d, F3b dhe F4c të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në faturën më të ulët të ngarkesës në nivel House ose në faturën më të ulët të transportit ajror në nivel House. Ky person duhet të jetë i ndryshëm nga transportuesi, përcjellësi i mallrave, konsoliduesi, operatori postar, ose agjenti doganor.

Adresa e dërguesit duhet t'i referohet një adrese jashtë R.SH.

3/6. Numri i identifikimit të dërguesit - Kontrata e transportit në nivel House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:
Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në kontratën e transportit në nivel House nga ana e porositësit të transportit. Shkruani numrin e dërguesit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) sa herë që ky numër është i disponueshëm për deklaruesin.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

3/7. Dërguesi

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në kontratën e transportit nga ana e porositësit të transportit.

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e dërguesit, kur numri i tij RIOE nuk është i disponueshëm për deklaruesin. Ky element duhet të jepet kur është i ndryshëm nga deklaruesi.
Kur të dhënat e kërkuara për një deklaratë përmbledhëse të daljes janë të përfshira në një deklaratë doganore në përputhje me nenin 236 (3) të Kodit, ky informacion korrespondon me D.E. 3/1. Eksportuesi i kësaj deklarate
doganore.

3/8. Numri i Identifikimit të dërguesit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat e të dhënave:

Pala që dërgon mallrat siç përcaktohet në kontratën e transportit nga ana e porositësit të transportit.

Shkruani numrin e dërguesit RIOE të përmendur në nenin 1 (26), sa herë që ky numër të jetë i disponueshëm për deklaruesin.
Ky element duhet të jepet kur është i ndryshëm nga deklaruesi.

Kur të dhënat e kërkuara për një deklaratë përmbledhëse të daljes janë të përfshira në një deklaratë doganore në përputhje me nenin 236 (3) të Kodit, ky informacion korrespondon me D.E. 3/2. Numri i identifikimit të eksportuesit të deklaratës doganore.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër, i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin .

3/9. Pritësi i ngarkesës
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala ndaj së cilës dërgohen në fakt mallrat.
Shkruani emrin e plotë dhe adresën e personit(ave) në fjalë.

Kolonat A1 dhe A2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Në rastet kur është i përfshirë një nën-kontraktues, ky informacion duhet të sigurohet në rastet kur është i disponueshëm.
Kur mallrat janë transportuar në bazë të një fature të negociueshme të ngarkesës që është "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed" si dhe në rastet kur marrësi është i panjohur, të dhënat e tij do të zëvendësohen me kodin përkatës në D.E. 2/2. Informacioni shtesë.

Kolona B3 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur mallrat që i nënshtrohen rimbursimeve të eksportit kanë hyrë në një magazinë doganore, marrësi është personi përgjegjës për rimbursimet e eksportit ose personi përgjegjës për magazinën ku mallrat janë magazinuar.

Kolonat D1 dhe D2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Në rastin e dërgesave grupazh, kur përdoret deklarata e bazuar në letër e transitit , autoriteti kompetent mund të sigurojë që kodi përkatës të hyrë në këtë kuti, si dhe lista e marrësit t'i bashkangjitet deklaratës.

3/10. Numri i Identifikimit të Pritësit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala ndaj së cilës dërgohen në fakt mallrat.

Kolonat A1 dhe A2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Në rastet kur përfshihet një nën-kontraktues, ky informacion duhet të sigurohet kur është i disponueshëm.

Ku mallrat janë transportuar në bazë të një fature të negociueshme të ngarkesës që është "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed"si dhe kur marrësi është i panjohur, të dhënat e tij do të zëvendësohen me kodin përkatës në D.E. 2/2. Informacioni shtesë.

Ai merr formën e numrit RIOE të marrësit, sa herë që ky numër është i disponueshëm për deklaruesin.
Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të vendit tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH. nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

Kolonat B1, B2 deri në B3, D1 deri në D3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur kërkohet një numër identifikimi, shënoni numrin RIOE të përmendur në nenin 1 (26). Kur marrësi që nuk është një operator ekonomik, nuk është i regjistruar në RIOE, atëherë shënoni numrin e kërkuar nga legjislacioni shqiptar.

Kolonat B1 dhe B2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të vendit tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

Kolona B3 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur mallrat që i nënshtrohen rimbursimeve të eksportit kanë hyrë në një magazinë doganore, atëherë marrësi është personi përgjegjës për rimbursimet e eksportit ose personi përgjegjës për magazinën ku mallrat janë magazinuar.

3/11. Pritësi - Kontrata e transportit në nivel Master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala ndaj së cilës dërgohen në fakt mallrat.
Shkruani emrin e plotë dhe adresën e personit(ave) në fjalë. Një numër kontakti mund të sigurohet.

Kolonat F4a dhe F4b të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky element nuk ka nevojë të sigurohet në rastet kur mund të konkludohet automatikisht nga D.E. 7/20 Numri i identifikimit të kontenierit.

Kolona F5 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Në rastet kur të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë dhënë në të njëjtin mesazh si të dhënat nga deklarata e transitit, atëherë nuk nevojitet të sigurohet ky element i të dhënave dhe do të përdoret D.E. 3/26. Blerësi.

3/12. Numri i identifikimit të marrësit - Kontrata e transportit në nivel Master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Futni numrin RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të palës së cilës i janë dërguar mallrat në fakt.

Ky element duhet të jepet kur të jetë i ndryshëm nga deklaruesi. Kur mallrat janë transportuar në bazë të një fature të negociueshme të ngarkesës që është "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed",

(a) në rastet kur një faturë e ngarkesës në nivel master është lëshuar nga transportuesi, atëherë identiteti i percjellësit të mallrave, operatori i stacionit të mallrave apo ndonjë transportues tjetër mund të jetë shënuar si pritësi i dërgesës.

(b) në rastet e mbuluara nga një faturë e drejtpërdrejtë e ngarkesës e lëshuar nga transportuesi ose një faturë e ngarkesës në nivel House e lëshuar nga personi në pajtim me nenin 243 (1) nënparagrafi i parë, atëherë pala porositëse do të raportohet si pritësi.

Ajo merr formën e numrit RIOE të pritësit, sa herë që ky numër është i disponueshëm për deklaruesin. Kur pritësi nuk është i regjistruar në RIOE duke qënë se ai nuk është një operator ekonomik, ose ai nuk është themeluar në R.SH, atëhere shkruani numrin e kërkuar nga legjislacioni shqiptar.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

Kolona F5 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Në rastet kur të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë dhënë në të njëjtin mesazh si të dhënat nga deklarata e transitit, atëherë nuk është e nevojshme të sigurohet ky element i të dhënave dhe do të përdoret D.E. 3/27 Identifikimi i Blerësit.

3/13. Pritësi - Kontrata e transportit në nivel master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pala që merr mallrat siç përcaktohet në faturën më të ulët të ngarkesës në nivel House ose në faturën më të ulët të transportit ajror në nivel House.

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e personit(ave) në fjalë. Një numër kontakti mund të sigurohet.

Nëse ky person është i ndryshëm nga përcjellësi i mallrave, nga konsoliduesi, nga operatori postar ose agjenti doganor, atëherë personi që paraqet të dhënat shtesë të deklaratës përmbledhëse të hyrjes në pajtim me nenin 243 (1), nënparagrafi i parë dhe të dytë dhe 244 (1) dhe (2) duhet të tregohet në E.D 3/38 Personi që dorëzon numrin e identifikimit të të dhenave shtesë ENS.

Në rast të një fature të negociueshme të ngarkesës, dmth "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed"si dhe kur pritësi nuk është i njohur, atëherë do të ofrohet informacioni për pronarin e fundit të njohur të ngarkesës së mallrave apo për përfaqësuesit e pronarit.

3/14. Numri i identifikimit të pritësit - Kontrata e transportit në nivel House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Futni numrin RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të palës së cilës i janë dërguar mallrat në fakt.

Ky element duhet të jepet kur të jetë i ndryshëm nga deklaruesi. Kur mallrat janë transportuar në bazë të një fature të negociueshme të ngarkesës që është "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed", si dhe pritësi i dërgesës është i panjohur, atëherë do të ofrohet informacioni për pronarin e fundit të njohur të ngarkesës së mallrave apo për përfaqësuesit e pronarit.

Ajo merr formën e numrit RIOE të pritësit, sa herë që ky numër të jetë i disponueshëm për deklaruesin. Kur pritësi nuk është i regjistruar në RIOE duke qënë se ai nuk është një operator ekonomik, ose ai nuk është themeluar në R.SH, atëherë shkruani numrin e kërkuar nga legjislacioni shqiptar.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të vendit tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

3/15. Importuesi

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Emri dhe adresa e palës që bën deklaratën ose në emër të së cilës bëhet kjo deklaratë.

3/16. Numri i identifikimit të Importuesit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Numri i identifikimit të palës që bën deklaratën e importit, ose në emër të së cilës bëhet kjo deklaratë.

Shënoni numrin RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të personit në fjalë. Kur importuesi nuk ka një numër RIOE, administrata doganore mund t'i caktojë atij një numër ad hoc për deklaratën në fjalë.

Kur importuesi nuk është i regjistruar në RIOE, duke qënë se ai nuk është një operator ekonomik, ose ai nuk është themeluar në R.SH, atëherë shkruani numrin e kërkuar nga legjislacioni shqiptar.

3/17. Deklaruesi

Kolonat 1 deri në B3 dhe C1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e personit në fjalë.

Nëse deklaruesi dhe eksportuesi / dërguesi janë i njëjti person, shënoni kodet përkatëse të përcaktuara për D.E. 2/2 Informacioni shtesë.

Kolonat H1 deri në H6 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e personit në fjalë.

Nëse deklaruesi dhe marrësi janë i njëjti person, shkruani kodin përkatës të përcaktuar për D.E. 2/2 Informacioni shtesë.

3/18. Numri i Identifikimit të deklaruesit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shënoni numrin RIOE të përmendur në nenin 1 (26).

Kolonat B1 deri në B3, C1, G4, H1 deri në H4 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur deklaruesi nuk ka një numër RIOE, administrata doganore mund t'i caktojë atij një numër ad hoc për deklaratën në fjalë.

Kolonat F1c, F1d, F2c, F2d, F3b, F4c dhe F4d të tabelës me kërkesat e të dhënave:

Futni numrin RIOE të personit që paraqet të dhënat shtesë ENS sipas neneve 243 (1) nënparagrafi i parë dhe të dytë, dhe 244 (1) dhe (2).

3/19. Përfaqësuesi

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion do të jetë i nevojshëm, nëse është i ndryshëm nga D.E. 3/17 Deklaruesi ose kur është e përshtatshme D.E. 3/22 Mbajtësi i regjimit të transitit.

3/20. Identifikimi i Përfaqësuesit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion do të kërkohet nëse është i ndryshëm nga D.E. 3/18 Numri i identifikimit të deklaruesit ose kur është e përshtatshme D.E. 3/23 Numri i identifikimit të mbajtësit të regjimit të transitit, D.E. 3/30 Numri i identifikimit të personit që paraqet mallrat në doganë, D.E.3 42 Numri i identifikimit të personit që depoziton listën e mallrave,
D.E. 3/43 Numri i identifikimit të personit që kërkon një provë për statusin doganor të mallrave shqiptare
D.E. 3/44 Numri i identifikimit të personit që njofton mbërritjen e mallrave pas lëvizjes nën magazinimin e përkohshëm. Shënoni numrin RIOE të personit në fjalë, siç përmendet në nenin 1 (26).

3/21. Kodi i statusit të Përfaqësuesit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani kodin përkatës që përfaqëson statusin e përfaqësuesit.

3/22. Mbajtësi i regjimit të transitit

Kolonat H1 deri në H6 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani emrin e plotë (person ose kompani) dhe adresën e mbajtësit të regjimit të transitit. Kur është e përshtatshme, shkruani emrin e plotë (person ose kompani) të përfaqësuesit të autorizuar për depozitimin e deklaratës së transitit në emër të mbajtësit të regjimit.

Kur përdoret një deklaratë e printuar e transitit, atëherë origjinali i nënshkruar me dorë nga personi në fjalë duhet të jepet mbi kopjen e deklaratës e cila duhet të qëndrojë në zyrën doganore të nisjes.

3/23. Numri i identifikimi të mbajtësit të regjimit të transitit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Futni numrin RIOE të mbajtësit të regjimit të transitit, të përmendur në nenin 1 (26).

Kur mbajtësi i regjimit të transitit nuk ka një numër RIOE, atëherë administrata doganore mund t'i caktojë atij një numër ad hoc për deklaratën në fjalë.

Megjithatë, numri i tij i identifikimit tregtar duhet të përdoret kur:

- Mbajtësi i regjimit të transitit, është themeluar në një palë kontraktuese të konventës së përbashkët të transitit, përveç R.SH,

- Mbajtësi i regjimit të transitit është themeluar në Andora apo në San Marino.

3/24. Shitësi

Kolonat F1a, F1d dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shitësi është subjekti i fundit i njohur i cili ka shitur mallrat, ose ka ranë dakord për t'i shitur mallrat blerësit. Nëse mallrat janë për importim, ndryshe nga ndjekja e procedurës së blerjes, atëherë duhet të jepen të dhënat e pronarit të mallrave. Kur numri RIOE i shitësit të mallrave nuk është i disponueshëm, shkruani emrin e plotë dhe adresën e shitësit. Një numër kontakti mund të sigurohet.

Kolona H1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur shitësi është i ndryshëm nga personi i dhënë në D.E. 3/1. Eksportuesi, atëherë shkruani emrin e plotë dhe adresën e shitësit të mallrave, në rast se numri i tij RIOE nuk është në dispozicion të deklaruesit. Në rast se vlera doganore llogaritet në përputhje me nenin 70 të Kodit, ky informacion duhet të jepet, nëse është e mundur.

3/25. Numri i identifikimit të shitësit

Kolonat F1a, F1d dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shitësi është subjekti i fundit i njohur i cili ka shitur mallrat, ose ka ranë dakord për t'i shitur mallrat blerësit. Nëse mallrat janë për importim, ndryshe nga ndjekja e procedurës së blerjes, atëherë duhet të jepen të dhënat e pronarit të mallrave. Futni numrin RIOE të shitësit të mallrave të përmendur në nenin 1 (26), sa herë që ky numër të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër , i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

Kolona H1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur shitësi është i ndryshëm nga personi i dhënë në D.E. 3/1. Eksportuesi, shkruani numrin RIOE të shitësit të mallrave, kur ky numër të jetë i disponueshëm. Në rast se vlera doganore llogaritet në përputhje me nenin 70 të Kodit, ky informacion duhet të jepet, nëse është e mundur.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër , i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

3/26. Blerësi

Kolonat F1a, F1d dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Blerësi është subjekti i fundit i njohur ndaj të cilit janë shitur mallrat ose është rënë dakord për t'i shitur mallrat. Nëse mallrat janë për importim, ndryshe nga ndjekja e procedurës së blerjes, atëherë duhet të jepen të dhënat e pronarit të mallrave.
Kur numri RIOE i blerësit të mallrave nuk është i disponueshëm, shkruani emrin e blerësit dhe adresën. Një numër kontakti mund të sigurohet.

Kolona H1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur blerësi është i ndryshëm nga personi i dhënë në D.E. 3/15 Importuesi, shkruani emrin dhe adresën e blerësit të mallrave, në rastet kur numri i tij RIOE nuk është i disponueshëm për deklaruesin.

Në rast se vlera doganore llogaritet në përputhje me nenin 70 të Kodit, ky informacion duhet të jepet, nëse është e mundur.

3/27. Numri i identifikimit të Blerësit

Kolonat F1a, F1d dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Blerësi është subjekti i fundit i njohur ndaj të cilit janë shitur mallrat ose është rënë dakord për t'i shitur mallrat. Nëse mallrat janë për importim, ndryshe nga ndjekja e procedurës së blerjes, atëherë duhet të jepen të dhënat e pronarit të mallrave.

Shënoni numrin RIOE të blerësit të mallrave, kur ky numër është i disponueshëm për deklaruesin.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjeëtr që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

Kolona H1 e tabelës me kërkesat e të dhënave:

Kur blerësi është i ndryshëm nga personi i dhënë në D.E. 3/16 Importuesi, atëherë ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të blerësit të mallrave, në rastet kur ky numër është i disponueshëm.

Në rast se vlera doganore llogaritet në përputhje me nenin 70 të Kodit, ky informacion duhet të jepet, nëse është e mundur.
Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

3/28. Numri i identifikimit të personit që njofton mbërritjen

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të personit që njofton ardhjen e mjeteve aktive të transportit që kalojnë kufirin.

3/29. Numri i identifikimit të personit që njofton devijimin

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të personit që njofton devijimin.

3/30. Numri i identifikimit të personit që paraqet mallrat në doganë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të personit që paraqet mallrat në doganë pas mbërritjes së tyre.

3/31. Transportuesi

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion do të sigurohet në situata kur transportuesi është i ndryshëm nga deklaruesi. Shkruani emrin e plotë dhe adresën e personit në fjalë. Një numër mund të sigurohet.

3/32. Numri i identifikimit të transportuesit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion do të sigurohet kur të jetë i ndryshëm nga deklaruesi.

Kur deklarata përmbledhëse e hyrjes, ose të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë paraqitur ose ndryshuar nga një person i përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 119 (4) të Kodit, ose janë dorëzuar në raste të veçanta, sipas nenit 119(6) të Kodi, atëherë duhet te jepet numri RIOE i transportuesit.

Numri RIOE i transportuesit sigurohet edhe në situata të mbuluara nga nenet 236; 237 dhe 240.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin. Ky numër mund të përdoret edhe kur transportuesi është deklaruesi.

Kolonat A1 deri në A3, F3a, F4a, F4b dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të transportuesit, sa herë që ky numër është i disponueshëm për deklaruesin.

Kolonat F1a deri në F1d, F2a deri në F2c të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të transportuesit.

3/33. Pala njoftuese - Kontrata e transportit në nivel master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e palës që do të njoftohet në hyrje të mbërritjes së mallrave, si ç është përcaktuar në faturën e ngarkesës në nivel master apo në faturën e transportit ajror në nivel master. Ky informacion duhet të sigurohet kur është i zbatueshëm. Një numër kontakti mund të sigurohet.

1. Kur mallrat janë transportuar në bazë të një fature të ngarkesës që është "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed", në një rast të tillë kur marrësi nuk është përmendur dhe nuk është futur kodi përkatës i përcaktuar për D.E.
2/2. Informacioni shtesë, atëherë duhet të jepet gjithmonë pala njoftuese.

3/34. Numri i identifikimit të palës njoftuese - Kontrata e transportit në nivel master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të palës njoftuese të përmendur në nenin 1 (26), sa herë që ky numër është i disponueshëm për deklaruesin.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

3/35. Pala njoftuese – Kontrata e transportit në nivel House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani emrin e plotë dhe adresën e palës për t'u njoftuar në hyrje të mbërritjes së mallrave të përcaktuara në faturën e ngarkesës në nivel House apo faturën e transportit ajror në nivel House. Ky informacion duhet të sigurohet kur është i zbatueshëm. Një numër kontakti mund të sigurohet.

1. Kur mallrat janë transportuar në bazë të një fature të ngarkesës që është "pa emrin e përfituesit/to order blank endorsed", në një rast të tillë kur pritësi nuk është përmendur dhe nuk është futur kodi përkatës i përcaktuar për D.E.
2/2. Informacioni shtesë, atëherë duhet të jepet gjithmonë pala njoftuese.

3/36. Numri i identifikimit të palës njoftuese - Kontrata e transportit në nivel House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të palës njoftuese të përmendur në nenin 1 (23), sa herë që ky numër është i disponueshëm për deklaruesin.

Kur lehtësirat janë dhënë në kuadër të programit të partneritetit të tregtarëve të një vendi tjetër që njihet nga R.SH, ky informacion mund të marrë formën e një numri identifikues unik të vendit tjetër i cili është vënë në dispozicion të R.SH nga vendi tjetër në fjalë. Ky numër mund të përdoret sa herë që të jetë i disponueshëm për deklaruesin.

3/37. Numri i identifikimit të aktorit(ëve) shtesë të zinxhirit të furnizimit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Numri unik i identifikimit i caktuar për një operator ekonomik të një vendi tjetër, në kuadër të programit të partneritetit tregtar të zhvilluar në përputhje me Kuadrin e Organizatës Botërore Doganore të Standardeve për Sigurinë dhe Lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare që njihet nga Bashkimi Evropian.

Identifikuesi i Palës në fjalë, do të paraprihet nga kodi i rolit që përcakton rolin e tij në zinxhirin e furnizimit.

3/38. Numri i identifikimit të të dhënave të personit i cili dorëzon ENS shtesë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të personit që lëshon një kontratë transporti siç përmendet në nenin 243 (1), nënparagrafi i parë ose të marrësit të përmendur në nenin 243 (1) nënparagrafi i dytë dhe 244 (1) dhe (2) (p.sh., përcjellesi i mallrave, operatori postar), i cili paraqet të dhënat shtesë të deklaratës përmbledhëse të hyrjes në zbatim të neneve 93 ose 94.

3/39. Numri i identifikimit të mbajtësit të autorizimit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të R.SH, shkruani llojin e autorizimit dhe numrin RIOE të mbajtësit të autorizimit, të parashikuar në nenin 1 (26).

3/40. Numri i identifikimit të referencës fiskale shtesë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Kur përdoret kodi 42 ose 63 i regjimit (kodi përkatës në R.Sh), atëherë nëse kërkohet duhet të regjistrohet informacioni i kërkuar nga ligji mbi TVSH-në.

3/41. Numri i identifikimit të personit që paraqet mallin në doganë në rast të hyrjes në regjistrat e deklaruesit ose para-depozitimit të deklaratës doganore
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të personit që paraqet mallrat në doganë në rastet kur deklarata është bërë nga hyrja në të dhënat e deklaruesit.

3/42. Numri i identifikimit të personit që dorëzon listën e mallrave doganore
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (18) të personit që dorëzon listën e mallrave doganore.

3/43. Numri i identifikimit të personit që ka kërkuar një provë për statusin doganor të mallrave shqiptare

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të personit që kërkon një provë të statusit doganor të mallrave shqiptare.

3/44. Numri i identifikimit të personit që njofton ardhjen e mallrave pas lëvizjes nën regjimin e magazinimit e përkohshëm
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky informacion merr formën e numrit RIOE të përmendur në nenin 1 (26) të personit që njofton ardhjen e mallrave pas lëvizjes së mallrave nën magazinimin e përkohshëm.

Grupi 4 – Informacioni i Vlerës / Taksat

4/1. Kushtet e dërgesës
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH dhe titujt, jepni të dhënat mbi kushtet e kontratës tregtare.

4/2. Mënyrat e pagesës për detyrimet e transportit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani kodin përkatës që përcakton mënyrën e pagesës për detyrimet e transportit.

4/3. Llogaritja e taksave – Lloji i taksës
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH dhe, nëse është e aplikueshme, kodin(et) e parashikuar nga autoriteti kompetent në fjalë, shënoni llojet e taksave për secilin nga llojet e detyrimeve ose taksave të zbatueshme për mallrat në fjalë.

4/4. Llogaritja e taksave - Baza tatimore
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani detyrimin apo bazën e taksës se zbatueshme (vlera, pesha ose të tjera).

4/5. Llogaritja e taksave – Norma tatimore
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani normat për secilin nga detyrimet dhe taksat e zbatueshme.

4/6. Llogaritja e taksave - Shuma e taksave për t'u paguar
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani shumën për secilin prej detyrimeve dhe taksave të zbatueshme.

Shumat në këtë fushë duhet të shprehen në njësinë e monedhës, kodi i së cilës mund të shfaqet në D.E. 4/12. Njësia e monedhës së brendshme, apo, në mungesë të një kodi të tillë në D.E. 4/12 Njësia e monedhës së brendshme, është LEK.

4/7. Llogaritja e taksave – Totali

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani shumën totale të detyrimeve dhe taksave për mallrat në fjalë.

Shumat në këtë fushë duhet të shprehen në njësinë e monedhës, kodi i së cilës mund të shfaqet në D.E. 4/12. Njësia e monedhës së brendshme, apo, në mungesë të një kodi të tillë në D.E. 4/12 Njësia e monedhës së brendshme, është LEK.

4/8. Llogaritja e taksave - Mënyra e pagesës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të R.SH, tregoni mënyrën e zbatueshme të pagesës.

4/9. Shtesat dhe zbritjet

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Për çdo lloj shtese apo zbritje përkatëse për një artikull të caktuar të mallrave, shkruani kodin përkatës të ndjekur nga sasia korresponduese në monedhën kombëtare (LEK) që ende nuk është përfshirë apo zbritur nga çmimi i artikullit.

4/10. Monedha e faturës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës, futni monedhën në të cilën është hartuar fatura tregtare.

Ky informacion është përdorur në lidhje me D.E. 4/11 Shuma totale e faturuar dhe D.E. 4/14 Çmimi / sasia e artikullit, aty ku është e nevojshme për llogaritjen e detyrimeve të importit.

4/11. Shuma totale e faturuar

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani çmimin e faturuar për të gjitha mallrat e deklaruara në deklaratën e shprehur në njësi të monedhës të deklaruar në D.E. 4/10 Monedha e faturës.

4/12. Njësia e monedhës së brendshme

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Deklaratat e bëra në RSH, të cilat i japin mundësi operatorëve ekonomikë të zgjedhin përdorimin e njësisë me euron për hartimin e deklaratave të tyre doganore, duhet të përfshijnë në këtë fushë një tregues të njësisë së monedhës, njësinë kombëtare të përdorur.

4/13. Treguesit e vlerës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse të R.SH, futni kombinimin e treguesve për të deklaruar nëse vlera e mallrave përcaktohet nga faktorë specifikë.

4/14. Çmimi / sasia e artikullit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Çmimi i mallrave për artikullin e deklaratës në fjalë, të shprehur në njësi të monedhës të deklaruar në D.E. 4/10 Monedha e Faturës.

4/15. Kursi i këmbimit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky element i të dhënave përmban kursin e këmbimit të përcaktuar më parë nga një kontratë mes palëve në fjalë.

4/16. Mënyra e përcaktimit të vlerës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të R.SH, shënoni mënyrën e vlerësimit të përdorur.

4/17. Preferenca

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky element i të dhënave ka të bëjë me informacionin mbi trajtimin tarifor të mallrave. Kur përdorimi i tij është dhënë si i detyrueshëm për tabelën me kërkesat për të dhënat të Kreut I, Kapitulli 3, Seksioni 1 të këtij Aneksi, atëherë ai duhet të përdoret edhe kur nuk është kërkuar asnjë tarifë për trajtimin preferencial. Shkruani kodin përkatës të R.SH.

Autoriteti kompetent do të publikojë në intervale të rregullta listën e kombinimeve të kodeve të përdorshëm, së bashku me shembuj dhe shënime.

4/18. Vlera Postare

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pjesa e përmbajtjes, vlera e deklaruar: Kodi i monedhës dhe vlera monetare e pjesës së përmbajtjes, e deklaruar për qëllime doganore.

4/19. Detyrimet postare

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Artikulli; Posta e paguar: Kodi i monedhës dhe shuma e postës së paguar nga postuesi ose në ngarkim të postuesit.

Grupi 5 - Datat / Orët/ Periudhat / Vendet

5/1. Data dhe ora e përllogaritur e mbërritjes në zyrën doganore të hyrjes në territorin doganor të R.SH

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Data dhe ora lokale e programuar kur mjeti aktiv i transportit arrin në R.SH (përmes rrugës tokësore) në postën e parë kufitare, (përmes ajrit) në aeroportin e parë ose (përmes detit) në portin e parë. Në rastin e transportit nga deti, ky informacion do të kufizohet në datën e mbërritjes.

Kolonat G1 deri në G3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky informacion do të jetë i kufizuar në datën e mbërritjes në vendin e parë të mbërritjes në territorin doganor të R.SH. të deklaruar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes.

5/2. Data dhe ora e përllogaritur e mbërritjes në portin e shkarkimit
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Data dhe ora lokale e programuar në të cilën anija pritet të mbërrijë në portin, ku mallrat do të shkarkohen.

5/3. Data dhe ora reale e mbërritjes në territorin doganor të R.SH.

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Data dhe ora lokale kur mjeti aktiv i transportit arrin në fakt në R.SH (përmes rrugëve tokësore) në postën e parë kufitare, (përmes ajrit) në aeroportin e parë ose (përmes detit) në portin e pare

5/4.Data e Deklaratës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Data në të cilën janë lëshuar deklaratat përkatëse dhe, kur është e përshtatshme, janë nënshkruar ose ndryshe vërtetuar.

5/5. Vendi i Deklaratës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Vendi në të cilën janë bërë deklaratat përkatëse të bazuara në letër.

5/6. Zyra e destinacionit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin e duhur të R.SH, futni numrin e referencës së zyrës doganore, ku do të përfundojnë operacionet e transitit.

5/7. Zyrat e parashikuara të kalimit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shënoni kodin për zyrën e parashikuar të hyrjes në secilën palë kontraktuese të konventës së transitit, dhe të zyrës doganore të hyrjes përmes së cilës mallrat ri-hyjnë në territorin doganor të R.SH pasi kanë kaluar në territorin e një vendi jo - pjesë të transitit të përbashkët, ose kur ngarkesa është për të kaluar në një territor tjetër përveç R.SH ose në një vend jo-pjesë të transitit të përbashkët, për zyrën doganore të daljes përmes së cilës largohet nga R.SH si dhe për zyrën doganore të hyrjes përmes së cilës ri-hyn në R.SH.

Duke përdorur kodin e duhur të R.Sh, futni numrat e referencës së zyrave doganore në fjalë.

5/8. Kodi i vendit të destinacionit

Kolonat B1 deri në B3 dhe C1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin e duhur të R.SH, shënoni shtetin për të cilin në kohën e lëshimit në regjimin doganor dihet se mallrat do të dërgohen drejt këtij vendi

Kolonat D1 deri në D3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin e duhur të R.SH, shënoni zyrën doganore të destinacionit të mallrave.

Zyra doganore e njohur si destinacioni i fundit është përcaktuar zyra doganore e njohur në kohën e vendosjes së mallrave në regjimin doganor ,zyrë drejt së cilës do të dërgohen këto mallra.

Kolonat H1, H2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të R.SH, shkruani kodin për autoritetin kompetent ku mallrat janë vendosur në kohën e vendosjes në regjimin doganor.

Megjithatë, kur në kohën e hartimit të deklaratës doganore, dihet se mallrat do të dërgohen në një autoritet tjetër pas çlirimit, atëherë shënoni kodin për këtë autoritetin e fundit.

Kolona H3 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur mallrat janë importuar, me qëllim për t'i vendosur ato nën regjimin e lejimit të përkohshëm, atëherë zyra doganore e destinacionit do të jetë zyra doganore ku mallrat do të përdoren për herë të parë.

Kolona H3 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur mallrat janë importuar, me qëllim për t'i vendosur ato nën regjimin e përpunimit aktiv, atëherë zyra doganore e destinacionit do të jetë zyra doganore ku kryhet aktiviteti i parë i përpunimit.

Kolona H4 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur janë importuar mallra me qëllim vendosjen e tyre në regjimin e përpunimit aktiv, zyra doganore e destinacionit do të jetë zyra në të cilën është kryer proçesi i parë i përpunimit.

5/9.Kodi i zyrës së destinacionit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të përcaktuar nga autoriteti kompetent, shkruani zyrën doganore të destinacionit të mallrave brenda R.SH.

5/10. Kodi i vendit të dorëzimit - Kontrata e transportit në nivelin master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Në rast të trafikut detar, shënoni UN / LOCODE, ose, nëse nuk është i disponueshëm, kodin e shtetit të ndjekur nga kodi postar për vendin ku bëhet dorëzimi përtej portit të shkarkimit, siç është përcaktuar në faturën e ngarkimit në nivel master.

Në rast të trafikut ajror, shënoni destinacionin e mallrave duke përdorur UN / LOCODE, ose, nëse nuk është i disponueshëm, shenoni kodin e shtetit të ndjekur nga kodi postar për vendin, siç është përcaktuar në faturën e transportit ajror në nivel master.

5/11. Kodi i vendit të dorëzimit - Kontrata e transportit në nivel House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Në rast të trafikut detar, futni UN / LOCODE, ose, nëse nuk është i disponuesh ëm, kodin e shtetit të ndjekur nga kodi postar për vendin ku bëhet dorëzimit përtej portit të shkarkimit, siç është përcaktuar në faturën e ngarkimit në nivel House.

Në rast të trafikut ajror, futni destinacionin e mallrave duke përdorur UN / LOCODE, ose, nëse nuk është i disponueshëm, kodin e shtetit të ndjekur nga kodi postar për vendin, siç është përcaktuar në faturën e transportit ajror në nivel House.

5/12. Zyra doganore e daljes

Kolonat A1, A2 dhe A3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin e duhur të R.SH, shënoni zyrën doganore.

Kolonat B1, B3 dhe C1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin e duhur të R.SH, shënoni zyrën doganore përmes së cilës synohet që mallrat të largohen nga territori doganor i R.SH.

5/13. Zyra(at) pasuese doganore e hyrjes

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të kërkesat për të dhënat:

Identifikimi i zyrave pasuese doganore të hyrjes në territorin doganor të R.SH.

Ky kod duhet të sigurohet kur Kodi për D.E. 7/4 Mënyra e transportit në kufi, është 1, 4 ose 8.

5/14. Kodi i vendit të dërgesës / eksportit

Kolonat B1 deri në B3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani kodin perkates te R.SH per zyren doganore ne te cilin rnallrat jane vendosur ne kohen e vendosjes te tyre ne regjirn.

Megjithatë, kur dihet se mallrat janë sjellë nga një zyrë doganore në një zyrë tjetër doganore në të cilën ato janë vendosur në kohën e vendosjes së tyre në regjimin doganor, atëherë tregojeni këtë zyrë tjetër doganore, me kusht që:

(i) mallrat të jenë sjellë nga atje vetëm për qëllime të eksportit; dhe

(ii) eksportuesi nuk është i vendosur në territorin në të cilin mallrat janë në kohën e vendosjes të tyre në regjimin doganor; dhe

(iii) hyrja në zyrën doganore në të cilën janë mallrat në momentin e vendosjes të tyre në regjimin doganor , nuk ishte një blerje e mallrave ose transaksion brenda R.SH e trajtuar si të tillë, siç përmendet në Ligjin mbi TVSH-në.

Megjithatë, kur mallrat eksportohen në bazë të regjimit të përpunimit aktiv, tregoni zyrën doganore ku kryhet aktiviteti i fundit i përpunimit.

Kolonat H1, H2 deri në H4 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Nëse nuk ka ndodhur asnjë transaksion tregtar (p.sh. shitja apo përpunimi), apo asnjë bllokim i mallrave që nuk ka lidhje me transportin e tyre në një zyrë të ndërmjetme doganore , atëherë shënoni kodin përkatës të R.SH për të treguar vendin nga ku mallrat janë dërguar fillimisht drejt zyrës doganore në të cilën mallrat janë në kohën e vendosjes të tyre në regjimin doganor. Në qoftë se ka ndodhur ndonjë bllokim i tillë apo transaksion tregtar, atëherë tregoni zyrën e fundit të ndërmjetme.

Për qëllim të kësaj kërkese për të dhëna, një bllokim për të mundësuar konsolidimin e mallrave "en-route", do të konsiderohet si i lidhur me transportin e mallrave.

5/15. Kodi i vendit të origjinës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani kodin përkatës të R.Sh për vendin e origjinës jo-preferenciale, siç përcaktohet në Kreu II Seksioni 1 I Kodit.

5/16. Kodi i vendit të origjinës preferenciale

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Nëse një trajtim preferencial në bazë të origjinës së mallit kërkohet në D.E. 4/17 Preferenca, ateherë shënoni vendin e origjinës, siç tregohet në provën e origjinës. Kur prova e origjinës i referohet një grupi vendesh, shënoni grupin e vendeve, duke përdorur kodet përkatëse të tyre.

5/17. Kodi i rajonit të origjinës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të përcaktuar nga autoriteti kompetent, shënoni vendin e dërgesës ose prodhimit të të mallrave në fjalë në zyrën doganore përkatëse.

5/18. Kodet e zyrave doganore të transitit

Kolona A1 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Identifikimi në mënyrë kronologjike i zyrave doganore përmes së cilave do të kalojnë mallrat nga zyra doganore e nisjes fillestare deri në destinacionin përfundimtar. Kjo përfshin edhe zyrat doganore të nisjes dhe të destinacionit të mallrave. Ky informacion duhet të sigurohet në masën që njihet.

Kolona A2 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Do të jepet vetëm zyra doganore e destinacionit të mallrave.

5/19. Kodet e zyrave doganore të transitit të mjeteve të transportit

Kolonat F1a, F1b, F2a, F2b dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Identifikimi në mënyrë kronologjike i zyrave doganore përmes së cilave do të kalojnë mjetet e transportit nga zyra doganore e nisjes deri në destinacionin përfundimtar. Kjo përfshin edhe zyrat doganore të nisjes fillestare dhe të destinacionit përfundimtar të mjeteve të transportit.

Kolonat F3a, F4a dhe F4b të tabelës me kërkesat për të dhënat:
Do të shënohet vetëm zyra doganore e nisjes fillestare të mjeteve të transportit,.

5/20. Kodet e zyrave doganor të transitit dërgesës

Kolonat A1, F1a, F1c, F2a, F2c, F3a dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Identifikimi në mënyrë kronologjike i zyrave doganore përmes së cilave do të kalojnë mallrat nga zyra doganore e nisjes fillestare deri në destinacionin përfundimtar, siç parashikohet në faturën më të ulët të ngarkesës në nivel House, në faturën më të ulët të transportit ajror në nivel House ose në dokumentin e transportit rrugor/hekurudhor. Kjo përfshin edhe zyrat doganore të nisjes fillestare dhe të destinacionit përfundimtar të mallrave.

Kolona A2 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Do të shënohet vetëm zyra doganore e destinacionit përfundimtar të mallrave.

5/21. Vendi i ngarkimit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Identifikimi i portit detar, aeroportit, terminalit të mallrave, stacionit hekurudhor ose i ndonjë vendi tjetër në të cilin mallrat janë ngarkuar në mjetet e transportit që përdoren për transportin e tyre, duke përfshirë edhe zyrën doganore ku ajo ndodhet. Kur është i disponueshëm, duhet të shënohet një kod, i cili mundëson identifikimin e vendndodhjes.

Në rast se nuk ka asnjë UN / LOCODE të disponueshëm për vendndodhjen në fjalë, atëherë kodi i zyrës doganoret do të pasohet nga emri i vendit, në nivelin maksimal të saktësisë në dispozicion.

Kolonat D1 deri në D3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin e duhur kur është e nevojshme, shënoni vendin, në të cilin mallrat janë ngarkuar mbi mjetet aktive të transportit me të cilat do të kalojnë kufirin e R.SH.

Kolonat F4a dhe F4b të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Dërgesat postare: ky element nuk ka nevojë të sigurohet kur mund të konkludohet automatikisht dhe në mënyrë të qartë nga elemente të tjera të të dhënave të siguruara nga operatori ekonomik.

Kolona F5 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky mund të jetë vendi ku mallrat janë marrë në dorëzim në bazë të kontratës së transportit ose në zyrën doganore të nisjes TIR.

5/22. Vendi i shkarkimit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Identifikimi i portit detar, aeroportit, terminalit të mallrave, stacionit hekurudhor ose i ndonjë vendi tjetër në të cilin mallrat janë shkarkuar nga mjetet e transportit që përdoren për transportin e tyre, duke përfshirë edhe zyrën doganore ku ajo ndodhet. Kur është i disponueshëm, duhet të shënohet një kod, i cili mundëson identifikimin e vendndodhjes.

Në Në rast se nuk ka asnjë UN / LOCODE të disponueshëm për vendndodhjen në fjalë, atëherë kodi i zyrës doganoret do të pasohet nga emri i vendit, në nivelin maksimal të saktësisë në dispozicion.

5/23. Vendndodhja e mallrave
Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodet përkatëse, shënoni vendin ku mallrat mund të kontrollohen. Ky vend duhet të jetë i saktë mjaftueshëm për të lejuar autoritetet doganore për të kryer kontrollin fizik të mallrave.

5/24. Kodi i zyrës doganore të hyrjes

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Identifikimi i zyrës doganore përgjegjëse për të kryer formalitetet, kur mjeti aktiv i transportit ka për qëllim të arrijë në territorin doganor të R.SH.

Kolonat G1 deri në G3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Identifikimi i zyrës doganore përgjegjëse për të kryer formalitetet, kur mjeti aktiv i transportit është deklaruar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes për të arritur në territorin doganor të R.SH.

5/25. Kodi i zyrës aktuale doganore të hyrjes

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Identifikimi i zyrës doganore përgjegjëse për të kryer formalitetet, ku mjeti aktiv i transportit arrin faktikisht në territorin doganor të R.Sh.

5/26. Zyra doganore e paraqitjes

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin përkatës të R.SH, tregoni zyrën doganore ku mallrat janë paraqitur me qëllim vendosjen e tyre në një regjim doganor.

5/27. Zyrë doganore mbikëqyrëse

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Duke përdorur kodin e duhur të R.SH, shënoni zyrën doganore të përcaktuar në autorizimin përkatës për mbikëqyrjen e regjimit.

Kolona G5 e tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky informacion do të marrë formën e identifikuesit të zyrës mbikëqyrëse doganore kompetente për përdorimin e magazinimit të përkohshëm në destinacion.

5/28. Vlefshmëria e kërkuar e provës

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Tregoni vlefshmërinë e kërkuar të provës së statusit doganor të mallrave shqiptare të shprehur në ditë, në rast se personi që kërkon provën për statusin doganor të mallrave shqiptare dëshiron të vendosë një periudhë vlefshmërie më të gjatë se ajo e parashikuar në nenin 260. Argumentimi i kërkesës duhet të sigurohet në DE 2/2 Informacioni shtesë.

5/29. Data e paraqitjes së mallrave

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Tregoni datën kur mallrat janë paraqitur në doganë në përputhje me nenin 130 të Kodit.

5/30. Vendi i pranimit

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Vendi ku mallrat merren në dorëzim nga dërguesit prej personit që lëshon faturën e ngarkimit.

Identifikimi i porti, terminalit të mallrave ose i ndonjë vendi tjetër në të cilin mallrat janë marrë në dorëzim nga dërguesit, përfshirë edhe zyrën doganore ku ndodhen. Kur është i disponueshëm, informacioni i koduar do të ofrohet për identifikimin e vendndodhjes.

Në rast se nuk ka asnjë UN / LOCODE të disponueshëm për vendndodhjen në fjalë, atëherë kodi i vendit do të pasohet nga emri i vendit, në nivelin maksimal të saktësisë në dispozicion.

Grupi 6 – Identifikimi i mallrave

6/1. Pesha neto (kg)

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani peshën neto, të shprehur në kilogram, të mallrave në fjalë nga artikulli përkatës i mallrave në deklaratë. Pesha neto është masa e mallrave pa paketim.

Kur një peshë neto më e madhe se 1 kg përfshin një pjesë të një njësie (kg), ajo mund të rrumbullakohet në këtë mënyrë:

- Nga 0,001 deri 0499: rrumbullakohet në kg më të vogël të afërt,

- Nga 0,5 në 0,999: rrumbullakohet në kg më të madh të afërt.

Një peshë neto prej më pak se 1 kg duhet të regjistrohet si "0", e ndjekur nga një numër dhjetorë deri në 6, duke hequr të gjithë '0' në fund të sasisë (p.sh. 0,123 për një pako prej 123 gram, 0,00304 për një pako prej 3 gram dhe 40 miligram ose 0,000654 për një paketë prej 654 miligram).

6/2. Njësitë shtesë

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Kur është e nevojshme, shënoni sasinë e artikullit në fjalë, të shprehur në njësinë e përcaktuar në legjislacionin e R.SH , siç është publikuar në TARIC/TARISH.

6/3. Pesha bruto (kg) - Kontrata e transportit në nivelin master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani peshën bruto, të shprehur në kilogram, të mallrave në fjalë nga artikulli përkatës i mallrave, siç tregohet në dokumentin e transportit të nivelit master. Pesha bruto është pesha totale e mallrave me të gjithë paketimin e tyre, duke përjashtuar kontenierët dhe pajisjet e tjera të transportit.

Kur një peshë bruto më e madhe se 1 kg përfshin një pjesë të një njësie (kg), ajo mund të rrumbullakohet në këtë mënyrë:

- Nga 0,001 deri 0,499: rrumbullakohet në kg më të vogël të afërt,

- Nga 0,5 në 0,999: rrumbullakohet në kg me të madh të afërt.

Një peshë bruto më pak se 1 kg duhet të regjistrohet si '0.' E ndjekur nga një numër dhjetorë deri në 6, duke hequr të gjithë '0' në fund të sasisë (p.sh. 0,123 për një paketë prej 123 gram, 0,00304 për një paketë prej 3 gram dhe 40 miligram ose 0,000654 për një paketë prej 654 miligram).

Kur është e mundur, operatori ekonomik mund të shënojë peshën në deklaratë në nivel artikulli .

6/4. Pesha bruto (kg) - Kontrata e transportit në nivelin House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Shkruani peshën bruto, të shprehur në kilogram, të mallrave në fjalë nga artikulli përkatës i mallrave, siç tregohet në dokumentin e transportit në nivel House. Pesha bruto është pasha totale e mallrave me të gjithë paketimin e tyre, duke përjashtuar kontenierët dhe pajisjet e tjera të transportit.

Kur një peshë bruto më e madhe se 1 kg përfshin një pjesë të një njësie (kg), ajo mund të rrumbullakohet në këtë mënyrë:

- Nga 0,001 deri 0,499: rrumbullakohet në kg më të vogël të afërt,

- Nga 0,5 në 0,999: rrumbullakohet në kg me të madh të afërt.

Një peshë bruto më pak se 1 kg duhet të regjistrohet si '0.' e ndjekur nga një numër dhjetorë deri në 6, duk e hequr të gjithë '0' në fund të sasisë (p.sh. 0,123 për një paketë prej 123 gram, 0,00304 për një paketë prej 3 gram dhe 40 miligram ose 0,000654 për një paketë prej 654 miligram).

Kolonat F1a, F1C, F2A, F2c, F2d, F3a, F3b dhe F5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur është e mundur, operatori ekonomik mund të shënojë peshën në deklaratë në nivel artikulli .

6/5. Pesha bruto (kg))

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Pesha bruto është pesha e mallrave, duke përfshirë paketimin, por duke përjashtuar pajisjet e transportuesit për deklaratën.

Kur një peshë bruto më e madhe se 1 kg përfshin një pjesë të një njësie (kg), ajo mund të rrumbullakohet në këtë mënyrë:

- Nga 0,001 deri 0,499: rrumbullakohet në kg më të vogël të afërt,

- Nga 0,5 në 0,999: rrumbullakohet në kg me të madh të afërt.

Një peshë bruto më pak se 1 kg duhet të regjistrohet si '0.' e ndjekur nga një numër dhjetorë deri në 6, duke hequr të gjithë '0' në fund të sasisë (p.sh. 0,123 për një paketë prej 123 gram, 0,00304 për një paketë prej 3 gram dhe 40 miligram ose 0,000654 për një paketë prej 654 miligram).

Kolonat B1 deri në B3, H1 deri në H6, I1 dhe I2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani masën bruto, të shprehur në kilogram, të mallrave në fjalë nga artikulli përkatës i mallrave.

Kur pesha e paletës është e përfshirë në dokumentet e transportit, pesha e paletës gjithashtu do të përfshihet në llogaritjen e peshës bruto, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) Paleta formon një artikull të veçantë në deklaratën doganore;

b) Përqindja e tarifës për artikullin në fjalë bazohet në peshën bruto dhe / ose kuota tarifore për artikullin në fjalë, menaxhohet në njësinë matëse 'peshë bruto ".

Kolonat A1, A2, E1, E2, G4 dhe G5 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Kur është e mundur, operatori ekonomik mund të shënojë peshën në deklaratë në nivel artikulli

Kolonat D1 deri në D3 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Shkruani peshën bruto, të shprehur në kilogram, të mallrave në fjalë nga artikulli përkatës i mallrave.

Kur deklarata përfshin disa artikuj të mallrave, të cilat kanë të bëjnë me mallrat që janë paketuar së bashku në mënyrë të tillë që është e pamundur për të përcaktuar peshën bruto të mallit që i përket secilit prej artikujve të mallrave, atëherë pesha totale bruto duhet vetëm të shënohet në nivelin kryesor.

Kur një deklaratë e bazuar në letër e transitit mbulon disa artikuj të mallrave, atëherë pesha totale bruto duhet vetëm të shënohet në kutinë e parë 35, duke lënë bosh kutitë e mbetura 35. Autoriteti kompetent mund ta shtrijë këtë rregull për të gjitha regjimet përkatëse të përmendura në tabelën e Kreut I.

6/6. Përshkrimi i mallrave - Kontrata e transportit në nivelin master

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky është një përshkrim i thjeshtë gjuhe që është mjaftueshëm i saktë për shërbimet doganore në mënyrë që këto të fundit të jenë në gjendje për të identifikuar mallrat. Nuk mund të pranohen termat e përgjithshëm (dmth 'të konsoliduara', 'ngarkesat e përgjithshme', 'pjesët' ose 'mallrave të të gjitha llojeve") si dhe përshkrimet që nuk janë mjaftueshëm të saktë. Një listë jo e plotë e termave të tilla të përgjithshme dhe e përshkrimeve rregullohet me udhëzim.

Kur deklaruesi jep kodin CUS për substancat dhe preparatet kimike, atëherë autoriteti kompetent mund të heqë dorë nga kërkesa për të siguruar një përshkrim të saktë të mallrave.

6/7. Përshkrimi i mallrave - Kontrata e transportit në nivel House

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Ky është një përshkrim i thjeshtë gjuhe që është mjaftueshëm i saktë për shërbimet doganore në mënyrë që këto të fundit të jenë në gjendje për të identifikuar mallrat. Nuk mund të pranohen termat e përgjithshëm (dmth 'të konsoliduara', 'ngarkesat e përgjithshme', 'pjesët' ose 'mallrat e të gjitha llojeve") si dhe përshkrimet që nuk janë mjaftueshëm të saktë. Një listë jo e plotë e termave të tilla të përgjithshme dhe e përshkrimeve rregullohet me udhëzim.

Kur deklaruesi jep kodin CUS për substancat dhe preparatet kimike, atëherë autoriteti kompetent mund të heqë dorë nga kërkesa për të siguruar një përshkrim të saktë të mallrave

6/8. Përshkrimi i mallrave

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Kur deklaruesi jep kodin CUS për substancat dhe preparatet kimike, atëherë autoriteti kompetent mund të heqë dorë nga kërkesa për të siguruar një përshkrim të saktë të mallrave

Kolonat A1 dhe A2 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky është një përshkrim i thjeshtë gjuhe që është mjaftueshëm i saktë për shërbimet doganore në mënyrë që këto të fundit të jenë në gjendje për të identifikuar mallrat. Nuk mund të pranohen termat e përgjithshëm (dmth 'të konsoliduara', 'ngarkesat e përgjithshme', 'pjesët' ose 'mallrat e të gjitha llojeve") si dhe përshkrimet që nuk janë mjaftueshëm të saktë. Një listë jo e plotë e termave të tilla të përgjithshme dhe e përshkrimeve rregullohet me udhëzim.

Kolonat B3, C1, D1, D2, E1 dhe E2 të tabelës me kërkesat e të dhënave:

Kjo nënkupton përshkrimin normal të tregtisë. Kur duhet të jepet kodi i mallit, përshkrimi duhet të jetë mjaftueshëm i saktë për të lejuar klasifikimin e mallrave.

Kolonat B1, B2, H1 deri në H4 dhe I1 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Përshkrimi i mallrave nënkupton përshkrimin normal të tregtisë. Me përjashtim të mallrave jo-shqiptare të vendosura nën regjimin e magazinimit doganor, në depo doganore publike të tipit I, II ose III ose në një magazinë doganore private, atëherë ky përshkrim duhet të shprehet në terma mjaft të sakta për të mundësuar identifikimin dhe klasifikimin e menjëhershëm dhe të qartë të mallrave.

Kolonat D3, G4, G5 dhe H6 të tabelës me kërkesat për të dhënat:

Ky është një përshkrim i thjeshtë gjuhe që është mjaftueshëm i saktë për shërbimet doganore në mënyrë që këto të fundit të jetë në gjendje të identifikojnë mallrat.

6/9. Lloji i paketimeve

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat e të dhënave:

Kodi specifikues për llojin e paketimit.

6/10. Numri i paketimeve

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat për të dhënat:

Numri total i paketimeve bazuar në njësisë më të vogël të paketimit të jashtëm. Ky është numri i artikujve të veçantë të paketuar në mënyrë të tillë që ata të mos ndahen pa hequr më parë paketimin, ose numri i copëve, nëse janë të paambalazhuara.

Ky informacion nuk do të jepet kur mallrat janë në sasi të mëdha.

6/11. Shenjat e anijeve

Kolonat përkatëse të përdorura të tabelës me të gjitha kërkesat e të dhënave:

Rregulli parësor: Pjesë dhe aksesorë të prodhuar nga format bazë të metalit:

1. Vendi i origjinës për mallrat që janë prodhuar nga format bazë të metalit, të cilat nga zbatimi i Rregullit të Përgjithshëm Interpretues të Sistemit të Përgjithshem të Harmonizuar 2(a) klasifikohen në të njëjtin kre, nënkre apo nëndarje si mallra të kompletuara apo të përfunduara, do të jetë vendi në të cilin forma bazë e metalit është përfunduar, me kusht që operacionet e dorës së fundit të përfshijnë konfigurimin në formën finale pas heqjes së materialit (ndryshe nga lëmimi apo lustrimi ose të dyja) ose nga proçeset formuese të tilla si përkulja, goditje me çekiç, presim apo stampim.
2. Paragrafi 1 më sipër zbatohet tek mallrat e klasifikueshme në dispozitat për pjesët ose pjesët dhe aksesorët, duke përfshirë mallrat të përmendura specifikisht nën dispozita të tilla.

Përkufizimi i 'Montimi i produkteve gjysëm-përçuese' për qëllim të krerëve 8535, 8536, 8537, 8541 dhe 8542

'Montim i produkteve gjysëm-përçuese' do të thotë një ndryshim nga çipat, diodat dhe produktet e tjera gjysëm-përçuese në çipa, dioda dhe produkte të tjera gjysëm-përçuese që paketohen ose montohen në një mbështetës për lidhje ose fillimisht lidhen pastaj montohen. Montimi i produkteve gjysëm-përçuese nuk do të konsiderohet si operacion minimal.

Shënime të kapitullit:

Shënimi 1: Grumbullimi i pjesëve:

Kur një ndryshim në klasifikim rezulton nga aplikimi i Rregullit të Përgjithshëm Interpretues të Sistemit të Harmonizuar 2(a) në respekt të grumbujve të pjesëve që janë paraqitur si artikuj të pabashkuar në një kre apo nënkre tjetër, pjesët individuale do të mbajnë origjinën e tyre para një grumbullimi të tillë

Shënimi 2: Grumbullimi i pjesëve:

Mallrat e bashkuara nga një grumbull pjesësh të klasifikuara si mall i bashkuar sipas Rregullit të Përgjithshëm Interpretues 2 do të kenë origjinën në vendin e montimit, duke siguruar që montimi ka përmbushur rregullin parësor për mallin dhe pjesët të jenë paraqitur veçmas dhe jo si grumbullim.

Shënimi 3: Çmontimi i mallrave:

Nëse nga çmontimi i mallrave do të rezultojë një ndryshim në klasifikim, kjo nuk do të konsiderohet si ndryshim i kërkuar nga rregulli i vendosur në 'listën e rregullave'. Vendi i origjinës së pjesëve të rikuperuara nga mallrat do të jetë vendi ku pjesët janë rikuperuar, veçse nëse importuesi, eksportuesi ose ndonjë person tjetër për të përcaktuar origjinën e pjesëve ka arsye të justifikueshme për të treguar një tjetër vend të origjinës bazuar në prova të verifikueshme si shenja të origjinës në pjesët në vetvete ose në dokumente.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 8501	Module ose panele fotovoltaike me kristale silici	CTH, përveç kreut 8541
8527	Aparatet marrëse për radio - transmetim, nëse janë ose jo të kombinuara, në të njëjtën karkasë, me aparate regjistrimi ose riprodhimi tingulli ose orë.	CTH, përveç kreut 8529
8528	Monitorët dhe projektorët nëse janë apo jo të bashkangjitur me marrësa televizivë; aparatet marrëse për televizione, nëse janë ose jo të trupëzuara në radiotransmetuese apo aparate rregjistrimi apo riprodhimi video ose të tingullit.	CTH, përveç kreut 8529
8535	Aparaturat elektrike për kyçjen ose mbrojtjen e qarqeve elektrike ose për të bërë lidhjen me ose në qarqet elektrike (psh, çelësat, siguresat, rrufepritësit, kufizuesit e tensionit, zbutësit e mbitensionit, prizat, spinat, portollampat, kutitë e bashkimit), me të mëdha se 1000 volt.	CTH, përveç kreut 8538; ose montimi i produkteve gjysëm-përçuese

ex 8536	Aparaturat elektrike për kyçjen ose mbrojtjen e qarqeve elektrike ose për të bërë lidhjen me ose në qarqet elektrike (psh, çelësat, siguresat, rrufepritësit, kufizuesit e tensionit, zbutësit e mbitensionit, prizat, spinat, portollampat, kutitë e bashkimit), për një voltazh që nuk i kalon 1000 volt.	CTH, përveç kreut 8538; ose montim i produkteve gjysëm-përçuese
ex 8537 10	Gjysëm-përçues inteligjent i bazuar në modul motorik për kontrollin e motorëve elektrikë me karakteristika të ndryshueshme të shpejtësisë së voltazhit < 1 000 V	CTH, përveç kreut 8538; ose montim i produkteve gjysëm-përçuese
8541	Diodat, tranzistorët dhe pajisjet e ngjashme gjysëm-përçuese; pajisjet gjysëm-përçuese të ndjeshme nga drita, përfshi pila fotovoltaike, nëse janë apo jo të montuara në module ose në panelë; diodat emëtuese të dritës; kristale të montuara piezoelektrike.	Siç specifikohet për krerë të ndarë
ex 8541 (a)	Module ose panele fotovoltaike me kristale silici	CTH
ex 8541 (b)	Të tjera	CTH ose montim i produkteve gjysëm-përçuese
8542	Qarqe të integruar elektronikë	CTH ose montim i produkteve gjysëm-përçuese

SEKSIONI XVIII

INSTRUMENTAT DHE APARATET OPTIKE, FOTOGRAFIKE, KINEMATOGRAFIKE, MATËSE, KONTROLLI, PREÇIZIONI, MJEKËSORE OSE KIRURGJIKALE; ORËT E TE GJITHA LLOJEVE; INSTRUMENTAT MUZIKORË; PJESËT DHE PLOTËSUESIT E TYRE

KAPITULLI 90

Instrumentat dhe aparatet optike, fotografike, kinematografike, matëse, kontrolli, preçizioni, mjekësore ose kirugjikale; pjesët dhe plotësuesit e tyre

Përkufizim i 'montimit të produkteve gjysëm-përçuese' për qëllim të krerëve 9026 dhe 9031 "Montim i produkteve gjysëm-përçuese' do të thotë një ndryshim nga çipat, diodat dhe produktet e tjera gjysëm-përçuese në çipa, dioda dhe produkte të tjera gjysëm-përçuese që paketohen ose montohen në një mbështetës për lidhje ose fillimisht lidhen pastaj montohen. Montimi i produkteve gjysëm-përçuese nuk do të konsiderohet si operacion minimal.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
9026	Instrumentet dhe aparatet për matjen ose kontrollin e rrjedhjes, nivelit, presionit ose variablave të tjera të lëngjeve ose gazeve (psh, rrjedhësmatësat, nivelmatësat, manometrat, nxehtësimatësat), përjashto instrumentet dhe aparatet e kreut 9014, 9015, 9028, apo 9032.	CTH, përveç kreut 9033; ose montim i produkteve gjysëm-përçuese
9031	Instrumentat matës ose kontrollues, pajisje dhe makina, jo të specifikuara ose të papërfshira diku tjetër në këtë Kapitull; projektorët e profilit.	CTH, përveç kreut 9033; ose montim i produkteve gjysëm-përçuese

KAPITULLI 91

Orët, orët e dorës dhe pjesët e tyre

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 9113	Rripa orësh dhe byzylykë orë, dhe pjesët e tyre, prej tekstili.	CTH

SEKSIONI XX

ARTIKUJ TË NDRYSHËM TË PRODHUAR

KAPITULLI 94

Mobileritë; krevatët, dyshekët, mbajtëset e dyshekëve, jastëqet dhe shtresa të ngjashme të mbushura; llambat dhe pajime ndriçimi, jo të përfshira apo të specifikuara dikutjetër; shenjandriçuese, pllakatandriçueseemrashdhetë ngjashmet e tyre; ndërtesat e parafabrikuara

Shenim i Kapitullit

Për qëllime të rregullave të origjinës të cilat i referohen ndryshimit të klasifikimit (psh ndryshimit të kreut ose ndryshimit të nënkreut), ndryshimet që rezultojnë nga ndryshimi i përdorimit nuk do të konsiderohen si dhënës origjine.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 9401 and ex 9403	Ndenjëset prej qeramike (ndryshe nga ato të kreut 9402), të konvertueshme ose jo në krevate, dhe mobilje të tjera, dhe pjesët e tyre, të dekoruara.	CTH
ex 9405	Llamba qeramike dhe plotësues ndriçimi prej qeramike, ku përfshihen projektorët dhe ndriçuesit projektorë dhe pjesët e tyre, të cilat nuk janë përfshirë apo specifikuar në vend tjetër, të dekoruara; shenjat ndriçuese, pllakat ndriçuese të emrave dhe të ngjashmet e tyre, të cilët kanë një burim drite të fiksuar të përhershëm, që nuk janë specifikuar apo përmendur në vend tjetër, të dekoruar	CTH

ANEKSI 22-11

Shënimet prezantuese dhe lista e punimit apo e përpunimit që kërkohen për t'u kryer mbi materialet jo-origjinuese në mënyrë që produkti i prodhuar të marrë statusin origjinues

PJESA I

SHËNIMET PREZANTUESE

Shënimi 1:

Lista jep kushtet e kërkuara për të gjitha produktet që ato do të konsiderohen si të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të Nenit 123

Shënimi 2:

2.1 Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e përftuar. Kolona e parë jep numrin e kreut ose të kapitullit të përdorur në Sistemin e Harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre ose kapitull. Për secilën hyrje në dy kolonat e para, specifikohet një rregull në kolonën 3 ose 4. Në disa raste, hyrja në kolonën e parë paraprihet nga një "ex", kjo tregon se rregullat në kolonat 3 ose 4 zbatohen vetëm tek pjesa e atij kreu sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2 Atje ku disa numra krerësh janë grupuar së bashku në kolonën 1 ose është dhënë një numër kapitulli dhe përshkrimi i produkteve në kolonën 2 është dhënë si rrjedhojë në terma të përgjithshëm, rregullat midis kolonës 3 ose 4 zbatohen për të gjitha produktet, të cilat nën Sistemin e Harmonizuar, janë klasifikuar në krerët e kapitullit ose në secilin nga krerët e grupuar sëbashku në kolonën 1.

2.3 Atje ku ndodhen rregulla të ndryshme në listë që zbatohen për produkte të ndryshme brenda një kreu, secila kryerrallë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut që mbulohet nga rregullat në kryerrallë në kolonën 3 ose 4.

2.4 Atje ku, për një hyrje në dy kolonat e para, specifikohet një rregull në të dyja kolonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë të zbatojë çdonjërin nga rregullat të dhënë në kolonën 3 ose atë të dhënë në kolonën 4. Nëse në kolonën 4 nuk jepet asnjë rregull për origjinën, atëherë duhet të zbatohet rregulli i dhënë në kolonën 3.

Shënimi 3:

3.1 Dispozitat e Nenit 61, në lidhje me produktet që kanë marrë statusin origjinues, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, do të zbatohen, pavarësisht nëse ky status ka qënë i marrë në ambientet e brendshme të fabrikës ku këto produkte janë përdorur ose të ndonjë fabrike tjetër në R.Sh ose në Bashkimin Evropian.

Shembull:
Një motor i kreut 8407, për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve jo-origjinuese të cilat mund të përfshihen në të nuk mund të kalojë 40% të çmimit të fabrikës/ex-works, bëhet nga "çelik tjetër i lidhur i formësuar nga farkëtimi" i kreut ex 7224.
Nëse ky farkëtim është kryer në vendin apo territorin përfitues nga një lingotë jo-origjinuese, ai ka marrë tashmë statusin origjinues për shkak të rregullit në listë për kreun ex 7224. Farkëtimi mund të vlerësohet si origjinues në llogaritjen e vlerës së motorit, pavarësisht nëse është bërë në të njëjtën fabrikë ose në një fabrikë tjetër në vendin apo territorin përfitues.Vlera e lingotës jo-origjinuese nuk merret në konsideratë kur shtohet vlera e materialeve jo-origjinues që janë përdorur.

3.2 Rregulli në listë përfaqëson masën minimale të punimit apo përpunimit të kërkuar, dhe kryerja e më shumë punimeve apo përpunimeve gjithashtu jep statusin origjinues; në të kundërt, kryerja e më pak punimeve apo përpunimeve nuk mund të japë statusin origjinues. Prandaj, nëse një rregull siguron që materiali jo-origjinues, në një nivel të dhënë të prodhimit, mund të përdoret, atëherë përdorimi i këtij materiali lejohet në një fazë më të hershme të prodhimit, dhe nuk lejohet në një fazë të mëvonshme të prodhimit.

3.3 Pa cënuar Shënimin 3.2, ku një rregull është "Prodhim nga materiale të çdo kreu", materialet e çdo kreu (krerëve)(edhe materialet e të njëjtit përshkrim dhe kre si produkti) mund të përdoren, megjithatë ato janë subjekt i çdo kufizimi specifik i cili gjithashtu mund të jetë të dhënë në rregull.

Megjithattë, shprehja "Prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshirë materiale të tjera të kreut..." ose "Prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshirë materiale të tjera të njëjtit kre me produktin" do të thotë se materialet e çdo kreu (krerëve) mund të përdoren, me përjashtim të atyre me të njëjtin përshkrim me produktin siç është dhënë në kolonën 2 të listës.

3.4 Kur një rregull në listë specifikon që një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë se mund të përdoren një ose më shumë materiale. Nuk kërkohet të përdoren të gjitha.

Shembull:

Rregulli për pëlhurat e krerëve 5208 deri në 5212 parashikon se mund të përdoren fibrat natyrore, dhe materialet kimike ndërmjet materialeve të tjera. Kjo nuk do të thotë që të dyja duhet të përdoren; është e mundur të përdoret njëra ose tjetra ose të dyja.

3.5 Kur një rregull në listë specifikon se një produkt duhet të prodhohet nga një material veçantë, kushti nuk parandalon përdorimin e materialeve të tjera, të cilat për shkak të natyrës së tyre t= q=n=sishme nuk mund ta përmbushin rregullin. (Shihni gjithashtu Shënimin 6.2 më poshtë në lidhje me tekstilet).

Shembull:

Rregulli për ushqime të përgatitura të kreut 1904, i cili specifikisht përjashton përdorimin e drithërave dhe derivateve të tyre, nuk parandalon përdorimin e kripërave minerale, lëndëve kimike dhe lëndëve të tjera të shtuara që nuk janë prodhime nga drithërat.
Megjithatë, kjo nuk zbatohet për produkte, të cilat, pavarësisht se nuk mund të prodhohen nga materiale të veçanta të specifikuara në listë, mund të prodhohen nga një material i së njëjtës natyre në një fazë më të hershme të prodhimit.

Shembull:

Në rastin e një neni për veshje të ex Kapitulli 62 të bërë nga materiale të paendura, nëse për këto artikuj lejohet përdorimi vetëm i fillit jo-origjinues, është e pamundur të fillohet nga pëlhura jo të endura – edhe nëse pëlhurat e paendura normalisht nuk mund të bëhen nga filli. Në raste të tilla, materiali fillestar normalisht duhet të jetë në një fazë para fillit – që është faza e fibrës.

3.6 Kur, në një rregull në listë, për vlerën maksimale të materialeve jo-origjinuese të cilat mund të përdoren, jepen dy përqindje, atëherë këto përqindje nuk mund të shtohen së bashku. Me fjalë të tjera, vlera maksimale e të gjitha materialeve jo-origjinues të përdorur nuk mund të kalojë kurrë përqindjen më të lartë të dhënë. Për më tepër, përqindjet individuale nuk mund të tejkalohen, në lidhje me materiale të veçanta tek të cilat ato zbatohen.

Shënimi 4:

4.1 Termi 'fibra natyrore' i përdorur në listë, i referohet fibrave ndryshe nga fibrat sintetike apo artificiale dhe është i kufizuar në fazat para se të kryhet tjerrja, duke përfshirë edhe mbetjet, dhe nëse nuk specifikohet ndryshe, përfshin fibrat të cilat janë gërhanur, krehur apo përpunuar ndryshe, por jo dredhur.

4.2 Termi "fibra natyrale" përfshin qime kali të kreut 0503, mëndafsh të krerëve 5002 dhe 5003, si edhe fibra leshi dhe qime të holla ose të ashpra të kafshëve të krerëve 5101 deri në 5105, fibra pambuku të krerëve 5201 deri në 5203, dhe fibra të tjera vegjetale të krerëve 5301 deri në 5305.

4.3 Termi "brumë tekstil", "materiale kimike" dhe "materiale për prodhim letre" janë përdorur në listë për të përshkruar materialet që nuk janë klasifikuar në Kapitujt 50 deri në 63, të cilat mund të përdoren për të prodhuar fibra artificiale, sintetike ose letre, apo fije.

4.4 Termi "fibra shtapel të bëra nga njeriu" përdoret në listë për t'iu referuar filamenteve artificiale ose sintetike, fibrave shtapel apo mbetjeve të krerëve 5501 deri në 5507.

Shënimi 5:

5.1 Aty ku, për një produkt të dhënë në listë, i referohet këtij Shënimi, kushtet e dhëna në kolonën 3 nuk do të zbatohen për ndonjë material tekstili bazë të përdorur në prodhimin e këtij produkti, dhe të cilat të marra së bashku përfaqësojnë 10% ose më pak të peshës totale të të gjitha materialeve bazë tekstili të përdorura. (Shihni gjithashtu Shënimet 5.3 dhe 5.4).

5.2 Megjithatë, toleranca e përmendur në Shënimin 5.1 mund të azbatohet vetëm në produktet e përziera të cilat janë bërë nga dy ose më shumë materiale tekstili bazë.

Të mëposhtmet janë materiale tekstili bazë:

— mëndafsh,

— lesh,

— qime të ashpra kafshësh,

— qime të holla kafshësh,

— qime kali,

— pambuk,

— materiale për prodhim letre dhe letra,

— liri,

— kërpi,

— juta dhe fibra tekstili prej lëvores,

— fibra sisali dhe fibra të tjera tekstile të gjinisë Agave,

— arra e kokosit, abaka, rami dhe fibra të tjera tekstile vegjetale,

— filamente sintetike të bëra nga njeriu,

— filamente artificiale të bëra nga njeru,

— filamente që përçonë rrymën elektrike,

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej polipropileni,

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej poliesteri,

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej poliamidi,

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej poliakrilonitrili,

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej poliimidi,

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej politetrafluoroetileni,

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej poli (fenileni sulfidi),

— fibra sintetike shtapel të bëra nga njeriu prej poly (vinil kloridi),

— fibra të tjera sintetike shtapel të bëra nga njeriu,

— fibra artificiale shtapel të bëra nga njeriu prej vizkoze,

— fibra të tjera artificiale shtapel të bëra nga njeriu,

— fije të bëra nga poliuretani i segmentuar me segmente fleksibël të polieterit, të përdredhur ose jo,

— fije të bëra nga poliuretani i fragmetizuar me segmente fleksibël të poliesterit, të përdredhuar ose jo,

— produktet e kreut 5605 (fill i metalizuar) që përfshin shirita që përbëhen nga një bazë prej flete alumimini ose një bazë filmi plastik, nëse janë apo jo të veshura me pluhur alumini, të një gjerësie jo më shumë se 5 mm, që me anë të ngjitësit transparent dhe të ngjyrosur vendoset mes dy shtresave të filmit plastik,

— produkte të tjera të kreut 5605.

Shembull:
Një fill i kreut 5205 i bërë nga fibra pambuku të kreut 5203 dhe fibrave shtapël sintetike të kreut 5506, është një fill i përzier. Prandaj, fibrat shtapel sintetike jo-origjinuese të cilat nuk përmbushin rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materiale kimike ose brumë tekstili) mund të përdoren, me kusht që pesha e tyre totale të mos kalojë 10% të peshës së fillit.

Shembull:

Një pëlhurë e leshtë e kreut 5112 e bërë nga fill leshi i kreut 5107 dhe fill sintetik prej fibrave shtapel sintetike të kreut 5509 është një pëlhurë e përzier. Prandaj, filli sintetik i cili nuk përmbush rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materiale kimike ose brumë tekstili) ose filli i leshtë i cili nuk përmbush rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga fibra natyrore jo të gërhanura ose krehura ose ndryshe të përgatitura për tjerrje) ose një kombinim i të dyjave mund të përdoret, me kusht që pesha e tyre totale të mos kalojë 10% të peshës së pëlhurës.

Shembull:

Pëlhurë tekstile me xhufka e kreut 5802 e bërë nga fill pambuku t= kreut 5205 dhe pëlhurë pambuku të kreut 5210, është një produkt i vetëm i përzier nëse pëlhura e pambukut është në vetvete një pëlhurë e përzier e bërë nga fije të klasifikuara në dy krerë të veçantë, ose nëse fijet e pambukut të përdorura janë në vetvete përzierje.

Shembull:

Nëse pëlhura tekstile me xhufka është bërë nga fije pambuku të kreut 5205 dhe pëlhurë sintetike të kreut 5407, atëherë është e dukshme se fijet e përdorura janë dy materiale tekstile bazë të ndara dhe si rrjedhojë pëlhura tekstile me xhufka është një produkt i përzier.

5.3 Në rastin e produkteve që përfshijnë "fije të bëra nga poliuretani i segmentuar në segmente fleksibël të polieterit, të dredhura ose jo", kjo tolerancë është 20% në lidhje me këtë fill.

5.4 Në rastin e produkteve që pëfshijnë 'shirita që përbëhen nga një bazë prej flete alumimini ose një bazë filmi plastik, nëse janë apo jo të veshura me pluhur alumini, të një gjerësie jo më shumë se 5 mm, që me anë të ngjitësit transparent dhe të ngjyrosur vendoset mes dy shtresave të filmit plastik', kjo tolerancë është 30% në lidhje me këtë shirit.

Shënimi 6:

6.1 Aty ku, në listë i referohet këtij shënimi, materialet tekstile (me përjashtim të astarëve dhe nënlinjave), të cilat nuk përmbushin rregullin e listës në kolonën 3 për produktet e përbëra, mund të përdoren me kusht që ato të jenë të klasifikuara në një kre të ndryshëm nga ai i produktit dhe që vlera e tyre të mos kalojë 8% të çmimit ex-works të produktit

6.2 Pa cënuar shënimin 6.3, materialet të cilat nuk janë klasifikuar brenda kapitujve 50 deri 63, mund të përdoren lirshëm në prodhimin e produkteve tekstile, nëse përmbajnë apo jo tekstile.

Shembull:

Nëse një rregull në listë thotë që për një artikull të veçantë tekstili (të tillë si pantallonat) duhet përdorur fill, kjo nuk ndalon përdorimin e artikujve metalike të tilla, si butonat, për arsyen se butonat nuk janë të klasifikuara në kapitujt 50 deri 63. Për të njëjtën arsye, nuk ndalohet përdorimi i zinxhirëve, edhe pse zinxhirët normalisht përmbajnë tekstil.

6.3 Në rastet e zbatimit të rregullit të përqindjes, vlera e materialeve që nuk janë të klasifikuara brenda kapitujve 50 deri 63 duhet të merret parasysh kur llogaritet vlera e materialeve jo-origjinuese të përfshira në të.

Shënimi 7:

7.1 Për qëllime të krerëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, "proçeset specifike" janë si më poshtë:

a) distilimi në vakum;

b) ridistilimi nëpërmjet një procesi fraksionues tejet tërësor;

c) ndarja;

ç) riformimi;

d) ekstraktimi me anë të tretësve selektivë;

dh) proçesi që përbëhet nga të gjitha operacionet e mëposhtme : procesimi me acid sulfurik të përqendruar, oleum apo anhidrid sulfurik; neutralizimi me agjentë alkaline; dekolorizimi dhe pastrimi me baltë aktive natyrore, baltë të aktivizuar, boksit apo qymyr të aktivizuar;

e) polimerizimi;

ë) alkilizimi;

f) izomerizimi

7.2 Për qëllime të krerëve 2710, 2711 dhe 2712, "proçeset specifike" janë si më poshtë:

a) distilimi në vakum

b) ridistilimi nëpërmjet një prçcesi fraksionues tejet tërësor ([1]);

c) ndarja;

ç) riformimi ;

d) ekstraktimi me anë të tretësve selektivë;

dh) proçesi që përbëhet nga të gjitha operacionet e mëposhtme : procesimi me acid sulfurik të përqendruar, oleum apo anhidrid sulfurik; neutralizimi me agjentë alkaline; dekolorizimi dhe pastrimi me baltë aktive natyrale, baltë të aktivizuar, boksit apo qymyr të aktivizuar;

([1]) Shënim shtesë 5(b) i Kapitullit 27 të Nomenklaturës së Kombinuar

e) polimerizimi ;

ë) alkilizimi;

f) izomerizimi;

g) në lidhje me vajrat e rënda vetëm të kreut ex 2710, desulfurizmi me hidrogjen, që rezulton në një reduktim prej të paktën 85% të përmbajtjes së sulfurit në produktet e përpunuara (metoda ASTM D 1266-59 T);

gj) në lidhje me produktet vetëm të kreut 2710, deparafinimi përmes një proçesi ndryshe nga filtrimi;

h) për sa i përket vetëm vajrave të rënda të kreut ex 2710, trajtimi me hidrogjen në një presion më shumë se 20 bar dhe një temperaturë prej më shumë se 250°C, me përdorimin e një katalizatori, ndryshe nga procesi që të ndikojë desulfurizimin, kur hidrogjeni përbën një element aktiv në një reaksion kimik. Trajtimi i mëtejshëm me hidrogjen i vajrave lubrifikante të kreut 2710, (p.sh. hidropërfundim apo dekolorizim) me qëllim që, me specifikisht, të përmirësojë ngjyrën apo stabilitetin, megjithatë nuk do të konsiderohen sikur janë një proces specifik;

i) për sa i përket vetëm vajrave të karburanteve të kreut ex 2710, distilimi atmosferik, me kusht që më pak se 30% e këtyre produkteve të distilohet, ndaj volumit, duke përfshirë humbjet, në 300 °C, nëpërmjet metodës ASTM D 86;

j) përsa i përket vetëm vajrave të rënda të ndryshme nga vajrat e gazrave apo të karburanteve të kreut ex 2710, trajtimi me anë të një furçe shkarkimi elektrike me frekuence të lartë;

k) përsa i përket vetëm produkteve të papërpunuara bruto (të ndryshme nga xhelatina e naftës, ozokeriti, dyll linjiti ose dylli torfe, dyll parafine që përmbajnë ndaj peshës më pak se 0.75% vaj) vetëm të kreut ex 2712, të zhvajosura nëpërmjet kristalizimit të fraksionuar.

7.3 Për qëllime të krerëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, nuk japin statusin origjinues operacionet e thjeshta, si: pastrimi, kullimi, shkripëzimi, heqja e ujit, filtrimi, ngjyrosja, shënimi, përftimi i një përmbajtjeje sulfuri si rezultat i përzierjes së produkteve me përmbajtje të ndryshme sulfuri, ose çfarëdo kombinimi i këtyre operacioneve apo operacioneve të tjera të ngjashme.

PJESA II

LISTA E PUNIMIT OSE E PËRPUNIMIT QË KËRKOHET TË NDËRMERRET MBI MATERIALET JO-ORIGJINUESE ME QËLLIM QË PRODUKTI I PRODHUAR TË PËRFTOJË STATUSIN ORIGJINUES

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
Kapitulli 1	Kafshë të gjalla	Të gjitha kafshët e Kapitullit 1 duhet të jenë tërësisht të përftuara	
Kapitulli 2	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitujve 1 dhe 2 janë tërësisht të përftuara	
Kapitulli 3	Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme, molusqet dhe kafshët e tjera jovertebrore ujore	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 3 janë tërësisht të përftuara	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
ex Kapitulli 4	Produkte bulmeti; vezë të shpendëve; mjalt natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, jo të përfshira apo specifikuara diku tjetër; përveç:	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 4 janë tërësisht të përftuara	
0403	Dhallë, qumësht e krem i prerë, kos, kefir dhe qumësht e krem tjetër të fermentuar apo të acidifikuara, nëse janë ose jo të koncentruara apo që përmbajnë sheqer shtesë ose lëndë të tjera ëmbëlsuese apo lëndë aromatizuese apo që përmbajnë fruta, arra apo kakao shtesë	Prodhim në të cilin: - të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 4 janë tërësisht të përftuara - të gjitha lëngjet e frutave (përjashtuar ato të ananasit, qitros ose greipfrutit) të përdorura të kreut 2009 janë origjinuese, dhe -vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	—
ex Kapitulli 5	Produkte me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; përveç:	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 5 janë tërësisht të përftuara	
ex 0502	Qime dhe lesh të përgatitur të derrave ose derrave të egër	Pastrimi, disifektimi, ndarja dhe drejtimi i qimeve dhe leshit	
Kapitulli 6	Pemë dhe bimë të tjera, të gjalla; zhardhokë, rrënjë dhe të ngjashmet me to; lule të prera dhe gjethnaja zbukuruese	Prodhim në të cilin : - të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 6 janë tërësisht të përftuara, dhe - vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit	
Kapitulli 7	Zarzavate të ngrënshme dhe rrënjët dhe tuberat përkatës	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 7 janë tërësisht të përftuara	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
Kapitulli 8	Fruta dhe arra të ngrënshme; lëkura të agrumeve apo të pjeprave	Prodhim në të cilin: - të gjitha frutat dhe arrat e përdorura janë tërësisht origjinuese, dhe - vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	—
ex Kapitulli 9	Kafe, çaj, mate dhe erëza, përveç:	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 9 janë tërësisht të përftuara	
0901	Kafe, nëse është apo jo e pjekur ose e dekafeinizuar; lëvoret dhe lëkurat e kafesë; zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe në çfarëdo porcioni	Prodhime prej materialeve të çdo kreu	
0902	Çaj, nëse është ose jo i aromatizuar	Prodhim prej materialeve të çdo kreu	
ex 0910	Përzierje të erëzave	Prodhim prej materialeve të çdo kreu	
Kapitulli 10	Drithëra	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 10 janë tërësisht të përftuara	
ex Kapitulli 11	Produkte të industrisë bluajtëse; malt; niseshtetë; inuline; gluteni i grurit, përveç:	Prodhim në të cilin të gjitha drithërat, zarzavatet e ngrënshme, rrënjët e tuberat e kreut 0714 ose frutat të përdorura janë tërësisht të përftuara	
ex 1106	Miell, kokrriza e pluhur i zarzavateve të thara leguminoze të kreut 0713	Tharja dhe bluarja e perimeve leguminoze të kreut 0708	
Kapitulli12	Fara vajore dhe fruta me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimë industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 12 janë tërësisht të përftuara	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
1301	Llak; gomë natyrale, rrëshirat, gomë-rrëshirat e oleo-rrëshirat (psh, balsamet)	Prodhim në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura të kreut 1301 nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit	
1302	Lëngje e ekstrakte vegjetale; substanca pektike, pektinatet e pektatet; agar-agar e lëndë të tjera ngjitëse e trashëse, nëse janë ose jo të modifikuara, të rrjedhura nga produktet vegjetale		
	- Ngjitësa dhe trashësa, të të rrjedhura nga produktet vegjetale, të modifikuara	Prodhim nga ngjitësit dhe trashësit e pamodifikuar	
	- Të tjera	Prodhim në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit	
Kapitulli 14	Materiale vegjetale që përdoren për thurje; produkte vegjetale të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 14 janë tërësisht të përftuara	
ex Kapitulli 15	Vajra e yndyrna prej kafshëve ose vegjetale dhe produktet e ndarjes së tyre; yndyrna të përgatitura të ngrënshme; dyllrat prej kafshëve ose vegjetale, përveç:	Prodhim prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit	
1501	Dhjamë derri (përfshirë sallo) dhe dhjam shpendësh, ndryshe nga ai i kreut 0209 apo 1503:		
	- Yndyrna prej kockave ose mbetjeve	Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të krerëve 0203, 0206 ose 0207 ose të kockave të kreut 0506	
	- Të tjera	Prodhim prej mishi ose të brendshmeve të ngrënshme të derrit të kreut 0203 ose 0206 ose mishi dhe të brendshmeve të ngrënshme të shpendëve të kreut 0207	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
1502	Dhjami i gjedhëve, deleve apo dhive, ndryshe nga ato të kreut 1503		
	- Yndyrna prej kockave ose mbetjeve	Prodhim prej materialeve të çdo kreu, përveç atyre të krerëve 0201, 0202, 0204, ose 0206, ose kockave të kreut 0506	
	- Të tjera	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 2 janë tërësisht të përftuara	
1504	Dhjamra e vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut ose të gjitarëve detarë, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht:		
	- Fraksione të ngurta	Prodhim nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1504	
	- Të tjera	Prodhim në të cilin të gjithë materialet e përdorura të Kapitujve 2 dhe 3 janë tërësisht të përftuara	
ex 1505	Lanolinë e rafinuar	Prodhim prej yndyrave të leshit të papërpunuar të kreut 1505	
1506	Dhjamra dhe vajra të tjera me origjinë prej kafshëve e fraksionet e tyre, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht:		
	- Fraksione të ngurta	Prodhim nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1506	
	- Të tjera	Prodhim në të cilin të gjithë materialet e përdorura të Kapitullit 2 janë tërësisht të përftuara	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
1507 deri në 1515	Vajra vegjetale dhe fraksionet e tyre:		
	Vaj soje, kikiriku, palme, kopre, thelb palme, babasu, vaj tungu e oitika, dyllë mersine i japonesë, fraksionet e vajit të jojobës e vajra për përdorime teknike e industriale të ndryshme nga prodhimet e ushqimit për konsum njerëzor	Prodhim nga materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit	
	- Fraksione të ngurta, duke përjashtuar ato të vajit jojoba	Prodhim prej materialeve të tjera të kreut 1507 deri në 1515	
	- Të tjera	Prodhim në të cilin të gjitha materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht të përftuara	
1516	Yndyrna me origjinë prej kafshëve apo vegjetale dhe vajra dhe fraksionet e tyre, tërësisht apo pjesërisht të hidrogjenizuara, të interesterifikuara, të riesterifikuara apo të elaidinifikuara (të gliceridifikuara), nëse janë ose jo të rafinuara, por jo më tej të përgatitura	Prodhim në të cilin: - të gjitha materialet të përdorura të Kapitullit 2 janë tërësisht të përftuara, dhe - të gjithë materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht të përftuara. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren	
1517	Margarinë; përzierjet apo përgatitjet e ngrënëshme te vajrave dhe dhjamrave vegjetale apo prej kafshëve apo të fraksioneve të yndyrnave të ndryshme të këtij Kapitulli, përveç yndyrnave të ngrënshme apo të fraksioneve të tyre të kreut 1516	Prodhim në të cilin: - të gjitha materialet të përdorura të Kapitullit 2 dhe 4 janë tërësisht të përftuara. dhe - të gjithë materialet bimore të përdorura janë tërësisht të përftuara. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
Kapitulli 16	Ushqime të përgatitura prej mishi, prej peshku ose prej krustacëve, prej molusqeve apo prej kafshëve të tjera jo vertebrore ujore	Prodhim: - prej kafshëve të Kapitullit 1, dhe/ose - në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 3 janë tërësisht të përftuara	—
ex Kapitulli 17	Sheqerna dhe konfeksione të ëmbëlsirave, përveç:	Prodhim nga materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit	
ex 1701	Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri ose nga panxhar sheqeri dhe saharoza kimikisht e pastër, në gjëndje të ngurtë, të aromatizuar ose me lëndë ngjyruese	Prodhim në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
1702	Sheqerna të tjera, përfshi laktozën, maltozë, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra, në gjendje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lëndë aromatizuese e ngjyruese shtesë; mjaltë artificial, nëse është ose jo i përzier me mjaltë natyral; karamel :		
	- Maltoza dhe fruktoza kimikisht të pastra	Prodhim prej materialeve të çdo kreu, përfshi materiale të tjera të kreut 1702	
	- Sheqerna të tjera në forma të ngurta, me shtesë aromatizuesi apo ngjyruesi	Prodhim në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
	- Të tjera	Prodhim në të cilin të gjithë materialet e përdorura janë origjinuese	
ex 1703	Melasat e rezultuara nga esktraktimi ose rafinimi i sheqerit, me shtesë aromatizuesi apo ngjyruesi	Prodhim në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
1704	Produkte me bazë sheqeri (përfshi çokollatën e bardhë) që nuk përmbajnë kakao	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit , dhe - në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	—
Kapitulli18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit , dhe - në të cilën vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	—
1901	Ekstrakt malti; përgatitje ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtesë ose ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao ndaj peshës më pak së 40% të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të paspecifikuara ose të papërfshira diku tjetër; përgatitje ushqimore të mallrave të kreut 0401 deri në 0404, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao ndaj peshës më pak së 5 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të papërfshira ose të paspecifikuara diku tjetër		
	- Ekstrakt malti	Prodhim nga drithëra të Kapitullit 10	
	- Të tjera	Prodhim: - nga materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe	—

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
		- në të cilin vlera e materialeve të përdorura të secilit nga Kapitujt 4 dhe 17 nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
1902	Brumrat, nëse janë apo jo të gatuar apo të mbushur (me mish apo me substanca të tjera) ose të përgatitur ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona petë, lazanjë, gnocchi, ravioli, kaneloni; couscous nëse janë ose jo të përgatitur :		
	- Me përmbajtje në peshë 20% ose më pak të mishit, të brendshmeve të mishit, peshkut, krustacëve apo molusqeve	Prodhim në të cilin të gjithë drithërat dhe nënproduktet e tyre (përjashtuar miellin durum dhe nënproduktet e tij) të përdorura janë tërësisht të përftuara	
	- Me përmbajtje në peshë më shumë se 20% të mishit, të brendshmeve të mishit, peshkut, krustacëve ose molusqeve	Prodhim në të cilat : - të gjitha drithërat dhe nënproduktet e tyre (përveç miellit durum dhe nënprodukteve të tij) të përdorura janë tërësisht të përftuara, dhe - të gjitha materialet e Kapitullit 2 dhe 3 të përdorura janë tërësisht të përftuara	
1903	Tapioka dhe zëvëndësuesit e tij përgatitur nga niseshteja, në formën e fetëzave, margaritarëve, topthash apo në forma të ngjashme	Prodhim prej materialeve të çdo kreu, përveç niseshtesë së patates të kreut 1108	
1904	Ushqime të përgatitura të fituara prej bymimit apo pjekjes së drithërave apo të produkteve të tyre (p.sh. fetëza drithi); drithërat (ndryshe nga misri (si drith)) në formë kokrre apo fetëzash apo kokrra të punuara ndryshe (përveç miellit e kokrrizave të miellit), të paragatuara apo të përgatitura ndryshe, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër	Prodhim: - nga materiale të çdo kreu, përveç atyre të kreutt 1806 - në të cilin të gjitha drithërat dhe mielli i përdorur (përveç miellit durum dhe misrit Zea indurata, dhe derivateve të tyre) janë tërësisht të përftuara, dhe	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
		- në të cilin vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorura nuk kalon 30 % të çmimit ex-works të produktit	
1905	Bukë, torta, kek, biskota dhe produkte të tjera të furrëtarit, nëse përmbajnë ose jo kakao; nafore, hapet (kapsulat) bosh të një lloji të përshtatshëm për qëllime farmaceutike, vaferat me shtresa, letër orizi dhe produkte të ngjashme	Prodhim prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të Kapitullit 11	
ex Kapitulli 20	Përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave ose pjesëve të tjera të bimëve, përveç :	Prodhim në të cilat të gjithë frutat, arrat ose zarzavatet e përdorura janë tërësisht të përftuara	
ex 2001	Zhardhokë, patate e ëmbël dhe pjesë të tjera të ngrënshme të ngjashme të bimëve, me përmbajtje 5% ose më shumë sipas peshës të niseshtesë, të përgatitura ose të ruajtura në uthull ose në acid acetik	Prodhim prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit	
ex 2004 dhe ex 2005	Patate në formë mielli, mielli të trashë ose copëzash, të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga në uthull ose në acid acetik	Prodhim prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit	
2006	Perime, fruta, arra, lëkura frutash e pjesë të tjera të bimëve, të ruajtura në sheqer (të thara, të sheqerosura ose të kristalizuara)	Prodhim në të cilën vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorura nuk kalon30% të çmimit ex-works të produktit	
2007	Reçelet, peltet e frutave, marmalatat, pure frutash apo arrash dhe brum frutash apo arrash, fituar nëpërmjet gatimit, nëse përmbajnë apo jo sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç, atij të produktit , dhe - në të cilin vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorura nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
ex 2008	- Arra, që nuk përmbajnë sheqer apo alkool shtesë	Prodhim në të cilin vlera e të gjitha arrave dhe vajrave prej farave bimore origjinuese të përdorura të krerëve 0801, 0802 dhe 1202 deri në 1207 të kaloi 60% të çmimit ex-works të produktit	
	- Gjalp kikiriku; përzierje të bazuara në drithëra; zemra palme; misër (drith)	Prodhim nga materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit	
	- Të tjera, përveç frutave dhe arrave të gatura ndryshe nga me avull ose vlim me ujë, duke mos përmbajtur sheqer shtesë, të ngrira	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilin vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorura nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
2009	Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) dhe lëngje zarzavatesh, të pafermentuara dhe që nuk përmbajnë lëndë alkoolike shtesë, nëse përmbajnë ose jo sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilin vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorura nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
ex Kapitulli 21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme, përveç:	Prodhim prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit	
2101	Ekstrakte, esenca dhe koncentrate, të kafesë, çajit apo matesë dhe përgatitjet me bazë të këtyre produkteve apo me bazë të kafesë, çajit apo matesë; çikore e pjekur dhe zëvendësuesit e tjerë të pjekur të kafesë dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej tyre	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
		- në të cilat të gjitha çikoret e përdorura janë tërësisht të përftuara	
2103	Salca dhe përgatitje prej tyre; erëza të përziera dhe aromatizues të përzier; miell senapi dhe mustardë senapi e përgatitur		
	- Salca dhe përgatitje prej tyre; erëza të përziera dhe aromatizues të përzierë	Prodhim prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit. Megjithatë, mielli i senapit ose mustarda e përgatitur mund të përdoren	
	- Miell senapi dhe senap i përgatitur	Prodhim prej materialeve të çdo kreu	
ex 2104	Supa dhe lëngje të mishit si dhe përgatitjet prej tyre	Prodhim prej materiale të çdo kreu përveç zarzavateve të përgatitura ose të ruajtura të kreut 2002 deri në 2005	
2106	Përgatitje ushqimore të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilin vlera e materialeve të secilit prej Kapitujve 4 dhe 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
ex Kapitulli 22	Pije, pije alkoolike dhe uthulla; përveç:	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilin i gjithë rrushi ose materiale të prejardhura prej rrushi të përdorura janë tërësisht të përftuara	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
2202	Ujëra, përfshirë ujëra minerale e ujra të gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese apo aromatizuese shtesë, dhe pije të tjera jo-alkolike, pa përfshirë lëngun e frutave ose të zarzavateve të kreut 2009	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, - në të cilin vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorura nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit, dhe - në të cilin i gjithë lëngu i frutave i përdorur (përveç lëngut të ananasit, qitros dhe grejpfrutit) është origjinues	—
2207	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% vol apo më e lartë; alkool etilik dhe alkoole të tjera, të denatyruara, të çdo lloj force	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç kreut 2207 ose 2208, dhe - në të cilin i gjithë rrushi ose materiale të prejardhura prej rrushi të përdorura janë tërësisht të përftuara, ose nëqoftëse të gjitha materialet e tjera të përdorura janë tashmë origjinuese, pije alkolike, 'arrack' mund të përdoret në një kufi deri në 5% sipas volumit	
2208	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak së 80 % vol; pije alkoolike, likere dhe alkoole të tjera	Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç kreut 2207 ose 2208, dhe - në të cilin i gjithë rrushi ose materiale të prejardhura prej rrushi të përdorura janë tërësisht të përftuara, ose nëqoftëse të gjitha materialet e tjera të përdorura janë tashmë origjinuese, pije alkolike, 'arrack' mund të përdoret në një kufi deri në 5% sipas volumit	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
ex Kapitulli 23	Mbetje dhe kthime nga industritë ushqimore; tagjia e përgatitur për kafshët; përveç :	Prodhim prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit	
ex 2301	Ushqim balene, miell, ushqim dhe toptha prej peshku ose krustacësh, molusqesh e kafshëve të tjera jovertebrore ujore, të papërshtatshme për konsum njerëzor	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorura janë tërësisht të përftuara	
ex 2303	Mbetjet prej prodhimeve të niseshtesë së misrit (përjashtuar lëngjet e konçentruar së tepërmi), me përmbajtje proteine të llogaritur ndaj produktit të thatë që tejkalon 40% ndaj peshës	Prodhim në të cilin i gjithë misri i përdorur është tërësisht i përftuar	
ex 2306	Vaj i trashë dhe mbetje të tjera të forta, përfituar nga përpunimi i vajit të ullirit, që përmban më shumë se 3% vaj ulliri	Prodhim në të cilin të gjithë ullinjtë e përdorur janë tërësisht të përftuar	
2309	Përgatitjet e një lloji të përdorur në ushqimin e kafshëve	Prodhim në të cilin: - të gjithë drithrat, sheqeri ose melasat, mishi ose qumështi i përdorur janë origjinuese, dhe - të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorura janë tërësisht të përftuara	—
ex Kapitulli 24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit; përveç :	Prodhim në të cilin të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 24 janë tërësisht të përftuara	
2402	Puro, cigare dhe cigarillos, prej duhanit apo prej zëvendësuesve të duhanit	Prodhim në të cilin të paktën 70% sipas peshës së duhanit të papërpunuar ose mbetjeve të duhanit të kreut 2401 të përdorur është origjinues	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
ex 2403	Duhan për tymosje	Prodhim në të cilin të paktën 70% sipas peshës së duhanit të papërpunuar ose mbetjeve të duhanit të kreut 2401 të përdorur është origjinues	
ex Kapitulli 25	Kripëra; sulfure; okside dhe gurë, materiale suvatuese, gëlqere e çimento; përveç:	Prodhim nga materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit	
ex 2504	Grafit natyral kristalin, me përmbajtje karbon të pasuruar, pastruar dhe bazë (natyral)	Pasurimi i karbonit në grafit, pastrimi e bluarja e grafiteve kristaline të papërpunuar	
ex 2515	Mermer thjesht i prerë, nga sharrimi ose ndryshe në blloqe ose pllaka në formë drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), të një trashësie që nuk kalon 25 cm	Prerje, me sharrë ose ndryshe, të mermerit (edhe nëse tashmë është i prerë) me një trashësi që kalon 25 cm	
ex 2516	Granit,porfir, bazalt, shkëmbinjtë ranor dhe gurë të tjerë monumentalë dhe ndërtimore, të prera thjesht nga sharrimi ose ndryshe, në blloqe ose pllaka në formë drejkëndëshe (përfshirë edhe katrorin), të një trashësie që nuk kalon 25 cm	Prerje, me sharrë ose ndryshe, të gurit (edhe nëse tashmë është i prerë) me një trashësi qëkalon 25 cm	
ex 2518	Dolomite të kalçinuara	Kalçinimi i dolomiteve të pakalçinuar	
ex 2519	Karbonat magnezi natyral i bluar (magnezit), në konteinerë hermetikë të mbyllur, dhe okside magnezi, nëse janë ose jo të pastra, të ndryshëm nga magnezi i shkrirë ose magnezi i vjetëruar (skorje)	Prodhime prej materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit. Megjithatë, karbonati i magneziumit natural (magnezitet) mund të përdoret	
ex 2520	Gipse të përgatitur në mënyrë për dëntiste	Prodhim në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit	
ex 2524	Fibra natyrale asbesti	Prodhime prej koncentrati asbesti	

Kreu i Sistemit të Harmonizuar 2012	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi, i kryer mbi materialet jo-origjinuese, që japin statusin origjinues	
(1)	(2)	(3)	(4)
ex 2525	Pluhur mika	Bluarje të mikas ose të	
ex 2530	Bojra dheu, të kalçinuara ose të pluhrëzuara	Kalçinimi ose bluarja e bojrave të dheut	
Kapitulli 26	Xeherorët, zgjyrat dhe hiri	Prodhim prej materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit	
Kodi NK, sasia neto, vlera (D)	Në rastin e vendosjes së mallrave jo shqiptare nën përpunimin aktiv, tregoni sasinë e disponueshme. Ky element të dhënash do të sigurohet nga zyra doganore e vendosjes nën regjim

Elementë specifike të të dhënave RPP	**Komente**
Rasti i RPP EX/IM	
Vendi i përpunimit (F)	—
Vendi i ri-importimit (F)	—
Mallrat ekuivalente (F)	—
Numri i deklaratës doganore PP (D)	Kur një deklaratë doganore për PP i referohet INF, ky element të dhënash sigurohet nga zyra dognaore e eksportit/vendosjes nën regjim.
Identifikimi i mallrave (D)	(D) përveç kur mallrat ekuivalente mund të përdoren. Kur një deklaratë doganore i referohet INF, ky element të dhënash mund të sigurohet nga zyra doganore e eksportit /vendosjes nën regjim.
Kodi NK, sasia neto (D)	Në rastin e vendosjes së mallrave shqiptare nën përpunim pasiv, tregoni sasinë e vlerësuar. Ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore e eksportit/vendosjes nën regjim.
Data e fundit e ri-importimit të produkteve të përpunuara(D)	Kur deklarata doganore i referohet INF, ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore e eksportit/vendosjes nën regjim.

Rezultati i daljes (D)	Kur një deklaratë doganore i referohet INF, ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore e daljes.
Data e ri-importimit të produkteve të përpunuara (D)	Kur një deklaratë doganore i referohet INF, ky element të dhënash do të sigurohet nga zyra doganore për çlirimin në qarkullim të lirë.
Hollësitë e deklaratës (ave) doganore për çlirim në qarkullim të lirë (F)	Kur një deklaratë doganore për çlirim në qarkullim të lirë i referohet INF, ky element të dhënash do të sigurohet nga zyra doganore për çlirimin në qarkullim të lirë.
Kodi NK, sasia neto, vlera (D)	Në rastin e ri-importit të produkteve të përpunuara, tregoni sasinë e produkteve të përpunuara të cilat mund të ri-importohen nën përpunimin Pasiv. Ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore për çlirimin në qarkullim të lirë.
Rasti i PP IM/EX	
Importi paraprak i produkteve të përpunuara (F)	Ky element të dhënash do të sigurohet nga zyra doganore për çlirimin në qarkullim të lirë. (duhet të sigurohet garanci)
Data e fundit e vendosjes së mallrave shqiptare, të cilat janë zëvendësuar nga mallra ekuivalente nën përpunim pasiv (F)	Kur një deklaratë doganore i referohet INF, ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore për çlirimin në qarkullim të lirë.
Data e vendosjes nën regjim të mallrave shqiptare, të cilat janë zëvendësuar nga mallra ekuivalente nën përpunim pasiv (D)	Kur një deklaratë doganore i referohet INF, ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore e eksportit/vendosjes nën regjim.

Kodi NK, sasia neto, vlera (D)	Në rastin e vendosjes së mallrave shqiptare, të cilat janë zëvendësuar nga mallra ekuivalntë, nën përpunimin pasiv, tregoni sasinë e mallrave shqiptare të cilat duhet të vendosen nën përpunimin pasiv. Kur një deklaratë doganore i referohet INF, ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore e eksportit/vendosjes nën regjim.
Rezultati i daljes (D)	Kur një deklaratë doganore i referohet INF, ky element të dhënash sigurohet nga zyra doganore e daljes.

Seksioni B

Shkëmbimi standard i informacionit (INF) ndërmjet autoriteteve doganore kërkohet por elementët e të dhënave INF akoma nuk janë të disponueshme në sistemin elektronik lidhur me INF

(1) Autoriteti doganor përgjegjës referuar Nenit 95(1) të Kodit ka kërkuar një INF ndërmjet autoriteteve doganore në përputhje me Nenin 552(2) sepse ka lindur një borxh doganor në përputhje me Nenet 72(1)(a) ose 74(1) të Kodit për produktet e përpunuara të cilat ishin përftuar nën përpunim aktiv IM/EX. Llogaritja e shumës së detyrimit të importit do të bëhet në përputhje me Nenin 81(3) të Kodit, por autoriteti doganor përgjegjës nuk ka informacion mbi mallrat të cilat ishin vendosur nën përpunimin aktiv IM/EX.

(2) Autoriteti doganor përgjegjës referuar Nenit 95(1) të Kodit ka kërkuar një INF ndërmjet autoriteteve doganore në përputhje me Nenin 552(2) sepse ka lindur një borxh doganor sipas Nenit 72(1)(a) ose 74(1) të Kodit për produktet e përpunuara të cilat ishin përftuar nën përpunimin aktiv IM/EX dhe janë të zbatueshme Masat e Politikës Tregtare .

(3) Në situatat e mbuluara nga pikat 1 ose 2 më sipër, autoriteti doganor përgjegjës siguron elementet e të dhënave të mëposhtme:

Elementë të përbashkëta të të dhënave	**Komente**
Tipi i kërkesës (D)	Proçedura duhet të identifikohet (PA ose PA CPM). Elementi i të dhënave "Tipi i kërkesës" është i nevojshëm vetëm në rastet kur deklarata doganore nuk i referohet INF.
Autoriteti doganor përgjegjës sipas Nenit 95(1) të Kodit (D)	Kodi COL mund të përdoret për qëllime identifikimi
Numri i autorizimit(D)	—
CPM (F)	
Zyra doganore mbikqyrëse e me marrjes së kërkesës (D)	Kodi COL mund të përdoret për qëllime identifikimi
Përshkrimi i mallrave ose produkteve të përpërpunuara për të cilat është kërkuar INF (D)	—
Kodi NK, sasia neto, vlera (D)	
MRN (F)	
Shënime (F)	Mund të shënohet çdo informacion shtesë

Zyra doganore mbikqyrëse që merr kërkesën do të bëjë të disponueshme elementët e të dhënave të mëposhtëm:

Elemente specifike të të dhënave PA IM/EX	**Komente**
Shuma e detyrimit të importit do të plotësohet në llogaritë dhe do t'i njoftohet debitorit në përputhje me Nenin 81(3) të Kodit (F)	—
Hollësi të nevojshme për zbatimin e masave të politikës tregtare (F)	—
Numri INF (D)	Numër unik i dhënë nga zyra doganore mbikqyrëse [psh PA/123456/AL + nr. autorizimit (nr RIOE është pjesë e numrit të autorizimit)]
MRN (F)	—

ANEKSI 71-06

Informacioni për t'u dhënë në dokumentin e mbylljes

a) hollësi reference të autorizimit;
b) sasia e çdo tipi mallrash të cilat janë vendosur nën regjimin e posaçëm në lidhje me të cilën pretendohet mbyllja;
c) kodi NK i mallrave të cilat janë vendosur nën regjimin e posaçëm;
ç) Niveli i detyrimeve të importit të detyrueshme për mallrat e vëna nën regjimin e posaçëm, dhe vlera e tyre doganore kur është e zbatueshme;
d) të dhënat e deklaratave doganore që i vënë mallrat nën regjimin e posaçëm;
dh) tipi dhe sasia e produkteve të përpunuara ose e mallrave të vendosura nën regjim dhe të dhënat e deklaratës doganore pasuese ose e ndonjë dokumenti tjetër në lidhje me mbylljen e regjimit;
e) kodi NK dhe vlera doganore e produkteve të përpunuara nëse metoda e matjes sasiore përdoret për qëllimin e mbylljes/shkarkimit;
ë) koefiçienti i shfrytëzimit;
f) shuma e detyrimit të importit për t'u paguar. Kur kjo shumë i referohet aplikimit të Nenit 550(4) duhet të specifikohet;
g) periudhat për mbylljen.

ANEKSI 72-03

Vërtetimi TC11

Kërkesat e përbashkëta për të dhënat

1) Vendi, emri dhe numri i referencës së zyrës doganore të destinacionit;
2) Tipi i deklaratës së transitit;
3) Data e regjistrimit nga zyra doganore e nisjes;
4) MRN (Master Reference Number/Numri Kryesor i Lëvizjes) i regjistruar;
5) Vendi, emri dhe numri i referencës së zyrës doganore të nisjes;
6) Vendi dhe data e lëshimit të vërtetimit;
7) Nënshkrimi dhe vula zyrtare e zyrës doganore të destinacionit

ANEKSI 72-04

VEPRA ARTI, ANTIKAT DHE PJESË TË KOLEKSIONISTËVE

Për qëllim të Nenit 679:

a) me "vepra arti" do të kuptojmë:
- fotografitë, kolazhet dhe pllakat e ngjashme dekorative, piktura dhe vizatime të bëra krejtësisht me dorë nga artisti, të ndryshme nga planet dhe pikturat e inxhinierisë arkitekturale, industriale, tregtare, topografike ose për qëllime të ngjashme, artikuj të përpunuar të dekoruar me dorë, skenografi teatrale, copë për sfondin e studiove ose copë e ngjashme me pëlhurën e pikturuar (kodi NK 9701).

- gdhendjet origjinale, gravurat dhe litografitë, që janë gdhendje(gjurmë) në numër të reduktuar, të bëra drejtpërsëdrejti në bardh e zi ose me ngjyra, të një ose disa pllakateve të ekzekutuara krejtësisht me dorë nga artisti, që nuk marrin paraysh procesin ose materialin e përdorur nga ai, por duke mos përfshirë asnjë proces mekanik ose fotomekanik (kodi NK 9702 00 00).

- skulpturat dhe statujat origjinale, në çdo material, me kusht që ato të jenë krejtësisht të bëra nga një artist; casts i skulpturës, prodhimi i të cilëve kufizohet në tetë kopje dhe është i mbikqyrur nga artisti ose pasardhësi i tij in title (kodi NK 9703 00 00).

- sixhade (kodi NK 5805 00 00) të bëra me dorë, bazuar në vizatime origjinale të një artisti, me kusht që të mos ketë më shumë se tetë kopje për secilën.

- pjesë të shkëputura qeramike të bëra me dorë, të kufizuara në tetë kopje që kanë nënshkrimin e artistit ose të studios, të ndryshme nga artikujt të bizhuterisë, të arit dhe argjendit (wares).

- fotografi të marra nga artistë, të stampuara nga artisti ose nën mbikqyrjen e tij, të nënshruara dhe në një numër të kufizuar prej 30 copësh, duke përfshirë të gjitha përmasat dhe kornizat.

b) me "pjesë të koleksionistëve" do të kuptojmë:

- pullat postare ose pullat fiskale, vulat postare, zarfat e ditës së parë, letërshkrimet postare dhe të ngjashmet e tyre, të vulosura ose të pavulosura që nuk janë dalje të ligjshme dhe që nuk parashikohet të përdoret për një dalje të ligjshme (kodi NK 9704 00 00),

- koleksionet dhe pjesë të koleksionistëve me interes zoologjik, botanik, mineralogjik, anatomik, historik, arkeologjik, paleontologjik, etnografik ose numizmatik (kodi NK 9705 00 00),

c) me "antika" do të kuptojmë objekte të tjera, të ndryshme nga veprat e artit ose pjesë të koleksionistëve, të cilat janë më shumë se 100 vjet të vjetra (kodi NK 9706 00 00).

ANEKSI 13

APLIKIMI DHE FORMA AUTORIZIMIT PËR MAGAZINË DOGANORE PRIVATE (DUTY FREE SHOPS)

Aplikimi për të përfituar autorizimin për magazinë doganore private

(duty free shops)

1. Aplikuesi, Numri i Identifikimit, Informacionet e kontaktit:

……
……

……
……

……
……

2. Vendi i saktë që synohet të përdoret si dyqanit "duty free shops":

……
……

……
……

……
……

3. Autorizimi/et e dhëna për regjime doganore:

……
……

4. Tipi i magazines për të cilën bëhet kërkesa:

……
……

5. Procedurat për:

a) futjen e mallrave:

……
……

b) vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave të futura:

……
……

c) ri eksportimi i mallrave të futura:

……
……

6. Përcaktimi i nevojes për hapjen e dyqanit "duty free shops":

……
……

7. Pershkrimi i regjistrave/inventarit të stokut të mbajtura ose që planifikohen dhe vendi ku ato mbahen ose do të mbahen:

……
……

8. Periudha mesatare e magazinimit:

……
……

9. Lloji i mallrave:

……
……

……
……

……
……

……
……

10. Zyra doganore mbikqyrëse:

……

11. Lista e dokumenteve shoqëruese bashkëngjitur:

……
……

……
……

……
……

……
……

Data: ……

Emri Mbiemri, Firma, Vula: ……

SHËNIME SHPJEGUESE PËR APLIKIMIN PËR TË PËRFITUAR AUTORIZIMIN PËR MAGAZINË DOGANORE PRIVATE

(DUTY FREE SHOPS)

1. Shkruani emrin, adresën e plotë të aplikuesit dhe numrin e identifikimit. Aplikuesi është personi të cilit i lëshohet autorizimi. Shkruani informacionin e duhur të kontaktit (personin e kontaktit, adresën e kontaktit, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e-mail)

2. Përcaktoni, vendin e saktë që synohet të përdoret si dyqan "duty free shops" dhe faktin nëse godina/ambjenti janë ekzistues apo janë në projekt për t'u ndërtuar.

3. Shkruani tipin, referencën dhe - nëse zbatohet - datën e mbarimit të autorizimit/meve përkatës për përdorimin e regjimeve doganore; në rastet kur sapo është aplikuar për autorizim, shkruani llojin e autorizimit për të cilin aplikohet dhe datën e aplikim.

Kodi	Rregjimi i Autorizuar
1	Magazinë Doganore
2	Përpunim aktiv
3	Lejimi i përkohshëm
4	Përdorim i veçantë përfundimtar (end use)
5	Përpunimi nën kontrollin doganor
6	Përpunimit pasiv

4. Shkruani tipin e magazines për të cilën bëhet kërkesa.

5. Përcaktoni në mënyrën e përshtatshme:

a) regjimin normal për futjen e mallrave,
b) regjimin normal për vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave të futura ,
c) regjimin normal për ri eksportimin e mallrave të futura.

6. Përcaktoni në mënyrë të qartë nevojat për hapjen e dyqanit "duty free shops".

7. Përshkruani qartë regjistrat e mbajtura ose që planifikohen të mbahen dhe vendi ku ato mbahen ose do të mbahen.

8. Përcaktoni qartë periudhën mesatare të magazinimit të mallrave.

9. Përshkruani në mënyrën e përshtatshme dhe sipas kodeve tarifore:

a) mallrat jo shqiptare,
b) mallrat jo shqiptare me aksize,
c) mallrat shqiptare,
d) mallrat shqiptare me aksizë.

10. Vendosni emërtimin e zyrës doganore mbikqyrëse.

11. Vendosni në mënyrë të qartë listën e të gjithë dokumentave të cilat shoqërojnë aplikimin

Të dhënat jo-konfidenciale të aksesueshme për publikun e gjerë:

Publikut të gjerë do ti jepet akses në të dhënat e mëposhtme (duke iu referuar formularit të aplikimit):

- Numri i autorizimit të dhënë;
- Kodi i zyrës doganore mbikqyrëse;

FORMA E AUTORIZIMIT PËR MAGAZINË DOGANORE PRIVATE (DUTY FREE SHOPS)

<table>
<tr><td>1. Mbajtësi i autorizimit:

Nr._____</td><td>Autorizim për:
Magazinë Doganore Private
“DUTY FREE SHOPS”

Nr._____

ORIGJINAL</td></tr>
<tr><td>2. Ky autorizim i referohet aplikimit:

Nr._____</td><td>3. Data e hyrjes në fuqi</td></tr>
<tr><td colspan="2">4. Ambjentet:
_____._____</td></tr>
<tr><td>5. Regjistrat e stokut/sistemi inventarit</td><td>6. Zyra doganore mbikqyrëse:

_____</td></tr>
<tr><td rowspan="2">7. Regjimi i zbatueshën:

_____
_____</td><td>8. Afati për dorëzimin e inventarit të mallrave</td></tr>
<tr><td>9. Shuma e garancisë:

_____</td></tr>
<tr><td colspan="2">10. Mallrat që mundet të pranohen:

_____</td></tr>
<tr><td>11. Dispozita të tjera: _____</td><td>12. Numri anekseve: _____</td></tr>
<tr><td>13. Autoriteti që lëshon autorizimin:
_____
Emër/ Mbiemër/Firma_____

Vendi / Data</td><td>_____
Vula
_____</td></tr>
</table>

FORMA E AUTORIZIMIT PËR MAGAZINË DOGANORE PRIVATE

(DUTY FREE SHOPS)

1. Mbajtësi i autorizimit: **Nr.**_____	**Autorizim për:** **Magazinë Doganore Private** **"DUTY FREE SHOPS"** **Nr.**_____ **KOPJE**
2. Ky autorizim i referohet aplikimit: **Nr.**_____	**3. Data e hyrjes në fuqi**
4. Ambjentet: _____._____	
5. Regjistrat e stokut/sistemi inventarit	**6. Zyra doganore mbikqyrëse:** _____
7. Regjimi i zbatueshën: _____	**8. Afati për dorëzimin e inventarit të mallrave** **9. Shuma e garancisë:** _____
10. Mallrat që mundet të pranohen: _____	
11. Dispozita të tjera: _____	**12. Numri anekseve:** _____
13. Autoriteti që lëshon autorizimin: _____ **Emër/ Mbiemër/Firma**_____ _____ **Vendi / Data**	**Vula**_____

_____ _____

SHËNIME SHPJEGUESE PËR FORMËN E AUTORIZIMIT PËR MAGAZINË DOGANORE PRIVATE (DUTY FREE SHOPS)

1. Shënoni emrin e mbajtësit apo emrin e shoqërisë dhe adresën e plotë. Numri identifikues konsiston në një gërmë që tregon tipin e magazinës në përputhje me nenin 633, plus një numër që identifikon magazinën/dyqanin në mënyrë individuale.

2. Shënoni datën dhe të dhënat referuese të aplikimit.

3. Shënoni datën e hyrjes në fuqi.

4. Jepni adresën e plotë të ambjenteve të magazinës/dyqanit.

5. Shënoni vendin e saktë ku mbahen regjistrat/inventaret e stokut.

6. Shënoni emrin e saktë të zyrës doganore mbikqyrëse.

7. Regjimi i zbatueshën:

8. Shënoni afatin e dorëzimit të inventarit të mallrave dhe deklaratës përmbledhëse.

9. Shënoni shumën e saktë të garancisë.

10. Jepni përshkrimin e mallrave që mundet të pranohen sipas kodeve të tyre tarifore.

11. Nëse është e nevojshme shënoni dispozita të tjera shtesë të zbatueshme.

12. Nëse është e nevojshme shënoni numrin e anekseve që i bashkëlidhen autorizimit.

ANEKSI 90

Tabela e korespondencës së cilës i referohet Neni 730

	Dispozita në zbatim të Ligjit Nr. 8449 dt.27.01.1999 "Kodi Doganor i R.SH" dhe VKM Nr. 205 dt.13.04.1999" Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor"	Dispozita në zbatim të Ligjit Nr.102/2014" Kodi Doganor i R.SH"(Kodi), të këtij vendimi.
1	VKM nr. 919 dt 19.12.2014 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" ; Titulli II "Operatorët ekonomikë të autorizuar"	Operatori Ekonomik i Autorizuar – kriteret për dhënien e statusit OEA (Nenet 27, 40 dhe 41 të Kodit dhe Nenet 49 deri në 53)
2	Siguria globale, përfshi garancinë globale për transitin : Neni 204 i Ligjit Nr. 8449 dt.27.01.1999 "Kodi Doganor i R.SH"; për tranzsitin: Neni 117 i Ligjit Nr. 8449 dt.27.01.1999 "Kodi Doganor i R.SH" dhe Neni 200 deri në nenin 202 VKM Nr. 205 dt.13.04.1999" Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor"	Autorizim për të përdorur një garanci globale (Nenet 84(5) dhe 90 të Kodit dhe Neni 194)
3	Nuk parashikohet ne dispozitat kombëtare	Garanci individuale në formën e voucher Neni 196
4	Autorizimi për përdorimin e magazinimit të përkohshëm (Neni 76(1) i Ligjit Nr. 8449 dt.27.01.1999 "Kodi Doganor i R.SH", Nenet 112 deri në nenin 117 të VKM Nr. 205 dt.13.04.1999" Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor"	Autorizimi për përdorimin e magazinimit të përkohshëm (neni 138 i Kodit, nenet 238 deri në 242 dhe 253).
5.	VKM nr. 919 dt 19.12.2014 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" Titulli IV "Deklaratat doganore standarde, deklaratat doganore të thjeshtuara, deklaratat plotësuese"	Autorizimi për 'deklaratë të thjeshtuar' (Nenet 152(2), 153 të Kodit, Nenet 321 deri 324 dhe 325 të këtij vendimi dhe Nenet 322, 323 dhe 326).
6.	Zhdoganimi në ambientet e operatorit ekonomik (zhdoganimi lokal), nenet 476-1 deri 476-9 Vendim Nr.205, datë 13.4.1999 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të kodit doganor"	Autorizime për 'hyrje në regjistrimet e deklaruesit' (Neni 165 i Kodit, Neni 336 dhe Nenet 327, 328, 330 dhe 332) - Ose autorizimi për 'deklaratë të thjeshtuar' (shihni pikën (5) -Dhe/ose vendet e përcaktuara ose miratuara (Neni 130 i Kodit dhe Neni 250 i këtij vendimi).
7	VKM nr. 919 dt 19.12.2014 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" Titulli IV "Deklaratat doganore standarde, deklaratat doganore të thjeshtuara, deklaratat plotësuese"	Autorizimi "për zhdoganim të centralizuar' (Neni 163 i Kodit, Neni 331 i këtij vendimi dhe Nenet 332, 699, 702 dhe 703)
8	Nuk parashikohet në dispozitat kombëtare	Autorizime për të kryer një shërbim të rregullt të transportit detar (Neni 295 të këtij vendimi)
9	Nuk parashikohet në dispozitat kombëtare	Autorizim për lëshimin e një prove nga një lëshues i

		autorizuar T2L, ose manifestin doganor të mallrave pa qenë e nevojshme të kërkoje miratimin dhe regjistrimin e provës nga zyra doganore kompetente (Neni 290 i këtij vendimi)
10	VKM nr. 919 dt 19.12.2014 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" neni 41-43	Autorizimi "peshues bananeje" (Nenet 393 deri në 397 të këtij vendimi)
11	Nuk parashikohet në dispozitat kombëtare	Autorizim për statusin e dërguesit të autorizuar, duke lejuar mbajtësin e regjimit t'i vendosë mallrat nën regjimin e transitit pa i paraqitur ato në doganë (Neni 207(4)(a) i Kodit, Nenet 583 deri 587)
12	Nuk parashikohet në dispozitat kombëtare	Autorizim për statusin e pritësit të autorizuar, duke e lejuar mbajtësin e regjimit të marrë mallrat që lëvizin nën regjimin e transitit në një vend të autorizuar për mbylljen e regjimit në përputhje me Nenin 207(2) të Kodit (Neni 207(4)(b) të Kodit, Nenet 583, 588 dhe 589 të këtij vendimi dhe Nenet 584, 590 dhe 591)
13	Nuk parashikohet në dispozitat kombëtare	Autorizim për pritës të autorizuar për qëllim të TIR (Neni 205 të Kodit, Nenet 567, 570 dhe 571 dhe Nenit 580)
14	Autorizim për Përpunimin nën Kontrollin Doganor (Nenet 150-156 te Ligjit nr. 8449 "Kodi Doganor i RSH" dhe nenet 326-341 te VKM nr.205 date 13.04.1999)	Autorizim për përpunim aktiv (Nenet 191 deri në 202 dhe 228 deri në 231 të Kodit dhe Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560 deri 562)
15	Autorizim për sistemin e pezullimit të përpunim aktiv (Nenet 136-149 te ligjit nr.8449, date 27.01.1999 dhe neni 272-325 te VKM nr.205, date 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të KD")	Autorizim për përpunim aktiv (Nenet 191 deri në 202 dhe 228 deri në 231 të Kodit dhe Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560 deri 562) Rregullat e përgjithshme për llogaritjen e shumës së detyrimit doganor të importit ose eksportit Neni 81(3) i Kodit Rregulla të veçanta për llogaritjen e shumës së taksës doganore të importit ose eksportit nëse përmbushen kushtet ekonomike në përputhje me Nenet 537 (1) (ë), (f), (i), (l), (m) ose (n) të këtij vendimi: Neni 80 (1) i Kodit
16	Autorizim i Perpunimit Aktiv sistemi me Rimbursim. (Nenet 136-149 te ligjit nr.8449, date 27.01.1999 dhe neni 272-325 te VKM nr.205, date 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të KD")	Autorizim për përpunim aktiv (Nenet 191 deri në 202 dhe 228 deri në 231 të Kodit dhe Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560 deri 562) Rregulla të përgjithshme për llogaritjen e detyrimit doganor të importit ose eksportit Neni 81 (3) të Kodit Rregulla të veçanta për llogaritjen e e detyrimit doganor të importit ose eksportit nëse përmbushen kushtet ekonomike në përputhje me Nenet 537 (1) (ë), (f), (i), (l), (m) ose (n) të këtij vendimi: Neni 80 (1) i Kodit
17	Autorizime për veprimin e mjediseve magazinuese si magazine doganore të tipit A (neni 121-135 i ligjit nr.8449 date "Kodi doganor i Republikes se Shqiperise" si dhe	Autorizime për një magazinë doganore publike të tipit I (Neni 192 dhe 213 deri në 216 të Kodit, Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)

	nenet 240-271 te VKM nr 205 date 13/04.1999 "Për dispozitat zbatuese te Kodit Doganor)	
18	Autorizime për veprimin e mjediseve magazinuese si magazinë doganore të tipit B (neni 121-135 i ligjit nr.8449 date "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" si dhe nenet 240-271 të VKM nr 205 datë 13/04.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor)	Autorizime për një magazinë doganore publike të tipit II (Neni 192 dhe 213 deri në 216 të Kodit, Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)
19	Autorizime për veprimin e mjediseve magazinuese si magazinë doganore të tipit C (neni 121-135 i ligjit nr.8449 date "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" si dhe nenet 240-271 te VKM nr 205 date 13/04.1999 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor)	Autorizime për një magazinë doganore private (Neni 192 dhe 213 deri në 216 të Kodit, Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)
20	Autorizime për veprim të mjediseve të magazinimit si magazinë doganore e tipit D (neni 121-135 i ligjit nr.8449 date "Kodi Doganor i Republikës se Shqiperise" si dhe nenet 240-271 te VKM nr 205 date 13/04.1999 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor)	Autorizime për magazinë private doganore (Neni 192 dhe 213 deri në 216 të Kodit, Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)
21	Autorizime për veprim të mjediseve të magazinimit si magazinë doganore e tipit E(neni 121-135 i ligjit nr.8449 date "Kodi doganor i Republikes se Shqiperise" si dhe nenet 240-271 te VKM nr 205 date 13/04.1999 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor)	Autorizime për magazinë private doganore (Neni 192 dhe 213 deri në 216 të Kodit, Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)
22	Autorizime për veprim të mjediseve të magazinimit si magazinë doganore e tipit F(neni 121-135 i ligjit nr.8449 date "Kodi doganor i Republikes se Shqiperise" si dhe nenet 240-271 te VKM nr 205 date 13/04.1999 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor)	Autorizime për magazinë publike doganore të tipit III (Neni 192 dhe 213 deri në 216 të Kodit, Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)
23	Autorizime për zona të lira (Neni 183-196 i ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i RSH", dhe neni 442-472 te VKM nr.205, date 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të KD").	Autorizime për zona të lira (Nenet 216 deri në 222 të Kodit). (Përfshirë dhe dispozitat kombëtare mbi duty free shops)
24	Autorizime për zona të lira (Neni 183-196 i ligjit nr.8449, date 27.01.1999 "Kodi Doganor i RSH", dhe neni 442-472 te VKM nr.205, datë 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese te KD")	Autorizime për magazinë doganore. Pas 1 Qershor 2017, autoritetet doganore do të vendosin se cilit tip të veçantë magazinash doganore mund t'i përkasin zonat e lira. (Nenet 213 deri në 215 të Kodit dhe Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)
25	Autorizime për magazinë të lira (Neni 183-196 i ligjit nr.8449, date 27.01.1999 "Kodi	Autorizime për magazinë doganore Autoritetet doganore do të vendosin se cilit tip të veçantë

	Doganor i RSH", dhe neni 442-472 te VKM nr.205, date 13.04.1999 "Per dispozitat zbatuese te KD").	magazinash doganore do t'i përkasin magazinat e lira. (Nenet 213 deri në 215 të Kodit dhe Nenet 529 deri 533, 535, 537, 538, 541, 544 deri 548, 550 deri 552, 554, 557, 558, 560)
26	Nuk parashikohet në dispozitat kombëtare	Autorizim për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë, kur plumbosja kërkohet për të siguruar identifikimin e mallrave të vendosura nën regjimin e transit . (Neni 207(4)(c) i Kodit, Nenet 583, 584, 593, dhe 594)
27	Autorizim për përpunim pasiv (Nenet 165-180 te ligjit nr. 8449, date 27.01.1999 dhe nenet 403-427 të VKM nr.205, date 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të KD")	Autorizim për përpunim pasiv (Nenet 191 deri në 202 dhe 228, 232 deri në 235 të Kodit dhe Nenet 531, 532, 535, 536, 539, 540, 541, 542, 545, 548, 549, 551, 552, 553, 555, 556, 557, 558, 559, 563, 687, 691, 692,)
28	Autorizim për Lejim i Përkohshëm (nenet 156-164 te ligjit nr. 8449 date 27.01.1999 dhe nenet 342 – 402 te VKM nr. 205 datë 13.04.1999)	Autorizim për Lejim i Përkohshëm (Nenet 191 deri në 202 dhe 223 deri në 226 të Kodit, Nenet 531, 532, 534, 539, 540, 541, 542, 543, 545, 548, 549, 555, 556, 557, 558, 559, 561, 563, 564, 649, 682, 683, 684, 685)
29	Autorizim per TTF (neni 28 te ligjit nr. 8449 date 27.01.1999 dhe nenet 163-179)	Autorizim për TTF (Neni 56 i Kodit dhe Nenet 89, 90 dhe 91)

SHTOJCA B

TABELA E PËRMBAJTJES

TITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

ANEKSI A Formatet dhe kodet e kërkesa të përbashkëta të të dhënave për aplikimet dhe vendimet

ANEKSI B Formatet dhe numri themelor i kërkesave të të dhënave të përbashkëta për deklarimet dhe njoftimet

ANEKSI 12-01 Kërkesa të përbashkëta për të dhënat për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe personave të tjerë

ANEKSI 12-02 Vendimet e Informaconit Detyrues të Origjinës

TITULLI II

FAKTORËT NË BAZË TË TË CILAVE ZBATOHEN DETYRIMET E IMPORTIT OSE EKSPORTIT DHE MASAT E TJERA NË LIDHJE ME TREGTIMIN E MALLRAVE

ANEKSI 21-01 Lista e elementeve të të dhënave të mbikqyrjes të përmendura në nenin 55(1)

ANEKSI21-02 Vendimet e informacionit detyrues të origjinës

ANEKSI 22-08 Çertifikata e origjinës Form A

ANEKSI 22-09 Certifikata e Origjinës

ANEKSI 22-10 Çertifikatë e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe aplikimet përkatëse

ANEKSI 22-13 Deklaratë fatura

ANEKSI 22-14 Certifikata e origjinës për produktet që i nënshtrohen marrveshjeve/rregullimeve të veçanta jo- preferenciale të importit

ANEKSI 22-15 Deklarata e furnitorit për produktet që kanë status të origjinës preferenciale

ANEKSI 22-16 Deklarata afatgjatë e furnitorit për produktet që kanë status të origjinës preferenciale

ANEKSI 22-17 Deklarata e furnitorit për produktet që nuk kanë status të origjinës preferenciale

ANEKSI 22-18 Deklarata afatgjatë e furnitorit për produktet që nuk kanë status të origjinës preferenciale

TITULLI III

BORXHI DOGANOR DHE GARANCITË

ANEKSI 32-01 Dorëzania e Garantuesit — Garancia individuale

ANEKSI 32-02 Dorëzania e garantuesit - Garancia individuale në formën e kuponit (voucher)

ANEKSI 32-03 Dorëzania e Garantuesit - Garancia globale

ANEKSI 32-06 Kupon (voucher) i garancisë individuale

ANEKSI 33-03 Model i Memos informuese mbi kërkesën për pagesë ndaj shoqatës garantuese të borxhit nën regjimin e transitit sipas Carnet ATA / e-ATA

ANEKSI 33-04 Formular taksimi për llogaritjen e detyrimit dhe pagesave të tjera që rezultojnë nga kërkesa për pagesë ndaj shoqatës garantuese të borxhit në regjimin e transitit sipas Carnet ATA / e-ATA

ANEKSI 33-05 Modeli i mbylljes që tregon se është iniciuar kërkesa ndaj shoqatës garantuese në shtetin/zyrën doganore ku borxhi doganor ka lindur nën regjimin e transitit me Carnet ATA/e-ATA

ANEKSI 33-06 Kërkesë për informacion shtesë, kur mallrat janë vendosur në një zyrë tjetër doganore

ANEKSI 33-07 Rimbursimi ose falja e detyrimit në rsh.

TITULLI IV

MALLRATE QË HYJNË NË TERRITORIN DOGANOR TË RSH

TITULLI V

RREGULLAT E PËRGJITHSHMË PËR STATUSIN DOGANOR, VENDOSJA E MALLRAVE SIPAS NJË REGJIMI DOGANOR, VERIFIKIMI, ÇLIRIMI DHE ASGJESIMI I MALLRAVE

ANEKSI 51-01 Dokumenti i regjistrimit të statusit

TITULLI VI

ÇLIRIMI PËR QARKULLIM TË LIRË DHE LËHTËSIMI NGA DETYRIMI I IMPORTIT

ANEKSI 61-02 Çertifikatat e peshimit të bananes — modeli

ANEKSI 61-03 Çertifikata e peshimit të bananes procedura

ANEKSI 62 Formulari i Aplikimit

ANEKSI 62-02 INF 3 — Fletë informuese e mallrave të rikthyera

ANEKSI 63 Formulari aplikimit për zgjatjen e afatit

TITULLI VII PROCEDURA

TË VEÇANTA

ANEKSI 72-01 Etiketa e verdhë

ANEKSI 72-03 TC 11 Vërtetimi

ANEKSI 72-04 Procedura e vazhdimësisë së punës për transitin PVP

ANEKS 80 Garancia për shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen

TITULLI VIII

MALLRATË NXJERRA JASHTË TERRITORIT DOGANOR TË RSH

ASNJË ANEKS

ANEKSI A

FORMATET DHE KODET E KËRKESA TË PËRBASHKËTA TË TË DHËNAVE PËR APLIKIMET DHE VENDIMET

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Dispozitat e përfshira në këto shënime janë të zbatueshme për të gjithë Titujt e këtij Aneksi.

Formatet, kodet dhe nëse është e zbatueshme, struktura e kërkesave të të dhënave të përfshira në këtë Aneks janë të zbatueshme në lidhje me kërkesat e të dhënave për aplikimet dhe vendimet që janë të parashikuara në Aneksin A SHTOJCA A.

2. Formatet dhe kodet e përcaktuara në këtë Aneks duhet të zbatohen për aplikimet dhe vendimet e marra, duke përdorur teknikën elektronike të përpunimit të të dhënave, si dhe të aplikimeve dhe vendimeve të bëra në letër.

3. Titulli I përfshin formatet e elmentevë të të dhënave.

4. Sa herë që informacioni në një aplikim apo vendim që trajtohen në Aneksin A SHTOJCA A merr formën e kodeve, duhet të zbatohet lista e kodeve të përcaktuara në Titullin II .

5. Madhësia e një element të dhëne nuk duhet të pengojë aplikuesin për të dhënë informacion të mjaftueshëm. Kur të dhënat e nevojshme nuk mund të jepen brenda një formati të caktuar të elementit të dhënash, duhet të përdoren skedarë të bashkëngjitur.

6. Termi "tip/ gjatësi“ 'në shpjegimin e një atributi tregon kërkesat për tipin e e të dhënës dhe gjatësinë e të dhënës. Kodet për tipet e të dhënës janë si vijon:

a alfabetike
n numerike
an alfanumerike

Numri që ndjek kondin tregon gjatësinë e pranueshme të të dhënës. Zbatohet si më poshtë:

Dy pikat fakultative përpara gjatësisë së treguesit do të thotë se e dhëna nuk ka gjatësi fikse, por që mund të ketë deri në një numër shifror, siç specifikohet nga gjatësia e treguesit. Presja në gjatësinë e të dhënës do të thotë se atributi mund të përmbajë numër dhjetor, shifra përpara presjes tregon gjatësinë totale të atributit, shifra pas presjes tregon numrin maksimal të shifrave pas pikës dhjetore.

Shembujt e fushës së gjatësive dhe formateve:
a1 1 karakter alfabetik, gjatësi e fiksuar
n2 2 karaktere numerike, gjatësi e fiksuar
an3 3 karaktere alfanumerike, gjatësi e fiksuar

a..4 deri në 4 karaktere alfabetike
n..5 deri në 5 karaktere numerike
an..6 deri në 6 karaktere alfanumerike
n..7,2 deri në 7 karaktere numerike duke përfshirë masimalisht 2 shifra dhjetore, një kufizues lejohet të përdoret.

7. Shkurtesat dhe akronimet e përdorura në Aneks interpretohet në mënyrën e mëposhtme:

Shkurtesa/akronime	Kuptimi
E. D.	Elementi i të dhënës
n.a.	Jo e zbatueshme

8. Numri themelor i referohet numrit maksimal të mundshëm të ndodhive të një elementi të caktuar të dhënash në aplikimin ose vendimit në fjalë.

TITULLI II

Kodet në lidhje me kërkesat e përbashkëta të të dhënave për aplikimet dhe vendimet

1. HYRJE

Ky Titull përmban kodet që duhen përdorur në aplikimet dhe vendimet.

2. KODET

1/1. Tipi i kodit të Aplikimit /Vendimit

Kodet e më poshtme duhet të përdoren:

Kodi	Tipi i Aplikimi/Vendimit	Kreu i kolonës në tabelën e Aneksit A SHTOJCA A.
IDT	Aplikim ose vendim lidhur me Informacionin DetyruesTarifor	1a
IDO	Aplikimi ose vendimit lidhur me Informacionin Detyrues të Origjinës	1b
OEAD	Aplikim ose vendim lidhur me statusin e operatorit ekonomik të autorizuar për "thjeshtësime doganorre"	2
OEAS	Aplikim ose vendim lidhur me statusin e operatorit ekonomik të autorizuar për "sigurinë dhe mbrojtjen",	2
OEAP	Aplikim ose vendim lidhur me statusin e operatorit ekonomik të autorizuar për — "thjeshtësime doganore/sigurinë dhe mbrojtjen"	
AVD	Aplikimi ose autorizim për thjeshtësime të përcaktimit të shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave	3
AGG	Aplikim ose autorizim për sigurimin e garancisë globale, duke përfshirë një reduktime të mundshme ose heqje dorë	4a
ASP	Aplikimi ose autorizimi për shtyrjen e afatit të pagesës	4b
ASD	Aplikimi ose vendim për shlyerjen e shumave të detyrimeve të importi ose eksportit.	4c
AFD	Aplikimi ose vendimit për faljen e shumave të detyrimeve të importi ose eksportit	4c
MPM	Aplikimi ose autorizimi për përdorimin e ambjenteve për magazinimin e përkohkshëm të mallrave	5
STD	Aplikim ose autorizim për të lejuar shërbim të rregullt të transportit detar.	6a
SDS	Aplikim ose autorizim për statusin e lëshuesit të autorizuar për provën e statusit doganor të mallrave shqiptare	6b
ADT	Aplikim ose autorizim për të përdorur deklaratë të thjeshtuara	7a

Kodi	Tipi i Aplikimi/Vendimit	Kreu i kolonës në tabelën e Aneksit A SHTOJCA A.
AZC	Aplikim ose autorizim për zhdoganim të centralizuar	7b
AHR	Aplikim ose autorizim për një deklarate doganore përmes hyrjes në rregjistrimet e deklaruesit, duke përfshirë regjimin e eksportit	7c
AVV	Aplikim ose autorizim për vetë vlerësimin	7d
PAB	Aplikim ose autorizim për statusin e peshuesit të autorizuar të bananeve.	7e
RPA	Aplikim ose autorizim për përdorimin e regjimit të perpunimit aktiv	8a
RPP	Aplikim ose autorizim për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv	8b
REU	Aplikim ose autorizim për përdorimin e regjimit të përdorimit përfundimtar (end use)	8c
RLP	Aplikim ose autorizim për përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm	8d
MDP	Aplikim ose autorizim për regjimin e magazinimit doganor të mallrave në një magazinë doganore private	8e
MDPI	Aplikim ose autorizim për regjimin e magazinimit doganor të mallrave në një magazinë doganore puplike tipi I	8e
MDPII	Aplikim ose autorizim për regjimin e magazinimit doganor të mallrave në një magazinë doganore puplike tipi II	8e
PATIR	Aplikim ose autorizim për statusin e pritësit të autorizuar për procedurën TIR .	9a
DAT	Aplikim ose autorizim për statusin e dërguesit të autorizuar për transit	9b
PAT	Aplikim ose autorizim për statusin e pritësit të autorizuar në transit	9c
PPV	Aplikim ose autorizim për përdorimin e plumbçeve të llojit të veçantë	9d
DTR	Aplikim ose autorizim për të përdorur deklaratë transiti me të dhëna të reduktuar	9e
DTE	Autorizim për përdorimin e një dokumenti transporti elektronik si deklaratë doganore	9f

1/3. **Tipi i aplikimit**

Duhet të përdoren kodet e mëposhtme:

1 Aplikim i parë
2 Aplikim për ndryshim të vendimit
3 Aplikim për rinovimin e autorizimit
4 Aplikim për revokimin e vendimit

1/4. **Vlefshmëria Gjeografike**

Duhet të përdoren kodet e mëposhtme:

1. Aplikim ose autorizim i vlefshëm në RSh
2. Aplikim ose autorizim i kufizuar për zyra doganore të caktuara
3. Aplikimi ose autorizim i kufizuar për një zyrë doganore

1/6. **Numri i referencës së vendimit**

Numri i referencës së vendimit është i strukturuar si mëposhtë:

Fusha	Përmbajtja	Formati	Shembuj
1	Kodi i identifikimit të shtetit (alpha 2 Kodi shtetit)	a2	AL
2	Tipi i kodit të vendimit	an..4	RPA
3	Identifikimi unik për vendimin	an..29	12345

Fusha 1 siç shpjegohet më sipër.
Fusha 2 duhet të plotësohet me kodin e vendimit të përcaktuara për E. D. 1/1 Tipi i kodit të vendimit në këtë Kre.
Fusha 3 duhet të plotësohet me një identifikues për vendimin në fjalë. Mënyra e përdorimit të kësaj fushe lidhet me numrin unik sipas tipit të vendimit në fjalë

1/7. **Autoriteti doganor vendim marrës**

Stuktura e kodeve është si në vijim:

- Dy karakteret e para (a2) shërbejnë për të identifikuar shtetin me anë të kodit të shtetit,
- Gjashtë karakteret vijuese (an6) tregojnë zyrën doganore. Sugjeruar që të përshtatet struktura në vijim:

Tre karakteret e para (an3) do të merren nga kodi i vendondhjes dhe tre të fundit nga një nëndarje kombëtare alfanumeri(an3). Në qoftë se nuk përdoret kjo nënndarje, duhet të futen shifrat‘000’.

5/8. **Identifikimi i mallrave**

Kodet që duhet të përdoren për identifikimin e mallrave janë si në vijim:

1 Numri serial ose numri i prodhuesit

2 Vendosja e plumbçeve, vulave, fashetave ose shenjeva të tjera dalluese

4 Marrja e kampioneve, ilustrimeve ose përshkrimet teknike

5 Kryerja e analizave

6 Dokumenti informues për të lehtësuar eksportimin e përkohshëm të mallrave të dërguar nga një shtet në një tjetër për prodhim, përpunim ose riparim (e përshtatshme vetëm përpunim pasiv)

7 Mënyra të tjera të identifikimit (të sigurojë një shpjegim mbi mënyrat e identifikimit që do të përdoren)

8 pa mënyra identifikimi sipas nenit 223 (2) (b) të Kodit (i përshtatshëm vetëm për lejimin e përkohshëm)

6/2. Kushtet ekonomike

Kodet që do të përdoren për rastet në të cilat kushtet ekonomike konsiderohen që duhet të plotësohen për përpunim aktiv:

Kodi 1 përpunimi i mallrave që nuk janë të listuara në Aneksin 71-02 SHTOJCA A.

Kodi 2 riparim

Kodi 3 përpunimi i mallrave drejtëpëdrejtë ose tërthorazi të vendosura në dispozicion të mbajtësit të autorizimit, të kryera sipas specifikave në emër të një personi të vendosur jashtë territorit doganor shqiptar, në përgjithësi kundrejt pagesës vetëm të shpenzimeve të përpunimit,

Kodi 4 përpunim i grurit durum në makarona,

Kodi 5 vendosja e mallrave nën përpunimin aktiv brenda kufijve të sasisë së përcaktuar mbi bazën e një balance në përputhje me legjislacionin specifik të fushës.

Kodi 6 përpunimi i mallrave të cilat janë të listuara në Aneksin 71-02 SHTOJCA A, në rast të pamundësisë së mallrave të prodhuara në Shqipëri që kanë të njëjtin Kod 8-shifror të Nomenklaturës së Kombinuar, të njëjtat cilësi tregtare dhe karakteristikat teknike si mallrat e destinuara për t'u importuar për operacionet e përpunimit të parashikuar,

Kodi 7 përpunimi i mallrave të cilat janë të listuara në Aneksin 71-02 SHTOJCA A, me kusht që të ketë dallime të çmimit midis mallrave të prodhuara në Shqipëri dhe atyre që kanë për qëllim të importohen, ku mallra e krahasueshme nuk mund të përdoret për shkak se çmimi i tyre nuk do të bëjë veprimin tregtar ekonomikisht të qëndrueshëm,

Kodi 8 përpunimi i mallrave të cilat janë të listuara në Aneksin 71-02 SHTOJCA A me kusht që të ketë detyrime kontraktuale, ku mallrat e krahasueshme nuk përputhen me kërkesat kontraktuale të blerësit të vëndit tjetër të produkteve të përpunuara, ose nëse, në përputhje me kontratën, produktet e përpunuara duhet të përftohen nga mallrat e destinuara për t'u vendosur nën përpunimin aktiv, në mënyrë që të përputhen me dispozitat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale ose tregtare,

Kodi 9 përpunimi i mallrave të cilat janë të listuara në Aneksin 71-02 SHTOJCA A, me kusht vlera totale e mallrave për t'u vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv për aplikues, vit kalendarik dhe për çdo kod tetë-shifror të nomeklaturës së kombinuar të mallrave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 000 EUR;

(1) rekomadimi 16 mbi KODI UN/LO — KODI PËR PORTET DHE VENDONDODHJET E TJERA.

Kodi 10 përpunimi i mallrave për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat teknike për çlirimin e tyre për qarkullim të lirë,

Kodi 11 përpunimin e mallrave të natyrës jo tregtare,

Kodi 12 përpunimi i mallrave të përftuara nën një autorizim të mëparshëm, lëshimi i të cilit ishte objekt i shqyrtimit të kushteve ekonomike,

Kodi 13 përpunimi i fraksioneve të ngurta dhe të lëngshme të vajit të palmës, vajit të kokosit, fraksionet e lëngshme të vajit të kokosit, të vajit të palmës kernel, të vajit babassu ose vajit të recinit në produkte të cilat nuk janë të destinuara për sektorin ushqimor;

Kodi 14 përpunimi në produktet që trupëzohen në ose përdoren për aviacionin civil për të cilin është lëshuar një çertifikatë e vlefshmërisë ajrore,

Kodi 15 përpunimi i produkteve që përfitojnë nga pezullimi autonom i detyrimit të importit të armëve dhe pajisjeve ushtarake të caktuara, në përputhje me legjislacionin e posaçëm që përcakton një gjë të tillë;

Kodi 16 përpunimi i mallrave në mostra,

Kodi 17 përpunimi i çdo lloji të komponenteve elektronike, pjesëve, amballazhimeve apo çdo materiali tjetër në produkte të teknologjisë së informacionit,

Kodi 18 përpunimi i mallrave që bëjnë pjesë në Kodin e Nrmenklaturës së Kombinuar 2707 ose 2710 në produktet që klasifikohen në Kodet e Nrmenklaturës së Kombinuar 2707, 2710 or 2902,

Kodi 19 reduktimi në mbeturina dhe skrap, shkatërrimi, rikuperimi i pjesëve ose komponentëve

Kodi 20 denatyrimi,

Kodi 21 format e zakonshme të trajtimit të përmendura në nenin 199 të Kodit,

Kodi 22 vlera totale e mallrave për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv për aplikues, vit kalendarik dhe për çdo kod tetë shifror të nomeklaturës së kombinuar të mallrave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 000 EUR në lidhje me mallrat të listuara në Aneksin 71-02 dhe vlerën ekuivalente në lekë të shumës 300 000 EUR për mallra të tjera, me përjashtim të rasteve kur mallrat e destinuara për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv do t'i nënshtrohen detyrimit të përkohshëm ose përfundimtar anti-dumping, detyrimit kundërbalancues, një mase mbrojtëse apo një detyrimi shtesë që rezulton nga një pezullim i koncesioneve, nëse do të ishin deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë.

7/3. Lloji i deklarimit

Kodet e mëposhtme duhet të përdoren për llojet e deklaratave:

1 Deklaratë standarte (në përputhje me nenin 149 të Kodit)

2 Deklaratë e thjeshtëzuar (në përputhje me nenin 152 të Kodit)

3 Hyrja në rregjistrimet e deklaruesit (në përputhje me nenin 165 Kodit)

8/6. Garancia

Duhet të përdoren kodet e më poshtme:

0 Nuk kërkohet garanci

1 Garanci e kërkuar.

II/9. Arsye e pavlefshmërisë

Shkruani një nga kodet e më poshtme:

55 I Anulluar

61 I pavlefshëm për arsye të ndryshimit të kodit të nrmenklaturës doganore

63 I pavlefshëm për arsye të masës ligjore kombëtare

64 Revokimi për arsye të klasifikimit të gabuar

65 Revokimi për arsye të ndryshme nga klasifikimi

66 I pavlefshëm për arsye të vlefshmërisë së kufizuar të kodit të nomenklaturë në kohën e lëshimit

IV/3. Roli (et) e aplikuesit në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit

Duhet të përdoren kodet e mëposhtme:

Kodi	Ro	Përshkrimi
PM	Prodhuesi i mallrave	Pala e cila prodhon mallrat. Ky Kod duhet të përdoret vetëm nëse operatori ekonomik prodhon mallrat. Nuk mbulon rastet kur opertori ekonomik është i përfshirë vetëm në tregtimin e mallrave (p.sh. eksportimi, importimi).
IM	Importuesi	Pala e cila bën, ose në emër të së cilës një agjent doganor ose një person tjetër i autorizuar bënë një deklaratë importi. Kjo mund të përfshijë një person i cili i ka mallrat në posedim ose tek i cili janë dërguar mallrat.
EX	Eksportuesi	Pala e cila bën, ose në emër të së cilës është bërë një deklaratë eksporti dhe është pronar i mallrave ose ka të drejta të ngjashme të përdorimit mbi to në kohën kur deklarata pranohet.

Kodi	Ro	Përshkrimi
AD	Agjent doganor	Agjenti ose përfaqësuesi doganor i cili merret drejtëpërdrejtë me zyrat doganore në emër të importuesit ose eksportuesit. Kodi gjithashtu mund të përdoret për opertorët ekonomikë cilët veprojnë si agjentë/ përfaqësues gjithashtu për qëllime të tjera (p.sh agjent transporti).
TR	Trasportuesi	Pala që ndërmerr ose organizon transportin e mallrave midis pikave të emërtuara
AT	Agjent Transporti	Palë që organizon dërgimin e mallrave.
CS	Konsilidator	Palë që konsolidon dërgesa, pagesa të ndryshme etj.
OT	Operator Terminali	Një palë e cila merret me ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve detare.

Kodi	Ro	Përshkrimi
MM	Mbajtësi i Magazinës	Pala që merr përgjegjësinë për hyrjen e mallrave në magazinë. Ky kod duhet të përdoret gjithashtu nga operatorët ekonomik të cilët operojnë lloje të tjerash ambjentesh magazinimi (p,sh. Magazinim i përkohshme, zonë e lirë, etj.).
CF	Operator i konteinerëve	Palë tek e cila është përcjellë posedimi i një prone të caktuar (p.sh. kontenier) për një periudhë kohe të caktuar në këmbim të pagesave të qirasë.
PNS	Punëtor ngarkim-shkarkimi	Palë e cila merret me ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve detare nga terminale të ndryshëm.
STD	Shërnbimi i linjës të transportit detar	Identifikon organizatën e shërbimit të linjës të transportit detar.
999	Të tjera	

VI/3. Niveli i garancisë

Kodet e më poshtme duhet të përdoren për nivelin e garancisë:

Për të mbuluar borxhet doganore ekzistuese dhe nëse është e zbatueshme, pagesa të tjera:

AA 100% e pjesës përkatëse të shumës referencë
AB 30% e pjesës përkatëse të shumës referencë

Për të mbuluar borxhet doganor të mundshme dhe, kur është e zbatueshme, pagesa të tjera:

BA 100 % e pjesës përkatëse të shumës referencë
BB 50 % e pjesës përkatëse të shumës referencë
BC 30 % e pjesës përkatëse të shumës referencë
BD 0 % e pjesës përkatëse të shumës referencë

VI/4. Forma e garancisë

Kodet e më poshtme duhet të përdoren për formën e garancisë:

1 Depozita në të holla (cash)

2 Dorëzani e dhënë nga një garantues

3* forma të tjera të përcaktuara në nenin 185.

31 Krijimi i një garancie hipotekore, një pagese për tokën, një kontratë shlyerje apo të drejte tjetër që konsiderohet e barabartë me të drejtën mbi pronën e paluajtshme;

32 dhënia e kredive, vendosja e një pengu, me ose pa dorëzimin e posedimit të mallrave, titujve ose kredive mbi një llogari kursimi bankare apo hyrje në regjistrin e borxhit kombëtar;

33 marrjen e përgjegjësisë të përbashkët kontraktore për shumën e plotë të borxhit nga një palë e tretë e miratuar për këtë qëllim nga autoritetet doganore ose depozitimi i një kambiali, pagesa e të cilit garantohet nga kjo palë e tretë;

34 një depozitë të hollash ose mjete te pagesës të barasvlershme me to, të ndryshme nga Leku në të cilën garancia është kërkuar;

35 pjesëmarrjen, me pagesën e një kontributi, në një skemë garancie të përgjithshme të administruar nga autoritetet doganore.

VI/6. Afati kohor për pagesat

Për afatin kohor duhet të përdoren kodet si vijon:

1 Periudha normale përpara pagesës, d.m.th maksimumi10 ditë pas njoftimit të bebitorit të borxhin doganorr në përputhje me nenin 101 të Kodit.

2 Pagesat e shtyra (neni103 i Kodit)

VII/1. Lloji i shtyrjes së pagesës

Për shtyrje e pagesës do të përdoren kodet e më poshtme:

1 Neni 103(b) i Kodit, d.m.th në nivel global në lidhje me çdo sasi të detyrimeve të importit ose eksportit të hyra në llogari në përputhje me paragrafin e parë të nenit 151 (1) gjatë një periudhe të caktuar që nuk i tejkalon 31 ditë.

2 Neni 103(c) i Kodit , d.m.th në nivel global në lidhje me çdo sasi të detyrimeve doganorre të importit ose eksportit që formojnë një hyrje të vetme në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 151(1)

VIII/9. Baza ligjore

Si bazë ligjore duhet të përdoren kodet e më poshtme:

Kodi	Përshkrimi	Baza ligjore
A	Shuma e tepërt e paguar e detyrimeve të importit ose eksportit	Neni 110 i Kodit
B	Mallra me defekte apo mallrat që nuk përputhen me kushtet e kontratës	Neni 111 i Kodit
C	Gabim nga autoritetet kompetente	Neni 112 i Kodit
D	Barasvlefshmëria	Neni 120 i Kodit
E	Shuma e detyrimit të importit ose eksportit të paguara lidhur me një deklaratë doganore të pavlefshme, në përputhje me nenin 159 të Kodit	Neni 109(1) i Kodit

IX/1. Lëvizja e mallrave

Për bazën ligjore të lëvizjes duhet të përdoren kodet e mëposhtme:

Për mallrat në magazinim të pëkohshëm:

A neni 138(5)(a) i Kodit

B neni 138(5)(b) i Kodit

C neni 138(5)(c) i Kodit

X/1. Portet e përfshira në shërbimin e rregullt të transportit detar

Kodet e mëposhtme do të përdoren si kualifikues:

0 port i përfshirë;
1 port potencialisht i përfshirë.

XIII/8. Kodi i statusit të përfaqësuesit fiskal

Do të përdoren kodet e më poshtme:

1 aplikuesi është duke vepruar në emër dhe në interes të tij;
2 një përfaqësues fiskal është duke vepruar në interes të aplikantit.

XVI/1. Aktiviteti ekonomik

Për aktivitetin do të përdoren kodet e më poshtme:

1 Importim
2 Transportim
3 Magazinim
4 Trajtim

XVIII/1. Sistemi i shkëmbimit standard

Do të përdoren kodet e më poshtme:

1 Sistemi i shkëmbimit standard pa importim paraprak të produkteve zëvendësuese
2 Sistemi i shkëmbimit standard pa importim paraprak të produkteve zëvendësuese

XVIII/2. Produktet zëvendësuese

Do të përdoren kodet e mëposhtme:

4 Marrja e kampionëve, illustrimeve ose përshkrimeve teknike
5 Kryerja e analizave
7 Mënyra të tjera identifikimi

ANEKSI B

Formatet dhe kodet e kërkesave të përbashkëta të të dhënave për deklaratat, njoftimet dhe provën e statusit doganor të mallrave shqiptare

SHËNIME HYRËSE

C.MIRATUAR NGA ZYRA QË PLOTËSON FORMALITETET DOGANORE PËR EKSPORT Informacioni i dhënë në kutitë 1 deri në 10 vërteton saktësinë e marrjes së masave identifikuese. Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)	11.KËRKESA E EKSPORTUESIT I nënshkruri, duke qenë eksportues ([1]) në emër të eksportuesit([1]), kërkon lëshimin e kësaj flete informuese për qëllime të riimportimit të mallrave të përshkruara në të Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)

(1) Fshini nëse është e nevojshme.

EMRI I PLOTE DHE ADRESA E ZYRËS DOGANORE TE EKSPORTIT

SHENIME

Kutia 1:	Jep emrin ose emrin tregtar dhe adresen e plotë duke perfshirë edhe Shtetin
Kutia 4:	Jep detaje te sakta të mallrave normalisht sipas përshkrimit të tyre tregtar ose përshkrimit të tyre tarifor. Ky përshkrim duhet të korrespondojë me atë të përdorur në dokumentin e eksportit.
Kutitë 5 dhe 6:	Japin sasitë që gjenden në dokumentin e eksportit.
Kutia 7:	Jep vlerën statistikore në kohën e eksportimit në vlerën monetare të R.SH/ shtetit të eksportimit.
Kutia 8:	Jep detaje të peshës neto, vëllimit, etj. të cilat personi i interesuar dëshiron ti riimportojë.
Kutia 10(c):	Kjo pikë lidhet me mallrat të cilat janë çliruar për qarkullim të lirë në R.SH. duke përfituar përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimi doganor për arsye të përdorimit të veçantë të tyre .
Kutia (10) d:	Kjo pikë lidhet me situatën e mallrave në kohën e eksportimit të tyre.

KËRKESË NGA ZYRA E RI IMPORTIMIT

Kërkesat e zyrës së ri importimit tregohen si më poshtë:

- Verifikimi i vërtetësisë së kësaj flete informuese dhe saktësisë së informacionit në këtë dokument [1]
- Informacioni të jepet si më poshtë(1):

(1)Fshini nëse është e nevojshme

Emri i plotë dhe adresa e zyrës së ri importimit	Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)

PËRGJIGJA E AUTORITETEVE KOMPETENTE

Kjo fletë informuese është e autentike dhe detajet që përmban ky dokument janë të sakta (1).
Kjo fletë informuese krijon komentin e mëposhtëm ([1]):

Informacione të tjera të kërkuara [1]):
(1) Fshini nëse është e nevojshme

Emri i plotë dhe adresa e autoriteteve kompetente	Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)

RI IMPORTIMI

Sasia e ri importuar	Numri i referencës, data dhe tipi i dokumentit të ri importimit Nënshkrimi dhe vula e zyrës së ri importimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

. Exportuesi	**INF3** KOPJE
	MALLRAT E KTHYERA
pritësi në kohën e ekportimit	**FLETË INFORMUESE**

E RËNDËSISHME
1. Përpara plotësimit të këtij formulari personi i interesuar duhet t'i referohet dispozitave që lidhen me mallrat e kthyera si edhe me shënimet që shfaqen në anën e prapme të këtij formulari.
2. Personi i interesuar duhet të plotësojë me shkronja shtypi ose me shkronja dore të mëdha kutitë nga 1 deri në 11 të këtij formati
3. Kur kjo fletë informuese plotësohet për mallrat a eksportimi i të cilave është kryer, brenda kuadrit të politikave të përbashkëta bujqësore , sipas një liçense eksporti ose lëshimit paraprak të çertifikatës / lëshuar a-priori ose për mallrat që përfitojnë nga rimbursimi i detyrimit të eksportit ose shumave të tjera të parashikuara në eksport, është vlefshme vetëm nëse kutia B dhe nëse është e nevojshme edhe kutia A, si më poshtë, janë miratuar nga autoritetet kompetente.
4. Kjo fletë informuese duhet t'i paraqitet zyrës doganore të ri importimit.

. Shteti në cilin mallrat janë dërguar në kohën e eksportit

4.Numri, lloji, shenjat dhe numrat e paketimeve dhe përshkrimet e mallrave të eksportuar	5. Pesha bruto

	. Pesha neto	Vlera statistikore

8. Sasia për të cilën kërkohet fletë informacioni

në shifra:	me fjalë:	9. Kodi CN

A. MIRATUAR NGA AUTORITETET KOMPETETNTE PËR LIÇENSAT E EKSPORTIT OSE ÇERTIFIKATAT E LËSHUARA PARAPRAKISHT	B. MIRATUAR NGA AUTORITETET KOMPETETNTE PËR DHËNIEN E RIMBURSIMEVE TË DETYRIMIT TË EKSPORTIT OSE SHUMAVE TË TJERA TË PARASHIKUARA NË EKSPORT	10. Informacion shtesë që lidhet me mallrat: a. Dokumenti i eksportit Tipi Nr.Ref. Data b. Mallra të eksportuara në përfundim të një operacioni të përpunimit aktiv([1]) c. Mallra të çliruara për qarkullim të lirë për një përdorim të veçantë ([1])
Zbatimi i rregulloreve mbi liçencat dhe çertifikatat.	--Nuk ka rimbursime ose shuma të tjera të dhëna mbi eksportin ([1])	
	--Rimbursime dhe shuma të tjera të ripaguara në eksport për .....(sasia)([1])	
	--E drejta për të paguar ose rimbursuar detyrimet e tjera në eksport të anulluara për ……(sasia)([1])	
Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)	Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)	

C.MIRATUAR NGA ZYRA QË PLOTËSON FORMALITETET DOGANORE PËR EKSPORT	11.KËRKESA E EKSPORTUESIT
Informacioni i dhënë në kutitë 1 deri në 10 vërteton saktësinë e e marrjes së masave identifikuese.	I nënshkruri, duke qenë eksportues ([1]) në emër të eksportuesit([1]), kërkon lëshimin e kësaj flete informuese për qëllime të riimportimit të mallrave të përshkruara në të
Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)	Në ....., më ..... (Nënshkrimi) (Vula)

(2) Fshini nëse është e nevojshme.

EMRI I PLOTE DHE ADRESA E ZYRËS DOGANORE TE EKSPORTIT

SHENIME

Kutia 1:	Jep emrin ose emrin tregtar dhe adresen e plotë duke perfshirë edhe Shtetin .
Kutia 4:	Jep detaje te sakta të mallrave normalisht sipas përshkrimit të tyre tregtar ose përshkrimit të tyre tarifor. Ky përshkrim duhet të korrespondojë me atë të përdorur në dokumentin e eksportit.
Kutitë 5 dhe 6:	Japin sasitë që gjenden në dokumentin e eksportit.
Kutia 7:	Jep vlerën statistikore në kohën e eksportimit në vlerën monetare të R.SH/ shtetit të eksportimit.
Kutia 8:	Jep detaje të peshës neto, vëllimit, etj. të cilat personi i interesuar dëshiron ti riimportojë.
Kutia 10(c):	Kjo pikë lidhet me mallrat të cilat janë çliruar për qarkullim të lirë në R.SH. duke përfituar përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimi doganor për arsye të përdorimit të veçantë të tyre .
Kutia (10) d:	Kjo pikë lidhet me situatën e mallrave në kohën e eksportimit të tyre.

KËRKESË NGA ZYRA E RI IMPORTIMIT

Kërkesat e zyrës së ri importimit tregohen si më poshtë:

-Vërifikimi i vërtetësisë së kësaj flete informuse dhe saktësisë së informacionit në këtë dokument (1)

- Informacioni të jepet si më poshtë(1):

(1) Fshini nëse është e nevojshme

Emri i plotë dhe adresa e zyrës së ri importimit	Në ....., më .....
	(Nënshkrimi) (Vula)

PËRGJIGJA E AUTORITETEVE KOMPETENTE

Kjo fletë informuese është e autentike dhe detajet që përmban ky dokument janë të sakta (1).
Kjo fletë informuese krijon komentin e mëposhtëm (1):

Informacione të tjera të kërkuara (1):

(1) Fshini nëse është e nevojshme

Emri i plotë dhe adresa e autoriteteve kompetente	Në ....., më .....
	(Nënshkrimi) (Vula)

RI IMPORTIMI	
Sasia e ri importuar	Numri i referencës, data dhe tipi i dokumentit të ri importimit Nënshkrimi dhe vula e zyrës së ri importimit

SHËNIME NË LIDHJE ME FLETËN INFORMUESE INF 3

1. Formularët duhen të shtypen në letër të bardhë, pa pulpë mekanike, të përshtatshëm për qëllime shkrimi dhe duhet të peshojnë të paktën 40 g / m2.

2. Përmasa e formularëve duhet të jetë 210 × 297 mm, duke lejuar një tolerancë maksimale në gjatësinë midis - 5 dhe 8 mm; paraqitja e formularëve duhet të respektohet në mënyrë rigoroze, me përjashtim të madhësisë së kutive 6 dhe 7.

3. R.SH. duhet të jetë përgjegjëse për të ndërmarrë hapat e nevojshme për shtypjen e formularëve. Çdo formular duhet të ketë një numër serial individual, i cili mund të jetë caktuar paraprakisht.

4. Formularët duhet të shtypen në gjuhën shqipe /në një nga gjuhët zyrtare të pranuara nga autoritetet kompetente të vendit eksportues. Ata duhet të plotësohen në të njëjtën gjuhë në të cilën janë shtypur. Kur është e nevojshme, autoritetet kompetente të zyrës doganore të ri-importit, në të cilën kërkohet fleta informuese INF 3, mund të kërkojnë përkthimin e saj në gjuhën ose gjuhët e tyre zyrtare.

Aneksi 63

Formulari aplikimit për zgjatjen e afatit

KOPJE PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

2	1. Aplikuesi Emri (*): Adresa (*): Qyteti (*): Kodi Postar: Nr. Identifikimit në sistemin doganor (nëse ka): Nr. NUIS/NIPT: Telefoni (+): Celular (+): Faks (+): Adresa e postës elektronike (e-mail): Faqja e internetit (website):	**2. Për përdorim Zyrtar** Data e Protokollit Nr. i regjistrimit të aplikimit .__.___.___.___.___.__.___ TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE KËRKESË PËR SHTYRJE TË AFATIT PËR VEPRIM NGA AUTORITETI DOGANOR Mbështetur në VKM nr.____, datë _____.

3 (*). Unë kërkoj një zgjatje të periudhës gjatë të cilës Autoritetet Doganore ndërmarrin veprime në zbatimin të këtij aplikimi.
Numri i regjistrimit të aplikimit

☐ Konfirmoj se nuk ka asnjë ndryshim në informacionin që lidhet me aplikimin për veprim dhe anekset e tij

☐ Unë jap informacionin e mëposhtëm në lidhje me aplikimin për veprim.

Shiko bashkëngjitur aneksin nr.___.

Çdo kërkesë për zgjatjen e afatit gjatë të cilës Autoritetet Doganore ndërrmarin veprime duhet të dorëzohet të paktën, 30 ditë punë përpara datës së mbarimit të afatit.

4(*). Firma

Data (D/M/V) Firma e mbajtësit të vendimit

Vendi Emri Mbiemri (shkronja kapitale)

Për përdorim zyrtar

Vendim i autoritetit doganor

☐ Zgjatja e Kërkesës është miratuar plotësisht

☐ Kërkesa për zgjatje është miratuar pjesërisht (Për pjesën e miratuat shiko listën bashkëngjitur)

Datë (D/M/V) Firmë dhe vulë Drejtoria e Pergjithshme e Doganave

Data e mbarimit të aplikimit

☐ Kërkesa për zgjatje është refuzuar

Vendimin e arsyetuar i cili paraqet refuzimin e plotë apo të pjesshëm të kërkesës dhe informacionin në lidhje me proçedurat e apelimit do ta gjeni bashkëlidhur.

Data (D/M/V) Firma dhe Vula Drejtoria e Pergjithshme e Doganave

(*) Fusha të detyrueshme për tu plotësuar (+) Të paktën njëra nga fushat duhet plotësuar

Mbrojtja e të dhënave personale dhe baza e të dhenave për përpunimin e aplikimeve për veprim

Kur përpunohen të dhëna personale që paraqiten në Aplikimin për veprim, zbatohet Ligji Nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale të paraqitura në këto Aplikime është zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale nga autoritetet doganore, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në doganë" për sa i përket drejtave të pronësisë intelektuale. Kontrolluesi në lidhje me përpunimin e të dhënave në bazën e të dhënave qendrore është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Në përputhje me nenin 120/5 të këtij vendimit, pa renë ndesh më legjislacionin në fuqi që zbatohet lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe për qëllim të kontribuimin në eliminimin e tregtisë ndërkombëtare të mallrave që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale, autoritetet doganore kompetente mund të shkëmbejnë me autoritetet doganore të shteteve të tjera të dhëna personale dhe informacione të tjera të përfshira.

Fushat e të dhënave të shënuara me (*) dhe të paktën një nga fushat e shënuara (+) janë të detyrueshme për t'u plotësuar. Në rast të refuzimit për të plotësuar këto të dhëna të detyrueshme, aplikimi refuzohet.

Subjekti i të dhënave ka të drejtë të ketë qasje në të dhënat personale në lidhje me atë që do të procesohen përmes bazës së të dhënave qendrore dhe kur është e përshtatshme, ka drejtën për të ndërhyrë në të dhënat personale në përputhje Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, të ndryshuar dhe legjislacionin në fuqi.

Të gjitha kërkesat për ushtrimin e të drejtës për ndërhyrje në data base qendrore lidhur me të dhënat personale paraqiten dhe të përpunohen nga autoritetet doganore.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale është ky vendim.

Të dhënat personale nuk ruhen më shumë se gjashtë muaj nga data e revokimit të vendimit që miraton aplikimin apo nga data e përfundimit të afatit, gjatë të cilit autoritetet doganore duhet të kryejnë veprimet për mbrojtjen e një të drejte të pronësisë intelektuale. Kjo periudhë specifikohet nga autoritetet doganore në dhënien e aplikimit dhe nuk duhet të kalojë një vit nga dita pas datës së miratimit të vendimit. Megjithatë, kur autoritetet doganore janë njoftuar për proçedimeve, që kanë filluar për të konstatuar një shkelje të mundshme të mallrave, sipas kërkesës, të dhënat personale duhet të ruhen për gjashtë muaj, pasi proçedura ka përfunduar.

Në rast konflikti subjekti ka të drejtën e ankimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe mund t'i drejtohet Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale.

ANEKSI 72-01

ETIKETA E VERDHË



Ngjyra : Shkronja të zeza mbi sfond të verdhë

ANEKSI 72-03

TC 11 – VËRTETIM

Zyra doganore e destinacionit në ……..... (vendi, emri dhe numri i references)
Me anë të këtij dokumenti vërteton se deklarata e tranzitit T1, T2, T2F(1)
E rregjistruar më …….. (dd/mm/vv), me nr. …… ……. (MRN(2)
Nga zyra doganore e nisjes në ……. (vendi, emri dhe numri referencës)
i është dorëzuar.

Vula zyrtare

Në…….. , më …… (dd/mm/vv)
……
(Nënshkrimi)

(1) *Fshini nëse është e nevojshme.*

(2) *Në rast të mos funksionimit të përkohshëm të sistemit të transitit vendosni një numër të përdorur në (Procedurën e Vazhdimësisë së Punës) PVP.*

ANEKSI 72-04

PROCEDURA E VAZHDIMËSISË SË PUNËS PËR TRANSITIN PVP

TITULLI I

KREU I

Dispozita të Përgjithshme

1. Ky aneks përcakton dispozita të veçanta për përdorimin e procedurës së vazhdimësisë së punës, sipas nenit 609 të këtij Vendimi, për mbajtësin e regjimit, përfshirë dërguesit e autorizuar, në rast mosfunksionimi të përkohshëm:

   - Të sistemit elektronik të transitit;
   - Të sistemit informatik të përdorur nga mbajtësi i regjimit për depozitimin e deklaratës së transitit me anë të teknikave informatike të përpunimit të të dhënave, ose;
   - Lidhjes elektronike midis sistemit informatik të përdorur nga mbajtësi i regjimit për depozitimin e deklaratës së transitit me anë të teknikave informatike të përpunimit të të dhënave dhe sistemit elektronik të transitit.

2. Deklarimet transitit

2.1 Deklarata e transitit e përdorur në PVP njihet nga të gjitha palët e përfshira në operacionin transit, në mënyrë që të shmangen problemet në zyrën doganore të transitit, në zyrën doganore të destinacionit dhe pas mbërritjes së mallrave pranë pritësit të autorizuar. Për këtë arsye, përdorimi i dokumentave kufizohet si më poshtë:

   - një Dokument Administrativ të Vetëm (DAV), ose;
   - një DAV i printuar në letër normale nga sistemi informatik i operatorit ekonomik, siç parashikohet në aneksin B-01, ose;
   - një Dokument Shoqërues Transit (DSHT), një Dokument Shoqërues Transit/Sigurisë (DSHTS) nëse është e nevojshme e plotësuar me Listën e Artikujve (LoI) ose Listën e Artikujve Transit/Sigurisë (TSLoI).

2.2 Deklarata e transitit mund të plotësohet nga një ose më shumë formularë plotësues sipas modelit të përcaktuar në aneksin B-01. Formularët duhet të jenë pjesë përbërëse e deklaratës. Listat e ngarkesave në përputhje me Kreun II, Kapitullin IV të këtij aneksi dhe të përpiluara duke përdorur formularin e paraqitur në Kreun II, Kapitulli III të këtij aneksi mund të përdoren në vend të formularëve plotësues si pjesë përshkruese e një deklarate transiti të shkruar, ku duhet të jenë pjesë përbërëse.

2.3 Për zbatimin e pikës 2.1 të këtij aneksi, deklarata e transitit duhet të plotësohet në përputhje me aneksin B SHTOJCA A dhe aneksin B SHTOJCA B.

KREU II

Rregullat zbatuese

3. Mosfunksionimi i sistemit elektonik të transitit.

3.1 Rregullat duhet të zbatohen si më poshtë:

- Deklarata transit duhet të plotësohet dhe dorëzohet në zyrën doganore të nisjes në kopjet 1, 4 dhe 5 të DAV në përputhje me Aneksin B-01 ose në dy kopje të DSHT/DSHTS, plotësuar, nëse është e nevojshme, me Listën e Artikujve ose Listën e Artikujve të Transit/Sigurisë, në përputhje me Anekset B-02, B-03, B-04 dhe B-05;
- Deklarata transitit duhet të regjistrohet në kutinë C duke përdorur një sistem të ndryshëm numëror nga ai i përdorur në sistemin elektronik të tranzitit;
- Procedura e vazhdimësisë së punës duhet të tregohet në kopjet e deklaratës së transitit me një nga vulat e duke përdorur formularët e përcaktuar në Kreun II, Kapitulli I të këtij Aneksi, në kutinë A të DAV ose në vend të MRN dhe bar-kodin mbi DSHT/DSHTS;
- Dërguesi i autorizuar duhet të përmbushë të gjitha detyrimet dhe kushtet në lidhje me të dhënat që do të plotësohen në deklaratë dhe përdorimi i vulës të një lloji të veçantë të referuar në pikat 22 deri 25 të këtij Aneksi, duke përdorur përkatësisht kutitë C dhe D;

- Deklarata transit duhet të vuloset ose nga zyra doganore e nisjes në rast të një procedure normale, ose nga një dërgues i autorizuar kur zbatohet neni 207(4)(a) i Kodit.

3.2 Nëse është marrë vendim për të aplikuar procedurën e vazhdimësisë së punës, çdo e dhënë transiti që ka Numrin e Referencës Lokale (NRL) ose MRN të një operacioni transit tërhiqet nga sistemi elektronik i transitit në bazë të informacioneve të siguruara nga personi, i cili i ka plotësuar ato të dhëna në sistemin elektronik të transitit.

3.3 Autoritetet doganore monitorojnë procedurën e vazhdimësisë së punës PVP me qëllim shmangien e keqpërdorimit të saj.

4. Në rast mosfunksionimi të sistemit informatik të përdorur nga mbajtësi i regjimit për depozitimin e të dhënave të deklaratës transit me anë të teknikave informatike të përpunimit të të dhënave apo e lidhjes elektronike midis këtij sistemi informatik dhe sistemit elektronik të transitit:

- duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në pikën 3 të këtij Aneksi;
- mbajtësi i regjimit duhet të informojë autoritetet doganore kur sistemi i tij informatik ose lidhja elektronike midis këtij sistemi dhe sistemit elektronik të transitit funksionojnë përsëri.

5. Mosfunksionimi i sistemit informatik të dërguesit të autorizuar ose lidhjes elektronike midis këtij sistemi dhe sistemit elektronik të transitit.

Në rast mosfunksionimi të sistemit informatik të dërguesit të autorizuar ose lidhjes elektronike midis këtij sistemi dhe sistemit elektronik të transitit zbatohet procedura e mëposhtme:

- duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në pikën 4 të këtij Aneksi;
- nëse një dërgues i autorizuar bën më shumë se 2% të deklarimeve të tija vjetore me procedurën e vazhdimësisë së punës, duhet të rishikohet autorizimi me qëllim që të vlerësohet nëse përmbushen ende kushtet përkatëse për autorizimin.

6. Regjistrimi i të dhënave nga autoritetet doganore.

Në dy rastet e përmendura në pikat 4 dhe 5 të këtij Aneksi, autoritetet doganore mund t'i lejojnë mbajtësit të regjimit të dorëzojë në zyrën doganore të nisjes një kopje të deklaratës transit (duke përdorur DAV ose DSHT/DSHTS) me qëllim që të përpunohet nga sistemi elektronik i transitit.

KREU III

Funskionimi i procedurës

7. Garancia individuale e dhënë nga një garantues

Nëse zyra doganore e nisjes për një operacion transiti është e ndryshme nga zyra doganore e garancisë, kjo e fundit mban një kopje të dorëzanisë së garantuesit. Origjinali paraqitet nga mbajtësi i regjimit në zyrën doganore të nisjes, ku edhe ruhet. Nëse është e nevojshme zyra doganore e nisjes mund të kërkojë përkthimin në gjuhën shqipe ose në një nga gjuhët zyrtare të vendeve të përfshira në operacionin transit.

8. Nënshkrimi i deklaratës transit dhe dorëzania e mbajtësit të regjimit.

Duke nënshkruar deklaratën e transitit mbajtësi i regjimit merr përgjegjësi përsa më poshtë:

- Saktësinë e informacionit të dhënë në deklaratë,
- Vërtetësinë e dokumentave të paraqitura,
- Përmbushjen e të gjitha detyrimeve që lidhen me vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit.

9. Masat identifikuese.

Kur zbatohet neni 617 i këtij Vendimi, zyra doganore e nisjes shënon në kutinë D të deklaratës së transitit krahas zërit "vendosja e plumbceve" fjalinë "Kontroll i zyrës së nisjes" dhe:

— Përjashtim nga depozitimi i garancisë — 99201.

10. Shënimet në deklaratën e transitit dhe çlirimi i mallrave.

- Zyra doganore e nisjes duhet të regjistrojë rezultatet e verifikimit në çdo kopje të deklaratës së transitit.
- Nëse rezultatet e verifikimit janë në përputhje me deklaratën, zyra doganore e nisjes duhet të çlirojë mallrat dhe të regjistrojë datën në kopjet e deklaratës së transitit.

11. Transporti i mallrave të vendosura nën regjimin e transitit mbulohet duke u shoqëruar me kopjet 4 dhe 5 të DAV-it ose me një nga kopjet e DSHT/DSHTS të cilat i janë dhënë mbajtësit të regjimit nga zyra doganore e nisjes. Kopja 1 e DAV dhe një kopje e DSHT/DSHTS mbahen pranë zyrës doganore të nisjes.

12. Zyra doganore e transitit

12.1 Transportuesi duhet të paraqesë një çdo zyrë doganore transiti, ku edhe ruhet, një njoftim kalimi të bërë sipas një formulari të përcaktuar në Kreun II, Kapitulli V të këtij Aneksi. Në vend të njoftim-kalimit zyra doganore e transitit mund të pranojë dhe të mbajë një fotokopje të kopjes 4 të DAV ose të DSHT / DSHTS.

12.2 Nëse mallrat transportohen përmes një zyrë doganore transiti të ndryshme nga ajo e deklaruar, zyra doganore aktuale e transitit duhet të informojë zyrën doganore të nisjes.

13. Paraqitja në zyrën doganore të destinacionit

13.1. Zyra doganore e destinacionit duhet të regjistrojë kopjet e deklaratës së transitit, të shënojë datën dhe orën e mbërritjes dhe detajet e kontrolleve të kryera.

13.2. Një operacion transiti mund të përfundojë në një zyrë të ndryshme nga zyra doganore e deklaruar në deklaratën e transitit. Kjo zyrë bëhet zyra doganore aktale e destinacionit.

Nëse zyra doganore reale e destinacionit ndodhet në një shtet të ndryshëm nga ai i zyrës doganore të deklaruar, zyra doganore aktuale duhet të vendosë në kutinë "I" të deklaratës transit "*kontroll nga zyra e destinacionit*" përveç shpjegimeve të zakonshme që duhet të bëjë si dhe shton shprehjen e mëposhtme:

— *Ndryshime: zyra doganore ku u paraqitën mallrat ..... (numri referencës së zyrës doganore) — 99 203.*

13.3. Kur zbatohet paragrafi i dytë i pikës 13.2 të këtij Aneksi dhe kur deklarata transit mban shprehjen e mëposhtme, zyra doganore aktuale e destinacionit duhet t'i mbajë mallrat nën kontroll dhe nuk duhet të lejojë largimin e tyre përveçse shtetit që ka juridiksion mbi zyrën doganore të nisjes, përveçse nëse është autorizuar specifikisht nga ky i fundit:

Dalja nga R.SH. që i nënshkrohet kufizimeve ose tarifave sipas legjislacionit në fuqi.

14. Vërtetimi

Vërtetimi mund të përgatitet në hapësirën e posaçme e cila gjendet në anën e pasme të kopjes 5 të DAV-it, ose sipas modelit të përcaktuar në Aneksin 72-03.

15. Rikthimi i kopjes 5 të DAV ose kopjes së DSHT/DSHTS.

Autoriteti doganor kompetent i vendit të destinacionit duhet t'ja rikthejë menjëherë kopjen 5 të DAV autoritetit doganor të vendit të nisjes, sidoqoftë jo më vonë se 8 ditë nga data kur operacioni përfundoi. Nëse është përdorur DSHT/DSHTS, atëherë do të rikthehet një kopje e tij sipas të njëjtave kushte si kopja 5.

16. Informimi i mbajtësit të regjimit dhe prova alternative e mbylljes së regjimit.

Nëse kopjet e përmendura në pikën 15 të këtij Aneksi nuk i janë rikthyer autoritetit doganor të vendit të nisjes brenda 30 ditëve nga koha limit për paraqitjen e mallrave në

zyrën doganore të destinacionit, ky autoritet duhet të informojë mbajtësin e regjimit dhe t'i kërkojë atij të sigurojë prova që regjimi është mbyllur në mënyrë korrekte.

17. Procedura e hetimit

17.1. Nëse zyra doganore e nisjes nuk ka marrë prova brenda 60 ditësh të afatit kohor për paraqitjen e mallrave në zyrën doganore të destinacionit që ky regjim është mbyllur në mënyrë korrekte, autoriteti doganor i vendit të nisjes duhet të kërkojë mënjëherë informacionin e nevojshëm për mbylljen e regjimit. Nëse gjatë procedurës së hetimit rezulton se regjimi transit nuk mund të mbyllet, autoriteti doganor i vendit të nisjes duhet të vendosë nëse ka lindur një borxh doganor.

Nëse ka lindur një borxh doganor, autoriteti doganor i vendit të nisjes duhet të marrë masat e mëposhtme:

—= të përcaktojë debitorin;
— të përcaktojë autoritetin doganor përgjegjës për njoftimin e borxhit doganor në përputhje me nenin 96 (1) të Kodit.

17.2. Nëse, para skadimit të këtyre afateve kohore, autoriteti doganor i vendit të nisjes merr informacion se regjimi i transitit nuk është mbyllur në mënyrë korrekte, ose dyshon që nuk do të mbyllet në mënyrën e duhur, ai dërgon menjëherë kërkesën.

17.3. Procedura e hetimit duhet të fillojë edhe kur është zbuluar më pas se prova e mbylljes të regjimit transit është falsifikuar dhe kjo procedurë është e nevojshme për të përmbushur objektivat e pikës 17.1 të këtij Aneksi.

18. Garancia— Shuma referencë

18.1 Për zbatimin e nenit 191 mbajtësi i regjimit duhet të sigurohet që shuma në fjalë nuk e kalon shumën referencë, duke marrë në konsideratë çdo operacion për të cilin regjimi nuk

është mbyllur ende.

18.2. Mbajtësi i regjimit duhet të informojë zyrën doganore të garancisë kur shuma referencë bie nën nivelin e mjaftueshëm për të mbuluar operacionet e tij të transitit.

19. Çertifikatat e garancisë globale, çertifikatat për përjashtim nga depozitimi i garancisë dhe kuponat e garancisë individuale.

19.1. Në zyrat doganore të nisjes duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

— çertifikata e garancisë globale, sipas modelit të përcaktuar në KapitullinVI;
— çertifikata për përjashtim nga depozitimi i garancisë, sipas modelit të përcaktuar në Kapitullin VII;
— kuponë të garancisë individualë, sipas modelit të përcaktuar në Aneksin 32-06.

19.2 Të dhënat e çertifikatave dhe kuponat duhet të vendosen në deklaratat transit.

20. Listë ngarkesat. e veçanta

20.1. Autoriteti doganor mund të pranojë deklaratën e transitit të plotësuar nga listë ngarkesa të cilat nuk përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kreun II, të këtij Aneksi.

Lista të tilla mund të përdoren vetëm kur:

— janë të prodhuara nga shoqëri të cilat përdorin një sistem elektronik të përpunimit të të dhënave për mbajtjen e të dhënave të tyre;
— janë të hartuara dhe të plotësuara në një mënyrë të tillë që të përdoren pa vështirësi nga autoriteti doganor;
— përfshijnë, për secilin artikull, informacionin e kërkuar në Kreun II, Kapitulli IV të këtij Aneksi.

20.2. Mund të autorizohet përdorimi si listë ngarkesë, sipas pikës 20.1 të këtij Aneksi, edhe i

listave përshkruese të hartuara për qëllimet e kryerjes së njoftimit të formaliteteve të /eksportit, edhe nëse lista të tilla janë të bëra nga shoqëri që nuk përdorin një sistem elektronik të përpunimit të të dhënave për mbajtjen e të dhënave të tyre.

20.3 Mbajtësi i regjimit i cili përdor një sistem elektronik të përpunimit të të dhënave për mbajtjen e të dhënave të tij dhe përdor listë ngarkesa të veçanta, mund t'i përdorë ato edhe për operacionet transit duke përfshirë vetëm një tip mallrash nëse ky thjeshtim është i nevojshëm në funksion të sistemit të mbajtësit të regjimit.

21. Përdorimi i plumbçeve të një lloji të veçantë.

Mbajtësi i regjimit vendos, në krah të shprehjes *"plumbçe të vendosura"* në kutinë "D". *"Kontroll nga zyra e nisjes"* të deklaratës së transitit, numrin e plumbçeve dhe numrin identifikues individual të plumbçes së vendosur.

22 Dërguesi i Autorizuar – Para-vërtetimi dhe formalitetet në nisje

22.1 Për zbatimin e pikave 3 dhe 5 të këtij Aneksi, autorizimi duhet të përcaktojë që në kutinë *'C. zyra e nisjes'* deklarata transit:

— të jetë vulosur më parë me vulën e zyrës doganore të nisjes nënshkruar nga një punonjës doganor i asaj zyre, ose;
— të jetë vulosur nga dërguesi i autorizuar me një vulë të veçantë të miratuar nga autoritetet kompetente dhe të përdorë formularët e përcaktuar në Kreun II, Kapitullin II të këtij Aneksi. Vula mund të printohet paraprakisht në formularët nëse përdoret një printer i miratuar për këtë qëllim.

Dërguesi i autorizuar duhet të plotësojë kutinë duke shënuar datën në të cilën mallrat janë dërguar dhe duhet ti caktojë një numër deklaratës transit në përputhje me rregullat e përcaktuara në autorizim.

22.2 Autoriteti doganor mund të vendosë përdorimin e formularëve që mbajnë një shenjë dalluese si mjet identifikues.

23. Dërguesi i Autorizuar – masa sigurie për vulën

Dërguesi i autorizuar duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për ruajtjen e vulave të veçanta ose formularëve që mbajnë vulën e zyrës doganore të nisjes ose një vulë të veçantë.

Ai duhet të informojë autoritetin doganor për masat e sigurisë që po ndërmerr në përputhje me sa më lart.

23.1. Në rast se ndonjë person keqpërdor ndonjë nga formularët paraprakisht të vulosur me vulën e zyrës doganore të nisjes, ose me një vulë të veçantë, dërguesi i autorizuar do të jetë përgjegjës, pa paragjykuar ndonjë procedim penal, për pagesën e detyrimit dhe pagesave të tjera të pagueshme në një vend të caktuar në lidhje me mallrat e transportuara të cilat janë objekt i formularëve të tillë, përveç nëse ai mund të bindë autoritetin doganor nga i cili u autorizua, që ai ndërrmori masat që u kërkuan prej tij sipas pikës 23.

24. Dërguesi i Autorizuar — Informacioni që duhet të plotësohet në deklarata

24.1 Përpara dërgimit të mallrave, dërguesi i autorizuar duhet të plotësojë deklaratën transit dhe kur është e nevojshme, të vendosë në kutinë 44 itinerarin e vendosur në përputhje me nenin 615 të këtij Vendimi dhe në kutinë "D. Kontrolli nga zyra e nisjes" të plotësojë periudhën e vendosur në përputhje me nenin 614 të këtij Vendimi, brenda së cilës mallrat duhet të paraqiten në zyrën doganore të destinacionit, masat identifikuese të zbatuara dhe shprehjen e mëposhtme:

— Dërguesi i Autorizuar — 99206

24.2. Nëse autoriteti kompetent i vendit të nisjes kontrollon një dërgesë para nisjes së saj, duhet

të regjistrojë këtë fakt në deklaratë, në kutinë "D. Kontrolli nga zyra e nisjes".

24.3. Pas ngarkesës, kopja 1 e DAV apo kopja e DSHT/DSHTS, që shoqërojnë ngarkesën, duhet të dorëzohet pa vonesë në zyrën doganore të nisjes, sipas rregullave të përcaktuara në autorizim. Kopjet e tjera duhet të shoqërojnë mallrat në përputhje me pikën 11 të këtij Aneksi.

25. Dërguesi i Autorizuar – Mosnënshkrimi

25.1 Dërguesi i autorizuar mund të lejohet nga autoritetet doganore të mos e nënshkruajë deklaratën transit që ka vulën e veçantë të përmendur në Kapitullin II të Kreut II të këtij Aneksi, e cila është e bërë nga sistemi elektronik i përpunimit të të dhënave. Mosnënshkrimi duhet te plotësojë kushtin që dërguesi i autorizuar paraprakisht t'u ketë dhënë autoriteteve doganore një dokument me shkrim, ku ai merr përsipër se është mbajtës i regjimit për të gjitha operacionet transit të kryera nën deklaratat e transitit që mbajnë vulën e veçantë.

25.2. Deklaratat e transitit të bëra në përputhje me pikën 25.1 të këtij Aneksi, në kutinë e rezervuar për nënshkrimin e mbajtësit të regjimit, duhet të përmbajnë shprehjen e mëposhtme:

— Lejimi i mosnënshkrimiit — 99207.

26. Pritësi i autorizuar - Detyrimet

26.1 Kur mallrat mbërrijnë në vendin e specifikuar në autorizim, pritësi i autorizuar duhet të informojë menjëherë zyrën doganore të destinacionit për mbërritjen. Ai duhet të tregojë datën e mbërritjes, gjendjen e çdo vule të vendosur dhe çdo parregullsi në kopjet 4 dhe 5 të DAV ose në kopjen e DSHT/DSHTS, të cilat shoqërojnë mallrat, dhe dorëzimin e mallrave në zyrën doganore të destinacionit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në autorizim.

26.2. Zyra doganore e destinacionit duhet të bëjë shënimet e përcaktuara në pikën 13 të këtij Aneksi në kopjet 4 dhe 5 të DAV ose në kopjen e DSHT/DSHTS.

TITULLI II

KREU I

Modelet e vulave të përdorura për procedurën e vazhdimësisë së punës

1. Vula nr.1

(përmasat: 26 x 59 mm)

PROCEDURA REZERVË NCTS

REGJIM TRANSITI / PROCEDURË E TRANSITIT TË PËRBASHKËT

ASNJË E DHËNË E DISPONUESHME NË SISTEM

2. Vula nr. 2

(përmasat: 26 x59 mm)

PROCEDURA E VAZHDIMËSISË SË PUNËS

REGJIM TRANSITI / PROCEDURË E TRANSITIT TË PËRBASHKËT

ASNJË E DHËNË E DISPONUESHME NË SISTEM

KREU II

Modelli i vulave të veçanta të përdorura nga dërguesi i autorizuar

1	2
3	4
5	6

(përmasat: 26 x59 mm)

1. Stema, ndonjë simbol tjetër ose kodi që përcakton shtetin
2. Numri i referencës në zyrën doganore të nisjes

3. Numri i deklaratës
4. Data
5. Dërguesi i autorizuar
6. Numri i autorizimit

KREU III

Listë ngarkesa

Nr.	Shenjat, numrat dhe lloji i paketimit, përshkimi i mallrave	Shteti i nisjes/eksportit	peshabruto (kg)	Rezervuar për përdorim zyrtar

(nënshkrimi)

KREU IV

Shënime shpjeguese mbi listë ngarkesën

Seksioni 1

1. Përkufizimi

1.1 Listë ngarkesa nënkupton një dokument që ka karakteristikat e përshkruara në këtë Aneks;

1.2 Mund të përdoret me deklaratën e transitit në zbatim të pikës 2.2 të këtij Aneksi.

2. Fomulari i listë ngarkesës

2.1 Vetëm pjesa e përparme mund të përdoret si listë ngarkese;

2.2 Karakteristikat e një listë ngarkese janë:

(a) Koka 'Listë ngarkesë';

(b) Një kuadrat 70x55 mm i ndarë në pjesën e sipërme 70 me 15 mm dhe në pjesën e poshtme 70 me 40 mm;

(c) Kolonat me koka si në vijim dhe të renditura sipas rendit të mëposhtëm :

- numri serial;
- shenjat, numrat, numri dhe lloji i paketimit, përshkrimi i mallrave;
- vendi i nisjes/eksportit;
- pesha bruto (kg);
- rezervuar për administratën;

Përdoruesit mund të rregullojnë gjerësinë e kolonave sipas nevojave të tyre. Megjithatë, koka e kolonës 'rezervuar për administratën' duhet gjithmonë të jetë të paktën 30 mm e gjerë. Përdoruesit mundet gjithashtu të vendosin vetë si t'i përdorin hapësirat e tjera të ndryshme nga ato të referuara në pikat (a), (b) dhe (c).

2.3 Një vijë horizontale duhet të hiqet menjëherë poshtë plotësimit të fundit dhe çdo hapësire boshe të pa përdorur duhe ti hiqet vizë përgjatë gjatësisë së tyre për të parandaluar shtesa të mëvonshme.

Seksioni 2

Të dhënat që duhet të plotësohen në tituj të ndryshëm

1. Kutia

1.1 Pjesa e sipërme

Nëse një listë ngarkesë shoqëron një deklaratë transiti, mbajtësi i regjimit/procedurës duhet të vendosë 'T1', 'T2' ose 'T2F' në pjesën e sipërme të kutisë.

1.2 Pjesa e poshtme

Të dhënat e renditura në paragrafin 4 të seksionit III të më poshtëm duhet të plotësohen në këtë pjesë të kutisë.

2. Kolonat

2.1 numri serial

Çdo artikull i paraqitur në listë ngarkesë duhet të pasohet nga një numër serial.

2.2 Shenjat, numrat, numri dhe lloji i paketimeve, përshkrimi i mallrave

Të dhënat e kërkuara duhet të jepen në përputhje me Aneksin B SHTOJCA A.

Nëse listë ngarkesa shoqëron një deklaratë transiti, ajo duhet të përfshijë informacionin e plotësuar në kutitë 31 (Paketimet dhe përshkrimi i mallrave), 40 (deklarata

përmbledhëse/dokumenti i mëparshëm), 44 (informacion shtesë, dokumentat e paraqitura, çertifikatat dhe autorizimet) dhe nëse është e nevojshme, 33 (Kodi i mallit) dhe 38 (pesha neto (kg), të deklaratës transit.

2.3 Shteti i nisjes/eksportit
Plotësohet me emrin e shtetit nga i cili po dërgohen ose eksportohen mallrat.

2.4 pesha bruto (kg)
Plotësohen detajet që shënohen në kutinë 35 të DAV (shiko Aneksin B SHTOJCA A).

Seksioni 3

Përdorimi i listë ngarkesës

1. Një deklaratë transit mund të mos ketë njëkohësisht listë ngarkesën dhe një ose më shumë faqe të vazhdimësisë së punës të bashkëlidhura me të.

2. Kur përdoret një listë ngarkesë, kutive 15 (Shteti i nisjes/eksportit), 32 (Nr artikullit), 33 (kodi i mallit), 35 (pesha bruto (kg)), 38 (pesha neto (kg)), 40 (deklarata përmbledhëse/dokumenti i mëparshëm) dhe, nëse është nevojshme, 44 (informacioni shtesë, dokumentat e paraqitura, çertifikatat dhe autorizimet) të formularit të deklaratës transit duhet t'u hiqet vizë dhe kutia 31 (paketimet dhe përshkrimi mallrave) mund të mos përdoret për të plotësuar me shenjat, numrat dhe llojet e paketimeve ose përshkrimin e mallrave. Në kutinë 31 të deklaratës transit (paketimet dhe përshkrimi mallrave) duhet të vendoset një referencë e numrit serial dhe simboli i listë ngarkesave të ndryshme.

3. Listë ngarkesa duhet të bëhet në të njëjtin numër kopjesh sikurse kopjet e deklaratës transitit me të cilat ajo lidhet.

4. Kur regjistrohet një deklaratë transiti, listë ngarkfesës i jepet i njëjti numër regjistrimi sikurse kopjeve të deklaratës së transitit me të cilat ajo lidhet. Ky numër duhet të plotësohet duke përdorur një vulë që përfshin emrin e zyrës doganore të nisjes, ose të shkruhet me dorë. Nëse

plotësohet me dorë, duhet të miratohet me vulën zyrtare të zyrës doganore të nisjes.
Nuk është e detyrueshme për një punonjës të zyrës doganore të nisjes të nënshkruajë formularët.

5. Nëse disa listë ngarkesa janë bashkëlidhur me një deklaratë transiti, listat duhet të mbajnë një numër serial të caktuar nga mbajtësi i regjimit, dhe numri i listë ngarkesave të bashkëlidhura, duhet të plotësohet në kutinë 4 (listë ngarkesat).

6. Formularët e listë ngarkesave duhet të printohen në letër e përgatitur për qëllime shkrimi, të peshojë të paktën 40 g/m^2 dhe të jetë mjaftueshmërisht e fortë për të parandaluar grisjet ose zhubrosjet e lehta gjatë përdorimit normal. Ngjyra mund të vendoset nga të interesuarit. Formati i formularëve duhet të jetë 210 me 297 mm, me një tolerancë maksimale prej 5 mm më pak dhe 8 mm më shumë në gjatësi.

KREU V

Njoftim kalimi transit

<table>
<tr><td colspan="3">TC 10 – NJOFTIM KALIMI TRANSIT

Identifikimi i mjeteve të transportit .....</td></tr>
<tr><td colspan="2">DEKLARATË TRANSITI</td><td rowspan="2">NUMRI REFERENCËS TË ZYRËS DOGANORE TË TRANSITIT TË DEKLARUAR</td></tr>
<tr><td>Tipi (T1,T2, ose T2F) dhe numri</td><td>Numri referencës të zyrës doganore të nisjes</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="3"></td><td>PËR PËRDORIM ZYRTAR</td></tr>
<tr><td>Data e transitit

.....</td></tr>
</table>

	..... (nënshkrim) Vula zyrtare

KREU VI

Çertifikata e garancisë globale

TC31 – ÇERTIFIKATA E GARANCISË GLOBALE

Faqja e përparme

1.E vlefshme deri	Dita	Muaji/Viti	2.Numri
3.Mbajtësi i regjimit/procedurës (emri dhe mbiemri, ose emri i shoqërisë, adresa e plotë dhe shteti)			
4.Garantuesi (emri dhe mbiemri, ose emri i shoqërisë, adresa e plotë dhe shteti)			
5. Zyra doganore e garancisë (numri i referencës)			
6. Shuma referencë Kodi i monedhës	Në shifra:	Me fjalë	

7. Zyra doganore e garancisë vërteton që mbajësi i regjimit/procedurës i përmendur më sipër ka depozituar një garanci globale e cila është e vlefshme për operacionet transit /procedurën e transitit të përbashkët përmes territoreve doganore të renditura si më poshtë, emrat e të cilëve nuk janë hequr: Bashkimi Evropian- Kosova–Islanda – Maqedonia – Norvegjia –Zvicera – Turqia (*) *(*) Vetëm për operacionet transit në R.Sh.*		
8. Shënime të veçanta		
9. Periudha e vlefshmërisë e zgjatur deri më dd/mm/vv *(e përfshirë)* Bërë Në.....më..... (vendi) (data) (Nënshkrimi dhe vula e zyrës doganore të garancisë)		Bërë Në.....më..... (vendi) (data) (Nënshkrimi dhe vula e zyrës doganore të garancisë)

Faqja e pasme

10. Personat e autorizuar për të nënshkruar deklaratat e transitit në emër të mbajtësit të regjimit/procedurës.

11. Mbiemër, emër dhe modeli i nënshkrimit të personit të autorizuar	12. Nënshkrimi i mbajtësit të regjimit/procedurës (*)	11. Mbiemër, emër dhe modeli i nënshkrimit të personit të autorizuar	12. Nënshkrimi i mbajtësit të regjimit/procedurës (*)

(*) Nëse mbajtësi i regjimit/procedurës është një person juridik, personi nënshkrimi i të cilit shfaqet në kutinë 12 duhet t'i shtojë nënshkrimit të tij mbiemrin, emrin dhe pozicionin në cilin ai po nënshkruan.

KREU VII

Çertifikata e mosdhënies së garancisë

TC33 – ÇERTIFIKATË E MOS DHËNIS SË GARANCISË

Faqja e parë

Njësia e vlefshme	Dita	Muaj/Viti	2.Numri
3.Mbajtësi i regjimit/procedurës (Mbiemër dhe mbiemër, ose emri i kompanisë, adresa e plotë dhe shteti)			
4.Garantuesi (Mbiemër dhe mbiemër, ose emri i kompanisë, adresa e plotë dhe shteti)			
5.Zyra doganore e garancisë (numri i referencës)			
6. Shuma e referencës Kodi monedhës	Në shifra:	Me fjalë	

<table>
<tr><td colspan="2">7.Zyra doganore e garancisë vërteton që mbajësi i regjimit/procedurës, i përmendur më sipër ka ofruar një garanci të plotë e cila është e vlefshme operacionet e tranzitit përmes territoreve doganore të renditura më poshtë, emrat e të cilëve nuk janë hequr:
Bashkimi Evropian -Kosova – Islanda – Maqedonia – Norvegjia –Zvicera – Turqia – (*)
(*) Vetëm për operacionet transit në R.Sh.</td></tr>
<tr><td colspan="2">8 . Vëzhgime të veçanta</td></tr>
<tr><td>9. Periudha e vlefshmërisë së zgjatur deri më
Dd/mm/vv e përfshirë</td><td></td></tr>
<tr><td>Bërë
Në ..... më .....
(vendi)(data)

(Nënshkrimi dhe vula e zyrës doganore të garancisë)</td><td>Bërë
Në ..... më .....
(vendi)(data)

(Nënshkrimi dhe vula e zyrës doganore të garancisë)</td></tr>
<tr><td colspan="2">(*) Vetëm për operacionet transit të Bashkimit Evropian.</td></tr>
</table>

Pjesa e prapme

10.Personat e autorizuar për të nënshkruar deklaratat e tranzitit në emër të mbajtësit të regjimit/procedurës.

11. Mbiemër, emër dhe specimeni i nënshkrimit të personit të autorizuar person	12. Nënshkrimi i mbajtësit të procedurës (*)	11. Mbiemër, emër dhe specimeni i nënshkrimit të personit të autorizuar	12. Nënshkrimi i mbajtësit të procedurës (*)
(*) *Nëse mbajtësi i regjimit/procedurës është një person juridik, personi nënshkrimi i të cilit shfaqet në kutinë 12 duhet t'i shtojë nënshkrimit të tij mbiemrin, emrin dhe pozicionin në cilin ai po nënshkruan.*			

KREU VIII

Shënime shpjeguese mbi certifikatat e garancisë globale dhe çertifikatat e mosdhënies së garancisë

1. Të dhënat për t'u vendosur në faqen e parë të një certifikate

Pasi të jenë lëshuar, nuk duhet të ketë ndryshime, shtesa apo fshirje të vërejtjeve në kutitë 1 deri 8 për çertifikatat e garancisë globale dhe kutitë 1 deri 7 të çertifikatave të mosdhënies së garancisë.

1.1 Kodi i monedhës

Shtetet duhet të vendosin në kutinë 6 të certifikatës së garancisë globale dhe në kutinë 5 të çertifikatës për mosdhënien e garancie kodin e monedhës së përdorur ISO ALPHA3 (ISO 4217).

1.2 Miratimet

Nëse mbajtësi i regjimit/procedurës ka marrë përsipër të paraqesë të gjitha deklaratat e tij të transitit në një zyrë të veçantë doganore të nisjes, emri i zyrës duhet të vendoset me shkronja të mëdha shtypi, sipas rastit, në kutinë 8 të çertifikatës së garancisë globale ose në kutinë 7 të çertifikatës për mosdhënien e garancisë.

1.3 Miratimi i çertifikatave në rastet kur vlefshmëria e tyre zgjatet

Nëse periudha e vlefshmërisë së çertifikatës është zgjatur, zyra doganore e garancisë duhet të miratojë, sipas rastit, kutinë 9 të çertifikatës së garancisë globale ose kutinë 8 të çertifikatës për mosdhënien e garancie,.

2. **Të hollësitë për t'u vendosur në anën e pasme të një çertifikate personat e autorizuar për të nënshkruar deklaratat e transitit**

2.1 Kur lëshohet një çertifikatë, ose në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj, mbajtësi i regjimit/procedurës duhet të vendosë në pjesën e prapme emrat e personave që ai autorizon për të nënshkruar deklaratat e transitit. Secila nga këto të dhëna duhet të përmbajë mbiemrin dhe emrin e personit të autorizuar dhe një specimen të nënshkrimit të tij dhe secili duhet të bashkë nënshkruhet nga mbajtësi i regjimit/procedurës. Mbajtësi i regjimit/procedurës ka mundësi të heqë një vizë përgjatë çdo kutie që ai nuk dëshiron të përdorë.

2.2 Mbajtësi i regjimit/procedurës mund të revokojë në çdo kohë një autorizim të tillë.

2.3 Çdo person, emri i të cilit është i vendosur në pjesën e prapme të një çertifikate të këtij lloji, i paraqitur në zyrën doganore të nisjes, është përfaqësues i autorizuar i mbajtësit të regjimit/procedurës.

3. **Kërkesat teknike**

3.1 Formularët për çertifikatat e garancisë globale dhe çertifikatës për mosdhënien e garancisë duhet të shtypen në fletë të bardhë, pa pulpë mekanike dhe të peshojë të paktën 100 g / m2. Të dy anët duhet të kenë një sfond arasbeskash në mënyrë që të zbulojnë çdo fallsifikim me mjete mekanike ose kimike. Formularët duhet të jetë:

- në ngjyrë të gjelbër për çertifikatat e garancisë globale,
- në ngjyrë blu të zbehtë për çertifikatat e mosdhënies së garancisë.

3.2 Formati i formularëve duhet të jetë 210 me 148 mm.

3.3 D.P.D. duhet të jetë përgjegjëse për shtypjen e formularëve ose të sigurohen që ato të jenë të shtypura. Secila çertifikatë duhet të ketë një numër urik identifikimi.

3.4 Mbi to nuk duhet të bëhen fshirje ose korigjime. Ndryshimet duhet të bëhen duke hequr vizë

mbi te dhenat e pasakta dhe, kur eshte e pershtatshme, duke shtuar ato te kerkuarat. <;do korigjim i tille duhet te nenshkruhet nga personi qe ka here ndryshimin dhe te miratohet nga autoritetet doganore.

ANEKSI 80

GARANCIA PËR SHUMËN E SANKSIONEVE TË APLIKUARA PËR SHKELJEN

1. Për qëllime të pikës 2 të nenit 282 të Kodit, dokumenti i garancisë duhet të përmbajë të dhëna të hollësishme për:

a) garantuesin, apeluesin ndaj të cilit del garant, përfituesin (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) dhe shumën e përgjithshme të sanksionit/eve për të cilën/cilat lëshohet garancia, si dhe referencat e vendimit (numrin, datën dhe degën doganore që e ka nxjerrë aktin) në të cilin përcaktohet masa e penalitetit/sanksionit;

b) angazhimin e garantuesit për garantimin e vlerës së plotë të penalitetit dhe afatin e vlefshmërisë së garancisë, i cili do të jetë 6 (gjashtë) muaj nga momenti i lëshimit. Ky afat mund të zgjatet rast pas rasti, sipas kërkesës me shkrim dhe nevojave së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

c) angazhimin e garantuesit për pagesën prej tij pa kushte të shumës së përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen, menjëherë pas kërkesës dhe pa qenë nevoja për argumentim të saj nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Formati i garancisë është si më poshtë vijon.

FORMATI I GARANCISË

(Institucioni garantues)

_____

Nr. _____ Prot. _____ më _____._____._____

GARANCI

PËR SHUMËN E SANKSIONEVE TË APLIKUARA PËR SHKELJE NË FUSHËN DOGANORE

Në emër të:……

Përfituesi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Duke qënë se Apeluesi/Shoqëria _____ po ushtron ankim ndaj vendimit të Degës së Doganës _____, bazuar në nenit 282 të ligjit nr. 102/2014 *"Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar;

Duke qënë se Apeluesi/Shoqëria për marrjen në shqyrtim të ankesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të paraqesë një garanci për shumën e përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti, sipas vendimit nr._____ datë _____ të Degës së Doganës _____, në shumën _____ (_____) lekë;

Me këtë dokument vërtetojmë se ne, _____ (institucioni garantues), marrim përsipër t'i paguajmë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, shumën totale prej _____ (_____) lekë shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar si më sipër.

Ne marrim përsipër ta kalojmë menjëherë dhe pa kushte këtë shumë në llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe pa qenë nevoja për të bërë argumentim të kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Me këtë garanci ju sigurojmë se nuk është e nevojshme t'i drejtoheni më parë Apeluesit/, Shoqërisë _____ për të realizuar pagesën në lidhje me këtë garanci.

Kjo garanci është e vlefshme 6 (gjashtë) muaj nga momenti i lëshimit. Ky afat mund të zgjatet rast pas rasti sipas nevojave dhe kërkesës me shkrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Me mbarimin e këtij afati, kjo garanci bëhet e pavlefshme dhe _____ (institucioni garantues) është i çliruar nga çdo lloj detyrimi, në lidhje me këtë garanci.

Nënshkrimet e përfaqësuesve të institucionit garantues

_____

SHTOJCA C DISPOZITA

KALIMTARE

ANEKSI 1	Kërkesat e përbashkëta për të dhënat mbi regjistrimin e operatorëve ekonomik dhe personave të tjerë në sistemin Asycuda World
ANEKSI 2	Aplikim për Informacion të Detyrueshëm Tarifor
ANEKSI 3	Vendim i Informacionit të Detyrueshëm Tarifor
ANEKSI 4	Deklarata e treguesve në lidhje me Vlerën Doganore
ANEKSI 5	Kode për t'u përdorur në formularë
ANEKSI 6	Aplikimi dhe Forma Autorizimit për Përdorimin e Proçedurës së Zhdoganimit Lokal
ANEKSI 7	Regjister per Autorizimin e Zhdoganimit Lokal
ANEKSI 8	Aplikime për autorizim për përdorimin e një regjimi të posaçëm, përveç transitit
ANEKSI 9	Autorizime për përdorimin e regjimeve të posaçme, përveç transitit
ANEKSI 10	Vula Speciale
ANEKSI 11	Aplikimi për Informacionin Detyrues të Origjinës
ANEKSI 12	Aplikimi për një Autorizim OEA
ANEKSI 13	Pyetësori i Vetë-vlerësimit
ANEKSI 14	Autorizim për operator ekonomik i autorizuar (OEA)

ANEKSI 1

Kërkesat e përbashkëta për të dhënat mbi regjistrimin e operatorëve ekonomik dhe personave të tjerë në sistemin Asycuda World.

1. Numri RIOE (NIPT/ NUIS)
21. Informacion shtesë	
22. Emri	Data……
Nënshkrimi	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autorizim për regjimi e përpunimit pasiv

- formulari vazhdues -

AL ……..(Numri i autorizimit)

18. Sistemi

□

19. Produkte zwvwndwsuese

Kodi i NK	Përshkrimi

20. Informacion shtesë


21.

Emri ..... Data……

Nënshkrimi .....

ANEKSI 10

VULA SPECIALE



1. **Kodi i zyrës doganore mbikëqyrëse**
2. **Kodi i zyrës doganore të daljes**
3. **Numri i dokumentit**
4. **Data**
5. **Eksportuesi i autorizuar**
6. **Autorizimi**

ANEKSI 11

APLIKIMI PËR INFORMACIONIN DETYRUES TË ORIGJINËS (IDO)

(ju lutemi të lexoni shënimet mbrapa, para se ta plotësoni)

1. Kërkuesi: (Emri & Adresa e plotë)	**2. Mbajtësi i caktuar për IDO:** (Emri & Adresa e plotë) (Vetëm nëse ka ndryshim nga Kutia 1)
3. Baza ligjore: (preferenciale/jo-preferenciale)	
4. (a) Përshkrimi i mallrave	**4. (b) Klasifikimi Tarifor:**
5. Përbërja e mallrave: *	**6. Çmimi ex-works: ***
7. Vendi i Origjinës i përcaktuar nga kërkuesi:	

8. Rregulli i konsideruar që është plotësuar: (shiko shënimin mbrapa) *

Materialet kryesore të përdorura	Vendi i Origjinës	Kreu Tarifor SH/Kodi NK	Vlera

9. Të lidhura që janë pranuar për përcaktimin e IDO së mallrave: (pika "4") *

☐ Mostra ☐ Fotografi ☐ Diagrama ☐ Broshura ☐ Të tjera

*Shënoni ndonjë veçanti që ka të bëjë me konfidencialitetin e kërkuar

10. A keni aplikuar më parë për IDO për mallra identike apo të ngjashme ?

☐ PO ☐ JO

Nëse po , ju lutemi të jepni detaje .....

11. A jeni në dijeni të ekzistencës së një IDO ose IDT për këto apo për mallra të njëjta?

☐ PO ☐ JO (pika "4")

Nëse po , ju lutemi të jepni detaje .....

Unë deklaroj se informacioni i dhënë në këtë aplikim është i vërtetë dhe i plotësuar nga njohuritë e mia më të mira. Unë jam dakort të ofroj një përkthim të ndonjë dokumenti në qoftë se do të kërkohet, dhe unë e pranoj se informacioni i ofruar, i ruajtur për këto veçanti të cilësuara si konfidenciale, mund të ruhet në bazën e të dhënave dhe të përdoren për qëllime të rregullores nr.....datë.../.../....

Emri:_____ **Firma:** _____ **Data:**
_____ **(ME GERMA KAPITALE)**

Telefon: _____ **Fax:**_____ **Adresë e-mailit:** _____

APLIKIMI PËR INFORMACIONIN DETYRUES TË ORIGJINËS (IDO)
(ju lutemi të lexoni shënimet mbrapa, para se ta plotësoni)

Shpjegime për plotësimin e Formës së Aplikimit

Të gjitha kutitë duhet të plotësohen me shkronja të mëdha kapitale dhe bojë të zezë. Aplikimet për IDO duhet të bëhen në përputhje me transaksionet tregtare të propozuara dhe duhet të përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme për të arritur në një vendim origjine. Aplikimi duhet të jetë në përputhje vetëm me një tip malli psh. produktet e mallrave, apo njësitë që klasifikohen në një kod të Nomeklaturës së Mallrave.

Forma e aplikimit e përfunduar sëbashku me ndonjë mostër që e ka shoqëruar, etj. duhet të dërgohen pranë Drejtorisë së Tarifës dhe e Origjinës

Email: s_origjina@dogana.gov.al

Kutia 1: Kërkuesi mund të jetë importuesi ose eksportuesi aktual ose agjenti doganor. Në qoftë se kërkuesi është një agjent doganor, Kutia 2 duhet të plotësohet gjithashtu në lidhje me mbajtësin e përcaktuar.

Kutia 3: Deklarimi nëse informacioni detyrues kërkohet për qëllime të origjinës preferenciale apo jo preferenciale.

Kutia 4: (a) Ky përshkrim duhet të jetë i detajuar mjaftueshëm, për të mundësuar identifikimin e mallrave (dhe klasifikimin në Nomeklaturën e Mallrave).

(b) duhet të vendoset kodi 8-shifrori i Nomeklaturës së Kombinuar të Mallrave, sikurse tregohet në Nomeklaturën e Mallrave të Shqipërisë.

Kutia 5: Për aq sa është e rëndësishme jepet përbërja e mallrave dhe metodat e përdorura për të përcaktuar përbërjen e tyre. Nomeklatura e mallrave shpesh tregon nënndarje psh. në rastin e produkteve bujqësore sipas përqindjes së përbërjes së mallrave. Në këto raste ndarja në përqindje duhet të tregohet këtu.

Kutia 6: Për aq sa është e rëndësishme, duhet të jepet çmimi ex-works.

Kutia 7: Kërkuesi është i ftuar për të shprehur opinionin e tij të vendit të origjinës së përcaktuar.

Kutia 8: Rregulli i veçantë i cili konsiderohet që është përmbushur dhe një shpjegim se si është plotësuar rregulli. Nëse është e nevojshme, shpjegimi duhet të përfshijë detaje të materialeve të përdorura në prodhimin e mallrave, klasifikimin e tyre tarifor dhe koston.

Për të dhënë detaje të tjera, nëse është e nevojshme, përdorni faqe të ndara nga formulari i aplikimi

Kutia 9: Çdo mostër, fotografi, plane, katalogë ose dokumente të tjera të vlefshme lidhur me përbërjen e mallrave ose materialeve përbërëse të tyre, të cilat mund të ilustrojnë proceset e

APLIKIMI PËR INFORMACIONIN DETYRUES TË ORIGJINËS (IDO)
(ju lutemi të lexoni shënimet mbrapa, para se ta plotësoni)

punimit apo prodhimit që këto materiale kanë pësuar duhet të bashkangjiten si anekse me vete nëse është e nevojshme.

Kutia 10: Një tregues nëse aplikuesi ose mbajtësi i propozuar ka aplikuar me parë për IDO për mallra identike apo të ngjashme duhet të jepet këtu.

Kutia 11: Çdo njohuri nga ana e aplikuesit ose të mbajtësit të propozuar për ekzistencën e një IDT (Informacioni Tarifor Detyrues) ose IDO (Informacioni Detyrues Origjinës) në përputhje me mallrat e të njëjtit lloj, duhet të përmenden dhe të citohen referencat.

Konfidenciteti: Në lidhje me kutitë 5, 6, 8 dhe 9 në veçanti, çdo informacion i ofruar, i cili duhet të trajtohet si konfidencial, duhet të shënohet qartësisht.

ANEKSI 12

Aplikimi për një Autorizim OEA

Shënim: Ju lutemi referojuni shënimit shpjegues kur plotësoni formularin

<table>
<tr><td>1. Aplikuesi</td><td colspan="2">Rezervuar për qëllime doganore</td></tr>
<tr><td colspan="2">2. Statusi ligjor i aplikuesit</td><td>3. Data e themelimit</td></tr>
<tr><td colspan="3">4. Adresa e vendit ku është i vendosur aplikuesi (operatori ekonomik)</td></tr>
<tr><td colspan="3">5. Vendndodhja e përhershme e biznesit</td></tr>
<tr><td colspan="2">6. Personi i kontaktit (emri, telefoni, faksi, e-mail)</td><td>7. Adresa e korrespondencës</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Numri Unik i Identifikimit të Subjektit NUIS (NIPT)</td><td>9. Numër identifikimi (tjetër nëse ka të tillë)</td></tr>
<tr><td colspan="3">10. Lloji i Autorizimit të kërkuar

❑ Autorizim OEAD– Thjeshtësime Doganore
∟ Autorizim OEAS – Siguria dhe Mbrojtja</td></tr>
<tr><td>11. Sektori ekonomik i aktivitetit</td><td colspan="2">12. Zyrat doganore ku kryhen aktivitete doganore</td></tr>
<tr><td>13. Informacioni i kalimit kufitar.</td><td colspan="2">14. Thjeshtësime ose lehtësira të dhëna aktualisht.</td></tr>
</table>

15. **Zyra ku mbahet dokumentacioni doganor:**
16. **Zyra përgjegjëse për sigurimin e të gjithë informacionit doganor:**
17. **Zyra ku mbahet kontabiliteti:**
18. **Nënshkrimi:** ……..….. **Emri:** …… **Numri i anekseve**: ..... **Pozicioni:** ..... **Data:** ……..

SHËNIME SHPJEGUESE
(për aneksin 12)

1. Aplikuesi:

Shënoni emrin e plotë të operatorit ekonomik aplikues.

2. Statusi ligjor i aplikuesit:

Shënoni statusin ligjor, siç përmendet në dokumentin e themelimit.

3. Data e themelimit:

Shënoni – me numra – ditën, muajin dhe vitin e themelimit.

4. Adresa e vendit ku është i vendosur aplikuesi (operatori ekonomik):

Shënoni adresën e plotë të vendit ku biznesi tuaj është themeluar.

5. Vendndodhja e përhershme e biznesit:

Shënoni adresën e plotë të vendndodhjes së përhershme të biznesit tuaj, aty ku kryhen aktivitetet kryesore.

6. Personi i kontaktit:

Shënoni emrin e plotë, numrat e telefonit, faksit dhe adresën e e-mail-it të personit të kontaktit të caktuar nga ju brenda kompanisë suaj, për t'u kontaktuar nga autoritetet doganore kur shqyrtojnë aplikimin.

7. Adresa e korrespondencës:

Plotësojeni vetëm kur ndryshon nga adresa e juaj e themelimit.

8 dhe 9. Numri Unik i Identifikimit të Subjektit NUIS (NIPT) dhe Numri i identifikimit (nëse ka një të tillë):

Vendos numrat e kërkuar.

Numrin unik të identifikimit të operatorit ekonomik siç është në dokumentin e regjistrimit.
Numrin e identifikimit tjetër të operatorit ekonomik (nëse ka një të tillë).

10. Lloji i Autorizimit të kërkuar:

Shënoni një kryq në kutinë përkatëse.

11. Sektori ekonomik i aktivitetit:

Përshkruaj aktivitetin tënd.

12. Zyrat doganore ku kryhen aktivitete doganore:

Shënoni emrat e zyrave doganore ku kryeni aktivitetet doganore dhe kodin/et përkatëse të këtyre zyrave.

13. Informacioni i kalimit kufitar:

Shënoni emrat e zyrave doganore që përdoren rregullisht për kalim kufitar.

14. Thjeshtime ose lehtësira të dhëna aktualisht:

Në rastin e thjeshtimeve të dhëna aktualisht, tregoni llojin e thjeshtësimit, proçedurën doganore përkatëse, dhe numrin e autorizimit.

Në rastin kur aplikuesi është mbajtës i një Autorizimi të barazvlefshëm të OEA të lëshuar në një vend tjetër, tregoni numrin e asaj çertifikate dhe vendin lëshues duke përdorur kodin vendit lëshues.

15, 16 & 17. Zyrat për dokumentacionet/informacion /kontabilitetin:

Shënoni adresat e plota të zyrave përkatëse. Nëse zyrat kanë të njëjtën adresë, plotësoni vetëm kutinë 15.

18. Emri, data dhe nënshkrimi i aplikuesit:

Nënshkrimi: nënshkruesi duhet të plotësoje pozicionin e tij pranë aplikuesit

Nënshkruesi duhet të jetë gjithmonë personi i cili përfaqëson në tërësi aplikuesin.

Emri: emri i aplikuesit dhe vula e aplikuesit.

Numri i anekseve: aplikuesi jep informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

1. Vështrim të përgjithshëm mbi aksionerët/pronarët kryesorë, duke dhënë emrat, adresat dhe interesat proporcionale të tyre. Vështrim i përgjithshëm mbi anëtarët e bordit të drejtuesve ose organi tjetër ekzekutiv. A njihen pronarët nga autoritetet doganore për sjellje jo të denjë të mëparshme?

2. Personin përgjegjës në administratën e aplikuesit për çështjet doganore.

3. Përshkrim të aktiviteteve të aplikuesit.

4. Specifikimin e detajeve të vendndodhjes të ambjenteve të ndryshme të aplikuesit dhe përshkrim i shkurtër i aktiviteteve në çdo ambjent. Specifikimin nëse aplikuesi dhe çdo ambjent vepron dhe funksionon brenda zinxhirit të furnizimit në emër dhe në interes të tij, ose kur vepron dhe funksionon në emër të tij dhe në interes të një personi tjetër, ose kur vepron dhe funksionon në emër dhe në interes të një personi tjetër.

5. Specifikimin nëse mallrat janë sjellë nga dhe/ose siguruar për shoqëri të cilat janë të bashkuara/të lidhura me aplikuesin.

6. Përshkrimin e strukturës së brendshme organizative të aplikuesit. Ju lutem bashkëlidhni, në qoftë se egziston, dokumentacionin për funksionet/kompetencat për çdo departament dhe/ose funksion.

7. Numrin e punonjësve në total për çdo sektor/ndarje.

8. Emrat e zyrtarëve kryesorë (drejtorët menaxhues, shefat e sektorëve, menaxherët e kontabilitetit, shefin e sektorit doganor, etj.) Përshkrimi i rutinave të miratuara në situata kur punonjësi kompetent nuk është i pranishëm, përkohësisht ose përherë.

9. Emrat dhe pozicionet brenda organizatës së aplikuesit të cilët kanë ekspertizë specifike doganore. Vlerësimi i nivelit të njohurive të këtyre personave në lidhje me përdorimin e teknologjisë IT në proçeset doganore dhe tregtare dhe çështje të përgjithshme tregtare.

10. Pranimin ose mospranimin e publikimit të informacionit në Autorizimin OEA në listën e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar, të përmendur në dispozitën përkatëse.

ANEKSI 13

Pyetësori i Vetë-vlerësimit

0.1	Shënim, rekomandohet që të lexoni Udhëzimet që mund të gjeni per OEA në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe BE-së.
0.2	Cilët sektorë/departamente keni përfshirë në proces për të përgatitur shoqërinë (kompaninë) tuaj për aplikim për OEA duke përfshirë dhe menaxhimin?
1.	**Informacion i kompanisë**
1.1.	**Informacion i përgjithshëm i kompanisë**
1.1.1.	Ju lutem jepni emrin, adresën, datën e themelimit dhe formën ligjore të organizimit të kompanisë aplikuese. Ju lutem përfshini dhe URL e adresës së internetit të kompanisë tuaj, nëse është rasti. Nëse kompania juaj është pjesë e një grupi, ju lutem tregoni nëse ndonjë nga njësitë e tjera në grup: a) ka aktualisht një Autorizim të OEA; ose b) ka aplikuar për statusin e OEA dhe janë aktualisht nën auditim nga autoriteti doganor.
1.1.2.	Ju lutem jepni detajet e mëposhtme (në qoftë se janë pjesë e formës ligjore të kompanisë tuaj): a) Detaje të plota rreth aksionerëve duke përfshirë përqindjet e tyre b) Detaje të plota rreth anëtarëve të bordit dhe/ose menaxherëve c) Detaje të plota rreth bordit këshillues dhe nëse ka, rreth bordit të drejtorëve. Detajet duhet të përfshijnë emrin dhe adresën e plotë, datën e lindjes dhe Numrin e Identifikimit (p.sh. numrin e kartës së identitetit (letërnjoftimit) ose numrin e sigurimeve).
1.1.3	Ju lutem tregoni emrin e personit përgjegjës për çështje doganore në administratën e aplikuesit. Detajet duhet të përfshijnë emrin dhe adresën e plotë, datën e lindjes dhe Numrin të Identifikimit (p.sh. numrin e kartës së identitetit (letërnjoftimit) ose numrin të sigurimeve)
1.1.4.	Ju lutem përshkruani shkurtimisht aktivitetin tuaj tregtar dhe theksoni pozicionin tuaj në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit (p.sh. prodhues, eksportues, spedicioner, mbajtës magazine doganore, agjent doganor, transportues, importues). Në qoftë se keni më shumë se një pozicion përfshijini të gjitha.
1.1.5.	Ju lutem specifikoni ambjentet, listoni adresat, emrin, numrat e telefonit dhe e-mail e pikave të kontaktit dhe një përshkrim të shkurtër të veprimeve të kryera më poshtë: a) ambjentet individuale të kompanisë tuaj si një njësi ligjore (ju lutem tregoni numrin e punonjësve në çdo departament) dhe b) ambjentet kur një palë e tretë kryen aktivitete të jashtme për kompaninë tuaj.
1.1.6.	Bleni nga/shisni tek bizneset me të cilat jeni të bashkuar? Po/Jo
1.1.7.	Përshkruani strukturën organizative të brendshme të kompanisë tuaj/përgjegjësitë e cdo departamenti.

1.1.8.	Ju lutem jepni emrat e menaxherëve të lartë:(Drejtorët, shefat e departamentave, shefin e financës/kontabilitetit, shefin e departamentit doganor dhe kështu me rradhë) të kompanisë dhe përshkruani shkurtimisht rregullat.
1.1.9.	Sa punonjës keni në biznesin tuaj?
1.1.10.	a) Ju lutem jepni emrat dhe pozicionin e personave brenda kompanisë tuaj të cilët kanë ekspertizë specifike doganore. b) Ju lutem detajoni shkurtimisht nivelin e njohurive të këtyre personave për sa i përket përdorimit të teknologjisë së IT në proceset doganore dhe tregtare dhe në përgjithësi në çështjet doganore.
1.1.11.	Unë këtu miratoj botimin e informacionit në Autorizimin e OEA në listën e operatorëve ekonomikë të autorizuar të përmendur në dispozitën përkatëse. Po/Jo Nëse po Firma…… Pozicioni i Nënshkruesit…… (Pyetësori i plotësuar duhet të nënshkruhet nga një Drejtor/Partner Menaxhues/Pronar i Vetëm sipas rastit, por në këtë rast rekomandohet që miratimi të jepet nga një nëshkrues i autorizuar) Data:……
1.1.12	Unë këtu miratoj shkëmbimin e informacionit në autorizimin e OEA për të garantuar implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me vendet e tjera për njohjen reciproke të statusit të operatorit ekonomik të autorizuar dhe masat në lidhje me sigurinë: Po/Jo Nëse po Firma…… Pozicioni i Nënshkruesit…… (Pyetësori i plotësuar duhet të nënshkruhet nga një Drejtor/Partner Menaxhues/Pronar i Vetëm sipas rastit, por në këtë rast rekomandohet që miratimi të jepet nga një nënshkrues i autorizuar) Data:……"
1.1.13	Në rast se ju keni miratuar njohjen reciproke në kutinë 1.1.12, ju lutem jepni dhe informacionin e mëposhtëm: Emrin me gërma kapitale:…… Rrugën dhe numrin me gërma kapitale:…… Kodin postar dhe qytetin me gërma kapitale:…… Vetëm karakteret në latinisht duhet të përdoren.

1.2.	**Vëllimi i biznesit**
1.2.1.	a) Jepni xhiron vjetore për tre vitet e fundit sipas kontabilitetit të plotë vjetor. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A.(e pa aplikueshme) b) Jepni fitimet neto vjetore ose humbjet për tre vitet e fundit sipas kontabilitetit të plotë vjetor.

	Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A. (e pa aplikueshme)
1.2.2.	Nëse përdorni ambjente magazinimi dhe ju nuk jeni pronar i tyre, ju lutem tregoni nga kush i keni marrë me qera këto ambjente.
1.2.3.	Për secilën nga të mëposhtmet jepni një numër dhe vlerë të përafërt të deklarimeve që ju keni bërë në tre vjetët e fundit. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A. (e pa aplikueshme) • Import • Eksport/Ri-eksport • Tranzit
1.2.4.	Për secilën nga të mëposhtmet jepni një shumë totale të përafërt që ju keni paguar në tre vjetët e fundit. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A (e pa aplikueshme) • Detyrim doganor • Detyrim akcize • TVSH importi
1.2.5.	a) Parashikoni ndryshime strukturale në kompaninë tuaj në 2 vitet e ardhëshme? Po/Jo. Nëse Po përshkruani shkurtimisht ndryshimet. b) Parashikoni ndryshime të mëdha në zinxhirin e furnizimit tuaj në kompani në 2 vitet e ardhëshme? Po/Jo. Nëse Po përshkruani shkurtimisht ndryshimet.
1.3.	**Informacion dhe Statistika për çështje doganore**
1.3.1.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Kryeni formalitete doganore në emrin tuaj dhe për llogari tuajën? b) Përfaqësoheni nga dikush tjetër në lidhje me formalitetet doganore, nëse po nga kush dhe si (direkt apo indirekt)? Ju lutem përfshini emrin, adresën dhe numrin NUIS (NIPT) të përfaqësuesit. c) Përfaqësoni persona të tjerë në formalitetet doganore? Nëse po, kë dhe si (direkt apo indirekt)? (Jepni emrat e kompanive më thelbësore)
1.3.2.	a) Si dhe nga kush vendoset klasifikimi tarifor i mallrave? b) Cfarë masash garancie/sigurie ju merrni për të garantuar që klasifikimet tarfiore janë të sakta (p.sh. verifikime, kontrolle të besueshmërisë, udhëzime të brendshme pune, trajnime të rregullta)? c) Mbani shënime për këto masa garancie/sigurie? d) Monitoroni rregullisht efektivitetin e masave tuaja të garancisë së sigurisë? e) Cfare burimesh përdorni për klasifikimin tuaj tarifor (p.sh. bazë të dhënash për të dhënat për mallrat)?
1.3.3.	a) Si dhe nga kush përcaktohet vlera doganore? b) Cfarë masash garancie/sigurie ju merrni për të garantuar që vlera doganore është përcaktuar sic duhet (p.sh. verifikime, kontrolle të besueshmërisë, udhëzime të brendshme pune, trajnime të rregullta, mjete të tjera)?

	c) Monitoroni rregullisht efektivitetin e masave tuaja të garancisë/sigurisë? d) Mbani shënime për këto masa garancie/sigurie?
1.3.4.	a) Jepni një vështrim të përgjithshëm mbi origjinën preferenciale ose jopreferenciale të mallrave të importuara. b) Cfare masash të brendshme keni implementuar për të verifikuar që vendi i origjinës i mallrave të importuara është deklaruar saktë? c) Përshkruani si lëshoni provën e preferencave dhe certifikatave të origjinës për eksportim.
1.3.5.	Merreni me mallra objekt të detyrimeve anti-dumping ose detyrime të masave kundërbalancuese? Po/Jo. Nëse po, jepni detaje rreth prodhuesit apo vendeve jashtë R.SH. mallrat e të cilave janë objekt i detyrimeve të mësipërme.
2.	**Pajtueshmëria/përputhshmeria e rregjistrime/të dhënave**
2.1.	a) Janë zbuluar shkelje të legjislacionit doganor dhe tatimor brenda kompanisë tuaj ose nga autoritetet doganore në tre vitet e fundit? Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A. Nëse po, përshkruani shkurtimisht shkeljet. b) Ja keni njoftuar shkeljet autoriteteve përkatëse kopetente dhe cfarë masash garantuese keni marrë për të shmangur shkelje të tilla në të ardhmen? Mbani shënime për këto masa garantuese?
2.2.	Ju janë refuzuar aplikime për autorizime/çertifikata apo ju janë pezulluar apo revokuar autorizime egzistuese për shkak të shkeljeve të legjislacionit doganorë dhe tatimore në tre vitet e fundit? Po/Jo. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A Mbani shënime për këto masa garantuese?
3.	**Sistemi i kontabilitetit dhe logjistik**
3.1.	**Gjurmët e auditit**
3.1.1.	Mundëson sistemi juaj i kontabilitetit një gjurmim të plotë auditimi të aktiviteteve tuaja doganore dhe tatimore ose lëvizjeve përkatëse të mallrave ose hedhjeve në kontabilitet? Nëse po, ju lutem përshkruani karakteristikat kryesore të këtij gjurmimi auditimi.
3.2.	**Sistemi i kontabilitetit**
3.2.1.	Çfare sistemi kompjuterik (hardware/software) përdorni në përgjithësi në biznesin tuaj dhe për çështjet doganore në veçanti? Jepni informacion për të mëposhtmet: - ndarjen e funksioneve ndërmjet zhvillimit, testimit dhe operimit

	- ndarjen e funksioneve ndërmjet përdoruesve - aksesin tek kontrollet (cilat/për kë) - gjurmueshmërinë midis sistemit të biznesit dhe sistemit të deklarimit
3.2.2.	Janë sistemet tuaja të kontabilitetit të afta për të dalluar mallrat shqiptare nga ato Jo-shqiptare ? Po/Jo Nëse po, jepni detajet.
3.2.3.	a) Në cfarë ambienti ndërmerren veprimet tuaja kompjuterike? b) Keni aplikime kompjuterike nga burime të jashtme? Nëse po, në cilën kompani të jashtme janë këto aplikime dhe si i menaxhoni kontrollet e aksesit për aplikimet e jashtme?
3.3.	**Sistemi i brendshëm i kontrollit**
3.3.1.	Keni në kompani udhëzime për sistemin e kontrollit të brendshëm në departamentin e kontabilitetit, departamentin e blerjes, departamentin e shitjes, departamentin doganor, prodhim, menaxhimin e materialeve dhe tregtisë dhe logjistikën? Po/Jo. Nëse po përshkruajeni shkurtimisht dhe se si ato përditësohen. P.sh. masat si udhëzime pune, trajnim të punonjësve, udhëzime për verifikimin e gabimeve, dhe mekanizëm për leximin e provave.
3.3.2.	A kanë qënë proçeset tuaja të brendshme të kontrollit objekt i ndonjë auditi te brendshëm/ të jashtëm? Po/Jo. Përfshihet këtu dhe rutina juaj doganore? Po/Jo. Nëse po, jepni një kopje të raportit tuaj më të fundit të auditit.
3.3.3.	Përshkruani shkurtimisht procedurat për verifikimin e dosjeve kompjuterike (standing data) apo dosjet kryesore? Nga këndvështrimi juaj, si i mbulojnë këto procedura rreziqet e mëposhtme : a) Rregjistrim i pasaktë dhe/ose i paplotë i transaksioneve në sistemin e kontabilitetit. b) Rregjistrimi i të dhënave të pasakta ose të vjetra të tilla si numri i artikujve dhe kodet tarifore. c) Kontroll i papërshtatshëm i proçeseve të kompanisë brenda biznesit të aplikuesit.
3.4.	**Fluksi i mallrave**
3.4.1.	Përshkruani shkurtimisht procedurën e rregjistrimit (fizikisht dhe në rregjistra) për fluksin e materialeve, magazinimin nga prodhimi në transportim. Kush i mban rregjistrimet dhe ku ruhen ato?
3.4.2.	Përshkruani shkurtimisht procedurat në vend për verifikimin e niveleve të inventarit, duke

	përfshirë frekuencën e këtyre verifikimeve dhe sesi trajtohen mospërputhjet (p.sh. Marrje në dorëzim dhe inventari)?
3.5.	**Rutinat doganore**
3.5.1.	Keni procedura të dokumentuara për verifikimin e saktësisë së deklarimeve doganore, duke përfshirë ato të paraqitura në emrin tuaj nga, p.sh. agjenti doganor ose spedicioneri? Po/Jo. Nëse po, përshkruani shkurtimisht procedurat. Nëse jo, verifikoni saktësinë e deklarimeve doganore? Po/Jo. Nëse po në cfarë mënyre?
3.5.2.	a) Ka kompania juaj udhëzime apo instruksione për njoftimin e parregullsive tek autoritetet kompetente (p.sh. dyshime për vjedhje, grabitje apo kontrabandë në lidhje me mallrat që kanë të bëjnë me doganat)? Janë të dokumentuara këtu instruksione (p.sh. instruksione pune, manuale, dokumente të tjerë udhëzimi)? b) Gjatë vitit të kaluar, keni zbuluar parregullsi (ose parregullsi të prezumuara) dhe ja keni njoftuar ato autoriteteve kompetente? Po/Jo.
3.5.3.	Tregtoni mallra që janë objekt i licensave tregtare ekonomike p.sh.mbetje, mallra me përdorim të dyfishtë? Po/Jo Nëse po, ju lutem përshkruani shkurtimisht procedurat për administrimin e licensave në lidhje me importin dhe/ose eksportin e këtyre mallrave.
3.6.	**Procedurat për mbështetje (back-up), rikuperimin dhe fallback dhe arkivimin**
3.6.1.	Përshkruani shkurtimisht procedurat për mbështetje (back-up), rikuperim, fallback, arkivim dhe korrigjim të rregjistrimeve të biznesit tuaj.
3.6.2.	Për sa kohë ruhen të dhënat në sistemin e prodhimit dhe për sa kohë arkivohen këto të dhëna?
3.6.3.	A ka kompania një plan emergjence në rast ndërprerje/dështimi të sistemit? Po/Jo
3.7.	**Mbrojtja e sistemeve kompjuterike**
3.7.1.	a) Përshkruani shkurtimisht masat që ju keni marrë për të ruajtur sistemin kompjuterik nga ndërhyrje të paautorizuara (Firewall, programe antivirus, ruajtje të fjalëkalimit/password ...)? b) Keni kryer ndonjë testim ndërhyrje, cilat ishin rezultatet dhe keni marrë masa korrigjimi?
3.7.2.	a) Përshkruani shkurtimisht sa të drejta aksesi për sistemet kompjuterike keni lëshuar? b) Kush është përgjegjës për funksionimin dhe mbrojtjen e sistemit kompjuterik?
3.7.3.	a) Ku vendoset serveri juaj kryesor?

	b) Jepni detaje se si është siguruar serveri juaj kryesor.
3.8.	**Siguria dokumentare**
3.8.1.	Përshkruani shkurtimisht masat që ju keni marrë për të ruajtur (p.sh. të drejtat e kufizuara të aksesit, krijimin e mbështetjes/backup elektronikë) informacionin/dokumentet nga akseset e paautorizuara, abuzimi, shkatërrimi i qëllimshëm dhe humbja?
3.8.2.	Keni pasur në vitin e kaluar ndonjë rast të aksesit të paautorizuar tek dokumentat, dhe nëse po çfarë masash keni marrë për të parandaluar të ndodhte përsëri?
3.8.3.	Ju lutem përgjigjuni shkurt pyetjeve të mëposhtme: a) Cilët kategori punonjësish kanë akses tek të dhënat e detajuara rreth fluksit të materialeve dhe mallrave? b) Cilët kategori punonjësish janë të autorizuar për të ndryshuar këto të dhëna? Janë të dokumentara tërësisht ndryshimet?
3.8.4.	Përshkruani shkurtimisht cfarë kërkesash në lidhje me sigurinë&mbrojtjen kërkoni nga partnerët tuaj të biznesit dhe persona të tjerë kontakti për të shmangur abuzimin me informacionin (p.sh. rrezikimin e zinxhirit të furnizimit nëpërmjet transferimit të paautorizuar të detajeve të transportit)?
4.	**Aftësia paguese financiare**
4.1.	Kane filluar proçedime rreth aftësisë tuaj paguese financiare në lidhje me asetet e kompanisë gjatë tre vjetëve të fundit? Po/Jo. Nëse po jepni detajet.
4.2.	Ka kompania tuaj një situatë financiare të mirë dhe të vazhdueshme, të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj financiare, gjatë tre vjetëve të fundit? Nëse po, jepeni këtë provë me anë të një letre nga auditorët tuaj ose si një raport auditi, një kopje të llogarive tuaja finale (në qoftë se ato nuk janë audituar), provë nga banka ose institucion financiar. Nëse jo, ju lutemi jepni detajet e plota.
4.3.	Nëse jeni një biznes i ri jepni të gjitha rregjistrimet dhe informacionin në lidhje me statusin tuaj financiar, p.sh. fluksin e fundit në cash, bilancin dhe parashikimet e fitimeve dhe humbjeve të miratuara nga drejtorët/partnerët/pronari i vetëm.
4.4.	Ka ndonjë gjë që ju jeni i ndërgjegjshëm që mund të ketë ndikim në aftësinë tuaj paguese në një të ardhme të parashikueshme? Po/Jo. Nëse po, jepni detajet.
5.	**Kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes**
5.1.	**Vetë vlerësimi**

5.1.1.	a) Keni kryer vlerësim të riskut dhe kërcënimit për biznesin tuaj? Po/Jo b) Ka plan sigurie për çdo ambjent (sipas rastit)? Po/Jo Sa shpesh rishikohen dhe përditësohen këto dokumente?
5.1.2.	Përshkruani shkurtimisht çfarë rreziqesh sigurie (brenda kompanisë ose në biznesin tuaj në lidhje me klientët, furnizuesit dhe shërbimet e jashtëme) keni identifikuar në lidhje me kriteret e sigurisë të OEA?
5.1.3.	Si janë implementuar dhe koordinuar masat e sigurisë në kompaninë tuaj dhe kush është përgjegjës për ato?
5.1.4.	Nëse keni disa ambjente të kompanisë tuaj, janë implementuar masat e sigurisë të harmonizuara në të gjitha këto ambjente? Po/Jo
5.1.5.	a) Keni udhëzime për sigurinë? Si ja komunikoni ato stafit tuaj dhe vizitorëve të ambjenteve të kompanisë tuaj? b) Si janë ato të dokumentuara (manual, udhëzim pune, broshurë, etj.)?
5.1.6.	a) Keni pasur incidente gjatë vitit të kaluar? Po/Jo. Nëse po, ju lutem jepni një përshkrim të shkurtër të incidenteve dhe çfarë masash keni marrë që të mos ndodhin përsëri? b) Mbani rregjistrime të incidenteve të ndodhura dhe masave të marra? Po/Jo
5.1.7.	a) Jeni çertifikuar nga ndonjë agjenci apo autoritet tjetër publik për qëllime sigurie (transport)? Po/Jo. Nëse po, ju lutem jepni një kopje të çertifikatës dhe jepni detajet e ambjenteve të cilat mbulohen nga kjo çertifikatë. b) Jepni një listë të standardeve/liçensave/autorizimeve të akredituara në mënyrë të pavarur tek të cilat ju aderoni dhe specifikoni cfarë kontrollesh/auditesh i janë nështruar këto.
5.1.8.	Ka kërkesa të vecanta sigurie dhe mbrojtje për mallrat që ju importoni/eksportoni?
5.1.9.	a) Përdorni shërbime të një kompanie sigurie? Nëse po, cfarë kompanie përdorni. b) Ka bërë kjo kompani një vlerësim të rrezikut të kompanisë tuaj? Nëse po, përshkruani shkurtimisht çfarë rreziqesh sigurie ka identifikuar në lidhje me kriteret e sigurisë së OEA.
5.1.10.	Ju imponojnë klientët apo kompanitë e siguracioneve ndonjë kërkesë sigurie dhe mbrojtje? Po/Jo. Nëse po, jepni detajet.

5.2.	**Aksesi tek ambjentet**
5.2.1.	a) Përshkruani shkurtimisht si është rregulluar proçesi i aksesit/hyrjes në ambjentet e tuaja (ndërtesat, zonat e prodhimit, magazinat, etj.) për stafin, vizitorët, personat e tjerë, makinat dhe mallrat?

	b) Kush kontrollon përputhshmërinë me proçedurat e parashikuara?
5.2.2.	a) Përshkruani procedurat që ndiqen kur zbulohet një person/mjet i paautorizuar në ambjentet e kompanisë (sheshe apo ndërtesa)? b) Si i komunikohen këto procedura stafit (p.sh. plan veprim, manual, udhëzime pune, trajnim)?
5.2.3.	Paraqitni një plan të ambjentit për çdo vendndodhje të kompanisë tuaj që përfshihen në aktivitete në lidhje me doganat (p.sh. planimetri, projekt plan) nga i cili mund të identifikohen kufijtë, rrugët e aksesit dhe vendndodhja e ndërtesave, nëse është rasti.
5.2.4.	Jepni emrat - nëse është rasti - e kompanive (p.sh. kompani të jashtme, pjesë të kompanive të jashtme) që ndodhen në ambjentet tuaja për çdo vendndodhje.
5.3.	**Siguria fizike**
5.3.1.	a) Jepni një përshkrim të shkurtër sesi sigurohen kufijtë e jashtëm të kompanisë. Si kontrollohet përputhshmëria me këto procedura? b) Si, nga kush dhe në çfarë intervalesh kryhen kontrolle tek kangjellat dhe ndërtesat? Si janë këto kontrolle dhe si rregjistrohen? c) Si raportohen incidentet me sigurinë dhe si mereni me ato?
5.3.2.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Cfarë mundësish aksesi hyrje-dalje egzistojnë? b) Si mbikqyren këto? Ka kufizime gjatë orarit të punës për çdo akses hyrje-dalje ?
5.3.3.	Janë të ndricuara mjaftueshëm ambjentet (p.sh. dritë e vazhdueshme, sensorë lëvizjesh, drita të ndjeshme)?
5.3.4.	Si kryhet administrimi i celsave në kompani (p.sh. ambjenteve, aksesi, logging)? Ka dokumentim me shkrim për këtë? Po/Jo
5.3.5.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Lejohet parkimi i makinave private në ambjente? b) Nëse po, për cilët persona? c) Kush jep miratimin? d) Kontrollohen makinat (në hyrje të ambjenteve apo në hyrjen në zonën e parkimit)? Egzistojnë rregullore të shkruara? Po/Jo
5.4.	**Njësitë e kargos (si konteinerë, rama, kuti transporti)**
5.4.1.	I nështrohet aksesi tek njësitë e kargos rregullave/kufizimeve? Po/Jo Nëse po, si zbatohen këto kufizime?

5.4.2.	Përshkruani shkurtimisht çfarë masash ekzistojnë për të parandaluar hyrjen e paautorizuar dhe ndërhyrjet tek njësitë e kargos (vecanërisht në zona të hapura magazinimi) (p.sh. mbikqyrje e vazhdueshme, trajnim i stafit dhe bërja e tyre e ndërgjegjshme ndaj rreziqeve, plumbcet, udhëzime për procedurat e ndjekura në rast hyrje të paautorizuar)?
5.4.3.	a) Përdorni plumbçe për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara tek mallrat? Nëse po, cfarë lloji? Përmbushin këto plumbce ndonje standard specifik (p.sh. ISO)? b) Si e garantoni që nuk ndërhyet tek mallrat nëse nuk përdoren plumbçet?
5.4.4.	Cfarë masash kontrolli përdorni për të kontrolluar njësitë e kargos (p.sh. procesin e inspektimit shtatë-pikësh: pjesa ballore, ana e majtë, ana e djathtë, dyshemeja, mbulesa/tavani, dyert e jashtme/të brendshme, jashtë/shasitë)?
5.4.5.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Kush është pronari/operatori i njësive të kargos? b) Kush mirëmban/riparon njësitë e kargos? c) Ka plane të rregullta mirëmbajtje ? Kontrollohen punët e mirëmbajtjes nga jashtë?

5.5.	**Proceset logjistike**
5.5.1.	a) Cfarë mjetesh transporti përdoren normalisht nga kompania tuaj? b) E kryen vetë kompania të gjithë transportin apo përdor gjithashtu shërbime të jashtme (p.sh. spedicionerë/transpotues)? c) Si e përcaktoni nëse spedicioneri/transportuesi i përmbush standardet e sigurisë të kërkuara (p.sh. me anë të një certifikate sigurie, deklarate apo marrëveshje)? d) Merrni masa të tjera për transportin e jashtëm me vështrim ndaj përmbushjes së standardeve të sigurisë? Nëse është rasti, ju lutem jepni natyrën dhe qëllimin e këtyre masave.

5.6.	**Kërkesa jofiskale**
5.6.1.	a) Merreni me mallra me përdorim të dyfishtë dhe/ose mallra për të cilat kërkohet licensë importi apo mallra që i nënshtrohen kufizimeve të eksportit apo embargove ose kërkesave të tjera jofiskale? Nëse po, përshkruani shkurtimisht procedurat që ju përdorni për të garantuar përputhjen me dispozitat përkatëse në lidhje me këto mallra (p.sh. menaxhimi i licensave, autorizimeve, përgjegjësive të vecanta, staf i trajnuar vecanërisht, etj.)? b) Ka udhëzime të vecanta pune, manuale apo udhëzime të tjera në kompani rreth këtyre mallrave? Po/Jo

5.7.	**Hyrja e mallrave**

5.7.1.	a) Përshkruani shkurtimisht procedurën për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes për mallrat që hyjnë? b) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.7.2.	Janë të informuar punonjësit tuaj rreth marrëveshjeve të sigurisë me furnizuesit dhe sesi garantohet kjo përputhshmëri?
5.7.3.	a) Përshkruani shkurtimisht sesi kryhen kontrollet për integritetin e plumbçeve tek mallrat që hyjnë? b) Janë të plumbosura mallrat që hyjnë, sipas rastit? Po/Jo Nëse po, cfarë rutine/masash keni?
5.7.4.	Shënohen mallrat që hyjnë në mënyrë uniforme apo magazinohen në vende të vecanta? Po/Jo Nëse po, si shënohen/ku magazinohen?
5.7.5.	Përshkruani shkurtimisht procesin për numërimin dhe peshimin e mallrave që hyjnë?
5.7.6.	Përshkruani shkurtimisht sesi, kur dhe nga kush kontrollohen mallrat që hyjnë përkundrejt dokumentave shoqëruese dhe sesi hidhen në rregjistra?
5.7.7.	a) Janë sektorët të ndarë qartë për blerjen e mallrave, marrjen e mallrave dhe administrimin e përgjithshëm? Po/Jo b) Egziston mekanizëm i brendshëm kontrolli ndërmjet sektorëve? Po/Jo. Nëse po, si kryhen ato?

5.8.	**Magazinimi i mallrave**
5.8.1.	Ju lutem përshkruani shkurtimisht në cilat ambjente ju keni zona të mënjanuara për magazinimin e mallrave?
5.8.2.	a) Ju lutem përshkruani shkurtimisht rutinën për caktimin e ambjentit të magazinimit për mallrat që hyjnë. b) Keni ambjente magazinimi të hapura? Po/Jo. Nëse po, ju lutem përshkruajini ato shkurtimisht.
5.8.3.	Keni procedura të dokumentuara për inventarizimin dhe që merren me parregullsitë gjatë inventarizimit? Po/Jo Nëse po, ju lutem përshkruani shkurtimisht ato.
5.8.4.	Magazinohen vecmas mallrat me nivele të ndryshme risku? Po/Jo a) Ju lutem përshkruani kriteret për cdo magazinim të vecantë (p.sh. mallra të rrezikshme, mallra me vlerë të lartë, kimikate, armë)? b) Ju lutem përshkruani sesi ju garantoni që mallrat rregjsitrohen menjëherë në llogaritë logjistike/inventarët?
5.8.5.	a) Përshkruani shkurtimisht sesi mbrohen mallrat ndaj hyrjeve të paautorizuara në ambjentet e magazinimit?

	b) Përshkruani shkurtimisht si kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.8.6	Nëse magazinoni mallrat jashtë tek një palë e tretë/shërbim i jashtëm, ju lutem përshkruani shkurtimisht si dhe ku magazinohen mallrat dhe masat e juaja të kontrollit që përdorni për mbikqyrjen e trajtimit të mallrave.
5.9.	**Prodhimi i mallrave**
5.9.1.	a) Përshkruani shkurtimisht çfarë ambjentesh/zona përcaktoni për prodhimin e mallrave? b) Nëse prodhimi kryhet nga një partner i jashtëm (p.sh. punë përpunimi, dërgesa), përshkruani shkurtimisht sesi garantoni integritetin e mallrave (p.sh. marrëveshje kontraktuale)?
5.9.2.	Keni masa sigurie për mbrojtjen e mallrave ndaj hyrjeve të paautorizuara në zonën e prodhimit? Po/Jo. Nëse po, përshkruani shkurtimisht cfarë masash janë dhe nëse egzistojnë me shkrim. Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.9.3.	Përshkruani shkurtimisht procedurat për produktet e paketuara dhe nëse egzistojnë me shkrim.
5.9.4.	Nëse produkti final paketohet në një palë të tretë, përshkruani shkurtimisht sesi garantoni integritetin e mallrave?
5.10.	**Ngarkimi i mallrave**
5.10.1.	a) Përshkruani shkurtimisht si menaxhohet ngarkimi i mallrave në kompaninë tuaj (p.sh. caktimi i përgjegjësive, kontrolli i mallrave dhe mjeteve të transportit, rregjistrimi i rezultateve, sigurimi i informacionit, etj.)? b) Ka udhëzime me shkrim sesi të organizohet procesi? Po/Jo
5.10.2.	a) Plumbosen mallrat apo mjetet që dalin? Po/Jo? Nëse po, si, nga kush dhe cfarë lloj plumbçesh përdoren? b) Përmenden numrat e plumbçeve në dokumentat shoqëruese të mallrave? Po/Jo c) Si mbani rregjistrimet e plumbçeve tuaja?
5.10.3.	Përshkruani shkurtimisht sesi garantoni përputhshmërinë me kërkesat e sigurisë së klientëve për ngarkimin e mallrave?
5.10.4.	Përshkruani shkurtimisht rregullimet që keni të cilat garantojnë që mallrat ngarkohen dhe proceset e ngarkimit nuk lihen të pambikqyrura.
5.10.5.	Kontrollohen mallrat që dalin për plotësinë e tyre (p.sh. të numëruara, të peshuara)? Po/Jo Nëse po, si dhe nga kush?
5.10.6.	Përshkruani shkurtimisht si, kur dhe nga kush kontrollohen mallrat që dalin ndaj porosive dhe listave të ngarkimit dhe c'rregjistrimi nga inventari?

5.10.7.	Përshkruani shkurtimisht çfarë mekanizmash kontrolli keni për zbulimin e parregullsive në lidhje me ngarkimin e mallrave?

5.11.	**Kërkesa sigurie për partnerët e biznesit**
5.11.1.	a) Përshkruani shkurtimisht çfarë kërkesash sigurie dhe mbrojtje aplikoni kur zgjidhni partnerët tuaj të biznesit (p.sh. deklarata sigurie, kërkesa kontraktuale, partnerë tregtarë me status të OEA)? b) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.11.2.	Përshkruani shkurtimisht sesi kompania tuaj identifikon partnerët tregtarë për të siguruar zinxhirin e furnizimit (kërkim informacioni përpara pranimit të porosive apo dhënies së porosive).
5.11.3.	Gjatë vitit të kaluar, keni zbuluar ndonjë shkelje të marrëveshjeve të sigurisë me partnerët tuaj? Po/Jo. Nëse po, çfarë masash keni marrë?

5.12.	**Siguria e personelit**
5.12.1.	a) Përshkruani shkurtimisht sesi politika tuaj e punësimit merret me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes? Kush është përgjegjës për këtë fushë? b) Rregjistrohen procedurat e sigurisë me shkrim? Po/Jo. c) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.12.2.	Në çfarë mase janë objekt i kontrolleve të sigurisë grupet e mëposhtëm të punonjësve (p.sh. verifikime policore për të konfirmuar nëse ai/ajo ka kryer vepra penale): a) punonjësit e rinj që do punojnë në fusha sigurie-sensitive b) punonjës egzistues që transferohen në fusha sigurie-sensitive. Si garantohet që kur largohet stafi ata të mos kenë më akses fizik apo elektronik në ambjentet apo të dhënat e kompanisë?
5.12.3.	Jepet trajnim për punonjësit në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen? Po/Jo. Nëse po: a) Cila është frekuenca e trajnimve të sigurisë dhe mbrojtjes? b) Keni freskime të përvitshme të trajnimeve? Po/Jo. c) Ky trajnim është i brendëshëm apo sigurohet nga jashtë? d) Ka rregjistrime me shkrim për trajnimet? Po/Jo.
5.12.4.	Ju lutem përgjigjuni me shkrim pyetjeve të mëposhtme: a) Specifikoni fushat ku përdoren punonjës të përkohshëm? b) Kontrollohen rregullisht këta punonjës në përputhje me standardet e sigurisë? Nëse po, si dhe nga kush? Keni gjithashtu udhëzime sigurie për këta punonjës?

5.13.	**Shërbime të Jashtme**

5.13.1.	Përdorni "shërbime të jashtme" me kontratë, si transportim, roje sigurie, pastrim, furnizime, mirëmbajtje etj.? Po/Jo. Nëse po: a) Përshkruani shkurtimisht çfarë shërbimesh ju sigurojnë ato dhe në çfarë mase (për ato që nuk janë shpjeguar në seksionet e mëparshme). b) Keni marrëveshje me shkrim me siguruesit e shërbimeve të jashtme që përmbajnë kërkesa sigurie? Po/Jo. c) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me procedurat e përfshira në këto marrëveshje?

5.14	**Standarted praktike dhe profesionale**

a) Përshkruani shkurtimisht se si politika e punësimit merret me kërkesat për standartet dhe kualifikimet profesionale. Kush është përgjegjës për këtë fushë?
b) Cili është programi i trajnimit i ndjekur, testimi i dhënë, insticioni apo qëndra arsimore/shoqata profesionale që e ka dhënë këtë trajnim?
c) Numri i punonjësve, emrat dhe pozicioni i punës aktual?
d) Dëshmitë e marra dhe kopje të tyre.

Shënimet shpjeguese për Pyetësorin e Vetë-Vlerësimit të OEA

Qëllimi i Aneksit 13, "Pyetësori i Vetë-vlerësimit" është për të mundësuar vlerësimin e kërkesave në lidhje me përfitimin e statusit të OEA dhe për t'i dhënë Autoriteteve Doganore informacion rreth jush dhe biznesit tuaj që hidhet në aplikim. Informacioni i dhënë në Pyetësorin e Vetë-vlerësimit për OEA nga operatori ekonomik gjithashtu do të përdoret në proçeset e dhënies së autorizimeve të tjera në të cilat është e nevojshme për të qenë në përputhje me disa apo të gjitha kriteret e OEA. Këto udhëzime ju japin drejtimin sesi t'i përgjigjeni pyetjeve si edhe informacionin për standardet që Autoritetet Doganore presin që Ju të arrini dhe të demonstroni për të fituar autorizimin e OEA.

1. Pyetësori i vetëvlerësimit është ndërtuar mbi dispozitat e Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikes së Shqipërisë", thjeshton dhe përshpejton proçesin e aplikimit për OEA.

   Për këtë arsye administrata doganore kërkon që operatorët ekonomikë të përdorin këtë pyetësor për të verifikuar gadishmërinë e tyre për të përmbushur kriteret e OEA.

   Kjo gjithashtu lejon Administratën Doganore të marrë një informacion të përgjithshëm për aplikuesin së bashku me aplikimin dhe kjo do të çojë në përshpejtimin e proçesit. Operatoret ekonomik janë të ftuar të plotësojnë saktësisht pyetësorin dhe t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve përkatëse për biznesin e tyre.

   Ju mund të gjeni informacion shtesë rreth OEA në faqen e internetit të administratës doganore.

   Ju lutem, keni kujdes që është e rëndësishme të lexoni legjislacionin e zbatueshëm përpara fillimit të proçesit të aplikimit.

2. Pyetesori duhet të dorëzohet së bashku me aplikimin për një Autorizim OEA sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 12 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (mënyra e dorëzimit varet nga mënyrat që përdor D.P.D.).

   Rekomandohet që të kontaktohet D.P.D. nëse keni pyetje apo shënime rreth pyetësorit ose aplikimit përpara dorëzimit të tyre.

3. Pyetësori përmban çështjet më të rëndësishme që mund të përdoren nga administrata doganore për çdo seksion. Megjithatë, disa nga çështjet ndikojnë vetëm në aktorë të caktuar të zinxhirit të furnizimit. Pyetjeve që nuk i përkasin biznesit tuaj nuk është e nevojshme t'i përgjigjeni. Kjo gjithashtu mund të ndryshojë në varësi të llojit të Autorizimit që aplikoni. Ju lutem përgjigjuni këtyre çështjeve me "E paaplikueshme(N/A)" me një koment të shkurtër pse është e paaplikueshme. Ju mund gjithashtu të bëni referim p.sh. tek pjesa e zinxhirit të furnizimit që jeni përfshirë ose për llojin e Autorizimit që aplikoni.

   Nëse ju keni aktualisht thjeshtime doganore ose autorizime të tjera doganore që demonstrojnë që një apo më shumë kritere të OEA përmbushen, atëhere është e mjaftueshme t'u referoheni këtyre thjeshtimeve apo autorizimeve.

   Nëse kompania juaj ka çertifikata, raporte ekspertësh ose përfundime të tjera të nxjerra nga ekspertë (p.sh. komente ekonomike, çertifikata ndërkombëtare, etj. Për më shumë referenca

shikoni seksionin korrespondues në Udhëzimet për OEA), të cilat mbulojnë pjesërisht ose plotësisht kritere të caktuara, ju lutem tregojeni këtë në përgjigjet e pyetjeve përkatëse. Ju lutem kini kujdes se kjo nuk është e nevojshme, por nëse keni ndonjë prej tyre ky mund të jetë informacion i dobishëm për doganat dhe mund të çojë në përshpejtimin e proçesit.

4. Duhet të vihet re që përgjigjet individuale të pyetjeve nuk konsiderohen të veçuara, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm në lidhje me kriterin. Një përgjigje e pakënaqshme e një pyetje të vetme nuk mund të çojë në refuzimin e statusit të OEA, nëse kriteri tregohet i plotësuar në një vend tjetër gjatë proçesit (në terma të përgjithshëm).

5. Kushtet dhe kriteret për një Autorizim OEA janë të gjitha të njëjta për të gjithë operatorët. Megjithatë, doganat do të marrin në konsideratë madhësinë e kompanisë (SMEs – ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme), statusin ligjor të kompanisë, strukturën, partnerët kyçë të biznesit dhe gjithashtu degët. Kjo nënkupton që implementimi i masave për të plotësuar kriteret mund të ndryshojë për shembull nga një operator në një operator tjetër në varësi të madhësisë, pa anashkaluar pajtueshmërinë me kërkesat.

6. Një Autorizim OEA mbështetet mbi të njëjtat parime si të gjitha standardet e tjera ndërkombëtare dhe nëse standardet e brendshme të sigurimit të cilësisë janë duke u zbatuar nga kompania. Ju jeni përgjegjës për të patur procedura të sigurimit të cilësisë në ambjentet tuaja për çështje doganore, si edhe të sigurisë dhe mbrojtjes (nëse është rasti). Në vizitat në terren kompania tuaj duhet t'i tregojë administratës doganore që ju keni procedura të brendshme të përshtatshme në vend për të menaxhuar çështjet doganore dhe/ose të sigurisë dhe mbrojtjes, si edhe kontrolle të duhura të brendshme për të garantuar që këto procedura funksionojnë siç duhet. Politikat e brendshme dhe/ose udhëzimet duhet të dokumentohen elektronikisht ose në letër. Ato duhet të njihen brenda kompanisë, të jenë në dispozicion të të gjithë përdoruesve dhe sigurisht të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme.

   Për këtë, hapi i parë ka lidhje me standardet e brendshme të sigurisë së cilësisë. Përgjigjet në pyetësor së bashku me aplikimin e dorëzuar duhet të jenë një përmbledhje e procedurave dhe udhëzimeve të brendshme që ju keni për t'i dhënë administratës doganore një vështrim të përgjithshëm të biznesit tuaj. Për t'ju përgjigjur pyetësorit dhe për t'u përgatitur për auditimin e proçesit të OEA, të gjitha departamentet kryesore të biznesit tuaj të përfshira në zinxhirin e furnizimit (doganat, logjistika, financa/kontabiliteti, kompjuterizimi, blerjet, shitjet, siguria, departamenti i cilësisë, etj.) duhet të përfshihen në proçes.

7. Politikat e brendshme të kompanisë dhe udhëzimet në lidhje me çështjet doganore dhe/ose të sigurisë dhe mbrojtjes mund të referohen në përgjigjet e pyetësorit. Nëse veproni kështu, ju lutem specifikoni emrin ose numrin e dokumentit dhe mbaheni gati për auditimin në terren nga administrata doganore. Për të përshpejtuar proçesin është gjithashtu e mundur të dorëzoni dokumentat (mënyra e dorëzimit do të varet nga mënyrat që përdor D.P.D.) së bashku me pyetësorin.

8. Pyetësori i plotësuar së bashku me dokumentat mbështetëse të kërkuara duhet t'i vihet në dispozicion D.P.D. në mënyrë elektronike (e preferueshme) ose me shkrim.

9. Informacioni i dërguar brenda proçesit të aplikimit është sipas legjislacionit të sigurisë së të dhënave dhe do të trajtohet në mënyrë konfidenciale.

Seksioni 1 Informacioni i kompanisë

